



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “BashkinëTropojë”

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
“FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË”
TË USHTRUAR NË BASHKINË TROPOJË”**

Nr.	Përmbajtja	Faqe
	Legjenda dhe shkurtime	1-3
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3-3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-8
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	8-11
II.	HYRJA	
1.	Objekti i auditimit	11-11
2.	Qëllimi i auditimit	12-12
3.	Identifikimi i çështjes	12-12
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	12-12
5.	Përgjegjësitë e audituesve	13-14
6.	Kriteret e vlerësimit	14-14
7.	Standardet e auditimit	14-14
8.	Metodat e auditimit	15-15
9.	Dokumentimi i auditimit	15-16
	III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	
	-Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	16-16
	-Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	
	1. Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm	16-19
	2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit	19-55
	3. Vlerësimi i raportimit financiar	55-88
	4. Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike dhe zbatimi i kontratave të punëve publike	88-179
	5. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshme	179-206
	6. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e teritorit	207-212
	IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	215-239
	V. ANEKSE	239-323

Shkurtime

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.

UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
IT	Teknologjia e Informacionit.
NJA	Njësi Administrative.
SHA	Shoqëri Anonimë.
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
OE	Operator Ekonomik.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Në zbatim të Programit të Auditimit nr.361/1 , datë 06.04.2021, shkresës nr.361/2 prot., datë 16.04.2021, me lëndë òNjoftimit për ndryshim në programin e auditimit nr.361/1 prot., datë 06.04.2021ò, si dhe shkresës nr.361/3 prot., datë 06.05.2021 me lëndë òNjoftimit për ndryshim në programin e auditimit nr.361/1 prot., datë 06.04.2021ò, miratuar nga Kryetari i KLSH,nga data 07.04.2021, deri më datën 04.06.2021në institucionin Bashkia Tropojëu krye në teren auditimi òFinanciar dhe i përputhshmërisë.

Auditimi mbuloi periudhën nga data01.01.2019 deri më datën 31.12.2020dhe u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit si: menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, vlerësimi i pasqyrave financiare, prokurimet publike, të ardhurat, zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, si dhe mbi planifikimin dhe zhvillimin e teritorit. Për përfitimin e rezultateve të auditimit, grupi i auditimit u mbështet mbi dy elementë: në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe në punën konkrete mbi evidencat e auditimit, por kryesisht mbi këtë të fundit. Audituesit janë kujdesur që evidencat me të cilat kanë punuar për të argumentuar rezultatet e auditimit, të plotësonin tre cilësi: të ishin të përshtatshme (të kishin lidhje me çështjen që auditohej), të besueshme (burimi nga vjen evidenca të ketë besueshmëri) dhe të mjaftueshme (sasia e evidencës të jetë e mjaftueshme për arritjen e konkluzioneve të auditimit). Në përfundim të punës audituse në terren, nga grupi i auditimit janë mbajtur dhe protokolluar në subjekt 10 akt konstatime dhe 2 akt verifikime dhe pas kryerjes së takimit përmbyllës mes palëve nga subjekti u paraqitën kundërshtitë për aktet e mbajtura. Pas hartimit të akteve të konstatimit dhe projektraportit, nga subjekti i audituar janë bërë kundërshti, të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit dhe janë bërë pjesë të naterialit në projektraport dhe në raportin përfundimtar të auditimit.

Auditimi në teren ka filluar në datën 07.04.2021 dhe ka përfunduar në datën 04.06.2021.

Projektraporti i auditimit është nisur në subjekt më shkresën nr.361/13 prot., datë 24.06.2021. Me shkresën nr. 935/40, datë 28.06.2021 (të dhëna të subjektit), protokolluar në KLSH me 361/14 prot, datë 01.07.2021, Bashkia Tropojë ka kthyer përgjigje se është njohur me projektraportin e auditimit në datën 28.06.2021.

Në vijim nga Bashkia Tropojë janë paraqitur në KLSH observacione lidhur me projektraportin e auditimit.

Në datën 26.07.2021 në ambientet e KLSH është realizua takimi përmbyllës midis përfaqësuesve të Bashkisë Tropojë dhe KLSH, për të cilin është mbajtur protokoli përkatës.

2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
<p>1.Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Tropojë janë konstatuar anom. materiale në sistemin e kontrollit të brendshëm. Politika dhe praktika e burimeve njerëzore nuk garanton ruajtjen dhe zhvillimin profesional të stafit, pasi nuk ka programe trajnimi për punonjësit, për të ngritur në vazhdimësi nivelin e tyre profesional. Për periudhën 01.01.2019-31.12.2020 kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës 156 punonjës, që përbën rreth 45% e numrit total të punonjësve gjë e cila përbën një risk përsa i përket përvojës së punës dhe nivelit profesional të punonjësve.</p> <p>Nuk ka një dokument të shkruar (akt të brendshëm administrativ), i cili të përcaktojë detyrimet që ka punonjësi dhe veprimet që ai kryen përpara largimit, si dhe detyrat që ka institucioni (njësia e burimeve njerëzore dhe financa) në këtë proces.</p> <p>Nuk është miratuar strategjia e menaxhimit të riskut, nuk janë identifikuar aktivitete me risk, si dhe nuk janë marrë masa për menaxhimin e tij.</p> <p>Nuk janë miratuar gjurmët e auditimit për proceset kryesore të punës.</p> <p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 16, 20, 21, 22, 23 dhe 24 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 dhe Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ligjin nr. 68/2017 dhe Për financat e vetëqeverisjes vendore, neni 32.</p>	16-19	<i>E lartë</i>	<p>1.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Tropojë dhe menaxherët kryesorë të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë vendore. Të hartohen rregulla për ruajtjen e aktiveve, për llojet e raporteve, frekuencën e raportimit me shkrim të Titullari nga secila drejtori/sector, etj. Të hartohet regjistri i riskut në nivel sektori, drejtorie dhe institucioni, gjurma e auditimit dhe lista (harta) e proceseve të punës.</p>
<p>2.Gjetje nga auditimi Në Bashkinë Tropojë Njësia e Auditimit të Brendshëm ka funksionuar deri në muajin maj të vitit 2020.</p> <p>Aktualisht Bashkia Tropojë nuk ka njësi të auditit të brendshëm, duke mos u mbuluar me këtë shërbim për shkak se kjo strukturë është hequr nga Kryetari i Bashkisë për performancë të dobët..</p> <p>Shkrirja e Njesisë së Auditit të Brendshëm është në kundërshtim me nenin 49 të ligjit 68/2017 dhe Për financat e vetëqeverisjes vendore, si dhe pikën 1 të VKM nr.83, datë 03.02.2016 dhe Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të brendshëm në sektorin publik, ku përcaktohet se në çdo njësi të vetëqeverisjes vendore krijohet njësi e auditimit të brendshëm.</p>			<p>2.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Tropojë të marrë masa për organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm në bashki, duke krijuar Njësine e Auditimit të Brendshëm brenda strukturës organizative të Bashkisë Tropojë.</p>

<p>3.Gjetje nga auditimi:Referuar të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve për periudhën 01.01.2019 ó 31.12.2020, u konstatua se nga 17 procedura prokurimi të vlerësuara për auditim, me vlerë të lidhjes së kontratës 588,555,120 lekë, janë konstatuar me shkelje të aktive ligjore/nënligjore të LPP, 16 procedura prokurimi me vlerë kontrate 579 milion lekë ose 98% e vlerës së audituar. Këto shkelje e mangësi rezultojnë në mos argumentimin e kriterëve të veçanta për kualifikim, vendosjen e tyre jo në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit dhe grafikun e punimeve, veprime në kundërshtim me nenin 1 <i>Objekti dhe qëllimi</i>, pika 2 e nenit 2 <i>Parimet e përzgjedhjes</i>, pika 1, e nenit 46, të ligjit nr. 9643, datë 20.01.2006, ndryshuar si dhe me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 <i>Për miratimin e rregullave të prokurimit publik</i>, i ndryshuar, Seksioni II, <i>Informacione të veçanta për kontratat</i>, neni 26 <i>Kontratat për punë publike</i>, pika 7 dhe Kreu VII, <i>Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave</i>, neni 61, <i>Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit</i>, pika 2, paragrafi 2, si dhe me aktet e tjera ligjore e nënligjore të trajtuara sipas rastit në çdo procedurë prokurimi të audituar. Vendosja e kriterëve në mënyrë të tillë ka sjellë një pjesëmarrje të ulët të OE në procedurat e prokurimit.</p>	88-170	<i>E lartë</i>	<p>3.1.Rekomandim:Autoriteti Kontraktor Bashkia Tropojë të analizojë situatën e të nxjerrë përgjegjësitë për përcaktimet e gabuara të kriterëve të veçanta për kualifikim dhe të marrë masa që përcaktimi e kriterëve për kualifikim të jetë në lidhje të ngushtë me objektin e procedurës së prokurimit.</p>
<p>4.Gjetje nga auditimi:Në auditimin e procedurës me objekt <i>Shkolla Asim Vokshi ó Palestër dhe terrene sportive dhe sistemime të jashtme në gjimnazin óAsim Vokshi</i>, zhvilluar në vitin 2019, me fond limit 50,319,591 lekë pa TVSh, nga KVO është kualifikuar dhe shpallur fitues OE <i>4.Mö ShPK</i>, me vlerën më të lartë të ofertës ekonomike prej 50,269,533 lekë pa TVSh, i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në DST. Nga KVO është <i>s</i>kualifikuar padrejtësisht oferta me vlerë 42,072,833 lekë pa TVSh, e paraqitur nga BOE <i>1.ö shpk & öSh.ö ShPK</i>, e cila ka një vlerë prej 8,196,700 lekë më të ulët se vlera e OE <i>4.Mö ShPK</i> të shpallur padrejtësisht fitues. Veprimet e mësipërme kanë shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 8,196,700 lekë, si diferencë midis dy ofertave dhe janë kryer në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 <i>Për prokurimin publik</i>, i ndryshuar, neni 1 <i>Objekti dhe qëllimi</i> pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 <i>Parimet e përzgjedhjes</i> germa (a), (b) dhe (c), me nenin 46 <i>Kualifikimi i ofertuesve</i>, nenin 53 <i>Shqyrtimi i ofertave</i> dhe nenin 55 <i>Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese</i>. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4 faqe 100-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)</p>	110-115	<i>E lartë</i>	<p>4.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Tropojë, të analizojë shkaqet që kanë çuar në kualifikimin e padrejtë të OE <i>4.Mö ShPK</i>, dhe në <i>s</i>kualifikimin e padrejtë të BOE <i>1.ö shpk & öSh.ö ShPK</i>, me ofertë më të ulët, veprime të cilat kanë shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 8,196,700 lekë. Të ndjek të gjitha procedurat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës 8,196,700 lekë, në vlerë të barabartë prej 2,732,233 lekënga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave si vijon: z. R. I. me detyrë ish Drejtor Ekonomik, ndërprerë marrëdhëniet e punës, z. R. B. me detyrë is Z/Kryetar i Bashkisë, ndërprerë marrëdhëniet e punës, z. Z. Ç., me detyrë ish Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse, ndërprerë marrëdhëniet e pun</p>
<p>5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit publik rezultoi se operatorët ekonomikë janë shpallur fitues edhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DST, të</p>	88-170	<i>E lartë</i>	<p>5.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Tropojë të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin</p>

<p>miratuara nga Autoriteti Kontraktor dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, òPër prokurimin publikòndryshuar dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij, duke sjellë shpalljen e fituesit të procedurës së prokurimit në mënyrë të paligjshme, për vlerë kontrate pa TVSh 518,815,711 lekë. Kjo anoM. për vitin 2019 është konstatuar në 10 procedura prokurimit me shumë të fondit limit 99,338,203 lekë, ndërsa për vitin 2020 është konstatuar në 3 procedura prokurimit me shumë të fondit limit 419,477,508 lekë,</p>			<p>dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST. Të merren masa për eliminimin këtyre praktikave në të ardhmen</p>
<p>6.Gjetje nga auditimi:Bashkia Tropojë nuk ka marrë masa të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, pasi vlera e tyre në fund të vitit 2020 ka pësuar ulje vetëm prej 1,688,825 lekë, krahasuar me vitin 2019, ose në masën 1%. Vlera e detyrimeve të prapambetura të raportuar në MFE nuk është e plotë, pasi kjo vlerë është më e ulët dhe nuk rakordon me vlerën që pasqyrojnë pasqyrat financiare. Në datën 31.12.2019 në MFE është raportuar vlera e detyrimeve të prapambetura 109,616,278 lek, ndërsa nga auditimi i pasqyrave financiare kjo vlerë është 123,151,017 lekë, ose 13,534,739 më shumë (llogaria 401-408 -Furnitorë e llogari te lidhura me to në vlerën 110,112,904 lekë dhe llogaria 467 -Kreditore te ndryshëm në vlerën 13,038,113 lekë). Të gjitha këto detyrime kanë si shkak marrjen e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, pasi duhej të mbuloheshin nga të ardhurat e veta. Bazuar në shkresën e Bashkisë Tropojë nr.356/1 prot., datë 03.03.2021, drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, konstatohet se vlera e detyrimeve të prapambetura, me burim financimi të ardhurat e veta në datën 31.12.2020 është 75,620,737 lekë, e cila përbëhet nga: - detyrimet për shpenzimet kapitale në vlerën 65,316,107 lekë, ose 86% të totalit të detyrimeve; - detyrimet korente në vlerën 3,574,046 lekë, ose 5% të totalit të detyrimeve; - detyrimet për vendimet gjyqësore në vlerën 6,730,584 lekë, ose 9% të totalit të detyrimeve. Edhe për vitin 2020 vlera e detyrimeve të prapambetura të raportuar në MFE nuk është e plotë, pasi kjo vlerë është më e ulët dhe nuk rakordon me vlerën që pasqyrojnë pasqyrat financiare, e cila është 121,462,192 lekë, ose 45,841,455 më shumë (llogaria 401-408 -Furnitorë e llogari te lidhura me to në vlerën 108,423,719 lekë dhe llogarisë 467 -Kreditore te ndryshëm në vlerën 13,038,113 lekë). Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHò, i ndryshuar, neni 40 , neni 52, UMF nr. 5, datë 27.02.2014 òPër shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaò i ndryshuar, UMF nr.9, datë 20.03.2018 òPër procedurat standarde të miratimit të buxhetitò, neni 101 dhe 106</p>	31-33	<i>E lartë</i>	<p>6.1.Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Tropojë të analizohet situata e detyrimeve të prapambetura dhe të nxirren përgjegjësitë për këtë situatë. Të mos marren angazhime te reja buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, në mënyrë që të mos krijohen detyrime të reja në vijimësi. Për detyrimet e prapambetura, të hartohet një grafik për likuidimin e tyre, duke zbatuar radhën e pagesave sipas kronologjisë së tyre. Të paraqitet në mbledhjen e këshillit bashkiak një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara si dhe planin dhe grafikun për likuidimin e tyre</p>
<p>7.Gjetje nga auditimi: Komisioni i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi për vitin 2019, për llogarinë 218 óInventar ekonomik (orendi zyre etj.), ka vlerësuar 679 aktive për tu nxjerrë jashtë përdorimit (me</p>	78-80	<i>E lartë</i>	<p>7.1.Rekomandim: Drejtoria ekonomike të marrë masa që në rastet e kryerjes së procesit të vlerësimit të</p>

<p>destinacion për asgjësim dhe skrap), kryesisht orendi shkollë si tavolina, karrige, banka, dollap, krevat hekuri, dyshek, por edhe disa paisje informatike si kompjuter, printer e fotokopje. Në datën 31.12.2019, vlera bruto e këtyre aktiveve është 18,459,741 lekë, ndërsa vlera e mbetur 9,386,124 lekë.</p> <p>Për vitin 2020 komisioni i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi ka vlerësuar 150 aktive të llogarisë ekonomike 218 óInventar ekonomik (orendi zyre etj.), për tu nxjerrë jashtë përdorimit (për asgjësim dhe skrap), në vlerën 1,744,596 lekë, vlerë të mbetur 338,656 lekë.</p> <p>Në listën e hartuar nga komisioni i vlerësimit për të dy vitet 2019 dhe 2020, jo të gjitha aktivet që janë vlerësuar për dalje nga përdorimi kanë plotësuar kohën e shfrytëzimit të tyre, në bazë të normave të amortizimit, pasi disa aktive nuk janë amortizuar plotësisht, ndërsa disa të tjera janë pa vlerë amortizimi, pra vlera bruto është e barabartë me vlerën neto, mungon viti i vënies në punë të aktivitetit, si dhe koha e shfrytëzimit të tij.</p> <p>Në procesverbalin e vlerësimit të aktiveve, komisioni i vlerësimit nuk ka shpjeguar kriteret mbi bazën e të cilave ka vlerësuar këto aktive për tu nxjerrë jashtë përdorimit (nëse është plotësuar koha e shfrytëzimit në bazë të normave të amortizimit dhe nuk mund të riparohen, kanë humbur cilësitë e tyre të caktuara fizike etj.).</p> <p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimet e MF nr. 30 datë 27.12.2011 óPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikó.</p>			<p>aktiveve për dalje nga përdorimi, komisioni i vlerësimit, përpara hartimit të kësaj liste të shpjegojë kriteret mbi bazën e të cilave vlerëson aktivet për dalje nga përdorimi, të hartohet relacioni i vlerësimit të aktiveve, i cili duhet të shpjegojë procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës. Për aktivet të cilat nuk kanë plotësuar normën e amortizimit dhe vlerësohen për jashtë përdorimit të dalin përgjegjësitë për pa mundësinë e përdorimit të mëtejshëm të aktivitetit.</p>
<p>8.Gjetje nga auditimi: Bashkia Tropojë gjatë vitit 2019 ka marrë si dhuratë aktive në vlerën 9,788,944 lekë, me destinacion përdorimi për shkollën e mesme óAsim Vokshio, por nga Titullari nuk është ngritur komision për marrjen në dorëzim të aktiveve, e si rrjedhim aktivet nuk janë bërë hyrje në magazinë dhe nuk janë regjistruar në librat e kontabilitetit Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimet e MF nr. 30 datë 27.12.2011 óPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikó.</p>	58-60	<i>E lartë</i>	<p>8.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Tropojë të marrë masa për ngritjen e komisionit për inventarizimin aktual të aktiveve të furnizuara dhe të pa regjistruara librin e magazinës dhe në kontabilitet, në vlerën 9,788,944 lekë.</p>
<p>9.Gjetje nga auditimi Llogaria 210 “Toka, troje, terreneó, për të dy vitet 2019 dhe 2020 në pasqyrat financiare ka vlerën 22,460,270 lekë, dhe përbëhet vetëm nga dy pasuri. Në këtë llogari nuk janë përfshirë tokat, trojet dhe terrenet që njëzia vendore ka në fakt si pasuri të saj, pasuritë që janë transferuar me VKM të posaçme pranë Bashkisë Tropojë dhe pranë ish komunave që tashmë janë pjesë e Bashkisë Tropojë. Nuk është hartuar regjistër i aktiveve për këtë llogarinë, ku miniM.sht duhet të identifikohet sipërfaqja e pasurisë, vendndodhja, statusi i saj (zaptuar ose jo), etj. - Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacioneó për vitin 2019 dhe vitin 2020 në pasqyrat financiare ka vlerën 10,017,959 lekë dhe përbëhet vetëm nga 6 pasuri. Nuk është hartuar regjistër i plotë i aktiveve për llogarinë 211, si dhe në vlerën e saj nuk janë përfshirë pyjet kullotat</p>	71-74	<i>E lartë</i>	<p>9.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Tropojë të ngriejë grup pune me specialist të fushës për evidentimin e të gjitha aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara (AQT) të cilat janë pasuri e Bashkisë, duke evidentuar statusin dhe gjendjen e tyre faktike në teren. Të plotësohet regjistri i të gjitha aktiveve sipas llogarive përkatëse, i cili të jetë elektronik dhe shkresor dhe të merren masa për</p>

<p>dhe plantacionet që njësia vendore ka në fakt si pasuri të saj, të cilat kanë kaluar në pronësi të njësisë vendore me VKM nr. 433, datë 8.6.2016 òPër transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish- komunave/ bashkiveò.</p> <p>-Llogaria 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, në pasqyrat financiare të vitit për vitin 2020 ka vlerën 1,168,261,128 lekë, e cila nuk rakordon me analizën e kësaj llogarie (vlerën e listës analitike), e cila jep informacion se kjo llogari përbëhet nga 146 aktive në vlerën neto 1,108,173,263 lekë. Vlera bruto e kësaj liste në datën 31.12.2020 është 1,329,807,522 lekë, e njëjtë me vlerën bruto të trashëguar nga pasqyrat financiare të vitit 2019, pra në listën analitike të vitit 2020 nuk janë reflektuar shtesat e bëra gjatë këtij viti.</p> <p>Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, për vitin 2020 ka vlerën neto 1,706,372,666 lekë, me një rritje nga viti 2019 në vlerën neto 669,484 lekë, por e pa argumentuar shtesa me listë analitike.</p> <p>Për periudhën 2019-2020 nuk është kryer inventarizimi i aktiveve të katër llogarive të mësipërme.</p> <p>Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, neni 3 -Përkufizime, pika 1,2, neni 7 - Dokumenti kontabël, neni 11 ó Qëllimi i pasqyrave financiare, neni 15-Inventari i aktiveve dhe detyrimeve;UMF nr. 30, datë 27.12.2011òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, kapitulli IV. pika 74, UMF nr. 8 datë 9.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò.</p>			<p>regjistrimin e pronave në ASHK dhe kontabilitet. Për çdo vit, të kryhet inventarizimi i këtyre aktiveve. Të argumentohet në analizën e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore, shtesa neto 669,484 lekë.</p>
<p>10.Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 òKreditorë për mjetet në ruajtjeò në pasqyrat financiare të vitit 2019 ka vlerën 32,471,986 lekë dhe është e analizuar sipas objekteve për 83 raste, ndërsa në pasqyrat financiare të vitit 2020 ka vlerën 28,728,604 lekë dhe është e analizuar për 81 raste. Për të dy vitet, Drejtoria Ekonomike në të dhënat që paraqiten në listën analitike nuk ka informacion të plotë, pasi mungon afati i fillimit dhe mbarimit të garancisë së vlerës 5% të punimeve për subjektet private. Kjo Drejtori nuk ka të evidentuar se cilat investime janë marrë në dorëzim në mënyrë përfundimtare dhe Bashkia Tropojë ka detyrimin e kthimit të garancisë dhe cilat ende janë të pa përfunduara. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, neni 12, pika 3, germë ògjò.</p>	80-81	E lartë	<p>10.1.Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në Bashkëpunim me Sektorin e Urbanistikës të evidentojë subjektet të cilat kanë shlyer detyrimin për të cilin ju është ngurtësuar vlera 5% e garancisë së punimeve dhe të bëjë likuidimin e kësaj vlere për subjektet. Ky proces të ndiqet në vijimësi, sipas të dhënave që paraqesin kontratat e punimeve, akët e kolaudimeve, procesverbalet e marrjes në përkohshme në dorëzim etj.</p>

3. Konkluzioni dhe opinionin e auditimit

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi pasqyrat financiare.

Opinion i modifikuar.

Ne audituam pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Tropojë për vitin ushtrimor 2019 dhe 2020, të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e fluksit të arkës, pasqyra e lëvizjes së kapitalit si dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat. Në opinionin tonë, veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit janë në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike, përfshirë rregullat për prokurimet dhe ato të buxhetit, përveç çështjeve të trajtuara në bazën për kualifikimin e opinionit.

“Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme të auditimit, mbështetur në standardet (ISSAI 1700) , ISSAI 1705 dhe (ISSAI 1200), si dhe në vlerën e materialitetit prej 6,622 mijë lekë për shpenzimet e realizuara për vitin ushtrimor 2020, për të cilin jepet edhe opinionin i auditimit, shprehim një **opinion të kualifikuar**¹ për llogaritë vjetore të Bashkisë Tropojë të vitit ushtrimor 2020, duke arritur në përfundimin se anom.të e konstatuara apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapuraö.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin ðPërgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiareö, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare- Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Ne kemi vënë re se në subjektin Bashkia Tropojë, pasqyrat financiare nuk japin siguri se kanë të përfshira të gjitha aktivet e katër llogarive kryesore të aktiveve afatgjata materiale si: Llogaria 210 ðToka, troje, terrene, Llogaria 211 ðPyje kullota plantacioneö, Llogaria 212 ðNdërtesa e Konstruksioneö, Llogaria 213 ðRrugë, rrjete, vepra ujoreö, pasi këto llogari nuk janë përfshirë në procesin e inventarizimit vjetor dhe nuk është ngritur grup pune për vlerësimin e gjendjes aktuale të pronës, përgatitjen e dokumentacionit për verifikimin dhe regjistrimin e të gjitha pronave të paluajtshme pranë Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ish ZRPP).

Llogaria 210 “Toka, troje, terreneö, për të dy vitet 2019 dhe 2020 në pasqyrat financiare ka vlerën 22,460,270 lekë, dhe përbëhet vetëm nga dy pasuri.

Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacioneö për vitin 2019 dhe vitin 2020 në pasqyrat financiare ka vlerën 10,017,959 lekë dhe përbëhet vetëm nga 6 pasuri.

Në këto dy llogari nuk janë përfshirë asetet që njësia vendore ka në fakt si pasuri të saj, të cilat janë transferuar me VKM të posaçme pranë Bashkisë Tropojë.

Llogaria 215 –Mjete Transporti ka një vlerë prej 3,452,393 lekë më tepër në pasqyrën e pozicionit financiar, se analiza analitike e kësaj llogarie.

¹Opinionin i modifikuar shprehet kur ka të dhëna të mjaftueshme se parregullsitë, individualisht apo së bashku janë materiale dhe jo të përhapura në pasqyrat financiare

-Llogaria 327 –Inventar i imët, në pasqyrat financiare është 9,624,803 lekë më shumë se vlera e dalë nga rezultatet e procesit të inventarizimit, e cila është 6,605,586 lekë.

- Bashkia Tropojë gjatë vitit 2019 ka marrë si dhuratë aktive në vlerën 9,788,944 lekë, të cilat janë ende të pa kontabilizuara dhe të pa bëra hyrje në magazinë.

- Llogaria 105 -Teprica e Grandeve kapitale te brendshme (e cila mbetet me tepricë në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet kur këto grante janë burim për investimet në proces), ka vlerën 67,358,609 lekë, por Drejtoria Ekonomike nuk ka informacion për përbërjen e kësaj llogarie. Mbështetur në të dhënat e pasqyrës së pozicionit financiare të vitit 2020, shuma e llogarisë 230 dhe 231 është 17,138,144 lekë dhe nuk përputhet me vlerën që paraqitet në llogarinë 105, e cila mbart një vlerë prej 50,220,465 lekë më shumë se llogaria 230 dhe 231 së bashku.

Opinion mbi përputhshmërinë

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së njësisë vendore me kuadrin rregullator në fuqi, në fushën e prokurimeve publike, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit (të ardhurat dhe shpenzimet), menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, planifikimin dhe zhvillimin e territorit, etj. Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, duke arritur në përfundimin se devijimet e pajtueshmërisë janë materiale dhe të përhapura, mbështetur në standardet ISSAI 4100 shprehim një **opinion të kundërt**² për përputhshmërinë, për periudhën e auditimit 01.01.2019 deri më datën 31.12.2020.

Baza për dhënien e opinionit

-Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm nuk ka funksionuar si duhet, duke sjelle mangësi material në elementët e tij kryesor. Për shkak të largimit të një numri të konsiderueshëm punonjësish dhe mungesës së një programi trajnimi, niveli i kualifikimit të punonjësve vlerësohet me risk. Për aktivitetet kryesore që zhvillon institucioni, nuk janë identifikuar rrisqet që rrezikojnë realizimin e objektivave dhe për rrjedhojë, nuk janë marrë masa për menaxhimin e tij. Nga muaji maj 2020 e në vijim në Bashkinë Tropojë nuk ka strukturë të Auditimit të Brendshëm.

- Janë konstatuar shkelje dhe mospërputhshmëri materiale, në fushën e prokurimeve publike. Nga 17 procedurat e prokurimit të audituara, 16 prej tyre në vlerën 579 milion lekë, ose 97% e vlerës së procedurave të zhvilluara, janë konstatuar me shkelje të cilat lidhen me hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim, konkretisht mos argumentimi i kriterëve dhe vendosjen e tyre jo në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimi, 14 prej tyre në vlerën 569,085,244 lekë, ose 92% e vlerës së procedurave të zhvilluara, janë konstatuar me shkelje të cilat lidhen me kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomik në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi.

-Planifikimi i të ardhurave nga burimet e veta gjatë vitit 2019 është i gabuar, pasi është llogaritur në vlerën 147,788 mijë lekë, një vlerë e pa argumentuar dhe jo reale, tre herë më e madhe se vlera e të ardhurave të realizuara në vitin e mëparshëm 2018.

- Janë konstatuar shkelje në masat që duhet të merreshin nga Drejtoria Ekonomike për ndjekjen dhe likuidimin e detyrimeve të prapambetura. Likuidimi i detyrimeve të prapambetura në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, është përmirësuar vetëm në masën 1%.

- Janë konstatuar anormale materiale në procesin e inventarizimit të aktiveve. Jo të gjitha aktivitet që janë vlerësuar për dalje nga përdorimi kanë plotësuar kohën e shfrytëzimit të tyre, në bazë të normave të amortizimit, si dhe nuk janë shpjeguar kriteret mbi bazën e të cilave janë vlerësuar këto aktive për tu nxjerrë jashtë përdorimit.

²Opinion i kundërt shprehet kur ka të dhëna të mjaftueshme se parregullsitë janë materiale dhe të përhapura

-Komisioni i asgjësimit të aktiveve ka kryer këtë proces pa identifikuar dhe veçuar ato aktive të cilat mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshme, dhe të shiteshin në ankand.

-Gjatë vitit 2019 janë marrë si dhuratë aktive në vlerën 9,788,944 lekë, por nuk është ngritur komision për marrjen në dorëzim të aktiveve dhe nuk është bërë regjistrimin i tyre në kontabilitet.

-Nga puna jo e plotë për mbledhjen e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, në fund të vitit 2020 këto detyrime progresive, kanë vlerën 18,082,240 lekë, e ardhur e munguar për buxhetin e njësisë vendore.

Përgjegjësitë e drejtuesve të njësisë vendore

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018 për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, UMF nr. 8 datë 9.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi. Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashttrimet e mundshme. Staf i drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e miratuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e audituesve të KLSH mbi auditimin

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojme bindje, të cilat do të shprehën në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar, si dhe nëse hartimi i kriterëve të DST, vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratave të punimeve janë në përputhshmëri me kriteret e fushës së prokurimeve publike dhe kriteret e kontratave të lidhura. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe fushave të tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomali që mund të ekzistojë.

Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur përpara i takon çështjeve të audituara, është ose jo në përputhje, në të gjitha aspektet materiale me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi

II. Hyrja (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit)

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH-së, në zbatim të Programit të Auditimit nr.361/1, datë 06.04.2021, shkresës nr.361/2 prot., datë 16.04.2021, me lëndë të Njoftimit për ndryshim në programin e auditimit nr.361/1 prot., datë 06.04.2021, si dhe shkresës nr.361/3 prot., datë 06.05.2021 me lëndë të Njoftimit për ndryshim në programin e auditimit nr.361/1 prot., datë 06.04.2021, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 07.04.2021, deri më datën 04.06.2021, në Institucionin Bashkia Tropojë u krye auditimi financiar dhe i përputhshmërisë. Auditimi mbuloi periudhën: prej 01.01.2019 deri më datën 31.12.2020.

Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. B. M., përgjegjës grupi
2. L. B., anëtar grupi
3. L. B., anëtar grupi
4. A. K., anëtar grupi
5. R. K., anëtar grupi

Prej datës 07.04.2021 deri në datën 16.04.2021, në grupin e auditimit ka marrë pjesë edhe z.V. R., i cili për shkak të kohës së shkurtër nuk ka mbajtur akte konstatimi/verifikimi. Gjithashtu sipas programit të auditimit në përbërje të grupit ka qenë edhe z. A. Z., i cili praktikisht nuk ka marrë pjesë në procesin e auditimit.

Auditimi u krye me zgjedhje, mbi bazën e riskut dhe materialitetit.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objekti i auditimit. Auditimi i kryer në Bashkinë Tropojë është auditim financiar dhe auditim përputhshmërie. Auditimi ka pasur si objekt pasqyrat financiare, prokurimet publike, të ardhurat, buxhetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, planifikimin dhe zhvillimin e territorit, zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e pasqyrave financiare janë:

- Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim si përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullsia.

-Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia etj.

- Marrja e garancive nëse procedurat e prokurimit publik janë zhvilluar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi, nëse punët publike janë realizuar mbi bazën e preventivit dhe kontratave të punimeve, mbi përputhshmërinë e zbatimit të kuadrit rregullator në fuqi në mbledhjen e të ardhurave dhe planifikimin dhe zbatimin e buxhetit.

2. Qëllimi i auditimit. Për pasqyrat financiare: të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.

Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar.

Për auditimin e përputhshmërisë, i cili përfshin fushën e sistemit të kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, buxheti, të ardhurat, planifikimin dhe zhvillimin e territorit, qëllimi i auditimit është të kuptohet se deri në çfarë shkalle subjekti zbaton kuadrin rregullator në fuqi, zbulimi i shkallës së devijimeve nga standardet e pranuar dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së parimeve të ligjshmërisë, efikasitetit, efektivitetit dhe ekonomicitetit të menaxhimit financiar, me qëllim që për rastet individuale të identifikuara të detyrohen personat përgjegjës të mbajnë përgjegjësi, si dhe të merren masa për parandalimin e shkeljeve në të ardhmen.

3. Identifikimi i çështjes.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

Pika 1. Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.

Pika 2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimit të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.

Pika 3. Vlerësimi i raportimit financiar për vitet 2019-2020.

Pika 4. Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike dhe zbatimin e kontratave të punëve publike.

Pika 5. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Pika 6. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:

Titullarët e njësive publike, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet, sigurimin, nëpërmjet akteve të brendshme administrative, të zbatimit të rregullave për kontrollin e brendshëm.

Nëpunësi autorizues z. R. B., me detyrë Kryetar i Bashkisë Tropojë dhe Nëpunësi zbatues z. B. T., me detyrë drejtor ekonomik, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Tropojë.

Bazuar në pikën 6 të nenit 34, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*: *“Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore”*.

Sipas neni 91. Njësitet e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: pika 1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:

a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;

b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre;

ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.

Neni 65; *“Administrata e njësisë administrative”*, pika 1, *“Në njësitet administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori”*.

Strukturat drejtuese të Bashkisë Tropojë, për problematikat e trajtuara lidhur me çështjet nën auditim për hartimin dhe zbatimin e buxhetit, mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, hartimin e pasqyrave financiare dhe inventarizimin e pasurisë; mbi prokurimet me fonde publike dhe zbatimin e kontratave, lejet e ndërtimit etj., mbajnë përgjegjësi në lidhje me mangësitë, në shkelje të dispozitave ligjore të përcaktuara nga ligjet nr. 68/2017 datë 27.04.2017 *“Për financat e vetëqeverisjes vendore”*; nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*; nr. 9936, datë 26.6.2008, *“Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”* dhe të akteve të tjera ligjore e nënligjore në aktivitetin financiar dhe përputhshmërisë. Problematikat dhe përgjegjësitë lidhur me to, të konstatuara gjatë procesit të auditimit, janë evidentuar në akt-konstatimet dhe akt verifikimet e mbajtura, në Projektraportin e Auditimit dhe në këtë Raport Përfundimtar.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e audituesve të KLSH-së, është që nëpërmjet auditimit të mund të shprehë një opinionin mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e raportimit të pasqyrave financiare si dhe çështjet që lidhen me përputhshmërinë për fushat e tjera të aktivitetit të njësisë vendore si procedurat e prokurimit me fonde publike, buxheti, të ardhurat dhe shpenzimet, administrimin e territorit etj.

Në këtë funksion, auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, sipas INTOSAI.

Këto standarde kërkojnë që ne t'ia përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi.

Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozonë që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe raportimit të shifrave në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi profesional i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesi vlerëson nivelin e kontrollit të brendshëm në entitet, në mënyrë që të programojë procedura auditimit që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit.

Gjatë kryerjes së auditimit, në mënyrë që të jepet një gjykim sa më profesional, objektiv dhe i pavarur, audituesit e grupit kanë zbatuar parimet e mëposhtme me karakter etik:

Parimin e integritetit;

Parimin e pavarësisë;

Parimin e objektivitetit;

Parimin e shmangies së konfliktit të interesit.

Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë në lidhje me pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë për fushat e tjera të audituara.

6. Kriteret e vlerësimit.

Kriter vlerësimi është i gjithë kuadri rregullator në fuqi (baza ligjore, aktet e brendshme të institucionit, kushtet e kontratës etj., me të cilat krahasohet aktiviteti i njësisë vendore që auditohet) dhe kryesisht:

Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2017 òPër vetëqeverisjen vendoreò; ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendoreò; ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë si dhe ligjet e udhëzimet vjetore të Ministrisë së Financave për buxhetin; ligji nr. 147/2015 òPër buxhetin e vitit 2016ò; ligji nr. 130/2016, datë 17.12.2016 òPër buxhetin e shtetit të vitit 2017ò; ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò i ndryshuar; UMF nr.8, datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò i ndryshuar; ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 òMenaxhimi i aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar; legjislacioni për administrimin e territorit etj.

-Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.

7. Standardet e auditimit

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t.

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC.

Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të

Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të adituesve;

Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë", etj.

Manualet e Auditimit Financiar dhe Përputhshmërisë të miratuar nga Kontrollit i Lartë i Shtetit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH-së etj.

Gjatë zhvillimit të auditimit nga grupi u patën parasysh dhe u zbatuan:

-Qasjen e auditimit mbi bazë risku (rreziku), sipas së cilës të gjithë përpjekjet dhe burimet

drejtohen në fushat dhe çështjet më të rëndësishme dhe ku vlerësimi i riskut është në nivelet më të larta;

-Përdorimin e gjykimit profesional duke u bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Manualin e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë.

Gjithashtu auditimi është kryer në zbatim të:

Ligjit organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit;

Rregullores së Brendshme të Mbi organizimin dhe funksionimit administrativ të KLSH-së, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30.06.2015;

-Rregullores të Mbi Procedurat e auditimit në KLSH, miratuar me vendimin nr. 63, datë 22.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së.

8. Metodat (Procedurat) e auditimit.

Përcaktimi i procedurave të auditimit nga grupi i auditimit u bë duke pasur parasysh parimet themelore të auditimit si më poshtë:

Procedurat e auditimit kanë për qëllim të sigurojnë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme cilat do të përbëjnë një bazë të arsyeshme për vlerësimet dhe përfundimet e auditimit (ISSAI 300, 3.5.1).

Audituesit përzgjedhin ato procedura auditimi të cilat sipas gjykimit të tyre profesional janë më të përshtatshme në varësi të rrethanave (ISSAI 300, 3.4.5)

Për arsye se në bazë të vlerësimi sistemi i kontrollit të brendshëm është përcaktuar jo në nivelin e duhur, grupi i auditimit u mbështetet më shumë në procedurat thelbësore dhe më pak në qasjen e mbështetur në sistemin e kontrollit të brendshëm. Siguria e auditimit është marrë më shumë nga procedurat thelbësore.

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 të Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët

Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakordura) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit (akt-konstatimet, akt-verifikimet dhe letrat e punës), i cili është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur

konkluzionet e auditimit. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Raporti i Auditimit.

Nga subjekti i audituar kanë ardhur kundërshti lidhur me çështjet e auditimit të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit.

9. Dokumentimi i auditimit

Është bërë mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë, si dhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, ISSAI 1230 të Dokumentimi i Auditimit. Nga grupi i auditimit është përgatitur dokumentacioni i duhur mbi bazën e të cilit mbështeten konkluzionet e auditimit. Për këtë janë përgatitur 10 akte konstatimit, 2 akte verifikimi, projektraporti i auditimit dhe ky raport përfundimtar i auditimit. Puna e dokumentuar në këto dokumente është mbështetur mbi bazën e evidencave konkrete, të mara nga subjekti i audituar, të cilat kanë plotësuar tre cilësitë e duhura: kanë qenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme. Procedurat e ndjekura të auditimit janë përshkruar nga secili auditues në aktet e konstatimit, gjatë trajtimit të çështjes sipas ndarjes së detyrave, ku janë evidentuar edhe evidencat të cilave ju jemi referuar. Një pjesë e evidencave të cilat duhet të mbështesin konkluzionet kryesore të auditimit janë pjesë e dosjes së auditimit. Gjatë fazës së auditimit në teren grupi i auditimit ka dokumentuar në informacionet periodike gjetjet kryesore të auditimit. Për çështjet e kundërshtuara nga subjekti prej tij janë bërë kundërshti të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit. Gjithashtu është kryer takimi ballafaques me subjektin pranë zyrave të KLSH.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar. Bashkia Tropojë ka 8 Njësi Administrative dhe një popullsi prej 28,100 banor, si vijon:

Njësia Administrative Bajram Curri, Njësia administrative Bujan, Njësia administrative Bytyç, Njësia administrative Fierzë, Njësia administrative Lekbibaj, Njësia administrative Llugaj, Njësia administrative Margegaj, Njësia administrative Tropojë. Sipërfaqja gjithsej Bashkia Tropojë 105730 ha, sipërfaqe pyjore 34245 ha dhe tokë bujqësore 7387 ha.

Për vitin 2019 buxheti i realizuar për shpenzimet ka vlerën 709,891,068 lekë, ku vlera 308,510,320 lekë, ose në masën 43% të shpenzimeve e zë ndihma ekonomike dhe pagesa për paaftësinë e kufizuar.

Për vitin 2020, buxheti i realizuar për shpenzimet ka vlerën 672,527,570 lekë, prej së cilës vlera 340,435,820 lekë, ose në masën 50% e zë ndihma ekonomike dhe pagesa për paaftësinë e kufizuar.

Të ardhurat e realizuara nga vetë njësia vendore për vitin 2019 kanë vlerën 50,937 mijë lekë, dhe zënë 13% të shpenzimeve totale të kryera për këtë vit.

Të ardhurat e realizuara nga vetë njësia vendore për vitin 2020 kanë vlerën 46,983 mijë lekë, dhe zënë 15 % të shpenzimeve totale të kryera për këtë vit. Në të dyja rastet për nxjerrjen e përqindjeve nuk është llogaritur ndihma ekonomike si shpenzim i bashkisë, pasi ky fond nuk sigurohet nga njësia vendore.

Përshkrimi i auditimit, sipas pikave të programit

1. Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm

1.1.Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm

Baza kryesore ligjore të cilët i jemi referuar gjatë procesit të auditimit është ligji 10296, datë 08.07.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe Manuali në zbatim të këtij ligji.

U auditua funksionimi i pesë elementëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm: mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, informimi dhe komunikimi, monitorimi. Në përfundim të auditimit arrihet në konkluzionin se nuk është hartuar një paketë e plotë rregullash të shkruara për të siguruar një funksionim të mirë të kontrollit të brendshëm. Mjedisi i kontrollit, si elementi bazë dhe kryesor i kontrollit të brendshëm, nuk është në nivelin e duhur, punonjësit kanë mangësi në njohjen e kërkesave të ligjit 10296, datë 08.07.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, nuk janë hartuar programe për të siguruar ruajtjen dhe zhvillimin profesional të stafit. Nuk janë hartuar dokumente si regjistri i rrishtit, gjurma e auditimit, rregulla për ruajtjen e aktiveve, nuk ka sistem rezervë për ruajtjen e të dhënave elektronike (back-up) për njësinë etj.

Titulli i Gjetjes: Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin pranë Bashkisë Tropojë

Situata: -*Mjedisi i kontrollit* - Nga ana e Titullarit të Bashkisë, nuk janë nxjerrë urdhra me shkrim për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së kontrollit. Nuk janë miratuar gjurmët e auditimit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010, neni 4 pika 19, neni 16 pika 2 dhe neni 22. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit. Politika dhe praktika e burimeve njerëzore nuk garanton ruajtjen dhe zhvillimin profesional të stafit, pasi nuk ka programe trajnimi për punonjësit, për të ngritur në vazhdimësi nivelin e tyre profesional.

Për periudhën 01.01.2019-31.12.2020 kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës 156 punonjës, që përbën rreth 45% e numrit total të punonjësve gjë e cila përbën një risk përse i përket përvojës së punës dhe nivelit profesional të punonjësve në këtë institucion(me detyra të ndryshme si, drejtor ekonomik, specialiste financash, përgjegjës shërbimesh, magazinier etj), të cilët përpara largimit nuk kanë bërë dorëzimin e detyrës me procesverbal (dorëzimin e dosjeve shkresore, elektronike, pra të gjithë punës së krijuar prej tyre gjatë qëndrimit në institucion). Këto veprime nuk garantojnë ruajtjen e bazës së të dhënave për sektorët përkatës të institucionit, krijojnë vështirësi për vazhdimësinë e punës së kryer dhe transmetimin e saj nga një punonjës te tjetri. Gjithashtu nuk ka një dokument të shkruar (akt të brendshëm administrativ), i cili të përcaktojë detyrimet që ka punonjësi dhe veprimet që ai kryen përpara largimit, si dhe detyrat që ka institucioni (njësia e burimeve njerëzore dhe financa) në këtë proces.

-Menaxhimi i riskut. Lidhur me identifikimin e aktiviteteve me risk, hapjen e regjistrit të riskut si dhe menaxhimin e tij, nuk është miratuar strategjia e menaxhimit të riskut, nuk janë identifikuar aktivitete me risk, si dhe nuk janë marrë masa për menaxhimin e tij. Nuk janë nxjerrë urdhra me shkrim për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së kontrollit, në kundërshtim me kërkesat e nenit 22 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010. Megjithëse është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik, nuk janë miratuar plane zhvillimi strategjikë me afat jo më pak se sa 5 vjet, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 68/2017 për financat e vetëqeverisjes vendore, neni 32.

-Veprimtaritë e kontrollit. Mungon sistemi i IT dhe nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up). Nuk ka rregulla të brendshme që garantojnë sigurinë e sistemit IT. Nuk ka procedura të veçanta të shkruara, mbi sistemet IT, të cilat përdoren në Bashkinë Tropojë, të cilat i janë bërë me dije stafit. Aktualisht nuk ka një manual të shkruar për sigurinë e IT.

-Informacioni dhe komunikimi. Realizohet sipas shkallës së strukturave, bazuar edhe në rregulloren e funksionimit të brendshëm, në zbatim të kërkesave të nenit 23 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010.

Monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, realizohet në mënyrë formale duke respektuar ato kritere mbi të cilat edhe raportohet pranë Ministrisë së Financave. Nuk janë përcaktuar rregulla të qarta lidhur me ndjekjen e zbatimit të kontratave të lidhura pas

procedurave të prokurimit me tender. Për projektet në bujqësi, arsim, urbanistikë, infrastrukturë etj., në rregulloren e funksionimit të brendshëm nuk janë përcaktuar detyra se kush duhet të ndjekë zbatimin e kontratave lidhur me afatet dhe cilësinë e punimeve.

Këto raste janë shkelje e kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikë i ndryshuar Kap. III, pikat 42, 47.

Për sa më sipër mban përgjegjësi ish titullari i AK z. B. D., titullari aktual z. R. B., ish nëpunësi zbatues z. R. I dhe nëpunësi zbatues z. B. T..

Kriteri:

Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, nenet 8, 16, 22, 23, 24.

Ndikimi/Efekti: Mos identifikimi dhe menaxhimi i risqeve, mungesa e analizimit të cilësisë së funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, mos trajnimi për rritjen profesionale të stafit, ndikojnë negativisht në arritjen e objektivave të institucionit, lënë hapësira për ndodhjen e anomive dhe mos informimin e titullarit për këto anomalitë, nuk nxjerrin qartë përgjegjësitë etj.

Shkaku: Mosnjohje e plotë e koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin si dhe nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave. Mosnjohje nga niveli i lartë drejtues i kriterëve të MFK, me nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Rëndësia: E lartë

1.2. Vlerësimi i Auditit të Brendshëm.

Për periudhën 01.01.2019-31.12.2020, në bashkinë Tropojë është organizuar dhe ka funksionuar Njësia e Auditimit të Brendshëm e përbërë nga dy specialistë si dhe Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit. Nga këta, Përgjegjësjë e Sektorit (e cila ka 3 vite përvojë pune si audituese) dhe një nga specialistët janë të pajisur me Certifikatën e Audituesit të Brendshëm në Sektorin Publik, në kundërshtim me gurmën b, pika 2 të nenit 11 të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 për auditimin e brendshëm në sektorin publikë, ku përcaktohet se drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm duhet të jetë i certifikuar si Auditues i Brendshëm në sektorin publikë dhe të ketë përvojë pune 5 vjet si auditues i brendshëm ose i jashtëm.

Me shkresën nr.2027 prot., datë 15.05.2020 dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me lëndë informacion për sektorin e Auditimit të Brendshëm, është vënë në dijeni Ministria e Financave dhe Ekonomisë për shkrirjen e Sektorit të Auditimit të Brendshëm për shkak se është konstatuar performancë e dobët në punë dhe nëse lind nevoja do të paraqitet projekt-vendim në Këshillin Bashkiak sipas rasteve për të marrë Audit të specializuar nga jashtë.

Nga njësia e auditimit të brendshëm janë hartuar dhe miratuar për çdo vit ne zbatim të ligjit për auditimin e Brendshëm Planet strategjike dhe vjetore sipas formateve të miratuara.

Për vitin 2019 nga 5 auditime të planifikuara janë realizuar 5 auditime, nga ku janë konstatuar 39 gjetje dhe janë lënë 39 rekomandime.

Për vitin 2020 nga 9 auditime të planifikuara është realizuar vetëm 1 auditim pasi në datën 15.05.2020 njësia e auditit të brendshëm është shkrirë me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Tropojë. Është kryer vetëm 1 auditim për vitin 2020, nga ku janë konstatuar 6 gjetje dhe janë lënë 6 rekomandime.

Titulli i Gjetjes: Mbi veprimtarinë e Njesisë së Auditit të Brendshëm

Situata: Në bashkinë Tropojë është organizuar dhe ka funksionuar Njësia e Auditimit të Brendshëm e përbërë nga dy specialistë si dhe Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit. Nga këta, Përgjegjësjë e Sektorit (e cila ka 3 vite përvojë pune si audituese) dhe një nga specialistët janë të pajisur me Certifikatën e Audituesit të Brendshëm në Sektorin Publik, në kundërshtim me gurmën b, pika 2 të nenit 11 të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 për auditimin e brendshëm në

sektorin publikë, ku përcaktohet se drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm duhet të jetë i certifikuar si Auditues i Brendshëm në sektorin publikë dhe të ketë përvojë pune 5 vjet si auditues i brendshëm ose i jashtëm.

Me shkresën nr.2027 prot., datë 15.05.2020 dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me lëndë informacion për sektorin e Auditimit të Brendshëm, është vënë në dijeni Ministria e Financave dhe Ekonomisë për shkrirjen e Sektorit të Auditimit të Brendshëm për shkak se është konstatuar performancë e dobët në punë dhe nëse lind nevoja do të paraqitet projekt-vendim në Këshillin Bashkiak sipas rasteve për të marrë Audit të specializuar nga jashtë.

Nga njësia e auditimit të brendshëm janë hartuar dhe miratuar për çdo vit ne zbatim te ligjit për auditimin e Brendshëm Planet strategjike dhe vjetore sipas formateve të miratuara.

Për vitin 2019 nga 5 auditime të planifikuara janë realizuar 5 auditime, nga ku janë konstatuar 39 gjetje dhe janë lenë 39 rekomandime.

Për vitin 2020 nga 9 auditime të planifikuara është realizuar vetëm 1 auditim pasi në datën 15.05.2020 njësia e auditit të brendshëm është shkrirë me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Tropojë. Është kryer vetëm 1 auditim për vitin 2020, nga ku janë konstatuar 6 gjetje dhe janë lenë 6 rekomandime.

Auditimet e kryera, janë evaduar me urdhër të Titullarit të Bashkisë ku janë marrë vendimet përkatëse për shkeljet e konstatuara.

Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka kryer auditime në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, të tilla si: prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, taksat dhe tarifat vendore, etj.

Për këtë arsye kjo njësi nuk i ka dhënë mbështetjen e duhur Kryetarit të Bashkisë për arritjen e objektivave, pasi nuk janë kryer auditime bazuar në vlerësimin objektiv të riskut.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e pikës 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016, *“Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publikë, i ndryshuar, nenin nr. 5 dhe nr. 6 të ligjit nr. 114/2015 për auditimin e brendshëm në sektorin publikë.*

Nga shqyrtimi i dosjeve të auditimeve të periudhës 01.01.2019-31.12.2020 u konstatua se në dosjet e auditimit të vitit 2019 dhe 2020, nuk është bërë kontrolli i cilësisë së auditimit të kryer, në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, Kap. II, pika 10.

Nuk ka nxjerrje përgjegjësie si dhe marrje masash për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit, duke bërë që NJAB të mos e realizojë plotësisht misionin e saj për kryerjen e monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Në auditimet e kryera konstatohet se nga ana e Njesisë së Auditimit Bashkia Tropojë për periudhën 01.01.2019-31.12.2020 nuk është kryer verifikimi i zbatimit të rekomandimeve me program tematik të veçantë, gjë që vjen në kundërshtim me Manualin e auditimit të miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 *“Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publikë, pikën 4.1.13.2, Raportimi i ndjekjes së rekomandimeve, ku përcaktohet se: **“Kur nuk është planifikuar angazhim auditimi në vitin në vazhdim, audituesit duhet t'i mundësojnë një raport të shkurtër titullarit të njësisë, për progresin e bërë në zbatimin e rekomandimeve të rëna dakord më parë. Në këto raste rishikimi i zbatimit të rekomandimeve mund të realizohet në auditimin e radhës në subjektin publik si pikë e veçantë e programit të auditimit”**.*

Në disa raste kur janë trajtuar gjetjet dhe rekomandimet nuk janë shoqëruar me referencën ligjore përkatëse, neni, pika, Ligje apo VKM, për pasojë një pjesë e këtyre rekomandimeve nuk janë të plota.

Kriteri:Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publikë. VKM nr. 83, datë 03.02.2016 për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publikë. Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 100 datë

25.10.2016 òPër Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publikò, ligji 68/2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendoreò.

Ndikimi/Efekt: Nëse nuk kryhen auditime në fushat me rrisht që ka veprimtaria e njësisë vendore, kjo sjell mosnjohjen nga auditit dhe titullarit të rreziqeve të mundshme që ka në këto fusha, e për pasojë, duke mos i njohur, nuk ka as vëmendje për ti minimizuar këto rrishte e për ti monitoruar. Si përfundim titullarit nuk i jepet këshillimi i duhur nga ana e auditit të brendshëm, e cila është detyra themelore e këtij të fundit.

Shkaku: Mungesa e kontrollit të cilësisë së auditimeve të kryera.

Rëndësia: E lartë

2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit.

Në këtë pikë trajtohen nën çështjet 1 deri në 5 të pikës nr.2 të programit të auditimit, si vijon:

2.1. Programimi i PBA për periudhën 2019-2020 dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2019 dhe 2020;

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura;

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës Covid 2019, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.

Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre.

2.4. Vlerësimi i rrishteve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e pa likuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.).

2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

Titulli i gjetjes: Në planifikimin e PBA 2019-2021 dhe buxhetit vjetor 2019, nga auditimi u konstatuan se edhe pse janë llogaritur fonde për detyrime të prapambetura, ky planifikim është bërë mbi bazën e një plani të të ardhurave jo realist në vlerën 147,788 mijë lekë, ose tre fish më shumë se plani i vitit të mëparshëm.

Situata:

Programimi i PBA 2019-2020 dhe programimi i buxhetit vjetor 2019 dhe 2020. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative.

U paraqitën vendimet nr. 1, datë 07.01.201 i ish kryetarit të bashkisë z. B. D., òMbi ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik dhe ekipet e menaxhimit të programeve për vitin 2019, urdhri nr. 132/1, datë 06.07.2020 i kryetarit të Bashkisë z. R. B., òPër ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik dhe ekipet e menaxhimit të programeve për vitin 2020ò. Të dy urdhrat kanë dalë me vonesë, pasi këto grupe duhet të ngrihen përpara vitit ushtrimor për të cilin do të hartohet buxheti. Janë hartuar PBA për periudhën 2019-2021 dhe 2020-2022, të cilat kanë si vit të parë vitin buxhetor respektivisht 2019 dhe 2020.

Miratimi buxhetit vjetor për të dy vitet është bërë brenda afateve që përcakton neni 32 - Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore, i ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò. (Këshilli i qeverisjes vendore, brenda datës

31 dhjetor, miraton buxhetin vendor në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor).

Viti 2019. Me vendimin e këshillit bashkiak (VKB) nr. 58, datë 17.04.2018 òPër miratimin e projekteve prioritare të Bashkisë Tropojë për vitet 2018-2020, është miratuar lista e investimeve prioritare për këtë periudhë sipas fushave përkatëse: 1-Infrastrukturë, 2-Ujësjesllës kanalizime, 3- Arsim-sport, 4-Zhvillim rural. Nga auditimi u konstatua se të gjitha procedurat e prokurimeve me vlera të larta për periudhën 2019-2020 janë pjesë e këtij vendimi, apo të vendimeve të tjera të poshtëshënuara për miratimin e buxhetit.

Treguesit për buxhetin afatmesëm të Bashkisë Tropojë për periudhën 2019-2021, si dhe buxhetin e vitit 2019, janë miratuar me VKB nr.187, datë 19.12.2018, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Kukës me shkresën nr.2/76 prot., datë 07.01.2019, kurse buxheti shtese për alokimin e fondeve të trashëguara nga viti 2018 është miratuar me VKB nr.2, datë 22.01.2019, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Kukës me shkresën nr.2/16 datë 31.01.2019.

Gjithashtu buxheti vjetor 2019 ka pësuar edhe dy ndryshime të tjera, respektivisht me VKB nr. 15, datë 25.02.2019 òPër një shtesë në VKB Nr.187, datë 19.12.2018, nëpërmjet të cilit është miratuar plani i të ardhurave shtesë, si dhe i shpenzimeve në vlerën 7,000,000 lekë, si dhe VKB nr. 40, datë 26.04.2019 òPër një shtesë në VKB Nr.187, datë 19.12.2018, nëpërmjet të cilit është miratuar plani i të ardhurave shtesë, si dhe i shpenzimeve në vlerën 8,000,000 lekë.

Të dhënat e buxhetit të planifikuar dhe miratuar, sipas VKB përkatëse jepen në aneksin nr.1, bashkangjitur raportit të auditimit.

Me VKB nr. 2, datë 22.01.2019 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Tropojë për miratimin e buxhetit shtese për alokimin e fondeve të trashëguara nga viti 2018, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 9,156,842 lekë, sipas aneksit nr.1/1 bashkangjitur raportit të auditimit.

Me VKB nr. 15, datë 25.02.2019 òPër një shtesë në VKB nr.187, datë 19.12.2018, është miratuar plani i të ardhurave shtesë, si dhe i shpenzimeve në vlerën 7,000 mijë lekë, pasqyruar në aneksin nr.1/2 bashkangjitur raportit të auditimit.

Me VKB nr. 40, datë 26.04.2019 òPër një shtesë në VKB nr.187, datë 19.12.2018, është miratuar plani i të ardhurave shtesë, si dhe i shpenzimeve në vlerën 8,000,000 lekë.

Nr	Burimi i të ardhurave të planifikuar për vitin 2019, miratuar me VKB nr. 40, datë 26.04.2019 (shtesë në buxhetin fillestar të vitit 2019)	Vlera në 000/lekë
	Të ardhurat	
1	Tarifë licencimi të karburanteve me pakicë	8,000
	Shpenzimet	
1	Për investime në llogarinë 4530 (rikonstrukcion i rrugës Curraj Epërm	8,000

Në total, miratimi i buxhetit përfundimtar i Bashkisë Tropojë për vitin 2019 ka vlerën 447,603 mijë lekë, si vijon:

Për të ardhurat:

- Të ardhurat e veta të planifikuara për realizim gjatë vitin 2019, në vlerën 147,788 mijë lekë;
- Të ardhura të veta të trashëguara nga viti 2018 në vlerën 5,110 mijë lekë;
- Transfertë e pakushtëzuar në vlerën 205,108 mijë lekë;
- Transferta specifike e pakushtëzuar në vlerën 89,597 mijë lekë.

Për shpenzimet:

- Shpenzime për paga dhe sigurime në vlerën 220,394 mijë lekë;
- Investime në vlerën 138,548 mijë lekë;
- Shpenzime operative në vlerën 75,958 mijë lekë;
- Fondi rezervë dhe i kontigjencës në vlerën 12,703 mijë lekë.

Në mënyrë të përmbledhur, planifikimi total i buxhetit të bashkisë Tropojë për vitin 2019, sipas VKB përkatëse paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tab.1

Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2019, Bashkia Tropojë. Në 000/lekë (Buxheti përfundimtar i planifikuar, pa ndihmën ekonomike dhe PAK)			
Nr	Burimi i të ardhurave për vitin 2019	Vlera në 000/lekë	VKB që ka miratuar buxhetin
1	a-Të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2019	132788	VKB nr.187, datë 19.12.2018
2	a/1 -Të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2019 (shitesë)	7000	VKB nr. 15, datë 25.02.2019
3	a/2 -Të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2019 (shitesë)	8000	VKB nr. 40, datë 26.04.2019.
4	I-Total nga të ardhurat e veta të planifikuara për vitin 2019	147,788	
5	II-Të ardhura të veta të trashëguara nga viti 2018	5110	VKB nr. 2, datë 22.01.2019
6	a-Transfertë e pakushtëzuar e çelur në vitin 2019	201742	VKB nr.187, datë 19.12.2018
7	b-Transfertë e pakushtëzuar e trashëguar nga viti 2018	3366	VKB nr. 2, datë 22.01.2019
8	III-Total Transfertë e pakushtëzuar	205108	
9	a-Transfertë specifike e çelur në vitin 2019	88917	VKB nr.187, datë 19.12.2018
10	b-Transfertë specifike e trashëguar nga viti 2018	680	VKB nr. 2, datë 22.01.2019
11	IV-Total Transferta specifike	89597	VKB nr. 2, datë 22.01.2019
12	Të ardhurat totale 2019 (Buxheti përfundimtar i planifikuar për të ardhurat: I+II-III-IV)	447603	
	Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2019		
1	a-Art. 600&601-Paga dhe sigurime	220363	VKB nr.187, datë 19.12.2018
2	b-Art. 600&601-Paga dhe sigurime (shitesë)	31	VKB nr. 2, datë 22.01.2019
3	I. Total Art. 600&601-Paga dhe sigurime	220394	
4	a-Art. 230&231 Investime	117072	VKB nr.187, datë 19.12.2018
5	b-Art. 230&231 Investime (shitesë)	6476	VKB nr. 2, datë 22.01.2019
6	Art. 230&231 Investime (shitesë)	7000	VKB nr. 15, datë 25.02.2019
7	c-Art. 230&231 Investime (shitesë)	8000	VKB nr. 40, datë 26.04.2019
8	II. Total Art. 230&231 Investime	138548	
9	Art. 602-Shpenzime operative	73308	VKB nr.187, datë 19.12.2018
10	Art. 602-Shpenzime operative (shitesë)	2650	VKB nr. 2, datë 22.01.2019
11	III. Total Art. 602-Shpenzime operative	75958	
12	Shpenzime Shuma I	434900	
13	Fondi rezervë nga granti	5813	VKB nr.187, datë 19.12.2018
14	Fondi rezervë nga të ardhurat	2656	VKB nr.187, datë 19.12.2018
15	Fondi kontigjencës nga granti	2907	VKB nr.187, datë 19.12.2018
16	Fondi kontigjencës nga të ardhurat	1328	VKB nr.187, datë

			19.12.2018
17	Shuma 2	12703	VKB nr.187, datë 19.12.2018
18	Total shpenzime Shuma 1+ Shuma 2 për vitin 2019 (Buxheti përfundimtar i planifikuar për shpenzimet)	447603	

Burimi: Bashkia Tropojë

Në planifikimin e PBA 2019-2021 dhe buxhetit vjetor 2019, nga auditimi u konstatuan se detyrimeve të prapambetura në datën 31.12.2018, sipas të dhënave të bilancit kanë vlerën 51,848,787 lekë (llog.401-408 -Furnitorë e llogari te lidhura me to + llog 467 ó Kreditor të ndryshëm). Gjithashtu nga auditimi i mëparshëm i KLSH janë konstatuar edhe detyrime të pa regjistruara në vlerën 31,279,137 lekë detyrime të pa regjistruara të konstatuar nga auditimi i mëparshëm, vlera reale është 83,127,924 lekë.

Planifikimi i të ardhurave që do të realizohen nga burimet e veta gjatë vitit 2019, në hartimin e buxhetit është llogaritur në vlerën 147,788 mijë lekë, e cila është një vlerë jo reale, tre herë më e madhe se vlera e të ardhurave të realizuara në vitin paraardhës 2017 dhe 2018, ndërkohë që neni 5 i ligjit nr. 68/2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, përcakton se në hartimin e buxhetit vjetor duhet bazuar në të ardhurat dhe shpenzimet faktike të viteve të mëparshëm.

Kriteret e vlerësimit: a- UMFE nr.9, datë 20.03.2018 òPër procedurat standarde të miratimit të buxhetitò, Rubrika -Rregulla dhe kriteret për përdorimin e buxhetit vendor, pika 106;

b-Ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, nenit nr.52 -Kryerja e shpenzimeve;

c-Ligjin nr. 68/2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, neni 33 -Kalendari i programit buxhetor afatmesëm dhe i buxhetit vjetor;

Kryerja e planifikimit të të ardhurave të vitit 2019, pa u mbështetur në të ardhurat faktike të realizuar në vitet e mëparshme, është në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, të ligjit nr. 68/2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, ku thuhet:

Në hartimin e buxhetit vjetor dhe të programit buxhetor afatmesëm njësitë e vetëqeverisjes vendore bazohen në parashikime realiste të të ardhurave dhe shpenzimeve faktike të viteve të mëparshme.

Nga Drejtoria Ekonomike, si strukturë përgjegjëse për hartimin e projektbuxhetit, si dhe Kryetari i Bashkisë Tropojë, si person përgjegjës që i propozon këshillit bashkiak programin buxhetor afatmesëm dhe projektbuxhetin vjetor duhet të ishin marrë masat si vijon:

-Vlera e planifikimit të të ardhurave nga burimet e veta gjatë vitit 2019, duhet të ishte mbështetur në vlerën e të ardhurave faktike të viteve të mëparshme.

- Nëse gjatë vitit do të kishte të ardhura shtesë (të realizuara), përdorimi i këtyre të ardhurave shtesë nga mbledhja e detyrimeve tatimore të pa mbledhura në kohë, i nënshtrohet procesit të rishikimit të buxhetit vjetor (pra në këtë rast bëhen shtesë në buxhet, kjo sipas kërkesave të pikës (e), neni 5, ligji nr. 68/2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendoreò.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi: Drejtori Ekonomik z. R. I., kryetari i Bashkisë Tropojë z. B. D., si dhe znj. F. D., me detyrë përgjegjëse e sektorit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2019.

Ndikimi/Efekti: Mos planifikimi i saktë i të ardhurave dhe mos korrigjimi i tyre gjatë vitit, ka sjellë edhe marrjen e angazhimeve të reja buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, duke mos zgjidhur çështjen e detyrimeve të prapambetura.

Shkaku: Mos zbatimi i kërkesave ligjore në procedurën e planifikimit të PBA dhe buxhetit vjetor 2019.

Rëndësia: E lartë.

Pretendimi i subjektit: Për sa më sipër në fazën e projektraporit është bërë observacion:

- Nga znj. V. B. dërguar në postën elektronike në adresën bmecaj@klsh.org.al, në datën 23.07.2021 (nuk është protokolluar në Bashkinë Tropojë);

- Nga znj. V. B. dhe z. R. I., protokolluar në KLSH me shkresën nr.361/17, datë 30.07.2021. Në të dy observacionet pothuaj trajtohen të njëjtat gjera (ku në mënyrë të përmbledhur thuhet: Kërkojmë të hiqet paragrafi: Në planifikimin e PBA 2019-2021 dhe buxhetin vjetor 2019 nga auditimi u konstatua se nuk janë planifikuar fonde për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura (faqe 11 e projekt raportit), për arsytet sa më poshtë:

Në PBA 2019-2021 dhe buxhetin e viti 2019 te miratuar me vendimin nr.187 date

18.12.2018, këto detyrime janë përfshire, janë planifikuar dhe për rrjedhojë janë likuiduar përgjatë vitit 2019.

Gjithashtu dhe në Vendimin nr.2 datë 22.01.2019 **“Për detajimin e buxheti të vitit 2019, me burim fondet e trashëguara nga viti 2018**”, nga totali në vlerën prej 5,703,738 leke,³

Në VKB nr.187 date 18.12.2018, në tabelën përkatëse janë paraqitur si detyrime investimet si me poshtë:

Për investimet:

1. Rikonstruksion Lagje e Paqes-Detyrim (i njësisë administrative Margegaj që nga viti 2015, detyrim i të gjithë kontratës në Shumën 10,6 milion lekë e përmblyllur në vitin 2019 ,për vlerën 4,000,000 leke-e likuiduar.
2. Ndërtim Urash, fshatrat shumice Prush Mëhallë e vjetër, Lugu i Tropojës, detyrim në vlerën 4,800,000 lekë-e likuiduar
3. Kanalizimi e prita në përenjt në lagjen Nimnaj, detyrim i vitit 2014, i Ministrise së Brendshme e likuiduar me buxhetin e vitit 2019 në vlerën 680,000 lekë -e likuiduar
4. Rrjeti Sekondar i ujësjellësit dhe lidhja e banesave me ujë të pijshëm-Detyrim i vitit 2015 ne Shumen 10,642,000 lekë-e likuiduar⁴

Sipas këtyre urdhër pagesave:

1. UP nr.69 date 29.01.201 në vlerën 10,641,648 leke **“Rrjeti sekondar i ujësjellësit dhe lidhja e banesave me ujë të pijshëm**-planifikuar me VKB nr.187 datë 18.12.2018-Detyrim óviti 2015.
2. UP nr.133 datë 22.02.2019 në vlerën 679,696 lekë **“Kanalizime prita ne përenjtë e lagjes Nimnaj- detyrim i vitit 2015”**.
3. UP nr 133 datë 26.02.2019 në vlerën 220,320 lekë **“supervizion Rikonstruksion rruga Lagje e Paqes-detyrim i vitit 2014 ish Komuna Margegajó**.
4. UP nr.317 datë 22.05.2019 në vlerën 350,304 leke-Supervizion
5. UP nr.322 datë 22.05.2019 në vlerën 1,343,900 leke **“Projektme rruge ish komuna dhe Bashkia B Curi Kompania ICP04”** detyrim i viteve 2011-2014 ish komunave dhe Bashkisë.

Totali i detyrimeve të përfshira në buxhetin e vitit 2019 dhe likuiduar është 19,942,000 lekë ,po ti shtojmë edhe vlerën e likuiduar sipas VKB nr.2 datë 22.01.2019 me fondet e trashëguara 5,703,738 ,vlera e përgjithshme e detyrimeve nga investimet është 25,645,738 lekë.

Për shpenzimet Operative

Sipas e Urdhër Pagesave(UP):

1. UP nr.31 date 24.01.2019 në vlerën 31,500 leke **“Shpenzime pritjeó** Detyrim i vitit 2018
2. UP nr.32 date 24.01.2019 në vlerën 208,000 leke **“Shërbim Interneti –Detyrim 2018**.
3. UP nr.33 date 25.01.2019 në vlerën 90,580 leke, **“Blerje bukeó** Detyrim i vitit 2018.

³Tabela nr.3 e vkb nr.2 datw 22.01.2019.

⁴VKB nr.187 date 18.12.2018, Tabela nr.4 Investimet

- 4.UP nr.34 date 25.01.2019 në vlerën 364,108 **öBlerje material për shërbime publike**-Detyrim i vitit 2018
- 5.UP nr.37 date 25.01.2019 në vlerën 211,560 lekë, **“Uniforma dhe veshje**ö planifikuar me VKB nr 187 date 18.12.2018.
- 6.UP nr.38 datë 25.01.2019 në vlerën 166,680 **öBlerje toner**-Detyrim i vitit 2018.
- 7.UP nr.39 datë 25.01.2019 në vlerën 244,440 lekë **öshërbim postar-komisione**ö fature tatimore 31.10.2018,-planifikuar me VKB nr.187 datë 18.12.2018-Detyrim óviti 2015.
- 8.UP nr.40 datë 25.01.2019 në vlerën 29,500 leke **öAktivitete**ö-detyrim i vitit 2018
- 9.UP nr 46 datë 28.02.2019 në vlerën 29,520 leke **“Blerje për shërbimet publike**-Detyrim I vitit 2018.
- 10.UP nr 42 date 25.01.2019 në vlerën 4,686,847 **öBlerje dru zjarri**-Kontrate 15.11.2016.
- 11.vlerën 89,676 **öBlerje për arsimin**-Detyrim 2018
- 12.UP nr 48 datë 28.01.2019 në vlerën 65,430 **öBlerje Materiale për shkolla**ö-Detyrim për vitin 2018/
- 13.UP nr.50 datë 28.01.2019 në vlerën 33,600 **öShpenzime pritje –Detyrim 2018”**.
- 14.UP nr 55 date 28.01.2019 në vlerën 162,600**öBlerje material për shkolla”**-Detyrim për vitin 2018.

Shpenzime operative totali likuiduar 6,414,041 lekë.

Vendime gjyqësore të planifikuara dhe likuiduara në vitin 2019 në vlerën 945,295 lekë

1.UP nr.56 date 28.01.2019 në vlerën 645,295 lekë **öVendim Gjyqësor Fabio Isufaj”-Detyrim i vitit 2014.**

2.UP nr.557 date 05.11.2019 në vlerën 300,000 leke ódetyrim i vitit 2004-ish komuna Bujan (Vendim Gjyqësore, dëmtim banese nga viti 1978).

Bashkangjitur janë :

1. Vendimin nr.187 date 19.12.2018ö Për miratimin e PBA-2019-2021,Buxhetit dhe numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Tropojë ,për vitin 2019,si vit i pare i PBA-së 2019-2021.
2. Vendimin nr.2 datë 22.01.2019 öPër detajimin e buxheti të vitit 2019,me burim fondet e trashëguara nga viti 2018ö,

Ky sqarim bëhet për të vërtetuar faktin se nga ana e Bashkisë Tropojë për vitin 2019 ishin planifikuar fonde për detyrimet.

Qëndrim i grupit të auditimit: Nëse i referohemi vlerave të bilancit të vitit 2018 vlera e llogarisë 401-408 në datën 31.12.2018 është 37,723,001 lekë , ndërsa në 31.12.2019 kjo vlerë është 110,112,904 lekë, e cila tregon se detyrimi është trefishuar. Llogaria tjetër 467 e detyrimeve është ulur me përafërsisht 1 milion lekë.

Pra në datën 31.12.2018 detyrimet e prapambetura (shuma e llogarisë 401-408 dhe 467) kanë një vlerë prej 51,848,787. Duke shtuar këtu edhe vlerën prej 31,279,137 lekë detyrime të pa regjistruara të konstatuar nga auditimi i mëparshëm, vlera reale e detyrimeve të prapambetura në datën 31.12.2018 është 83,127,924 lekë, vlerë e cila pas një viti, pra në 31.12.2019 ka shuar 123,151,017 lekë, pra detyrimi në 31.12.2019 del përafërsisht 40 milion lekë më shumë së në fillim të këtij viti. (e analizuar hollësisht në raportin e auditimit). Pra të gjitha analizat tregojnë se detyrimet e prapambetura janë rritur dukshëm nga një vit në tjetrin. Pretendimet tuaja se keni planifikuar detyrime të prapambetura në buxhetin e vitit 2019 qëndron, pasi keni paraqitur edhe dokumente për këtrë qëllim dhe për këtë qëllim është e nevojshme të korrektohet mënyra e të shprehurit nga audituesi i çështjes. Por çështja shikohet në tërësinë e vet dhe jo e shkëputur, pra nëse është planifikuar gjatë vitit 2019 një vlerë e caktuar për likuidim nga detyrimet e prapambetura të vitit 2018 dhe është likuiduar një pjesë e tyre, por gjatë këtij viti (2019) janë krijuar detyrime të reja të prapambetura dhe si rezultat përfundimtar detyrimet në fund të vitit 2019 janë rritur (si dhe ka ndodhur në fakt për mos realizimin e të ardhurave), atëherë nuk mund të pretendohet se janë marrë masa të plota për

shlyerjen e detyrimeve të prapambetura në total, pavarësisht kujt periudhe i përkasin, vitit 2018 apo 2019. Planifikimi i të ardhurave nga burimet e veta gjatë vitit 2019 është llogaritur në vlerën 147,788 mijë lekë, e cila është një vlerë e pa argumentuar, jo reale, tre herë më e madhe se vlera e të ardhurave të realizuara në vitet paraardhëse 2017 dhe 2018. Planifikimi i shpenzimeve mbi këtë plan të cilin nuk e ka realizuar dhe ky është një defekt në procesin e planifikimit. Por është e rëndësishme të thuhet se planifikimi dhe realizimi i buxhetit shikohen së bashku e jo të ndarë, pasi kur nuk realizohet plani i të ardhurave, duhet të rishikohet edhe plani i shpenzimeve. Observacioni juaj merret pjesërisht në konsideratë, duke mos mohuar faktin që keni llogaritur fonde për detyrimet e prapambetura (e cila do të korrektohet në raport), por keni krijuar sërish detyrime të reja dhe në këtë mënyrë nuk keni përmirësuar situatën e detyrimeve të prapambetura.

2. Titulli i gjetjes: Në planifikimin e PBA 2020-2022 dhe buxhetit vjetor 2020, për disa zëra nuk janë planifikuar fonde për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Mos planifikimi ka ardhur si rezultat i mos miratimit nga Titullari i Institucionit të propozimit të Drejtorisë Ekonomike për përfshirjen në PBA dhe buxhetin vjetor të detyrimeve të prapambetura për këto zëra shpenzimesh.

Situata:

Për vitin 2020. Treguesit për buxhetin afatmesëm të Bashkisë Tropojë, për periudhën 2020-2022, si dhe buxhetin e vitit 2020, janë miratuar me VKB nr.60, datë 30.12.2019, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Kukës me shkresën nr.2/4 prot., datë 14.01.2020, sipas tabelës në vijim. Në këtë vendim është miratuar: numri maksimal i punonjësve të Bashkisë Tropojë 352. Struktura organike mbi bazën e këtij numri është miratuar më urdhrin nr. 297/4, datë 24.01.2020 të kryetarit të Bashkisë z.R. B., si vijon:

a-Punonjës që paguhen nga transfertat e pa kushtëzuar dhe të ardhurat 191 (administrata 89, çerdhe 6, shërbime publike dhe mjedisi 86, drejtoria e kulturës, muzeut dhe biblioteka 6, sektori i klubit të sportit Valbona 4).

-b-Punonjës fondi i pagave të të cilëve përballohet nga transfertat specifike numri 150, si vijon: punonjës të arsimit bazë, të mesëm dhe mbështetës 84, punonjës të pyjeve dhe kullotave 27, punonjës të bordit të kullimit 5, punonjës të mirëmbajtjes së rrugëve rurale 17, punonjës të MZSH 17.

Punonjës fondi i pagave të të cilëve përballohet nga funksionet e deleguara, numri 11, si vijon: punonjës të gjendjes civile 9, punonjës të QKR 2.

Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2020 sipas VKB nr.60, datë 30.12.2019 është si më poshtë vijon

Tab.2

Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2020, sipas VKB nr.60, datë 30.12.2019. Në lekë		
	Burimi i të ardhurave për vitin 2020	Vlera
Nr	Të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2020	55,000,000
1	Transfertë e pakushtëzuar	206,870,000
2	Transfertë specifike	89,845,000
3	Të ardhurat totale	351,715,000
	Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2020	
1	Art. 600&601-Paga dhe sigurime	221,070,000
2	Art. 230&231 Investime (30% e vlerës)	75, 011,000
3	Art. 602-Shpenzime operative	32,066,000
4	Art.602-Shpenzime operative, këshilltarët (602)	9,500,000
5	Shpenzime Shuma 1	337,647,000
6	Fondi rezervë nga granti	5,934,000
7	Fondi rezervë nga të ardhurat	1,100,000

8	Fondi kontigjencës nga granti	2,967,000
9	Fondi kontigjencës nga të ardhurat	550,000
10	Fondi i emergjencës civile	3,517,000
11	Shuma 2	14,068,000
12	Total shpenzime Shuma 1+ Shuma 2	351,715,000

Burimi Bashkia Tropojë

Planifikimi i të ardhurave është i balancuar me planifikimin e shpenzimeve në fazën e planifikimit.

Në pikën nr.4 të VKB nr.60, datë 30.12.2019, për buxhetit të vitit 2020, nga këshilli bashkiak, është marrë vendim: Të bëjë shtyrjen e miratimit të grafikut të detyrimeve të prapambetura, sipas tabelës nr.2 për periudhën 2015-2019, të paraqitura në këshillin bashkiak, ku miratimi i tyre do të bëhet sapo të krijohen burime financiare nga rishikimi i planit të të ardhurave, ose rishikimi i transfertës së pakushtëzuar, sipas propozimit të kryetarit të bashkisë.

Nga auditimi u konstataua se buxheti i miratuar me VKB nr.60, datë 30.12.2019, ka diferenca me të dhënat e relacionit dhe projekt vendimit të përgatitur nga Drejtoria Ekonomike për këshillin bashkiak, por të pa miratuara nga Kryetari i Bashkisë z. R. B..

Në relacionin e përgatitur nga Drejtoria Ekonomike, datë 24.12.2019, nr.4071/2 prot., me lëndë "Relacion për PBA 2020-2022 dhe projektbuxhetin e vitit 2020 si vit i parë i PBA 2020-2022", rezulton se nga Drejtoria Ekonomike është parashikuar që në PBA 2020-2022 të llogariten fonde për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Tropojë në vlerën 89,562 mijë lekë, si dhe detyrimi prej 5,390 ndaj OSHEE (total 99,759 mijë lekë). Detyrimet janë rekomanduar të shlyhen për tre vite 2020-2022, në masën 30%, 30% dhe 40%. Për detyrimet për 5 investime në vlerën 68,072 mijë lekë është rekomanduar që të bëhen akt marrëveshje me operatorët ekonomik për shmangien e kamatëvonesave në pagesa, si dhe është planifikuar shlyerja e tyre për tre vite, 2020-2022, në vlerën 20421 mijë lekë, vlerën 20432 mijë lekë dhe vlerën 27,228 mijë lekë, për objektet:

Propozimi i bërë nga Drejtoria Ekonomike për detyrimet e prapambetura në PBA 2020-2022, në 000/lekë (i pa miratuar).

Tab.3

Nr.	Objekti i prokurimit	Furnitori	Vlera totale	Planifikuar për likuidim gjatë 2020	Planifikuar për likuidim gjatë 2021	Planifiku ar për likuidim gjatë 2022
1	Rikonstruksion rruge lagje ëDardania	H. 1	19539	5862	5862	7815
2	Rikonstruksion rruga auto Lekbibaj ó Curraj Eper	H. shpk	7935	2380	2380	3174
3	Rikonsruksion rruge lagjeje "28 Gushti" B.Curri	F. shpk	20513	6154	6154	8205
4	Sistemime Lagje "Partizani" B.Curri	M. shpk	13205	3961	3962	5282
5	Ndertim i rrjetit shperndares te ujesjellesit te fshatit Kasaj, Tropoje	T. shpk	6880	2064	2064	2752
	Shuma		68062	20421	20423	27228

Burimi Bashkia Tropojë

Propozimi i bërë nga Drejtoria Ekonomike për detyrimet e prapambetura në PBA 2020-2022, i pa miratuar nga kryetari i bashkisë, pasi prej Tij është propozuar në këshillin bashkiak varianti pa planifikuar detyrimet e prapambetura në PBA, por me përfshirjen e tyre në planifikim gjatë vitit në varësi të fondeve buxhetore të realizuara. Kryetari i bashkisë z. R. B.,

në relacionin me nr. 4071 prot., datë 26.12.2019, me lëndë ÷Informacion drejtuar këshillit bashkiak, drejtorisë ekonomike, p/sectorit të buxhetit dhe financës, sqaron se nuk mbështet plotësisht projektin e propozuar nga Drejtoria Ekonomike, për arsye se kjo e fundit nuk ka marrë parasysh të parashikoj prioritetet e vëna nga kryetari i bashkisë z. R. B., lidhur me rikonstruksionin e 5 segmenteve rrugore: 1-Kërnajë-Hoxhaj, 2-Kërnajë-Zhenaj, 3-Geghysen (Lekurtaj), 4-Cernice, 5-Rruga TPLA.

Në VKB nr. 60, datë 30.12.2019, e cila ka miratuar PBA 2020-2022 dhe buxhetin vjetor 2020, është miratuar tabela përmbledhëse e investimeve, pjesë e të cilës është vlera e tyre e plotë për 5 segmente rrugësh me objekt: ÷Rikonstruksion i 5 segmenteve rrugore. Segmentet rrugore të këtij investimi janë: 1-Kërnajë-Hoxhaj, 2-Kërnajë-Zhenaj, 3-Geghysen (Lekurtaj), 4-Cernice, 5-Rruga TPLA. Burimi i të ardhurave për këtë investim janë planifikuar të ardhurat e veta të bashkisë.

Në planifikimin e buxhetit të vitit 2020, vlera 75,011,000 për investimet, i përket 5 segmenteve rrugore të mësipërme, nga e cila vlera 8,582,991 i përket projekteve për këto investime. Tenderi për këto investime është zhvilluar në datën 23.11.2020 dhe për arsye të mos zhvillimit konkret të punimeve, nuk janë likuiduar fonde për zbatimin e investimit të mësipërm.

Në listën e prioriteteve të planifikuara dhe të miratuara në buxhetin e vitit 2020, është edhe investimi me objekt ÷Rikonstruksion kompleksi sportiv te lojërave me dore, në vlerën e planifikuar 9,268,620 lekë. Për këtë investim, me VKB nr.138, datë 23.09.2019 është marrë vendim për shtimin e fondeve në vlerën 3,000,000 lekë, me burim financimi shtesë grandë nga MFE, alokuar me shkresën nr.1364/1, datë 30.07.2020, me lëndë ÷Akordim nga fondi rezervë për njësitë e vetëqeverisjes vendore, për vitin 2020, në vlerën 4,000,000 lekë (nga e cila këshilli ka vendosur për investimin e mësipërm vetëm vlerën 3,000,000 lekë).

Me VKB nr. 93, datë 27.03.2020 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Tropojë për shtese në buxhetin fillestar, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 18,466,256 lekë, si vijon:

- të ardhura të trashëguara nga viti 2019 në vlerën 8,051,136 lekë;
- të ardhura nga transfertat e pakushtëzuar në vlerën 6,232,303 lekë;
- të ardhura nga transfertat specifike në vlerën 4,182,817 lekë;

Në total të ardhurat: 18,466,256 lekë.

Këto të ardhura janë miratuar të shpenzohen vetëm për artikullin 602 ÷shpenzime operative.

Tab.4

Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2020, sipas VKB 93, datë 27.03.2020 (shtesë në buxhetin e miratuar me VKB nr.60, datë 30.12.2019 . Në lekë	
Burimi i të ardhurave për vitin 2020	Vlera
Të ardhura të trashëguara nga viti 2019	8,051,136
Të ardhura nga transfertat e pakushtëzuar	6,232,303
Të ardhura nga transfertat specifike	4,182,817
Të ardhurat totale	18,466,256
Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2020 me të ardhurat e mësipërme	
Artikulli 602 –Shpenzime operative	18,466,256
Të ardhura nga grandë i kushtëzuar i akorduar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës	13,861,904
Planifikimi i shpenzimit të grandit	
÷Ujësjetësuesi i fshatit Dragobi	13,861,904

Burimi Bashkia Tropojë

Për alokimin e grandit në vlerën 13,861,904 lekë, pasqyruar në tabelën e mësipërme, Bashkia Tropojë është njoftuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës me shkresën nr. 1884.prot., datë 23,07,2020, me lëndë ÷Dërgohet detajimi i aktit normativ nr.28, datë 02,07,2020, për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për programin ÷Furnizimi me

ujë dhe kanalizime. Ky grand ka pasur si destinacion shpenzimi investimin me objekt ÕUjësjetllësi i fshatit Dragobi, investim i cili është miratuar me VKB. nr.59 dt.30.12.2019.

Në total, miratimi i buxhetit përfundimtar i Bashkisë Tropojë për vitin 2020, sipas burimit të financimit, drejtimeve të shpenzimeve dhe VKB për miratim ka vlerën 388,043,160 lekë, miratuar me:

- VKB nr. 60, datë 30.12.2019, i cili ka miratuar PBA 2020-2022 dhe buxhetin vjetor 2020 (në total të ardhurat dhe shpenzimet në vlerën **351,715,000 lekë**);

- VKB nr. 93, datë 27.03.2020, i cili ka miratuar të ardhurat e trashëguara, të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuar, të ardhura nga transfertat specifike, si dhe shpenzimet mbi bazën e këtyre të ardhurave, në total **18,466,256 lekë**.

- Grandit të kushtëzuar, i akorduar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës në vlerën **13,861,904 lekë**;

- Grantit të kushtëzuar të akorduar nga MFE në vlerën **4,000,000 lekë**, buxheti total i Bashkisë Tropojë për vitin 2020 është në vlerën 388,043,160 lekë si vijon (nuk përfshihet ndihma ekonomike dhe PAK):

Tab.5

Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2020, Bashkia Tropojë. Në lekë (Buxheti përfundimtar i planifikuar pa ndihmën ekonomike dhe PAK)		
	Burimi i të ardhurave për vitin 2020	Vlera
Nr	a-Të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2020	55,000,000
	b-Të ardhura të veta të trashëguara nga viti 2019	8,051,136
1	a-Transfertë e pakushtëzuar	206,870,000
	b- Transfertë e pakushtëzuar	6,232,303
2	a-Transfertë specifike	89,845,000
	b-Transfertë specifike	4,182,817
	a-Të ardhura nga granti i kushtëzuar	13,861,904
	b- Të ardhura nga granti i kushtëzuar	4,000,000
3	Të ardhurat totale 2020 (Buxheti përfundimtar i planifikuar për të ardhurat)	388 043 160
Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2020		
1	Art. 600&601-Paga dhe sigurime	221,070,000
2	Art. 230&231 Investime (30% e vlerës)	92 872 904
3	Art. 602-Shpenzime operative	50 532 256
4	Art.602-Shpenzime operative, këshilltarët (602)	9,500,000
5	Shpenzime Shuma 1	369 975 160
6	Fondi rezervë nga granti	5,934,000
7	Fondi rezervë nga të ardhurat	1,100,000
8	Fondi kontigjencës nga granti	2,967,000
9	Fondi kontigjencës nga të ardhurat	550,000
10	Fondi i emergjencës civile	3,517,000
11	Shuma 2	14,068,000
12	Total shpenzime Shuma 1+ Shuma 2 për vitin 2020 (Buxheti përfundimtar i planifikuar për shpenzimet)	388 043 160

Burimi Bashkia Tropojë

Kriteret e vlerësimit: Mos përfshirja në PBA 2020-2022 dhe projektbuxhetin e vitit 2020 si vit i parë i PBA 2020-2022, i detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me:

a- UMFE nr.9, datë 20.03.2018 ÕPër procedurat standarde të miratimit të buxhetit, Rubrika - Rregulla dhe kriteret për përdorimin e buxhetit vendor, pika 106, thuhet:

Në miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave të shpenzimeve më parë do të mbulohen detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe pastaj fondet për të financuar veprimtarinë e vitit në vazhdim.

b-Ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, nenit nr.52 -Kryerja e shpenzimeve ku thuhet:

...Shpenzimet, që rezultojnë nga angazhime të marra përsipër gjatë viteve të mëparshme, në përputhje me dispozitat e veçanta të ligjit të buxhetit vjetor, përfshihen në buxhetin e vitit pasardhës”.

c-Ligjin nr. 68/2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendore, neni 33 -Kalendari i programit buxhetor afatmesëm dhe i buxhetit vjetor, ku thuhet:

Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe dërgon për miratim në këshillin e njësisë, kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, bazuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave për procedurat standarde për përgatitjen e kërkesave buxhetore të programit buxhetor afatmesëm qendror e vendor

Mbështetur në detyrimin ligjor për hartimin e buxhetit, Kryetari i Bashkisë Tropojë, si person përgjegjës që i propozon këshillit bashkiak programin buxhetor afatmesëm dhe projektbuxhetin vjetor, krahas prioriteteve strategjike të zhvillimit të njësisë vendore, duhet të kishte parashikuar në PBA 2020-2022 dhe projektbuxhetin vjetor 2020, edhe fonde për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, për mos parashikimin në PBA 2020-2022 dhe projektbuxhetin vjetor 2020 të fondeve për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, ngarkohet me përgjegjësi kryetari i Bashkisë Tropojë z. R. B..

-U auditua llogaritja e fondit rezervë, kontigjencës dhe emergjencës dhe në llogaritjet e bëra nga njësia vendore u konstatua se janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 139/2015 ”Për vetëqeverisjen vendore, për këtë qëllim. Gjithashtu u auditua përdorimi i të ardhurave. Në mënyrë të zgjeruar trajtimi këtyre dy çështjeve paraqitet në aneksin nr.1/3, bashkangjitur raportit të auditimit.

Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura. Saktësia dhe shkalla e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Përdorimi i të ardhurave.

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2019

Për vitin 2019, planifikimi i buxhetit për zërin e shpenzimeve, duke përfshirë edhe ndihmën ekonomike dhe PAK, ka vlerën **727603976** lekë, ndërsa realizimi në vlerën **709891068** lekë, ose nëmasën 98%. Zëri paga është planifikuar në vlerën 178577416 lekë dhe është realizuar në vlerën 175419844 lekë, ose në masën 98%, zëri sigurime shoqërore dhe shëndetësore planifikuar 30294900 lekë, realizuar 29165864 lekë, ose në masën 96%.

Artikulli 602 -Shpenzime operative i cili është planifikuar në vlerën 67,538,988 lekë dhe është realizuar në vlerën 43,670,424 lekë, ose në masën 64%, si dhe artikulli 231 - Investimeve, i cili është planifikuar në vlerën 105,010,251 lekë dhe është realizuar në vlerën 79,470,423 lekë, ose në masën 76%. Zëri óShpenzime për paga është realizuar në masën 99%, nga 175,902,200 lekë i planifikuar është realizuar në vlerën 175,136,765 lekë.

Buxheti përfundimtar plan-fakt Bashkia Tropojë, për vitin 2020.

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2020

Për vitin 2020, planifikimi i buxhetit për zërin e shpenzimeve, duke përfshirë edhe ndihmën ekonomike dhe PAK, ka vlerën 734,239,239 lekë, ndërsa realizimi në vlerën 672,527,570 lekë, ose nëmasën 92%. Zëri që ka nivelin më të ulët të realizimit është artikulli 602 - Shpenzime operative i cili është planifikuar në vlerën 67,538,988 lekë dhe është realizuar në vlerën 43,670,424 lekë, ose në masën 64%, si dhe artikulli 231 -Investimeve, i cili është

planifikuar në vlerën 105,010,251 lekë dhe është realizuar në vlerën 79,470,423 lekë, ose në masën 76%. Zëri 6 Shpenzime për paga është realizuar në masën 99%, nga 175,902,200 lekë i planifikuar është realizuar në vlerën 175,136,765 lekë.

Për vitin 2019, sipas burimit të financimit, mbulimi i shpenzimeve me fonde: Në shpenzimet totale, nga të ardhurat e veta është mbuluar vlera prej 47,695,924 lekë, nga transfertat e pakushtëzuar vlera 260,567,372 lekë, nga transfertat e kushtëzuar specifike vlera 89,912,077 lekë, nga transfertat e kushtëzuar për funksionet e deleguara vlera 298,449,678 lekë, nga transfertat e kushtëzuar për investimet vlera 13,266,017 lekë, të pasqyruara në tabelë sipas aneksit nr. 1/4, bashkangjitur raportit të auditimit.

Për vitin 2020, sipas burimit të financimit, mbulimi i shpenzimeve me fonde:

Në shpenzimet totale, nga të ardhurat e veta është mbuluar vlera prej 14,341,141 lekë, nga transfertat e pakushtëzuar vlera 181,471,679 lekë, nga transfertat e kushtëzuar specifike vlera 89,203,192 lekë, nga transfertat e kushtëzuar për funksionet e deleguara vlera 335,296,743 lekë, nga transfertat e kushtëzuar për investimet vlera 52,214,815 lekë, të pasqyruara në tabelë sipas aneksit nr. 1/5, bashkangjitur raportit të auditimit.

Përqindja e secilit zë të shpenzimeve faktike në shpenzimet totale për vitin 2020

Shpenzimet totale së bashku me ndihmën ekonomike janë në vlerën 672,527,570 lekë, ndërsa pa ndihmën ekonomike dhe PAK janë në vlerën 332,091,750 lekë. Vlera e ndihmës ekonomike dhe PAK është 340,435,820, ose 51% e të gjithë buxhetit total të shpenzuar gjatë vitit 2020.

Tab.6

Zërat e shpenzimeve	Vlera në % e secilit zë shpenzimi mbi shpenzimet totale, (duke llogaritur në shpenzimet totale edhe ndihmën ekonomike dhe PAK)	Vlera në % e secilit zë shpenzimi mbi shpenzimet totale (pa llogaritur në shpenzimet totale ndihmën ekonomike dhe PAK)
Artikulli - 600 Paga	26	53
Artikulli - 601 Sig. shoqërore & shënd	4	9
Artikulli - 602 Shpenzime operative	6	13
Artikulli - 231 Investime	11	23
Artikulli - 604 Emergjencia civile	0.5	1
Artikulli 606-Shperblime lindje	0.1	0.3
Artikulli 606-Ndihme dhe PAK	51	

Burimi Bashkia Tropojë

Duke krahasuar peshën specifike që ka secili zë i shpenzimeve në shpenzimet totale vjetore për vitin 2020 (së bashku me ndihmën ekonomike dhe PAK), rezulton si vijon:

Për vitin 2020 peshën specifike më të madhe e zënë shpenzimet për pagat e personelit, në masën 26% të shpenzimeve totale, shpenzimet për investime 11%, shpenzimet operative 6%, shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore 4%, shpenzimet për ndihmës ekonomike dhe PAK 51%.

Fondet e shpenzuara për përbalimin e situatës së pandemisë nga Covid 19

Në VKB nr. 60, datë 30.12.2019 është miratuar për vitin 2020 fondi rezervë, i kontigjencës, si dhe fondi i emergjencës në total 14,068 mijë lekë, si vijon:

- fondi rezervë nga granti në vlerën 5,934 mijë lekë;
- fondi rezervë nga të ardhurat në vlerën 1,100 mijë lekë;
- fondi kontigjencës nga granti në vlerën 2,967 mijë lekë;

- fondi kontigjencës nga të ardhurat në vlerën 550 mijë;
- fondi i emergjencës civile në vlerën 3,517 mijë lekë.

VKM nr. 236, datë 19.03.2020 òPër miratimin e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga Covid 19, midis të tjerash ka vendosur:

Ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë nga strukturat shtetërore, në kushtet e epidemisë të shkaktuar nga COVID-19.

Ofrimi i asistencës, sipas këtij vendimi, do të konsistojë në dërgimin e pagesave mujore që subjektet përfitojnë nga programi i mbrojtjes sociale nga sigurimet shoqërore dhe në dërgimin e produkteve, ushqimore e jo ushqimore, minimale, barnave të rimbursueshme dhe atyre me kërkesë, për përballimin e situatës apo në kryerjen e furnizimeve me produktet e mësipërme, për llogari të tyre.

Për përballimin e situatës Covid 19, Këshilli i Ministrave me vendim nr.243, datë 24.3.2020 òPër shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, ka vendosur òShpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

Mbështetur në nenin 65 të ligjit nr.45/2019 òPër mbrojtjen civile, Bashkitë, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të këtij ligji, mbështeten në parashikimin minimal prej 4 për qind të totalit të buxhetit vjetor të tyre, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit. Bashkitë mund të planifikojnë fonde të tjera shtesë nga burimet financiare, si të ardhurat e veta vendore etj.

Me shkresën nr.23198/1 prot., datë 24.12.2019 të Ministrit të Financave me lëndë òMbi parashikimin e fondeve buxhetore të emergjencave civile nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, është kërkuar prej bashkive: òNë vijim të procesit të miratimit të buxhetit 2020 nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, lidhur me parashikimet e fondeve për rastet e emergjencave civile në buxhetin vendor 2020, ju bëjmë me dije se: Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr.45/2019 òPër mbrojtjen civile, njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të parashikojnë nga burimet e veta të financimit për emergjencat civile, jo më pak se 1.7% të totalit të buxhetit. Pjesa tjetër e financimit për mbrojtjen civile do të mbulohet në formën e transfertës së kushtëzuar nga buxheti qendror në vitin buxhetor 2020.

Në detyrim sa më sipër nga Bashkia Tropojë në buxhetin e vitit 2020 është parashikuar fondi i emergjencës civile në vlerën 3,517 mijë lekë, në masën 1.7% të buxhetit, (duke ju referuar ò transfertës së pakushtëzuar në vlerën 206,870 mijë lekë).

Me shkresën nr.1650 prot., datë 24.03.2020, të Ministrit të Mbrojtjes me lëndë òKërkesë për marrjen e masave urgjente për përdorimin e fondeve për mbrojtjen civile (tepër urgjente), drejtuar të gjitha bashkive të vendit, thuhet ò Në mbështetje të nenin 65 të ligjit nr.45/2019 òPër mbrojtjen civile, ...bashkitë për zvogëlimin e rrishtit nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, mbështeten në parashikimin minimal prej 4% të totalit të buxhetit vjetor të tyre, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit. Në këtë shkresë është kërkuar që bashkitë të raportojnë për vlerën e fondeve që kanë në dispozicion për mbrojtjen civile dhe sa për qind të buxhetit përbëjnë.

Në zbatim sa më sipër, me vendimin e këshillit bashkia Tropojë nr. 98, datë 09.04.2020 (konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Kukës me shkresën nr.2/29, datë 24.04.2020), është bërë ndryshimi në buxhetin e vitit 2020, i vlerës së fondit të emergjencës nga 1.7% në 4%, pra nga 3,517 mijë lekë, në 8,275 mijë lekë (4%*206,870). Fondet e shtuara për të plotësuar 4% janë marrë nga fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës.

VKB nr. 98, datë 09.04.2020: *Të miratojë ndryshimin në buxhet sipas tabelës bashkangjitur nga 1.7% në 4% (lidhur me fondin e emergjencës). Këto burime të përdoren sipas nevojave me urdhër të titullarit, mbështetur në procesverbalet e komisionit sipas vazhdimësisë.*

Pra, Bashkia Tropojë ka pasur në dispozicion për të shpenzuar nga fondi i emergjencave për situatën Covid 19, vlerën 8,275 mijë lekë, prej të cilit është shpenzuar vlera 6,461,234 lekë, për dy objekte prokurimi:

1- ÷Blerje pako ushqimore për raste emergjence Covid 2019÷, në vlerën e kontratës 3,456,250 lekë pa TVSH, ose vlerën 4,147,500 lekë me TVSH, zhvilluar në muajin maj 2020;

2- ÷Shërbime dezinfektimi pandemia Covid 2019÷, në vlerën e kontratës 1,928,112 lekë pa TVSH, ose vlerën 2 313 734 lekë me TVSH, zhvilluar në muajin maj 2020 .

Me shkresën nr.19697 prot., datë 20.10.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të MFE është bërë alokimi i transfertës specifike ÷Për mbrojtjen civile÷, në vlerën 2,993 mijë lekë, e cila nuk është shpenzuar ende.

Si përfundim, burimi i financimit të fondeve të planifikuara për shkak të situatës Covid 19, janë fondet ÷Për mbrojtjen civile÷. Vlera e këtyre fondeve të miratuara dhe të shpenzuara paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr	Burimi i financimit	Vlera e planifikuar	Vlera e shpenzuar	Vlera e pa shpenzuar
1	Transfertë e pakushtëzuar	8,275	6,461	1,814
2	Transfertë specifike (e kushtëzuar)	2,993	0	2,993
	Total	11,268	6,461	4,807

3. Titulli i gjetjes: Mos hartimi i raporteve të monitorimit për zbatimin e buxhetit për vitin 2019 dhe 2020.

Raportet e monitorimit të treguesve buxhetor. Nga ish kryetari i bashkisë z. B. D. për vitin 2019 dhe kryetari aktual z. R. B. për vitin 2020, nuk janë zbatuar detyrimeve ligjore për hartimin e raporteve të monitorimit për zbatimin të buxhetit, pasi nuk janë bërë raportet periodike për zbatimin e tij (buxhetit). Kjo ka sjellë mos informimin e këshillit bashkiak për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për vitin buxhetor, si dhe mos marrjen e masave për korrigjimin e buxhetit gjatë vitit, gjë e cila ka qenë e nevojshme sidomos gjatë vitit 2019, ku është planifikuar një buxhet mbi bazën e të ardhurave të veta jashtë mundësisë reale të njësisë vendore, në vlerën 147,788 mijë lekë, tre herë më shumë se vlera e realizuar në vitet e fundit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e:

- nenit 44 -Raporti vjetor, të ligjit nr. 139/2015 ÷Për vetëqeverisjen vendore÷, ku thuhet:

÷Kryetari njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim të këshillit për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport i paraqitet këshillit jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.

- nenin 47 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, i ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 ÷Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ku thuhet:

Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore bën një analizë të plotë të zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor të çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, edhe propozimet përkatëse për ndryshimin e vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, që ka miratuar buxhetin e vitit. Procedura e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve të vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore është e njëjtë me atë të vendimit për miratimin e buxhetit vjetor.

-nenin 101 të UMFE nr.9, datë 20.03.2018 ÷Për procedurat standarde të miratimit të buxhetit÷, ku thuhet:

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, kanë të drejtë, sipas ligjit për vetëqeverisjen vendore dhe financat e vetëqeverisjes vendore, të kryejnë rishikimin e buxhetit të miratuar në përputhje

me realizimin e të ardhurave dhe me ndryshimin e prioriteteve gjatë vitit. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore brenda datës 30 qershor analizon zbatimin e buxhetit dhe i propozon këshillit të njësisë ndryshimin e buxhetit, në rast se është e nevojshme. Ndryshimi i buxhetit gjatë vitit do të ndjekë të njëjtën rrugë procedurale të miratimit të buxhetit në fillim të vitit.

Vlerësimi i rrisqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

Titulli i gjetjes: Mos marrja e masave për likuidimin e detyrimeve të prapambetura gjatë vitit 2019 dhe 2020

Situata:

Detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2019

Bazuar në shkresën e Bashkisë Tropojë nr.553 prot., datë 07.12.2019, me lëndë oDërgojmë detyrimet për tremujorin e katërt të vitit 2019, drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, konstatohet se vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta të Bashkisë Tropojë, në datën 31.12.2019 është 109,616,278 lekë. Ky detyrim përbëhet nga:

- detyrime të prapambetura për investime në vlerën 89,246,109 lekë, ose 81% të totalit të detyrimeve;
- detyrime të prapambetura për mallra dhe shërbime në vlerën 10,087,060 lekë, ose 9% të totalit të detyrimeve;
- detyrime të prapambetura për vendime gjyqësore në vlerën 10,283,109 lekë, ose 10% të totalit të detyrimeve.

Bazuar në aktin e rakordimit me degën e thesarit Kukës, datë 24.01.2020, konstatohet se detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2019 kanë vlerën 24,305,203 lekë, ose 5 herë më pak se vlera e raportuar në Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Sipas këtij akti rakordimi detyrimet përbëhen si vijon:

- detyrime për investime në vlerën 5,889,905 lekë;
 - detyrime të prapambetura për vendime gjyqësore në vlerën 11,117,199 lekë;
 - detyrime të prapambetura për mallra dhe shërbime në vlerën 6,531,627 lekë;
 - shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambetura, në vlerën 766,472 lekë.
- Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar në pasqyrat financiare të vitit 2019, konstatohet se vlera e llogarisë 486 oShpenzime të periudhave të ardhshme, është 0 lekë, ndërsa vlera e llogarisë 401-408 -Furnitorë e llogari te lidhura me to, është 110,112,904. Gjithashtu nga auditimi i llogarisë 467 -Kreditorë te ndryshëm, ka vlerën 13,038,113 lekë. Pra në total sipas pasqyrave financiare, shuma e llogarisë 401-408 dhe llogarisë 467 japin një vlerë të detyrimeve të prapambetura prej 123,151,017 lekë. Pasqyrat financiare të vitit 2019 pasqyrojnë një vlerë të detyrimeve të prapambetura prej 13,534,739 lekë më shumë se vlera e raportuar në MFE.

Gjatë vitit 2019 nuk janë marrë masa të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe nuk janë marrë masa për likuidimin e të gjitha angazhimeve buxhetore të marra gjatë vitit 2019, duke krijuar detyrime të reja. Nga auditimi i pasqyrave financiare konstatohet se në datën 31.12.2018 detyrimet e prapambetura (shuma e llogarisë 401-408 dhe 467) kanë një vlerë prej 51,848,787. Duke shtuar këtu edhe vlerën prej 31,279,137 lekë detyrime të pa regjistruara të konstatuar nga auditimi i mëparshëm, vlera reale e detyrimeve të prapambetura në datën 31.12.2018 është 83,127,924 lekë, vlerë e cila pas një viti, pra në 31.12.2019 ka shuar 123,151,017 lekë. Për këtë ngarkohet me përgjegjësi z. R. I. me detyrë ish drejtor ekonomik, në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe znj. V. B. me detyrë ish përgjegjëse e financës (sipas rregullores së brendshme përgjegjësi ka për detyre regjistrimin e detyrimeve të

konstatuara, përgatitjen çeljen mujore të fondeve për njësinë shpenzuese për paga, sigurime, shpenzime korente e investime), z. B. D., me detyrë ish kryetar i bashkisë Tropojë.

Detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2020

Bazuar në shkresën e Bashkisë Tropojë nr.356/1 prot., datë 03.03.2021, me lëndë òNë përgjigje të shkresës nr.1542, datë 26.010.2021ò, drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, konstatohet se vlera e detyrimeve të prapambetura, me burim financimi të ardhurat e veta në datën 31.12.2020 është 75,620,737 lekë, e cila përbëhet nga:

- detyrimet për shpenzimet kapitale në vlerën 65,316,107 lekë, ose 86% të totalit të detyrimeve;

- detyrimet korente në vlerën 3,574,046 lekë, ose 5% të totalit të detyrimeve;

- detyrimet për vendimet gjyqësore në vlerën 6,730,584 lekë, ose 9% të totalit të detyrimeve.

Bazuar në aktin e rakordimit me degën e thesarit datë 17.03.2021, konstatohet se detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2020 kanë vlerën 76,625,373 lekë, ose 1,004,636 lekë më shumë se vlera e raportuar në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë. Sipas këtij akti rakordimi detyrimet përbëhen si vijon:

- detyrime për investime në vlerën 65,316,107 lekë;

- detyrime të prapambetura për vendime gjyqësore në vlerën 7,735,220 lekë;

- detyrime të prapambetura për shërbime në vlerën 1,183,360 lekë;

- detyrime të prapambetura për mirëmbajtje në vlerën 2,390,686 lekë.

Gjatë vitit 2020 nuk janë marrë masa të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura. Nga auditimi i pasqyrave financiare konstatohet se në datën 31.12.2019 detyrimet e prapambetura (shuma e llogarisë 401-408 dhe 467) kanë një vlerë prej 123,151,017 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 kjo vlerë është 121,462,192 lekë, duke pësuar ulje vetëm prej 1,688,825 lekë.

Për këtë ngarkohet me përgjegjësi z. B. T. me detyrë drejtor ekonomik, z. R. B., me detyrë kryetar i bashkisë Tropojë.

Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar në pasqyrat financiare të vitit 2020, konstatohet se vlera e llogarisë 486 òShpenzime të periudhave të ardhshmeò, është 0 lekë, ndërsa vlera e llogarisë 401-408 -Furnitorë e llogari te lidhura me to, është 108,423,719 lekë.

Gjithashtu nga auditimi i llogarisë 467 -Kreditorë te ndryshëm, ka vlerën 13,038,113 lekë. Pra në total sipas pasqyrave financiare, shuma e llogarisë 401-408 dhe llogarisë 467 japin një vlerë të detyrimeve të prapambetura prej 121,462,192 lekë. Pasqyrat financiare të vitit 2020 pasqyrojnë një vlerë të detyrimeve të prapambetura prej 45,841,455 lekë më shumë se vlera e raportuar në MFE.

Për të dy vitet 2019 dhe 2020, diferenca midis vlerës së raportuar në MFE dhe vlerës së që pasqyrojnë pasqyrat financiare, sipas shpjegimeve të dhëna nga drejtoria e financës vjen për shkak se për këtë diferencë nuk ka të dhëna të sakta për kreditorët, pasi janë të mbartura nga vitet e mëparshme dhe nga bashkia kjo diferencë nuk është pasqyruar në raportimet e bëra në MFE.

Kriteret e vlerësimit: Mos marrja e masave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me: ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, neni 40, 52 -Kryerja e shpenzimeve, ku thuhet:

Neni 52:Shpenzimet, që rezultojnë nga angazhime të marra përsipër gjatë viteve të mëparshme, në përputhje me dispozitat e veçanta të ligjit të buxhetit vjetor, përfshihen në buxhetin e vitit pasardhës”.

- udhëzimit plotësues për zbatimin e buxhetit të vitin 2019 (edhe 2020) pika 107 thuhet :

“Në buxhetin vendor të vitit 2019, duhet të përfshihet edhe shlyerja e detyrimeve të prapambetura të akumuluar ndër vite. Plani i shlyerjes së këtyre detyrimeve duhet të jetë jo

më i ulët se shuma e raportuar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore me shkresë zyrtare në MFE

Gjithashtu veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMF nr. 5, datë 27.02.2014 òPër shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaò ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014;

Ndikimi: Mos shlyerja e detyrimeve të prapambetura dhe marrja e angazhimeve të reja buxhetore pa pasur fonde në dispozicion vë në vështirësi financat e njësisë vendore, nuk zbaton detyrimet kontraktuale me kreditorët, duke vënë në vështirësi financiare edhe këta të fundit.

Shkaku: Mos marrja e masave sipas procedurave ligjore për likuidimin e detyrimeve të prapambetura; marrja e angazhimeve buxhetore të reja pa pasur fonde në dispozicion.

Rëndësia: E lartë

Vlerësimi i rrisqeve buxhetore nga zbatimi i vendimeve gjyqësore.

Për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2019 dhe vitin 2020 nuk janë kryer pagesa.

Sipas të dhënave të bashkisë Tropojë, ka vetëm një vendim gjyqësor për çështje të largimeve të punonjësve nga puna, në vlerën 755,000 lekë, e cila është si vlerë të mbartur nga vite të mëparshme, por bashkia nuk ka të dhëna për emrin e kreditorit, vendimin e gjykatës etj.

Për çështje që lidhen me largimet e punonjësve nga puna gjatë vitit 2019 janë zhvilluar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tropojë 7 çështje gjyqësore të cilat aktualisht janë në Gjykatën e Apelit. Për vitin 2020 janë hapur 15 çështje gjyqësore, nga të cilat 2 në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Shkodër, 13-të Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropoje.

Në datën 01.01.2019, Bashkia Tropojë ka pasur si detyrim shlyerje 4 vendime gjyqësore të ardhura nga ish komunat (i përkasin vitit 2004, 2013 dhe 2015), në vlerën 7,619,483, të cilat lidhen me problematika të ndryshme nga ajo e largimit të punonjësve nga puna. Gjatë vitit 2019 nga auditimi i ditarit të bankës konstatohet se është likuiduar vlera 1,396,728 lekë (për dy prej këtyre vendimeve së bashku me një vlerë përmbartimore) është. Për vitin 2020 nuk janë kryer pagesa për zbatimin e vendimeve gjyqësore.

Për sa më sipër pritshmëria e efekteve të vendimeve gjyqësore për largimet e punonjësve nga puna, në buxhetin e njësisë vendore, pritet të jetë e lartë. Kjo situatë tregon se Bashkia Tropojë si punëdhënëse, në marrëdhënien që ka më punonjësit e vet, duhet të tregojë vëmendje maksimale dhe të zbatojë të gjitha detyrimet kontraktuale të kontratës së punës, si dhe detyrimet që rrjedhin nga kuadri rregullator në fuqi në lidhje me statusin e nëpunësit civil, në mënyrë që të shmang efektet negative në buxhet për shkak të zbatimit të vendimeve gjyqësore, për çështje që lidhen me largimet e punonjësve nga puna.

Celja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Për vitin 2019 pranë bashkisë Tropojë janë financuar dy investime nga Fondi i Zhvillimit Rajoneve nëpërmjet Ministrisë Arsimit dhe Sportit konkretisht:

1. Shkolla Asim Vokshi-Palester dhe terrene sportive dhe sistemime të jashtme në gjimnazin "Asim Vokshi" REF-18885-04-18-2019, kontrate nr.15 date 24.09.2019 vlera e kontratës 59,441,140 leke me tvsh lidhur me operatorin 4.M shpk. Vlera e kësaj kontrate për pjesën që i takon financimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit është financuar komplet nga ana e tyre gjatë vitit 2019. Nuk ka detyrime nga ana e MAS të trashëguara për vitin 2020.

2. Rikonstruksion i shkollës "Tinka Kurti", Lekbibaj REF-18199-04-16-2019 kontrate nr.12 date 27.06.2019. Vlera e kontratës 22 417 160 leke me tvsh, operatori H. 1.&Sh. shpk, Vlera e kësaj kontrate për pjesën që i takon financimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit është

financuar komplet nga ana e tyre gjate vitit 2019. Nuk ka detyrime nga ana e MAS te trashëguara për vitin 2020.

Për vitin 2020 është financuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtar e ujësjellës Kanalizime, objekti i prokurimit ò Ujësjellësi i fshatit Dragobiò, me vlerë totale 70,921,175 lekë. Ky financim shtrihet në vitet buxhetore 2020-2020, dhe për vitin 2020 është financuar e gjithë vlera e parashikuar, përkatësisht vlera 13,861,04 lekë për investimin dhe vlera 276,240 lekë për supervizim.

Pika 2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe nxjerrja e detyrimeve tatimore e ndarë sipas viteve.

Në zbatim të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Vendimet e Këshillit Bashkiak Tropojë për miratimin e paketave fiskale të viteve 2019 dhe 2020;
- Pasqyrat financiare në lidhje me arkëtimet, kontabilizimin dhe pasqyrimin e të ardhurave nga subjektet, familjarët, taksat e tokës, etj.;
- Dokumentacioni i zyrave të financës dhe tatim-taksave në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave të tatim-paguesve;
- Regjistrimi dhe mbajtja e Debitorëve për bizneset dhe familjarët, si për taksat ashtu edhe për tarifatat vendore;
- Analiza dhe pasqyra financiare të planifikimit të të ardhurave për vitet 2019 dhe 2020;
- Realizimi faktik i të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara;
- Dokumentacioni në lidhje me agjentët tatimorë, rakordimet me ta, me thesarin, etj.;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga zyra e financës dhe e tatim-taksave;
- Vendimi i Këshillit Bashkisë nr.176, datë 23.11.2018 òPër miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore, në bashkinë e Tropojë viti 2019ò, ndryshuar me VKB nr.16, datë 25.02.2019 të konfirmuara ligjshmëria nga Prefekti Qarkut Kukës me shkresën nr.2/65, datë 05.12.2018;
- Vendimi Këshillit Bashkisë nr.40, datë 20.11.2019 òPër miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore viti 2020ò ndryshuar me VKB nr.87, datë 21.03.2020 të konfirmuara ligjshmëria nga Prefekti Qarkut Kukës me shkresën nr.2/28, datë 07.05.2020.

2.6.1. Auditim mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave të institucionit dhe të njëjësive të varësisë, si dhe zbatimi i dispozitave nënligjore në përdorimin e tyre.

• Krijimi i strukturave për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore. Bazuar në VKB dhe në konfirmimet nga Prefekti i Qarkut Kukës për vitet 2019 e 2020 është miratuar struktura organizative, ku përfshihet edhe struktura e Sektorit të Taksave e Tarifave. Për vitin 2019 ky sektor ka në përbërje 4 punonjës, dhe për vitin 2020 ky sektor ka në përbërje 6 punonjës. Krahas strukturës në qendër, në Njësitë Administrative Lekbibaj, Fierzë, Bujan, Llugaj, Margegaj, Tropojë dhe Bytyç ka nga një punonjës, i cili mbulon taksat. Administratorët e njëjësive administrative janë të ngarkuar për vjeljen e taksave/tarifave vendore familjare, përfshirë dhe taksën mbi tokën bujqësore, në mbështetje të VKB-së nr. 80, datë 27.09.2017.

Struktura nominale e këtij sektori është sipas tabelës sa më poshtë vijon:

Tab.7

	Funksioni	Pozicioni	Vitet	
			2019	2020
Sektori i tatim taksave				

	Funksioni	Pozicioni	Vitet	
			2019	2020
1	Përgjegjës i sektorit të tatim taksave	Përgjegjës	F. D.	21.02.20 e në vazhdim N. A.
2	Specialist i tatim taksave për realizimin e të ardhurave	Specialist	H. S.	H. S.
3	Specialist i kadastrës fiskale dhe kontrolli i subjekteve në terren	Specialist	A. B.	21.02.20 e në vazhdim F. D.
4	Specialist i tregut dhe kontratave të subjekteve minerale dhe rregjimit tatimor	Specialist	B. S.	06.11.20 e në vazhdim A. Ç.
5	Specialist i menaxhimit të borxhit	Specialist	--	19.03.20 e në vazhdim K. B.
6	Specialist i menaxhimit të taksave familjare	Specialist	--	20.07.20 e në vazhdim E. B., zv më datë 02.11.20 për arsye leje lindje nga B. B..

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

Konkluzion: për vitin 2019 struktura e sektorit të të ardhurave nuk ka qenë e plotësuar me staf.

2.6/2 Parashikimi, realizimi dhe përdorimi i taksave vendore sipas llojeve:

Për vitet objekt auditimi, paketa e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Tropojë është miratuar sipas viteve me:

2019:

- VKB nr.176, datë 23.11.2018, me nr.4555 prot., datë 23.11.2018 òPër miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Tropoje për vitin 2019. Konfirmimi i Prefektit të Qarkut Kukës nr. Prot.2/65, datë 05.12.2018, të VKB nr.176, datë 23.11.2018.
- VKB nr.16, datë 25.02.2019, me nr.877 prot., datë 25.02.20219 òPër disa shtesa dhe ndryshime në VKB nr.176, datë 23.11.2018...ò. Konfirmimi i Prefektit të Qarkut Kukës nr. Prot.2/21, datë 07.03.2019, të VKB nr.15, datë 25.02.2019.

2020:

- VKB nr.40, datë 20.11.2019, me nr.3468 prot., datë 26.11.2019 òPër miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendoreò, në Bashkinë Tropoje për vitin 2020. Konfirmimi i Prefektit të Qarkut Kukës nr. prot.2/78, datë 02.12.2019, të VKB nr.40, datë 20.11.2019.
- VKB nr.87, datë 31.03.2020, me nr.1473 prot., datë 31.03.2020 òPër një ndryshim në VKB nr. 40, datë 20.11.2019, për miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendoreò. Konfirmimi i Prefektit të Qarkut Kukës nr. prot.2/24, datë 09.04.2020, të VKB nr.87, datë 27.03.2020.
- VKB nr.102, datë 28.05.2020, me nr.2250 prot., datë 05.06.2020 òPër shtesa dhe ndryshime në VKB nr.40, datë 20.11.2019 òPër miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendoreò, në Bashkinë Tropoje për vitin 2020ò. Konfirmimi i Prefektit të Qarkut Kukës nr. prot.2/35, datë 12.06.2020, të VKB nr.102, datë 28.05.2020.

Përgjithësisht, paketat tatimore nuk ndryshojnë gjatë viteve të audituara dhe janë sipas parashikimeve ligjore.

Parashikimi për të ardhurat vendore është pjesë e parashikimeve buxhetore, e cila përpara miratimit në Këshillin Bashkiak, përpilohet në formë relacioni nga Sektori i Tatim Taksave.

Situata e planifikimeve dhe realizimeve, paraqitet e detajuar në tabelën në vijim:

Tab.8

në mijë lekë

Llojet e të ardhurave			2019			2020		
			Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
A	Te ardhurat e veta gjithsej		147,788	50,937	34.5	55,000	46,983	85.4

Llojet e të ardhurave			2019			2020		
			Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
I	I	Te ardhurat nga taksa vendore	105,535	27,409	26.0	24,671	22,709	92.0
1	I.1	Nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për BV	1,300	726	55.8	800	721	90.1
2	I.2	Nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	11,027	2,196	19.9	5,891	3,021	51.3
2.1	I.2.1	Nga taksa mbi ndërtesat	5,250	1,677	31.9	3,254	2,359	72.5
2.2.1	I.2.2.1	Ndërtesa banimi	2,750	51	1.9	1,250	308	24.6
2.2.2	I.2.2.2	Ndërtesa të tjera	2,500	1,626	65.0	2,004	2,051	102.3
2.2.3	I.2.2.3	Ndërtesa në pronësi apo në përdorim, në territore të miratuara si fshatra turistike.	-	-	0.0	-	-	0.0
2.2	I.2.2	Nga Taksa mbi tokën bujqësore	5,323	261	4.9	2,188	246	11.2
2.3	I.2.3	Nga taksa mbi truallin	454	258	56.8	449	416	92.7
3	I.3	Nga taksa e fjetjes ne hotel	1,600	999	62.4	1,850	464	25.1
4	I.4	Nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	84,294	13,381	15.9	5,250	3,300	62.9
5	I.5	Nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	110	-	0.0	110	65	59.1
6	I.6	Nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura	3,385	8,430	249.0	8,455	9,424	111.5
7	I.7	Nga taksa e rentës minerare	900	650	72.2	650	197	30.3
8	I.8	Nga taksa e tabelës dhe reklamës	2,469	1,027	41.6	1,150	1,378	119.8
9	I.9	Taksë te tjera	450	-	0.0	515	-	0.0
10	I.10	Nga tatim mbi te ardhurat personale (2%)	-	-	0.0	-	4,139	
II	II	Te ardhurat nga tarifrat vendore	35,932	15,876	44.2	22,709	19,622	86.4
1	II.1	Nga tarifa e shërbimeve publike (pastrim dhe largimit të mbetjeve, tarifa e ndriçimit, gjelbërimit dhe kanalizimeve	17,049	11,102	65.1	11,259	12,574	111.7
1.1	II.1.1	Nga familjet	4,193	1,172	28.0	1,159	1,912	165.0
1.2	II.1.2	Nga institucione	1,690	1,101	65.1	1,000	1,547	154.7
1.3	II.1.3	Nga biznesi	11,166	8,829	79.1	9,100	9,115	100.2
4	II.4	Tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë Tropojë	15,718	1,727	11.0	8,800	3,832	43.5
4.1	II.4.1	Nga vërtetime, autorizime, dokumente te tjera	1,000	133	13.3	130	203	156.2
4.2	II.4.2	Nga tarifa për vulosje veterinare të bagëtive të therura	120	-	0.0	100	-	0.0
4.3	II.4.3	Nga Tarifat e licencimit të veprimtarive të transportit, autorizime	9,000	565	6.3	7,000	2,201	31.4
4.4	II.4.4	Nga Tarifat parkimi për mjetet e licencuara, dhe tarifa për parkimin e automjeteve në vend parkime publike me pagesë:	398	455	114.3	1,000	430	43.0
4.5	II.4.5	Të ardhura nga tarifrat në sektorin e pyjeve dhe kullotave.	5,200	574	11.0	570	998	175.1
4.6	II.4.6	Nga tarifa për shërbimin në institucione të arsimit, kulturës, sportit, shërbimit social etj.	3,165	3,047	96.3	2,650	3,216	121.4
4.6.1	II.4.6.1	Pallati i Kulturës	100	-	0.0	100	-	0.0
4.6.2	II.4.6.2	Pallati i Sportit	100	-	0.0	100	-	0.0
4.6.3	II.4.6.3	Kopshtet	1,300	1,227	94.4	1,250	645	51.6
4.6.4	II.4.6.4	Çerdhet	405	159	39.3	400	152	38.0
4.7	II.4.7	Të ardhura nga tarifa për zënien e hapësirave publike	755	216	28.6	300	64	21.3


Llojet e të ardhurave			2019			2020		
			Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
4.8	II.4.8	Nga Gjendja Civile	-	-	0.0	-	-	0.0
4.9	II.4.9	Te ardhura te tjera	505	1,445	286.1	500	2,355	471.0
	III	Gjobat	600	528	88,0	520	850	163,5
	IV	Të ardhura jo tatimore	6.226	8.569	137,6	7.600	6.157	81,0
	IV.1	-Të ardhura nga dhënia me qira e asetëve në pronësi të Bashkisë	5.721	7.124	124,5	7.100	3.802	53,5
	IV.2	-Të ardhura nga sekuestrime e zhdëmtime	119	119	100,0	500	2.227	

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike dhe Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore

Nga Sektori i Tatim Taksave në relacionet mujore gjatë vitit 2019, mbi realizimin e të ardhurave dhe ecurinë e debitorëve, dërguar Kryetarit të Bashkisë dhe Drejtorit Ekonomik: i është sugjeruar që ÷plani i miratuar prej 147,8 milion duhet të ri shihet dhe të miratohet ndryshimi në Këshillin Bashkiak dhe në Prefekturën e Qarkut Kukës, ku plani vjetor duhet të jetë në shifrën 55 milion lekë.

Në mënyrë krahasimore për vitet 2019 -2020 realizimi në % i të ardhurave rezulton me trend rritës **për shkak të planifikimit të fryrë të të ardhurave për vitin 2019** dhe paraqitet grafikisht sa vijon:


Të ardhurat e veta:



Tab.9

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike dhe Sektori Taksve dhe Tarifave Vendore

Të ardhurat nga tarifat vendore.



Tab.10

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike dhe Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore

Konkretisht për disa nga zërat:

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin: Ky tregues mblidhet dhe transferohet në llogarinë e Bashkisë Tropojë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Kukës, e cila është në rolin e agentit tatimor. Rakordimet me Drejtorinë Rajonale Tatimore Kukës, sipas të cilave rezulton se shumtë që janë arkëtuar pranë DRT Kukës, janë kaluar nëpërmjet Degës së Thesarit në Bashkinë Tropojë, për subjektet në juridiksion të saj, pasi është mbajtur komisioni përkatës.

Taksa mbi ndërtesat: Në këtë zë, është problematik arkëtimi i taksave nga familjarët, ndërkohë që nga bizneset arkëtimet kanë qenë në nivelet e planifikuara.

Taksa e tokës bujqësore: paraqitet në nivele shumë të ulëta. Administratorët e njësive administrative janë të ngarkuar për vjeljen e taksave/tarifave vendore familjare, përfshirë dhe taksën mbi tokën bujqësore.

Taksa e fjetjes në Hotel: Nga kontrollet e ushtruara pranë subjekteve nga ana e Sektorit të Taksave të Bashkisë Tropojë, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, është konstatuar se gjatë vitit 2019 dhe 2020 ka pasur ulje të ndjeshme të bujtësve, kryesisht turistëve të huaj, në krahasim me vitet e mëparshme, duke sjellë rënie të të ardhurave në përgjithësi, sidomos në atë pjesë që ndikohet drejtpërdrejt, siç është taksa e fjetjes në hotel. Faktori bazë ka qenë efekti i Pandemisë COVID-19, që ka çuar në bllokimin e kufijve, mosardhjen e turistëve të huaj, po ashtu as turistëve vendës, kjo edhe si rezultat i masave të marra me vendime të veçanta nga Qeveria, për ruajtjen e shëndetit.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë: ka pësuar rritje në vitin 2020 me rreth 40%. Kjo ka ardhur si rezultat e aplikimeve për ndërtime të reja, po kështu dhe nga arkëtimi i detyrimeve të prapambetura.

Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme: i realizuar shumë ulët. Kjo taksë, për kalimin e të drejtës së pronësisë personit përkatës, taksë që duhet të vilet para regjistrimit, duhet të kalojë nga (ish- Zyra e Regjistrimit të Pasurisë), ASHK, e cila në rolin e agentit të taksës përfiton 3% të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdh për llogari të

buxhetit përkatës të bashkisë Tropojë. Më gjithë shkresat e dërguara nga Bashkia Tropoje nuk ka kryer një veprim te tille

Taksa vjetore e mjeteve të përdorura: Ky tregues realizohet dhe transferohet (18%), nëpërmjet Drejtorisë Rajonale të Transportit Rrugor Kukës, ku çdo muaj janë kryer norM.sht rakordimet përkatëse për këtë taksë, duke marrë evidencat përkatëse nga DRSHTRR Kukës.

Renta minerare: Kjo taksë është në varësi të sasisë të shitur të mineralit si brenda vendit ashtu dhe për eksport. Për këtë taksë është rakorduar norM.sht por jo rregullisht me Drejtorinë Rajonale Doganore dhe Tatimore, të cilave Sektori i Taksave/tarifave u ka dërguar shkresa te veçanta për t'i dërguar te dhëna, ku janë marrë të dhëna konkrete, po nëpërmjet Ministrisë së Financave (Drejtorisë të Buxhetit), kanë ardhur të dhënat konkrete, ku kjo e fundit alokon shumën e rentës sipas bashkive përkatëse ku ushtrojnë aktivitetet subjektet.

Taksa të tjera: plani 450 mijë lekë, fakti 0 mijë lekë ose 0%. Fakt që tregon planifikim të gabuar.

Tarifa për vulosje veterinare të bagëtive të therura: fakti zero. Pavarësisht se nga veterineri është dërguar informacioni përkatës dhe janë dërguar faturat për arkëtim subjekteve përkatëse, nuk është bërë asnjë pagesë.

Tarifa e licencimit të veprimtarive të transportit, autorizime: Ne planifikimin e këtij treguesi është mbajtur parasysh, detyrimi i prapambetur për takse licencim tregtim karburanti prej 7.1 milion lek.

Tarifa në sektorin e pyjeve e kullotave:Këtu është parashikuar që drutë e zjarrit për shkollat, kopshte e çerdhe do te tenderoheshin me subjekt privat, ku janë marrë për bazë treguesit e viteve te mëparshme, porse ky aktivitet është realizuar me fuqi punëtorë e mjete nga Bashkia.

Të ardhurat nga pallati i kulturës dhe nga pallati i sportit: plani 100 mijë lekë, nuk ka arkëtime. Kjo ka ardhur nga fakti qe nuk ka patur aktivitete, (Pandemia COVID-19).

Të ardhura nga çerdhet: mosrealizim nga paaftësia paguese e popullsisë.

Të ardhurat për zënien e hapësirave publike: në këtë zë përfshihen edhe tarifat për tavolinat e vendosura në ambientet që janë pronë publike, tarifa e të cilave është 540 lek/muaj/tavolinë.

Titulli i gjetjes: Për disa tregues të të ardhurave, megjithëse janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me paketën fiskale, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk ka planifikuar dhe pasqyruar të ardhura, ndërsa ka evidentuar planin me 0 (zero), për pasojë edhe realizimi është me 0 (zero) konkretisht

Situata:Në paketat fiskale të periudhës raportuese, nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore është planifikuar dhe miratuar niveli për; *“Tarifë për depozitimin e inerteve”* e detajuar me nivele pagese për qytetarët 50 lekë/ton dhe për operatorët ekonomik 100 lekë/tonö. Nëpërmjet kësaj tarife, Këshilli i Bashkisë ka krijuar mundësinë që si operatorët ekonomik ashtu edhe qytetarët të veprojnë në mospërputhje me përcaktimet ligjore për mbrojtjen e territorit, pasi inertet dhe mbetjet e ngurta e krijuara është detyrim të depozitohen me shpenzimet e tyre në vend depozitimet përkatëse, në të kundërt ushtrohet e drejta e penaltetit nëpërmjet tarifës *“Për gjoba ndërhyrje infrastrukturë”*, nivel i pasqyruar edhe në paketën fiskale, për pasojë këto dy tarifa kundërshtojnë njëra tjetrën.

Për disa tregues të të ardhurave, megjithëse janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me paketën fiskale, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk ka planifikuar dhe pasqyruar të ardhura, ndërsa ka evidentuar planin me 0 (zero), për pasojë edhe realizimi është me 0 (zero) konkretisht sa më poshtë;

2-Tarifë për depozitimin e inerteve, me programimin niveli me 0 (zero).

a-Për qytetarët, me programimin niveli me 0 (zero).

b-Për operatorët ekonomik, me programimin niveli me 0 (zero).

11-Tarifa për linjat ajrore e nëntokësore, me programimin niveli me 0 (zero).

13-Për shërbime në fushën transporti.

c-Për shërbime transporti, me programimin niveli me 0 (zero).

d-Të tjera, me programimin niveli me 0 (zero).

IV-Nga të ardhura jo tatimore, me programimin niveli me 0 (zero)

-10 tregues të kësaj tarife, me programimin niveli me 0 (zero).

Në këto kushte, shkaqet dhe arsyet në mos realizimin e të ardhurave nga zbatimi i nivelit të taksave e tarifave vendore e gjykojmë se mund të ketë ndikim në:

- mos planifikimi i drejtë dhe mos përcaktimi i saktë i burimit të krijimit të të ardhurave.

- planifikimi pa argumentuar, duke marr për bazë veçanërisht për token bujqësore të pa regjistruar në kadastër.

- largimi i banorëve dhe mospërdorimi i tokës bujqësore, si dhe mungesa e vullnetit për të paguar detyrimet nga kryefamiljarët, pavarësisht përpjekjeve të bëra nga inspektorët e terrenit.

- planifikimi i pa argumentuar duke marrë për bazë familjet sipas gjendjes civile dhe jo familjet.

Kriteri: paketat fiskale të periudhës raportuese;

Impakti: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë;

Shkaku: Mungesa e zbatimit të plotë të kuadrit ligjorë për arkëtimin e detyrimeve;

Rëndësia: E lartë.

Titulli i gjetjes: Planifikim i gabuar i të ardhurave për vitin 2019.

Situata

Për vitin 2019 ka pasur mosrealizim të planit të përgjithshëm të të ardhurave në masën 65.5 % më pak ose -96,851 mijë lekë dhe për vitin 2020 me një mosrealizim -8,017 mijë lekë ose 14.6%.

Theksojmë se plani i vitit 2020 është më pak se plani i vitit 2019 për 92,788 mijë lekë ose 2.69 herë më i vogël se plani i vitit 2019.

Mosrealizimet dhe realizimet respektive flasin për një planifikim jo të drejtë të të ardhurave për vitin 2019.

Në analizë:

- Në VKB të Bashkisë Tropojë nr.72, datë 27.06.2017 òPër miratimin e planit të të ardhurave 2018 -2020 për Bashkinë Tropojë, në tabelën planifikimi i të ardhurave për periudhën 2018 ó 2020 të firmosur nga ish Përgjegjëse e Sektorit të Tatim Taksave F. D., Drejtori Ekonomik R. I., dhe Kryetari B. D., parashikimi i të ardhurave është sa vijon:

në 000 lekë

	Fakti 2016	I pritshmi 2017	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020
Të ardhurat tatimore	77,219	55,000	55,000	<u>56,000</u>	57,000

- Me VKB të Bashkisë Tropojë nr.05, datë 25.01.2018, òPër miratimin e raportit vlerësues paraprak të të ardhurave për periudhën 2019 ó 2021, është përcaktuar ky nivel:

në 000 lekë

	Fakti 2017	I pritshmi 2018	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020	Parashikimi 2021
Të ardhurat tatimore	46,541	55,000	<u>56,000</u>	57,000	57,049

- Me shkresën nr.1276 prot., datë 01.04.2019 të Bashkisë Tropojë, Drejtoria Ekonomike, i është dërguar Buxheti i Bashkisë Tropojë për vitin 2019, Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Financave Vendore, të miratuara me VKB Tropojë numër 187, datë 19.12.2018, òPër miratimin e PBA 2019 -2021, buxheti dhe numri maksimal të punonjësve të Bashkisë Tropojë për vitin 2019 si viti i parë i PBA 2019 -2021.

Bashkëlidhur kësaj shkrese është tabela e burimeve financiare për vitin 2019 -2020- 2021, ku të ardhurat e planifikuara janë sa vijon:

në 000 lekë

	2019	2020	2021
Të ardhurat e planifikuara	132,788	111,899	116,623

Ndërkohë që nuk ka dokumentacion tjetër përveç Projekt vendimit nr.11, datë 25.01.2018 për parashikimin e të ardhurave për vitin 2019 në shumën 56,000,000 lekë

Nuk argumentohet përcaktimi i të ardhurave të planifikuara në shumën 132,788 mijë lekë, e cila është firmosur nga ish përgjegjësja e sektorit të tatim taksave F. D., gjithashtu edhe shtesat e të ardhurave për sa vijon:

- VKB nr.15, datë 25.02.2019, nr. 876 prot., datë 25.02.2019, òPër një shtesë në VKB Tropojë nr.187, datë 19.12.2018, òPër miratimin e Buxhetit dhe numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Tropojë për vitin 2019, ku janë shtuar të ardhurat për:

- a- Të ardhura nga tarifa në sektorin e pyjeve dhe kullotave shtuar plani i 2019 për 3,500,000 lekë;
- b- Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë shtuar plani i 2019 për 3,500,000 lekë; Në total burimet shtesë janë + **7,000,000** lekë.(e paargumentuar me dokumentacion nga sektori i taksave).

- VKB nr.40, datë 26.04.2019, nr. 1447 prot., datë 26.04.2019, òPër një shtesë në VKB Tropojë nr.187, datë 19.12.2018, òPër miratimin e Buxhetit dhe numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Tropojë për vitin 2019, ku janë shtuar të ardhurat për:

- a- Të ardhura nga tarifa e licencimit të karburanteve me pakicë shtuar plani i 2019 për + **8,000,000** lekë;

Në total plani të ardhurave për vitin 2019 është 132,788 mijë + 7,000 mijë + 8,000 mijë = **147,788 mijë** nga të cilat të paargumentuara me dokumentacion shuma prej **91,788 mijë** lekë.

Sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi ish Përgjegjësja e sektorit të të ardhurave F. D. dhe ish Drejtori Ekonomik R. I. (deri më datë 04.02.2020).

Kriteri: dokumentacioni i sipërcituar i pa argumentuar.

Impakti: Planifikimi i të ardhurave për vitin 2019 tej kapaciteteve arkëtuese të Bashkisë në masën 2.7 herë më shumë me impakt mosrealizimin e financimit të investimeve me burim të ardhurat për këtë vit.

Shkaku: Mungesa e argumentimit të planifikimit të të ardhurave.

Rëndësia: E lartë

Pretendim i subjektit: Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. s`ka, datë 09.06.2021, e protokolluar në KLSH me numër prot., 361/6, datë 14.06.2021 dhe 361/8, datë 16.06.2021, nga znjV. B., ku janë shprehur komentet si më poshtë:

“Nuk ka dokumentacion tjetër përveç projekt vendimit nr. 11, datë 25.01.2018 për parashikim të ardhurash në shumën 56,000,000.

Kundërshtoj si më poshtë: Shtesa e planit të të ardhurave është bërë në fazën e dytë të miratimit të PBA-së 2019-2021.

Sipas pikës VI të Udhëzimit nr.6/1, datë 28.02.2018 ó Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021citohet: òDokumenti i programi Buxhetor Afat Mesëm 2019-2021, përgatitet nëpërmjet Instrumentit të Planifikimit Financiar (FTP).

Ne këtë format Formatit F1 plotësohet elektronikisht nga sektori i Tatim taksave dhe ato pasqyrohen automatikisht ne burimet për shpërndarjen në formatin F4.

Pra konstatimi juaj duhej t`u përgjigjej pyetjeve si më poshtë:

- a. A është plotësuar sipas udhëzimit Formatit F1, dhe nga kush është plotësuar, pra nuk ka format tjetër për plotësim, të tjerat mund të jenë ndihmëse.

- b. Nëse nuk e kanë plotësuar a ka përgjegjësi për mos zbatim të dispozitave ligjore, pasi dhe shpërndarja e burimeve teknikisht, ishte e pamundur, për shkak të mënyrës si është ndërtuar softi FTP.
- c. Punonjësit e sektorit të tatim taksave janë njohur me VKB, e kanë pranuar ekzistencën e këtij plani, çfarë vendimi kanë ndjekur për zbatim?
- d. Punonjësit e tatim taksave e kanë përdorë si reference në raportime dhe në formularin e vlerësimit të burimeve për vitin 2020, ku e kanë marrë këtë shumë.
Ku qëndron Përgjegjësia ime? Për këtë sqarimin ua bej unë.
Paketa fiskale është miratuar ne fazën e dyte të PBA-së 2019-2021, dhe është miratuar në muajin nëntor 2019.

Është miratuar Vendimi nr. 187 datë 19.12.2018 për miratimin e buxhetit dhe numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë për vitin 2019.

Ky Vendim është konfirmuar nga Prefekti dhe ka marre trajtën e një akti ligjor për t'u zbatuar.

Punonjësit e tatim taksave e kanë referuar atë plan ne vijimësi për raportim, pa i kërkuar Kryetarit te Bashkisë qe përgjatë vitit 2019, indicet që kanë shërbyer për atë plan, nuk janë aktuale dhe të kishin së pari rishikim të planit të të ardhurave.

Nuk bëhet rishikim i buxhetit, pa u bërë më parë rishikimi i planit të të ardhurave.

A ka mosveprim të sektorit të tatim taksave?

Në momentin e vlerësimit të burimeve që do të shërbente si bazë për programin afatmesëm 2020-2022 që është bërë në janar të vitit 2019, pra menjëherë sa ka filluar viti, Ky sektor e ka konfirmuar ekzistence e këtij plani dhe e ka nënshkruar. Bashkëngjitet konfirmimi i këtij plani ne fillim te vitit 2019, pra në muajin e parë të efektit të këtij vendimi.

Dhe me vonë me informacionin date 25.09.2019, drejtuar Kryetarit te bashkisë R. B. është pranuar ekzistenca e këtij plani prej 132.788 mije leke, të cilin ju e administroni në dosjen Tuaj me te cilin unë jam njohur kur kam kontaktuar me Ju.

Pra mungesa e një dokumenti, fizik nuk me ngarkon mua me përgjegjësi, pasi ky plan i hedhur ne te vetmin dokument ligjor te programit buxhetor, përgjegjësi dhe kompetencë e sektorit te Tatim Taksave, duhej te kundërshtohej nga sektori përkatës dhe jo te miratohej ne heshtje, sepse ai tashme ishte një akt zyrtar ligjor.

Përfundimisht, plani i te ardhurave, duhej te rishikohej dhe ne të bënim reflektimin përkatës ne buxhet.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se komenti në lidhje me sa më lart në lidhje me përgjegjësinë tuaj qëndron dhe merret në konsideratë pasi plani i të ardhurave në vlerën 132 milion lekë është firmosur nga ish përgjegjësja e sektorit të tatim taksave F. D.. Në lidhje me pyetjet që shtroni ju bëjmë me dije se ato janë sqaruar në pjesën takuese të auditimit të procedurave të buxhetit.

Titulli i gjetjes: Realizim shumë i ulët i vjeljes së taksës së tokës.

Situata:

Vjelja e taksës së tokës, në Bashkinë Tropojë dhe në Njësitë Administrative, sipas regjistrimit të taksës së tokës, është llogaritur në nivelin 3.6% të planit total të të ardhurave të vitit 2019, dhe është vjelë në nivelin 0.2% të totalit të të ardhurave.

Ndërsa për vitin 2020 është llogaritur në nivelin 3.9% të planit total të të ardhurave të vitit 2020, dhe është vjelë në nivelin 0.45% të totalit të të ardhurave.

Sipërfaqja e tokës e ndarë me ligjin 7501 është paraqitur në **tabelën sa më poshtë**, sipas NJA. Vjelja e taksës së tokës bujqësore, krahas taksave/tarifave familjare e përcaktuar në VKB, realizohet nga Administratoret e çdo njësie.

Tab.11

Emërtimi	Nr. i fshatrave për çdo njësi	Sipërfaqja e tokës së ndarë, në Ha	Nr. i familjeve të trajtuara me tokë
----------	-------------------------------	------------------------------------	--------------------------------------

			sipas ligjit 7501
Nj.A. Bujan	7	759	1,148
Nj.A. Bytyç	12	711	815
Nj.A. Margegaj	10	483.7	1,490
Nj.A. Tropojë	15	1,242	2,129
Nj.A. Fierzë	4	371.4	651
Nj.A. Lekbibaj	12	357	1,595
Nj.A. Llugaj	6	694.4	934
Nj.A. B. Curri		125	61
Totali	66	4,743.5	8,823

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike dhe Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore

Në paketat fiskale të miratuara me VKB-të përkatëse, për të dy vitet në auditim, duke cilësuar se “...Taksat/tarifat për familjet shlyhet në bazë vjetore dhe mbledhet nga administratorët e çdo njësie...”, Bashkia Tropojë e ka deleguar përgjegjësinë e vjeljes të taksës së tokës në Njësitë Administrative. Familjarët janë njoftuar nga Bashkia Tropojë për pagesat e taksave dhe tarifave vendore, me shkresat nr. 4577 prot., datë 30.12.2016 dhe nr. 95 prot., datë 05.01.2018.

Tarifat dhe taksat për familjarët pasi arkëtohen nga njësitë administrative, punonjësit përkatës shumat e mbledhura i arkëtojnë në mënyrë të përmblodhur pranë arkës së bashkisë në qendër. Arka qendër i detajon në një faturë të përmblodhur, por të detajuara sipas llojeve përkatëse (tarifë shërbimi për familjarët, taksë ndërtese për familjarët, taksë trualli për familjarët, taksë e tokës bujqësore, etj., këto së bashku me të ardhurat e akumuluar në arkën qendër, arkëtari qendër i arkëton në bankë.

Sektori i Taksave dhe Tarifave me të dhënat nga banka për arkëtimet e taksave për familjarët i pasqyron në ditarin e të ardhurave tatimore, sipas dokumenteve përkatëse të arkëtimit, të zberthyera sipas llojit të taksës/tarifës.

Për qytetin dhe çdo njësi administrative është krijuar në mënyrë manuale dhe elektronike në formatin Excel regjistri për taksat dhe tarifave vendore për subjektet private.

Gjithashtu, janë hartuar dhe funksionojnë edhe regjistrat në formë manuale, sipas formatit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

Si për qytetin, ashtu edhe për Njësitë Administrative, nuk janë krijuar regjistra të posaçëm, as në mënyrë manuale dhe as elektronike për taksat dhe tarifave e familjarëve. Nga sektori i Taksave dhe Tarifave arkëtimet e taksave për familjarët pasqyrohen në ditarin e të ardhurave tatimore, sipas dokumenteve përkatëse të arkëtimit, të zberthyera sipas llojit të taksës/tarifës.

Kriteri: VKM-në nr. 510, datë 10.06.2015 òPër miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorialë dhe të Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë për Çështjet Vendore dhe Ministrisë të Financave nr. 3237, datë 16.7.2015 òPër procedurat, afatet kohore, standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm, për riorganizimin administrativo-territorialë; Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 òPër Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare ò dhe me UMF nr. 8, datë 09.03.2018 òPër Paraqitjen e Pasqyrave Financiare në NJQPö.

Impakti: Bashkia Tropojë nuk ka informacion të saktë dhe të plotë për situatën e familjeve debitorë në lidhje me taksën e tokës dhe detyrimet e tjera të familjarëve.

Shkaku: Mos krijimi i bazave të të dhënave dhe pamundësia për të zbatuar kriteret ligjore dhe nënligjore në lidhje me reformën territoriale.

Rëndësia: E lartë

Titulli i gjetjes: Debitorët për taksa e tarifa vendore më 31.12.2020 janë në shumën 18,082,240 lekë, nga të cilat, detyrimet e lindura gjatë vitit 2020 dhe gjendje më 31.12.2020, për shumën 5,058,984 lekë.

Situata:

Debitorët total gjendje më 31.12.2020 për shumën 18,082,240 lekë, nga të cilat, detyrimet e lindura gjatë vitit 2020 dhe gjendje më 31.12.2020, për shumën 5,058,984 lekë.

Në mënyrë analitike duke përfshirë edhe vitin 2018 pasqyra e gjendjes së debitorëve në periudhat 31.12.2018, 31.12.2019, 31.12.2020 dhe arkëtimet në vitet 2019, 2020, paraqiten në tabelën sa më poshtë vijon:

Tab.12

(Ne lekë)

Përshkrimi i debitorëve:	Gjendja e debitorëve 31.12.18	Arkëtuar viti 2019	Gjendja e debitorëve 31.12.19	Arkëtuar 2020	Gjendja e debitorëve 31.12.20	
					Nr.	Vlerë
Taksa/tarifa vendore të 2012-2018	10,557,990	957,395	9,600,595	513,315	141	9,087,280
Taksa/tarifa vendore 2019	-	-	4,479,111	1,552,742	90	2,926,369
Taksa/tarifa vendore 2020	-	-	-	-	124	4,408,304
Instit. për taksa/tarifa 2019	-	-	483,960	249,480	2	234,480
Instit. për taksa/tarifa shtuar 2020	-	-	-	-	3	650,680
taksë infrastrukture 2018	1,805,540	592,496	1,213,044	437,917	22	775,127
Totali :	12,363,530	1,549,891	15,776,710	2,753,454	382	18,082,240

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike dhe Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore

o Në analizë përditësimi i debitorëve sipas periudhave 31.12.2018, 31.12.2019; 31.12.2020:

✓ Nga debitorët gjendje më 31.12.2018, në shumën 12,363,530 lekë, janë arkëtuar në vitin 2019 në shumën 1,549,891 lekë, dhe në vitin 2019 në shumën 951,232 lekë.

✓ Debitorë të periudhës të vitit 2019 gjendje më 31.12.2019, në shumën 4,963,071 lekë (debitorë për taksa/tarifa vendore të vitit 2019, për 4,479,111 lekë, debitorë institucione për taksa tarifa vendore të vitit 2019 për 483,960 lekë). Janë arkëtuar në vitin 2020 në shumën 1,802,222 lekë.

✓ Shuma e debitorëve gjendje më 31.12.2019 për 15,776,710 lekë, i janë dërguar sektorit të financës dhe janë kontabilizuar në bilancin e vitit 2019 në llogarinë 468.

✓ Debitorët gjendje më 31.12.2020 në shumën 18,082,240 lekë, nga të cilët debitorë të periudhës të vitit 2020 gjendje më 31.12.2020 për shumën 5,058,984 lekë (debitor taksa tarifa vendore të vitit 2020 për 4,408,304 lekë, debitorë institucione/ente për taksa tarifa shtuar në vitin 2020 për 650,680 lekë).

✓ Debitorët e krijuar në vitin 2020 gjendje më 31.12.2020 për shumën 5,58,984 lekë i janë dërguar sektorit të financës dhe janë kontabilizuar në bilancin e vitin 2020 në llogarinë 468.

➤ Gjendja e debitorëve të Biznesit të Vogël dhe Biznesit të Madh me datë 31.12.2012 - 31.12.2020:

a- Tab.13 Biznesi i madh

Vitet			totali prog/lekë 31.12.2020	totali prog/lekë 30.3.2021	Llog.Kamat vonesa 2021 31.03.2021
2012 -2018	2019	2020			
1	2	3	4(1-3)	5	6
2,748,092	1,314,728	1,601,614	5,664,434	6,480,904	876,590

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike dhe Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore

b- Tab.14 Biznesi i vogël

Vitet			totali prog/lekë 31.12.2020	totali prog/lekë 30.3.2021	Llog.Kamat vonesa 2021 31.03.2021
2012 -2018	2019	2020			
1	2	3	4(1-3)	5	6
6,339,188	1,611,641	2,806,690	10,757,519	12,377,269	1,741,234

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike dhe Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore

c- Tab.15 Gjendja me 31.12.2020, regjistri i debitorëve taksa tarifa biznesi për vitet 2012-2018-2019-2020

Debitorë 2012-2017	Ngarkesa 2018	Debitorë 2012-2018	Ngarkesa		Debitorë 2012-2020
			2019	2020	
6,457,628	2,629,652	9,087,280	2,926,369	4,408,304	16,421,953

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike dhe Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore

d- Tab.16 Gjendja 31.12.2020 e debitorëve për taksa/tarifa nga institucionet/entet për vitet 2012-2018-2019-2020:

Debitorë 2012-2017	Ngarkesa 2018	Debitorë 2012-2018	Ngarkesa		Debitorë 2012-2020
			2019	2020	
0	0	0	234,480	650,680	885,160

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike dhe Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore

e- Taksë ndikimi në infrastrukturë e periudhës 2017-2018, e konstatuar nga KLSH, gjendje më 31.12.2020 është në shumën 775,127 lekë.

f- Totali i debitorëve gjendje më 31.12.2020 sipas tabelave të mësipërme bashkë me debitorët për taksën e ndikimit në infrastrukture janë në total për 18,082,240 lekë (16,421,953+885,160+775,127)

Debitorët e biznesit të vogël dhe të madh në mënyrë progresive deri në 31.12.2020

Tabela sa më poshtë vijon është plotësuar për debitorët e biznesit të madh dhe të biznesit të vogël për taksat/tarifat vendore që i përkasin periudhës 2012-2020, gjendje më 31.12.2020.

- Debitorë biznesi i vogël për 10,757,519 lekë
- Debitorë biznesi i madh për 5,664,434 lekë
- Totali me 31.12.2020 për 16,421,953 lekë

Pasqyra e lëvizjes së gjendjes së debitorëve datë 31.12.2020:

Tab.17

(Ne lekë)

Përshkrimi i debitorëve	Gjendja e debitorëve me 31.12.2020
Taksa/tarifa vendore (biznesi) të periudhës 2012-2020	16,421,953
Institucione për taksa/tarifa	885,160
Takse infrastrukturë të vitit 2017-2018	775,127
Totali :	18,082,240

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike dhe Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore

-Detyrimet totale gjendje më 31.12.2019 për shumën 15,776,710 lekë janë pasqyruar në bilancin e vitit 2019, në llogarinë 468 nga Sektori i Financës.

-Debitorët e krijuar në vitin 2020, gjendje më 31.12.2020 për **5,058,984 lekë** janë pasqyruar në bilancin e vitit 2020, në llogarinë 468 nga Sektori i Financës.

Pasqyra përmbledhëse e taksave në shkallë bashkë së bashku me NJA më datën 31.12.2020 në mënyrë progresive duke filluar nga data 01.01.2012 deri 31.12.2020, paraqitet në aneks 2/2, bashkëlidhur.

E analizuar :

- a. Debitorë nga biznesi për taksa/tarifa vendore të periudhës 2012-2018 për **9,087,280** lekë;
- b. Debitorë nga biznesi për taksa/tarifa vendore të periudhës 2019 për **2,926,369** lekë;
- c. Debitorë nga biznesi për taksa/tarifa vendore të periudhës 2020 për **4,408,304** lekë;
- d. Debitorë nga institucionet për taksa/tarifa vendore të periudhës 2019 për **234,480** lekë;
- e. Debitorë nga institucionet për taksa/tarifa vendore të evidentuar 2020 për **650,680** lekë;
- f. Debitorë për taksë infrastrukturë të periudhës 2017-2018 për **775,127** lekë;

Nga debitorët e mësipërm:

-Debitorë të krijuar rishtas në vitin 2020, janë për shumën **5,058,984** lekë;

-Debitorë të mbetur të periudhës kaluar janë për shumën **13,023,256** lekë;

Debitorët total gjendje më 31.12.2020 për shumën 18,082,240 lekë, nga të cilat, detyrimet e lindura gjatë vitit 2020 dhe gjendje më 31.12.2020, për shumën 5,058,984

lekë, janë pasqyruar në bilancin e vitit 2020, në llogarinë 468 nga Sektori i Financës, të analizuar sipas llojit:

a- debitorët për subjektet private (biznes i madh dhe biznes i vogël) te periudhës 2020 gjendje më 31.12.2020 për taksat/tarifat vendore, 117 raste për 4,408,304 leke sipas aneks 2/1, bashkëlidhur.

b- Debitorët shtetëror institucione/ente për taksat/tarifat vendore të zbuluar gjatë vitit 2020 gjendje më 31.12.2020, 3 raste, për 650,480 lekë, sipas tabelës së mëposhtme:

Debitor për taksa/tarifa vendore Institucione/ente te zbuluara gjate vitit 2020, gjendje më 31.12.2020 (lekë).

Nr.	Emërtimi i Institucionit	Adresa	NIPTI	Shuma e detyrimit
1	Zyra Vendore e Punësimit	B.Curri	K49326610H	240,340
2	Dega e thesarit	Tropoje	K49326609D	58,620
3	OSHEE (Drejtoria Rajonale)	Tropoje	K72410014H	351,720
Totali				650,680

Tab.18

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike dhe Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore

Kriteri: Ligji nr. 33-2017 ÷Për shuarjen e detyrimeve tatimore; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 ÷Për Sistemin e Taksave Vendore, i ndryshuar; Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008, ÷Për Procedurat Tatimore, i ndryshuar; Ligji nr. 33/2017 ÷Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore, etj.

Impakti: Mos pasqyrim i drejtë i situatës financiare të Bashkisë Tropojë, mangësi në realizimin e të ardhurave të programuara sipas paketës fiskale dhe rrjedhimisht mos përmbushje e programeve buxhetore në lidhje me realizimin e tyre, duke mos ofruar të gjitha shërbimet e nevojshme për popullatën. Me të ardhura të munguara në shumën **18,082,240 lekë**.

Shkaku: Mos ndjekja dhe mos arkëtimi i detyrimeve të debitorëve nga Drejtoritë e të Ardhurave.

Rëndësia: E lartë

Titulli i gjetjes: nga auditimi rezultuan 24 debitorë të subjekteve pa NIPT, për të cilat është llogaritur detyrimi në shumën **2,356,275 lekë**, por nuk kanë paguar.

Situata: Nga auditimi i debitorëve rezultuan subjekte aktive gjendje me 31.12.2020, por që janë pa NIPT. Këto dosje janë dorëzuar me proces verbalin date 21.1.2017 nga ish-p/sektoirit tatim taksave Vera Aliaj (dalë në pension), marrësi në dorëzim F. D.-P/sektoirit tatim taksave, për të cilët vazhdohet t'u llogaritet taksa/tarifa vendore dhe që nuk ka asnjë arkëtim, sipas aneksit 2/2/a bashkëlidhur raportit të auditimit.

Kriteri: Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008, ÷Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 40, ÷Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare ;, pikat 1 dhe 5:

1. Personat fizikë dhe juridikë **ushtrojnë veprimtari ekonomiko-tregtare vetëm pas regjistrimit të tyre**, në përputhje me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 ÷Për Qendrën Kombëtare të Biznesit.

5. **Mosregjistrimi nuk e çliron një person nga pagesa e detyrimit tatimor** ose përmbushja e detyrimeve të tjera tatimore.

Impakti: Mos pasqyrim i drejtë i situatës financiare të Bashkisë Tropojë, mangësi në realizimin e të ardhurave të programuara sipas paketës fiskale dhe rrjedhimisht mos përmbushje e programeve buxhetore në lidhje me realizimin e tyre, duke mos ofruar të gjitha shërbimet e nevojshme për popullatën. Me të ardhura të munguara në shumën **2,356,275 lekë**.

Shkaku: Mos ndjekja dhe mos arkëtimi i detyrimeve të debitorëve nga Drejtoritë e të Ardhurave.

Rëndësia: E lartë

Titulli i gjetjes: Mbi moskonfirmimin e shlyerjes së detyrimeve për taksa e tarifave vendore, nga sektori i takave.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me arkëtimin e debitorëve, rezultojnë shkresa nga Bashkia Tropojë, Struktura Vendore e Apelimit Tatimor, drejtuar Sektorit të Tatim Taksave mbi praktikën e ndjekur dhe konfirmimin me shkresë për detyrimet apo arkëtimet òfaktike sipas regjistrimit të ardhurave për subjektet të cilët pretendojnë se i kanë shlyer detyrimet e taksave e tarifave e konkretisht:

Shkresa nr.1, datë 28.05.2018, e prot., në Bashki me nr. 2573, datë 28.05.2018, **Shkresa nr. 1/2**, datë 18.06.2018, e prot në Bashki me nr.2573/1, datë 18.06.2018, për subjektet:

- 1- B. A. shpk ,e administrator A. H.;
- 2- L. I., person fizik;
- 3- S. M., përsón fizik;
- 4- A. G., person fizik;
- 5- M. L. G., person fizik;
- 6- G. shpk, me administrator A. B.;
- 7- L. Ç., person fizik;
- 8- R. K., person fizik;
- 9- A. G. shpk, me administrator M. A.;
- 10-D. I., person fizik.

Shkresa nr. 1/3 datë 18.06.2018, e protokolluar në Bashki me nr. 2573/2, datë 18.06.2018, për subjektet:

- 1- E. shpk;
- 2- S. H., person fizik;
- 3- H. I., person fizik;
- 4- T. S. sha;
- 5- B. K..

Shkresa nr.2, datë 10.09.2018, e protokolluar në Bashki me nr.3617, datë 10.09.2018 për N. M., për të cilin është kthyer përgjigje nga Drejtoria Ekonomike me shkresën nr.367/1, datë 13.09.2018 se ky person ka kryer pagesën e taksave e tarifave vendore në vlerën 40,220 lekë. Sa më sipër trajtuar rezulton se nga Sektori i Tatim Taksave, nuk ka përgjigje me përjashtim të një rasti.

Për rrjedhje nga ky Sektor duhet të verifikohen pagesat e pretenduara të kryera nga personat fizike apo juridik bazuar në dokumente zyrtare.

Kriteri: Ligji 9920, datë 19.05.20008, i ndryshuar.

Impakti: Mos pasqyrim i drejtë i situatës së debitorëveMos rendim i punës midis Strukturës Vendore të Apelimit Tatimor dhe Sektorit të të Ardhurave.

Rëndësia: E lartë

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni nëpërmjetë postës elektronike në adresën lbaholli@klsh.org.al ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: -Në periudhën maj-Qershor te vitit 2018, nga Struktura e Apelimit Tatimor pranë Bashkisë Tropojë i është kërkuar Sektorit Tatim Taksave Bashkia Tropojë të dhëna për detyrime apo arkëtimet faktike, për detyrime taksa/tarifa vendore, regjistrim apo çregjistrim nga subjekte private që kanë ankimuar pranë kësaj strukture, ku nga Sektori i Tatim Taksave, çdo shkresë të ardhur për këtë qëllim i kemi kthyer përgjigje dhe i kemi dërguar të dhënat konkrete analitike që disponojmë, dhe konkretisht:

1.Shkresa nr.1, prot.,datë 28.5.2018 të ardhur nga Struktura e Apelimit Tatimor, Sektori i Tatim Taksave i ka dërguar të dhënat e kërkuara me shkresën nr.1/1 prot., datë 30.05.2018.

2.Shkresa nr.1/2, prot.,datë 18.06.2018 të ardhur nga Struktura e Apelimit Tatimor, Sektori i Tatim Taksave i ka dërguar të dhënat e kërkuara me shkresën nr.3 prot., datë 20.06.2018.

3.Shkresa nr.1/3, prot.,datë 18.06.2018 të ardhur nga Struktura e Apelimit Tatimor, Sektori i Tatim Taksave i ka dërguar të dhënat e kërkuara me shkresën nr.2 prot., datë 20.06.2018.

Struktura e apelimit tatimor ka kërkuar dokumentacionin e mësipërm nga sektori i tatim taksave për ato subjekte që kanë bërë ankimim pranë tyre, por vendimet përfundimtare për këto raste apo informacion tjetër nuk i kanë kthyer sektorit tatim taksave, përveç rastit të subjektit N. M.-person fizik.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarohet se nga ana e Drejtorive dhe Sektorëve të Bashkisë Tropojë ashtu sikurse edhe ju komentoni nuk ka bashkëndim të punëve për dhënien e përgjigjeve ankimesve mbi situatën faktike financiare të tyre. Përderisa ka ankesa nga qytetarët të cilët pretendojnë se kanë shlyer detyrimet, qëndron argumenti i audituesit.

Titulli i gjetjes: Debitorët për taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Situata: Debitorët për taksën e ndikimit në infrastrukturë, e cila duhet të ishte arkëtuar për objektet e regjistruar në ZVRPP nga ALUIZNI, gjatë viteve 2017-2018, është paraqitur në tabelën sa më poshtë vijon me kosto mesatare/sipërfaqe ndërtimi 32,899 lekë/m², sipas EKB. Janë në shumën **1,805,540 trajtuar në aneks 2/4.**

Gjatë periudhës viti 2019 janë arkëtuar 592,498 lekë dhe për vitin 2020 janë arkëtuar 437,917 lekë sipas aneks 2/5 dhe 2/6 bashkëlidhur.

Nga këto kanë mbetur pa arkëtuar 775,126 lekë sipas aneks 2/7, bashkëlidhur.

Janë arkëtuar gjithsej **1,030,414 lekë**, mbeten debitorë gjendje më 30.12.2020 për **775,126 lekë**, vlerë e cilapërbën mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Tropojë.

Kryesisht, sipas zyrës së taksave dhe tarifave të Bashkisë Tropojë, këto mos arkëtime janë për shkak të anashkalimit të arkëtimit të këtyre detyrimeve nga ana e ZVRPP-së, për të cilën nga Bashkia Tropojë është kërkuar vazhdimisht në rrugë zyrtare që të mos i kryejnë veprimet e regjistrimit të pronës nga këto lloj subjektësh, pa paraqitur dokumentin e pagesës së kësaj taksë.

Kriteri: Neni 22 i ligjit nr. 9632, datë 06.05.2017 për sistemin e taksave vendore me ndryshime.

Impakti: Mos arkëtimin e të ardhurave në interes të Bashkisë për vlerën **775,126 lekë**.

Shkaku: Bashkëpunimi midis drejtorive dhe institucioneve përgjegjës për këtë taksë.

Rëndësia: I lartë

Agjentët tatimorë:

- **Me DRSHTRR Kukës, e cila është agjent tatimor i mbledhjes së taksës vjetore të mjeteve të përdorura, Akt Rakordimet janë mbajtur sistematikisht, (trajtuar në akt konstatimin nr.3). Për vitin 2019 është arkëtuar e ardhur nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura në shumën 8,429,534 lekë dhe për vitin 2020 në shumën 9,424,043 lekë, pra nuk ka debitor**

Shumat e arkëtuara në periudhat 2019, 2020 përputhen me të dhënat e evidencave të realizimit të të ardhurave në zërin përkatës.

Rakordimet në lidhje me Tatimin e Thjeshtuar mbi fitimin janë mbajtur dhe nënshkruar rregullisht nga palët dhe përputhen me shumat e kaluara Bashkisë Tropojë në vitet 2019 dhe 2020. Shumat e arkëtuara në periudhat 2019, 2020 përputhen me të dhënat e evidencave të realizimit të ardhurave në zërin përkatës.

- Regjistri i subjekteve aktive gjendje më 31.12.2019 (ngarkesat fiskale taksa/tarifa vendore)

Tab.19

Në lekë

Gjendje	Tatim	Takse	Takse	Tarife	Tarife	Tarife	Totali
---------	-------	-------	-------	--------	--------	--------	--------

më:	Ndërtese	Trualli	tabele	shërbimi	reklame	parkimi	
31.12.2020	2,075,683	332,246	81,553	11,407,031	584,678	301,230	14,782,421
31.12.2019	2,045,714	275,199	47,742	11,127,036	642,247	84,700	14,222,638

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike dhe Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore

Pasqyra e ngarkesës, arkëtimeve, gjendje ne fund e debitorëve- ne lekë:

Tab.20

Viti	Ngarkesa fiskale vjetore	Arkëtime gjate vitit	Gjendja debitorë me 31.12.2020
2019	14,782,421	11,856,052	2,926,369
2020	14,222,638	9,814,334	4,408,304

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike dhe Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore

- Dokumentacioni për subjektet që ushtrojnë aktivitet privat në territorin e Bashkisë Tropojë, është grumbulluar nga Njësitë Administrative në kuadër të reformës territoriale dhe aktualisht ndodhet në Sektorin e Taksave/Tarifave.

Bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Tropojë janë përmbledhur në tabelën sa më poshtë vijon:

Tab.21

Nr	Lloji Biznesit	Periudha	Gjendja në fillim	Regjistrime të reja	Mbyllur aktivitetin	Gjendja në fund
1	Biznesi Vogël	2019	271	28	26	273
2	Biznesi Madh	2019	86	16	10	92
	Totali		357	44	36	365

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike dhe Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore.

Për këtë periudhë raportuese ushtrimore kanë ushtruar aktivitet gjithsej **365 subjekte**, nga të cilat me status *oBiznes i vogël* janë 273 subjekte dhe *oBiznes i madh* janë 92 subjekte, ku janë regjistrime të reja me 44 subjekte, ndërsa kanë ndërprerë dhe mbyllur aktivitetin 36 subjekte.

Për periudhën raportuese viti 2020, kanë ushtruar veprimtari ekonomike në aktivitete me objekt **“Biznesi vogël dhe Biznesi i madh”** për sa më poshtë;

Tab.22

Nr	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrime të reja	Mbyllur aktivitetin	Gjendja në fund
1	Biznesi Vogël	2020	273	23	28	268
2	Biznesi Madh	2020	92	6	4	94
	Totali		365	29	32	362

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike dhe Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore.

Për këtë periudhë raportuese ushtrimore kanë ushtruar aktivitet gjithsej **362 subjekte**, nga të cilat me status *oBiznes i vogël* janë 268 subjekte dhe *oBiznes i madh* janë 94 subjekte, ku janë regjistrime të reja me 29 subjekte, ndërsa kanë ndërprerë dhe mbyllur aktivitetin 32 subjekte.

- Sipas regjistrimit të kontratave të qirasë bazë të kontratave që gjenden në sektorin e taksave/tarifave për subjektet minerarellogaritja dhe arkëtimi i qirasë, paraqitet sa më poshtë vijon:

Tab.23

Subjekte	Vlera e llogaritur	Vlera e arkëtuar	Detyrim i mbetur
10	5,784,587	4,456,092	1,328,495

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike dhe Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore.

Më poshtë janë debitorët për kontratat e qerasë:

Tab.24. Tabela e debitorëve për kontratat e qerases 2019-2020, për subjektet minerare

Nr	Subjekti	NIPT	Kontrata		Afati i kontratës		Shuma lekë
			Nr.	Date	Prej	Deri	
1	A.T.A E. E. shpk	L.E	2365/7	24.08.2017	24.08.2020	23.08.2021	473,495

Nr	Subjekti	NIPT	Kontrata		Afati i kontratës		Shuma lekë
			Nr.	Date	Prej	Deri	
2	M. shpk	K.T	1673	20.04.2017	20.04.2017	19.04.2026	115,000
3	L. shpk	K.L	1672	11.04.2017	11.04.2018	10.04.2019	181,000
4	L. shpk	K.L	1672	11.04.2017	11.04.2019	10.04.2020	181,000
5	L. shpk	K.L	1672	11.04.2017	11.04.2020	10.04.2021	181,000
6	V. M. A. shpk	L.L	4943/2	18.1.2019	18.01.2019	17.01.2020	98,500
7	V. M. A. shpk	L.L	4943/2	18.1.2019	18.01.2020	17.01.2021	98,500
	Totali						1,328,495

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike dhe Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore.

Në tabelën e mësipërme, subjekti V. M. A. shpk ka dërguar nëpërmes rrjetit hatsAp punonjësve të sektorit taksave/tarifave shkresën nr.8667/1, date 27.11.2018, te Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore ÷Refuzim miratim programi vjetor të punës për lejen minerare nr. 1849, datë 23.10.2017, për periudhën 09.11.2018 deri 23.10.2019, por nuk ka të dhëna të tjera nëse subjekti ka mbyllur aktivitetin në vendburimin Kepenek fshat, NJA Bytyç.

Tab.25. Tabela e debitorëve për kontratat e qerese 2019-2020, për subjektet Antena Celulare, Hec-e, shoqata, subjekte per lokale:

Nr	Subjekti	NIPT	Kontrata		Afati i kontratës		Shuma lekë
			Nr.	Date	Prej	Deri	
1	Sh. A. shpk	K.N	3359/5	6.12.2018	6.12.2020	5.12.2021	151,370
2	Sh. I.	L.H	2168/2	31.07.2019	31.07.2020	30.07.2021	67,200
3	V. A. sha	K.H	1573	16.5.2019	15.11.2020	14.11.2021	255000
4	Trojet Energy shpk	L.H	4335/6	21.12.2018	21.12.2020	20.12.2021	690,272
5	Valmira Hoxhaj	L.M	1772	27.4.2016	10.12.2019	10.6.2021	90,000
6	H. V. shpk	L.T	2705/3	24.7.2019	24.7.2019	23.7.2020	1,135,804
	Totali						2,390,006

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike dhe Sektori Taksve dhe Tarifave Vendore

Shënim: subjektit H. V. shpk, shuma prej 1,135,804 lekë, përbehet prej 1,050,852 lekë qira troje dhe 84,952 kamat vonese e llogaritur deri me 25.01.2021.

Titulli gjetjes: Auditimi i tarifave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre,

Situata: Nga procesi i auditimit mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga Sektori Taksave e Tarifave Vendore, si dhe nga dokumentacioni i administruar në dosjen fizike për secilin subjekt që kryen aktivitet tregtim me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse në përdorim nga konsumatorët fundorë dhe tregtim të naftës bruto e nënproduktet e saj e lëndë djegëse të pajisur, apo rifreskimme (licencë/autorizime), për Periudhat raportuese vitet (2019 dhe 2020) u konstatua se, për të ardhurat e planifikuara nga zbatimi i nivelit të tarifës për pajisje, apo rifreskimin me (licencë/autorizime), KB me vendime përkatës ka parashikuar dhe miratuar në paketat fiskale për Periudhat ushtrimore vitet 2019; 2020, në Kapitulli (II) ÷ Tarifat vendore, pika (II-6) ÷ Dhënie licenca për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukte të saj, Tabela (19); ÷ Dhënie dhe përsëritje e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet dhe vajra lubrifikantë me nivel tarife viti 2019 me **2,000,000 lekë** dhe viti 2020 me **1,000,000 lekë**; ÷ Dhënie dhe përsëritje e licencave për njësite e shitjes së lëndëve djegëse, për veprimtarin e tregtimit për përdorim nga konsumatorët fundor me nivel tarife për 100,000 lekë në çdo vit.

Ky nivel tarife i parashikuar dhe miratuar me VKB për të ardhurat që do realizohen nga zbatimi nivelit të tarifës për pajisje, apo rifreskim me (Autorizim/Licencë) nga struktura përgjegjëse për programimin e këtij nivel tarife nuk janë respektuar kriteret e parashikuara nga VKM nr. 970, datë 02.12.2015 ÷ Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj i ndryshuar me

VKM nr.344, datë 19.04.2017ö, (ku sipas paketave fiskale niveli tarifës është miratuar 2,000,000 dhe 1.000.000 lekë për autorizim pika karburanti, ndërsa 100.000 lekë për autorizim njësi të shitjes së lëndë djegëse dhe bombola të gazit, për të cilat nuk është parashikuar afati i autorizimit bazë si edhe rinovimi për 5 vite), sepse niveli i tarifës i parashikuar me paketën fiskale në periudhën 2019 nuk është me 2,000,000 lekë për 5 vite kalendarik, ndërsa është ndryshuar me paketën fiskale në periudhën 2020 me 1,000,000 lekë për 5 vite kalendarik, ndërkohë që pagesa nuk është e pasqyruar me afat në autorizimin bazë, apo në rinovimin për 5 vitet mbi të cilën duhet të planifikohet dhe përllogaritet e ardhura vendore nga ky nivel tarife.

Referuar në të dhënat e informacionit që dërgoi Drejtoria e SHMZSH në lidhje me saktësimin dhe evidentimin e operatoreve ekonomik që ushtrojnë aktivitet me objekt tregtim me pakicë të karburantit, lëndë djegëse e gaz të lëngshëm për konsumatorë fundorë rezultoi se në territorin e Bashkisë Tropojë kryejnë këtë aktivitet subjektet sa më poshtë për të cilat nuk ka penalitete nga ana e Bashkisë është sipas tabelës sa më poshtë vijon:

Tab.26

Nr	Subjekti	NIPTI	Adresa	Aktiviteti	Periudha kontrollit
I					
Pikat e tregëtimit te karburantit					
1	õS.õshpk		Fshati Sopot	Pikë karburanti dhe plus Gaz	06.06.2019
2	õS.õshpk		LDardania BC	Pikë karburanti	
3	õH. 1.õshpk		LDardania BC	Pikë karburanti dhe plus Gaz	
4	õE. O.õshpk		L.Dardania BC	Pikë karburanti	
5	õA. A.õshpk		L.Dardania BC	Pikë karburanti dhe plus Gaz	
6	õD. O.õshpk		L.Dardania BC	Pikë karburanti dhe plus Gaz	
7	õG. C.õshpk		Rrug,Krojt BC	Pikë karburanti dhe plus Gaz	
8	õP.õshpk		L.Dardania BC	Pikë karburanti	
9	õSh.õshpk		Fierze	Pikë karburanti	

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike dhe Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore

Në dokumentacionin që është administruar në dosjen fizike të secilit subjekt nga Sektori i Taksave e Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Shërbimeve rezulton se, në territori Bashkisë Tropojë përfshirë Njësit Administrative (*Tropojë; Bujan; Bytyç; Margegaj; Llugaj; Fierz; Lekbibaj*) e ushtrojnë këtë aktivitet të pajisur me (*autorizim/licencë*) bazë, apo me rinovim pas përfundimit të afatit vlefshmërisë 5 vite kalendarike me të dhënat e pasqyruara sa më poshtë;

Pasqyra e subjekteve që ushtrojnë aktivitet, tregtim me pakicë karburant dhe gaz i lëngshëm për konsumatorë fundorë të pajisur me rinovim (autorizimi/licencë) për Periudhat 2019; 2020 me nivelin e tarifës VKM nr.344 në shumën 1,000,000:

Tab.27

Nr	Subjekti	NIPTI	Adresa	Autorizimi bazë	Rifreskimi Autorizimit		Niveli i tarifës së paguar		Diferencë në Pagesë
					Duhet	Është bërë	Vlera	Data	
1	õS.õshpk		Fshati Sopot	20.03.2017	17.05.2022	Në proces	640,000	10.12.2020	360,000
2	õS.õshpk		LDardania	17.05.2016	16.05.2021	Në proces	400,000	27.12.2016	600,000
3	õH. 1.õshpk		LDardania	09.08.2019	09.08.2024	Në proces	100,000	19.03.2019	900,000
4	õG. C.õshpk		Rrug,Krojt	15.03.2020	15.03.2025	16.03.2022	300,000	04.11.2020	700,000
5	õD. O.õshpk		L.Dardania	11.03.2017	12.03.2021	Në proces	360,000	18.09.2020	640,000
6	õE. O.õshpk		L.Dardania	11.01.2019	10.01.2024	Në proces	100,000	28.12.2018	900,000
7	õA. A.õshpk		L.Dardania	29.10.2013	10.04.2018	Ska aktual	460,000	2019/20	640,000
8	õP.õshpk		L.Dardania	21.09.2020	20.09.2025	20.09.2021	200,000	21.09.2020	800,000
9	õSh.õshpk		Fierze	20.09.2018	19.09.2023	Në proces	600,000	2018/20	400,000
Totali detyrimit									5,940,000

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike dhe Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore

Sa më sipër, shuma totale prej **5,940,000 lekë**, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tropojë.

Kriteri: Pika 9 e VKM nr. 970, datë 2.12.2015 òPër përcaktimin e proceduravedhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin enaftës bruto dhenënprodukteve të sajò i ndryshuar.

UMF nr. 26, Dt. 04.09.2008 dhe nr. 12, dt. 4.4.2017, òPër Taksat Kombètareò, etj.

Impakti: Mos aplikim i saktë i tarifës për paisje me autorizim, ka çuar në mungesë të ardhurash në shumën 5,940,000 lekë.

Shkaku: Moszbatim I akteve ligjore

Rëndësia: E lartë

Titulli gjetjes: Mbi mos vjeljen e taksave dhe tarifave vendore nga kontraktorët të cilët kanë lidhur kontrata për punë publike në territorin e Bashkisë Tropojë.

Situata: Nga procesi auditimit mbi dokumentacionin e administruar në regjistrat e realizimit të prokurimit publik për periudhën raportuese (2019; 2020), në lidhje me punët publike të realizuara në Bashkinë Tropojë nga OE të shpallur fitues në procedurat e prokurimit të cilët kanë lidhur kontrata për punë publike në territorin e Bashkisë Tropojë, përllogaritjet për çdo subjekt sipas afatit të përfundimit të punimeve pasqyrohet në aneks 2/8 bashkëlidhur. Rezulton se Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, në zbatim të VKB (te trajtuar në fillim të kësaj pike të programit të auditimit) për miratimin e paketës fiskale Kap.òTarifat Vendoreò, Pika II.1, tabela (13) nuk ka përllogaritur e aplikuar nivelin e tarifës për òpastrimin, largimin e mbetjeve, ndriçimin, gjelbërimin dhe kanalizimeòme afatet (nën/mbi 4 muaj), ku me 13 kontraktorë janë lidhur kontrata për punë publike me afat (nën 4/muaj) me 7 kontraktorë janë lidhur kontrata për punë publike me afat (mbi 4/muaj), ndërsa përpara fillimit të punimeve në kantier këta kontraktorë nuk kanë aplikuar në QKB për hapje e NIPTIT sekondar të vendit të ushtrimit të veprimtarisë të ndryshëm nga selia (sipas vendndodhjes të objektit të kontratës), për pasojë edhe nuk janë ngarkuar me detyrime për nivelin e tarifave të pastrimit, largimit e mbetjeve, ndriçimit, gjelbërimin dhe kanalizime të miratuara me paketën fiskale.

Pasqyra përmbledhëse e detyrimeve që duhet të kryhet për nivelin e tarifës së pastrimit, largimit të mbetjeve, ndriçimit, gjelbërimin dhe kanalizimeve në investimet e kryera nga subjektet ekonomik të shpallur fitues me kontrata të lidhura për periudhën raportuese (2019; 2020).

Tab.28

Nr	Subjekti	NIPT	Kontratat			Niveli Tarifës		Totali
			Nr	Data	Afati	Nën 4/muaj	Mbi 4/muaj	
1	'H. 1.'shpk	K.F	4	26.03.2019	2 muaj	68,000	0	68,000
2	'F.' shpk	J.P	5	26.03.2019	2 muaj	68,000	0	68,000
3	'M.'shpk	K.T	3	26.03.2019	2 muaj	68,000	0	68,000
4	'Sh.A.'shpk	K.N	3	26.03.2019	2 muaj	68,000	0	68,000
5	'V.'shpk	J.O	8	15.04.2019	1 muaj	68,000	0	68,000
6	'V.'shpk	J.O	6	15.04.2019	2 muaj	68,000	0	68,000
7	'V.'shpk	J.O	7	15.04.2019	2 muaj	68,000	0	68,000
8	'V.'shpk	J.O	9	29.05.2019	2 muaj	68,000	0	68,000
9	'H. 1.'shpk	K.F	12	27.06.2019	3 muaj	68,000	0	68,000
10	'Sh.'shpk	K.N	12	27.06.2019	3 muaj	68,000	0	68,000
11	'T.'shpk	L.F	10	14.06.2019	3 muaj	68,000	0	68,000
12	'N.' shpk	K.I	10	14.06.2019	3 muaj	68,000	0	68,000
13	'4.M'shpk	J.P	15	24.09.2019	3 muaj	68,000	0	68,000
14	'H. 1.' shpk	K.N	11	19.06.2019	1 muaj	68,000	0	68,000
15	'Sh.' shpk	K.N	11	19.06.2019	1 muaj	68,000	0	68,000
16	'V.' shpk	K.N	14	30.07.2019	1 muaj	68,000	0	68,000

Nr	Subjekti	NIPT	Kontratat			Niveli Tarifës		Totali
			Nr	Data	Afati	Nën 4/muaj	Mbi 4/muaj	
17	'G.'shpk	J.C	7	17.07.2020	1 muaj	68,000	0	68,000
18	'V.'shpk	K.N	14	13.11.2020	2 muaj	0	68,000	68,000
19	'V.'shpk	K.N	12	05.11.2020	4 muaj	0	75,000	75,000
20	'F.'shpk	J.P	16	08.12.2020	6 muaj	0	75,000	75,000
21	4. M.shpk	J.P	16	08.12.2020	6 muaj	0	75,000	75,000
22	'V.'shpk	K.N	24	11.01.2021	4 muaj	0	75,000	75,000
23	Sh.A.shpk	K.N	18	10.12.2020	6 muaj	0	75,000	75,000
24	'T.'shpk	L.F	18	10.12.2020	6 muaj	0	75,000	75,000
25	'F.'shpk	J.P	19	18.12.2020	12 muaj	0	75,000	75,000
26	4. M.shpk	J.P	19	18.12.2020	12 muaj	0	75,000	75,000
27	'V.'shpk	K.N	19	18.12.2020	12 muaj	0	75,000	75,000
28	'G.'shpk	J.C	25	22.01.2021	4 muaj	0	75,000	75,000
Totali								1,974,000

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Financës, Njësia e prokurimit dhe Sektori Taksave e Tarifave Vendore.

Në këto kushte si pasojë e mos programimit dhe mos aplikimit të nivelit të tarifës për këto kontrata investimi, si dhe mos likuidimi i detyrimit nga operatorët ekonomik në cilësinë e kontraktuesit në vlerën prej **1,974,000 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar e pa planifikuar për buxhetin e Bashkisë Tropojë.**

Kriteri: Këto veprime janë në mospërputhje me neni 43 pika 1/1, ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 ÷Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar; ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 ÷Për sistemin e taksave vendore i ndryshuar, Kreu (VII), neni 35, pika (1/1) neni 43, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ÷Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, si dhe UKM nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, neni 43/1 ÷Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, në çdo rast bëhen përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm. Kjo certifikatë lëshohet për të identifikuar vendndodhjen e ushtrimit të veprimtarisë, kur është e ndryshme nga selia, si dhe Vendime KB Tropojë nr.176, datë 23.11.2018 dhe nr.40, datë 26.11.2019 ÷Për miratimin e nivelit të taksave e tarifave vendore, citohet se;

Për vitin 2019; VKB nr.176, datë 23.11.2018, Kap.II. Tarifat vendore, Pika 1.

÷**Tarifa e shërbimeve publike** (pastrimit, largimit të mbetjeve, ndriçimit, gjelbërimit dhe kanalizimeve; Tabela nr.13.

Germa (F)-Për subjekte ndërtimit me kontrata sipërmarrje;

Pika 2-a) me kohë zgjatje deri në 4 muaj tarifa prej 68,000 lekë

Pika 2-b) me kohë zgjatje mbi 4 muaj tarifa prej 75,000 000 lekë

Për vitin 2020; VKB nr.40, datë 20.11.2019, Kap.II. Tarifat vendore, Pika 1.

÷**Tarifa e shërbimeve publike** (pastrimit, largimit të mbetjeve, ndriçimit, gjelbërimit dhe kanalizimeve; Tabela nr.13.

Germa (F)-Për subjekte ndërtimit me kontrata sipërmarrje;

Pika 2-a) me kohë zgjatje deri në 4 muaj tarifa prej 68,000 lekë.

Pika 2-b) me kohë zgjatje mbi 4 muaj tarifa prej 75,000 lekë.

Impakti: mungesë të ardhurash në shumën 1,974,000 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar e pa planifikuar për buxhetin e Bashkisë Tropojë

Shkaku: Mungesë bashkëpunimi midis drejtorive për rendimin e punëve si dhe moszbatim I akteve ligjore të fushës.

Rëndësia: E lartë

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni nëpërmjet postës elektronike në adresën lbaholli@klsh.org.al ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

-Për subjektet ekonomike të shpallur fitues me kontrata të lidhura, sipas pasqyrimit tuaj; për vitin 2019 dhe 2020 për 28 raste, për shumën e detyrimit të përlogaritur nga ana e juaj për 1,974,000 leke, Autoriteti Kontraktor- Bashkia Tropojë, Njësia e Prokurimit e Bashkisë Tropojë nuk ka dërguar në asnjë rast asnjë të dhënë në Sektorin e Tatim Taksave të Bashkisë Tropojë, lidhur me kontratat e lidhura me operatorët ekonomik, afatet, apo të dhënë tjetër sipas regjistrimit të realizimit që ata duhet të kenë.

Nëse do të na vinin të dhënat e regjistrimit të prokurimeve, nga Njësia e Prokurimit; kontratat e lidhura për punë publike me OE të shpallur fituese në procedurat e prokurimit publik sipas investimit me kohë zgjatjen, kantierin e ndërtimit, të realizuara në territorin e Bashkisë Tropojë, Sektori i Tatim Taksave do të kryente përlogaritjen e tarifës përkatëse të shërbimeve sipas VKB përkatëse të secilit vit.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se nga ana e Drejtorive dhe Sektorëve të Bashkisë Tropojë në lidhje me sa ju komentoni, shpreheni për mos rendim të punëve në funksion të detyrave të caktuara, gjë që duhet kryer për menaxhimin dhe realizimin e të ardhurave.

Si konkluzion,

a- Për vitin 2019 ka pasur mosrealizim të planit të përgjithshëm të të ardhurave në masën 65.5 % më pak ose -96,851 mijë lekë dhe për vitin 2020 me një mosrealizim -8,017 mijë lekë ose 14.6%. Theksojmë se plani i vitit 2020 është më pak se plani i vitit 2019 për 92,788 mijë lekë ose 2.69 herë më i vogël se plani i vitit 2019. Mosrealizimet dhe realizimet respektive flasin për një planifikim jo të drejtë të të ardhurave për vitin 2019.

b- Detyrimi prej **18,082,240 lekë**, i cili rezulton nga mospagimi i taksave dhe tarifave, përveçse borxh tatimor, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tropojë e përbërë nga:

Tab.29

Përshkrimi i debitorëve	Gjendja e debitorëve me 31.12.2020
Taksa/tarifa vendore (biznesi) të periudhës 2012-2020	16,421,953
Institucione për taksa/tarifa	885,160
Takse infrastrukture të vitit 2017-2018	775,127
Totali :	18,082,240

Burimi i të dhënave: Sektori Taksave e Tarifave Vendore

c- Shuma totale prej **5,940,000 lekë**, e llogaritur gabim për autorizimin e shitjes në stacionet e shitjes me pakicë të karburanteve dhe lëndëve djegëse për popullatën, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tropojë.

d- Shuma totale prej **1,328,495 lekë** e debitorëve për kontratat e qerave 2019-2020, për subjektet minerare përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tropojë.

e- Shuma totale prej 2,390,006 e debitorëve për kontratat e qerave 2019-2020, për subjektet Antena Celulare, Hec-e, shoqata, subjekte për lokale përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tropojë.

f- Si pasojë e mos programimit dhe mos aplikimit të nivelit të tarifës për kontratat e investimeve, si dhe mos likuidimi i detyrimit për taksa e tarifa vendore nga operatorët ekonomik në cilësinë e kontraktuesit është konstatuar vlera **1.974,000 lekë** e cila konsiderohet e ardhur e munguar e pa planifikuar për buxhetin e Bashkisë Tropojë.

Në total, rezulton një vlerë e mungesës së të ardhurave në buxhetin e Bashkisë Tropojë, në shumën **24,682,240 lekë**.

Për veprimet dhe mos veprimet e analizuar më sipër në lidhje me mangësitë e konstatuara në zbatimin e procedurave ligjore dhe nënligjore për arkëtimin e vlerës së nivelit të tarifës vendore, bazuar në kriteret e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, ngarkohen me përgjegjësi:

Tab.30

Funksioni	Vitet	
	2019	2020
Përgjegjës i sektorit të tatim taksave	F. D.	Nga 21.02.20 N. A.
Specialist i tatim taksave për realizimin e të ardhurave	H. S.	H. S.
Specialist i kadastres fiskale, kontrolli i subjekteve në terren	A. B.	Nga 21.02.20 F. D.
Specialist i tregut, kontratave të subjekteve minerale dhe rregjimit tatimor	B. S.	Nga 06.11.20 A. Ç.
Specialist i menaxhimit të borxhit	--	Nga 19.03.20 K. B.
Specialist i menaxhimit të taksave familjare	--	20.07.20 e në vazhdim E. B., zv më 02.11.20 nga B. B..

Burimi i të dhënave: Bashkia Tropojë

Sa trajuar më sipër është mbajtur akt konstatimi nr 3, datë 04.06.2021.

3.Vlerësimi i raportimit financiar (Auditim i pasqyrave financiare)

Pika nr. 3 e programit. Auditim i pasqyrave financiare (Vlerësimi i raportimit financiar).

Në zbatim të programit të auditimit, për të dy vitet 2019 dhe 2020 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Pasqyrat financiare të nënshkruara nga dega e thesarit Tropojë;

Lista e inventarit të aktiveve;

Dokumentacioni lidhur me kryerjen e inventarizimit vjetor;

Evidenca përmbledhëse të fund vitit mbi gjendjen e debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore.

Evidencat analitike mbi gjendjen e debitorëve të tjerë, si dhe evidencat analitike mbi gjendjen e kreditorëve.

Aktet e rakordimi me degën e thesarit Tropojë për të ardhurat dhe shpenzimet;

Dokumentacioni mbi transaksionet bankare të kryera (lidhjet e bankës).

Ditarët e bankës, anliza e llogarive etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

Baza ligjore (për të dy vitet 2019 dhe 2020).

1.Përshkrimi i situatës: Nga subjekti nuk është e evidentuar në pasqyrat financiare baza ligjore mbi të cilën janë hartuar pasqyrat financiarë (detyrë e lënë nga auditimi i mëparshëm). Gjithashtu nga disa anoM. të konstatuara gjatë procesit të auditimit e të evidentuara në vijim, konstatohet se nuk njihet si duhet baza ligjore për të gjithë procesin e inventarizimit dhe përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore.

Baza kryesore ligjore mbi të cilën njëzia vendore duhet të bazohet për hartimin e pasqyrave financiare vjetore është si vijon: ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, VKM nr. 248, datë 10.04.1998 për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të njësive që varen prej tyre, i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001, UMF nr. 14, datë 28.12.2006 për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2007, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendorë i ndryshuar, UMF nr. 8 datë 9.03.2018

ËPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, UMF nr. 30 datë 27.12.2011 ËPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, etj. legjislacion rregullues.

Për vitin 2019 pasqyrat financiare janë hartuar nga z. B. T., i cili prej datës 01.01.2020 e në vazhdim kryen detyrën e Drejtorit Ekonomik.

Për evidentimin kontabël të aktivitetit ekonomik dhe financiar, në këtë bashki, është organizuar dhe funksionon struktura e drejtorisë ekonomike.

Kontabiliteti mbahet në program Excel, bashkia nuk administron program financiar për këtë qëllim.

Për vitin 2019, janë hartuar pasqyrat financiare të njësisë së vetëqeverisjes vendore Bashkia Tropojë, të cilat janë paraqitur në degën e thesarit Tropojë, në datën 14.04.2020, ndërsa pasqyrat financiare të vitit 2020, janë përfunduar dhe paraqitur pranë degës së thesarit Tropojë, në datën 10.05.2021.

Për të dy vitet 2019 dhe 2020, pasqyrat financiare janë përfunduar jashtë afateve ligjore, në kundërshtim me kërkesat e nenit 29 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ËPër tatimin mbi të ardhurat, në të cilin përcaktohet se data përfundimtare për hartimin e pasqyrave financiare është data 31 mars e vitit pasardhës. Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi z. B. T., me detyrë drejtor ekonomik dhe z. P. M., me detyrë përgjegjësi i financës (ky i fundit vetëm për vitin 2020)

Pasqyrat financiare janë të përbëra nga formatet e mëposhtme:

Format nr. 1 ÓPasqyra e pozicionit financiar.

Format nr. 2 ÓPasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).

Format nr. 3 Ó Pasqyra e flukseve monetare (Cash-Flou).

Format nr. 4 ÓPasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.

Format nr. 5 ÓPyetësor dhe shënimet shpjeguese.

Format nr. 6 ÓInvestimet dhe burimet e financimit.

Format nr. 7/a ÓGjendja dhe ndryshimi i aktiveve (kosto historike).

Format nr. 7/b ÓGjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).

Format nr. 8 ÓNumri i punonjësve dhe fondi i pagave

Kontrolli periodik i aktiveve

1. Titulli i gjetjes: Mos respektimi si duhet i procedurave ligjore nga komisioni i inventarizimit (Mos hartimi i raportit lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, korrigjimi i gjendjes kontabël në dokumentin e fletës së inventarizimit)

Situata: *Procesi i inventarizimit të aktiveve për vitin 2019:*

Për kryerjen e procesit të inventarizimit të vitin 2019, nga kryetari i bashkisë z.R. B. kanë dalë urdhrat si vijon:

1. Urdhri nr. 282, datë 30.12.2019 nr.4108 prot., ËPër ngritjen e komisionit të inventarizimit për vitin 2019, Bashkia Tropojë. Në urdhër është përcaktuar:

a. Ngritja e komisionit për vitin 2019 në Bashkinë Tropojë dhe institucionet që varen prej saj, sipas listës bashkangjitur.

b. Për paisjen e komisionit me inventarët përkatës ngarkohet z. B. T.. Në vijim të urdhrat janë përcaktuar anëtarët e komisionit të inventarizimit, të ndarë sipas njësive administrative.

Në urdhër është përcaktuar se ËInventarizimi do të fillojë në datën 08.01.2020 dhe do të përfundojë në datën 25.01.2020.

Në përfundim të procesit të inventarizimit, komisionet e inventarizimit nuk kanë hartuar raport me shkrim lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësimin e tyre paraprak, gjendjen e tyre fizike (aktivet e dëmtuara të cilat duhet më tej të vlerësohen nga komisioni i vlerësimit të

aktiveve), kushtet e ruajtjes së aktiveve, diferencat nëse ka ose jo, dëmtimet, nëse ka ose jo. Për shkak të mungesë së këtij raporti, për vitin 2019 u audituan fletët e inventarizimit, një e nga një dhe nuk u konstatua që komisionet e inventarizimit të jenë shprehur në këto fletë për mungesa të aktiveve.

-Procesi i inventarizimit të aktiveve për vitin 2020:

Për kryerjen e procesit të inventarizimit të vitin 2020, nga kryetari i bashkisë z.R. B. ka dalë urdhri nr. 216, datë 21.12.2020 nr.4998 prot., ÷Për ngritjen e komisionit të inventarizimit për vitin 2020 në Bashkinë Tropojë.

Në urdhër është përcaktuar se ÷Inventarizimi do të fillojë në datën 28.12.2020 dhe do të përfundojë në datën 29.01.2020.

Janë ngritur 12 komisione sipas njësive administrative dhe natyrës së aktiveve, në total 36 persona.

Në përfundim të procesit të inventarizimit, komisionet e inventarizimit nuk kanë hartuar raport me shkrim lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësimin e tyre paraprak, gjendjen e tyre fizike (aktivet e dëmtuara të cilat duhet më tej të vlerësohen nga komisioni i vlerësimit të aktiveve), kushtet e ruajtjes së aktiveve, diferencat nëse ka ose jo, dëmtimet, nëse ka ose jo. Për shkak të mungesë së këtij raporti, për vitin 2020 u audituan fletët e inventarizimit, një e nga një dhe nuk u konstatua që komisionet e inventarizimit të jenë shprehur në këto fletë për mungesa të aktiveve.

Konstatohet se disa nga komisionet e inventarizimit korrigjojnë me shkrim dore gjendjen kontabël të aktiveve, duke e zvogëluar këtë vlerë, me vlerën e aktiveve që ata vlerësojnë paraprakisht se janë për t'ju nënshtruar për vlerësim përfundimtar nga komisioni i vlerësimit të aktiveve. Kjo tregon se personat që caktohen për inventarizim nuk kanë të qartë rregullat e kryerjes së këtij procesi, pra nuk njohin si duhet kërkesat e udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ÷Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik. Fakti që përgjegjësi i buxhetit dhe i financës dhe drejtori i ekonomik (për të dy vitet 2019 dhe 2020) kanë pranuar dokumente të tilla tregon se edhe prej tyre nuk njihen si duhet dhe nuk zbatohen kërkesat e mësipërme të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ÷Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik.

Ashtu si dhe në vitin 2019, nga drejtorja e financës edhe në vitin 2020 janë dhënë për komisionin e inventarizimit vetëm fletët kontabël të llogarisë 327, 218, 215 dhe si rrjedhim nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i të gjitha aktiveve të njësisë vendore.

Kriteri: Mos hartimi i raportit përmbledhës është në kundërshtim me kërkesat e pikës nr.85, germa (c) e udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 ÷Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, ku thuhet:

Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për...Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësimin paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues.

Nuk ka dokumentacion vërtetues për datën e përfundimit të inventarizimit vjetor 2019 dhe 2020, pasi prej komisioneve, nuk është hartuar raporti ku të dokumentohet përfundimi i këtij procesi.

Korrigjimi i gjendjes kontabël të aktiveve në fletën e inventarizimit nga komisioni është në kundërshtim me kërkesat e pikës nr.85 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 ÷Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, ku thuhet:

Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për:
a. Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë publike dhe pasqyrimin e të dhënave të inventarizimit në procesverbalin përkatës, i

cili ruhet gjatë periudhës së inventarizimit.

b. Të bëjë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura mesektorin e financës, të llogaritë kompensimet e lejueshme, duke marrë edhe mendimin e specialistëve përkatës dhe, për diferencat që mund të dalin pas kompensimeve, të hartojë procesverbalet.

c. Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësimin paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues.

Ndikimi (Efekti): Mos hartimi i raportit në përfundim të procesit të inventarizimit nuk jep informacion të plotë dhe përmbledhës për rezultatet e përgjithshme të inventarizimit, ndërsa korrigjimi i vlerës kontabël në fletët e inventarizimit, deformon situatën reale të aktiveve, në sasi dhe vlerë.

Shkaku: Mos zbatim i kërkesave ligjore të mësipërme (rubrika kriteri), lidhur me procesin e inventarizimit të aktiveve.

Rëndësia: e mesme

2.Titulli i gjetjes: Mos ngritja e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara, mos bërja e tyre hyrje në magazinë dhe mos regjistrimi në kontabilitet edhe pasi janë konstatuar të pa regjistruara nga komisioni inventarizimit dhe ky i fundit ka njoftuar Drejtorinë Ekonomike.

Situata: Komisioni i inventarizimit në vitin 2019, gjatë kryerjes së këtij procesi në shkollën e mesme Gjinnazi òAsim Vokshiò, ka konstatuar aktive tepër, në vlerën 9,788,944 lekë, të pa përfshira në gjendjen kontabël të printuar nga financa dhe të pa regjistruara në librat e kontabilitetit të Drejtorisë Ekonomike të Bashkisë Tropojë, të pa bëra hyrje në magazinën e kësaj bashkie. Aktivet, të cilat janë furnizime pa pagesë, kanë ardhur nga KESH sha D. dhe ZA Tropojë. Këto aktive janë marrë në dorëzim provizorisht nga drejtoresha e Gjinnazit òAsim Vokshiò, znj. Sh. B., e cila është personi që ka firmosur si òmarrës në dorëzimò, në fletëdaljen e furnitorit. Kjo shkollë nuk ka strukturë të financës dhe si rrjedhim duke mos u kryer procesi i dorëzimit të mallit në magazinën e Bashkisë Tropojë, mallrat nuk janë regjistruar në librat e kontabilitetit. Po ashtu shpërndarja e tyre sipas destinacioneve në këtë shkollë (laboratorëve përkatës) nuk është dokumentuar.

Të dhëna për aktivet e paregjistruara në bashkinë Tropojë, të gjetura tepër nga komisioni i inventarizimit, në Gjinnazin òAsim Vokshiò jepen në aneksin nr.3, bashkëlidhur raportit të auditimit.

Gjatë procesit të inventarizimit, komisioni i inventarizimit ka nënshkruar fletëdaljet e mësipërme të furnitorit, të cilat kanë qenë tashmë të firmosura nga drejtore e shkollës znj. Sh. B., gjë të cilën nuk duhet ta bënte, pasi në fletëdalje për subjektin ku dorëzohet malli, pra për Bashkinë Tropojë, firmos marrësi i mallit në dorëzim (i cili bazuar në UMF nr.30 datë 27.12.2011, është komision i ngritur me urdhër të titullarit, ose sektori i shërbimeve) dhe magazinieri, i cili pas marrjes së mallit në dorëzim bënë hyrjen e mallit në magazinë.

Komisioni i inventarizimit në dokumentin nr. 1166 prot., datë 28.02.2020, drejtuar drejtorisë ekonomike, ka vënë në dijeni këtë të fundit për ekzistencën e aktiveve të paregjistruara në librat e kontabilitetit dhe të pa bëra hyrje në magazinë. Pasi është njohur me këtë informacion, drejtoria ekonomike nuk ka marrë masa për hyrjen e mallit në magazinën e Bashkisë Tropojë, e si rrjedhim as regjistrimin e tyre në librat e kontabilitetit.

Kriteri: Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme nga drejtoria e ekonomike janë në kundërshtim me kërkesat eudhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, rubrika -Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara, ku thuhet:

Pika 55. Për hyrjet e mallrave që qarkullojnë pa pagesë në njësitë e sektorit publik fletë-hyrja e plotësuar nga magazina duhet të ketë bashkëlidhur dokumentacionin përkatës si:

Pika 57. Për hyrjet e aktiveve të dhuruara dokumentacioni shoqërues përbëhet nga Marrëveshja/akti i dhurimit ose letrën zyrtare të njësisë donatore; Faturën që identifikon mallrat dhe vlerën e tyre; Dokumentet e zhdoganimit dhe Çertifikatën e origjinës (në rast importi); Procesverbalin e marrjes në dorëzim të konfirmuar nga sektori i shërbimeve...

56. Për të gjitha hyrjet që bëhen pa pagesë, njësia publike pritëse e aktivitetit i përcjell akt-konfirmimin dërguesit brenda datës 20 të muajit pas ardhës. Akt konfirmimi firmoset nga nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues i njësisë pritëse.

- Pika nr. 89: Në rast se pas inventarizimit dalin ndryshime në vleftë, mungesa mbetet në ngarkim të punonjësit me përgjegjësi materiale, kurse tepricat bëhen hyrje në magazinë dhe shkojnë në dobi të njësisë.

Aktivet e mësipërme në vlerën 9,788,944 lekë, vazhdojnë aktualisht deri në datën 04.06.2020, të mos jenë bërë hyrje në magazinë dhe të mos jenë regjistruar në kontabilitet.

- Për mos ngritjen e komisioneve për marrjen në dorëzim të aktiveve ka përgjegjësi ish Kryetari i Bashkisë z. B. D. (për një pjesë të aktiveve të dhuruara në muajin qershor 201), si dhe Kryetari aktual i Bashkisë z. R. B. (për aktivet e dhuruara gjatë muajit shtator 201).

- Për mos rregjistrimin e aktiveve të dhuruara në vlerën 9,788,944 lekë, në magazinë dhe në librat e kontabilitetit të drejtorisë ekonomike, në momentin pasi këto aktive janë konstatuar nga komisioni i inventarizimit, i cili me raportin nr. 1166 prot., datë 28.02.2020, ka njoftuar me shkrim këtë drejtori, për këto aktive të pa rregjistruara, mban përgjegjësi z. P. M. në cilësinë e përgjegjësit të financës dhe buxhetit, i cili në detyrat funksionale të rregullores së brendshme përgjigjet për kontrollin dhe respektimin e disiplinës financiare, për përdorimin e vlerave materiale dhe monetare të njësisë, si dhe z. B. T., me detyrë drejtor ekonomik, në cilësinë e nëpunësit zbatues.

Ndikimi (Efekti): Mos marrja në dorëzim e aktiveve nga komisioni i posaçëm i ngritur me urdhër të Titullarit, ka shkëputur vijimësinë e mëtejshme të regjistrimit të tyre: aktivet nuk janë bërë hyrje në magazinë, nuk janë shpërndarë me fletëdalje personave përgjegjës, nuk janë regjistruar në librat e kontabilitetit, e si rrjedhojë të gjitha këto krijojnë premisa për humbjen e tyre.

Shkaku: Mos zbatimi i kërkesave ligjore lidhur me marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara.

Rëndësia: e lartë

3. Titulli i gjetjes. Anom. në procesin e vlerësimit të aktiveve për dalje nga përdorimi. Mos hartimi i relacionit të vlerësimit nga komisioni i vlerësimit, duke mos shpjeguar procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës. Në listën e aktiveve që do të dalin nga përdorimi janë vendosur edhe aktive të cilat nuk janë amortizuar, pa dhënë shpjegime.

Situata. *Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi për vitin 2019*

Për vlerësimin e aktiveve të Bashkisë Tropojë për vitin 2019, nga Kryetari i Bashkisë z.R. B. ka dalë urdhri nr.6, datë 16.01.2020, nr.243 prot., që mban ngritjen e komisionit të vlerësimit të aktiveve të propozuara për nxjerrjen ashtë përdorimit. Komisioni përbëhet nga z. B. T.,

kryetar, me detyrë drejtor ekonomik, si dhe anëtarët: z. P. M., me detyrë përgjegjës i financës dhe buxhetit, z.F. M. me detyrë këshilltar i kryetarit.

-Në zbatim të urdhrin të mësipërm nga komisioni i vlerësimit të aktiveve, në përfundim të këtij procesi është mbajtur procesverbali nr. ska, datë 28.02.2020, ò Për vlerësimin dhe kategorizimin e AQT të propozuara për jashtë përdorimit nga Njësia Qendër, zyrat e administratës. Më këtë procesverbal janë listuar aktivet e vlerësuara për jashtë përdorimit (për asgjësim dhe skrap), për llogarinë ekonomike 218 óInventar ekonomik (orendi zyre etj.) dhe llogarinë 327 óInventar i imët.

Për llogarinë 218-1 dhe 218-6, në procesverbal komisioni ka dokumentuar se ka vlerësuar 679 aktive të llogarisë të cilat duhet të nxirren jashtë përdorimit, kryesisht tavolina shkolle, karrige shkolle, banka shkolle, dollap shkolle, krevat hekuri, dyshek, por edhe disa paisje informatike si kompjuter, printer, fotokopje. Në datën 31.12.2019, vlera bruto e aktiveve të vlerësuara për jashtë përdorimit nga komisioni i vlerësimit, është 18,459,741 lekë, ndërsa vlera e mbetur e këtyre aktiveve (vlera neto) është 9,386,124 lekë. Në procesverbalin e vlerësimit të aktiveve komisioni i vlerësimit nuk ka shpjeguar kriteret mbi bazën e të cilave ka vlerësuar këto aktive për tu nxjerrë jashtë përdorimit (nëse është plotësuar koha e shfrytëzimit në bazë të normave të amortizimit, dhe nuk mund të riparohen, kanë humbur cilësitë e tyre të caktuara etj.).

Në listën e hartuar mungon viti i vënies në punë të aktivitetit, koha e shfrytëzimit. Nga vlera e mbetur e tyre prej 9,386,124 lekë, konstatohet se jo të gjitha aktivet e kanë plotësuar kohën e shfrytëzimit të tyre, në bazë të normave të amortizimit. Pra disa aktive në bazë të të dhënave të pasqyruara në këtë listë, nuk janë amortizuar plotësisht, ndërsa disa të tjera janë pa vlerë amortizimi, pra vlera bruto është e barabartë me vlerën neto, por nga komisioni nuk janë dhënë shpjegime për arsyen e listimit të tyre për jashtë përdorimit.

Procesverbali i vlerësimit të aktiveve nuk është firmosur nga përgjegjësi material dhe nuk është miratuar nga titullari i institucionit. Nga komisioni i vlerësimit nuk është hartuar relacioni i vlerësimit të aktiveve, i cili duhet të shpjegojë procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës.

- Për llogarinë 327 óInventar i imët (aktive të cilat nuk i nënshtrohen amortizimit), në procesverbalin e mësipërm, në listën e aktiveve të vlerësuara për jashtë përdorimit nga komisioni i vlerësimit, janë listuar 337 aktive, në vlerën 1,682,669 lekë, si perde, stufa, libra shkollor, maket shtroje, stenda etj., por edhe për këto aktive nuk janë shpjeguar arsyet e vlerësimit për jashtë përdorimit.

Përsa më sipër mban përgjegjësi komisioni i vlerësimit të aktiveve: z. B. T., kryetar (njëkohësisht nëpunës zbatues), me detyrë drejtor ekonomik, si dhe anëtarët: z. P. M., me detyrë përgjegjës i financës dhe buxhetit, z. F. M. me detyrë këshilltar i kryetarit të bashkisë. Këshilli bashkiak me vendimin nr.90, datë 27.03.2020, òPër miratimin e raportit vlerësimit të aktiveve për nxjerrjen jashtë përdorimit, në Bashkinë Tropojë për vitin 2019, ka miratuar listën e aktiveve të propozuara për jashtë përdorimit nga komisioni i vlerësimit, për të dy llogaritë 218 dhe 327.

Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi për vitin 2020

Për vlerësimin e aktiveve të Bashkisë Tropojë për vitin 2020, nga Kryetari i Bashkisë z.R. B. ka dalë urdhri nr.25, datë 11.02.2021, nr.479 prot., òPër ngritjen e komisionit të vlerësimit të aktiveve të propozuara për nxjerrjen ashtë përdorimit në Bashkinë Tropojë. Komisioni përbëhet nga z. B. T., kryetar, me detyrë drejtor ekonomik dhe njëkohësisht nëpunës zbatues, si dhe anëtarët: znj. B. S., me detyrë specialiste finance, z. P. M., me detyrë përgjegjës i financës dhe buxhetit.

-Në zbatim të urdhrin të mësipërm nga komisioni i vlerësimit të aktiveve, në përfundim të këtij procesi është mbajtur procesverbali nr. ska, datë 11.02.2021, ò Për vlerësimin dhe

kategorizimin e AQT të propozuara për jashtë përdorimit nga njësia qendër, zyrat e administratës. Më këtë procesverbal janë listuar aktivet e vlerësuara për jashtë përdorimit (për asgjësim dhe skrap), për llogarinë ekonomike 218 óInventar ekonomik (orendi zyre etj.) dhe llogarinë 327 óInventar i imët.

Për llogarinë 218-1 dhe 218-6, në procesverbal komisioni ka dokumentuar se ka vlerësuar 150 aktive të llogarisë të cilat duhet të nxirren jashtë përdorimit, kryesisht tavolina shkolle, karrige shkolle, perde shkolle, krevat hekuri, dyshek. Në datën 31.12.2020, vlera bruto e aktiveve të vlerësuara për jashtë përdorimit nga komisioni i vlerësimit, është 1,744,596 lekë, ndërsa vlera e mbetur e këtyre aktiveve (vlera neto) është 338,656 lekë.

Nga auditimi i këtij procesverbali u konstatua se komisioni i vlerësimit të aktiveve nuk ka shpjeguar arsyet përse i ka vlerësuar këto aktive të llogarisë 218 për tu nxjerrë jashtë përdorimit. Në listën e hartuar mungon viti i vënies në punë të aktivitetit, koha e shfrytëzimit. Nga vlera e mbetur e tyre prej 338,656 lekë, konstatohet se jo të gjitha aktivet e kanë plotësuar kohën e shfrytëzimit të tyre, në bazë të normave të amortizimit. Pra disa aktive në bazë të të dhënave të pasqyruara në këtë listë, nuk janë amortizuar plotësisht. Procesverbali i vlerësimit të aktiveve nuk është firmosur nga përgjegjësi material dhe nuk është miratuar nga titullari i institucionit.

Nga komisioni i vlerësimit nuk është hartuar relacioni i vlerësimit të aktiveve, i cili duhet të shpjegojë procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës.

- Për llogarinë 327 óInventar i imët (aktive të cilat nuk i nënshtrohen amortizimit), nga komisioni i vlerësimit të aktiveve, është mbajtur procesverbali nr. ska, datë 26.02.2021. Në procesverbalin e mësipërm, në listën e aktiveve të vlerësuara për jashtë përdorimit janë listuar 105 aktive, në vlerën bruto 322,142 lekë. Edhe për këto aktive nuk janë shpjeguar arsyet e vlerësimit për jashtë përdorimit.

Përsa më sipër mban përgjegjësi komisioni i vlerësimit të aktiveve: z. B. T., kryetar dhe anëtarët: znj. B. S., z. P. M.,

Këshilli bashkiak me vendimin nr.32, datë 30.03.2021, óPër miratimin e raportit të vlerësimit të aktiveve për nxjerrjen e tyre jashtë përdorimit, në Bashkinë Tropojë për vitin 2020, ka miratuar listën e aktiveve të propozuara për jashtë përdorimit nga komisioni i vlerësimit, për të dy llogaritë 218 dhe 327.

Kriteri: Për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje jashtë përdorimit është vepruar në kundërshtim me udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 óPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, pika 95 e rubrikës óProcesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi, pika 102 e rubrikës óLista e aktiveve të identifikuar për vlerësim, pika 103 e rubrikës óKriteret për vlerësimin e Aktiveve, pika 104 dhe 105 të rubrikës óProces verbali i vlerësimit, pika 106 të rubrikës óRelacioni i vlerësimit.

Në pikën 102 të udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 thuhet:

Nëpunësi Zbatues i njësisë, në bazë të gjendjes faktike të aktiveve të rezultuar nga inventarizimi, normave të amortizimit, afatit të skadencës, vitit të vënies në punë, vlerës së shtuar ndër vite, mundësitë për riaftësimin e aktiveve në raport me kosto/ përfitimin për një veprim të tillë, informacionit zyrtar të marrë mbi dobishmërinë e aktiveve nga drejtuesit e programeve buxhetore dhe punonjësit e tjerë të njësisë, përcakton gjendjen e aktiveve dhe harton listën e atyre që do të vlerësohen. Lista nënshkruhet nga komisioni i vlerësimit dhe përgjegjësi material dhe hartohet në tre kopje, një nga të cilat qëndron në arkiv.

Pika 104 dhe 105.- Procesverbali i vlerësimit: Hartohet nga komisioni i vlerësimit pas verifikimit faktik të të gjitha aktiveve duke argumentuar arsyet për vlerësimin e secilit prej tyre...

Procesverbali hartohet në tre kopje dhe nënshkruhet nga përgjegjësi material dhe komisioni

Ndikimi (Efekti): Mos hartimi dhe ndjekja e procedurave standarde ligjore për vlerësimin e aktiveve për dalje nga përdorimi nuk jep siguri për ruajtjen dhe mirë administrimin e aktiveve. Mos dhënia e argumenteve për arsyen e listimit të aktivitetit për dalje nga përdorimi, lë shkak për abuzime dhe keqpërdorime të aktiveve.

Shkaku: Mos zbatimi i kërkesave ligjore lidhur me vlerësimin e aktiveve për dalje nga komisioni i vlerësimit për dalje nga përdorimi.

Rëndësia: e lartë

4. Titulli i gjetjes. Heqja e aktiveve nga kontabiliteti pa u kryer procesi i daljes nga përdorimi, por mbi bazën e procesit të vlerësimit. Mos identifikimi dhe mos veçimi gjatë procesit të asgjësimit të aktiveve të cilat mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshme, dhe të shiteshin në ankand.

Situata. *Nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve për vitin 2019.*

Për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit nga Kryetari i Bashkisë z.R. B. ka dalë urdhri nr.197, datë 9.11.2020, nr.4533 prot., òPër ngritjen e komisionit të asgjësimit të aktiveve të propozuara për jashtë përdorimitò. Ky komision përbëhet nga znj. Z. K. I., me detyrë n/kryetare bashkisë, kryetare e komisionit, si dhe anëtarët: znj. B. S., me detyrë specialiste finance, znj. E. H., me detyrë inspektore e pyjeve, z. P. M., me detyrë përgjegjës i financës dhe i buxhetit, z.E. M., me detyrë specialist për administrimin. e regjistrin të teritorit. Në urdhër nuk është përcaktuar afati i përfundimit të procesit të nxjerrjes jashtë përdorimit. Nga Kryetari i Bashkisë z. R. B., urdhri për asgjësimin e aktiveve është nxjerrë më vonesë, pasi ka diferencë të konsiderueshme në kohë me urdhrin për ngritjen e komisionit të vlerësimit të aktiveve, si dhe është nxjerrë pas datës 31 mars, e cila është data e fundit për dorëzimin e pasqyrave financiare në degën e thesarit.

Kryerja e inventarizimit, vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve, duhet të përfundojë shumë kohë përpara datës 31 mars të vitit buxhetor, me qëllim që rezultatet e këtij procesi të jenë në dispozicion të drejtorisë së financës për hartimin e pasqyrave financiare. Urdhrat duhet të dalin në një diferencë kohe të arsyeshme me njeri-tjetrin, në mënyrë që komisioni i vlerësimit të ketë në dispozicion rezultatet e komisionit të inventarizimit dhe komisioni i asgjësimit të ketë në dispozicion rezultatet e komisionit të vlerësimit. Gjithashtu veprimet e asgjësimit duhet të mos sjellin vonesa në kohë për hartimin e pasqyrave financiare.

Gjatë vitit 2020, komisioni i asgjësimit nuk ka kryer veprime lidhur me asgjësimin e aktiveve për llogari të vitit buxhetor 2019. Aktivitetet e vlerësuar për jashtë përdorimit nga komisioni i vlerësimit të aktiveve të ngritur me urdhrin nr.6, datë 16.01.2020, nr.243 prot., janë asgjësuar gjatë vitit 2021, së bashku më aktivet e vlerësuara për jashtë përdorimit nga komisioni i vlerësimit ngritur me urdhrin nr. 25, datë 11.02.2021.

Por për llogari të vitit buxhetor 2019, nga drejtoria ekonomike janë hequr nga kontabiliteti aktive (trajtuar te analiza e llogarive përkatëse të pasqyrës së pozicionit financiar), pa u kryer procesi i asgjësimit, por duke u mbështetur vetëm në procesverbalin e vlerësimit të aktiveve për jashtë përdorimit.

Nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve për vitin 2020

Për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit nga Kryetari i Bashkisë z.R. B. ka dalë urdhri nr.212, datë 10.12.2020, nr.4896 prot., òPër ngritjen e komisionit të asgjësimit të aktiveve të propozuara për jashtë përdorimit në Bashkinë Tropojë. Ky komision përbëhet nga znj. Z. K. I., me detyrë n/kryetare bashkisë, kryetare e komisionit, si dhe anëtarët: znj. B. S., me detyrë specialiste finance, znj. E. H., me detyrë inspektore e pyjeve, z. P. M., me detyrë përgjegjës i financës dhe i buxhetit, z.E. M., me detyrë specialist për administrimin. e regjistrin të teritorit.

Për llogari të vitit 2020, komisioni i asgjësimit (i ngritur me urdhrin nr.212, datë 10.12.2020) në datën 20.04.2021 ka mbajtur procesverbalin nr.1, nr.1292 prot., òPër asgjësimin e inventarit ekonomik Bashkia Tropojë, i cili është miratuar nga Kryetari i Bashkisë z. R. B.. Në këtë procesverbal, konstatohet se komisioni ka kryer asgjësimin e 105 aktive të llogarisë 327, në vlerën bruto 322,142 lekë, si dhe 150 aktive të llogarisë 218 me vlerë bruto 1,744,596 lekë, vlera e mbetur 338,656 lekë, Këto lista përputhet me listat e komisionit të vlerësimit për jashtë përdorimit.

Për llogari të vitit 2019, komisioni i asgjësimit i ngritur me urdhrin nr.212, datë 10.12.2020, ka kryer asgjësimin edhe të aktiveve të vlerësuara si jashtë përdorimit nga komisioni i vlerësimit të vitit të mëparshëm (i cili ka vlerësuar aktivet për llogari të vitit buxhetor 2019). Për këtë komisioni ka mbajtur procesverbalin nr.1, datë 20.04.2021, nr.1292/1 prot., bashkangjitur të cilit është lista e 679 artikujve të llogarisë 218, në vlerën bruto 18,459,751 lekë dhe vlerën e mbetur 9,386,129 lekë, si dhe lista e 337 aktive të llogarisë 327, në vlerën 1,682,659 lekë. Listat e asgjësimit përputhen me listën e vlerësimit të aktiveve për jashtë përdorimit nga komisioni i vlerësimit, ngritur me urdhrin nr.6, datë 16.01.2020, nr.243 prot. (pra janë asgjësuar aktivet e propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit nga komisioni i një viti më parë, për llogari të vitit buxhetor 2019, pasi procedura e asgjësimit për këtë vit nuk është kryer dhe aktivet e propozuara për jashtë përdorimit nuk janë asgjësuar).

Për vitin 2019 dhe 2020 një numër shumë i vogël nga këto aktive si kasafortë, krevat hekuri, lavatrice, stufa, nga komisioni i vlerësimit janë përcaktuar me destinacion për skrap, por nuk janë ndjekur procedurat për vlerësimin e mbetjeve, hyrjen në magazinë dhe shitjen e tyre gjatë procesit të asgjësimit.

Të gjitha aktivet e nxjerra jashtë përdorimit kanë qenë me destinacion òpër asgjësim/tjetërsim, dhe bazuar në procesverbalin e mbajtur nga komisioni, aktivet janë asgjësuar, por nuk janë identifikuar dhe veçuar ato aktive të cilat mund të përdroreshin si vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshme, dhe të shiteshin në ankand (ose për ato me përbërje lëndë druri, pasi të vlerësoheshin të përdroreshin edhe si dru zjarri në kopshtet dhe çerdhet e njësisë vendore nëpërmjet dokumentacionit përkatës).

Për mos zbatimin e kërkesave ligjore gjatë procesit të daljes së aktiveve nga përdorimi ka përgjegjësim komisioni i asgjësimit i përbërë znj. Z. K. I., me detyrë n/kryetare bashkisë, kryetare e komisionit, si dhe anëtarët: znj. B. S., me detyrë specialiste finance, znj. E. H., me detyrë inspektore e pyjeve, z. P. M., me detyrë përgjegjës i financës dhe i buxhetit, z.E. M., me detyrë specialist për administrimin. e regjistrat të teritorit.

Për heqjen e aktiveve nga pasqyrat financiare të vitit 2019, pa u kryer procesi i asgjësimit të tyre, por mbi bazën e procesverbalit të komisionit të vlerësimit të aktiveve për dalje nga përdorimi, **ngarkohet me përgjegjësi** z. B. T., me detyrë Drejtor Ekonomik, në cilësinë e nëpunësit zbatues.

Kriteri. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me faktin e ndodhur dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, rubrika - Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve, pika 34-36, si dhe pikës 109, ku thuhet:

Pika 34. Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në:

a. Dokumente autorizues - janë ato dokumente që autorizojnë kryerjen e një veprimi të caktuar ekonomik e që i bashkëlidhet dokumentit vërtetues. Të tilla janë urdhrat e blerjeve, kontratat, urdhri për krijimin e komisioneve, urdhër për nxjerrje jashtë përdorimit, etj.

b. Dokumente vërtetues - vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arkëtimet, mandat pagesat, procesverbalet, dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi.

c. Dokumente të kontabilitetit - janë dokumentet përmbledhës ose regjistrat kontabël (libri i madh, librat analitike, kartelat e aktiveve, etj) të çdo lloji forme, bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra

nga dokumentet vërtetuese.

Pika 109: Aktivet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira, mbeturina, materiale të riciklueshme, hiqen nga regjistri i aktiveve në përdorim, bëhen hyrje në magazinë dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë (me përjashtim të rasteve kur sipas rregullave të shëndetësisë duhet të asgjësohen), kurse të tjerat asgjësohen nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi duke ndryshuar formën e tyre fillestare, gruposur ose djegur.

Në këtë rast mungon dokumenti vërtetues, i cili është procesverbali i asgjësimit të aktiveve dhe për këtë arsye nuk mund të bëhen ndryshime në librat e kontabilitetit dhe në pasqyrat financiare, lidhur me pakësimin e aktiveve, pa këtë procesverbal.

Ndikimi (Efekti): Heqja e aktiveve nga kontabiliteti në vitin 2019, pa u kryer procesi i asgjësimit, deformon informacionin në pasqyrat financiare, si dhe krijon shkak për humbjen e tyre.

Të gjitha aktivet e nxjerra jashtë përdorimit kanë qenë me destinacion për asgjësim/tjetërsim, por mos identifikimi dhe mos veçimi i aktiveve të cilat mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshme dhe të shiteshin në ankand, është keqpërdorim i aktiveve dhe heqje e mundësisë për përfitimin e të ardhurave nga shitja e tyre.

Shkaku: Mos zbatimi i kërkesave ligjore lidhur me nxjerrjen e aktiveve nga përdorimi dhe hartimin e pasqyrave financiare.

Rëndësia: E lartë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të projekt raportit të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni nga znj. Z. I., znj. B. S., z. F. M., me shkresë nr. 935/32, datë 16.06.2021 (të dhëna të subjektit), protokolluar në KLSH me nr.361/10, datë 18.6.2021, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në vijim të bazës ligjore sa më sipër ju vëme në dijeni se aktivet e transferuara nga komunat e suprimuar nuk kanë pasur të dhënat e mjaftueshme me të paktën datën e vënies në punë të aktivitetit dhe për rrjedhojë nuk kemi pasur mundësinë për të bërë te mundur një llogaritje të sakte të amortizimit.

2. Aktivet e llogarisë 218 inventar ekonomik përkatësisht pajisje zyre dhe kompjuterike në mbështetje të udhëzimit Nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, kjo llogari amortizohet me vlerën fillestare dhe me një vlerë 25% në vit. Pajisjet kompjuterike nga vet natyra e tyre si dhe teknologjia në zhvillim riparimi i tyre është me i kushtueshëm si dhe një garanci riparimi shumë e vogël, prandaj është parë nxjerrja jashtë përdorimit për tu zëvendësuar pajisje të reja.

3. Përsa i përket pikës 3 në Akt Konstatimin nr .9 ju bëjmë me dijeni se nuk janë identifikuar dhe veçuar ato aktive të cilat mund të përdoren si vjetërsira, mbeturina, materiale të riciklueshme dhe ato me përbërje lende drusore të përdorshme si dru zjarri në kopshte dhe çerdhe. Nuk e kemi realizuar seleksionimi për arsye se fuqia punëtore për seleksionimin dhe ndarjen e tyre ka një kosto më të lartë se vlera e druve dhe materialeve të riciklueshme

4. Pika nr.2 Akt konstatimi nr .9 .

Tabela në proces verbalin e mbajtur me datën 11.02.2021 "Për vlerësimin dhe kategorizimin e AQT të propozuara për jashtë përdorim " në këtë proces verbale janë vlerësuar në totale 105 aktive të propozuar për jashtë përdorim tabela përmban të dhëna mbi vendndodhjen e aktiveve personin përgjegjës çmim, sasinë , vlerën bruto me datë më 31.12.2020 amortizimin e akumuluar ndër vite dhe vlerën e mbeture neto me datë 31.12.2020 .

Pjesa e aktiveve që vlera neto nuk i është konsumuar totalisht janë propozuar për nxjerrje jashtë përdorimi për arsye se janë të dëmtuara, pavarësisht se nuk janë amortizuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Pretendimet që ngrini nuk qëndrojnë pasi bëhet fjalë për aktivet e llogarisë 218, jo të llogarisë 327 (jo për 105 aktivet). Ju nuk keni të dhëna për shkallën e amortizimit dhe vlerën e mbetur për disa aktive të cilat janë nxjerrë jashtë përdorimit ndërsa të tjera janë nxjerrë jashtë përdorimit me vlerë të mbetur të konsiderueshme krahasuar me vlerën e tyre fillestare. Pretendimi juaj se nuk keni veçuar ato aktive të cilat mund të përdoshin si vjetërsira, mbeturina, materiale të riciklueshme me arsye se fuqia punëtore për të kryer seleksionimin dhe ndarjen e tyre ka kosto të lartë, nuk qëndron sepse këto janë kërkesa të udhëzimit nr.30 për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik duhet të respektohen gjatë procesit të inventarizimit.

Aktivitet Afat shkurtra

5. Titulli i gjetjes: Kryerja e veprimeve të shpeshta me para në dorë nëpërmjet arkës, si për pagesa edhe për arkëtime, mbi limitin e lejuar, si dhe ruajtja e vlerave financiare në arkë mbi këtë limit për të dy vitet 2019 dhe 2020. Mos monitorimi i gjendjes së arkës nga Drejtori Ekonomik, por nga specialisti i financës.

Situata: Llogaria 531 -Mjete monetare në arkë, më 31.12.2019 ka vlerën 100,000 lekë. Gjatë vitit 2019 është kryer inventari i gjendjes së arkës në fund të çdo muaji dhe është hartuar procesverbale midis arkëtares znj.V. D. dhe specialistes së financës znj.D. H., por ky inventarizim nuk është nën shkruar dhe si pasojë nuk është mbikëqyrur. Inventari i arkës në 31.12.2019 nënshkruar prej tyre ka vlerën 100,000 lekë (gjendje në arkë), vlerë e cila përputhet me vlerën e llog.531 në pasqyrën e pozicionit financiar.

Nga auditimi i procesverbalit nr. ska, datë 31.12.2019, e mbajtur midis arkëtares znj. V. D. dhe specialistes së financës znj. D. H., për inventarin e arkës për muajin dhjetor 2019, konstatohet se nuk ka përputhje midis gjendjes kontabël të arkës, e cila është 100,000 lekë dhe gjendjes fizike të saj, e cila është zero lekë. Në procesverbal është shënuar se òkjo shumë është tërhequr nga n/kryetarja e Bashkisë znj. Z. I.. Arkëtarja posedon një dokument të nënshkruar nga N/Kryetares që deklaron që ka tërhequr shumën e lekëve prej 100,000 lekësh për nevoja të institucionit

Nuk ka rregulla të brendshme të shkruara nga titullari për funksionimin e procesit të arkëtimeve dhe pagesave nga arka, kontrolleve të arkëtarit prej eprorëve të tij, rakordimeve midis tyre, depozitimin e vlerave financiare nga arka në bankë.

Arkëtimet në arkë për vitin 2019:

Arkëtime me arkë janë kryesisht detyrimet e taksave e tarifave vendore nga bizneset dhe abonentët familjar, vërtetime të ndryshme, pagesat e kopsht/ çerdhe, nga NJA (detyrimet taksash dhe vërtetim), të ardhura nga dru zjarri, etj.

Sipas të dhënave nga arkëtarja znj.V. D.për periudhën janar-dhjetor 2019 janë prerë gjithsej:

- 2,583 mandat arkëtime (MA) për vlerën 3,541,369 lekë;
- janë tërhequr me cekë nga banka dhe janë arkëtuar në arkë në 6 raste, në vlerën 4,643,870 lekë;
- një arkëtim për shpërblim lindje në vlerën 50,000 lekë;
- pagesa të KZAZ, të pa tërhequra nga anëtarët e KZAZ, në vlerën 52,190 lekë;
- gjendja e arkës më 01.01.2019 (nga viti 2018), vlera 120,000 lekë

Totali i arkëtimeve 8,407,429 lekë, totali i pagesave 8,307,429 lekë, mbetje në arkë në 31.12.2019 vlera 100,000 lekë (8,407,429-**8,307,429**).

Pagesat nga arka për 2019: Pagesat nga arka janë kryer për ndihmën e menjëhershme, (emergjencës) dhe të shpërblimeve të lindjes,

Janë prerë 35 mandat pagesa në vlerën 8,307,429 lekë, nga të cilat 20 MP janë derdhje në thesar. Pagesat për ndihmën e menjëhershme janë kryer në vlerën 3,659,500 lekë, nëpërmjet 9 MP, sipas aneksit 3/1, bashkangjitur raportit të auditimit.

Pagesat e kryera në bankë (derdhje nga arka në bankë për thesarin) kanë vlera nga 100,000 deri në 500,000 lekë, të cilat tregojnë edhe vlerat financiare të mbajtura në arkë mbi limitin e lejuar, sipas aneksit 3/2, bashkangjitur raportit të auditimit, ku paraqiten disa nga MP e kryera në vitin 2019.

-Llogaria 531 -Mjete monetare në arkë, më 31.12.2020 në pasqyrën e pozicionit financiar ka vlerën 597,862 lekë dhe përputhet me vlerën e gjendjes së arkës më 31.12.2020. Gjatë vitit 2020 është kryer inventari i gjendjes së arkës në fund të çdo muaji dhe është hartuar procesverbal midis arkëtares znj. V. D. dhe specialistes së financës znj. D. H. deri në muajin prill, ndërsa në vijim deri në muajin dhjetor midis arkëtares znj. V. D. dhe specialistes së financës znj. B. S.. Nga këto procesverbale konstatohet se gjendja e arkës në datën 31.12.2020 ka vlerën 597,862 lekë. Procesverbalet e inventarizimit të arkës nuk janë nënshkruar nga nëpunësi zbatues z. B. T..

Në muajin janar 2020, në procesverbalin e mbajtur prej arkëtares dhe specialistes së financës është pasqyruar diferenca prej 100,000 lekë, e mbartur nga viti 2019. Në datë 28.02.2020, në procesverbalin e mbajtur prej tyre, është pasqyruar një diferencë midis gjendjes kontabël dhe gjendjes fizike në vlerën 105,653 lekë, Në procesverbal është përshkruar: *“Nga kontrolli i arkës u konstatua diferencë midis gjendjes kontabël dhe gjendjes fizike për vlerën 105,653 lekë. Shuma prej 100,000 lekë është e mbartur që nga muaji dhjetor 2019, sipas shpjegimit për diferencën nga ana e arkëtares e cila posedon një dokument të nënshkruar nga ana e N/Kryetares znj. Z. I., ku deklaron se shumën e ka tërhequr për nevoja të institucionit, ndërsa shuma prej 5,600 lekë rezulton si shkak i blerjes së mandat arkëtimeve/pagesave, sipas faturës bashkangjitur, e urdhëruar nga N/Kryetarja znj. Z. I. (K.).*

Në procesverbalin për kontrollin e arkës të muajit mars dhe prill 2020, vetëm vlera 5,600 lekë është evidentuar si mos përputhje midis gjendjes kontabël dhe gjendjes fizike, ndërsa vlera 100,000 lekë nuk është pasqyruar. U paraqit procesverbali i mbajtur në datën 06.03.2020, midis arkëtares znj.V. D. dhe znj. Z. I., në të cilin është përshkruar se prej kësaj të fundit ÷u bë dorëzimi prana arkës së Bashkisë Tropojë shuma prej 100,000 lekë.

Nga arkëtarja u paraqit mandat arkëtimi në bankën Raiffeisen, me datë 09.03.2020, i cili ka përshkrimin e arkëtimit të vlerës 100,000 lekë, derdhje për thesarin. Për argumentimin e nevojës së përdorimit të vlerës 100,000 lekë, u paraqit procesverbali me datë 03.12.2019, mbajtur nga z./kryetari z. K. R., z/kryetari znj. Z. I., shoferi z. P. K., në të cilin shpjegohet se për arsye të mungesës së fondeve për shërbimin e makinës së pastrimit, e cila ka nevojë për riparim, janë tërhequr vlera financiare nga arka.

Për vlerën 5,600 lekë blerje MP dhe PA, u paraqit fatura tatimore, kuponi tatimor dhe fletëhyrja e mallit në magazine. Për vlerën 5,600 lekë nuk është prerë mandat pagesë nga arkëtarja, duke u mjaftuar me dokumentacionin e mësipërm.

Për vlerën 100,000 lekë, si tërheqja dhe arkëtimi i vlerës, është bërë pa mandat arkëtimi dhe pagese, por me dokument dore, në kundërshtim me UMF nr.30, gjë e cila ngarkon me përgjegjësi arkëtares znj. V. D., si dhe znj. Z. I., lidhur me mosrespektimin e procedurave të disiplinës financiare.

Arkëtimet në arkë për vitin 2020

Arkëtime me arkë janë kryesisht detyrimet e taksave e tarifave vendore nga bizneset dhe abonentët familjar, vërtetime të ndryshme, pagesat e kopsht/çerdhe, nga NJA (detyrimet taksash dhe vërtetim), të ardhura nga dru zjarri etj.

Sipas të dhënave nga arkëtarja znj.V. D. dhe specialistja e financës znj. B. S., për periudhën janar-dhjetor 2020 janë prerë gjithsej:

- 1972 mandat arkëtime (MA) për vlerën 4,240,036 lekë;
- janë tërhequr me cekë nga banka dhe janë arkëtuar në arkë në 4 raste, në vlerën 2,203,672 lekë;

- gjendja e arkës më 01.01.2020 (nga viti 2019), vlera 100,000 lekë

Totali i arkëtimeve 6,543,708 lekë, totali i pagesave 5,945,836 lekë (30 MP), mbetje në arkë në 31.12.2020 vlera 597,827 lekë (6,543,708 -5,945,836).

Pagesat nga arka për 2020: Pagesat nga arka janë kryer për ndihmën e menjëhershme (emergjencës) në vlerën 1,606,000, me 4 MP, një MP për pagesë komisioner dhe të tjerat janë MP për derdhjen e vlerave financiare nga arka në bankë (derdhje për thesarin), të cilat kanë vlera nga 77 mijë lejë deri më 390 mijë lekë, disa prej të cilave për vitin 2020 jepen në aneksin nr. 3/3, bashkëngjitur raportit të auditimit.

Për vitin 2020 janë kryer pagesa nga arka për ndihmën e menjëhershme (emergjente), të cilat janë përfituar nga familjet që kanë pasur gjendjen e emergjencës, sipas të dhënave në aneksin nr. 3/4, bashkëngjitur raportit të auditimit.

Kriteri: Për të dy vitet 2019 dhe 2020 procesverbalet për përcaktimin e gjendjes së vlerave financiare në arkë, janë hartuar nga arkëtari dhe specialisti i financës, por jo nga nëpunësi zbatues, në kundërshtim me Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, pika nr.78, ku thuhet:

“Përcaktimi i gjendjes së vlerave monetare në arkë dhe letrave me vlerë bëhet nga nëpunësi zbatues me anë të inventarizimit fizik minimalisht një herë në muaj.”

Për të dy vitet 2019 dhe 2020, konstatohet se nga Bashkia Tropojë janë kryer veprimeve me arkën (arkëtime dhe pagesa), si dhe janë mbajtur vlera financiare në arkë, mbi limitin e lejuar ligjorë, në kundërshtim me pikat 63 dhe 64, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve të njësisë së sektorit publik, të ndryshuar dhe VKM nr. 290, datë 14.6.1993 për limitin e arkës në ndërmarrjet shtetërore, pika nr.3, ku respektivisht thuhet:

UMF nr. 30, datë 27.12.2011, pika 63. Veprimet me para në dorë kryhen vetëm brenda limitit ditor të arkës, të miratuar nga Nëpunësi i Pare Autorizues me propozim të Sistemit të Thesarit, me akte të veçanta sipas specifikave të njësisë publike. Pika 64. Veprimet me para në dorë kryhen për transaksionet financiare në formën e paradhënies për udhëtime e dieta, gjithashtu edhe për arkëtimin e të ardhurave në vlera më të vogla se 1000 lekë. Përjashtim bëjnë vetëm arkëtimet e tarifave për shërbimin shëndetësor ofruar pacientëve nga njësitë shpenzuese të shërbimit shëndetësor. VKM nr. 290, datë 14.6.1993 “Limiti ditor i arkës caktohet:- Për ndërmarrjet kombëtare 100 mijë lekë - Për ndërmarrjet lokale 50 mijë lekë”.

Për sa më sipër është përgjegjësi e nëpunësit zbatues z. R. I. për vitin 2019 dhe z. B. T. për vitin 2020, por edhe e arkëtares znj. V. D..

Llogaria 520 -Disponibilitete në Thesar më 31.12.2019 ka vlerën debitorë 50,585,750lekë dhe për vitin 2020 ka vlerën 124,155,622lekë. Kjo llogari ka analizën e saj, e cila më gjerësisht trajtohet në aneksin nr. 3/5, bashkëngjitur raportit të auditimit.

Ndikimi (Efekti): Mos monitorimi i gjendjes së arkës nga Drejtori Ekonomik, mbajtja e vlerave financiare në arkë dhe kryerja e veprimeve të shpeshta mbi limitin e lejuar, përveçse janë shkelje e disiplinës financiare, kanë edhe risk në ruajtjen e vlerave financiare.

Shkaku: Mos zbatimi i kërkesave ligjore lidhur me kryerjen e veprimeve financiare nëpërmjet arkës.

Rëmdësia: E mesme.

Inventar qarkullues.

6. Titulli i gjetjes: Mos kryerja e inventarizimit të llogarisë 312 –Materiale

Situata: -Llog. 31 –Materiale. Në bilancin e vitit 2019 ka vlerën 416,100 lekë.

Për të vërtetuar vlerën e kësaj llogarie u paraqit vetëm lista analitike e kësaj llogarie, si dhe një pasqyrë përmbledhëse të hartuara nga ish specialisti i financës z. B. T., aktualisht drejtor finance, e cila ka të njëjtën vlerë me atë të pasqyruar në aktivin e pasqyrës së pozicionit financiar.

Pasqyra përmbledhëse tregon: gjendja në fillim të vitit 2019 ka vlerën 2,022,837 lekë, shtesa (debitim) gjatë vitit 2019 në vlerën 19,257,217 lekë, paksime (kreditim) gjatë vitit 2019 në vlerën 20863954 lekë. Llogaria 31 óMateriale, është llogari, rezultati i së cilës në fund të vitit del nga rezultatet e inventarizimit vjetor të magazinës ku ndodhen këto aktive, por nga auditimi konstatohet se në procesin e inventarizimit të vitit 2019 nuk është kryer inventarizimi i kësaj llogarie nga komisionet e ngritura për këtë qëllim, e si rrjedhim vlera e pasqyruar në pasqyrat financiare nga hartuesi i tyre z. B. T., nuk jep siguri se është një vlerë e saktë. Përgjegjësit material nuk kanë firmosur në listën analitike bashkangjitur bilancit.

-Llog. 31 –Materiale. Në bilancin e vitit 2020 ka vlerën 288,385 lekë.

Për të vërtetuar vlerën e kësaj llogarie u paraqit lista analitike e kësaj llogarie, në të cilën është rakorduar midis përgjegjësit material të magazinës dhe specialistes së financës (materiale janë ushqime për kopshte dhe çerdhe).

Komisioni i inventarizimit nuk është shprehur për gjendjen e kësaj llogarie.

Kriteri: Mos inventarizimi nga komisioni i llogarisë 312 óMateriale, është në kundërshtim me pikat 73 dhe 74, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve të njësisë së sektorit publikò, ku thuhet:

...Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këtë udhëzim dhe me urdhra /udhëzime nga titullari i njësi publike.

Cdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.

Ndikimi (Efekti): Mos kryerja e inventarizimit ndikon në uljen e sigurisë për ruajtjen dhe mirë përdorimin e aktiveve.

Shkaku: Mos zbatimi i kërkesave ligjore lidhur me kryerjen e procesit të inventarizimit.

Rëndësia: E ulët

7. Titulli i gjetjes: Për vitin 2019 dhe 2020, për llogarinë 327 –Inventar i imët, ka mospërputhje midis vlerës së pasqyruar në pasqyrat financiare, vlerës së komisionit të inventarizimit dhe vlerës së listës analitike të kësaj llogaria që administrohet nga Drejtoria Ekonomike

Situata: Llog.32 -Inventar i imët, në bilancin e vitit 2019 ka vlerën 12,339,373 lekë, ndërsa në 31.12.2018 ka vlerën 19,561,578 lekë.

U paraqit dokumenti kontabilitetit (elektronik) me emërtimin òAnaliza e llogarisë 327ò, hartuar nga ish specialisti i financës z. B. T., aktualisht drejtor finance, ku janë të përshkruar artikujt me sasi çmim, vlerë të llogarisë 327, e cila tregon vlerën totale më 31.12.2019 prej 6,044,150 lekë. U paraqit gjithashtu dokumenti i kontabilitetit (elektronik) me emërtimin òAnaliza e llogarisë 327ò, në të cilin nuk ka listë analitike (me artikuj, çmim, vlerë), por vetëm vlera totale të debitimeve dhe kreditimeve vjetore 2019, si vijon:

Gjendje me 01.01.2019 (çelje)	Levizjet 2019		Gjedja Kontabel
Debi	Debi	Kredi	me 31.12.2019
19,561,578	721,600	7,943,805	12,339,373

Sipas dokumentit të mësipërm, gjendja (debi) e llogarisë 32 -Inventar i imët, në 01.01.2019 (celja), ka vlerën 19,561,578 lekë, shtesa (debi) gjatë vitit 2019 në vlerën 721,600 lekë, pakësimi (kredi) gjatë vitit 2019 në vlerën 7,943,805 lekë. Gjendja në 31.12.2019 ka vlerën 12,339,373 lekë.

Nga të dhënat e mësipërme konstatohet se këto dy dokumente nuk rakordojnë me njëra-tjetrën.

Nga auditimi i dokumentacionit të procesit të inventarizimit të vitit 2019, u konstatua se komisionet e inventarizimit janë shprehur për gjendjen e llogarisë 327- Inventar i imët, sipas fletëve të inventarizimit të marra nga drejtoria ekonomike. Pas përfundimit të procesit të inventarizimit, nuk janë konstatuar aktive mangut dhe dokumentet e inventarizimit janë dorëzuar pranë drejtorisë së financës, por nga kjo e fundit nuk është përgatitur përmbledhëset e inventarizimit për llogarinë 327. Kjo gjë u bë gjatë procesit të auditimit, nga drejtori i financës z. B. T., me kërkesën e grupit të auditimit dhe sipas përmbledhëses së dhënë prej drejtorit të financës, rezulton se në përfundim të procesit të inventarizimit, vlera totale e llogarisë 327 - Inventar i imët, në datën 31.12.2019 është 7,460,247 lekë, si vijon:

Tab.31

Llogaria 327 në 31.12.2019		
Nr	Njësia administrative	Vlera në lekë
	Qendra	1,325,820
	Qendra 1	4,268,758
	Njësiti Administrative (7 Njësiti)	1,865,669
		7,460,247

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike

Në mënyrë të përmbledhur për llogarinë 327 -Inventar i imët, sipas dokumentacionit përkatës, për vitin 2019 janë këto të dhëna:

Gjendja fizike

- Rezultati i komisionit të inventarizimit, pra gjendja fizike e kësaj llogarie në vlerën 7,460,247 lekë;

-Nxjerrje jashtë përdorimit në vlerën 1,682,659 lekë, e cila praktikisht është kryer në procesin e inventarizimit e vitit buxhetor 2020, por veprimet kontabël, heqja e aktiveve nga kontabiliteti janë pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2019, mbi bazën e rezultateve të komisionit të vlerësimit të aktiveve.

- Gjendja fizike e aktiveve të llogarisë 327, në datën 31.12.2019, sipas rezultateve të komisionit të inventarizimit del 5,777,588 lekë, e ndryshme nga gjendja kontabël, pasqyruar në vijim.

Gjendja kontabël

- Gjendja kontabël sipas kartelave të inventarizimit të drejtorisë së financës, dhënë komisionit të inventarizimit për kryerjen e këtij procesi, në vlerën 7,460,247 lekë;

- Lista analitike e kësaj llogarie (elektronike) hartuar nga ish specialisti i financës z. B. T., në datën 31.12.2019 ka vlerën 6,044,150 lekë;

- Vlera e pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2019, prej 12,339,373 lekë.

Si konkluzion, pasqyrat financiare të vitit 2019 për llogarinë 327 –Inventar i imët, pasqyrojnë një vlerë prej 6,561,785 lekë më shumë se vlera e rezultateve të inventarizimit dhe 6,295,223 lekë më shumë se vlera e analizës së llogarisë (lista analitike) që disponon Drejtoria Ekonomike.

Llog.32 -Inventar i imët, në bilancin e vitit 2020 ka vlerën 16,230,389 lekë.

Rezultatet e inventarizimit për llogarinë 32 -Inventar i imët, për vitin ushtrimor 2020:

Me shkresën nr.1751 prot., datë 26.05.2021, nga Drejtoria Ekonomike u paraqit lista përmbledhëse e rezultateve të komisionit të inventarizimit për vitin ushtrimor 2020, e cila ka

vlerën 5,989,628 lekë. Gjithashtu nga kjo drejtori, me shkresën nr.935/6 prot., u paraqit lista e aktiveve të cilat janë bërë dalje nga magazina për vitin 2020 (të cilat janë veshje për policinë e zjarrfikëseve), në vlerën totale 1,007,093 lekë, nga të cilat është përfshirë në procesin e inventarizimit vetëm vlera 68,986 lekë, ndërsa vlera 938,100 lekë nuk i është nënshtruar procesit të inventarizimit dhe gjithashtu nuk është bërë pjesë e rezultatit total të llogarisë 327-Inventar i imët.

Tab.32

Llogaria 327 në 31.12.2020		
Nr	Njësia administrative	Vlera në lekë
	Qendra	279,486
	Qendra 1	4,392,268
	Njesitë Administrative (7 Njesitë)	1,317,874
	Vlera e pa pasqyruar në procesin e inventarizimit	938,100
	Shuma	6,927,728

Burimi: Drejtoria Ekonomike Bashkia Tropojë

Vlera e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit për llogarinë 327 për vitin ushtrimor 2020 është 322,142 lekë.

Si përfundim, gjendja e kësaj llogarie, sipas procesit të inventarizimit në datën 31.12.2020 del në vlerën 6,605,586 lekë (6,927,728 -322,142) dhe jo në vlerën 16,230,389 lekë që pasqyrohet në pasqyrën e pozicionit financiar.

U paraqit dokumenti kontabilitetit (elektronik) me emërtimin "Analiza e llogarisë 327", hartuar nga përgjegjësi buxhetit dhe i financës z. P. M. dhe drejtori ekonomik z. B. T., ku janë të përshkruar artikujt me sasi çmim, vlerë të llogarisë 327, e cila në datën 31.12.2020 tregon vlerën totale prej 6,044,150 lekë, vlerë e njëjtë me atë të datës 31.12.2019. Nuk ka të dhëna kontabël të rregjistruara nëse ka pasur shtesa gjatë vitit 2020 kjo llogari dhe nëse po, sa është kjo vlerë. Gjithashtu në analizën e llogarisë nuk është rregjistruar vlera 322,142 lekë e nxjerrjes jashtë përdorimit.

Si konkluzion:

- Gjendja e llogarisë 327 nga procesi i inventarizimit 6,927,728 lekë;
- Paksime të gjendjes nga nxjerrja jashtë përdorimit në vlerën 322,142 lekë
- Vlera që duhet të kishte llogaria 327 në bilanc mbështetur në rezultatet e inventarizimit është 6,605,586 lekë;
- Vlera që kanë në fakt pasqyrat financiare është 16,230,389 lekë;

Në pasqyrat financiare pasqyrohet një vlerë prej 9,624,803 lekë më shumë se vlera e dalë nga rezultatet e procesit të inventarizimit.

Komisioni i asgjësimit (i ngritur me urdhrin nr.212, datë 10.12.2020) në datën 20.04.2021 ka mbajtur procesverbalin nr.1, nr.1292 prot., në të cilin vërtetohet se ka nxjerrë jashtë përdorimit aktive të llogarisë 327 në vlerën 322,142 lekë, për llogari të vitit ushtrimor 2020.

Për mangësitë e mësipërme mban përgjegjësi z. B. T., me detyrë drejtor ekonomik, në cilësinë e nëpunësit zbatues, z. P. M. (vetëm për vitin 2020).

Pretendim i subjektit të audituar: Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni pa protokoll nga subjekti, protokolluar në KLSH me numër prot., 361/6, datë 14.06.2021 dhe 361/8, datë 16.06.2021, nga znjV. B., ku në mënyrë të përmbledhur janë shprehur komentet si më poshtë:

-Në observacionin nr. 361/6prot., datë 14.06.2021, KLSH vihet në dijeni për kërkesën që znj. V. B. ka bërë në Bashkinë Tropojë për kërkesë dokumentacioni.

Në observacionin nr. 361/8 prot., , datë 16.06.2021, thuhet:

Jam pezulluar nga detyra në datën 08.01.2021 dhe nuk kam marrë pjesë në mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2019 dhe as në procesin e inventarizimit për llogari të vitit 2019.

Qëndrim i grupit të auditimit: Për sa më sipër është e drejtë, pasi Ju nuk keni marrë pjesë në hartimin e pasqyrave të vitit 2019 dhe as në procesin e inventarizimit të këtij viti, veprime

të cilat janë kryer pas pezullimit tuaj nga puna dhe për këtë arsye nuk jeni përgjegjëse për këtë çështje.

Kriteri: Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e nenit 3, pika 1, nenin 7 dhe 11, të ligjit nr. 25/2018 për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare; Kap. II, të VKM nr. 783, datë 22.11.2006 për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabëlë; udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Ndikimi (Efekti): Pasqyrat financiare për llogarinë 327 - Inventar i imët, nuk japin informacion të vërtetë për gjendjen e kësaj llogarie, pasi vlera e paraqitur nuk është rrjedhojë e procesit të inventarizimit.

Shkaku: Mos zbatimi i kërkesave ligjore lidhur me hartimin e pasqyrave financiare

Rëndësia: E lartë

U audituan llogaritë e arkëtueshme: Llogaria 423-429 për Personeli, paradhënie, deficite, gjoba

Llogaria 468 për Debitorë të ndryshëm, Llogaria 4342 -Te tjera operacione me shtetin debitor (të drejtat e njësisë vendore), Llogaria 486 për Shpenzime te periudhave te ardhshme, të cilat janë trajtuar gjerësisht në aneksin nr.3/6, bashkëngjitur raportit të auditimit, për shkak se nuk përmbajnë Anom. të rëndësishme. Në llogarinë 468 janë pasqyruar debitorët e taksave dhe tarifave vendore, sipas listës përkatëse të këtij sektori, ndërsa llogaria 486 për Shpenzime te periudhave te ardhshme pasqyrat financiare të vitit 2019 dhe 2020 ka vlerën 0 lekë. Kjo vlerë nuk përfaqëson në fakt vlerën e detyrimeve të prapambetura ndaj të tretëve, të cilat janë të pa financuara nga njësia vendore për shkak të mungesës së fondeve (vlerë e cila është pasqyruar në llogarinë 401-408 dhe llogarinë 467).

8. Titulli i gjetjes: Anom. në aktivet afatgjata jo materiale dhe jo materiale. Pasqyrat financiare nuk pasqyrojnë vlerën e saktë për disa nga këto llogari. Mos kryerja e inventarizimit të këtyre aktiveve.

Situata: Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”, në pasqyrat financiare të vitit 2019 ka vlerën 2,000,512 lekë, ndërsa në pasqyrat financiare të vitit 2018 ka vlerën 3,253,555 lekë. Përbërja e kësaj llogarie, vlera e kostos historike, amortizimi, shtesat, paksimet dhe vlera neto e llogarisë 202, pasqyrohen në aneksin nr. 3/6, bashkëngjitur raportit të auditimit. Në pasqyrat financiare të vitit 2019 në këtë llogari janë pasqyruar edhe tre projekte, investimet e të cilave kanë përfunduar dhe vlera e tyre prej 1,380,206 lekë duhet të ishte bashkuar me vlerën e investimit, si vijon:

-Projekti i qendrës Lekbibaj me vlerën neto 300,169 lekë, realizuar në vitin 2014;

-Projekti kolaudim objektesh në ish- Komunën Lekbibaj për vlerën neto 144,037 lekë, realizuar në vitin 2015;

-Projekti shtesë ujësjellësi Valbonë Bashkia Tropojë për vlerën neto 936,000 lekë, realizuar në vitin 2016;

Referuar të dhënave të mësipërme, për tre projekte në vlerën 1,380,206 lekë, kontabilizimi i tyre në llog.202 për Studime dhe kërkime, është i gabuar, pasi vlera e këtyre projekteve duhet të paraqitet në zërat e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara (sipas objekteve), pasi përfaqëson vlerën e projekteve, investimet e të cilave kanë përfunduar dhe duhet të kapitalizohet në vlerën e objektit.

-Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”, në pasqyrat financiare të vitit 2020 ka vlerën 11,472,824 lekë, me një rritje nga viti 2019 në vlerën 9,472,311 lekë dhe rakordon me vlerën e paraqitur në pasqyrën F-7, për Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto).

Në tre raste është llogaritur amortizim mbi vlerën fillestare edhe pasi aktivi nga ana kontabël është amortizuar tërësisht, veprim i gabuar i drejtorisë ekonomike, pasi ka zvogëluar vlerën neto të kësaj llogarie prej 250,794 lekë në mënyrë të pa drejtë. Vlera e llogarisë 202 për vitin 2020 në pasqyrën e pozicionit financiar dhe pasqyrën F-7 -Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto) duhet të ishte në vlerën 11,723,618 lekë, e përbërë vetëm nga shumë e tre projekteve: 471,520 +150,000+ 11,102,098. Nga ana tjetër duhet të ishin marrë masa për sistemimin e vlerës së projektit me vlerë 150,000 lekë (nga ish komunat). Si konkluzion llogaria 202 në pasqyrat financiare për vitin 2020 paraqet një vlerë prej 250,794 lekë më pak se vlera e projekteve të pa përfunduar (duke përfshire edhe projektin prej 150,000 lekë pa informacion nga njësia vendore).

- Aktive Afatgjata materiale

Për vitin 2019 vlera totale e aktiveve afatgjata materiale në pasqyrën e pozicionit financiar është 2,952,293,724 lekë dhe rakordon me vlerën e pasqyrës F-7 òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto).

Për vitin 2020 vlera totale e aktiveve afatgjata materiale në pasqyrën e pozicionit financiar është 2,991,849,204 lekë dhe rakordon me vlerën e pasqyrës F-7 òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto).

Në Bashkinë Tropojë lidhur me pasurit e transferuar, konstatohet se nuk janë kryer veprime për marrjen në dorëzim dhe pasqyrimin në inventar dhe kontabilitet të tyre, nuk është ngritur grup i posaçëm pune për inventarizimin, vlerësimin e gjendjes aktuale të pronës, nuk është ngritur grup pune për përgatitjen e dokumentacionit teknik të aseteve në pronësi dhe në përdorim, për të realizuar regjistrimin e pronave pranë ASHK Tropojë (ish ZRPP). Nuk janë veçuar me regjistër të veçantë pronat të cilat i kanë kaluar në pronësi Bashkisë dhe ato në përdorim. Për aktivet e qëndrueshme nuk administrohet nga Bashkia Tropojë lista e atyre që janë të rregjistruara në ASHK (pra me certifikatë pronësie) dhe lista e aktiveve të pa rregjistruar. Nuk ka një plan të hartuar nga bashkia për regjistrimin e tyre. Regjistri i aktiveve afatgjata është vetëm në formë elektronike, nuk ka një regjistër të tillë në formë shkresore.

Përbërja e llogarisë ò**Aktive Afatgjata materiale**” është si vijon:

Viti 2019 dhe 2020. -Llog. 210 “Toka, troje, terrene”, ka vlerën 22,460,270 lekë, pa ndryshime nga viti i mëparshëm 2018 dhe përbëhet nga dy pasuri:

Tab.33

Nr.	Emertimi	Llog.ekonomike	Vlera
1	Truall i Shkolla e re_9-vjecare "A.Podrimja"		17855270
2	Varrezat e qytetit Muri rrethues		4605000
Totali			22,460,270

Burimi: Drejtoria Ekonomike Bashkia Tropojë

Në këtë llogari nuk janë përfshirë tokat, trojet dhe terrenet që njësia vendore ka në fakt si pasuri të saj, të cilat janë transferuar me VKM të posaçme në këtë njësi vendore dhe në ish komunat që tashmë janë pjesë e bashkisë Tropojë.

Njësia vendore nuk ka hartuar regjistër të aktiveve për llogarinë 210 - Toka, troje, terrene, ku miniM.sht duhet të identifikonte sipërfaqen e pasurisë, vendndodhjen, statusin e saj (zaptuar ose jo), etj. në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò Kap. III- òRegjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyreò, pika 26, 27 dhe 30.Për sa më sipër kjo llogari nuk pasqyron vlerën e saktë të pasurisë së njësisë vendore. Nuk kanë filluar procedurat për përgatitjen e dokumentacionit ligjor për verifikimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme pranë ARSH (ish ZRPP).

Nuk është kryer inventarizimi i llogarisë 210- Toka, troje, terrene sepse në urdhrin e ngritur nga titullari nuk është përcaktuar inventarizimi i kësaj llogarie (janë ngritur disa komisione dhe janë ndarë se çfarë inventarizimi do të kryej njëri apo tjetri).

Nuk ka regjistër të aktiveve në formë shkresore nga Drejtoria e Financës për llogarinë 210 ó Toka, troje terrene (vetëm elektronik).

-Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione” për vitin 2019 dhe vitin 2020 ka vlerën neto 10,017,959 lekë, me zvogëlim prej 200,943 lekë krahasuar me vitin 2018 (në të cilin kjo llogari është 10,218,903 lekë). Vlera 200,994 përbën vlerën e amortizimit. Nuk ka shtesa dhe paksime për këtë llogari

Vlera e kësaj llogarie në pasqyrën e pozicionit financiar rakordon me vlerën në pasqyrën F-7 òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)ò.

Lista analitike e llogarisë 211 -òPyje, kullota, plantacioneò, pasqyrohet në aneksin nr. 3/7, bashkëngjitur raportit të auditimit.

Në këtë llogari nuk janë përfshirë pyjet kullotat dhe plantacionet që njëzia vendore ka në fakt si pasuri të saj, të cilat kanë kaluar në pronësi të njësisë vendore me VKM nr. 433, datë 8.6.2016 òPër transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish- komunave/ bashkiveò.

Sipërfaqet pyjore dhe kullosore, sipas listës së inventarit, që transferohen në pronësi të Bashkisë Tropojë, janë sipas shtojcës 41, bashkë-lidhur këtij vendimi, e cila përmban listën e inventarit që fillon me numrin rendor 1 (një) deri 2 792 (dy mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy).

Nuk është kryer inventarizimi i llogarisë 211-òPyje, kullota, plantacioneò sepse në urdhrin e ngritur nga titullari nuk është përcaktuar inventarizimi i kësaj llogarie (janë ngritur disa komisione dhe janë ndarë se çfarë inventarizimi do të kryej njëri apo tjetri). Nuk ka regjistër të aktiveve në formë shkresore nga Drejtoria e Financës për llogarinë 210 óToka, troje terrene (vetëm elektronik).

-Llog. 212 “Ndërtesa e Konstruksione”(pasqyruar në aneksin nr. 3/8, bashkëngjitur raportit të auditimit), për vitin 2019 ka vlerën 1,121,471,338 lekë, me një rritje prej 80,099,962 lekë krahasuar me vitin 2018 (vlera 1,041,371,376 lekë).

Për vlerën e shtuar gjatë vitit 2019 prej 80,099,962 lekë vlerë neto dhe vlerën 93,398,037 lekë kosto historike u paraqit lista analitike në formë elektronike.

U paraqit në mënyrë elektronike lista e 146 aktiveve të llogarisë 212, në vlerën neto 1,121,471,338 lekë, e cila përputhet me vlerën e pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar. Vlera në bilanc përputhet me vlerën në pasqyrën òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)ò.

-Llog. 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, (pasqyruar në aneksin nr. 3/8, bashkëngjitur raportit të auditimit), për vitin 2020 në pasqyrat financiare ka vlerën neto 1,168,261,128 lekë, me një rritje prej 46,789,790 lekë vlerë neto krahasuar me vitin 2019, ose rritje prej 60,087,865 lekë vlerë bruto. Sipas pasqyrës F-7 Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, e cila përshkruan se kjo rritje është rezultat i blerjeve me pagesë.

Nga auditimi i analizës së llogarisë 212, të dhëna elektronikisht nga përgjegjësi i financës z. P. M. konstatohet se kjo llogari përbëhet nga 146 aktive në vlerën neto 1,108,173,263, vlerë e cila nuk përputhet me vlerën e pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar. Vlera bruto e tyre është 1,329,807,522 lekë, e cila përfaqëson vetëm vlerën bruto të trashëguar nga pasqyrat financiare të vitit 2019, pra nuk janë reflektuar shtesat gjatë vitit 2020.

Vlera e paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar rakordon me vlerën e në pasqyrën F-7 - Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)ò.

Nuk është inventarizuar kjo llogari si në vitin 2019 dhe në vitin 2020, për arsye se komisioni i inventarizimit nuk është paisur me fletët kontabël të inventarizimit nga drejtori i financës z. B. T..

Për llogarinë 210, 211 dhe 212, nga Bashkia Tropojë lidhur me pasuritë e transferuara, konstatohet se nuk janë kryer veprime për marrjen në dorëzim dhe pasqyrimin në inventar dhe kontabilitet, nuk është ngritur grup i posaçëm pune për vlerësimin e gjendjes aktuale të pronës, nuk kanë filluar procedurat për përgatitjen e dokumentacionit për regjistrimin e pronave të paluajtshme publike në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

-Llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, për vitin 2019 ka vlerën neto 1,705,703,182 lekë, ndërsa në vitin 2018 ka vlerën 1,686,317,255 lekë. Në vitin 2019 kjo llogari është shtuar me vlerën neto 19,385,927 lekë (vlerën bruto 38,198,140 lekë).

Për llogarinë 213 nuk ka pasqyrë shoqëruese bashkëngjitur bilancit, si për vlerën e sajë totale edhe për shtesat gjatë vitit 2019. U paraqit analiza e kësaj llogarie në format elektronik, nga e cila konstatohet se kjo llogari përbëhet nga 147 aktive në vlerën neto 1,705,703,182 lekë (në datën 31.12.2019). Vlera në pasqyrën ÷Pozicionit financiarë, përputhet me vlerën në pasqyrën ÷Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)÷, pasqyruar aneksin nr. 3/9, bashkëngjitur raportit të auditimit.

-Llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, për vitin 2020 ka vlerën neto 1,706,372,666 lekë, me një rritje nga viti 2019 në vlerën neto 669,484 lekë.

Vlera në pasqyrën ÷Pozicionit financiarë, përputhet me vlerën në pasqyrën ÷Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)÷, pasqyruar aneksin nr. 3/9, bashkëngjitur raportit të auditimit.

Nuk u argumentua me listë analitike ndryshimi i kësaj llogarie nga Drejtori Ekonomik z. B. T. dhe Përgjegjësi i Financës z. P. M..

Nuk është inventarizuar kjo llogari si në vitin 2019 dhe në vitin 2020, për arsye se komisioni i inventarizimit nuk është paisur me fletët kontabël të inventarizimit nga drejtori i financës z. B. T..

Llog. 214 -Instalime teknike, makineri e pajisje, për vitin 2019 ka vlerën neto 14,307,211 lekë, ndërsa për vitin 2018 kjo llogari ka vlerën neto 15,512,964 lekë, sipas aneksit nr. 3/10 bashkëngjitur raportit të auditimit.

Nuk rezultojnë shtesa dhe paksime gjatë vitit 2019. Ndryshimet midis dy viteve vijnë si rezultat i amortizimit.

U paraqit analiza e kësaj llogarie në format elektronik, nga auditimi i së cilës konstatohet se kjo llogari përbëhet nga 58 artikuj në vlerën 14,307,211 lekë. Vlera e listës analitike, rakordon me vlerën e pasqyrës ÷Pozicioni financiarë dhe kjo e fundit rakordon me vlerën e pasqyrës ÷Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)÷.

Llog. 214 -Instalime teknike, makineri e pajisje, për vitin 2020 ka vlerën neto 13,665,972 lekë, me një zvogëlim nga viti 2019 në vlerën neto 641,239 lekë. Gjatë vitit 2020 kjo llogari është shtuar me vlerën bruto 500,000 lekë dhurim nga shoqëria ÷ L. C.÷ shpk, të një ÷ Kripore÷, në datën 20.08.2020, për të cilën u paraqit procesverbali i marrjes në dorëzim. Vlera totale bruto 21,066,098 lekë, amortizimi i akumuluar 7,400,126 lekë, vlera neto më 31.12.2020 është 13,665,972 lekë. Vlera e kësaj llogarie në pasqyrës së pozicionit financiar, rakordon me vlerën e pasqyrës ÷Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto), pasqyruar në aneksin nr. 3/10 bashkëngjitur raportit të auditimit.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ish kryetari i bashkisë z. B. D., kryetari aktual i bashkisë z. R. B., z. R. I. me detyrë ish drejtor ekonomik (jo për anomalitë që ka në hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2019, pasi këto pasqyra nuk janë mbyllur prej z. R. I.), në cilësinë e ish nëpunësit zbatues z. B. T. me detyrë drejtor ekonomik, në cilësinë e nëpunësit zbatues.

Kriteri: Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme nga Titullari dhe struktura e Drejtorisë Ekonomike, të cilat kanë sjellë mangësitë e konstatuara në llogaritë e AQT-ve, janë në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018 ÷Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare÷, neni 3 -

Përkufizime, pika 1,2, neni 7 - Dokumenti kontabël, neni 15-Inventari i aktiveve dhe detyrimeve, ku thuhet:

Neni 3, pika 1 dhe 2: "Mbajtje e kontabilitetit" është regjistrimi kronologjik në ditar dhe në llogari i të gjitha veprimeve dhe fakteve ekonomike që i përkasin një njësie ekonomike. 2. "Sistem kontabël" është sistemi që përdoret për përcaktimin, marrjen në llogari, matjen, klasifikimin dhe paraqitjen e të dhënave financiare të veprimtarisë së një njësie ekonomike.

Neni 7 - Dokumenti kontabël: Regjistrimet kontabël justifikohen me dokumentet kontabël, në formë dokumentare ose informatike, që sigurojnë besueshmërinë e tyre. Dokumenti kontabël mbahet si provë dokumentare gjatë gjithë periudhës kohore të përcaktuar në nenin 8 të këtij ligji. 2. Për çdo regjistrim kontabël duhet të shkruhet origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ose e ngjarjes ekonomike.

neni 15-Inventari i aktiveve dhe detyrimeve: 1. Njësitë ekonomike, subjekt i këtij ligji, duhet të kontrollojnë, të paktën një herë gjatë periudhës raportuese, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumenteve kontabël përkatëse në përputhje me rregulloren e inventarizimit të hartuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit. 2. Organi i drejtimit të njësisë ekonomike mban përgjegjësi për procedurat e ndjekura për inventarizimin e aktiveve dhe detyrimeve, me qëllim paraqitjen me vërtetësi dhe besueshmëri të elementeve të aktivitetit dhe detyrimeve në pasqyrat financiare

Gjithashtu veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò i ndryshuar, pika 74, ku thuhet:

Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.

Mos fillimi i procedurat për përgatitjen e dokumentacionit ligjor për verifikimin dhe regjistrimin e të gjitha pronave të paluajtshme pranë ARSH (ish ZRPP) dhe mungesa e certifikatës së pronësisë është në kundërshtim mekërkesat e ligjit nr. 139/2015 òPër Vetëqeverisjen Vendoreò i ndryshuar, Kap. III, neni 9, pika 1.2 dhe Kap. VII, neni 23, pika 14, ku respektivisht thuhet:

Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë: a) njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë. Ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të tyre, si dhe ushtrojnë të drejta të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;

Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për: ...14. Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Ndikimi/Efekti: Pasqyrat financiare për llogarinë 210, 211, 212 dhe 213, nuk japin siguri për vlerën që pasqyrohet në to, pasi nuk është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve për këto llogari, si dhe nuk janë pjesë e pasqyrave financiare të gjitha asetet që kanë kaluar në Bashkinë Tropojë me VKM të posaçme.

Shkaku: Mos kryerja e procesit të inventarizimit për llogaritë e mësipërme dhe mos hartimi i regjistrimit të aktiveve për të gjitha pasuritë që ka ligjërisht Bashkia Tropojë.

Rëndësia:E lartë

9. Titulli i gjetjes: Për të dy vitet 2019 dhe 2020, për llogarinë 215 -Mjete transportua se në pasqyrat financiare pasqyrohet një vlerë 3,452,393 lekë më tepër se vlera që paraqet

analiza e kësaj llogarie.Gjithashtu tetë mjete me vlerë të kostos historike 6,791,000 lekë dhe vlerë të mbetur zero lekë (të amortizuara), të cilat janë vlerësuar me komision për dalje jashtë përdorimit, janë pa përgjegjës material, jashtë ruajtjes.

Në llogarinë 24 -Aktive afatgjata të dëmtuara, vlera neto në pasqyrat financiare të vitit 2019 dhe 2020 është 3,013,808 lekë më e madhe se vlera neto që pasqyron analiza e kësaj llogarie.

Situata: Llog. 215 –Mjete Transporti në pasqyrat financiare të vitit 2019 ka vlerën neto 21,334,976 lekë ndërsa për vitin 2018 vlerën neto 20,858,284 lekë. Vlera e pasqyruar në aktivin pasqyrës së pozicionit financiar (F1) prej 21,334,976 lekë, përputhet me vlerën e pasqyrës të Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (F7) në pasqyrat financiare të vitit 2019. Amortizimi i akumuluar ka vlerën 38,066,892 lekë.

U paraqit lista analitike e kësaj llogarie, si dhe rezultatet e komisionit të inventarizimit, vlerat e të cilave në datën 31.12.2019 është 55,049,475 lekë (kosto historike) dhe përbëhet nga 32 mjete, nga të cilat 9 mjete vlerën e mbetur të tyre e kanë zero leke, ndërsa 23 mjete transporti kanë vlerën e mbetur 21,334,976 lekë.

Për tetë nga këto mjete, të cilat kanë vlerë të mbetur zero lekë (janë amortizuar) dhe kosto historike 6,791,000 lekë, sipas listës në vijim, në analizën e llogarisë që administrohet nga drejtori i financës është bërë shënimi jashtë përdorimit, por procesi i nxjerrjes jashtë përdorimit nuk është realizuar. Duke parë historikun e këtyre mjeteve, u konstatua se me vendimin nr. 154, datë 23.10.2018 ò Për miratimin e raport vlerësimit të aktiveve për nxjerrjen jashtë përdorimit të automjeteve të bashkisë Tropojë për vitin 2017ò, këshilli bashkiak ka miratuar nxjerrjen jashtë përdorimit të automjeteve sipas pasqyrës përmbledhëse të njësive administrative, ku janë të listuar 8 mjetet e mësipërme.

Gjithashtu u konstatua se me urdhrin nr. 89, datë 20.06.2018 të ish kryetarit të bashkisë z. B. D. me lëndë ò Për bërjen hyrje të automjeteve që janë propozuar për jashtë përdorimit, është urdhëruar që òAutomjetet të cilat janë propozuar për jashtë përdorimit nga komisioni i inventarizimit për dalje jashtë përdorimit, të bëhen hyrje në magazinë sipas listës së mëposhtme...ò. Në listën në vijim të këtij urdhri janë 11 mjete në vlerën e kostos historike 10,971,600 lekë. Nga auditimi i gjendjes së magazinës u konstatua se në 31.12.2020, në gjendjen kontabël të magazinës është edhe lista e 7 mjeteve të transportit të llogarisë 215, në vlerën 10,659,210 lekë. Duke krahasuar listën e mjeteve sipas urdhrin nr. 89, datë 20.06.2018, me listën e mjeteve gjendje në magazinë, konstatohet se vetëm 3 nga 11 mjetet që janë pjesë e urdhrin të mësipërm, janë magazinuar, pra janë shtuar në inventarin e magazinës, ndërsa 8 mjete të tjera në vlerën 6,791,000 lekë, nuk janë bërë hyrje në magazinë. Praktikisht këto mjete janë pa përgjegjës material, që megjithëse të dëmtuara, bëhen pre e vjedhjeve pjesore apo tërësore.

Gjatë vitit 2019 llogaria 215 ka shtesë në vlerën bruto prej 900,000 lekë si rezultat i dorëzimit të një mjeti nga ish kryetari i komunës Lekbibaj, nga z. P. N.. Dokumentacioni vërtetues: Fletëhyrja nr. 2, datë 30.04.2019, me përshkrimin òAutoveturë Suzukiò, copë 1, vlera 900,000 lekë. Marrës në dorëzim magazinieri A. G.. Mjeti është vlerësuar nga komisioni i ngritur për këtë qëllim, përpara hyrjes në magazinë. Nga auditimi i procesit të inventarizimit në vitin 2019, u konstatua se mjeti është gjendje në ngarkim të magazinierit znj. V. D..

Krahasimi i të dhënave të bilancit me të dhënat e listës analitike për llogarinë 215 òMjete transporti në formë tabele jepet në aneksin nr. 3/11, bashkangjitur raportit të auditimit.

Nga krahasimi i të dhënave të pasqyruara në aktivin e pasqyrës së pozicionit financiar për llogarinë 215 òMjete transporti, me të dhënat që jep për këtë llogari analiza e saj (lista analitike që administrohet nga Drejtoria Ekonomike, konstatohet se ka diferencë midis tyre në vlerën 3,452,393 lekë, e cila është më tepër në pasqyrën e pozicionit financiar (bilanc),

krahasuar me listën analitike të paraqitur nga drejtoria ekonomike. Sipas shënimeve shpjeguese të bëra në bilancin e vitit 2019 kjo diferencë i përket ish komunës Lekbibaj, për shkak të diferencave midis gjendjes kontabël dhe gjendjes fizike. Përveç këtij shpjegimi, nga Drejtoria Ekonomike nuk administrohet dokumentacion për të shpjeguar konkretisht përse vjen kjo diferencë e mbartur nga komuna Lekbibaj.

Llog. 215 –Mjete Transporti në pasqyrat financiare të vitit 2020 ka vlerën neto 17,617,689 lekë, me një zvogëlim në vlerë neto krahasuar me vitin 2019, prej 3,717,287 lekë, e cila vjen për shkak të vlerës së amortizimit, paraqitur në formë tabele në aneksin nr. 3/11, bashkangjitur raportit të auditimit.

Vlera e pasqyruar në aktivin pasqyrës së pozicionit financiar (F1), përputhet me vlerën e pasqyrës òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjataö (F7) në pasqyrat financiare të vitit 2020.

Rezultatet e komisionit të inventarizimit japin vlerën bruto 55,949,475 lekë, e njëjta me listën e vitit 2019.

Në pasqyrat financiare të vitit 2020, për llogarinë 215 óMjete transporti, është bërë shënimi: *“Gjendja kontabël është 59,401,868 lekë, ndërsa gjendja sipas regjistrit 55,949,475 lekë. Diferenca në mungesë 3,452,393 lekë i përket ish komunës Lekbibaj”*.

Krahasimi i të dhënave të bilancit me të dhënat e listës analitike për llogarinë 215 óMjete transporti në formë tabele për vitin 2020, jepet në aneksin nr. 3/11, bashkangjitur raportit të auditimit.

Nga krahasimi i të dhënave të pasqyruara në aktivin e pasqyrës së pozicionit financiar për llogarinë 215 óMjete transporti, me të dhënat që jep për këtë llogari analiza e saj (lista analitike që administrohet nga Drejtoria Ekonomike, konstatohet se ka diferencë midis tyre në vlerën 3,452,393 lekë, e cila është më tepër në pasqyrën e pozicionit financiar (bilanc), krahasuar me listën analitike të paraqitur nga drejtoria ekonomike dhe rezultatet e komisionit të inventarizimit, pra e njëjta situatë me atë të vitit 2019, sqaruar më lartë.

Lista analitike e llogarisë 215 óMjete transporti, lista e mjeteve të transportit gjendje në magazinë më 31.12.2020, si dhe lista e 8 mjeteve të transportit, të propozuara për jashtë përdorimit dhe të pa bëra hyrje në magazinë, pasqyrohet në aneksin nr. nr. 3/12, bashkangjitur raportit të auditimit.

Llogaria 24 -Aktive afatgjata te dëmtuara për vitin 2019 dhe 2020 ka vlerën 11,771,382 lekë, vlerë e njëjta me vitin 2018 dhe përfaqëson mjete transporti të dëmtuara në vite. Për këto mjete drejtoria e financës paraqiti listën analitike të këtyre mjeteve, e cila tregon llojin e aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën historike, vlerën e mbetur, sipas aneksit nr. 3/13, bashkangjitur raportit të auditimit.

Vlera neto në pasqyrat financiare të vitit 2019 dhe 2020 është 3,013,808 lekë më e madhe se vlera neto që pasqyron analiza e kësaj llogarie.

Në pasqyrat financiare të vitit 2020, për llogarinë 24 është bërë shënimi në vijim:

Llogaria 24 –Aktive të qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara, ka një diferencë në mungesë për shumën 3,013,808 lekë. Gjendja kontabël është 25,023,037 lekë, sipas rregjistrit 22,009,229 lekë. Diferenca i përket ish komunës Lekbibaj. Bashkia Tropojë nuk administron dokumentacion shpjegues për diferencën e mësipërme.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ish kryetari i bashkisë z. B. D., pasi ka nxjerrë urdhrin për bërjen hyrje të mjeteve, por nuk ka monitoruar zbatimin e tij, kryetari aktual i bashkisë z. R. B., z. R. I. me detyrë ish drejtor ekonomik, në cilësinë e ish nëpunësit zbatues z. B. T. me detyrë drejtor ekonomik, në cilësinë e nëpunësit zbatues, z. P. M. me detyrë përgjegjës i financës, hartues i pasqyrave financiare për vitin 2020

Kriteri: Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018 për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, neni 3 -Përkufizime, pika 1,2, neni 7 - Dokumenti kontabël, neni 11 óQëllimi i pasqyrave financiare, neni 15-Inventari i aktiveve dhe detyrimeve;UMF nr. 8 datë 9.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme.

Ndikimi/Efekti:deformim i vlerës së aktiveve të llogarisë 215 në pasqyrat financiare, për shkak se kjo vlerë nuk mbështetet në vlerën e inventarizimit t aktiveve.

Shkaku: Mos marrja e masave për përcaktimin e arsyes së anoM.ve të pasqyrave financiare të ish komunës Lekbibaj për llogarinë 215, si dhe për sistemimin e vlerës së vetë pasqyrave financiare të bashkisë mbi bazën e vlerës së inventarizimit.

Rëndësia:E lartë.

Titulli i gjetjes: Pasqyrat financiare të vitit 2020, nuk pasqyrojnë vlerën e saktë të llogarisë 218 - Inventar ekonomik. Kjo llogari në pasqyrta financiare ka vlerën bruto 74,744,833 lekë, ndërsa rezultatet e inventarizimit jënë në vlerën bruto 74,684,359 lekë, pra pasqyrat kanë një vlerë bruto 60,474 lekë më shumë se vlera e aktiveve të konstatuara gjatë procesit të inventarizimit.Mos plotësimi me të gjithë elementët e duhur të listës analitike të llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”.

Situata: Llog. 218 –Inventar ekonomik për vitin 2019 në pasqyrat financiare ka vlerën neto 45,227,407 lekë, ndërsa për vitin 2018 kjo llogari ka vlerën neto 57,251,639 lekë.

Rezultatet e inventarizimit për llogarinë 218 -Inventar ekonomik, për vitin 2019:

Komision i vlerësimit të aktiveve në procesin e inventarizimit të aktiveve për vitin ushtrimor 2019, ka vlerësuar për dalje jashtë përdorimit 679 artikuj të llogarisë 218, në vlerën bruto 18,459,751 lekë dhe vlerën e mbetur 9,386,129 lekë (trajtuar gjerësisht në procesin e inventarizimit vjetor të aktiveve). Komisioni i asgjësimit të aktiveve të vlerësuara për dalje jashtë përdorimit, nuk ka kryer asgjësimin e tyre në procesin e inventarizimit të vitit 201, por i ka asgjësuar këto aktive një vit më vonë, pra në procesin e inventarizimit të vitit 2020. Por nga Drejtoria ekonomike veprimet kontabël për heqjen e aktiveve nga kontabiliteti, janë bërë që në pasqyrat financiare të vitit 2019, mbi bazën e procesverbalit të komisionit të vlerësimit të aktiveve. Nga komisioni vlerësimit të aktiveve janë vlerësuar për dalje jashtë përdorimit 679 artikujve të llogarisë 218, në vlerën bruto 18,459,751 lekë dhe vlerën e mbetur 9,386,129 lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit të procesit të inventarizimit të vitit 2019, u konstatua se komisionet e inventarizimit janë shprehur për gjendjen e llogarisë 218 óInventar ekonomik, sipas fletëve të inventarizimit të marra nga drejtoria ekonomike. Pas përfundimit të procesit të inventarizimit, nuk janë konstatuar aktive mangut dhe dokumentet e inventarizimit janë dorëzuar pranë drejtorisë së financës, por nga kjo e fundit nuk është përgatitur përmbledhëset e inventarizimit për këtë llogari. Kjo gjë u bë gjatë procesit të auditimit, nga drejtori i financës z. B. T. dhe përgjegjësi i buxhetit dhe financës z. P. M., me kërkesën e grupit të auditimit dhe, sipas përmbledhëses së dhënë prej tyre, rezulton se në përfundim të procesit të inventarizimit, vlera bruto totale e llogarisë 218 óInventar ekonomik, në datën 31.12.2019, është 93,091,883 lekë, si vijon:

Tab.34

Llogaria 218 në 31.12.2019		
Nr	Njësia administrative	Vlera bruto në lekë
	Qendra	14,159,757
	Qendra I	48,105,981
	Njesitë Administrative (7 Njësitë)	30,826,145
	Shuma sipas inventarizimit	93,091,883

Burimi Drejtoria Ekonomike Bashkia Tropojë

Bazuar ne rezultatet e inventarizimit vjetor, vlera e kostos historike e llogarisë 218óInventar ekonomik në 31.12.2019, në pasqyrat financiare duhet të ishte:

Kosto historike në 31.12.2019 në vlerën 93,091,883 lekë, zbriten në vlerën e kostos historike 18,459,751 lekë aktive të vlerësuara për dalje jashtë përdorimit, por të hequra nga kontabiliteti edhe pse asgjësimi i tyre është bërë vitin e ardhshëm (93,091,883 - 18,459,751 = 74,810,759)

Pra rezultati në **kosto historike** në pasqyrat financiare, në datën 31.12.2019 sipas inventarizimit duhet të jetë 74,632,132 lekë.

Sipas gjendjes kontabël:

Vlera e llog.218 në pasqyrën e òPozicionit financiarò përputhet me vlerën e kësaj llogarie në pasqyrën òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)ö.

Sipas pasqyrës F-7, òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)ö, kjo llogari gjatë vitit 2019 është shtuar me vlerën e kostos historike 2,519,812 lekë të cilat përfaqësojnë vlerën 900,000 lekë blerje me pagesë dhe 1,619,812 lekë, shtesa pa pagesë brenda sistemit.

Gjithashtu gjatë vitit 2019 në pasqyrat financiare (F-7), llogaria 218 është pakësuar me vlerën e kostos historike 18,458,951 lekë si rezultat i veprimeve të gabuara të drejtorisë së financës, pasi këto veprime janë bërë mbi bazën e komisionit të vlerësimit të aktiveve për nxjerrje jashtë përdorimit (nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve realisht është bërë në vitin 2021). Amortizimi i aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit, në listën e aktiveve të hartuar për këtë qëllim, ka vlerën e 9,073,621 lekë, ndërsa në tabelën F-7 òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)ö, kjo vlerë është 7,654,526 lekë.

Në pasqyrat financiare të vitit 2019, tabela F-7, vlera e kostos historike është 74,810,759 lekë, me diferencë nga rezultati inventarizimit prej 178,627 lekë më shumë në pasqyrat financiare, sipas aneksit nr. 3/14, bashkangjitur raportit të auditimit.

Konstatohet se nga aktivet e dala jashtë përdorimit kanë një vlerë amortizimi prej 9,072,627 lekë (sipas listës së vlerësimit dhe asgjësimit), por vlera totale e amortizimit të pasqyra F-7 është pakësuar me vlerën 7,654,526 lekë, pra 1,418,101 lekë më pak.

Llog. 218 –Inventar ekonomik për vitin 2020 ka vlerën bruto 74,810,759 lekë, vlerën neto 41,682,138 lekë, më zvogëlim nga viti i mëparshëm 2019 në vlerën neto 3,545,269 lekë.

Sipas gjendjes kontabël:

Vlera e llog.218 në pasqyrën e òPozicionit financiarò përputhet me vlerën e kësaj llogarie në pasqyrën òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)ö.

Sipas pasqyrës F-7, òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)ö, kjo llogari gjatë vitit 2020 është shtuar me vlerën e kostos historike 1,678,670 lekë të cilat përfaqësojnë shtesa pa pagesë brenda sistemit. Gjithashtu është zvogëluar në vlerën e kostos historike për vlerën 1,744,596 lekë, për arsye të daljeve jashtë përdorimit, si dhe amortizimit të akumuluar prej 33,062,695 lekë. Nuk është zbritur nga amortizimi total vlera e amortizimit të aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit (Në tabelën F-7 të pasqyrave financiare, paksimet e amortizimit gjatë vitit ka vlerën zero lekë), sipas aneksit nr. 3/14, bashkangjitur raportit të auditimit.

Sipas gjendjes fizike (inventarizimit)

Nga auditimi i përmbledhëses së procesit të inventarizimit për llogarinë 218, të hartuar nga drejtori i financës z. B. T. dhe përgjegjësi i buxhetit dhe financës z. P. M., rezulton se në përfundim të procesit të inventarizimit, vlera bruto totale e llogarisë 218 óInventar ekonomik, në datën 31.12.2020 është **76,428,955 lek lekë**, si vijon:

Tab.35

Llogaria 218 në 31.12.2020, sipas procesit të inventarizimit		
Nr	Njësia administrative	Vlera bruto në lekë

	Qendra	38,761,580
	Qendra 1	12,505,497
	Njësitë Administrative (7 Njësitë)	25,161,878
	Shuma sipas inventarizimit	76,428,955

Burimi Drejtoria Ekonomike Bashkia Tropojë

Kanë dalë jashtë përdorimit 150 aktive të llogarisë 218 me vlerë bruto 1,744,596 lekë.

Konkluzion: vlera bruto e llogarisë 218 në pasqyrat financiare të vitit 2020 duhet të jetë 74,684,359 lekë, por në fakt është 74,744,833 lekë, me një diferencë prej 60,474 lekë më shumë në pasqyrat financiare.

Kriteri: Për sa më sipër është në kundërshtim me udhëzimin MF nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, pika 95 e rubrikës "Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi", pika 102 e rubrikës "Lista e aktiveve të identifikuar për vlerësim", pika 103 e rubrikës "Kriteret për vlerësimin e Aktiveve", pika 104 dhe 105 të rubrikës "Proces verbali i vlerësimit", pika 106 të rubrikës "Relacioni i vlerësimit", me ligjin nr. 25/2018 për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, neni 3; pika 1,2, neni 7, 11, 15.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi z. R. I. me detyrë ish drejtor ekonomik, në cilësinë e ish nëpunësit zbatues z. B. T. me detyrë drejtor ekonomik, në cilësinë e nëpunësit zbatues, z. P. M. me detyrë përgjegjës i financës, hartues i pasqyrave financiare për vitin 2020.

Ndikimi/Efekti: deformim i vlerës së llogarisë së llogarisë 218 në pasqyrat financiare.

Shkaku: Mos zbatimi i kërkesave ligjore në hartimin e pasqyrave financiare, pasi për llogaritë inventariale pasqyrat duhet të kenë të njëjtën vlerë me rezultatet e inventarizimit.

Rëndësia: E lartë.

Investimet

Llogaria 230 "Aktive afatgjata jo materiale", në pasqyrat financiare të vitit 2019 dhe 2020 ka vlerën 0 lekë.

Të dhëna për llogarinë 231, e cila në vitin 2020, pasqyrojnë vetëm investimet në proces, jepen në aneksin nr. nr. 3/15, bashkë me raportin e auditimit.

Pasivet (Detyrimet)

Titulli i gjetjes: Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" për vitin 2019 dhe 2020 ka analizën e saj të detajuar, por një pjesë e të dhënave nuk është e plotë për një numër të konsiderueshëm subjektsh, si numri i faturës, data e faturës dhe objekti i prokurimit.

Llogaria 466 "Kreditorë për mjetet në ruajtje" nuk jep informacion të plotë, pasi mungon afati i fillimit dhe mbarimit të garancisë së vlerës 5% të punimeve për subjektet private.

-Llog.467 –Kreditor të ndryshëm nuk është e plotësuar me historikun e krijimit të këtyre detyrimeve që njëzia vendore ka ndaj të tretëve. Llog 419 -Kreditorë, parapagime, në pasqyrat financiare 2019 dhe 2020 ka vlerën 193,470 lekë por nuk ka dokumentacion për kohën e lindjes së këtij detyrimi

Situata: Viti 2019. Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" për vitin 2019 ka vlerën 110,112,904 lekë dhe ka analizën e saj të detajuar, por një pjesë e të dhënave nuk është e plotë për një numër të konsiderueshëm subjektsh, si numri i faturës, data e faturës dhe objekti i prokurimit. Konstatohet se mungesa e objektit të prokurimit për shumicën e rasteve lidhet me punën e pakujdesshme të Drejtorisë së Financës, për mos rregjistrimin e të dhënave

të plota në listën e detyrimeve, pasi kjo e dhënë mungon në shumicën e objekteve të prokurimit të zhvilluar në vitin 2018 dhe 2019 (pra nuk lidhet me mungesë të dhënash në vite, të lëna nga ish komunat etj.).

Nga analiza e kësaj llogarie paraqitur nga drejtoria ekonomike kjo llogari përbëhet nga detyrimet e njësisë vendore për 44 subjekte, sipas aneksit nr. 3/16, bashkangjitur raportit të auditimit.

Viti 2020. Llogaria 401-408 òFurnitorë e llogari të lidhura me toò për vitin 2020ka vlerën 108,423,711lekë dhe ka analizën e saj, përsa i përket emrit të furnitorit dhe vlerës, por nuk ka të dhëna të tjera për objektin e prokurimit, numrin e faturës, datën e faturës, elementë të domosdoshëm për regjistrimet në kontabilitet dhe për kryerjen e pagesës ndaj furnitorit, paraqitur aneksin nr. 3/17, bashkangjitur raportit të auditimit.

Viti 2019-Llogaria 466 òKreditorë për mjetet në ruajtjeò në pasqyrat financiare është për vlerën kontabël 32,471,986 lekë dhe është e analizuar sipas objekteve për 83 raste. Analiza e llogarisë rakordon me vlerën në bilanc. Në të dhënat që paraqiten në listën analitike nuk ka informacion se cilat objekte kanë përfunduar afatin e garancisë dhe cilat janë brenda këtij afati dhe për këtë arsye për vitin 2019 grupi i auditimit nuk mund të shprehet për analizën e kësaj llogarie në lidhur me faktin nëse ka ose jo subjekte të cilave duhej tju paguhej nga institucioni vlera e garancisë. Lista analitike e kësaj llogarie është e vulosur nga thesari, por nuk ka një akt rakordimi të mirëfilltë për këtë.

Viti 2020-Llogaria 466 òKreditorë për mjetet në ruajtjeò në pasqyrat financiare 2020 ka vlerën kontabël 28,728,604 lekë dhe është e analizuar sipas objekteve për 81 raste. U paraqit analiza e llogarisë rakordon me vlerën në bilanc. Në të dhënat që paraqiten në listën analitike nuk ka informacion për fillimin dhe mbarimin e afatit të garancisë së vlerës 5% të punimeve. Për këtë arsye ashtu si për vitin 2019, nuk mund të shprehem për numrin e subjekteve të cilave ju është përbushur afati i garancisë dhe për vlerën e cila duhej të xhirohej në llogarinë e subjektit, nëse janë përfunduar detyrimet kontraktuale.

Lista analitike e kësaj llogarie është e vulosur nga thesari, si dhe firmosur nga përgjegjësi i buxhetit dhe financës, por nuk ka një akt rakordimi të mirëfilltë për këtë.

-Llog.467 –Kreditor të ndryshëm në pasqyrat financiare të vitit 2019 dhe 2020 ka vlerën e njëjtë prej 13,038,113 lekë. Kjo llogari ka analizën e saj (listën analitike), e cila nuk është e plotësuar me historikun e krijimit të këtyre detyrimeve që njësia vendore ka ndaj të tretëve. Shpjegohet verbalisht nga Drejtori i Financës se janë detyrime të mbartura në vite, të cilat lidhen me zbatimin e vendimeve gjyqësore për çështje të marrëdhënieve të punës dhe çështje të tjera. Në mënyrë analitike kjo llogari pasqyrohet në aneksin nr. 3/18, bashkangjitur raportit të auditimit.

Llog 419 -Kreditore, parapagime, në pasqyrat financiare 2019 dhe 2020 ka vlerën 193,470 lekë dhe përbëhet nga detyrimi që njësia vendore ka ndaj tre subjekteve person fizik të NJA Margegaj, për të cilat drejtoria ekonomike nuk administron dokumentacion për kohën e lindjes së këtij detyrimi dhe arsyen e detyrimit, por shpjegohet se janë detyrime të trashëguara për të cilat nuk ka dokumentacion.

Tab.36

Njesia Margegaj	U K PF	79,160.00
Njesia Margegaj	Njesia Private "V"	100,000.00
Njesia Margegaj	A P	14,310.00
Shuma		193,470

Burimi: Drejtoria Ekonomike Bashkia Tropojë

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi z. R. I. me detyrë ish drejtor ekonomik, në cilësinë e ish nëpunësit zbatues z. B. T. me detyrë drejtor ekonomik, në cilësinë e nëpunësit zbatues, z. P. M. me detyrë përgjegjës i financës, hartues i pasqyrave financiare për vitin 2020.

Kriteri: Për sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, neni 3; pika 1,2, neni 7, 11, 15, UMF nr. 8 datë 9.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, kushtet e kontratës të lidhur midis palëve, si dhe ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollin, neni 12, pika 3, germë ògj, ku thuhet se nëpunësi zbatues përgjigjet për: *...Garantimin që të gjithë kreditorët të paguhen në kohë dhe në rastet kur kreditorët nuk janë paguar apo në rast ankesash për mos pagesë nga kreditorët, nëpunësi zbatues duhet t'ia shpjegojë rrethanat nëpunësit autorizues*”.

Efekti: Mos administrimi i të dhënave në formë shkresore dhe zyrtare, bënë që Drejtoria Ekonomike të mos i jap informacionin e duhur Titullarit lidhur me detyrimet, radhën, afatin e shlyerjes së tyre. Gjithashtu kjo lë shkak për mundësinë e abuzimeve nga kjo drejtori lidhur me afatet e shlyerjes së detyrimeve, si dhe nuk zbatohen detyrimet kontraktuale në kohë, duke sjellë pasoja të natyrave gjyqësore me efekte financiare në formën e kamatëvonesave, në dëm të buxhetit të bashkisë.

Shkaku: Mos zbatimi i kërkesave ligjore lidhur me administrimin e saktë të informacionit shkresor për kreditorët dhe mos marrja e masave për likuidimin e tyre.

Rëndësia: E lartë.

U audituan llogaritë e pasivit: Llogaria 42 òDetyrime ndaj personelit, Llogarinë 431 òDetyrime ndaj shtetit tatim taksa òLlogaria 435 òDetyrime për sigurime shoqërore, Llogaria 436 òDetyrime për sigurimet shëndetësore, Llogaria 434 òOperacione me shtetin kreditor (Detyrime ndaj shtetit), pasqyra F-3, Cash-Floë, si dhe disa llogari në pasqyrën e performancës financiare, në të cilat nuk ku konstatuan anoM. dhe për këtë arsye janë paraqitur në aneksin nr.3/19 bashkangjitur raportiti të auditimit.

Titulli i gjetjes: AnoM. në llogarinë 475, Te ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse, Llogaria 105 -Teprica e Granteve kapitale te brendshme, llogaria 7206-Financim i pritshëm nga buxheti.

Situata -Llogarinë 475 -Te ardhura për t'u regjistruar në vitet pasardhëse, në pasqyrat e vitit 2019 ka vlerën 18,113,764. Në këtë llogari janë pasqyruar vlerat financiare që trashëgohen për vitin pasardhës, sipas aktit të rakordimit me thesarin. Kjo llogari ka këtë përbërje:

Tab.37

Burimi i financimit	Shuma
Transfertë e pa kushtëzuar	6,916,155
Transfertë specifike	3,498,976
Të ardhura të çelura	5,653,252
Të ardhura të paautorizuara	2,045,381
Shuma	18,113,764

Burimi: Drejtoria Ekonomike Bashkia Tropojë

Për vitin 2020, fondet e trashëguara për vitin 2021 janë paraqitur në llogarinë 520.

Bazuar në udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 të MFE òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, - Llogaria 475, òTë ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse, hyn në grupin e llogarive rregulluese. Në të, sipas rastit të çdo institucioni, evidentohen të ardhurat që janë arkëtuar përpara ngjarjes

ose veprimet që krijon të ardhura. Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me të ardhura të arkëtuara përpara ngjarjes ose veprimet që krijon të ardhura.

- Llogaria 105 -Teprica e Granteve kapitale te brendshme, për vitin 2019 dhe 2020 ka vlerën 67,358,609 lekë, por Drejtoria Ekonomike nuk ka informacion për përbërjen e kësaj llogarie, duke shpjeguar vetëm faktin se është një vlerë të cilën e ka konstatuar në pasqyrat e vitit 2019 dhe e ka mbartur atë edhe në vitin 2020.

Bazuar në UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 të MFE òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, aneksi 1 Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik, pika 1.1.2/a, shpjegohet:

Llogaritë 105 mbeten me tepricë në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet kur këto grante janë burim për investimet në proces të institucioneve (të papërfunduara ose të pamarra në dorëzim). Në aktiv të bilancit këto janë investime në proces në grupin e llogarive 23. Këto mbyllen (kapitalizohen) me fondet bazë në kohën kur investimi është përfunduar dhe marrë në dorëzim.

Por mbështetur në të dhënat e pasqyrës së pozicionit financiarë të vitit 2020, vlera e llogarisë 230 + 231 është 17,138,144 lekë dhe nuk përputhet me vlerën që paraqet e llogarisë 105, e cila mbart një vlerë prej 50,220,465 lekë më shumë.

Në pasqyrën e performancës financiare, llogaria 7206- Financim i pritshëm nga buxheti, për vitin 2020 ka vlerën 18,501,346 lekë dhe rakordon me shumën e llogarive të pasivit: 42 ó Detyrime ndaj personelit, 431 -Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa, 435-Sigurime Shoqërore, 436 -Sigurime Shëndetësorë. Nuk është përfshirë në llogarinë 7206- Financim i pritshëm nga buxheti, vlera prej 108,423,719 lekë, e llogarisë -Furnitorë e llogari të lidhura me to, në kundërshtim me udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 të MFE òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, pika 32 dhe 59 ku thuhet:

32. Të drejtat duhet të evidentohen në kohën e lindjes së tyre, ndërsa si të ardhura të njihen dhe evidentohen në pasqyrat financiare në çastin e arkëtimit të tyre në llogaritë financiare, duke mbajtur nën kontroll evidentimin e të ardhurave me baza rritëse (llogaria 7206, “Financim i pritshëm nga buxheti”), të cilat evidentojnë të drejta të njësisë të qeverisjes së përgjithshme në marrëdhënie me shtetin (llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta).
59. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, në rastet kur është e nevojshme, duhet të regjistrojnë në kontabilitetin e vitit ushtrimor edhe marrëdhëniet e tyre me shtetin, për të drejta të konstatuara sipas rrethanave të ndryshme. a) Në rastin e një të drejte të njësisë ndaj shtetit, regjistrimi në kontabilitet bëhet me artikullin kontabël si më poshtë: - Debitohet llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)”; dhe - Kreditohet llogaria 7206, “Financimi i pritshëm nga buxheti”.

Për vitin 2020, -Llogaria 4342 -Te tjera operacione me shtetin debitor (të drejtat e njësisë vendore), në pasqyrat financiare të vitit 2020, ka vlerën 140,157,008 lekë.

Kriteri: UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 të MFE òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò,

Efkti: Të dhëna jo të sakta në pasqyrat financiare.

Shkaku: Mos zbatimi i kërkesave të UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 të MFE òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, gjatë hartimit të pasqyrave financiare.

Titulli i gjetjes: Mangësi në plotësimin si duhet të dokumentacionit për zërin udhëtim e dieta dhe pagesat për fatkeqësitë natyrore. Mos shlyerja e detyrimeve për dy punonjës për zërin udhëtim e dieta, duke mos patur mangësi në dokumentacionin.

Situata: Pagesat për zërin udhëtim e dieta

Për vitin 2019. Bazuar në të dhënat e ditarit elektronik të bankës, të hartuar nga drejtoria ekonomike, konstatohet se gjatë vitit 2019 Bashkia Tropojë ka shpenzuar për zërin udhëtim e dieta vlerën 2,296,066 lekë, ndërsa për vitin 2020 ka shpenzuar vlerën 1,410,905 lekë, sipas tabelave në vijim. Dokumentacioni justifikues mbahet më vete nga urdhër shpenzimi, për shkak se në një urdhër shpenzim janë disa punonjës dhe volum dokumentacioni. Nëse këto shpenzime janë kryer me objekt të përcaktuar nga titullari dhe nëse kanë dokumentacionin e plotë justifikues, u audituan me zgjedhje muaji janar, mars, prill, korrik 2019 dhe muaji prill, maj qershor për vitin 2020 (sipas kalimeve në bankë, por që përmbajnë urdhër shërbime të muajve të mëparshëm). Nga auditimi rezultoi se:

Shpenzimet e fjetjes janë të justifikuara me dokumentit tatimor përkatës të paraqitur nga hoteli (fatura tatimore) e shoqëruar me faturën e printuar nga kasa elektronike fiskale.

Dërgimi me shërbim i punonjësit është i autorizohet nga Kryetari i Bashkisë. Në autorizim është përcaktuar koha e zgjatjes së shërbimit dhe qëllimi i tij. Qëllimi i dërgimit me shërbim lidhet me arsye të ndryshme si konferenca kombëtare "Shqipëria decentralizim në zhvillim", pjesëmarrje në Forumin e Bashkërendimit të Planifikimit Vendor, Trajnim i organizuar nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, në bashkëpunim me ASPA-në, trajnime mbi Kadastrën, trajnim mbi përdorimi n e sistemit RKA, pjesëmarrje në ankand të organizuar nga MFE, ftesë për takim konsultativ me njësitë e vetëqeverisjes vendore etj. Bashkangjitur dokumentacionit ndodhet ftesa e organizatorëve të këtyre takimeve (me e-mail). Nga auditimi u konstatua se në disa raste ftesa për pjesëmarrje mungon, apo nuk është qartësuar objekti i shërbimit të punonjësit. Nga auditimi me zgjedhje raste të tilla janë si vijon:

-Autorizim për pjesëmarrje në konferencën kombëtare "Shqipëria decentralizim në zhvillim", pjesëmarrje në Forumin e Bashkërendimit të Planifikimit Vendor dhe pjesëmarrje në Forumin e Bashkërendimit të Planifikimit Vendor, ku ka marrë pjesë N/Kryetari i Bashkisë z. A. M. (dy ditë, vlera 11,000 lekë).

- Autorizim për pjesëmarrje në konferencë të organizuar nga MFE për pjesëmarrje në ankand të z. K. R., në datat 29.09-01.10.2019, vlera 18,500 lekë.

- Autorizim për z. I. B., për punë me administratën, katër ditë, prej 24.02.2020 ó 28.02.2020, pa përcaktuar qartë objektin e shërbimit, vlera 24,000 lekë.

- Autorizim për z. F. M., me detyrë sekretar i kryetarit, për shërbim ndaj Bashkisë Tropojë prej 30.09-01.10.2019, vlera 5,500 lekë, datat 11-12.02.2020, vlera 5,500 lekë, datat 21-22.02.2020, vlera 5,500 lekë. Në këto autorizime nuk është qartësuar se çfarë shërbimi do të kryej punonjësi, por është argumentuar se do të shoqëroj kryetarin e bashkisë.

Përveç mangësive të natyrës së mësipërme, duke marrë parasysh buxhetin e vogël të Bashkisë Tropojë, si dhe nevojat që ka lidhur me prioritetet e saj, si dhe likuidimin e detyrimeve të prapambetura, duke mos nënvlerësuar nevojën e marrjes pjesë në trajnime, apo takime të tjera zyrtare, të nevojshme, gjykojmë se nga Kryetari i Bashkisë duhet të disiplinohet ky zë shpenzimi. Kufizimet nuk duhet të vijnë vetëm për periudhën e pandemisë, por edhe pas saj, duke ruajtur një ekuilibër të përshtatshëm midis nevojave që ka bashkia për udhëtim e dieta me buxhetin që ka në dispozicion.

Shpenzime për udhëtim e dieta për vitin 2019 dhe 2020 jepen në aneksin nr. 3/20, bashkangjitur raportit të auditimit.

Nga auditimi u konstatua se Bashkia Tropojë nuk ka shlyer vlerën prej 47,120 lekë për zërin udhëtim e dieta, për trajtimin financiar të punonjëses M. G., me detyrë ish Përgjegjëse e

Sektorit të Auditit të Brendshëm, e cila është dërguar me shërbim në Tiranë për datat 17-19.11.2019 (vlera 12,560 lekë), datat 22.9-28.09.2019, në vlerën 34,560 lekë. Nga auditimi u konstatua se dokumentet justifikues për kryerjen e shërbimit me destinancion Tropojë ó Tiranë, nga znj. M. G., janë të plota, si vijon:

Për datat e shërbimit 17-19.11.2019, dokumentet justifikues janë:

- autorizimi i Kryetarit të Bashkisë z. R. B., në të cilin është përcaktuar se qëllimi i shërbimit është trajnimi me teme zhvillimi i sistemit të komunikimit të rezultateve të veprimtarisë së auditimit të brendshëm dhe shkëmbim eksperience ndërmjet NJABö;

- Urdhër shërbimi i miratuar nga Kryetari i Bashkisë;

- E-mail, nga Drejtorja e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm të MFE, me datë 11.11.2019;

- Fatura tatimore me TVSH në vlerën 6,000 lekë shpenzime fjetje, së bashku me kuponin tatimor bashkangjitur

Për datat e shërbimit 22.9-28.09.2019, në vlerën 34,560 lekë, dokumentet justifikues janë:

- autorizimi i Kryetarit të Bashkisë z. R. B., në të cilin është përcaktuar se qëllimi i shërbimit është: ò Për trajnimin e vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm sipas shkresës nr.16331, datë 12.09.2019 të Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE, protokolluar në bashki me nr.2658, datë 16.09.2019ö;

- Urdhër shërbimi i miratuar nga Kryetari i Bashkisë;

- E-mail, nga Drejtorja e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm të MFE, me datë 13.09.2019;

- Fatura tatimore me TVSH në vlerën 18,000 lekë shpenzime fjetje, së bashku me kuponin tatimor bashkangjitur.

Znj.M. G. ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me Bashkinë Tropojë në datën 27 Maj 2020.

Nga auditimi u konstatua se Bashkia Tropojë nuk ka shlyer gjithashtu vlerën prej 34,560 lekë për zërin òdhëtim e dietaö, për trajtimin financiar të punonjësës M. B., me detyrë ish specialiste e Sektorit të Auditit të Brendshëm, e cila është dërguar me shërbim në Tiranë për datat 22.09.2019 deri më 28.09.2019, 6 ditë.

Nga auditimi u konstatua se dokumentet justifikues për kryerjen e shërbimit me destinancion Tropojë ó Tiranë, nga znj. M. B., janë të plota, si vijon:

- autorizimi i Kryetarit të Bashkisë z. R. B., datë 20.09.2019, në të cilin është përcaktuar se qëllimi i shërbimit është trajnimi pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm të MFE, sipas shkresës nr.16331, datë 12.09.2019.

- Urdhër shërbimi i miratuar nga Kryetari i Bashkisë;

- E-mail, nga Drejtorja e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm të MFE, me datë 13.09.2019;

- Shkresa me nr.16331, datë 12.09.2019, e Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm të MFE, me lëndë òNjoftim për trajnimin e vijueshëm profesional të audituesve të brendshëmö, drejtuar Bashkisë Tropojë.

- Fatura tatimore me TVSH në vlerën 18,000 lekë shpenzime fjetje, së bashku me kuponin tatimor bashkangjitur, datë 28.09.2019.

Znj.M. B. ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me Bashkinë Tropojë në datën 27.05.2020.

Për mos likuidimin e vlerës prej 47,120 lekë për zërin òdhëtim e dietaö, për zn. M. G. dhe vlerën 34,560 lekë dhe për znj. M. B., ngarkohet me përgjegjësi z. R. B. me detyrë Kryetar i Bashkisë Tropojë, në cilësinë e nëpunësit autorizues, z. R. I., me detyrë ish drejtor ekonomik, pezulluar nga ushtrimi i detyrës me vendimin e ndërmjetëm nr.3, nr.43/3 prot., datë 09.01.2020 të komisionit disiplinor, ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 11.02.2020, me urdhrin nr.27, datë 04.02.2020, znj.V. B. me detyrë ish përgjegjëse e financës, pezulluar nga ushtrimi i detyrës me vendimin e ndërmjetëm nr.4, nr.44/3 prot., datë 09.01.2020 të komisionit disiplinor, ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 22.06.2020, me urdhrin

nr.97/1, datë 12.06.2020, z.B. T., me detyrë drejtor ekonomik, z. P. M. me detyrë përgjegjësi i buxhetit dhe i financës (sipas rregullores së brendshme përgjegjësi ka për detyrë regjistrimin e detyrimeve të konstatuara, përgatitjen çeljen mujore të fondeve për njësinë shpenzuese për paga, sigurime, shpenzime korente e investime).

Pretendime nga subjekti i audituar: Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni pa protokoll nga subjekti, protokolluar në KLSH me numër prot., 361/6, datë 14.06.2021, nga znjV. B., ku në mënyrë të përmbledhur janë shprehur komentet si më poshtë:

-Konstatimi për mos pagimin e dietave nuk është i saktë pasi nuk kam administruar dhe nuk ka dorëzuar dokumentacion për dietat. Dokumentacioni është edhe sot pjesërisht në zyrën e n/kryetares së bashkisë znj. Z. I. dhe vetëm një pjesë që janë firmosur i kanë kaluar znj. Suela Vatoci (specialiste financës). A keni gjetur ndonjë dokumentacion që vërteton që ne i kemi refuzuar. Pretendimi juaj është hamendësim dhe nuk janë vetëm këto dy punonjëse që janë ankuar të cilat nuk kanë marrë dietat, janë më shumë se 2 milion lekë shuma e dietave të paguara. Detyra juaj nuk është të veproni në bazë të ankesave.

Qëndrim i grupit të auditimit: Dokumentacioni i rregullt për udhëtim e dieta që është i pa likuiduar, i përket periudhës në të cilën Ju keni ushtruar detyrën e përgjegjëses së financës dhe keni pasur detyrimin e likuidimit të tyre.

Për sa i përket faktit se ka edhe dieta të tjera të pa likuiduara sqarojmë se:

Grui i auditimit auditon transaksionet financiare të kryera nga subjekti, pra dokumentacionin që gjendet në lidhjen e bankës. Për këto dy raste, dokumentacioni administrohej nga Drejtoria e Financës, por ato u bënë pjesë e auditimit, me kërkesën tonë, bazuar në kërkesën e bërë nga dy ish punonjëset, në adresën zyrtare elektronike të audituesit B. M.. Për sa më sipër lidhur me mos përfshirjen e përgjegjësisë Tuaj për mos shlyerjen e vlerës prej 47,120 lekë për zërin òudhëtim e dietaò, për zn. M. G. dhe vlerën 34,560 lekë dhe për znj. M. B., pretendimet nuk merren në konsideratë, pasi çdo punonjës, me përfundimin e shërbimit bënë dorëzimin e dokumentacionit të përgjegjësi i financës, i cili ka për detyrë regjistrimin dhe likuidimin e tyre.

Pagesat për rastet e emergjencave nga fatkeqësitë natyrore.

Nga Bashkia Tropojë nga fondi rezervë i krijuar janë dhënë fonde për familjet të cilëve u janë dëmtuar shtëpitë nga fatkeqësi natyrore. Për vitin 2019 janë dhënë ndihma të menjëhershme për 71 familje në vlerën 3,950,000 lekë, kryesisht emergjenca të krijuara nga stuhi dhe në tre raste dëmtim nga zjarri. Për vitin 2020 u konstatuan 7 raste ndihma për fatkeqësitë natyrore në vlerën 800,000 lekë, në një vlerë 5 herë më të ulët se shpenzimet e kësaj natyre të bëra në vitin 2019.

Lista për ndihmat e menjëhershme pasqyrohen në aneksin nr. 3/22, bashkangjitur raportit të auditimit.

Nga auditimi i dosjeve të personave përfitues të ndihmës së emergjencës, u konstatua se në pjesën më të madhe të tyre mungon karta e identitetit të përfituesit dhe fotot të cilat duhet të japin pamje të dëmtimit të banesës së përfituesit, krahas procesverbaleve të mbajtura për këtë qëllim.

Në fazën e auditimit në teren, janë konstatuar dy raste të cilave ju mungon dokumentacioni i përfituesit të ndihmës së emergjencës, por për z.R. Ç., praktika që vërteton dëmtimin e shtëpisë së tij, u paraqit nëpërmjet kundërshtive të bëra nga Bashkia Tropojë dhe kjo praktikë konsiderohet e rregullt.

1-Përfitues z. A. K., arsyeja e përfitimit të fondit është riparimi i çatise së shtëpisë, Fondi për përfituesin në vlerën 90,000 lekë është miratuar me vendimin e këshillit bashkiak nr.21, datë 30.09.2019.

2- Përfitues z. R. Ç., arsyeja e përfitimit të fondit është përcaktuar nga stuhia, pa përcaktuar llojin e dëmit të shkaktuar. Fondi për përfituesin në vlerën 50,000 lekë është miratuar me vendimin e këshillit bashkiak nr.110, datë 28.05.2020. U paraqit dokumenti justifikues për këtë shpenzim kërkesa e qytetarit e datës 19.05.2020, projekt vendimi nr. 2083 prot., datë 22.05.2020, i miratuar nga Kryetari i bashkisë z. R. B., konceptuar nga përgjegjësi i sektorit të emergjencave civile z. B. G., specialistja e sektorit juridik znj. J. Q., drejtori ekonomik z. B. T..

Për mangësitë e konstatuara në dosjet e familjeve përfituesve nga situatat e emergjencës, ngarkohen me përgjegjësi z. B. G. me detyrë ish përgjegjës i sektorit të emergjencave civile, ndërprerë marrëdhëniet e punës në datë 20.7.2020 për shkak të daljes në pension.

Për përfitimin e vlerës 90,000 lekë nga z. A. K., në mungesë të dokumentacionit vërtetues, ngarkohet me përgjegjësi ish kryetari i bashkisë z. B. D., z. B. G., z. R. I., me detyrë ish drejtor i financës në cilësinë e ish nëpunësit zbatues.

Vlera 90,000 lekë konsiderohet përdorim i fondeve publike pa efencë dhe efektivitet.

Kriteri: Për sa më sipër vendosja në listën e përfituesve nga emergjencat civile për dy personat e mësipërm, në mungesë të dokumentacionit vërtetues për ngjarjen e emergjencës, është në kundërshtim me shkronjën (f) e pikës 2, të VKM nr. 329, datë 16.05.2012 òPër kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore dhe udhëzimin e Ministrisë së Brendshme nr. 1185/1, datë 18.7.2007 òKriteret, rregullat dhe procedurat e përdorimit të fondit të emergjencave civile planifikuar në buxhetin vjetor të Ministrisë së Brendshme, si dhe të donacioneve që jepen si ndihmë në raste të emergjencave civile, pika 1, shkronja (c). Mos likuidimi i detyrimeve për dy ish punonjës për zërin udhëtim e dieta është në kundërshtim me rregulloren e brendshme të Bashkisë Tropojë, detyrat e përgjegjësimit të financës, si dhe ligjin nr.10 296, datë 8.7.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollin, neni 12, pika 3, germë ògjë, ku thuhet se nëpunësi zbatues përgjigjet për:

...Garantimin që të gjithë kreditorët të paguhen në kohë dhe në rastet kur kreditorët nuk janë paguar apo në rast ankesash për mos pagesë nga kreditorët, nëpunësi zbatues duhet t'ia shpjegojë rrethanat nëpunësit autorizues”.

Efekti: Pagesat e pa mbështetura në dokumentacionin urdhëruar dhe vërtetues sjellin keqpërdorim të fondeve publike, mos kryerja e pagesës për dy raste të cilat kanë dokumentacion është mohim i të drejtave financiare të punonjësimit.

Shkaku: Mos respektim i detyrave funksionale dhe kuadrit rregullator në fuqi.

Rëndësia: E mesme

Testime të tjera të transaksioneve të bankës pasqyrohen në aneksin 3/23, bashkangjitur raportit të auditimit.

Të dhëna për pasqyrat financiare jepen në aneksin nr. 3/24, bashkangjitur raportit të auditimit. Për sa më sipër është mbajtur akt konstatimi nr.9.

4. Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike dhe zbatimi i kontratave të punëve publike.

Planifikimi, realizimi, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike me vlera të vogla dhe të larta.

- a. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrimit të prokurimeve.
- b. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.
- c. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit).

d. *Auditim mbi zbatimin e kushteve në kontratat e lidhura me operatorë ekonomik të shpallur fitues për mallra dhe shërbime, si dhe marrja në dorëzim e tyre sipas specifikimeve teknike.*

e. *Auditim mbi zbatimin e kushteve në realizimin e punimeve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera në kontratat e lidhura me operatorët ekonomike fitues.*

❖ **Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.**

Nga auditimi ka rezultuar se është hartuar regjistri i parashikimeve për vitet 2019 dhe 2020 si dhe regjistri i realizimit të prokurimeve për këto vite.

Mbas miratimit në sistem të regjistrit nga APP, janë dërguar në Degën e Thesarit, regjistri i parashikimit të prokurimeve për vitet objekt auditimi mbështetur në VKB përkatëse "Mbi miratimin e buxhetit vjetor të Bashkisë Tropojë". Gjithashtu në të gjitha rastet e shtesave dhe pakësimeve është dërguar regjistri përkatës. Në këto regjistra janë pasqyruar shtesat dhe ndryshimet e bëra sipas VKB o ve përkatëse.

NJP dhe NZ, kanë vepruar në përputhje me VKM, nenin 4 o Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publiko, pika 1.

Dërgimi i regjistrit të parashikimeve në APP, është bërë brenda afateve të përcaktuara në VKM nr. 914, neni 4, pika 3.

Nga auditimi ka rezultuar se gjatë vitit ka patur ndryshim të regjistrit të parashikimeve, për të cilat për vitin 2019 nuk është bërë buxhetimi i tyre. Të gjitha ndryshimet janë hedhur në SPE, referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014, me ndryshime, neni 4, pika 4.

❖ **Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.**

Për kryerjen e auditimit mbi disponimin e fondeve dhe angazhimin e tyre për kryerjen e procedurave të prokurimit për investime publike për periudhën objekt auditimi, nga Grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Programi buxhetor Afatmesëm 2018-2020-2022; Plani Buxhetit; Fakti i buxhetit; Regjistri i Parashikimeve; Regjistri i Realizimeve.

Titulli i gjetjes: Njësia Shpenzuese "Bashkia Tropojë", përsa i përket zbatimit të disiplinës buxhetore dhe fillimit të procedurave pas marrjes së kërkesave dhe konfirmimit mbi disponibilitetin e fondeve, për vitin 2019, nuk ka treguar kujdesin e duhur duke kryer procedura prokurimi pa fonde dispozicion.

Situata: Nga auditimi rezulton se kontratat e objekteve sa me poshtë vijon janë lidhur pa fonde në dizpozicion (trajtuar më hollësisht në auditimin e procedurave të prokurimit të vitit 2019.

Tab.38

Objekti i kontratës	Kontrata		Vendimi i Këshillit Bashkiak
	Nr.	Datë	
Rikonstruksion rruge Lagje "Dardania"	4	26.03.2019	VKB nr.187, datë 19.12.2018
Rikonstruksion rruge Lagje "28 Gushti"	5	26.03.2019	VKB nr.187, datë 19.12.2018
Sistemim Lagje "Partizani"	3	26.03.2019	VKB nr.187, datë 19.12.2018
Rikonstruksion rruga Lekbibaj-Curraj Eper	11	19.06.2019	VKB nr.40, datë 26.04.2019

Burimi: Bashkia Tropojë

Veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 o Për miratimin e rregullave të prokurimit publiko, i ndryshuar, Neni 60 o Urdhri i prokurimito, ku është përcaktuar: Kur ka nevojë për punë/mallra/shërbime, pas përlllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë:

- objektin e prokurimit;

- **fondin e përlogaritur të vitit buxhetor**, si dhe fondin total të përlogaritur, në rastin e kontratave shumëvjeçare dhe marrëveshjes kuadër; si dhe në kundërshtim me udhëzimin plotësues nr. 1, datë 17.01.2019, të MF *ËPër zbatimin e Buxhetit të vitit 2019*o.

Sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi ish Kryetari i Bashkisë Tropojë z. B. D. dhe ish Drejtori Ekonomik R. I.

Kriteri: VKM nr. 914, datë 24.12.2014 *ËPër rregullat e Prokurimit Publik*o; Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 *ËPër prokurimin publik*o të ndryshuar, etj; Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008, *ËPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*o, i ndryshuar, neni 50 *ËAngazhimet buxhetore*o, paragrafi 2; UMF nr. 9, datë 20.03.18 *ËPër procedurat standard të zbatimit të buxhetit*o:

Kapitulli *ËTë përgjithshme*o, pika 7 dhe Kapitulli *ËMarrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike*o, pikat 153-155; Udhëzimi plotësues nr. 1, datë 17.01.2019, të MF *ËPër zbatimin e Buxhetit të vitit 2019*o

Ndikimi/efekti Kjo situatë shkakton vështirësi financiare dhe rritjen e detyrimeve të Bashkisë Tropojë kundrejt OE.

Njësia shpenzuese, përse i përket zbatimit të disiplinës buxhetore dhe fillimit të procedurave pas marrjes së kërkesave dhe konfirmimit mbi disponibilitetin e fondeve, nuk ka treguar kujdesin e duhur, gjë e cila rrisht fillimin e procedurave pa fonde dispozicion.

Shkaku Mosrespektimi i disiplinës, buxhetore sjell fillimin e procedurave dhe marrjen e angazhimeve buxhetore, pa patur në dispozicion fondet buxhetore për financimin e shpenzimeve.

Rëndësia e lartë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën e datës 11.06.2021, e protokolluar në KLSH me numër prot., 361/4, datë 11.06.2021 “Shkresë përcjellëse”, nga z. R. I., Z. Ç. dhe R. B., si anëtarë të KVO janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Referuar Projekt raportit të auditimit Nr.361/13 prot ,datë 24.6.2021 , ,paraqesim kund rshimet si më poshtë: P r procedurat e prokurimit publik viti 2019 ,faqe 79-120 e projektit :

I.Konkretish në faqen 80 të tijë ku cil soni se p r 7 objekte p r vitin 2019 n vler n 70964598 lek , rezulton se jan likujduar 10,162,025 leke e kontratave t lidhura sipas tabel s tuaj :

Tab.39

Kod	Emertimi objektit	Plan	Fakt	Pa likujduar
1450142	Kanale vaditese	61.139.155	6.082.968	55.056.187
1450145	Nd rtim Urash:Prush,Mehalle e vjeter,Lugu i Tropojes	4.800.000	3.996.258	803.742
1450147	Ndertim Ujesjellsi Nimnaj	960.000	0	960.000
1450155	Dhomat e zhveshjes	3.000.000	0	3.000.000
1450156	Sistemime ne lagjen qyteti B.Curri	565.747	82.799	482.948
1450158	Bashkefinacime me FZHR	379.696	0	379.696
1450159	Blerje program per ujsjellsin	120.000	0	120.000
Totali		2019 70.964.598	10.162.025	60.802.573

Burimi: Bashkia Tropojë

Kundërshtoj, pasi q kjo tabel ka t dh na t pa sakta si dhe faktin se ato jan lidhur pa fonde n dispozicion konkretisht:

Kanale vaditëse nuk q ndorn shuma q keni vendosur p r vitin 2019 , sht zhvilluar kjo procedur :**Rikonstruktion i kanaleve vaditëse bashkia Tropoje** fondi pa tvsh 4,026,501 lek vlera fituese pa tvsh 4,020,374 lek , kontrate 15.04.2019 e likujduar plot sisht n

vlerën 4,580,705 lekë në datën 23.10.2019 në Dëgjimin e Thesarit <https://www.financa.gov.al/pagesat-e-kryera-2019/>, **kjo kundërshton dhe faktin që e keni cilësuar se për këtë procedurë nuk ka patur fonde ,fondet kanë qenë të disponueshme sepse investimi ka qenë nga grantet e veta të bashkisë burim i sigurtë i fondit** , vlera që keni vendosur nuk është e saktë sepse e keni të faktuar nga vetë ju në faqen 83 të projektit tabela nr.1 ,ku keni audituar 11 procedura për vitin 2019 ,kjo procedurë është përfaqësuar në këtë tabelë e renditur e 6 në tabelë .

Ndërtim Urash:Prush,Mehalle e vjeter,Lugu i Tropojes fondi pa tvsh 4,189,033 vlera fituese pa tvsh 4,176,020 leke pa tvsh , e likujduar plotësisht në vlerën 4,580,705 lekë në datën 23.10.2019 në Dëgjimin e Thesarit <https://www.financa.gov.al/pagesat-e-kryera-2019/> 4,760,322 leke me tvsh ,pra nuk ka detyrimit ngelur sic keni theksuar ju,**kjo kundërshton dhe faktin që e keni cilësuar se për këtë procedurë nuk ka patur fonde ,fondet kanë qenë të disponueshme sepse investimi ka qenë nga grantet e veta të bashkisë burim i sigurtë i fondit** , vlera që keni vendosur nuk është e saktë sepse e keni të faktuar nga vetë ju në faqen 83 të projektit tabela nr.1 ,ku keni audituar 11 procedura për vitin 2019 ,kjo procedurë është përfaqësuar në këtë tabelë e renditur e 5 në tabelë .

Ndërtim Ujesjellsimi Nimmaj,kundërshtoj ,kjo procedurë nuk është zhvilluar në vitin 2019 ,nuk është përfaqësuar në tabelën nr.1 faqe 83 të projektit tek procedurat e audituara ,por nuk është zhvilluar as si blerje e vogël .

Dhomat e zhveshjes: kundërshtoj ,kjo procedurë nuk është zhvilluar në vitin 2019 ,nuk është përfaqësuar në tabelën nr.1 faqe 83 tek procedurat e audituara sepse nuk ka patur procedurë të tillë .

Sistemime në lagjen qyteti B.Curri në vlerën 565,747 lekë kundërshtoj ,kjo procedurë nuk është zhvilluar në vitin 2019 ,nuk është përfaqësuar në tabelën nr.1 faqe 83 tek procedurat e audituara, është zhvilluar kjo procedurë :**Sistemime Lagje “Partizani” Bajram Curri** me fond limit 11,221,024 lekë burimi i financimit nga të ardhurat e veta ,nuk është likujduar për pengesë nga kryetari i bashkisë z.R. B. i cili ka refuzuar likuidimin e tyre me pretendimin se kështu nuk janë tenderuar nga unë ,fondet ishin disponueshme kjo faktohet me faktin se bashkia Tropojë **trashëgoi fonde të mjaftueshme** për të bërë likuidimin e plotë të kësaj kontrate ose pjesor sipas VKB nr.93 datë 27.03.2020 ku është miratura buxheti i fondeve të trashëguara **në vlerën 18,466,256 lekë** trajtuar në projekt raport faqe 16 e tij ,në këtë periudhë unë isha i larguar nga puna dhe nuk mund të veproja .

Bashkefinacime me FZHR me vlerë 379.696,**kundërshtoj** kjo nuk është procedurë prokurimi,kështu janë fonde që i kalohen FZHR-s sipas akt marrvëshjeve që ka me bashkinë .

Blerje program për ujesjellsimin në vlerë 120,000 lekë ,**kundërshtoj** ky fond nuk është prokuruar asnjëherë nga bashkia Tropojë ,

II. Sa i përket konstatimit faktin se ato(kontrata) janë lidhur pa fonde në dispozicion:Kundërshtoj nga 11 procedurat e auditura nga ana juaj sipas tabelës nr.1 faqe 83 e projektit, 5 procedura si më poshtë :

1. Rikonstruktion i kanaleve vaditëse bashkia Tropojë
2. Ndërtim Urash:Prush,Mehalle e vjeter,Lugu i Tropojes
3. Punim ndërtimore shkollën fshatra
4. Sistemime fshati Margegaj dhe qyteti Fierz .
5. Ndërtim i rrejtit shpërndarës të ujësjellsit fshati Kasaj.

Kështu procedura kanë patur burim financimi granti transferte e pakushtëzuar ,pra fondet kanë qenë të disponueshme që nga momneti i nxjerrjes së urdhër prokurimit ,lidhje kontrate dhe likuidimi i tyre ,pasi që kështu kontrata janë likujduar plotësisht gjatë vitit 2019 ,për rjashtoj kontratën e Ndërtim i rrejtit shpërndarës të ujësjellsit fshati Kasaj për të cilën është likujduar situacion pjesor gjatë 2019 në Dëgjimin e thesarit Tropojë <https://www.financa.gov.al/pagesat-e->

kryera-2019 (23 tetor), për arsye se nuk kishte përfunduar akoma dhe është likuajduar i plotë pas përfundimit të punimeve.

Për dy kontrata si më poshtë:

1. Rikonstruktion i shkollës "Tinka Kurti", Lekbibaj.
2. Shkolla Asim Vokshi "Palestina" dhe terrenet sportive etj.

Këto kontrata janë prokuruar dhe lidhur kontrata me fondet financiare nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, fondet për këto kontrata janë deleguar nga kjo ministri dhe është bërë likuidimi i tyre i plotë, pra fondet kanë qenë qarta nga momenti i nxjerrjes urdhrat për prokurimit deri në lidhje kontrate.

Si përfundim theksoj se mungesa e vlerësimit të thesarit në urdhër prokurime për këto objekte nuk tregon mungesën e fondeve sepse këto kontrata nuk kanë krijuar vlera të papaguara në përfundim të kontratës, sic keni theksuar.

Për 4 objektet si më poshtë:

1. Sistemime Lagje "Partizani" Bajram Curri.
2. Rikonstruktion rrugë lagjeje "Dardania".
3. Rikonstruktion rrugë lagjeje "28 Gushti".
4. Rikonstruktion rrugë Lekbibaj-Curaj Eper.

Këto objekte janë prokuruar me burime të vet bashkisë (të ardhurat), të cilat ishin parashikuar të realizoheshin nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, kjo e parashikuar nga sektori i tatimit taksave në FTP e hartimit buxhetit, 3 objektet e lagjeve në qytet kishin përfunduar punimet dhe ishin marrë në dorëzim brenda datës 30.05.2019, dhe nëse kishte pamundësi realizimi plani të ardhurave, sektori i tatimit mundë të propozonte rishikim plani të ardhurave trajtuar kjo edhe nga ish përgjegjësi e sektorit finacës si observacion e pasqzruar në faqen 32-33 të projekt raportit.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se: në lidhje me pikën I, komenti juaj merret në konsideratë dhe nuk do të trajtohet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Ndërsa në lidhje me pikën 2, ju sqarojmë se komenti juaj nuk merret në konsideratë, këto prokurime janë kryer pa fonde në dispozicion të trajtuara më hollësisht përgjatë këtij materiali.

❖ Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit).

Për auditimin e kësaj nën çështjeje u verifikuan: Dosjet e procedurave; Përcaktimi i kriterëve të vlerësimit; Hartimi i DT;

Administrimi i dosjeve të prokurimit: Urdhrat e Titullarit të AK; Procesverbalet e mbajtura nga NJP dhe KVO, etj; Raporti përfundimtar; Korrespondenca me OE; Dokumentacioni që plotësohet nga AK; Korrespondenca me APP dhe KPP; Dokumentacioni mbi angazhimin e fondeve buxhetore.

Mbi administrimin e dosjeve nga NJP: Nga Grupi i auditimit u shqyrtua i gjithë dokumentacioni i ndodhur në Dosjen e prokurimit për të gjitha procedurat e audituara, nga ku rezultoi se: Në përgjithësi nga NJP, janë zbatuar të gjitha detyrat e përcaktuara, si: përgatitja e regjistrave të prokurimit; përzgjedhja e llojit të procedurës, hartimi Urdhrit të prokurimit; përgatitja e DT, plotësimi i gjithë dokumenteve standarde për të plotësuar nga AK, ka administruar të gjitha procesverbalet e mbajtura gjatë zhvillimit të procedurës; ka respektuar afatet e procedurës, ka administruar dokumentacionin e OE fitues, ka shqyrtuar dhe ka reflektuar të gjitha Rekomandimet e APP-së, mbi kriteret kualifikuese, sipas vërejtjeve të saj gjatë monitorimit të procedurave, etj. Nga ana e Juristit të NJP janë administruar dhe inventarizuar të gjitha dosjet e prokurimit. Pjesë e dosjeve ishte i gjithë dokumentacioni i kërkuar sipas akteve ligjore, nënligjore dhe DST.

Sa më sipër, juristi i NJP ka vepruar në përputhje me VKM nenin 57, òPersoni përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimitò, pika 3.

- Mbi auditimin e zbatimit të procedurave të prokurimit publik:

Në Bashkinë Tropojë për periudhën objekt auditimi janë zhvilluar 30 procedura prokurimi me fond limit 631,298 mijë lekë, nga të cilat janë audituar 17 prej tyre me fond limit 588,555 mijë lekë ose 93.23% e fondit limit dhe 56.7% e numrit të prokurimeve të zhvilluara, sa më poshtë vijon:

Tab.40

në lekë


vitet	procedura	zhvilluar		audituar		në % kundrejt:	
		nr.	fond limit	nr.	fond limit	nr.	vlerë
2019		14	166,223,364	11	149,657,794	78.57	90.03
të hapur		5	119,188,192	4	108,771,525	80.00	91.26
• kerkesë për propozim		9	47,035,172	7	40,886,269	77.78	86.93
2020		16	465,075,541	6	438,897,326	37.50	94.37
• kerkesë për propozim		10	30,678,214	2	10,000,000	20.00	32.60
te hapura		3	419,477,508	3	419,477,508	100.00	100.00
konsulence		1	9,419,818	1	9,419,818	100.00	100.00
negocim		2	5,500,000				
totali		30	631,298,905	17	588,555,120	56.67	93.23

Të dhëna nga rregjistri i prokurimeve, të përpunuara nga grupi i auditimit


2019 -2020 Lloji i procedurës	zhvilluar		audituar		në % kundrejt fondit limit:
	nr.	fond limit	nr.	fond limit	
kërkesë për propozim	19	77,713,386	9	50,886,269	65%
të hapura	8	536,665,700	7	528,249,033	98.4%
konsulence	1	9,419,818	1	9,419,818	100%
negocim	2	5,500,000			
Total	30	631,298,905	17	588,555,120	93%

Të dhëna nga rregjistri i prokurimeve, të përpunuara nga grupi i auditimit


• Në mënyrë nominale procedurat e audituara janë në **Aneks 4/a** bashkëlidhur. Nga ku rezulton se procedura më e përdorur është ajo òe hapurò e cila zë 85 % të fondeve të prokuruar, (ku vetëm një procedurë është në vlerën 350 milion lekë) sipas grafikut, sa më poshtë vijon:



Ndërsa procedura më e përdorur është ajo e llojit òkërkesë për propozimò e cila zë 63% të procedurave të prokurimit të përdorura, sipas grafikut sa më poshtë vijon;



Sipas riskut dhe materialitetit bazuar në llojin e procedurave për vitet objekt auditimi mbulimi me auditimin i procedurave të prokurimit është në masën 93%. Sipas llojit të tyre paraqitet:



Auditim i procedurave të prokurimit publik për vitin 2019.

Tab.41

Nr	Objekti	Fondi limit	Procedura	OE fitues	Vlera e ofertës fituese	Diferenca nga fondi limit	Operatorë ekonomikë		
							Total	S' kualifikuar	Kualifikuar
Viti 2019									
1	Rik.ruge lagjeje ëDardaniaö	16,347,126	E hapur	H. 1.	16,288,828	58,298	3	2	1
2	Rik. rruge lagjeje "28 Gushti"	17,225,606	E hapur	F.	17,119,472	106,134	1		1
3	Sistmime Lagje "Partizani" B.Curri	11,221,024	K. propoz.	M.&Sh. A.ö	11,005,963	215,061	2	1	1
4	Punime ndërtime Shkolla e fshatit	2,032,082	K. propoz.	V.	2,022,394	9,688	2	1	1
5	Ndërtim Ura, ne vende te ndryshme	4,189,033	K. propoz.	V.	4,176,020	13,013	1		1
6	Rik. i kanaleve Vaditëse	4,026,501	K. propoz.	V.	4,020,374	6,127	1		1
7	Sistmime Fshati Margegaj, dhe Qyteti Fierze	2,823,771	K. propoz.	V.	2,814,212	9,559	3	2	1
8	Rik. i shkollës "Tinka Kurti", Lekbibaj	24,879,202	E hapur	öH. 1.ö & öSh.ö	18,680,967	6,198,235	6	4	2

Nr	Objekti	Fondi limit	Procedura	OE fitues	Vlera e ofertës fituese	Diferenca nga fondin limit	Operatorë ekonomikë		
							Total	S'kualifikuar	Kualifikuar
9	Ndërtim i rrjetit shpërndarës të ujës/jellës të fshatit Kasaj,	9,927,191	K. propoz.	öT.ö & öN.ö	9,899,217	27,974	2		2
10	Shkolla Asim Vokshi-Palestër dhe terrene sportive etj.	50,319,591	E hapur	4.M	50,269,533	50,058	9	8	1
11	Rik. Rruga Lekbibaj ö Curraj Eper	6,666,667	K. propoz.	öH. 1.ö öSh.ö	6,624,188	42,479	3	2	1
Totali		149,657,794			142,921,168	6,736,626	33	20	13

Burimi Bashkia Tropojë

Në mënyrë analitike sipas procedurave të audituara ka rezultuar:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rikonstruksion rrugë lagjeje "28 Gushti", B. Curri.		
1. Urdhër Prokurimi: nr. 2/1 prot. datë 21.01.2019	3. Hartuesit e D. Tenderit: nr. 2/1 datë 21.01.2019	4. Komisioni i V. Ofertave: nr. 2/2, datë 21.01.2019
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit öE hapurö	H. Ç. ö Inxhinier B. I. ö Juriste M. B. ö Inxhiniere	R. B. ö Kryetar Z. Ç. ö Anëtar R. I. ö Anëtar
5. Fondi Limit 17,225,606 lekë	6. Oferta fituese 17,119,472 lekë (F. shpk)	7. Diferenca me fondin limit: (patvsh) 106,134 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 25.02.2019	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender, 1 OE b) Kualifikuar 1 OE,
11. Ankimime AK – s'ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK ö	13. Përgjigje Ankesës nga KKP

Titulli i Gjetjes: Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt öRikonstruksion rrugë lagjeje ö28 Gushtiö, B. Curriö, me fond limit **17,225,606 lekë pa tvsh.**

Situata: Nga Autoriteti Kontraktor (AK) Bashkia Tropojë, nuk është bërë e mundur që ky urdhër prokurimi të konfirmohet në Degën e Thesarit, për të siguruar garancinë e fondeve dhe mos krijimin e vlerave të papaguara në përfundim të kontratës, veprime në kundërshtim me udhëzimin plotësues nr. 1, datë 17.01.2019, të MF öPër zbatimin e Buxhetit të vitit 2019ö, ku përcaktohet se:

öDega e Thesarit kryen kontrollin e totalit të fondeve të paraqitura në regjistrin e prokurimeve me totalin e fondeve të miratuara në buxhetin e njësisë dhe, vetëm pasi vulozet nga Thesari urdhri i prokurimit, njësia mund të fillojë procesin e prokurimit në Agjencinë e Prokurimeve Publikeö.

öTë gjithë urdhrat e prokurimit që nxirren gjatë vitit për mallrat, shërbimet dhe investimet duhet të paraqiten në degën e Thesarit, së bashku me ftesën për prokurim, të cilat duhet: (i) t'i përmbahen listës së prokurimeve të dorëzuar në Thesar, (ii) të kontrollohen për përputhshmëri me regjistrin e prokurimeve dhe të vulozen nga dega e Thesarit, përpara procedimit, sipas rregullave të prokurimit publikö.

Përsa i përket kriteve të veçanta të vendosura në DST nga njësia e prokurimit rezultojnë kriteret për kualifikim janë argumentuar, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, öPër miratimin e rregullave të prokurimit publikö, nenin 61, öHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitö, pika 2.

Nga auditimi rezultoi se ka marrë pjesë vetëm 1 OE e cila është kualifikuar dhe shpallur fituese nga KVO.

Mangësitë e konstatuara në dokumentacionin e OE të shpallur fitues òF.ò shpk, me vlerë të ofertës në shumën prej 17,119,472 lekë pa tvsh, janë si më poshtë:

Për plotësimin e këtij kriteri OE òF.ò shpk ka paraqitur shtojcën 10 Mbi disponimin e makinerive, si dhe ka paraqitur disa kontrata noteriale si më poshtë vijon:

1-Kontratë noteriale me nr. 1402 Rep., dhe 1024 Kol., të datës 23.02.2019 të lidhur me shoqërinë òG.ò shpk, me anë të së cilës ka marrë me qera 2 kamiona me targa AA 817 RL dhe AA 965 RB.

2-Kontratë noteriale me nr. 1400 Rep., dhe 1022 Kol., të datës 23.02.2019 të lidhur me shoqërinë òGò shpk, me anë të së cilës ka marrë me qera mjetin me targa AA 213 UO.

Në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 òPër transportet rrugoreò, neni 1, 3, 5 dhe Kreut III.1, òTransporti i mallrave me qira dhe për të tretëò, nenet 41, 42, 43 dhe 44, si dhe Kreut III.2, òTransporti i mallrave për veteò, nenet 45, 46, dhe 47, bëhet qartësisht ndarja midis këtyre mënyrave të transportit dhe përcaktohet ndalimi i secilës nga mënyrat e transportit pa pajisjen me licencën përkatëse.

Në rastet konkrete, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se certifikatat e mjeteve të mësipërme të cilat i disponojnë shoqëritë òG.ò shpk dhe òGò shpk, sipas lejeve të qarkullimit, **janë specifike dhe të lëshuara vetëm për transport për vete, për kryerjen e transportit të mallrave me kamion, vetëm për llogari të veprimtarisë së OE “G.” shpk & “G” shpk.**

Në këtë mënyrë, kryerja e transportit të mallrave nga ana e shoqërisë òF.ò sh.p.k. me kamionët e shoqërive të mësimërme do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa liçencën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit òPër transportet rrugoreò është i ndaluar.

Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e OE òF.ò shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar **përdorim të paligjshëm të fondeve publike në vlerën 17,119,472 lekë** dhe ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga: z. R. B., z. Z. Ç. dhe z. R. I.

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.

Ndikimi/Efekt: përdorim të paligjshëm të fondeve publike në vlerën 17,119,472 lekë.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Nga ana e bashkisë Tropojë të merren masa për vendosjen e kriterëve të DST në përputhje me objektin e prokurimit si dhe për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të OE që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni në adresën zyrtare të emailit, nga z. H. Ç., znj. V. N., znj. B. I. dhe znj. M. B., si anëtarë të njësisë së prokurimit, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Nga autoriteti kontraktor, bashkia Tropojë, nuk është bërë e mundur që urdhri i prokurimit të konfirmohet në degën e thesarit”

-Njësia e prokurimit, arsyeton se: Autoriteti kontraktor ka zbardhur urdhrin e prokurimit, bazuar në **VKB nr.187, datë 19.12.2018 “Për miratimin e PBA-së 2019-2021, Buxheti dhe numrit maksimal të punonjësve të bashkisë Tropojë për vitin 2019, si viti i parë i PBA-së 2019-2021,** regjistrin e parashikimeve publike për vitin 2019, date 07.01.2019 nr.18/3 Prot., të dërguar në degën e thesarit Tropoje. Çdo urdhër prokurimi, në të gjitha procedurat e prokurimit, një kopje është firmosur/miratuar nga Drejtoria Ekonomike për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave përkatëse.

-Përsa i përket procesverbaleve të mbajtura nga komisionet dhe formularët e zhvillimit të

procedurës së prokurimit, janë të pa protokolluarat .

Arsyetojmë se njësia e prokurimit ka dorëzuar dosjet e të gjitha procedurave të prokurimit me fletë inventari.

-Përsa i përket konstatimit se kërkesat e veçanta për kualifikim nuk janë argumentuar nga ana e NJHDT, por vetëm janë listuar si të tilla, arsyetojmë se në këtë rast dhe në të gjitha rastet, ne si njësi, me anë të procesverbaleve përkatëse dhe në rastin konkret të procesverbalit nr.2, date 22.01.2019 òProces-verbal i njësisë së prokurimit për hartimin e dokumenteve të tenderit nr.2ö,kemi bërë argumentimin për çdo kriter të veçantë, në përputhje me natyrën e punimeve, volumin e punimeve dhe afatin e përcaktuar për përfundimin e punimeve, sipas tabelës në këtë procesverbal, faqe 6-10 të tij.

-Përsa i përket konstatimit se ò*Kërkesa për paraqitjen e aktit te marrjes ne dorëzimö*, është kërkesë e tejkaluar, sipas VKM nr.914, date 29.12.2014, neni 26.

Arsyetojmë se, ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 26 të VKM se mësipërme, pika 6, paragrafi si vijon: Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

-Përsa i përket konstatimit se janë kërkuar një numër prej 32 punonjësish për periudhën gusht 2018 ó janar 2019 dhe pretendimit nga ana juaj *se nuk janë argumentuar me zberthim te grafikut dhe preventivit te punimeve*,

sqarojmë se në këtë rast dhe në të gjitha rastet, ne si njësi, me anë të procesverbaleve përkatëse dhe në rastin konkret të procesverbalit nr.2, date 06.02.2019 òProces-verbal i njësisë së prokurimit për hartimin e dokumenteve të tenderit nr.2ö,kemi bërë argumentimin për çdo kriter të veçantë, në përputhje me natyrën e punimeve, volumin e punimeve dhe afatin e përcaktuar për përfundimin e punimeve.

-Përsa i përket konstatimit se nuk është kërkuar specialist i fushës së punimeve elektrike,

ju sqarojmë se të gjitha punimet elektrike të parashikuara në preventiv, sipas zberthimit të zërave të punimeve për punëtorinë e kësaj fushe, del me pak se 1 (një) specialist + punëtor i kësaj fushe. Vendosija e një kriteri të tillë me përbindje kaq të ulët, është i tepërt logjikisht, pasi kriteri plotësohet edhe me kërkesat e licencës dhe punëve të ngjashme (licencimi dëshmon plotësimin e kapaciteteve teknik, duke përfshirë specialistët e fushës dhe kryerjen e punimeve të tilla).

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se nga AK Bashkia Tropojë, nuk është bërë e mundur që ky urdhër prokurim të konfirmohet në Degën e Thesarit, për të siguruar garancinë e fondeve dhe mos krijimin e vlerave të papaguara në përfundim të kontratës, veprime në kundërshtim me udhëzimin plotësues nr. 1, datë 17.01.2019 të MF ò*Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2019ö*. Mungesa e vulës së thesarit në urdhër prokurim, tregon që nuk ka fonde në dispozicion nga AK për kryerjen e kësaj procedure prokurimi dhe ngarkon me përgjegjësi drejtorin ekonomik, z. R. I..

Ky argument nuk merret në konsideratë.

Përsa i përket argumentimit të kriterëve, komentet e bëra nga ana juaj janë të argumentuara si dhe kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye merren në konsideratë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni në adresën zyrtare të emailit nga z. R. I., z. Z. Ç. dhe z. R. B., si anëtarë të KVO ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në zbatim të kriterëve të vendosur, KVO-ja ka vlerësuar se OE òF.ö shpk, ka paraqitur kontratat qeraje noteriale me anë të së cilës ka marrë me qera mjetet siç edhe i keni theksuar

në aktkonstatimin nr.7. KVO në zbatim të nenit 53, pika 4, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006
 ÷Për prokurimin publik, i ndryshuar, ka kualifikuar këtë operator pasi i përmbush kriteret e vendosura në DST.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Për plotësimin e kriterit për makineritë, OE ÷F.ö shpk ka paraqitur shtojcën 10 Mbi disponimin e makinerive, si dhe ka paraqitur disa kontrata noteriale si më poshtë vijon:

1-Kontratë noteriale me nr. 1402 Rep., dhe 1024 Kol., të datës 23.02.2019 të lidhur me shoqërinë ÷G.ö shpk, me anë të së cilës ka marrë me qera 2 kamiona me targa AA 817 RL dhe AA 965 RB.

2-Kontratë noteriale me nr. 1400 Rep., dhe 1022 Kol., të datës 23.02.2019 të lidhur me shoqërinë ÷Gö shpk, me anë të së cilës ka marrë me qera mjetin me targa AA 213 UO.

Në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 ÷Për transportet rrugore, neni 1, 3, 5 dhe Kreut III.1, ÷Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë, nenet 41, 42, 43 dhe 44, si dhe Kreut III.2, ÷Transporti i mallrave për vete, nenet 45, 46, dhe 47, bëhet qartësisht ndarja midis këtyre mënyrave të transportit dhe përcaktohet ndalimi i secilës nga mënyrat e transportit pa pajisjen me licencën përkatëse.

Në rastet konkrete, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se certifikatat e mjeteve të mësipërme të cilat i disponojnë shoqëritë ÷G.ö shpk dhe ÷Gö shpk, sipas lejeve të qarkullimit, janë specifike dhe të lëshuara vetëm për transport për vete, për kryerjen e transportit të mallrave me kamion, vetëm për llogari të veprimtarisë së OE "G" shpk & "G" shpk.

Në këtë mënyrë, kryerja e transportit të mallrave nga ana e shoqërisë ÷F.ö sh.p.k. me kamionët e shoqërive të mësimërme do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa licencën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit ÷Për transportet rrugore është i ndaluar. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rikonstruksion i kanaleve vaditëse bashkia Tropojë.		
1. Urdhër Prokurimi: nr. 381/1 prot. datë 12.02.2019	3. Hartuesit e D. Tenderit: nr. 381/1 datë 12.02.2019	4. Komisioni i V. Ofertave: nr. 381/2, datë 12.02.2019
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit ÷Kërkesë për propozimë	H. Ç. ÷ Inxhinier V. N. ÷ Juriste M. B. ÷ Inxhiniere	R. B. ÷ Kryetar Z. Ç. ÷ Anëtar R. I. ÷ Anëtar
5. Fondi Limit (pa tvsh) 4,026,501 lekë	6. Oferta fituese (patvsh): 4,020,374 lekë (V. shpk)	7. Diferenca me fondin limit: (patvsh) 6,127 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 04.03.2019	9. Burimi Financimit Buxheti i shtetit + të ardhurat e bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender, 1 OE b) Kualifikuar 1 OE,
11. Ankimime AK – s'ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK ÷	13. Përgjigje Ankesës nga KKP

Titulli i Gjetjes: Moszbatim i legjislationit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt ÷Rikonstruksion i kanaleve vaditëse bashkia Tropojë, me fond limit 4,026,501 lekë.

Situata: Nga AK Bashkia Tropojë, nuk është bërë e mundur që ky urdhër prokurimi të konfirmohet në Degën e Thesarit, për të siguruar garancinë e fondeve dhe mos krijimin e vlerave të papaguara në përfundim të kontratës, veprime në kundërshtim me udhëzimin plotësues nr. 1, datë 17.01.2019, të MF ÷Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2019.

Përsa i përket kriterëve të veçanta të vendosura në DST nga njësia e prokurimit rezulton se kriteret për kualifikim janë argumentuar, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë

29.12.2014, ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, nenin 61, ÷Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit, pika 2.

Nga auditimi rezultoi se ka marrë pjesë vetëm 1 OE e cila është kualifikuar dhe shpallur fituese nga KVO.

Mangësitë e konstatuara në dokumentacionin e OE të shpallur fitues ÷V.ö shpk, me vlerë të ofertës në shumën prej 4,020,374 lekë pa tvsh, janë si më poshtë:

Për plotësimin e kriterit të energjisë elektrike, OE ÷V.ö shpk, ka paraqitur vërtetimin me nr.15 prot., datë 09.02.2019, sipas të cilit ka paguar faturat e energjisë elektrike vlerë e llogaritur deri në datën 09.02.2019, duke përfshirë faturën koherente të muajit dhjetor 2018.

Data e zhvillimit të kësaj procedure prokurimi është data 04.03.2019 dhe muaji i fundit i maturuar i energjisë elektrike është muaji janar 2019. Mospagimi i energjisë elektrike të muajit janar 2019, sjell si pasojë mosplotësimin e këtij kriteri nga OE ÷V.ö shpk.

OE ÷V.ö shpk, ndër të tjera ka përcaktuar si drejtues teknik të përfshirë në licencën e firmës Ing. R. K., i cili do të jetë i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate dhe nuk është i angazhuar në kontrata të tjera.

Ky OE ka lidhur kontratë pune me ing. R. K., me nr. 127 Rep., dhe 56 Kol., datë 05.03.2018 për një afat 1 vjeçar. Në këtë kontratë është parashikuar që paga e ing. R. K. do të jetë 45.000 lekë në muaj, ndërkohë që në listë pagesat e 6 muajve të fundit, rezulton se është paguar me pagën prej 24.000 lekë në muaj. Në DST është shprehur qartë rastet e dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kusht për s kualifikim dhe në këtë rast kontrata me drejtuesin teknik të sipër cituar është e pasaktë dhe e rreme.

Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e OE ÷V.ö shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar **përdorim të paligjshëm të fondeve publike në vlerën 4,020,374 lekë** dhe ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga: z. R. B., z. Z. Ç. dhe z. R. I..

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.

Rëndësia:E lartë.

Ndikimi/efekti: Vendosija e kriterëve në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të LPP, përdorim të paligjshëm të fondeve publike në vlerën 4,020,374 lekë

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.

Rekomandim:Nga ana e Bashkisë Tropojë të merren masa për vendosjen e kriterëve të DST në përputhje me objektin e prokurimit si dhe për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të OE që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni në adresën zyrtare të emailit, nga z. H. Ç., znj. V. N., znj. B. I. dhe znj. M. B., si anëtarë të njësies së prokurimit, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

- *Nga autoriteti kontraktor, bashkia Tropoje, nuk është bërë e mundur që urdhri i prokurimit të konfirmohet në degën e thesarit”*

-Njësia e prokurimit, arsyeton se: Autoriteti kontraktor ka zbardhur urdhrin e prokurimit, bazuar në **VKB nr.187, datë 19.12.2018 “Për miratimin e PBA-së 2019-2021, Buxheti dhe numrit maksimal të punonjësve të bashkisë Tropojë për vitin 2019, si viti i parë i PBA-së 2019-2021,** regjistrin e parashikimeve publike për vitin 2019, date 07.01.2019 nr.18/3 Prot., të dërguar ne degën e thesarit Tropoje. Çdo urdhër prokurimi, në të gjitha procedurat e prokurimit, një kopje është firmosur/miratuar nga Drejtoria Ekonomike për vazhdimin e mëtejshëm te procedurave përkatëse.

-Përsa i përket procesverbaleve të mbajtura nga komisionet dhe formularët e zhvillimit të procedurës së prokurimit, janë të pa protokolluarat .

Arsyetojmë se njësia e prokurimit ka dorëzuar dosjet e të gjitha procedurave të prokurimit me

fletë inventari.

- Përsa i përket konstatimit se NJP ka ftuar vetëm 4 operatorë ekonomikë në këtë procedurë,

arsyetojmë se në këtë rast dhe në të gjitha rastet e procedurave **“Kërkesë për propozime”**, kemi ftuar gjithmonë nga 5 operatorë ekonomikë. Në rastin konkret, në shkresën e datës 18.02.2019 te NJP, është një lapsus në renditjen e operatorëve ekonomik, pasi në sistemin e APP kemi bërë ftesë 5 operatorëve ekonomik.

-Përsa i përket konstatimit se kërkesat e veçanta për kualifikim nuk janë argumentuar nga ana e NJHDT, por vetëm janë listuar si të tilla, arsyetojmë se në këtë rast dhe në të gjitha rastet, ne si njësi, me anë të procesverbaleve përkatëse dhe në rastin konkret të procesverbalit nr.2, date 22.01.2019 **“Proces-verbal i njësisë së prokurimit për hartimin e dokumentave të tenderit nr.2” (bashkangjitur)**, kemi bere argumentimin për çdo kriter të veçantë, në përputhje me natyrën e punimeve, volumin e punimeve dhe afatin e përcaktuar për përfundimin e punimeve.

-Përsa i përket konstatimit se *oKërkesa për paraqitjen e aktit te marrjes ne dorëzimö*, është kërkesë e tejkaluar, sipas VKM nr.914, date 29.12.2014, neni 26.

Arsyetojmë se, ky kriter është vendosur ne përputhje me nenin 26 te VKM se mësipërme, pika 6, paragrafi si vijon: Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

-Përsa i përket konstatimit se janë kërkuar një numër prej 30 punonjësish për periudhën gusht 2018 ó janar 2019 dhe pretendimit nga ana juaj *se nuk janë argumentuar me zbërthim te grafikut dhe preventivit te punimeve*,

sqarojmë se në këtë rast dhe në të gjitha rastet, ne si njësi, me anë të procesverbaleve përkatëse dhe në rastin konkret të procesverbalit nr.2, date 12.02.2019 **“Proces-verbal i njësisë së prokurimit për hartimin e dokumenteve të tenderit nr.2”**, kemi bërë argumentimin për çdo kriter të veçantë, në përputhje me natyrën e punimeve, volumin e punimeve dhe afatin e përcaktuar për përfundimin e punimeve.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se nga AK Bashkia Tropojë, nuk është bërë e mundur që ky urdhër prokurim të konfirmohet në Degën e Thesarit, për të siguruar garancinë e fondeve dhe mos krijimin e vlerave të papaguara në përfundim të kontratës, veprime në kundërshtim me udhëzimin plotësues nr. 1, datë 17.01.2019 të MF *oPër zbatimin e Buxhetit të vitit 2019ö*. Mungesa e vulës së thesarit në urdhër prokurim, tregon që nuk ka fonde në dispozicion nga AK për kryerjen e kësaj procedure prokurimi dhe ngarkon me përgjegjësi drejtorin ekonomik, z. R. I..

Ky argument nuk merret në konsideratë.

Përsa i përket argumentimit të kriterëve, komentet e bëra nga ana juaj janë të argumentuara si dhe kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye merren në konsideratë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni në adresën zyrtare të emailit nga z. R. I., z. Z. Ç. dhe z. R. B., si anëtarë të KVO ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Referuar dokumentit të paraqitur vërtetim nr.15 prot., datë 09.02.2019, OE nuk rezulton debitor por rezulton se ka shlyer të gjitha detyrimet siç dhe kërkohet në DST. Në referencë sa më sipër po ky OE ka paraqitur në procedurën e prokurimit *oSisteme Fshati Margegajö*, zhvilluar në datën 16.04.2019 vërtetimin që tregon se ky OE ka shlyer në vazhdimësi

detyrimet e energjisë elektrike. KVO e ka kualifikuar këtë operator pasi përmbush kriteret e vendosura në DST.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Data e zhvillimit të kësaj procedure prokurimi është data 04.03.2019 dhe muaji i fundit i maturuar i energjisë elektrike është muaji janar 2019. Mospagimi i energjisë elektrike të muajit janar 2019, sjell si pasojë mosplotësimin e këtij kriteri nga OE òV.ò shpk. Ndërkohë ju në observacion nuk jeni shprehur edhe për mangësinë tjetër të konstatuar të këtij operatori ekonomik. OE òV.ò shpk, ndër të tjera ka përcaktuar si drejtues teknik të përfshirë në licencën e firmës Ing. R. K., i cili do të jetë i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate dhe nuk është i angazhuar në kontrata të tjera. Ky OE ka lidhur kontratë pune me ing. R. K., me nr. 127 Rep., dhe 56 Kol., datë 05.03.2018 për një afat 1 vjeçar. Në këtë kontratë është parashikuar që paga e ing. R. K. do të jetë 45.000 lekë në muaj, ndërkohë që në listëpagesat e 6 muajve të fundit, rezultojnë se është paguar me pagën prej 24.000 lekë në muaj. Në DST është shprehur qartë rastet e dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kusht për skualifikim dhe në këtë rast kontrata me drejtuesin teknik të sipër cituar është e pasaktë dhe e rreme. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e tjera të bëra nga ana juaj nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Sistemime Lagje "Partizani", B. Curri.		
1. Urdhër Prokurimi: nr. 3/1 prot. datë 21.01.2019	3. Hartuesit e D. Tenderit: nr. 3/1 datë 21.01.2019	4. Komisioni i V. Ofertave: nr. 3/2, datë 21.01.2019
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit òKërkesë për propozimò	H. Ç. ó Inxhinier B. I. ó Juriste M. B. ó Inxhiniere	R. B. ó Kryetar Z. Ç. ó Anëtar R. I. ó Anëtar
5. Fondi Limit (pa tvsh) 11,221,024 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh): 11,005,963 lekë (M. shpk&Sh.A. shpk)	7. Diferenca me fondin limit: (patvsh) 215,061 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 14.02.2019	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender, 2 OE b) Kualifikuar 1 OE, c) Søkualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK – s'ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK ó	13. Përgjigje Ankesës nga KKP

Titulli i Gjetjes: Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt òSistemime lagje òPartizaniò, B. Curriò, me fond limit **11,221,024 lekë**.

Situata: Nga AK Bashkia Tropojë, nuk është bërë e mundur që ky urdhër prokurimi të konfirmohet në Degën e Thesarit, për të siguruar garancinë e fondeve dhe mos krijimin e vlerave të papaguara në përfundim të kontratës, veprime në kundërshtim me udhëzimin plotësues nr. 1, datë 17.01.2019, të MF òPër zbatimin e Buxhetit të vitit 2019ò.

Përsa i përket kriteve të veçanta të vendosura në DST nga njësia e prokurimit rezultojnë se kriteret për kualifikim janë argumentuar, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, nenin 61, òHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitò, pika 2.

Nga auditimi rezultoi se kanë marrë pjesë 2 OE. Është søkualifikuar 1 OE pasi nuk ka paraqitur ofertë dhe është kualifikuar dhe shpallur fituese oferta tjetër.

Mangësitë e konstatuara në dokumentacionin e BOE të shpallur fitues òM.ò shpk & òSh. A.ò, me vlerë të ofertës në shumën prej 11,005,963 lekë pa tvsh, janë si më poshtë:

Për plotësimin e kriterit të makinerive OE òM.ò shpk ka paraqitur shtojcën 10 "Mbi disponimin e makinerive" si dhe ka paraqitur këtë kontratë noteriale si më poshtë vijon:

1-Kontratë noteriale me nr. 513 Rep., dhe 143/1 Kol., të datës 12.02.2019 të lidhur me shoqërinë òGj. K.ò sh.a, me anë të së cilës ka marrë ndër të tjera me qera 1 kamion me targa TR 8770 L.

Në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 òPër transportet rrugoreò, neni 1, 3, 5 dhe Kreut III.1, òTransporti i mallrave me qira dhe për të tretëò, nenet 41, 42, 43 dhe 44, si dhe Kreut III.2, òTransporti i mallrave për veteò, nenet 45, 46, dhe 47, bëhet qartësisht ndarja midis këtyre mënyrave të transportit dhe përcaktohet ndalimi i secilës nga mënyrat e transportit pa pajisjen me licencën përkatëse.

Në rastet konkrete, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se certifikata e mjetit të mësipërm të cilin e disponon shoqëria òGj. K.ò sh.a sipas lejes së qarkullimit, **është specifike dhe e lëshuar vetëm për transport për vete, për kryerjen e transportit të mallrave me kamion, vetëm për llogari të veprimtarisë së operatorit ekonomik “Gj. K.” sh.a.**

Në këtë mënyrë, kryerja e transportit të mallrave nga ana e shoqërisë òM.ò sh.p.k. me kamionin e shoqërisë òGj. K.ò sh.a do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa licencën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit òPër transportet rrugoreò është i ndaluar.

Bilancet e paraqitura nga OE òM.ò shpk për vitet 2015 dhe 2016 nuk janë të certifikuara nga autoritetet përkatëse.

Në shtojcën nr.10 OE òSh.A.ò shpk, ka deklaruar 7 punë në proces por nuk ka deklaruar edhe këtë punë tjetër sipas buletinit të APP dhe më konkretisht:

Sipas buletinit nr.32, datë 13.08.2018, është shpallur fitues së bashku me OE òM.ò shpk, në procedurën e prokurimit të zhvilluar nga Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër, me objekt òMirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga Qafë M. ó Fierzë 58 kmò, me fond limit 74,051,762 lekë pa tvsh. Data e lidhjes së kontratës është data 30.07.2018, me kohëzgjatje 24 muaj.

Sa më sipër KVO nuk e ka konstatuar faktin se ky OE ka paraqitur deklaram të rremë në këtë procedurë prokurimi. Mosveprimi i KVO për paraqitjen e deklaramit të rremë, nga ana e OE òSh.A.ò shpk, është në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 47, òS`kualifikimi i ofertuesveò, dhe Neni 13, pika 3.

Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE òM.ò shpk & òSh.A.ò shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar **përdorim të paligjshëm të fondeve publike në vlerën 11,005,963 lekë** dhe ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga: z. R. B., z. Z. Ç. dhe z. R. I..

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.

Ndikimi/efekti: Vendosja e kriteve në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të LPP, përdorim të paligjshëm të fondeve publike në vlerën 11,005,963 lekë.

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Tropojë të merren masa për vendosjen e kriteve të DST në përputhje me objektin e prokurimit si dhe për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të OE që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni në adresën zyrtare të emailit, nga z. H. Ç., znj. V. N., znj. B. I. dhe znj. M. B., si anëtarë të njësisë së prokurimit, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

- Nga autoriteti kontraktor, bashkia Tropojë, nuk është bere e mundur qe urdhri i prokurimit të konfirmohet në degën e thesarit”

-Njësia e prokurimit, arsyeton se: Autoriteti kontraktor ka zbardhur urdhrin e prokurimit,

bazuar ne *VKB nr.187, datë 19.12.2018 “Për miratimin e PBA-së 2019-2021, Buxheti dhe numrit maksimal të punonjësve të bashkisë Tropojë për vitin 2019, si viti i parë i PBA-së 2019-2021*, regjistrin e parashikimeve publike për vitin 2019, date 07.01.2019 nr.18/3 Prot., të dërguar ne degën e thesarit Tropoje. Çdo urdhër prokurimi, në të gjitha procedurat e prokurimit, një kopje është firmosur/miratuar nga Drejtoria Ekonomike për vazhdimin e mëtejshëm te procedurave përkatëse. Përsa i përket procesverbaleve të mbajtura nga komisionet dhe formularët e zhvillimit të procedurës së prokurimit, janë të pa protokolluará .

Arsyetojmë se njësia e prokurimit ka dorëzuar dosjet e të gjitha procedurave të prokurimit me fletë inventari. Përsa i përket konstatimit se *òKërkesa për paraqitjen e aktit te marrjes ne dorëzimò*, është kërkesë e tejkualuar, sipas VKM nr.914, date 29.12.2014, neni 26.

Arsyetojmë se, ky kriter është vendosur ne përputhje me nenin 26 te VKM se mësipërme, pika 6, paragrafi si vijon: Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

-Përsa i përket konstatimit se janë kërkuar një numër prej 16 punonjësish për periudhën korrik 2018 ó dhjetor 2018 dhe pretendimit nga ana juaj *se nuk janë argumentuar me zbërthim te grafikut dhe preventivit te punimeve*,

sqarojmë se në këtë rast dhe në të gjitha rastet, ne si njësi, me anë të procesverbaleve përkatëse dhe në rastin konkret të procesverbalit nr.2, date 22.01.2019 **“Proces-verbal i njësisë së prokurimit për hartimin e dokumenteve të tenderit nr.2”**, kemi bërë argumentimin për çdo kriter të veçantë, në përputhje me natyrën e punimeve, volumin e punimeve dhe afatin e përcaktuar për përfundimin e punimeve.

-*Përsa i përket konstatimit se nuk është kërkuar specialist i fushës së punimeve elektrike, ju sqarojmë se të gjitha punimet elektrike të parashikuara në preventiv, sipas zbërthimit të zërave të punimeve për punëtorinë e kësaj fushe, del 0.5 specialist + punëtor i kësaj fushe. Vendosja e një kriteri të tillë me përqindje kaq të ulët, është i tepërt logjikisht, pasi kriteri plotësohet edhe me kërkesat e licencës dhe punëve të ngjashme (licensimi dëshmon plotësimin e kapaciteteve teknik, duke përfshirë specialistët e fushës dhe kryerjen e punimeve të tilla).*

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se nga AK Bashkia Tropojë, nuk është bërë e mundur që ky urdhër prokurim të konfirmohet në Degën e Thesarit, për të siguruar garancinë e fondeve dhe mos krijimin e vlerave të papaguara në përfundim të kontratës, veprime në kundërshtim me udhëzimin plotësues nr. 1, datë 17.01.2019 të MF *òPër zbatimin e Buxhetit të vitit 2019ò*. Mungesa e vulës së thesarit në urdhër prokurim, tregon që nuk ka fonde në dispozicion nga AK për kryerjen e kësaj procedure prokurimi dhe ngarkon me përgjegjësi drejtorin ekonomik, z. R. I.. **Ky argument nuk merret në konsideratë.**

Përsa i përket argumentimit të kriterëve, komentet e bëra nga ana juaj janë të argumentuara si dhe kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye merren në konsideratë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni në adresën zyrtare të emailit nga z. R. I., z. Z. Ç. dhe z. R. B., si anëtarë të KVO ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në zbatim të kriterëve të vendosur, KVO-ja ka vlerësuar se OE òM.ò shpk, ka paraqitur kontrata qeraje noteriale me anë të së cilës ka marrë me qera mjetet siç edhe i keni theksuar në aktkonstatimin nr.7. KVO në zbatim të nenit 53, pika 4, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 *òPër prokurimin publikò*, i ndryshuar, ka kualifikuar këtë operator

pasi i përmbush kriteret e vendosura në DST. Në lidhje me bilancin, bilancet e paraqitura nga ky OE për vitet 2015 dhe 2016 kanë vulën e organeve tatimore të Drejtorisë Tatimore Kukësë. Në lidhje me faktin se OE Sh.A. shpk i cili është në këtë procedurë prokurimi si bashkim operatorësh nuk ka deklaruar një punë në shtojcën nr.10 sipas buletinit të APP nr.32, datë 13.08.2018, nga ana e KVO nuk ka patur indicie për këtë operator për mos deklarim të kësaj pune në mënyrë që të kryente hetime.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Për plotësimin e kriterit për makineritë OE M. shpk ka paraqitur shtojcën 10 mbi disponimin e makinerive, si dhe ka paraqitur këtë kontratë noteriale si më poshtë vijon:

1-Kontratë noteriale me nr. 513 Rep., dhe 143/1 Kol., të datës 12.02.2019 të lidhur me shoqërinë Gj. K. sh.a, me anë të së cilës ka marrë ndër të tjera me qera 1 kamion me targa TR 8770 L.

Në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 *Për transportet rrugore*, neni 1, 3, 5 dhe Kreut III.1, *Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë*, nenet 41, 42, 43 dhe 44, si dhe Kreut III.2, *Transporti i mallrave për vetë*, nenet 45, 46, dhe 47, bëhet qartësisht ndarja midis këtyre mënyrave të transportit dhe përcaktohet ndalimi i secilës nga mënyrat e transportit pa pajisjen me licencën përkatëse. Në rastet konkrete, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se çertifikata e mjetit të mësipërm të cilin e disponon shoqëria Gj. K. sh.a sipas lejes së qarkullimit, **është specifike dhe e lëshuar vetëm për transport për vetë, për kryerjen e transportit të mallrave me kamion, vetëm për llogari të veprimtarisë së operatorit ekonomik "Gj. K." sh.a.**

Në këtë mënyrë, kryerja e transportit të mallrave nga ana e shoqërisë M. sh.p.k. me kamionin e shoqërisë Gj. K. sh.a do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa licencën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit *Për transportet rrugore* është i ndaluar.

Bilancet e paraqitura nga OE M. shpk për vitet 2015 dhe 2016 nuk janë të certifikuara nga autoritetet përkatëse, me firmë dhe vulë për çdo faqe (përfshirë faqen e parë). Madje në faqen e 3 të bilancit të vitit 2015, kalohet te bilanci i vitit 2014, duke mos ofruar besueshmëri për vërtetësinë e këtyre bilanceve të paraqitura.

Përsa i përket punës së padeklaruar nga ana e OE Sh.A. shpk, është detyrë e KVO të bëjë të gjitha hetimet e nevojshme të dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomikë. Ju sqarohet se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Rikonstruksion rrugë lagjeje "Dardania", Bajram Curri.		
1. Urdhër Prokurimi: nr. 44/1 prot. datë 10.01.2019	3. Hartuesit e D. Tenderit: nr. 44/1 datë 10.01.2019	4. Komisioni i V. Ofertave: nr. 44/2, dt 10.01.2019
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit ðE hapur	H. Ç. ó Inxhinier B. I. ó Juriste M. B. ó Inxhiniere	R. B. ó Kryetar Z. Ç. ó Anëtar R. I. ó Anëtar
5. Fondi Limit (pa tvsh) 16,347,126 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh): 16,288,828 lekë (H. 1shpk &Sh. shpk)	7. Diferenca me fondin limit: (patvsh) 58,298 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 22.02.2019	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender, 3 OE b) Kualifikuar 1 OE, c) Skualifikuar 2 OE
11. Ankimime AK – s'ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK ó	13. Përgjigje Ankesës nga KKP

Titulli i Gjetjes: Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt *Rikonstruksion rrugë lagjeje Dardania*, Bajram Curri, me fond limit **16,347,126 lekë**.

Situata: Nga AK Bashkia Tropojë, nuk është bërë e mundur që ky urdhër prokurimi të konfirmohet në Degën e Thesarit, për të siguruar garancinë e fondeve dhe mos krijimin e vlerave të papaguara në përfundim të kontratës, veprime në kundërshtim me udhëzimin plotësues nr. 1, datë 17.01.2019, të MF *ËPër zbatimin e Buxhetit të vitit 2019*.

Përsa i përket kriterëve të veçanta të vendosura në DST nga njësia e prokurimit rezultojnë se kriteret për kualifikim janë argumentuar, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, *ËPër miratimin e rregullave të prokurimit publik*, nenin 61, *ËHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*, pika 2.

Nga auditimi rezultoi se kanë marrë pjesë 3 OE. Janë s`kualifikuar 2 OE, njëra ngaqë nuk ka paraqitur ofertë dhe OE tjetër pasi ka mangësi në dokumentacion dhe është kualifikuar dhe shpallur fituese oferta me vlerën më të lartë.

Mangësitë e konstatuara në dokumentacionin e BOE të shpallur fitues *ËH. 1.Ë shpk & ËSh.Ë shpk*, me vlerë të ofertës në shumën prej 16,288,828 lekë pa tvsh, janë si më poshtë:

Për plotësimin e kriterit të makinerive OE *ËSh.Ë shpk* ka paraqitur shtojcën 10 *ËMbi disponimin e makinerive* si dhe ka paraqitur disa kontrata noteriale si më poshtë vijon:

1-Kontratë noteriale me nr. 1019 Rep., dhe 308 Kol., të datës 28.04.2011 të lidhur me shoqërinë *ËJ. C.Ë shpk*, me anë të së cilës ndër të tjera ka marrë me qera 1 Asfaltoshtruese me targa 2549.

2-Kontratë noteriale me nr. 1084 Rep., dhe 508 Kol., të datës 27.06.2016 të lidhur me shoqërinë *ËJ. C.Ë shpk*, me anë të së cilës ndër të tjera ka marrë me qera 2 kamiona me targa SR 2857 B dhe AA 078 IL.

3-Kontratë noteriale me nr. 2559 Rep., dhe 983 Kol., të datës 08.11.2018 të lidhur me shoqërinë *ËJ. C.Ë shpk*, me anë të së cilës ndër të tjera ka marrë me qera 2 kamiona me targa AA 413 TK dhe AA 998 IK.

Gjithashtu, data e zhvillimit të tenderit është data 22.02.2019, ndërkohë që certifikata e kontrollit teknik është e vlefshme deri në datën 19.02.2019 për mjetin me targa AA 413 TK.

Në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 *ËPër transportet rrugore*, neni 1, 3, 5 dhe Kreut III.1, *ËTransporti i mallrave me qira dhe për të tretë*, nenet 41, 42, 43 dhe 44, si dhe Kreut III.2, *ËTransporti i mallrave për vetë*, nenet 45, 46, dhe 47, bëhet qartësisht ndarja midis këtyre mënyrave të transportit dhe përcaktohet ndalimi i secilës nga mënyrat e transportit pa pajisjen me licencën përkatëse.

Në rastet konkrete, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se certifikatat e mjeteve të mësipërme të cilat i disponon shoqëria *ËJ. C.Ë shpk* sipas lejeve të qarkullimit, ***janë specifike dhe të lëshuara vetëm për transport për vetë, për kryerjen e transportit të mallrave me kamion, vetëm për llogari të veprimtarisë së operatorit ekonomik "J. C."***

Në këtë mënyrë, kryerja e transportit të mallrave nga ana e shoqërisë *ËSh.Ë sh.p.k.* me kamionët e shoqërisë *ËJ. C.Ë shpk* do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa licencën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit *ËPër transportet rrugore* është i ndaluar.

OE *ËH. 1.Ë shpk*, ka përcaktuar si drejtues teknik të përfshirë në licencën e firmës Ing. D. R. e cila do të jetë e disponueshme për realizimin e kësaj kontrate dhe nuk është e angazhuar në kontrata të tjera.

Ky OE ka lidhur kontratë pune me ing. D. L. R., me nr. 1233 Rep., dhe 364 Kol., datë 07.05.2018 për një afat 5 vjeçar. Në këtë kontratë është parashikuar që paga e ing. D. R. do të jetë 48.000 lekë në muaj, ndërkohë që në listë pagesat e 6 muajve të fundit, rezultojnë se është paguar me pagën prej 40.000 lekë në muaj. Në DST është shprehur qartë rastet e dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kusht për s`kualifikim dhe në këtë rast kontrata me drejtuesin teknik të sipër cituar është e pasaktë dhe e rreme.

Në shtojcën nr.9 mbi disponimin e makinerive, OE *ËH. 1.Ë shpk*, ndër të tjera ka deklaruar se ka në pronësi edhe një ekskavator i blerë në datën 22.02.2017 si dhe dy betoniere për të cilat

ka paraqitur faturat me nr.7, datë 04.03.2010 dhe nr.389 datë 20.06.2011, mjete këto të cilat nuk figurojnë në inventarin e automjeteve, bashkëlidhur pasqyrave financiare të vitit 2018. Sa më sipër KVO nuk e ka konstatuar faktin se ky OE ka paraqitur deklaram të rremë në këtë procedurë prokurimi.

Mosveprimi i KVO për paraqitjen e deklaramit të rremë, nga ana e OE òH. 1.ò shpk, është në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 47, òS`kualifikimi i ofertuesveò, Neni 13, pika 3.

Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE òH. 1.ò shpk & òSh.ò shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar **përdorim të paligjshëm të fondeve publike në vlerën 16,288,828 lekë** dhe ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga: z. R. B., z. Z. Ç. dhe z. R. I..

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.

Ndikimi/Efekti:përdorim të paligjshëm të fondeve publike në vlerën 16,288,828 lekë.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim:Nga ana e bashkisë Tropojë të merren masa për vendosjen e kriterëve të DST në përputhje me objektin e prokurimit si dhe për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të OE që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni në adresën zyrtare të emailit, nga z. H. Ç., znj. V. N., znj. B. I. dhe znj. M. B., si anëtarë të njësisë së prokurimit, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

- *Nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tropoje, nuk është bere e mundur qe urdhri i prokurimit të konfirmohet në degën e thesarit”*

-Njësia e prokurimit, arsyeton se: Autoriteti kontraktor ka zbardhur urdhrin e prokurimit, bazuar ne **VKB nr.187, datë 19.12.2018 “Për miratimin e PBA-së 2019-2021, Buxheti dhe numrit maksimal të punonjësve të bashkisë Tropojë për vitin 2019, si viti i parë i PBA-së 2019-2021,** regjistrin e parashikimeve publike për vitin 2019, date 07.01.2019 nr.18/3 Prot., të dërguar ne degën e thesarit Tropoje. Çdo urdhër prokurimi, në të gjitha procedurat e prokurimit, një kopje është firmosur/miratuar nga Drejtoria Ekonomike për vazhdimin e mëtejshëm te procedurave përkatëse. Përsa i përket procesverbaleve të mbajtura nga komisionet dhe formularët e zhvillimit të procedurës së prokurimit, janë të pa protokolluaraí .

Arsyetojmë se njësia e prokurimit ka dorëzuar dosjet e të gjitha procedurave të prokurimit me fletë inventari. Përsa i përket konstatimit se kërkesat e veçanta për kualifikim nuk janë argumentuar nga ana e NJHDT, por vetëm janë listuar si të tilla, arsyetojmë se në këtë rast dhe në të gjitha rastet, ne si njësi, me anë të procesverbaleve përkatëse dhe në rastin konkret të procesverbalit nr.2, date 22.01.2019 **“Proces-verbal i njësisë së prokurimit për hartimin e dokumentave të tenderit nr.2” (bashkangjitur)**, kemi bere argumentimin për çdo kriter të veçantë, në përputhje me natyrën e punimeve, volumin e punimeve dhe afatin e përcaktuar për përfundimin e punimeve. Përsa i përket konstatimit se òKërkesa për paraqitjen e aktit te marrjes ne dorëzimò, është kërkesë e tejkaluar, sipas VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 26. Arsyetojmë se, ky kriter është vendosur ne përputhje me nenin 26 te VKM se mësipërme, pika 6, paragrafi si vijon: Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

-Përsa i përket konstatimit se janë kërkuar një numër prej 40 punonjësish për periudhën korrik 2018 ó dhjetor 2018 dhe pretendimit nga ana juaj se nuk janë argumentuar me zbërthim te grafikut dhe preventivit te punimeve,

sqarojmë se në këtë rast dhe në të gjitha rastet, ne si njësi, me anë të procesverbaleve përkatëse dhe në rastin konkret të procesverbalit nr.2, date 14.01.2019 “**Proces-verbal i njësish së prokurimit për hartimin e dokumenteve të tenderit nr.2**”, kemi bërë argumentimin për çdo kriter të veçantë, në përputhje me natyrën e punimeve, volumin e punimeve dhe afatin e përcaktuar për përfundimin e punimeve.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se nga AK Bashkia Tropojë, nuk është bërë e mundur që ky urdhër prokurim të konfirmohet në Degën e Thesarit, për të siguruar garancinë e fondeve dhe mos krijimin e vlerave të papaguara në përfundim të kontratës, veprime në kundërshtim me udhëzimin plotësues nr. 1, datë 17.01.2019 të MF *ôPër zbatimin e Buxhetit të vitit 2019*ö. Mungesa e vulës së thesarit në urdhër prokurim, tregon që nuk ka fonde në dispozicion nga AK për kryerjen e kësaj procedure prokurimi dhe ngarkon me përgjegjësi drejtorin ekonomik, z. R. I. **Ky argument nuk merret në konsideratë.**

Përsa i përket argumentimit të kriterëve, komentet e bëra nga ana juaj janë të argumentuara si dhe kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye merren në konsideratë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni në adresën zyrtare të emailit nga z. R. I., z. Z. Ç. dhe z. R. B., si anëtarë të KVO ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në zbatim të kriterëve të vendosur, KVO-ja ka vlerësuar se OE ôSh.ö shpk, ka paraqitur kontrata qeraje noteriale me anë të së cilës ka marrë me qera mjetet siç edhe i keni theksuar në aktkonstatimin nr.7. KVO në zbatim të nenit 53, pika 4, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 ôPër prokurimin publikö,i ndryshuar, ka kualifikuar këtë operator pasi i përmbush kriteret e vendosura në DST. Afatin e certifikatës së kontrollit teknik të mjetit me targa AA 413 TK, që kishte mbaruar 3 ditë para zhvillimit të procedurës, KVO e ka konsideruar devijim të vogël.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Për plotësimin e kriterit të makinerive OE ôSh.ö shpk ka paraqitur shtojcën 10 Mbi disponimin e makineriveø si dhe ka paraqitur disa kontrata noteriale si më poshtë vijon:

1-Kontratë noteriale me nr. 1019 Rep., dhe 308 Kol., të datës 28.04.2011 të lidhur me shoqërinë ôJ. C.ö shpk, me anë të së cilës ndër të tjera ka marrë me qera 1 Asfaltoshtruese me targa 2549.

2-Kontratë noteriale me nr. 1084 Rep., dhe 508 Kol., të datës 27.06.2016 të lidhur me shoqërinë ôJ. C.ö shpk, me anë të së cilës ndër të tjera ka marrë me qera 2 kamiona me targa SR 2857 B dhe AA 078 IL.

3-Kontratë noteriale me nr. 2559 Rep., dhe 983 Kol., të datës 08.11.2018 të lidhur me shoqërinë ôJ. C.ö shpk, me anë të së cilës ndër të tjera ka marrë me qera 2 kamiona me targa AA 413 TK dhe AA 998 IK.

Gjithashtu, data e zhvillimit të tenderit është data 22.02.2019, ndërkohë që certifikata e kontrollit teknik është e vlefshme deri në datën 19.02.2019 për mjetin me targa AA 413 TK.

Në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 ôPër transportet rrugoreö, neni 1, 3, 5 dhe Kreut III.1, ôTransporti i mallrave me qira dhe për të tretëö, nenet 41, 42, 43 dhe 44, si dhe Kreut III.2, ôTransporti i mallrave për veteö, nenet 45, 46, dhe 47, bëhet qartësisht ndarja midis këtyre mënyrave të transportit dhe përcaktohet ndalimi i secilës nga mënyrat e transportit pa pajisjen me licencën përkatëse.

Në rastet konkrete, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se certifikatat e mjeteve të mësipërme të cilat i disponon shoqëria òJ. C.ò shpk sipas lejeve të qarkullimit, **janë specifike dhe të lëshuara vetëm për transport për vete, për kryerjen e transportit të mallrave me kamion, vetëm për llogari të veprimtarisë së operatorit ekonomik "J. C."**. Në këtë mënyrë, kryerja e transportit të mallrave nga ana e shoqërisë òSh.ò sh.p.k. me kamionët e shoqërisë òJ. C.ò shpk do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa licencën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit òPër transportet rrugoreò është i ndaluar.

OE òH. 1.ò shpk, ka përcaktuar si drejtues teknik të përfshirë në licencën e firmës Ing. D. R. e cila do të jetë e disponueshme për realizimin e kësaj kontrate dhe nuk është e angazhuar në kontrata të tjera.

Ky OE ka lidhur kontratë pune me ing. D. L. R., me nr. 1233 Rep., dhe 364 Kol., datë 07.05.2018 për një afat 5 vjeçar. Në këtë kontratë është parashikuar që paga e ing. D. R. do të jetë 48.000 lekë në muaj, ndërkohë që në listë pagesat e 6 muajve të fundit, rezulton se është paguar me pagën prej 40.000 lekë në muaj. Në DST është shprehur qartë rastet e dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kusht për s`kualifikim dhe në këtë rast kontrata me drejtuesin teknik të sipër cituar është e pasaktë dhe e rreme.

Ju sqarohet se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Rikonstruksion rruga auto Lekbibaj – Curraj Eper.		
1. Urdhër Prokurimi: nr. 1503/1 prot. datë 09.05.2019	3. Hartuesit e D. Tenderit: nr. 1503/1 datë 09.05.2019	4. Komisioni i V. Ofertave: nr. 1503/2, datë 09.05.2019
2. Lloji i Procedurës òKërkesë për propozimò	H. Ç. ó Inxhinier V. N. ó Juriste M. B. ó Inxhiniere	R. B. ó Kryetar Z. Ç. ó Anëtar R. I. ó Anëtar
5. Fondi Limit (pa tvsh) 6,666,667 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh): 6,624,188 lekë (H. 1shpk &Sh. shpk)	7. Diferenca me fondin limit: (pa tvsh) 42,479 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 23.05.2019	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender, 3 OE b) Kualifikuar 1 OE, c) Søkualifikuar 2 OE
11. Ankimime AK – s`ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK ó	13. Përgjigje Ankesës nga KKP

Titulli i Gjetjes: Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt òRikonstruksion rruga auto Lekbibaj ó Curraj Eperò, me fond limit **6,666,667 lekë pa tvsh**.

Situata: Nga AK Bashkia Tropojë, nuk është bërë e mundur që ky urdhër prokurimi të konfirmohet në Degën e Thesarit, për të siguruar garancinë e fondeve dhe mos krijimin e vlerave të papaguara në përfundim të kontratës, veprime në kundërshtim me udhëzimin plotësues nr. 1, datë 17.01.2019, të MF òPër zbatimin e Buxhetit të vitit 2019ò.

Përsa i përket kriterëve të veçanta të vendosura në DST nga njësia e prokurimit rezulton se kriteret për kualifikim janë argumentuar, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, nenin 61, òHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitò, pika 2.

Nga auditimi rezultoi se kanë marrë pjesë 3 OE. Janë søkualifikuar 2 OE me ofertat më të ulta për mangësi në dokumentacion dhe është kualifikuar dhe shpallur fituese oferta me vlerën më të lartë.

Mangësitë e konstatuara në dokumentacionin e BOE të shpallur fitues òH. 1.ò shpk & òSh.ò shpk, me vlerë të ofertës në shumën prej 6,624,188 lekë pa tvsh, janë si më poshtë:

OE òH. 1.ò shpk, ka përcaktuar si drejtues teknik të përfshirë në licencën e firmës Ing. D. R. e cila do të jetë e disponueshme për realizimin e kësaj kontrate dhe nuk është e angazhuar në kontrata të tjera.

Ky OE ka lidhur kontratë pune me ing. D. L. R., me nr. 1233 Rep., dhe 364 Kol., datë 07.05.2018 për një afat 5 vjeçar. Në këtë kontratë është parashikuar që paga e ing. D. R. do të jetë 48.000 lekë në muaj, ndërkohë që në listëpagesat e 6 muajve të fundit, rezulton se është paguar me pagën prej 40.000 lekë në muaj. Në DST është shprehur qartë rastet e dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kusht për s`kualifikim dhe në këtë rast kontrata me drejtuesin teknik të sipër cituar është e pasaktë dhe e rreme.

Në shtojcën nr.9 mbi disponimin e makinerive, OE òH. 1.ò shpk, ndër të tjera ka deklaruar se ka në pronësi edhe një ekskavator i blerë në datën 22.02.2017 si dhe dy betoniere për të cilat ka paraqitur faturat me nr.7, datë 04.03.2010 dhe nr.389 datë 20.06.2011, mjete këto të cilat nuk figurojnë në inventarin e automjeteve, bashkëlidhur pasqyrave financiare të vitit 2018. Sa më sipër KVO nuk e ka konstatuar faktin se ky OE ka paraqitur deklaram të rremë në këtë procedurë prokurimi.

Mosveprimi i KVO për paraqitjen e deklaramit të rremë, nga ana e OE òH. 1.ò shpk, është në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 47, òS`kualifikimi i ofertuesveò, neni 13, pika 3.

Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE òH. 1.ò shpk & òSh.ò shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar **përdorim të paligjshëm të fondeve publike në vlerën 6,624,188 lekë** dhe ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga: z. R. B., z. Z. Ç. dhe z. R. I..

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.

Ndikimi/efekti: Vendosja e kriterëve në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të LPP, përdorim të paligjshëm të fondeve publike në vlerën 6,624,188 lekë.

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.

Rëndësia:E lartë.

Rekomandim:Nga ana e bashkisë Tropojë të merren masa për vendosjen e kriterëve të DST në përputhje me objektin e prokurimit si dhe për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të OE që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni në adresën zyrtare të emailit, nga z. H. Ç., znj. V. N., znj. B. I. dhe znj. M. B., si anëtarë të njësisë së prokurimit, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

- Nga autoriteti kontraktor, bashkia Tropoje, nuk është bere e mundur qe urdhri i prokurimit të konfirmohet në degën e thesarit”

-Njësia e prokurimit, arsyeton se: Autoriteti kontraktor ka zbardhur urdhrin e prokurimit, bazuar ne **VKB nr.187, datë 19.12.2018 “Për miratimin e PBA-së 2019-2021, Buxheti dhe numrit maksimal të punonjësve të bashkisë Tropojë për vitin 2019, si viti i parë i PBA-së 2019-2021**, regjistrin e parashikimeve publike për vitin 2019, date 07.01.2019 nr.18/3 Prot., të dërguar ne degën e thesarit Tropoje. Çdo urdhër prokurimi, në të gjitha procedurat e prokurimit, një kopje është firmosur/miratuar nga Drejtoria Ekonomike për vazhdimin e mëtejshëm te procedurave përkatëse. Përsa i përket procesverbaleve të mbajtura nga komisionet dhe formularët e zhvillimit të procedurës së prokurimit, janë të pa protokolluará .

Arsyetojmë se njësia e prokurimit ka dorëzuar dosjet e të gjitha procedurave të prokurimit me fletë inventari. Përsa i përket konstatimit se kërkesat e veçanta për kualifikim nuk janë argumentuar nga ana e NJHDT, por vetëm janë listuar si të tilla, arsyetojmë se në këtë rast dhe në të gjitha rastet, ne si njësi, me anë të procesverbaleve përkatëse dhe në rastin konkret

të procesverbalit nr.2, date 22.01.2019 òProces-verbal i njësisë së prokurimit për hartimin e dokumenteve të tenderit nr.2ö (bashkangjitur),kemi bere argumentimin për çdo kriter të veçantë, në përputhje me natyrën e punimeve, volumin e punimeve dhe afatin e përcaktuar për përfundimin e punimeve. Përsa i përket konstatimit se òKërkesa për paraqitjen e aktit te marrjes ne dorëzimö, është kërkesë e tejkualuar, sipas VKM ne.914, date 29.12.2014, neni 26. Arsyetojmë se, ky kriter është vendosur ne përputhje me nenin 26 te VKM se mësipërme, pika 6, paragrafi si vijon: Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

-Përsa i përket konstatimit se janë kërkuar një numër prej 40 punonjësisish për periudhën korrik 2018 ó dhjetor 2018 dhe pretendimit nga ana juaj se nuk janë argumentuar me zbërthim te grafikut dhe preventivit të punimeve,

sqarojmë se në këtë rast dhe në të gjitha rastet, ne si njësi, me anë të procesverbaleve përkatëse dhe në rastin konkret të procesverbalit nr.2, date 22.01.2019 òProces-verbal i njësisë së prokurimit për hartimin e dokumenteve të tenderit nr.2ö,kemi bërë argumentimin për çdo kriter të veçantë, në përputhje me natyrën e punimeve, volumin e punimeve dhe afatin e përcaktuar për përfundimin e punimeve.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se nga AK Bashkia Tropojë, nuk është bërë e mundur që ky urdhër prokurim të konfirmohet në Degën e Thesarit, për të siguruar garancinë e fondeve dhe mos krijimin e vlerave të papaguara në përfundim të kontratës, veprime në kundërshtim me udhëzimin plotësues nr. 1, datë 17.01.2019 të MF òPër zbatimin e Buxhetit të vitit 2019ö. Mungesa e vulës së thesarit në urdhër prokurim, tregon që nuk ka fonde në dispozicion nga AK për kryerjen e kësaj procedure prokurimi dhe ngarkon me përgjegjësi drejtorin ekonomik, z. R. I. **Ky argument nuk merret në konsideratë.**

Përsa i përket argumentimit të kriterëve, komentet e bëra nga ana juaj janë të argumentuara si dhe kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye merren në konsideratë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni në adresën zyrtare të emailit nga z. R. I., z. Z. Ç. dhe z. R. B., si anëtarë të KVO ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: OE òH. 1.ö shpk, mbi disponimin e makinerive ndër të tjera ka deklaruar në pronësi një eskavator të blerë në datën 22.02.2017 si dhe dy betoniere me faturë, mjete këto të cilat nuk figurojnë në inventarin e automjeteve në pasqyrën financiare të vitit 2018. Në lidhje me këtë ju sqarojmë, se betonjeret nuk kategorizohen te automjetet dhe nuk mund të figurojnë në inventarin e automjeteve por te zëri òpaisje veglaö ku dhe janë të shënuara.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Përsa i përket mjeteve në inventarin e OE òH. 1.ö shpk, fjala është për eskavatorin e blerë me kontratën e datës 22.02.2017 i cili nuk figuron në inventarin. Përveç kësaj, ky OE ka dhe një mangësi tjetër për të cilën ju nuk keni paraqitur argument siç është: OE òH. 1.ö shpk, ka përcaktuar si drejtues teknik të përfshirë në licencën e firmës Ing. D. R. e cila do të jetë e disponueshme për realizimin e kësaj kontrate dhe nuk është e angazhuar në kontrata të tjera.

Ky OE ka lidhur kontratë pune me ing. D. L. R., me nr. 1233 Rep., dhe 364 Kol., datë 07.05.2018 për një afat 5 vjeçar. Në këtë kontratë është parashikuar që paga e ing. D. R. do të jetë 48.000 lekë në muaj, ndërkohë që në listëpagesat e 6 muajve të fundit, rezulton se është paguar me pagën prej 40.000 lekë në muaj. Në DST është shprehur qartë rastet e dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kusht për skualifikim dhe në këtë rast

kontrata me drejtuesin teknik të sipër cituar është e pasaktë dhe e rreme. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Shkolla Asim Vokshi – Palestër dhe terrene sportive dhe sistemime të jashtme në gjimnazin “Asim Vokshi”.		
1. Urdhër Prokurimi: nr. 1269/1 prot. datë 16.04.2019	3. Hartuesit e D. Tenderit: nr. 1269/1 datë 16.04.2019	4. Komisioni i V. Ofertave: nr. 1269/2, datë 16.04.2019
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit òE hapurò	H. Ç. ó Inxhinier V. N. ó Juriste M. B. ó Inxhiniere	R. B. ó Kryetar Z. Ç. ó Anëtar R. I. ó Anëtar
5. Fondi Limit (pa tvsh) 50,319,591 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh): 50,269,533 lekë (4.M shpk)	7. Diferenca me fondin limit: (pa tvsh) 50,058 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 24.05.2019	9. Burimi Financimit Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender, 9 OE b) Kualifikuar 1 OE, c) Søkualifikuar 8 OE
11. Ankimime AK – shkresa nr.1900 prot., datë 25.06.2019	12. Përgjigje Ankesës nga AK ó shkresa 1900/2 prot., datë 27.06.2019	13. Përgjigje Ankesës nga KKP ó Vendimi nr.575/2019, datë 02.09.2019

Titulli i Gjetjes: Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt òShkolla Asim Vokshi ó Palestër dhe terrene sportive dhe sistemime të jashtme në gjimnazin òAsim Vokshiò, me fond limit **50,319,591 lekë pa tvsh.**

Situata: Nga AK Bashkia Tropojë, nuk është bërë e mundur që ky urdhër prokurimi të konfirmohet në Degën e Thesarit, për të siguruar garancinë e fondeve dhe mos krijimin e vlerave të papaguara në përfundim të kontratës, veprime në kundërshtim me udhëzimin plotësues nr. 1, datë 17.01.2019, të MF òPër zbatimin e Buxhetit të vitit 2019ò.

Përsa i përket kriterëve të veçanta të vendosura në DST nga njësia e prokurimit rezultojnë se kriteret për kualifikim janë argumentuar, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, nenin 61, òHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitò, pika 2.

Nga auditimi rezultoi se kanë marrë pjesë 9 OE. Janë søkualifikuar 8 OE me ofertat më të ulta për mangësi në dokumentacion dhe është kualifikuar dhe shpallur fituese oferta me vlerën më të lartë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE të søkualifikuar, rezultojnë se vendimi i KVO për søkualifikimin e ofertës së dytë më të ulët të ofruar nga bashkimi i OE òH. 1.ò shpk & òSh.ò shpk, në shumën prej 42,072,833, nuk është i drejtë.

Ky operator ka marrë pjesë në 2 procedura prokurimi të zhvilluara nga bashkia Tropojë, të cilat janë:

1- *Shkolla Asim Vokshi – Palestër dhe terrene sportive dhe sistemime të jashtme në gjimnazin “Asim Vokshi – të zhvilluar në datën 24.05.2019, me vlerë të fondit limit në shumën prej 50,319,591 lekë pa tvsh.*

2- *Rikonstruksion i shkollës “Tinka Kurti”, Lekbibaj, të zhvilluar në datën 27.05.2019, me fond limit në shumën prej 24,879,202 lekë pa tvsh.*

Në të dyja këto procedura, përbërja e KVO është e njëjtë dhe argumenti i përdorur prej tyre për søkualifikimin e BOE òH. 1.ò shpk & òSh.ò shpk nuk qëndron pasi ky bashkim operatorësh ka marrë pjesë fillimisht në këtë procedurë prokurimi dhe më pas në procedurën për rikonstruksionin e shkollës Tinka Kurti e cila është zhvilluar 3 ditë më vonë. Për këtë arsye, drejtuesi teknik, manovratorët dhe makineritë nuk janë të përfshira në kontrata të tjera, duke qenë se në kohën e hapjes së ofertave të kësaj procedure, nuk ishte zhvilluar akoma

procedura tjetër dhe ky bashkim operatorësh drejtuesin teknik, makineritë dhe manovratorët nuk i ka pasur të përfshirë në kontrata të tjera.

Mangësitë e konstatuara në dokumentacionin e OE të shpallur fitues 04.Mö shpk, me vlerë të ofertës në shumën prej 50,269,533 lekë pa tvsh, janë si më poshtë:

Për plotësimin e kriterit për makineritë OE 04.Mö shpk ka paraqitur shtojcën 10 Mbi disponimin e makinerive si dhe ka paraqitur disa kontrata noteriale si më poshtë vijon:

1-Kontratë noteriale me nr. 3386 Rep., dhe 634/1 Kol., të datës 20.05.2019 të lidhur me shoqërinë 0M. 2ö shpk, me anë të së cilës ka marrë me qira 2 kamionë me targa TR 9042 D dhe TR 4121 F.

Në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 *0Për transportet rrugore*, neni 1, 3, 5 dhe Kreut III.1, *0Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë*, nenet 41, 42, 43 dhe 44, si dhe Kreut III.2, *0Transporti i mallrave për vete*, nenet 45, 46, dhe 47, bëhet qartësisht ndarja midis këtyre mënyrave të transportit dhe përcaktohet ndalimi i secilës nga mënyrat e transportit pa pajisjen me licencën përkatëse.

Në rastet konkrete, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se certifikatat e mjeteve të mësipërme të cilat i disponon shoqëria 0M. 2ö shpk sipas lejeve të qarkullimit, **janë specifike dhe të lëshuara vetëm për transport për vete, për kryerjen e transportit të mallrave me kamion, vetëm për llogari të veprimtarisë së operatorit ekonomik "M. 2" shpk.**

Në këtë mënyrë, kryerja e transportit të mallrave nga ana e shoqërisë 04.Mö sh.p.k. me kamionët e shoqërisë 0M. 2ö shpk do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa licencën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit *0Për transportet rrugore* është i ndaluar.

Gjithashtu ka paraqitur edhe këtë kontratë noteriale si më poshtë vijon:

1-Kontratë noteriale me nr. 3388 Rep., dhe 636/1 Kol., të datës 20.05.2019 të lidhur me shoqërinë 0S. E.ö shpk, me anë të së cilës ka marrë me qira 1 vinq eskavator.

Dokumentacioni bashkëngjitur që provon pronësinë e këtij mjete nga ana e OE 0S. E.ö shpk, është fatura e zhdoganimit, e cila në sistemin elektronik është e palexueshme.

Nuk ka deklaruar në shtojcën nr 8 *0Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të gjithë personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluesbrenda operatorit ekonomik, drejtuesin teknik M. L..*

Në auditimin e procedurës me objekt *0Shkolla Asim Vokshi 0 Palestër dhe terrene sportive dhe sistemime të jashtme në gjimnazin 0Asim Vokshiö*, zhvilluar në vitin 2019, me fond limit 50,319,591 lekë pa TVSh, nga KVO është kualifikuar dhe propozuar për tu shpallur fitues OE 04.Mö ShPK, me vlerën më të lartë të ofertës ekonomike prej 50,269,533 lekë pa TVSh, i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në DST dhe është ofertë më e lartë se vlera e ofertës së skualifikuar padrejtësisht.

Nga KVO është skualifikuar padrejtësisht oferta me vlerë 42,072,833 lekë pa TVSh, e paraqitur nga BOE 0H. 1.ö shpk & 0Sh.ö ShPK, e cila ka një vlerë prej 8,196,700 lekë më të ulët se vlera e OE 04.Mö ShPK të shpallur padrejtësisht fitues. Veprimet e mësipërme kanë shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **8,196,700 lekë**, si diferencë midis dy ofertave dhe ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga: z. R. B., z. Z. Ç. dhe z. R. I..

Kriteri: ligji nr.9643, datë 20.11.2006 *0Për prokurimin publikö*, i ndryshuar, neni 1 *0Objekti dhe qëllimiö* pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 *0Parimet e përzgjedhjesö* germa (a), (b) dhe (c), me nenin 46 *0Kualifikimi i ofertuesveö*, nenin 53 *0Shqyrtimi i ofertaveö* dhe nenin 55 *0Kriteret e përcaktimit të ofertës fitueseö*.

Ndikimi/efekti: mos zbatimi i kuadrit rregullator në fuqi për vlerësimin dhe kualifikimin e ofertave ka shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 8,196,700 lekë.

Shkaku: Moszbatimi nga KVO i akteve ligjore e nënligjore të LPP.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Tropojë, të analizojë shkaqet që kanë çuar në kualifikimin e padrejtë të OE 04.Mö ShPK, dhe në squalifikimin e padrejtë të BOE 0H. 1.ö shpk & 0Sh.ö ShPK, me ofertë më të ulët, veprime të cilat kanë shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 8,196,700 lekë. Të ndjek të gjitha procedurat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës 8,196,700 lekë nga anaëtarët e KVO.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni në adresën zyrtare të emailit, nga z. H. Ç., znj. V. N., znj. B. I. dhe znj. M. B., si anëtarë të njësisë së prokurimit, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

- Nga autoriteti kontraktor, bashkia Tropojë, nuk është bërë e mundur që urdhri i prokurimit të konfirmohet në degën e thesarit”

Njësia e prokurimit, arsyeton se: Autoriteti kontraktor ka zbardhur urdhrin e prokurimit, bazuar në VKM nr.2, datë 27.3.2019 “për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja e parë për vitin 2019, grantet “arsimi bazë”, “arsimi i mesëm”, regjistrin e parashikimeve publike për vitin 2019, date 22.05.2019 nr.18/4 Prot., te dërguar ne degën e thesarit Tropojë. Çdo urdhër prokurimi, ne te gjitha procedurat e prokurimit, një kopje është firmosur/miratuar nga Drejtoria Ekonomike për vazhdimin e mëtejshëm te procedurave përkatëse. Përsa i përket procesverbaleve të mbajtura nga komisionet dhe formularët e zhvillimit të procedurës së prokurimit, janë të pa protokolluará .

Arsyetojmë se njësia e prokurimit ka dorëzuar dosjet e të gjitha procedurave të prokurimit me fletë inventari. Përsa i përket konstatimit se kërkesat e veçanta për kualifikim nuk janë argumentuar nga ana e NJHDT, por vetëm janë listuar si të tilla, arsyetojmë se në këtë rast dhe në të gjitha rastet, ne si njësi, me anë të procesverbaleve përkatëse dhe në rastin konkret të procesverbalit nr.2, date 19.04.2019 0Proces-verbal i njësisë së prokurimit për hartimin e dokumentave të tenderit nr.2ö (bashkangjitur), kemi bere argumentimin për çdo kriter të veçantë, në përputhje me natyrën e punimeve, volumin e punimeve dhe afatin e përcaktuar për përfundimin e punimeve. Përsa i përket konstatimit se 0Kërkesa për paraqitjen e aktit te marrjes ne dorëzimö, është kërkesë e tejkualuar, sipas VKM nr. 914, date 29.12.2014, neni 26. Arsyetojmë se, ky kriter është vendosur ne përputhje me nenin 26 te VKM se mësipërme, pika 6, paragrafi si vijon: Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

-Përsa i përket konstatimit se janë kërkuar një numër prej 80 punonjësish për periudhën tetor 2018 ó prill 2019 dhe pretendimit nga ana juaj se nuk janë argumentuar me zbërthim te grafikut dhe preventivit të punimeve,

sqarojmë se në këtë rast dhe në të gjitha rastet, ne si njësi, me anë të procesverbaleve përkatëse dhe në rastin konkret të procesverbalit nr.2, date 19.04.2019 0Proces-verbal i njësisë së prokurimit për hartimin e dokumenteve të tenderit nr.2ö,kemi bërë argumentimin për çdo kriter të veçantë, në përputhje me natyrën e punimeve, volumin e punimeve dhe afatin e përcaktuar për përfundimin e punimeve.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se nga AK Bashkia Tropojë, nuk është bërë e mundur që ky urdhër prokurim të konfirmohet në Degën e Thesarit, për të siguruar garancinë e fondeve dhe mos krijimin e vlerave të papaguara në përfundim të kontratës, veprime në kundërshtim me udhëzimin plotësues nr. 1, datë 17.01.2019 të MF 0Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2019ö. Mungesa e vulës së thesarit në urdhër prokurim, tregon që nuk ka fonde në dispozicion nga AK për kryerjen e kësaj procedure prokurimi dhe ngarkon me përgjegjësi drejtorin ekonomik, z. R. I. **Ky argument nuk merret në konsideratë.**

Përsa i përket argumentimit të kriterëve, komentet e bëra nga ana juaj janë të argumentuara si dhe kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye merren në konsideratë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni në adresën zyrtare të e-mailit nga z. R. I., z. Z. Ç. dhe z. R. B., si anëtarë të KVO ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me s̄kualifikimin e BOE òH. 1.ò shpk & òSh.ò shpk, pavarësisht se procedura òRikonstruksion i shkollës Tinka Kurtiò, është zhvilluar më datë 27.05.2019, pra tre ditë pasi ishte hapur kjo procedurë prokurimi, për arsye të ankimit të kësaj procedure, vlerësimi për procedurën e shkollës òTinka Kurtiò është mbyllur me datën 11.06.2019 dhe në datën 27.06.2019 ka lidhur kontratë me bashkinë Tropojë. Në kohën kur KPP doli me vendimin nr.575/2019, datë 02.09.2019, protokolluar në bashkinë Tropojë me nr. 2595 prot., datë 06.09.2019, me anë të së cilës KPP ka rrëzuar ankesën e paraqitur nga OE òKevin Konstruksionò shpk, për këtë procedurë prokurimi, BOE òH. 1.ò shpk & òSh.ò shpk, kishte lidhur kontratën me bashkinë Tropojë dhe s̄kualifikimi i tij ishte i drejtë nga ana e KVO.

Përsa i përket OE ò4.Mò shpk të shpallur fitues, KVO-ja ka vlerësuar se ky OE, ka paraqitur kontrata qeraje noteriale me anë të së cilës ka marrë me qera mjetet siç edhe i keni theksuar në aktkonstatimin nr.7. KVO në zbatim të nenit 53, pika 4, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò,i ndryshuar, ka kualifikuar këtë operator pasi i përmbush kriteret e vendosura në DST.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në këtë procedurë prokurimi KVO e ka shkelur afatin e përcaktuar në nenin 66, òShqyrtimi dhe vlerësimi i ofertaveò pika 2, të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, ku përcaktohet se: òkohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë 15 ditë, përveç rasteve të tjera të cilësuar ndryshe në këto rregullaò. S̄kualifikimi i BOE òH. 1.ò shpk & òSh.ò shpk nuk qëndron pasi ky bashkim operatorësh ka marrë pjesë fillimisht në këtë procedurë prokurimi dhe më pas në procedurën për rikonstruksionin e shkollës Tinka Kurti e cila është zhvilluar 3 ditë më vonë. Për këtë arsye, drejtuesi teknik, manovratorët dhe makineritë nuk janë të përfshira në kontrata të tjera, duke qenë se në kohën e hapjes së ofertave të kësaj procedure, nuk ishte zhvilluar akoma procedura tjetër dhe ky bashkim operatorësh drejtuesin teknik, makineritë dhe manovratorët nuk i ka pasur të përfshirë në kontrata të tjera.

Në lidhje me OE ò4.Mò shpk të shpallur fitues, ka paraqitur shtojcën 10 -Mbi disponimin e makineriveò si dhe ka paraqitur disa kontrata noteriale si më poshtë vijon:

1-Kontratë noteriale me nr. 3386 Rep., dhe 634/1 Kol., të datës 20.05.2019 të lidhur me shoqërinë òM. 2ò shpk, me anë të së cilës ka marrë me qera 2 kamiona me targa TR 9042 D dhe TR 4121 F.

Në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 òPër transportet rrugoreò, neni 1, 3, 5 dhe Kreut III.1, òTransporti i mallrave me qira dhe për të tretëò, nenet 41, 42, 43 dhe 44, si dhe Kreut III.2, òTransporti i mallrave për veteò, nenet 45, 46, dhe 47, bëhet qartësisht ndarja midis këtyre mënyrave të transportit dhe përcaktohet ndalimi i secilës nga mënyrat e transportit pa pajisjen me licencën përkatëse.

Në rastet konkrete, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se certifikatat e mjeteve të mësipërme të cilat i disponon shoqëria òM. 2ò shpk sipas lejeve të qarkullimit, **janë specifike dhe të lëshuara vetëm për transport për vete, për kryerjen e transportit të mallrave me kamion, vetëm për llogari të veprimtarisë së operatorit ekonomik “M. 2” shpk.**

Në këtë mënyrë, kryerja e transportit të mallrave nga ana e shoqërisë ò4.Mò sh.p.k. me kamionët e shoqërisë òM. 2ò shpk do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave

me qira dhe për të tretë pa liçencën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit *“Për transportet rrugore”* është i ndaluar.

1-Kontrata noteriale me nr. 3388 Rep., dhe 636/1 Kol., të datës 20.05.2019 të lidhur me shoqërinë *“S. E.ö shpk”*, me anë të së cilës ka marrë me qera 1 vinç eskavator.

Dokumentacioni bashkëngjitur që provon pronësinë e këtij mjeti nga ana e OE *“S. E.ö shpk”*, është fatura e zhdoganimit, e cila në sistemin elektronik është e palexueshme.

Ndërkohë nuk jeni shprehur edhe për mangësinë tjetër të këtij OE si më poshtë: nuk ka deklaruar në shtojcën nr 8 *“Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të gjithë personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, drejtuesin teknik M. L..”* Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga operatori ekonomik “4.M” shpk., është paraqitur observacioni në adresën zyrtare të emailit në datën 27.07.2021, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i operatorit ekonomik “4.M” shpk: argumentojmë se KVO ka vepruar drejtë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi pasi procedura e prokurimit me objekt *“Shkolla Asim Vokshi, Palestër dhe terrene sportive dhe sistemime të jashtme në gjimnazin Asim Vokshi”* është zhvilluar me datë 24.05.2019.

Procedura e prokurimit me objekt *“Rikonstruksion i shkollës Tinka Kurti, Lekbibajë”* është zhvilluar me datë 27.05.2019.

Vlerësimi i ofertave për *“Rikonstruksion i shkollës Tinka Kurti, Lekbibajë”* është realizuar me datë 11.06.2019.

Ndërkohë që vlerësimi i ofertave për procedurën e prokurimit me objekt *“Shkolla Asim Vokshi, Palestër dhe terrene sportive dhe sistemime të jashtme në gjimnazin Asim Vokshi”* është realizuar më datë 18.06.2019, pra 1 (një) javë pas vlerësimit të procedurës tjetër dhe për më tepër që ky operator aty është operator i vetëm i kualifikuar dhe potencialisht fitues duke qenë se nuk është paraqitur asnjë ankesë për këtë procedurë pra (Rikonstruksionin e shkollës *“Tinka Kurti”* Lekbibajë). Në këtë kuptim autoriteti kontraktor nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale por të analizojë në themel kapacitetet e ofertuesit në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilat vendosen kriteret e përcaktuara.

Lidhur me kualifikimin e OE *“4.M”* shpk

Në lidhje me mosdeklarimin në shtojcën nr 8 *“Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të gjithë personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, drejtuesin teknik M. L..”*

Z. M. L. është emëruar më datë 16.01.2019 me vendim të Ortakut të Vetëm të shoqërisë në detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë për transport kombëtar dhe ndërkombëtar të mallrave, sikurse rezulton edhe në dokumentacionin përkatës, bashkëlidhur ekstraktit historik të shoqërisë lehtësisht të aksesueshëm pranë QKB).

Përsa i përket makinerive të marra me qera nga shoqëria *“M. 2ö shpk”*, theksojmë se shoqëria *“4.M”* shpk është e licensuar për transport mallrash për të tretë dhe me qera në transportin kombëtar dhe ndërkombëtar me nr. LN-9200-02-2015 dhe si rrjedhim kryerja e transportit të mallrave nga ana e shoqërisë tonë me kamionët e shoqërisë *“M. 2ö shpk”* do të jetë në përputhje me kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë në respektim të ligjit *“Për transportet rrugore”* dokument ky lehtësisht i aksesueshëm pranë QKB (por nuk është paraqitur gjatë procedurës së prokurimit pasi nuk ka qenë obligim i parashikuar në kërkesat për kualifikim të dokumentave të tenderit).

Përsa i përket kontratës noteriale me nr. 3388 Rep., dhe 636/1 Kol., të datës 20.05.2019 të lidhur me shoqërinë òS. E.ò shpk, po ju vëmë sërish në dispozicion faturën e zhdoganimit e cila është e datës 01.07.2009.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në këtë procedurë prokurimi KVO e ka shkelur afatin e përcaktuar në nenin 66, òShqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave pika 2, të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, ku përcaktohet se: òkohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë 15 ditë, përveç rasteve të tjera të cilësuar ndryshe në këto rregullaò. Fillimisht KVO duhej të kishte bërë vlerësimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi brenda 15 ditësh, pra në datën 08.06.2019 (dhe jo në datën 18.06.2019, 25 ditë pas zhvillimit të procedurës), dhe më pas në datën 11.06.2019 të bënte vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit òRikonstruksion i shkollës Tinka Kurti, Lekbibajò. Sòkualifikimi i BOE òH. 1.ò shpk & òSh.ò shpk nuk qëndron pasi ky bashkim operatorësh ka marrë pjesë fillimisht në këtë procedurë prokurimi dhe më pas në procedurën për rikonstruksionin e shkollës Tinka Kurti e cila është zhvilluar 3 ditë më vonë.

Për këtë arsye, drejtuesi teknik, manovratorët dhe makineritë nuk janë të përfshira në kontrata të tjera, duke qenë se në kohën e hapjes së ofertave të kësaj procedure, nuk ishte zhvilluar akoma procedura tjetër dhe ky bashkim operatorësh drejtuesin teknik, makineritë dhe manovratorët nuk i ka pasur të përfshirë në kontrata të tjera.

Në lidhje me makineritë e marra me qera:

Në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 òPër transportet rrugoreò, neni 1, 3, 5 dhe Kreut III.1, òTransporti i mallrave me qira dhe për të tretëò, nenet 41, 42, 43 dhe 44, si dhe Kreut III.2, òTransporti i mallrave për veteò, nenet 45, 46, dhe 47, bëhet qartësisht ndarja midis këtyre mënyrave të transportit dhe përcaktohet ndalimi i secilës nga mënyrat e transportit pa pajisjen me licencën përkatëse.

Në rastet konkrete, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se certifikatat e mjeteve të mësipërme të cilat i disponon shoqëria òM. 2ò shpk sipas lejeve të qarkullimit, **janë specifike dhe të lëshuara vetëm për transport për vete, për kryerjen e transportit të mallrave me kamion, vetëm për llogari të veprimtarisë së operatorit ekonomik “M. 2” shpk.**

Në këtë mënyrë, kryerja e transportit të mallrave nga ana e shoqërisë ò4.Mò sh.p.k. me kamionët e shoqërisë òM. 2ò shpk do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa licencën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit òPër transportet rrugoreò është i ndaluar.

Në lidhje me kontratën noteriale me nr. 3388 Rep., dhe 636/1 Kol., të datës 20.05.2019 të lidhur me shoqërinë òS. E.ò shpk, me anë të së cilës ka marrë me qera 1 vinç eskavator.

Dokumentacioni bashkëngjitur që provon pronësinë e këtij mjete nga ana e OE òS. E.ò shpk, është fatura e zhdoganimit, e cila në sistemin elektronik është e palexueshme. Dokumenti përveç se është i palexueshëm në sistemin elektronik, është i datës 01.07.2009, pra 10 vite para zhvillimit të kësaj procedure dhe nuk ka asnjë dokument tjetër që të provojë se shoqëria òS. E.ò vazhdon ta ketë në pronësinë e saj këtë mjet.

Gjithashtu nuk merret parasysh mungesa e deklarimit në shtojcën nr 8 òDeklaratë mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme të gjithë personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, drejtuesin teknik M. L..

Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Punime ndërtimore shkolla e fshatit Shoshan dhe Margegaj, Nj. Ad. Margegaj; Buçaj, Aste dhe Kovaç, Nj. Ad. Tropojë Fshat.
--

1. Urdhër Prokurimi: nr. 343/1 prot. datë 04.02.2019	3. Hartuesit e D. Tenderit: nr. 343/1 datë 04.02.2019	4. Komisioni i V. Ofertave: nr. 343/2, dt 04.02.2019
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit ōKërkesë për propozimō	H. Ç. ō Inxhinier V. N. ō Juriste M. B. ō Inxhinier	R. B. ō Kryetar Z. Ç. ō Anëtar R. I. ō Anëtar
5. Fondi Limit (pa tvsh) 2,032,082 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh): 2,022,394 lekë (V. shpk)	7. Diferenca me fondin limit: (patvsh) 9,688 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 25.02.2019	9. Burimi Financimit Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender, 2 OE b) Kualifikuar 1 OE, c) S̄kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK – s'ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK ō	13. Përgjigje Ankesës nga KKP

Titulli i Gjetjes: Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt ōPunime ndërtimore shkolla e fshatit Shoshan dhe Margegaj, Nj. Ad. Margegaj, Buçaj, Aste dhe Kovaç, Nj. Ad. Tropojë fshatō, me fond limit **2,032,082 lekë pa tvsh**.

Situata: Nga AK Bashkia Tropojë, nuk është bërë e mundur që ky urdhër prokurimi të konfirmohet në Degën e Thesarit, për të siguruar garancinë e fondeve dhe mos krijimin e vlerave të papaguara në përfundim të kontratës, veprime në kundërshtim me udhëzimin plotësues nr. 1, datë 17.01.2019, të MF ōPër zbatimin e Buxhetit të vitit 2019ō.

Përsa i përket kriterëve të veçanta të vendosura në DST nga njësia e prokurimit rezultojnë kriteret për kualifikim janë argumentuar, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ōPër miratimin e rregullave të prokurimit publikō, nenin 61, ōHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitō, pika 2.

Nga auditimi rezultoi se kanë marrë pjesë 2 OE. Është s̄kualifikuar 1 OE pasi nuk ka paraqitur ofertë dhe është kualifikuar dhe shpallur fituese oferta tjetër.

Mangësitë e konstatuara në dokumentacionin e OE të shpallur fitues ōV.ō shpk, me vlerë të ofertës në shumën prej 2,022,394 lekë pa tvsh, janë si më poshtë:

OE ōV.ō shpk, ndër të tjera ka përcaktuar si drejtues teknik të përfshirë në licencën e firmës Ing. R. K., i cili do të jetë i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate dhe nuk është i angazhuar në kontrata të tjera.

Ky OE ka lidhur kontratë pune me ing. R. K., me nr. 127 Rep., dhe 56 Kol., datë 05.03.2018 për një afat 1 vjeçar. Në këtë kontratë është parashikuar që paga e ing. R. K. do të jetë 45.000 lekë në muaj, ndërkohë që në listë pagesat e 6 muajve të fundit, rezultojnë se është paguar me pagën prej 24.000 lekë në muaj. Në DST është shprehur qartë rastet e dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kusht për s̄kualifikim dhe në këtë rast kontrata me drejtuesin teknik të sipër cituar është e pasaktë dhe e rreme.

Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e OE ōV.ō shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar **përdorim të paligjshëm të fondeve publike në vlerën 2,022,394 lekë** dhe ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga: z. R. B., z. Z. Ç. dhe z. R. I.

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.

Ndikimi/efekti: Vendosja e kriterëve në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të LPP përdorim të paligjshëm të fondeve publike në vlerën 2,022,394 lekë.

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Tropojë të merren masa për vendosjen e kriterëve të DST në përputhje me objektin e prokurimit si dhe për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të OE që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni në adresën zyrtare të emailit, nga z. H. Ç., znj. V. N., znj. B. I. dhe znj. M. B., si anëtarë të njësisë së prokurimit, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

- Nga autoriteti kontraktor, bashkia Tropojë, nuk është bërë e mundur që urdhri i prokurimit të konfirmohet në degën e thesarit”

-Njësia e prokurimit, arsyeton se: Autoriteti kontraktor ka zbardhur urdhrin e prokurimit, bazuar ne **VKB nr.187, datë 19.12.2018 “Për miratimin e PBA-së 2019-2021, Buxheti dhe numrit maksimal të punonjësve të bashkisë Tropojë për vitin 2019, si viti i parë i PBA-së 2019-2021,** regjistrin e parashikimeve publike për vitin 2019, date 07.01.2019 nr.18/3 Prot., të dërguar ne degën e thesarit Tropoje. Çdo urdhër prokurimi, në të gjitha procedurat e prokurimit, një kopje është firmosur/miratuar nga Drejtoria Ekonomike për vazhdimin e mëtejshëm te procedurave përkatëse. Përsa i përket procesverbaleve të mbajtura nga komisionet dhe formularët e zhvillimit të procedurës së prokurimit, janë të pa protokolluará .

Arsyetojmë se njësia e prokurimit ka dorëzuar dosjet e të gjitha procedurave të prokurimit me fletë inventari. Përsa i përket konstatimit se kërkesat e veçanta për kualifikim nuk janë argumentuar nga ana e NJHDT, por vetëm janë listuar si të tilla, arsyetojmë se në këtë rast dhe në të gjitha rastet, ne si njësi, me anë të procesverbaleve përkatëse dhe në rastin konkret të procesverbalit nr.2, date 19.04.2019 òProces-verbal i njësisë së prokurimit për hartimin e dokumenteve të tenderit nr.2ö (bashkangjitur), kemi bere argumentimin për çdo kriter të veçantë, në përputhje me natyrën e punimeve, volumin e punimeve dhe afatin e përcaktuar për përfundimin e punimeve. Përsa i përket konstatimit se òKërkesa për paraqitjen e aktit te marrjes ne dorëzimö, është kërkesë e tejkualuar, sipas VKM nr.914, date 29.12.2014, neni 26.

Arsyetojmë se, ky kriter është vendosur ne përputhje me nenin 26 te VKM se mësipërme, pika 6, paragrafi si vijon: Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

-Përsa i përket konstatimit se janë kërkuar një numër prej 15 punonjësish për periudhën korrik 2018 ó dhjetor 2018 dhe pretendimit nga ana juaj *se nuk janë argumentuar me zbërthim te grafikut dhe preventivit të punimeve,*

sqarojmë se në këtë rast dhe në të gjitha rastet, ne si njësi, me anë të procesverbaleve përkatëse dhe në rastin konkret të procesverbalit nr.2, date 22.01.2019 òProces-verbal i njësisë së prokurimit për hartimin e dokumenteve të tenderit nr.2ö,kemi bërë argumentimin për çdo kriter të veçantë, në përputhje me natyrën e punimeve, volumin e punimeve dhe afatin e përcaktuar për përfundimin e punimeve.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se nga AK Bashkia Tropojë, nuk është bërë e mundur që ky urdhër prokurim të konfirmohet në Degën e Thesarit, për të siguruar garancinë e fondeve dhe mos krijimin e vlerave të papaguara në përfundim të kontratës, veprime në kundërshtim me udhëzimin plotësues nr. 1, datë 17.01.2019 të MF òPër zbatimin e Buxhetit të vitit 2019ö. Mungesa e vulës së thesarit në urdhër prokurim, tregon që nuk ka fonde në dispozicion nga AK për kryerjen e kësaj procedure prokurimi dhe ngarkon me përgjegjësi drejtorin ekonomik, z. R. I..

Ky argument nuk merret në konsideratë.

Përsa i përket argumentimit të kriterëve, komentet e bëra nga ana juaj janë të argumentuara si dhe kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye merren në konsideratë.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rikonstrukcion i shkollës Tinka Kurti, Lekbibaj.

1. Urdhër Prokurimi: nr. 8/1 prot. datë 18.04.2019	3. Hartuesit e D. Tenderit: nr. 8/1 datë 18.04.2019	4. Komisioni i V. Ofertave: nr. 8/2, datë 18.04.2019
2.Lloji i Procedurës së Prokurimit òE hapurò	H. Ç. ó Inxhinier V. N. ó Juriste M. B. ó Inxhiniere	R. B. ó Kryetar Z. Ç. ó Anëtar R. I. ó Anëtar
5. Fondi Limit (pa tvsh) 24,879,202 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh): 18,680,967 lekë (H. 1shpk &Sh. shpk)	7. Diferenca me fondin limit: (pa tvsh) 6,198,235 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 27.05.2019	9. Burimi Financimit Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender, 6 OE b) Kualifikuar 2 OE, c) S`kualifikuar 4 OE
11. Ankimime AK – s`ka	12.PërgjigjeAnkesës nga AK ó	13. Përgjigje Ankesës nga KKP

Titulli i Gjetjes: Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt òRikonstruksion i shkollës Tinka Kurti, Lekbibajò, me fond limit **24,879,202lekë**.

Situata: Nga AK Bashkia Tropojë, nuk është bërë e mundur që ky urdhër prokurimi të konfirmohet në Degën e Thesarit, për të siguruar garancinë e fondeve dhe mos krijimin e vlerave të papaguara në përfundim të kontratës, veprime në kundërshtim me udhëzimin plotësues nr. 1, datë 17.01.2019, të MF òPër zbatimin e Buxhetit të vitit 2019”.

Përsa i përket kriterëve të veçanta të vendosura në DST nga njësia e prokurimit rezultojnë se kriteret për kualifikim janë argumentuar, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, nenin 61, òHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitò, pika 2.

Nga auditimi rezultoi se kanë marrë pjesë 6 OE. Janë s`kualifikuar 5 OE për mangësi në dokumentacion dhe është kualifikuar dhe shpallur fituese oferta me vlerën më të ulët.

Mangësitë e konstatuara në dokumentacionin e BOE të shpallur fitues òH. 1.ò shpk & òSh.ò shpk, me vlerë të ofertës në shumën prej 18,680,967 lekë pa tvsh, janë si më poshtë:

OE òH. 1.ò shpk, nuk ka deklaruar në shtojcën nr. 1/1 òDeklaratë për paraqitje oferte të pavarur në pikën 6 të saj nëse e ka paraqitur ofertën në mënyrë të pavarur sipas pikës 6.a apo pikës 6.b të saj duke e lënë të paqartë mënyrën e ofertimit.

OE òH. 1.ò shpk, ka përcaktuar si drejtues teknik të përfshirë në licencën e firmës Ing. D. R. e cila do të jetë e disponueshme për realizimin e kësaj kontrate dhe nuk është e angazhuar në kontrata të tjera.

Ky OE ka lidhur kontratë pune me ing. D. L. R., me nr. 1233 Rep., dhe 364 Kol., datë 07.05.2018 për një afat 5 vjeçar. Në këtë kontratë është parashikuar që paga e ing. D. R. do të jetë 48.000 lekë në muaj, ndërkohë që në listë pagesat e 6 muajve të fundit, rezultojnë se është paguar me pagën prej 40.000 lekë në muaj. Në DST është shprehur qartë rastet e dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kusht për s`kualifikim dhe në këtë rast kontrata me drejtuesin teknik të sipër cituar është e pasaktë dhe e rreme.

Në shtojcën nr.9 mbi disponimin e makinerive, OE òH. 1.ò shpk, ndër të tjera ka deklaruar se ka në pronësi edhe një eskavator i blerë në datën 22.02.2017 si dhe dy betoniere për të cilat ka paraqitur faturat me nr.7, datë 04.03.2010 dhe nr.389 datë 20.06.2011, mjete këto të cilat nuk figurojnë në inventarin e automjeteve, bashkëlidhur pasqyrave financiare të vitit 2018. Sa më sipër KVO nuk e ka konstatuar faktin se ky OE ka paraqitur deklaram të rremë në këtë procedurë prokurimi. Mosveprimi i KVO për paraqitjen e deklaramit të rremë, nga ana e OE òH. 1.ò shpk, është në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 47, òS`kualifikimi i ofertuesveò, neni 13, pika 3.

OE òSh.ò shpk, në shtojcën nr. 1/1 òDeklaratë për paraqitje oferte të pavarur në pikën 6 të saj nëse e ka paraqitur ofertën në mënyrë të pavarur sipas pikës 6.a apo pikës 6.b të saj, ka zgjedhur pikën a. të saj dhe jo pikën b (në rastet e bashkimit të OE).

OE òSh.ò shpk për plotësimin e këtij kriteri ka paraqitur këto kontrata:

1-Kontrata e lidhur me bashkinë Mallakastër, me nr.1045, datë 05.06.2017, me objekt òRikonstruksion dhe shtesë kati në ndërtesën e Bashkisë, me vlerë 57,087,891 lekë me tvsh.
2-Kontrata e lidhur me bashkinë Pukë, me nr.1047/15 prot., datë 11.08.2017, me objekt òRikonstruksion i shkollës së mesme Sabah Sinani, Pukë, me vlerë 27,280,568 lekë me tvsh.
OE òSh.ò shpk, nuk ka pasqyruar në Ekstraktin historik të QKR-së këto vende të zhvillimit të biznesit si dhe hapjen e NIPTI-t sekondar. Operatori ndonëse zhvillon aktivitetet biznesi në vendndodhje të ndryshme nga selia, nuk i ka pasqyruar në ekstraktin e QKR-së, si vende zhvillimi të biznesit ku do të duhej të pajisej edhe me NIPT sekondar për këto vende të tjera zhvillimi biznesi, e më tej të paguante detyrimet vendore e të pajisej me vërtetim për secilin prej këtyre njësisive. Personi i tatueshëm qe ushtron veprimtari në adresa (vendndodhje) të ndryshme biznesi, pajiset me certifikatë regjistrimi për çdo adresë, e cila ka një NIPT òunikò. Mos regjistrimi vjen në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 òPer procedurat tatimoreò nenin 40, nenin 3.1/a.b.c te ligjit nr. 131/2015 òPër qendrën kombëtare të biznesitò, si dhe ligjin nr. 9723 datë 03.05.2007 òPër Qendrën Kombëtare të Regjistrimitò.

Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE òH. 1.ò shpk & òSh.ò shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar **përdorim të paligjshëm të fondeve publike në vlerën 18,680,967 lekë** dhe ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga: z. R. B., z. Z. Ç. dhe z. R. I..

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.

Ndikimi/efekti: Vendosja e kriterëve në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të LPP, përdorim të paligjshëm të fondeve publike në vlerën 18,680,967 lekë.

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Tropojë të merren masa për vendosjen e kriterëve të DST në përputhje me objektin e prokurimit si dhe për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të OE që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni në adresën zyrtare të emailit, nga z. H. Ç., znj. V. N., znj. B. I. dhe znj. M. B., si anëtarë të njësisë së prokurimit, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

- Nga autoriteti kontraktor, bashkia Tropojë, nuk është bërë e mundur që urdhri i prokurimit të konfirmohet në degën e thesarit”

Njësia e prokurimit, arsyeton se: Autoriteti kontraktor ka zbardhur urdhrin e prokurimit, bazuar në **VKM nr.2, datë 27.3.2019 “për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja e parë për vitin 2019, grantet “arsimi bazë”, “arsimi i mesëm”,** regjistrin e parashikimeve publike për vitin 2019, date 22.05.2019 nr.18/4 Prot., te dërguar ne degën e thesarit Tropojë. Çdo urdhër prokurimi, ne te gjitha procedurat e prokurimit, një kopje është firmosur/miratur nga Drejtoria Ekonomike për vazhdimin e mëtejshëm te procedurave përkatëse. Përsa i përket procesverbaleve të mbajtura nga komisionet dhe formularët e zhvillimit të procedurës së prokurimit, janë të pa protokolluaraf .

Arsyetojmë se njësia e prokurimit ka dorëzuar dosjet e të gjitha procedurave të prokurimit me fletë inventari. Përsa i përket konstatimit se kërkesat e veçanta për kualifikim nuk janë argumentuar nga ana e NJHDT, por vetëm janë listuar si të tilla, arsyetojmë se në këtë rast dhe në të gjitha rastet, ne si njësi, me anë të procesverbaleve përkatëse dhe në rastin konkret të procesverbalit nr.2, date 15.04.2019 òProces-verbal i njësisë së prokurimit për hartimin e dokumenteve të tenderit nr.2ò (bashkangjitur), kemi bërë argumentimin për çdo kriter të

veçantë, në përputhje me natyrën e punimeve, volumin e punimeve dhe afatin e përcaktuar për përfundimin e punimeve. Përsa i përket konstatimit se *ōKërkesa për paraqitjen e aktit të marrjes ne dorëzimō*, është kërkesë e tejkaluar, sipas VKM ne.914, date 29.12.2014, neni 26. Arsyetohet se, ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 26 të VKM se mësipërme, pika 6, paragrafi si vijon: Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdo dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

-Përsa i përket konstatimit se janë kërkuar një numër prej 53 punonjësish për periudhën tetor 2018 ó mars 2019 dhe pretendimit nga ana juaj *se nuk janë argumentuar me zbërthim të grafikut dhe preventivit të punimeve*,

sqarojmë se në këtë rast dhe në të gjitha rastet, ne si njësi, me anë të procesverbaleve përkatëse dhe në rastin konkret të procesverbalit nr.2, date 15.04.2019 *ōProces-verbal i njësisë së prokurimit për hartimin e dokumenteve të tenderit nr.2ō*, kemi bërë argumentimin për çdo kriter të veçantë, në përputhje me natyrën e punimeve, volumin e punimeve dhe afatin e përcaktuar për përfundimin e punimeve.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se nga AK Bashkia Tropojë, nuk është bërë e mundur që ky urdhër prokurim të konfirmohet në Degën e Thesarit, për të siguruar garancinë e fondeve dhe mos krijimin e vlerave të papaguara në përfundim të kontratës, veprime në kundërshtim me udhëzimin plotësues nr. 1, datë 17.01.2019 të MF *ōPër zbatimin e Buxhetit të vitit 2019ō*. Mungesa e vulës së thesarit në urdhër prokurim, tregon që nuk ka fonde në dispozicion nga AK për kryerjen e kësaj procedure prokurimi dhe ngarkon me përgjegjësi drejtorin ekonomik, z. R. I..

Ky argument nuk merret në konsideratë.

Përsa i përket argumentimit të kriterëve, komentet e bëra nga ana juaj janë të argumentuara si dhe kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye merren në konsideratë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni në adresën zyrtare të emailit nga z. R. I., z. Z. Ç. dhe z. R. B., si anëtarë të KVO ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: OE *ōH. 1.ō* shpk, nuk ka deklaruar në shtojcën nr.1/1, deklaratë për paraqitje oferte të pavarur në pikën 6 të saj nëse e ka paraqitur ofertën në mënyrë të pavarur sipas pikës 6.a apo pikës 6.b të saj duk e lënë të paqartë mënyrën e ofertimit. KVO mos çekimin në kuadratin e deklaratës e ka cilësuar devijim të vogël. Në lidhje me disponimin e makinerive ndër të tjera ka deklaruar në pronësi një eskavator të blerë në datën 22.02.2017 si dhe dy betoniere me faturë, mjete këto të cilat nuk figurojnë në inventarin e automjeteve në pasqyrën financiare të vitit 2018. Në lidhje me këtë ju sqarojmë, se betonierët nuk kategorizohen të automjetet dhe nuk mund të figurojnë në inventarin e automjeteve por të zëri *ōpajse veglaō* ku dhe janë të shënuara.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Përsa i përket mjeteve në inventarin e OE *ōH. 1.ō* shpk, fjala është për eskavatorin e blerë me kontratën e datës 22.02.2017 i cili nuk figuron në inventar. Përsa i përket mungesës së çekimit në kuadratin e deklaratës, çdo OE pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të shprehet mbi mënyrën e ofertimit, dhe ky nuk është devijim i vogël.

Përveç kësaj, ky OE ka dhe një mangësi tjetër për të cilën ju nuk keni paraqitur argument siç është: OE *ōH. 1.ō* shpk, ka përcaktuar si drejtues teknik të përfshirë në licencën e firmës Ing. D. R. e cila do të jetë e disponueshme për realizimin e kësaj kontrate dhe nuk është e angazhuar në kontrata të tjera.

Ky OE ka lidhur kontratë pune me ing. D. L. R., me nr. 1233 Rep., dhe 364 Kol., datë 07.05.2018 për një afat 5 vjeçar. Në këtë kontratë është parashikuar që paga e ing. D. R. do të jetë 48.000 lekë në muaj, ndërkohë që në listëpagesat e 6 muajve të fundit, rezultoi se është paguar me pagën prej 40.000 lekë në muaj. Në DST është shprehur qartë rastet e dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kusht për s'kualifikim dhe në këtë rast kontrata me drejtuesin teknik të sipër cituar është e pasaktë dhe e rreme. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Sistemime Fshati Margegaj, Nj. Ad. Margegaj dhe qyteti Fierzë, Nj. Ad. Fierzë.		
1. Urdhër Prokurimi: nr. 380/1 prot. datë 01.04.2019	3. Hartuesit e D. Tenderit: nr. 380/1 datë 01.04.2019	4. Komisioni i V. Ofertave: nr. 380/2, dt 01.04.2019
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit oKërkesë për propozimë	H. Ç. ó Inxhinier V. N. ó Juriste M. B. ó Inxhinierë	R. B. ó Kryetar Z. Ç. ó Anëtar R. I. ó Anëtar
5. Fondi Limit (pa tvsh) 2,823,771 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh): 2,814,212 lekë (V. shpk)	7. Diferenca me fondin limit: (pa tvsh) 9,559 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 16.04.2019	9. Burimi Financimit Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender, 3 OE b) Kualifikuar 1 OE, c) S'kualifikuar 2 OE
11. Ankimime AK – s'ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK ó	13. Përgjigje Ankesës nga KKP

Titulli i Gjetjes: Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt oSistemime fshati Margegaj, NJA Margegaj dhe qyteti Fierzë, NJA Fierzë, me fond limit **2,823,771 lekë**.

Situata: Nga AK Bashkia Tropojë, nuk është bërë e mundur që ky urdhër prokurimi të konfirmohet në Degën e Thesarit, për të siguruar garancinë e fondeve dhe mos krijimin e vlerave të papaguara në përfundim të kontratës, veprime në kundërshtim me udhëzimin plotësues nr. 1, datë 17.01.2019, të MF oPër zbatimin e Buxhetit të vitit 2019.

Përsa i përket kriterëve të veçanta të vendosura në DST nga njësia e prokurimit rezultoi se kriteret për kualifikim janë argumentuar, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, oPër miratimin e rregullave të prokurimit publiko, nenin 61, oHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit, pika 2.

Nga auditimi rezultoi se kanë marrë pjesë 3 OE. Janë s'kualifikuar 2 OE për mangësi në dokumentacion dhe është kualifikuar dhe shpallur fituese oferta me vlerën më të lartë.

Mangësitë e konstatuara në dokumentacionin e OE të shpallur fitues oV.ö shpk, me vlerë të ofertës në shumën prej 2,814,212 lekë pa tvsh, janë si më poshtë:

Nuk ka deklaruar në shtojcën nr 1/1 oDeklaratë për paraqitje oferte të pavarur në pikën 6 të saj nëse e ka paraqitur ofertën në mënyrë të pavarur sipas pikës 6.a apo pikës 6.b të saj duke e lënë të paqartë mënyrën e ofertimit.

Ky OE është shpallur fitues dhe ka lidhur kontratën për 3 punimet e deklaruar më sipër në datën 15.04.2019 me Autoritetin Kontraktor Bashkia Tropojë, por në deklaratën e paraqitur në datën 16.04.2019 nuk ka deklaruar asnjë prej punëve më sipër.

Sa më sipër KVO nuk e ka konstatuar faktin se ky OE ka paraqitur deklaram të rremë në këtë procedurë prokurimi. Mosveprimi i KVO për paraqitjen e deklaramit të rremë, nga ana e OE oV.ö shpk, është në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, oPër prokurimin publiko, i ndryshuar, neni 47, oS'kualifikimi i ofertuesveo dhe neni 13, pika 3.

Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e OE oV.ö shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar **përdorim të paligjshëm të fondeve publike në vlerën 2,814,212 lekë** dhe ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga: z. R. B., z. Z. Ç. dhe z. R. I.

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.

Ndikimi/efekti: Vendosja e kriterëve në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të LPP, përdorim të paligjshëm të fondeve publike në vlerën 2,814,212 lekë.

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.

Rëndësia: e lartë.

Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Tropojë të merren masa për vendosjen e kriterëve të DST në përputhje me objektin e prokurimit si dhe për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të OE që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni në adresën zyrtare të emailit, nga z. H. Ç., znj. V. N., znj. B. I. dhe znj. M. B., si anëtarë të njësisë së prokurimit, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

- Nga autoriteti kontraktor, bashkia Tropojë, nuk është bërë e mundur që urdhri i prokurimit të konfirmohet në degën e thesarit ”

-Njësia e prokurimit, arsyeton se: Autoriteti kontraktor ka zbardhur urdhrin e prokurimit, bazuar ne VKB nr.187, datë 19.12.2018 “Për miratimin e PBA-së 2019-2021, Buxheti dhe numrit maksimal të punonjësve të bashkisë Tropojë për vitin 2019, si viti i parë i PBA-së 2019-2021, regjistrin e parashikimeve publike për vitin 2019, date 07.01.2019 nr.18/3 Prot., të dërguar ne degën e thesarit Tropoje. Çdo urdhër prokurimi, në të gjitha procedurat e prokurimit, një kopje është firmosur/miratuar nga Drejtoria Ekonomike për vazhdimin e mëtejshëm te procedurave përkatëse. Përsa i përket procesverbaleve të mbajtura nga komisionet dhe formularët e zhvillimit të procedurës së prokurimit, janë të pa protokolluará .

Arsyetojmë se njësia e prokurimit ka dorëzuar dosjet e të gjitha procedurave të prokurimit me fletë inventari. Përsa i përket konstatimit se kërkesat e veçanta për kualifikim nuk janë argumentuar nga ana e NJHDT, por vetëm janë listuar si të tilla, arsyetojmë se në këtë rast dhe në të gjitha rastet, ne si njësi, me anë të procesverbaleve përkatëse dhe në rastin konkret të procesverbalit nr.2, date 03.04.2019 òProces-verbal i njësisë së prokurimit për hartimin e dokumenteve të tenderit nr.2ò (bashkangjitur), kemi bere argumentimin për çdo kriter të veçantë, në përputhje me natyrën e punimeve, volumin e punimeve dhe afatin e përcaktuar për përfundimin e punimeve. Përsa i përket konstatimit se òKërkesa për paraqitjen e aktit te marrjes ne dorëzimò, është kërkesë e tejkualuar, sipas VKM nr.914, date 29.12.2014, neni 26.

Arsyetojmë se, ky kriter është vendosur ne përputhje me nenin 26 te VKM se mësipërme, pika 6, paragrafi si vijon: Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

-Përsa i përket konstatimit se janë kërkuar një numër prej 13 punonjësish për periudhën tetor 2018 ó mars 2019 dhe pretendimit nga ana juaj se nuk janë argumentuar me zberthim te grafikut dhe preventivit të punimeve,

sqarojmë se në këtë rast dhe në të gjitha rastet, ne si njësi, me anë të procesverbaleve përkatëse dhe në rastin konkret të procesverbalit nr.2, date 03.04.2019 òProces-verbal i njësisë së prokurimit për hartimin e dokumenteve të tenderit nr.2ò, kemi bërë argumentimin për çdo kriter të veçantë, në përputhje me natyrën e punimeve, volumin e punimeve dhe afatin e përcaktuar për përfundimin e punimeve.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se nga AK Bashkia Tropojë, nuk është bërë e mundur që ky urdhër prokurim të konfirmohet në Degën e Thesarit, për të siguruar garancinë e fondeve dhe mos krijimin e

vlerave të papaguara në përfundim të kontratës, veprime në kundërshtim me udhëzimin plotësues nr. 1, datë 17.01.2019 të MF *ËPër zbatimin e Buxhetit të vitit 2019*. Mungesa e vulës së thesarit në urdhër prokurim, tregon që nuk ka fonde në dispozicion nga AK për kryerjen e kësaj procedure prokurimi dhe ngarkon me përgjegjësi drejtorin ekonomik, z. R. I..

Ky argument nuk merret në konsideratë.

Përsa i përket argumentimit të kriterëve, komentet e bëra nga ana juaj janë të argumentuara si dhe kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye merren në konsideratë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni në adresën zyrtare të emailit nga z. R. I., z. Z. Ç. dhe z. R. B., si anëtarë të KVO ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: OE ÷V.ö shpk, nuk ka deklaruar në shtojcën nr.1/1, deklaratë për paraqitje oferte të pavarur në pikën 6 të saj nëse e ka paraqitur ofertën në mënyrë të pavarur sipas pikës 6.a apo pikës 6.b të saj duk e lënë të paqartë mënyrën e ofertimit. KVO mos çekimin në kuadratin e deklaratës e ka cilësuar devijim të vogël. Numri i punonjësve të kërkuar në 3 procedurat e mësipërme ku ky OE është shpallur fitues, e tejkalon numrin e punimeve që disponon ky OE. Sqarojmë se në kohën kur është lidhur kontrata me OE ÷V.ö shpk, për këtë kontratë datë 29.05.2019, ky OE për kontratën ÷Punime ndërtimore shkolla e fshatit Shoshanë me fond limit 2,032,082 lekë ka deklaruar përfundim të punimeve në datën 24.05.2019.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Përsa i përket mungesës së çekimit në kuadratin e deklaratës, çdo OE pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të shprehet mbi mënyrën e ofertimit, dhe ky nuk është devijim i vogël. Ky OE është shpallur fitues dhe ka lidhur kontratën për 3 punimet e deklaruara më sipër në datën 15.04.2019 me Autoritetin Kontraktor Bashkia Tropojë, por në deklaratën e paraqitur në datën 16.04.2019 nuk ka deklaruar asnjë prej punëve më sipër. Sa më sipër KVO nuk e ka konstatuar faktin se ky OE ka paraqitur deklaram të rremë në këtë procedurë prokurimi. Mosveprimi i KVO për paraqitjen e deklaramit të rremë, nga ana e OE ÷V.ö shpk, është në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, *ËPër prokurimin publikë, i ndryshuar, neni 47, ÷S`kualifikimi i ofertuesve, si dhe nenin 13, pika 3.* Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Ndërtim i rrjetit shpërndarës të ujësjellësit të fshatit Kasaj, Tropojë.		
1. Urdhër Prokurimi: nr. 382/1 prot. datë 19.04.2019	3. Hartuesit e D. Tenderit: nr. 382/1 datë 19.04.2019	4. Komisioni i V. Ofertave: nr. 382/2, datë 19.04.2019
2.Lloji i Procedurës së Prokurimit ÷Kërkesë për propozimë	H. Ç. ó Inxhinier V. N. ó Juriste M. B. ó Inxhiniere	R. B. ó Kryetar Z. Ç. ó Anëtar R. I. ó Anëtar
5. Fondi Limit (pa tvsh) 9,927,191 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh): 9,899,217 lekë (T. shpk&N. shpk)	7. Diferenca me fondin limit: (pa tvsh) 27,974 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 17.05.2019	9. Burimi Financimit Buxheti i shtetit + të ardhurat e bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender, 2 OE b) Kualifikuar 2 OE,
11. Ankimime AK – s’ka	12.PërgjigjeAnkesës nga AK ó	13. Përgjigje Ankesës nga KKP

Titulli i Gjetjes: Moszbatim i legjisllacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt *÷Ndërtim i rrjetit shpërndarës të ujësjellësit të fshatit Kasaj, me fond limit 9,927,191 lekë.*

Situata: Nga AK Bashkia Tropojë, nuk është bërë e mundur që ky urdhër prokurimi të konfirmohet në Degën e Thesarit, për të siguruar garancinë e fondeve dhe mos krijimin e vlerave të papaguara në përfundim të kontratës, veprime në kundërshtim me udhëzimin plotësues nr. 1, datë 17.01.2019, të MF *ËPër zbatimin e Buxhetit të vitit 2019*.

Përsa i përket kritereve të veçanta të vendosura në DST nga njësia e prokurimit rezultojnë se kriteret për kualifikim janë argumentuar, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, *ËPër miratimin e rregullave të prokurimit publik, nenin 61, ËHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit, pika 2.*

Nga auditimi rezultoi se kanë marrë pjesë 2 OE, të cilët janë kualifikuar të 2 dhe është shpallur fituese oferta me vlerën më të ulët.

Mangësitë e konstatuara në dokumentacionin e BOE të shpallur fitues *ËT.Ë shpk & ËN.Ë shpk*, me vlerë të ofertës në shumën prej 9,899,217 lekë pa tvsh, janë si më poshtë:

OE *ËT.Ë shpk*, nuk ka deklaruar në shtojcën nr 1/1 *ËDeklaratë për paraqitje oferte të pavarur në pikën 6 të saj nëse e ka paraqitur ofertën në mënyrë të pavarur sipas pikës 6.a apo pikës 6.b të saj duke e lënë të paqartë mënyrën e ofertimit.*

OE *ËN.Ë shpk*, nuk ka deklaruar në shtojcën nr 1/1 *ËDeklaratë për paraqitje oferte të pavarur në pikën 6 të saj nëse e ka paraqitur ofertën në mënyrë të pavarur sipas pikës 6.a apo pikës 6.b të saj duke e lënë të paqartë mënyrën e ofertimit.*

Një nga punët e ngjashme për plotësimin e këtij kriteri, të paraqitur nga këta 2 operatorë ekonomikë, është edhe kontrata e lidhur me bashkinë Tropojë me nr.1167/7 prot., datë 05.08.2018 me objekt *Ëndërtim ujësjellësi i fshatit Luzhe, NJA Llugaj, faza e parë me vlerë të kontratës prej 3,399,900 lekë pa tvsh.*

OE *ËN.Ë shpk*, nuk ka pasqyruar në Ekstraktin historik të QKR-së këtë vend të zhvillimit të biznesit si dhe hapjen e NIPTI-t sekondar. Operatori ndonëse zhvillon aktivitetin biznesi në vendndodhje të ndryshme nga selia, nuk i ka pasqyruar në ekstraktin e QKR-së, si vend zhvillimi të biznesit ku do të duhej të pajisej edhe me NIPT sekondar për këtë vend tjetër zhvillimi biznesi, e më tej të paguante detyrimet vendore e të pajisej me vërtetim për secilin prej këtyre njësive. Personi i tatueshëm që ushtron veprimtari në adresa (vendndodhje) të ndryshme biznesi, pajiset me certifikatë regjistrimi për çdo adresë, e cila ka një NIPT *Ëunikë*. Mos regjistrimi vjen në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 *ËPer procedurat tatimore* në nenin 40, nenin 3.1/a.b.c të ligjit nr. 131/2015 *ËPër qendrën kombëtare të biznesit*, si dhe ligjin nr. 9723 datë 03.05.2007 *ËPër Qendrën Kombëtare të Regjistrimit*.

Shpallja fituese e BOE *ËT.Ë shpk & ËN.Ë shpk*, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar **përdorim të paligjshëm të fondeve publike në vlerën 9,899,217 lekë** dhe ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga: z. R. B., z. Z. Ç. dhe z. R. I.

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.

Ndikimi/efekti: Vendosja e kritereve në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të LPP, përdorim të paligjshëm të fondeve publike në vlerën 9,899,217 lekë.

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Tropojë të merren masa për vendosjen e kritereve të DST në përputhje me objektin e prokurimit si dhe për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fituese të OE që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni në adresën zyrtare të emailit, nga z. H. Ç., znj. V. N., znj. B. I. dhe znj. M. B., si anëtarë të njësisë së prokurimit, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

- *Nga autoriteti kontraktor, bashkia Tropoje, nuk është bërë e mundur që urdhri i prokurimit të konfirmohet në degën e thesarit”*

-Njësia e prokurimit, arsyeton se: Autoriteti kontraktor ka zbardhur urdhrin e prokurimit, bazuar ne *VKB nr.187, datë 19.12.2018 “Për miratimin e PBA-së 2019-2021, Buxheti dhe numrit maksimal të punonjësve të bashkisë Tropojë për vitin 2019, si viti i parë i PBA-së 2019-2021,* regjistrin e parashikimeve publike për vitin 2019, date 07.01.2019 nr.18/3 Prot., të dërguar ne degën e thesarit Tropoje. Çdo urdhër prokurimi, në të gjitha procedurat e prokurimit, një kopje është firmosur/miratuar nga Drejtoria Ekonomike për vazhdimin e mëtejshëm te procedurave përkatëse. Përsa i përket procesverbaleve të mbajtura nga komisionet dhe formularët e zhvillimit të procedurës së prokurimit, janë të pa protokolluará .

Arsyetojmë se njësia e prokurimit ka dorëzuar dosjet e të gjitha procedurave të prokurimit me fletë inventari. Përsa i përket konstatimit se kërkesat e veçanta për kualifikim nuk janë argumentuar nga ana e NJHDT, por vetëm janë listuar si të tilla, arsyetojmë se në këtë rast dhe në të gjitha rastet, ne si njësi, me anë të procesverbaleve përkatëse dhe në rastin konkret të procesverbalit nr.2, date 19.04.2019 òProces-verbal i njësisë së prokurimit për hartimin e dokumenteve të tenderit nr.2ö (bashkangjitur), kemi bere argumentimin për çdo kriter të veçantë, në përputhje me natyrën e punimeve, volumin e punimeve dhe afatin e përcaktuar për përfundimin e punimeve. Përsa i përket konstatimit se òKërkesa për paraqitjen e aktit te marrjes ne dorëzimö, është kërkesë e tejkualuar, sipas VKM nr.914, date 29.12.2014, neni 26.

Arsyetojmë se, ky kriter është vendosur ne përputhje me nenin 26 te VKM se mësipërme, pika 6, paragrafi si vijon: Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

-Përsa i përket konstatimit se janë kërkuar një numër prej 27 punonjësish për periudhën shtator 2018 ó mars 2019 dhe pretendimit nga ana juaj *se nuk janë argumentuar me zberthim te grafikut dhe preventivit të punimeve,*

sqarojmë se në këtë rast dhe në të gjitha rastet, ne si njësi, me anë të procesverbaleve përkatëse dhe në rastin konkret të procesverbalit nr.2, date 19.04.2019 òProces-verbal i njësisë së prokurimit për hartimin e dokumenteve të tenderit nr.2ö, kemi bërë argumentimin për çdo kriter të veçantë, në përputhje me natyrën e punimeve, volumin e punimeve dhe afatin e përcaktuar për përfundimin e punimeve.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se nga AK Bashkia Tropojë, nuk është bërë e mundur që ky urdhër prokurim të konfirmohet në Degën e Thesarit, për të siguruar garancinë e fondeve dhe mos krijimin e vlerave të papaguara në përfundim të kontratës, veprime në kundërshtim me udhëzimin plotësues nr. 1, datë 17.01.2019 të MF òPër zbatimin e Buxhetit të vitit 2019ö. Mungesa e vulës së thesarit në urdhër prokurim, tregon që nuk ka fonde në dispozicion nga AK për kryerjen e kësaj procedure prokurimi dhe ngarkon me përgjegjësi drejtorin ekonomik, z. R. I. **Ky argument nuk merret në konsideratë.**

Përsa i përket argumentimit të kriterëve, komentet e bëra nga ana juaj janë të argumentuara si dhe kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye merren në konsideratë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni në adresën zyrtare të emailit nga z. R. I., z. Z. Ç. dhe z. R. B., si anëtarë të KVO ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: OE òT.ö shpk, nuk ka deklaruar në shtojcën nr.1/1, deklaratë për paraqitje oferte të pavarur në pikën 6 të saj nëse e ka paraqitur ofertën në mënyrë të pavarur sipas pikës 6.a apo pikës 6.b të saj duk e lënë të paqartë mënyrën e ofertimit. KVO mos çekimin në kuadratin e deklaratës e ka cilësuar devijim të vogël.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Përsa i përket mungesës së çekimit në kuadratin e deklaratës, çdo OE pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të shprehet mbi mënyrën e ofertimit, dhe ky nuk është devijim i vogël. Përveç këtij OE, edhe operatori tjetër ekonomik nuk ka çekuar mbi këtë kuadrat. Gjithashtu nuk jeni shprehur edhe mbi mangësinë tjetër të konstatuar të këtyre OE në këtë procedurë prokurimi siç është: një nga punët e ngjashme për plotësimin e këtij kriteri, të paraqitur nga këta 2 operatorë ekonomikë, është edhe kontrata e lidhur me bashkinë Tropojë me nr.1167/7 prot., datë 05.08.2018 me objekt òndërtim ujësjiellësi i fshatit Luzhe, NJA Llugaj, faza e parë me vlerë të kontratës prej 3,399,900 lekë pa tvsh.

OE òN.ò shpk, nuk ka pasqyruar në Ekstraktin historik të QKR-së këtë vend të zhvillimit të biznesit si dhe hapjen e niptit sekondar. Operatori ndonëse zhvillon aktivitet biznesi në vendndodhje të ndryshme nga selia, nuk i ka pasqyruar në ekstraktin e QKR-së, si vend zhvillimi të biznesit ku do të duhej të pajisej edhe me NIPT sekondar për këtë vend tjetër zhvillimi biznesi, e më tej të paguante detyrimet vendore e të pajisej me vërtetim për secilin prej këtyre njërive. Personi i tatueshëm qe ushtron veprimtari në adresa (vendndodhje) të ndryshme biznesi, pajiset me certifikatë regjistrimi për çdo adresë, e cila ka një NIPT òunikò. Mosregjistrimi vjen në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 òPer procedurat tatimoreò nenin 40, nenin 3.1/a.b.c te ligjit nr. 131/2015 òPër qendrën kombëtare të biznesitò, si dhe ligjin nr. 9723 dt.03.05.2007 òPër Qendrën Kombëtare të Regjistrimitò.

Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Ndërtim Ura, Nj. Ad. Bujan; Fshati Vrane, Nj. Ad. Lekbibaj; Fshati Bukovë, Nj. Ad. Llugaj; Lagje Iberhasaj, Nj. Ad. Tropojë Fshat.		
1. Urdhër Prokurimi: nr. 344/1 prot. datë 06.02.2019	3. Hartuesit e D. Tenderit: nr. 344/1 datë 06.02.2019 H. Ç. ó Inxhinier V. N. ó Juriste M. B. ó Inxhiniere	4. Komisioni i V. Ofertave: nr. 344/2, datë 06.02.2019 R. B. ó Kryetar Z. Ç. ó Anëtar R. I. ó Anëtar
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit òKërkesë për propozimò		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 4,189,033 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh): 4,176,020 lekë (V. shpk)	7. Diferenca me fondin limit: (pa tvsh) 13,013 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 19.02.2019	9. Burimi Financimit Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender, 1 OE b) Kualifikuar 1 OE,
11. Ankimime AK – s'ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK ó	13. Përgjigje Ankesës nga KKP

Titulli i Gjetjes: Moszbatim i legjislationit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt òNdërtim Ura, Nj. Ad. Bujan, Fshati Vrane, Nj. Ad. Lekbibaj, Fshati Bukovë, Nj. Ad. Llugaj, Lagje Iberhasaj, Nj. Ad. Tropojë Fshatò, me fond limit **4,189,033 lekë**.

Situata: Nga AK Bashkia Tropojë, nuk është bërë e mundur që ky urdhër prokurimi të konfirmohet në Degën e Thesarit, për të siguruar garancinë e fondeve dhe mos krijimin e vlerave të papaguara në përfundim të kontratës, veprime në kundërshtim me udhëzimin plotësues nr. 1, datë 17.01.2019, të MF òPër zbatimin e Buxhetit të vitit 2019ò.

Përsa i përket kriterëve të veçanta të vendosura në DST nga njësia e prokurimit rezultojnë se kriteret për kualifikim janë argumentuar, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, nenin 61, òHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitò, pika 2.

Nga auditimi rezultoi se ka marrë pjesë vetëm 1 OE e cila është kualifikuar dhe është shpallur fituese.

Mangësitë e konstatuara në dokumentacionin e OE të shpallur fitues òV.ò shpk, me vlerë të ofertës në shumën prej 4,176,020 lekë pa tvsh, janë si më poshtë:

OE òV.ò shpk, ndër të tjera ka përcaktuar si drejtues teknik të përfshirë në licencën e firmës Ing. R. K., i cili do të jetë i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate dhe nuk është i angazhuar në kontrata të tjera.

Ky OE ka lidhur kontratë pune me ing. R. K., me nr. 127 Rep., dhe 56 Kol., datë 05.03.2018 për një afat 1 vjeçar. Në këtë kontratë është parashikuar që paga e ing. R. K. do të jetë 45.000 lekë në muaj, ndërkohë që në listë pagesat e 6 muajve të fundit, rezulton se është paguar me pagën prej 24.000 lekë në muaj. Në DST është shprehur qartë rastet e dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kusht për s`kualifikim dhe në këtë rast kontrata me drejtuesin teknik të sipër cituar është e pasaktë dhe e rreme.

Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e OE òV.ò shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar **përdorim të paligjshëm të fondeve publike në vlerën 4,176,020 lekë** dhe ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga: z. R. B., z. Z. Ç. dhe z. R. I.

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.

Ndikimi/efekti: Vendosja e kriterëve në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të LPP, përdorim të paligjshëm të fondeve publike në vlerën 4,176,020 lekë.

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Nga ana e bashkisë Tropojë të merren masa për vendosjen e kriterëve të DST në përputhje me objektin e prokurimit si dhe për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të OE që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni në adresën zyrtare të emailit, nga z. H. Ç., znj. V. N., znj. B. I. dhe znj. M. B., si anëtarë të njësisë së prokurimit, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

- *Nga autoriteti kontraktor, bashkia Tropoje, nuk është bërë e mundur që urdhri i prokurimit të konfirmohet në degën e thesarit”*

-Njësia e prokurimit, arsyeton se: Autoriteti kontraktor ka zbardhur urdhrin e prokurimit, bazuar ne *VKB nr.187, datë 19.12.2018 “Për miratimin e PBA-së 2019-2021, Buxheti dhe numrit maksimal të punonjësve të bashkisë Tropojë për vitin 2019, si viti i parë i PBA-së 2019-2021,* regjistrin e parashikimeve publike për vitin 2019, date 07.01.2019 nr.18/3 Prot., të dërguar ne degën e thesarit Tropoje. Çdo urdhër prokurimi, në të gjitha procedurat e prokurimit, një kopje është firmosur/miratuar nga Drejtoria Ekonomike për vazhdimin e mëtejshëm te procedurave përkatëse. Përsa i përket procesverbaleve të mbajtura nga komisionet dhe formularët e zhvillimit të procedurës së prokurimit, janë të pa protokolluará .

Arsyetojmë se njësia e prokurimit ka dorëzuar dosjet e të gjitha procedurave të prokurimit me fletë inventari. Përsa i përket konstatimit se kërkesat e veçanta për kualifikim nuk janë argumentuar nga ana e NJHDT, por vetëm janë listuar si të tilla, arsyetojmë se në këtë rast dhe në të gjitha rastet, ne si njësi, me anë të procesverbaleve përkatëse dhe në rastin konkret të procesverbalit nr.2, date 06.02.2019 òProces-verbal i njësisë së prokurimit për hartimin e dokumenteve të tenderit nr.2ò (bashkangjitur), kemi bere argumentimin për çdo kriter të veçantë, në përputhje me natyrën e punimeve, volumin e punimeve dhe afatin e përcaktuar për përfundimin e punimeve. Përsa i përket konstatimit se òKërkesa për paraqitjen e aktit te marrjes ne dorëzimò, është kërkesë e tejkualuar, sipas VKM nr.914, date 29.12.2014, neni 26.

Arsyetojmë se, ky kriter është vendosur ne përputhje me nenin 26 te VKM se mësipërme, pika 6, paragrafi si vijon: Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon

vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

-Përsa i përket konstatimit se janë kërkuar një numër prej 14 punonjësish për periudhën korrik 2018 ó dhjetor 2018 dhe pretendimit nga ana juaj *se nuk janë argumentuar me zbërthim te grafikut dhe preventivit të punimeve,*

sqarojmë se në këtë rast dhe në të gjitha rastet, ne si njësi, me anë të procesverbaleve përkatëse dhe në rastin konkret të procesverbalit nr.2, date 06.02.2019 óProces-verbal i njësisë së prokurimit për hartimin e dokumenteve të tenderit nr.2ó,kemi bërë argumentimin për çdo kriter të veçantë, në përputhje me natyrën e punimeve, volumin e punimeve dhe afatin e përcaktuar për përfundimin e punimeve.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se nga AK Bashkia Tropojë, nuk është bërë e mundur që ky urdhër prokurim të konfirmohet në Degën e Thesarit, për të siguruar garancinë e fondeve dhe mos krijimin e vlerave të papaguara në përfundim të kontratës, veprime në kundërshtim me udhëzimin plotësues nr. 1, datë 17.01.2019 të MF *óPër zbatimin e Buxhetit të vitit 2019ó*. Mungesa e vulës së thesarit në urdhër prokurim, tregon që nuk ka fonde në dispozicion nga AK për kryerjen e kësaj procedure prokurimi dhe ngarkon me përgjegjësi drejtorin ekonomik, z. R. I.

Ky argument nuk merret në konsideratë.

Përsa i përket argumentimit të kriterëve, komentet e bëra nga ana juaj janë të argumentuara si dhe kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye merren në konsideratë.

Auditim i procedurave të prokurimit publik për vitin 2020

Grupi i auditimit bazuar në riskun dhe materialitetin e auditimit ushtroi auditimin në procedurat e prokurimit sipas tabelës nr. 2, sa vijon:

Tabela nr. 42, “Mbi procedurat e prokurimit dhe të audituara nga të zhvilluarat në Bashkinë Tropojë, për periudhën viti 2020”.

Nr.	Objekti	Fondi limit	Procedura	OE fitues	Vlera e ofertës fituese	Diferenca nga fondi limit	Operatorë ekonomikë		
							Total	S' kualifikuar	Kualifikuar
Viti 2020									
1	Rik.i 5 Seg. Rrugore fshati Gri, Bujan, Cërnicë	343,905,073	e hapur	óF.ó & ó4. M.ó & óV.ó	340,421,901	3,483,172	2	1	1
2	Rik. Kompleksit sportiv të lojërave me dorë	17,814,500	e hapur	óSh. A.ó & óT.ó	16,928,438	886,062	1	0	1
3	Rik. I kanaleve vaditëse	5,500,000	k. propoz.	óG.ó ShPK	3,494,818	2,005,182	7	1	6
4	Mirëmbajtje e rrugëve rurale 2020-2021	4,500,000	k. propoz.	óG.ó ShPK	4,480,942	19,058	2	1	1
5	Ujësullësi i fshatit Dragobi	57,757,935	e hapur	óF.ó ShPK & ó4. M.ó ShPK	56,891,216	866,719	2	1	1
6	Projektim, Rik. Rrugësh për vitin 2020	9,419,818	e hapur	óD. E.ó ShPK	9,345,200	74,618	7	6	1
Totali		438,897,326			431,562,515	7,334,811	21	10	11

Burimi Bashkia Tropojë

Nga auditimi me zgjedhje i zbatimit të procedurave të prokurimit publik rezultoi sa më poshtë vijon:

1.Titulli gjetjes: Mangësi në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të procedurës së prokurimit publik me objekt “**Rikonstruksion i 5 segmenteve rrugore fshati Gri, Bujan, Cërrnicë**”, me këto të dhëna:

Urdhër prokurimi Nr. 82, datë 21.09.2020	NJHDT: K. B.	KVO: Nr. 52, datë 21.09.2020 M. V.
Lloji i procedurës òe hapurò	H. I.	P. R.
Fondi limit 343,905,073 lekë.	B. B.	Sh. D.
Burimi Financimit: Buxheti i shtetit (Grand +Te Ardhura). Për vitin 2020 fondi në dispozicion është në vlerën 60,000,000 pa tvsh. Financimi i mëtejshëm sipas PBA-së per tre vite.	OE fitues: òF.ò ShPK & ò4. M.ò ShPK & òV.ò ShPK	OE Pjesëmarrës në tender: 2 Sòkualifikuar 1 me ofertë 0 lekë Kualifikuar 1
	Vlera e fituar: 340,421,901 lekë	
Data e hapjes së tenderit: 23.11.2020	Miratimi procedurës 10.12.2020	Kontrata nr. 19, datë 18.12.2020 Vlera 408,506,281.2 lekë. Afati 12 muaj
Ankimime në AK: s`ka	Ankimime në KPP:- s`ka	Titullari i AK: Personi i autorizuar nga Titullari i AK Nën Kryetar A. K..

Situata nr.1 :

Oponenca teknike: Për këtë procedurë nuk ka oponencë teknike, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 3/2020 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, òPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò, të ndryshuar, neni 6, ku është përcaktuar se:

òNeni 6 Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, për të gjitha:

- a) ndërtimet publike;
- b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë;
- c) objektet me akses publik. Me òobjekte me akses publikò, sipas këtij neni, do të kuptohen të gjitha objektet, ku, pavarësisht statusit të pronësisë së tyre, qytetarët kanë akses të lirë hyrjeje, si: kinema, teatro, stadione, markete etj.ò.

Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë tropojë z. R. B. dhe Drejtori i PZHT z. H. I.

Në lidhje me procedurën e prokurimit konstatohet se:

Kjo procedurë është për 5 segmente rrugore të cilat gjenden në hapësira të ndryshme gjeografike pa lidhje territoriale me njëra tjetrën.

Nga ana e NJHDT kjo procedurë duhej të hidhej ose si procedura më vete për secilin segment, ose me lote bazuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, Neni 9, òLlogaritja e vlerës së kontratësò, pika 5, ku është përcaktuar se:

òKontrata ndahet në lote, kur përbëhet nga punë, mallra apo shërbime, homogjene ose të ngjashme, dhe kur vlera e kombinuar është e tillë që vetëm një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë do të ishin në gjendje t'i siguronin ato. Kjo mënyrë mund të përdoret veçanërisht për të nxitur pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm dhe për të ulur kostot administrative të autoritetit kontraktor.

Në çdo rast, kur kontrata ndahet në lote, për efekt të përzgjedhjes së procedurës së prokurimit, vlera limit e kontratës do të jetë shuma e vlerës së secilit lotò.

Hartimi i projekteve:

Rruga e fshatit Cërnice- Segmenti rrugor Bajram Curri – Vernicë (lapidari) dhe degëzimi i fshatit Cërnice.

Projekti për këtë segment është hartuar në vitin 2013 nga konsulenti òl. C. P. shpk dhe sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion të gjendur në dosjen e procedurës së prokurimit është miratuar nga Kryetari i Komunës Llugaj (viti 2013) V. Ç..

Sistemim asfaltim i rrugës Bujan Tplan l= 6123.3 ml. Projekti për këtë segment është hartuar në mars 2010 nga konsulenti A. A.ShPK dhe sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion të gjendur në dosjen e procedurës së prokurimit është miratuar nga Komuna Fierzë (viti 2010) (nuk ka miratim Kryetari Komune). Projekti nuk është firmosur nga i gjithë grupi i projektimit.

Sistemim asfaltim i rrugës Qendër Komunë Rosujë Lekurtaj Selimaj. Projekti për këtë segment është hartuar në mars 2012 nga konsulenti S. T. ShPK dhe sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion të gjendur në dosjen e procedurës së prokurimit është miratuar nga Komuna Bujan Kryetari B. H. (viti 2012). Nga auditimi rezulton se ky projekt është hartuar 8 vjet më parë:

Sistemim asfaltim i rrugës segmenti nga rruga nacionale – Tropojë e vjetër – Myhejan l= 4000 m. Projekti për këtë segment është hartuar në mars 2007 nga konsulenti A. A.ShPK dhe sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion të gjendur në dosjen e procedurës së prokurimit është miratuar nga Komuna Tropojë e Vjetër. Nga auditimi rezulton se ky projekt është hartuar 13 vjet më parë me gjatësi të rrugës është 4000 m

Segmenti Kërnaj Nezhaj. Ky projekt është hartuar nga konsulenti D. E. ShPK, sipas procedurës së prokurimit me objekt: òProjektim, Rikonstruksion rrugësh për vitin 2020ò, i zhvilluar me procedurë prokurimi òi hapur konsulenceò, procedurë e hapur më datë 01/06/20 me fond limit 9,419,818 lekë, fituar nga OE òD. E.ò ShPK, me vlerë 9,345,200 lekë, me vlerë 73,173,075 lekë.

Hartimi i dokumenteve të tenderit:

Procesverbali i hartimit të DT mban datën 01.10.2020. Në hartimin e DT rezulton se nuk ka gjetur zbatim pika 1, e nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.01.2006, ndryshuar si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, sa vijon:
1- Seksioni II, òInformacione të veçanta për kontratatò, neni 26 òKontratat për punë publikeò, pika 7, ku është përcaktuar se:

7.Për të provuar përmbushjen e kriterit për kapacitetet financiare dhe ekonomike, AK kërkon: (paragrafi i fundit), ku është përcaktuar se: òKërkesat e mësipërme **duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.** Ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të OE dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratësò.

2- Kreu VII, òZyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i proceduraveò, neni 61, òHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitò, pika 2, paragrafi 2, në të cilin kërkohet që: òNë çdo rast, hartimi i tyre **duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht**, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderitò.

Në lidhje me kriteret për kualifikim nga ana e APP me email datë 29.10.2020, ku ka sugjeruar:

- Ndryshimin e numrit të punonjësve;
- Për kërkesën për inxhinier ndërtimi, profili strukturist;
- Për kërkesën për inxhinier elektronik;
- Për kërkesën për 3 inxhinier ndërtimi, 3 inxhinier topograf, 1 inxhinier pyjor;
- Për kërkesën për 6 inxhinierë ndërtimi dhe 4 inxhinierë topograf;
- Për kategoritë e licencës NS 5A dhe NS 12 B;

- Për mjek;
- Për shërbime kodit III.2.A (1+2);
- Kod III.1.B;
- Kod III.7.A;
- Për kërkesat e elementëve të pasqyrave financiare të OE;
- Për inxhinier të certifikuar si përgjegjës për mbrojtjen në punë;
- Për inxhinier të certifikuar për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë ISO 9001: 2015;
- Për manovratorë (5 auto makinistë dhe 10 ekskavatorist e shoferë);
- Për mjetet.

Nga ana e NJHDT është hartuar shtojca nr. 1, datë 02.11.2020, ku janë reflektuar minimisht sugjerimet e APP si vijon:

Ishte	Bëhet
2.2.2 OE duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qendrueshëm gjatë tre viteve të fundit 2017, 2018 dhe 2019. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti OE duhet të paraqesë kopje të bilanceve të tre viteve të fundit (si me sipër), të paraqitur pranë autoritetit përkatës, të konfirmuara nga ky autoritet, në të cilat duhet të rezultojë se nuk ka dale me humbje të paktën në dy vite të njëpasnjëshme. Si dhe të shoqëruara me akt ekspertizën e kryer nga eksperti kontabel i autorizuar.	2.2.2 OE duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qendrueshëm gjatë tre viteve të fundit 2017, 2018 dhe 2019. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti OE duhet të paraqesë kopje të bilanceve të tre viteve të fundit (si me sipër), të paraqitur pranë autoritetit përkatës, të konfirmuara nga ky autoritet, në të cilat duhet të rezultojë se nuk ka dale me humbje të paktën në dy vite të njëpasnjëshme.
2.3.1/a Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti OE duhet të paraqesë formularët e vlerësimit sipas shtojcës përkatëse të DST të shoqëruar me kontratën/kontratën e nënshkruara nga palet, situacionet perfundimtare, faturat tatimore, aktet e kolaudimit. Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.	2.3.1/a Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti OE duhet të paraqesë formularët e vlerësimit sipas shtojcës përkatëse të DST të shoqëruar me kontratën/kontratën e nënshkruara nga palet, situacionet perfundimtare, faturat tatimore, aktet e kolaudimit. Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.
2.3.2 OE duhet të ketë një punësim mesatar, me jo më pak se 200 punonjës, për periudhën (Shtator 2019 ó Gusht 2020), e vërtetuar kjo me: Vërtetim të lëshuar nga Administratata Tatimore për periudhën e kërkuar, shoqëruar me formularët E-SIG të konfirmuara nga organet përkatëse (me nënshkrim elektronik ose në hard copy).	2.3.2 OE duhet të ketë një punësim mesatar, me jo më pak se 194 punonjës, për periudhën (Dhjetor 2019 ó Gusht 2020), e vërtetuar kjo me: Vërtetim të lëshuar nga Administratata Tatimore për periudhën e kërkuar, shoqëruar me formularët E-SIG të konfirmuara nga organet përkatëse (me nënshkrim elektronik ose në hard copy).
2.3.3 OE për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, duhet të ketë të punësuar drejtues teknik të përfshirë në licencën e shoqërisë si më poshtë: 1 Inxhinier Ndërtimi; profili Strukturist 1 Inxhinier Ndërtimi; profili transport 1 Inxhinier Ndërtimi; profili gjeoteknik 1 Inxhinier Hidroteknik 1 Inxhinier Mekanik 1 Inxhinier Topograf 1 Inxhinier Elektrik 1 Inxhinier Elektronik	2.3.3 OE për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, duhet të ketë të punësuar drejtues teknik të përfshirë në licencën e shoqërisë si më poshtë: 1 Inxhinier Ndërtimi; profili Strukturist 1 Inxhinier Ndërtimi; profili transport 1 Inxhinier Ndërtimi; profili gjeoteknik 1 Inxhinier Hidroteknik 1 Inxhinier Mekanik 1 Inxhinier Topograf 1 Inxhinier Elektrik
Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtëme: - NP ó 1/A (Punime Gërmimi në tokë.) - NP ó 4/E (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.) - NP ó 7/A (Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje.) - NP ó 11/A (Ndërtime për N/Stacionet, kabinat e	Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtëme: - NP ó 1/A (Punime Gërmimi në tokë.) - NP ó 4/E (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.) - NP ó 7/A (Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje.) - NP ó 11/A (Ndërtime për N/Stacionet, kabinat e

<p>transformatoreve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarje e energjisë.)</p> <ul style="list-style-type: none"> - NP – 12/A (Punime të inxhinierisë së mjedisit.) - NS ó 1/A (Punime per prishjen e ndertimeve) - NS – 5/A (Impiante te sinjalistikes ndricuese te trafikut) - NS ó 6/B (Sinjalistikë rrugore jondriçuese) - NS ó 7/B (Bariera dhe mbrojtje rrugore) - NS – 12B (Impiante teknologjik, termike dhe te kondicionimit) - NS -18/ A(Punime topogjeodezike) 	<p>transformatoreve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarje e energjisë.)</p> <ul style="list-style-type: none"> - NP ó 12/A (Punime të inxhinierisë së mjedisit.) - NS ó 1/A (Punime per prishjen e ndertimeve) - NS ó 6/B (Sinjalistikë rrugore jondriçuese) - NS ó 7/B (Bariera dhe mbrojtje rrugore) - NS -18/ A (Punime topogjeodezike)
<p>2.3.5 OE ofertues duhet të ketë të punësuar si pjese te stafit te tij, pervec stafit të mesipërm te kerkuar te paktën: 3 inxhinier Ndërtimi infrastrukture transporti, 3 inxhinier topograf, 1 inxhinier pyjor, të cilët duhet të jene te siguruar dhe te figurojnë listepagesat përkatëse (3) muajt e fundit.</p>	<p>2.3.5 OE ofertues duhet të kete te punësuar si pjese te stafit te tij, përveç stafit te mësipërm te kerkuar te paktën: 3 inxhinier Ndërtimi infrastrukture transporti, 3 inxhinier topograf, 1 inxhinier pyjor, të cilët duhet të jene te siguruar dhe te figurojnë listepagesat përkatëse (3) muajt e fundit</p>
<p>2.3.6 OE duhet të disponoje dhe paraqesë leje dhe licensa nga QKB si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> * me kod III.2.A (1+2) * me kod III.2.B * me kod III.1.B * me kod III.7.A 	<p>2.3.6 OE duhet të disponoje dhe paraqesë leje dhe licensa nga QKB si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> * me kod III.2.A (1+2) * me kod III.2.B * me kod III.1.B * me kod III.7.A
<p>2.3.7 OE ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një)punonjës që disponon çertifikatën si òPërgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit ne puneò në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 òPër sigurinë dhe shëndetin në punëò dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 òPër miratimin e e rregullores òPër sigurine në kantierò. Për specialistin e shoqërisë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit për òSpecialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punëòe dhëne nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj dhe kontrata e punës e vlefshme, si dhe duhet të jetë i përfshirë në listë pagesën e shoqërisë për periudhen Shtator 2019 ó Shkurt 2020.</p>	<p>2.3.7 OE ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një)punonjës që disponon çertifikatën si òPërgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit ne puneò në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 òPër sigurinë dhe shëndetin në punëò dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 òPër miratimin e e rregullores òPër sigurine në kantierò. Për specialistin e shoqërisë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit për òSpecialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punëòe dhëne nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj dhe kontrata e punës e vlefshme, si dhe duhet të jetë i përfshirë në listë pagesën e shoqërisë për periudhen Dhjetor 2019 ó Gusht 2020.</p>
<p>2.3.8 OE ofertues duhet të ketë të punësuar si dhe te figurojnë listpagesat e shoqërisë për periushen Shtator 2019 ó Gusht 2020, punonjës si më poshtë;</p> <p>1 Inxhinier _ Çertifikuar si Përgjegjës per mbrojtjen dhe menaxhimin e demeve në mjedis.</p> <p>1 Inxhinier _ Çertifikuar per Sigurimin dhe kontrollin e cilesise ISO9001:2015</p>	<p>2.3.8 OE ofertues duhet të ketë te punësuar si dhe te figurojnë ne listpagesat e shoqërisë për periushen Dhjetor 2019 ó Gusht 2020, punonjës si me poshtë;</p> <p>1 Inxhinier _ Çertifikuar si Përgjegjës per mbrojtjen dhe menaxhimin e demeve në mjedis.</p> <p>1 Inxhinier _ Çertifikuar per Sigurimin dhe kontrollin e cilesise ISO9001:2015</p>
<p>2.3.9 OE ofertues duhet të ketë të punësuar miniM.sht 15 (pesembedhjet) punonjës manovratorë (nga të cilët 5 Automakinist dhe 10 eskavatoristë/buldozeristë) dhe 10 shoferë të mjeteve të rënda, per të cilët duhet të paraqesë kontrate individuale të punës të vlefshme, Dëshmi aftësie Profesionale (te vlefshme)/patenten përkatëse, lëshuar nga institucionet përkatëse, si dhe te figurojë në listë pagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit.</p>	<p>2.3.9 OE ofertues duhet të ketë të punësuar miniM.sht 11 (njembedhjet) punonjës manovratorë (nga të cilët 4 Automakinist dhe 7 eskavatoristë/buldozeristë) dhe 10 shoferë të mjeteve të rënda, per të cilët duhet të paraqesë kontrate individuale të punës të vlefshme, Dëshmi aftësie Profesionale (te vlefshme)/patenten përkatëse, lëshuar nga institucionet përkatëse, si dhe te figurojë në listë pagesat e shoqërisë për të paktën 2 muajt e fundit.</p>
<p>2.3.10 OE duhet të ketë në përbërje të stafit Nje Mjek në përputhje të plotë me VKM nr. 108 datë 09.02.2011, i ndryshuar, të vërtetuar me kontratë pune te vlefshme, diplome CV, leje ushtrimi profesioni te lëshuar nga Urdhëri i Mjekut</p>	<p>2.3.10 OE duhet të ketë në përbërje të stafit apo me kontrate shërbimi Një Mjek ne përputhje te plote me VKM nr. 108 datë 09.02.2011, i ndryshuar, te vërtetuar me diplome CV, leje ushtrimi profesioni te lëshuar nga Urdhëri i Mjekut</p>
<p>2.3.11 OE duhet të disponoje mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike</p>	

Nr	Emertimi i mjetit	Njësi	Sasi	
			ishte	bëhet
1	Eskavator me Zinxhire me cekic	copë	2	2
2	Motomjete per prerjen e bimesise	copë	20	15
3	Eskavator me zinxhine me kove 0.5m ³	copë	5	5
4	Eskavator me goma	copë	3	3
	Eskavator me zinxhine me krah te gjate min 15m	copë	1	-
5	Greider	copë	3	3
6	Kamion me kapacitet min 20 Ton	copë	12	10
7	Kamion me kapacitet min 10-20 Ton	copë	5	5
8	Rrul Gome ó Hekur Kapacitet jo me pak se 18 Ton	copë	2	2
9	Rrul Gome ó Hekur me gunga kapacitet 9-12 Ton	copë	1	1
10	Rrul asfalti max 4 Ton	copë	3	3
11	Rrul asfalti hekur ó hekur 8-10 ton	copë	2	2
12	Rrul vibrues kapaciteti jo me pak se 10 Ton	copë	2	2
13	Fshese per pastrimin e rruges	copë	1	1
14	Autobot uji me sprucator	copë	3	3
15	Autobot nafte	copë	2	2
16	Autobitumatrice	copë	1	1
17	Asfaltoshtruese	copë	4	2
18	Autobetoniere	copë	4	4
19	Autopompe betoni	copë	2	2
	Autokull me lartesi min 9m	copë	1	
20	Autopompe Stacionare per shtresat e betonit	copë	1	1
21	Impiant Betoni me kod III.1.B	copë	1	1
22	Impiant i fraksionimit te inerteve me kod III.1.B	copë	1	1
23	Impiant Asfalti me kod III.1.B	copë	1	1
	Impiant per prodhimin e tombinove + platformat me diameter max 1200mm dhe kesoneve me dimension 2000x2000mm kod III.1.B	copë	1	1
24	Impiant per prodhimin e pusetave me dimension max 2000x2000mm + bordurat e betonit me kod III.1.B			
25	Armatura metalike	m ²	500	500
26	Batipal	copë	1	2
27	Makineri per vijezim rruge(boje Bikomponente)	copë	1	1
28	Makineri per vijezim rruge(boje Akrilike)	copë	1	1
29	Makineri per ngjitje tubi HDPE me dimension max 315mm		1	
30				
31	Hydromulcer me kapacitet min 4 Ton	copë	1	1
32	Gjenerator me fuqi min 200kVA	copë	1	1
33	Trencher per punime specifike(kapacitet min 20 ton)	copë	1	1
34	Set laboratorik per testimin e asfaltit,bitumit,betonit,gureve dhe llojeve te ndryshme te dherave sipas Direktiveve europiane(2006/42/CE, 2014/35/UE, 2014/30/UE/, BS 1377:2, BS6576 + Certifikate konformiteti	Set	1	1
2.3.12 OE duhet të disponoje dhe paraqesë çertifikatat te vlefshme si më poshtë: É EN-ISO 14001:2004 É EN- ISO 9001-2015 É EN-OHSAS 18001:2007		2.3.12 OE duhet të disponoje dhe paraqesë çertifikatat te vlefshme si më poshtë: É EN-ISO 14001:2004 É EN- ISO 9001-2015 É EN-OHSAS 18001:2007		

Gjithashtu me shtojcën nr. 2, datë 13.11.2020, po në zbatim të këtij email të APP është bërë ndryshim i preventivit të punimeve të objektit të prokurimit. Nga këqyrja e këtij eM. nuk rezultojnë vërejtje në lidhje me preventivin, **për rrjedhojë ndryshimi i tij për efekt të emailit të APP datë 29.10.2020 nuk qëndron.**

Konkretisht kërkesat në lidhje me kategoritë e licencave, numrin e punonjësve dhe kategoritë e punësimit, numrin dhe llojin e mjeteve etj., nuk janë argumentuar me zberthimin e preventivit dhe sipas grafikut të punimeve.

Nuk kanë mbështetje ligjore kërkesat si vijon:

Në DT është kërkuar: OE duhet të ketë nje punësim mesatar, me jo më pak se 194 punonjës, për periudhën (Dhjetor 2019 ó Gusht 2020), e vërtetuar kjo me: *Vërtetim të lëshuar nga Administratata Tatimore për periudhën e kerkuar, shoqëruar me formularët E-SIG te konfirmuara nga organet përkatëse (me nënshkrim elektronik ose në hard copy).*

➤ Nuk është argumentuar me volume punimesh dhe me grafik numri i punonjësve (staf teknik + punëtorë). NJHDT duhet t'i referohej kreut III, të VKM nr. 42, datë 16.01.2008, òPër miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, ku parashikohet shprehimisht se: òAutoritetet kontraktore, në përcaktimin e grafikëve dhe afateve për përfundimin e punimeve të ndërtimit, në dokumentet e tenderit të prokurimit dhe në kontratën e zbatimit të veprave publike, ndërtimore, detyrohen të llogarisin kryerjen e punimeve, për periudhën 22 mars ó 23 tetor me 2 turne, për ndërtimin e objekteve në lartësi, dhe me 3 turne, për ndërtimin e rrugëve dhe ndërtimeve të tjera.

ç) Autoritetet kontraktore për moszbatimin e kërkesave të përcaktuara në shkronjën òcò dhe për mosndjekjen e zbatimit të këtyre kushteve (kryerjen e punimeve me dy e tri turne), të përcaktuara në kontratën e nënshkruar, ngarkohen me përgjegjësi administrative dhe/ose me përgjegjësi, sipas legjislacionit për prokurimin publik.

Gjithashtu në nenin 78 pika 1 dhe 4 të Kodit të Punës parashikohet se: Kohëzgjatja ditore normale e punës është jo më shumë se 8 orë. Ajo përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në kontratën kolektive, ose në kontratën individuale të punës, brenda limiteve të kohës javore maksimale të punës.

4. Pushimi ditor është të paktën 11 orë pa ndërprerje brenda ditës ose në rast nevojë për dy ditë rresht.

Në nenin 83 të Kodit të Punës parashikohet se: òKohëzgjatja normale e javës së punës është jo më shumë se 40 orë. Ajo përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në kontratën kolektive ose në kontratën individuale të punës.ò

Në nenin 85 të Kodit të Punës parashikohet se:

1. Pushimi javor është jo më pak se 36 orë, prej të cilave 24 orë pa ndërprerje.
2. Pushimi javor përfshin ditën e diel.
3. Pushimi javor nuk është i pagueshëm.
4. Përfshirjet rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave ose me kontratë kolektive.

Nga ana e autoritetit kontraktor është e rëndësishme të provohet disponimi i numrit të nevojshëm të punonjësve nga ana e operatorëve ekonomikë por përcaktimi i numrit duhet të vijë pas një analize gjithëpërfshirëse të gjithë elementëve si më sipërcituar nga AK, me qëllim përcaktimin e numrit në mënyrë të arsyeshme, proporcionale, dhe në përputhje me nevojat reale për ekzekutimin e kontratës në mënyrë të sukseshme, në respekt të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò të ndryshuar dhe nenin 26 pika 5 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publicotë ndryshuar, ku parashikohet se: òKërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe

vlerën e kontratës. Në çdo rast, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete

që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.ò

Si konkluzion AK nuk ka arritur të argumentojë teknikisht mbi kërkesën për disponimin e një numri prej **194** punonjësish si dëshmi të fuqisë punëtore.

Në DT është kërkuar: OE për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, duhet të ketë të punësuar drejtues teknik të përfshirë në licencën e shoqërisë si më poshtë: 1 Inxhinier Ndërtimi; profili Strukturist; 1 Inxhinier Ndërtimi; profili transport; 1 Inxhinier Ndërtimi; profili gjeoteknik; 1 Inxhinier Hidroteknik; 1 Inxhinier Mekanik; 1 Inxhinier Topograf dhe 1 Inxhinier Elektrik.

➤ **Numri prej 7 inxhinierësh në staf** si drejtues teknik, është i fryrë dhe ul konkurrencën në procedurë. OE mund të marrë staf edhe të punësuar me kontratë. Gjithashtu sa i përket kërkesës së autoritetit kontraktor që stafi i punonjësve të jetë i pasqyruar në listë pagesa, **kjo kërkesë kufizon numrin e shoqërive pjesëmarrëse që nuk zotërojnë staf**

tekniktë përhershëm (gjë që reflektohet në listë pagesat e shoqërisë), por që kanë mundësinë të sigurojnë këtë staf, duke lidhur kontrata pune me afat sa afati i kontratës objekt prokurimi.

➤ Kërkesa lidhur me inxhinier ndërtimi, profili strukturist, nuk ka lidhje me objektin e prokurimit pasi ky lloj inxhinieri është për projektimin e elementëve strukturorë të objektit dhe s'ka lidhje me objektin e prokurimit, përcaktimi i të cilit është në kundërshtim me pikën 1 të nenit 46 të LPP.

Në DT është kërkuar: OE duhet të disponojnë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me VKM nr. 42, datë 16.01.2008, për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari Ndërtimi. Shqyrtimi i licencave do të behet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa me sipër. Nga ana e NJHDT nuk janë argumentuar kategoritë me volumet e punimeve:

➤ Për kategorinë N.P. 12 A (Punime të inxhinierisë mjedisore), nuk ka punime bazuar në përcaktimet e VKM nr. 42, datë 16.01.2008.

➤ Në lidhje me përcaktimin e klasifikimit öEö, për kategorinë NP ó 4/E (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaji, metro, pista aeroportuale.) nuk argumentohet me volume pune sipas preventivit, pasi jo e gjithë vlera e preventivit është punim për këtë kategori.

➤ Për klasifikimin öBö të kategorive sa vijon: NS ó 6/B (Sinjalistikë rrugore jo ndriçuese) NS ó 7/B (Barriera dhe mbrojtje rrugore), nuk është argumentuar klasifikimi me volumet e punës sipas preventivit të punimeve.

Në DT është kërkuar: OE ofertues duhet të ketë të punësuar si pjesë të stafit të tij, përveç stafit të mësipërm të kërkuar të paktën: 3 inxhinier ndërtimi infrastrukture transporti, 3 inxhinier topograf, 1 inxhinier pyjor, të cilët duhet të jenë të siguar dhe të figurojnë në listë pagesat përkatëse (3) muajt e fundit.

➤ Në lidhje me këtë kërkesë nga ana e NJHDT nuk janë argumentuar kërkesa për staf të shtuar për inxhinier me volumin dhe grafikun e punimeve.

➤ Gjithashtu nuk ka punime në preventiv për një inxhinier pyjor, përcaktimi i të cilit si kriter kualifikues është në kundërshtim me nenin 20 dhe 46 të LPP.

➤ Nga auditimi i kriterëve në përgjithësi rezulton se është kërkuar një numër shumë e lartë inxhinierësh. Kërkesa për ta nuk është bërë bazuar në zberthimin e preventivit të punimeve dhe në grafikun e punimeve. Aq më tepër që ata janë kërkuar që të figurojnë në listë pagesat e OE, ndërkohë që në rast se do të ishte e domosdoshme duhet të ishin kërkuar edhe ose me kontratë.

Në DT është kërkuar: OE ofertues duhet të ketë të punësuar 1 punonjës që disponon certifikatën si öPërgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 për miratimin e rregullores për sigurinë në kantierë. Për specialistin e shoqërisë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit për öSpecialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë dhe dhëne nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj dhe kontrata e punës e vlefshme, si dhe duhet të jetë i përfshirë në listë pagesën e shoqërisë për periudhën Dhjetor 2019 ó Gusht 2020.

➤ Kërkesë jo në përputhje me nenin 7 dhe 38 të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 për sigurinë dhe shëndetin në punë, i ndryshuar si dhe referuar rregullave të prokurimit publik dhe legjislacionit të fushës përkatëse, kërkesa e autoritetit kontraktor që punonjësit për sigurimin teknik dhe mbrojtjen e shëndetit në punë të figurojnë në listë pagesa, të figurojnë në licencën e shoqërisë dhe të kenë dëshmitë përkatëse, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe aspak në përputhje me ligjin nr. 10237, datë 18.02.2010 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, i ndryshuar.

Në DT është kërkuar:OE ofertues duhet të ketë të punësuar si dhe të figurojnë në listë pagesat e shoqërisë për periudhën dhjetor 2019 ó gusht 2020, punonjës si me poshtë;

1 Inxhinier _ certifikuar si përgjegjës për mbrojtjen dhe menaxhimin e dëmeve në mjedis.

1 Inxhinier _ certifikuar për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë ISO 9001:2015

➤ Kërkesë diskriminuuese që sjell kufizimin e pjesëmarrjes ne procedurën e prokurimit. Kërkesë e cila nuk është argumentuar teknikisht dhe që ka lidhje me punën e mbikëqyrësit të punimeve gjatë zbatimit të objektit në kantier.

Në DT është kërkuar:OE ofertues duhet të ketë të punësuar miniM.sht 11 punonjës manovratorë (nga të cilët 4 auto makinist dhe 7 eskavatoristë/ buldozeristë) dhe 10 shoferë të mjeteve të rënda, për të cilët duhet të paraqesë kontrate individuale të punës të vlefshme, dëshmi aftësie profesionale (të vlefshme) /patentën përkatëse, lëshuar nga institucionet përkatëse, si dhe te figurojë në listë pagesat e shoqërisë për të paktën 2 muajt e fundit.

➤ Kjo kërkesë nuk është argumentuar **bazuar në** VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".

➤ Gjithashtu nisur nga fakti që mjetet janë kërkuar që të jenë në pronësi apo me qira, mjetet që merren me drejtues të mjetit nuk mund të jenë në listë pagesat e OE pjesëmarrës, pasi këto punonjës mund të kontraktohen.

Në DT është kërkuar:OE duhet të ketë në përbërje të stafit apo me kontratë shërbimi një mjek në përputhje të plotë me VKM nr. 108, datë 09.02.2011, i ndryshuar, të vërtetuar me diplomë CV, leje ushtrimi profesioni të lëshuar nga Urdhri i Mjekut

➤ Kërkesa për mjek është e tepërt dhe nuk ka lidhje me asnjë nga përcaktimet e kontratës si dhe është në kundërshtim me VKM nr. 632, datë 15.07.2015, e cila ka ndryshuar VKM nr. 108, datë 9.2.2011 Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë, pika 1, ku përcaktohet se: òPas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje, si më poshtë vijon: ò6. Punëdhënësit e grupeve òAö dhe òBö, në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve òCö dhe òDö, për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë.

Në DT është kërkuar:OE duhet të disponoje mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës, si vijon:

Nr	emertimi i mjetit	njësi	sasi	në pronësi ose me qera
1	Eskavator me zinxhire me cekic	copë	2	Në pronësi ose me qera
2	Motomjete per prerjen e bimesise	copë	15	Në pronësi ose me qera
3	Eskavator me zinxhine me kove 0.5 m ³	copë	5	Në pronësi ose me qera
4	Eskavator me goma	copë	3	Në pronësi ose me qera
5	Greider	copë	3	Në pronësi ose me qera
6	Kamion me kapacitet min 20 ton	copë	10	Në pronësi ose me qera
7	Kamion me kapacitet min 10-20 ton	copë	5	Në pronësi ose me qera
8	Rrul gome ó hekur kapacitet jo me pak se 18 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
9	Rrul gome ó hekur me gunga kapacitet 9-12 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
10	Rrul asfalti max 4 Ton	copë	3	Në pronësi ose me qera
11	Rrul asfalti hekur ó hekur 8-10 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
12	Rrul vibrues kapaciteti jo me pak se 10 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
13	Fshese per pastrimin e rruges	copë	1	Në pronësi ose me qera
14	Autobot uji me sprucator	copë	3	Në pronësi ose me qera
15	Autobot naftë	copë	2	Në pronësi ose me qera
16	Autobitumatrice	copë	1	Në pronësi ose me qera
17	Asfaltoshtruese	copë	2	Në pronësi ose me qera
18	Autobetoniere	copë	4	Në pronësi ose me qera
19	Autopompe betoni	copë	2	Në pronësi ose me qera

20	Autopompe Stacionare per shtresat e betonit	copë	1	Në pronësi ose me qera
21	Impiant Betoni me kod III.1.B	copë	1	Në pronësi ose me qera ose kontrate Furnizimi
22	Impiant i fraksionimit te inerteve me kod III.1.B	copë	1	Në pronësi ose me qera ose kontrate Furnizimi
23	Impiant Asfalti me kod III.1.B	copë	1	Në pronësi, me qera, kontrate furnizimi
24	Impiant per prodhimin e tombinove + platformat me diameter max 1200mm dhe kesoneve me dimension 2000x2000mm kod III.1.B	copë	1	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi
25	Impiant per prodhimin e pusetave me dimension max 2000x2000mm + bordurat e betonit me kod III.1.B			Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi
26	Armatura metalike	m ²	500	Në pronësi ose me qera
27	Batipal	copë	2	Në pronësi ose me qera
28	Makineri per vijezim rruge(boje Bikomponente)	copë	1	Në pronësi ose me qera
29	Makineri per vijezim rruge(boje Akrilike)	copë	1	Në pronësi ose me qera
30	Makineri per ngjitje tubi HDPE me dim.max 315mm			Në pronësi ose me qera
31	Hydromulcer me kapacitet min 4 Ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
32	Gjenerator me fuqi min 200kVA	copë	1	Në pronësi ose me qera
33	Trencher per punime specifike(kapacitet min 20 ton)	copë	1	Në pronësi ose me qera
34	Set laboratorik per testimin e asfaltit, bitumit, betonit, gureve dhe llojeve te ndryshme te dherave sipas Direktivave europiane(2006/42/CE, 2014/35/UE, 2014/30/UE/, BS 1377:2, BS6576 + Certificate konformiteti	set	1	Në pronësi ose me qera

Në lidhje me mjetet e kërkuara rezulton se:

➤ Nuk është argumentuar me volume punimesh dhe me grafik numri dhe kapaciteti i mjeteve të kërkuara.

Në DT është kërkuar: Për fabrikën e asfaltit, inerteve, betonit, kesoneve, bordurave dhe tombinove nëse është Në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo ç -doganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, leja mjedisore lëshuar nga QKL. Nëse është marre me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerese. OE për fabrikën e asfaltit dhe betonit mund të paraqesë edhe kontrata te vlefshme furnizimi me operatorë ekonomikë. **Në këtë rast duhet të paraqesë kontratën e furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton ekzistencën dhe pronësinë e impiantit.**

➤ Kërkesa sa më lart janë dokumente që i takojnë palëve të treta të cilat nuk janë konkurrentë në procedurën konkrete të prokurimit.

Në DT në lidhje me mjetet është kërkuar: ÷Set laboratorik për testimin e asfaltit, bitumit, betonit, gurëve dhe llojeve te ndryshme te dherave sipas Direktivave evropiane (2006/42/CE, 2014/35/UE, 2014/30/UE/, BS 1377:2, BS6576 + Certificate konformiteti)

➤ **Kërkesë në kundërshtim me kushtet e përgjithshme të kontratës pjesë e DST, neni 26,** Testimet dhe Inspektimet, ku thuhet:

26.1 Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës

26.2 AK me shpenzimet e tij, ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nëse materialet prodhohen ose përgatiten në vende të ndryshme nga ato të kontraktorit, kontraktori duhet të sigurojë leje për Autoritetin Kontraktor për të ndjekur këto teste dhe inspektime.

26.3 AK gjithashtu mund të kërkojë kontraktorit të bëjë teste ose inspektime shpesh të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Punimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. AK do të mbajë përgjegjësi për koston e

këtyre testeve. Gjithashtu, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së kontraktorit, AK do të bjerë dakort të ndryshojë grafikun.

26.4 AK do të refuzojë çdo punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

26.5 As ekzekutimi i testeve as inspektimi i punimeve nuk do ta lirojë kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

Në DT është kërkuar: 2.3.6 OE duhet të disponojë dhe paraqesë leje dhe licenca nga QKB si më poshtë: me kod III.2.A (1+2), me kod III.2.B, me kod III.1.B, me kod III.7.A.

➤ Kërkesa për licencat e mësipërme nuk ka lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit, pasi në kuptim të pikës 6a të nenit 1, të ligjit 10440, datë 07.07.2011, òPër vlerësimin e ndikimit në mjedisò ekspertizat profesionale sa më lart kërkuar janë ezauruar njëherë gjatë procesit të studimit dhe të projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit, relacioneve teknike dhe raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Këto kërkesa janë në kundërshtim me nenin 26/5 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014

Në DT është kërkuar:OE duhet të disponojë dhe paraqesë certifikatat te vlefshme si më poshtë: *EN-ISO 14001:2004 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit); EN- ISO 9001-2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë); EN-OHSAS 18001:2007 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë.)*

➤ Për sa më sipër NJHDT duhet të kishte kërkuara certifikatat të azhurnuara ndërsa në lidhje me certifikatën EN OHSAS 18001:2007 duhet që AK të pranojë edhe OE të cilët disponojnë certifikatën me standardin e azhurnuar dhe ekuivalent të njohur nga standardet shqiptare ISO 45001:2018.

➤ **Nga auditimi rezulton se nga ana e NJHDT,** nuk është kërkuar që OE duhet tëdeklarojëmedeklaratë të administratorit drejtuesin/it teknik që duhet të jenë gjatë gjithë kohës në vepër dhe të paangazhuara në punë të tjera, kërkesë e përcaktuar në kreun I, pika 2.1 të UKM nr. 2, datë 13.05.2005, òPër zbatimin e punimeve të ndërtimit, ku parashikohet se për punime mbi 30 milion lekë është e detyrueshme qëndrimi i drejtuesit teknik në kantier gjatë gjithë periudhës së punimeve.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 “Për rregullat e Prokurimit Publik” sipas të cilit: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”,ngarkohet me përgjegjësi NJHDT të përbërë nga z.K. B., me detyrë drejtor i drejtorisë së pyjeve, kullotave dhe bujqësisë, z.H. I., me detyrë drejtor i drejtorisë sëplanifikimit dhe zhvillimit të territorit, z. B. B.,me detyrë teknik ndërtimi për emergjencat civile.

Kriteri: Nga njësia për hartimin e dokumenteve të tenderit është vepruar në kundërstim me:

- VKM nr. 914, datë 24.12.2014 òPër rregullat e Prokurimit Publikò;
- UKM nr. 2, datë 13.05.2005;
- VKM nr. 632, datë 15.07.2015, e cila ka ndryshuar VKM nr. 108, datë 9.2.2011 Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punëò;
- VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre";
- Ligji nr. 3/2020 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, òPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò, të ndryshuar;
- Ligji 10440, datë 07.07.2011, òPër vlerësimin e ndikimit në mjedisò;
- VKM nr. 42, datë 16.01.2008, òPër miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimiò;

• Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò të ndryshuar, etj.

Ndikimi/efekti: Vendosja e kriterëve në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.

Rëndësia: e lartë

Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Tropojë të merren masa për vendosjen e kriterëve të DST në përputhje me objektin e prokurimit si dhe për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të OE që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

Situata nr.2:

Zhvillimi i procedurës së prokurimit: procedura e prokurimit është hapur më datë 23.11.2020 dhe është vlerësuar, sa më poshtë vijon:

Nr.	Operatorë ekonomikë	Oferta	Vlerësimi i KVO
1	òF.ò ShPK & ò4. M.ò ShPK & òV.ò ShPK	340,421,901	Kualifikuar dhe shpallur fituese.
2	òH. 1.ò ShPK	0	S'kualifikuar

Auditimi i ofertës fituese: Në këtë procedurë prokurimi është shpallur fitues bashkimi i operatorëve ekonomik ò4.Mò ShPK & òF.ò ShPK & òV.ò ShPK. Ndarja në përqindje e punimeve sipas aktmarrëveshjes midis palëve është 47 % ò4.Mò ShPK, OE òF.ò ShPK 32 % dhe 21 % do të kryhet nga OE òV.ò ShPK.

Këta operatorë nuk kanë deklaruar në sistemin elektronik të APP që janë pjesë e një bashkimi operatorësh në këtë procedurë prokurimi.

Mangësitë e OE "4.M" ShPK. Nuk ka deklaruar në shtojcën nr. 8 òDeklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të gjithë personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, drejtuesin teknik M. L..

Në DST është kërkuar: *Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo në proces, sipas Shtojcës 11;* Për plotësimin e këtij kriteri, OE ò4.Mò ShPK, ka paraqitur këtë deklaratën mbi punimet e tij në proces. Ndërkohë ky OE nuk ka paraqitur edhe këto punë të tjera në proces të deklaruara po në këtë procedurë nga antari tjetër i BOE òF.ò ShPK, dhe më konkretisht:

Shtojca 11

DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROCES²

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë 23.11.2020 nga Autoriteti Kontraktor "Bashkia Tropoje" me objekt "Rikonstruksion i" 5 (pesc)Segmenteve Rrugore fshati Gri,Bujan,Cernice,Tropoje(2)" me fond limit 343 905 073 leke pa TVSH.

Unë i nënshkruari Ardit Metaliaj me cilësinë e Administratorit të operatorit ekonomik 4 A-M shpk deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës së prokurimit/kontratës	Vlera e shpallur fituese (LEKE pa TVSH)
1	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Ndërtimi i Rrjetit Rrugor dhe Infrastrukturës Urbane të Zonës Fushë Krujë Zona 1	278 173 980 leke
2	Ujesjelles Kanalizime Tirane sh.a.	Ndërtimi i Godinës së Re të Ujesjellësit	564 424 268.94 leke me TVSH (4 A-M 75 % që i korrespondon vlerës 423 318 202)
3	Autoriteti Rrugor Shqiptar	Ndërtim Rruga Porto Romano Durres, Loti 3	771 084 915 leke me TVSH
4	Bashkia Kamez	Ndërtim Ura Paskuqan 1	102 917 980.32 leke me TVSH
5	Ujesjelles Kanalizime Tirane sh.a.	Permirësim furnizimi me ujë në zonën e Kasharit	9 128 564 leke me TVSH
6	Bashkia Tirane	Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.1)	305 946 636.93 leke pa TVSH

Data e dorëzimit të deklaratës: 23.11.2020

Përfaqësuesi i ofertuesit Ardit Metaliaj

Nënshkrimi

Vula

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik)

DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROCES⁴

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë: **23.11.2020** nga Autoriteti Kontraktor: **Bashkia Tropoje** me objekt: **Rikonstruksion i" 5 (pese)Segmenteve Rrugore fshati Gri,Bujan,Cernice,Tropoje(2)"** me fond limit: **343 905 073 Leke.**

Unë i nënshkruari Zeqir BUSHGJOKAJ me cilësinë Administratorit të operatorit ekonomik FLORIDA Shpk deklaroj se kam në proces dhc/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës se prokurimi/kontratës	Vlera e shpallur fituese
1	Drejtoria e Rajonit Verior Shkoder.	Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga "B.Curri - Valbonë, U.Bujan - Q.Morinë (doganë), Sopot-Kernajë, Q.Mejdan -Tropoje-Bucaj	192.052.710 Lekë pa TVSH.
2	Bashkia Tropojë	Ndertim i Ujesjellsit Fshati Dragobi.	20 % e vleres 56.891.216 Lekë pa TVSH.

Data e dorëzimit të deklaratës 23.11.2020

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula



Shënim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

OE òF.ò ShPK, ka paraqitur deklaratën e punëve në proces, ku ndër të tjera ka deklaruar dhe objektin òNdertim i ujësjiellësit fshati Dragobiò, ku ka marrë përsipër 20% të punimeve. Në këtë objekt, fituesi është BOE i përbërë nga OE ò4.Mò ShPK që ka marrë përsipër 80% të punimeve, ndërkohë që nuk e ka deklaruar këtë punë në proces në deklaratën e saj.

Gjithashtu OE ò4.Mò ShPK, nuk ka deklaruar edhe këto punë të tjera në proces dhe më konkretisht:

Sipas buletinit nr. 35, datë 15.06.2020 të APP, nuk ka deklaruar këtë kontratë të lidhur me bashkinë Kolonjë, buletinit nr. 85, datë 12.10.2020 të APP, nuk ka deklaruar këtë kontratë të lidhur me bashkinë Përmet, buletinit nr. 99, datë 09.11.2020 të APP, nuk ka deklaruar këtë kontratë të lidhur me Posta Shqiptare sh.a.

BASHKIA KOLONJË

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri	Bashkia Kolonjë
Adresa	Sheshi " Rilindja "
Tel/Fax	+355 812 23173 ; 0812 22 25 ; 22 32
E-mail	bashkia.kolonje@gmail.com
Faqja e Internetit	http://www.kolonja.gov.al

2. Lloji i procedurës: "E HAPUR", "PUNË",prokurim me mjete elektronike.

3. Objekti i kontratës: Rikonstruksion i rrjetit të brëndshëm dhe të jashtëm të furnizimit me ujë të qytetit të Leskovikut.

4. Numri i referencës së procedurës: REF-53703-03-10-2020

5. Fondi limit : 231,309,747 (Dyqindetridhjetëenjëmilionetreqindetërmijëeshtatëqindedyzetë eshtatë) lekë pa tvsh.

6. Vlera totale përfundimtare e kontratës (duke përfshirë lotet opsionetdhe nenkontraktimin):

Vlera	274,456,182	me Tvsh	Monedha	Lekë
Vlera e nenkontraktimit	_____	me Tvsh	Monedha	_____

7. Data e lidhjes së kontratës Nr. 6 dhe Nr.2104 Prot Data e Kontratës: 08 / 06 / 2020

8. Emri dhe adresa e kontraktorit BOE " Arkonstudio Shpk " dhe " 4 A-M Shpk "

Emri	Arkonstudio Shpk
Adresa	Tiranë,Rruga Mihal Duri, Objekti Nr. 33
Nr. NIP1	L420190041
Emri	4 A-M Shpk
Adresa	Tiranë ,Rruga Artan Lenja Pallati i 4 A-M, Apartamenti A1, kati i I-rc
Nr. NIPT	K92005016L

BASHKIA PËRMET

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor
Emri Bashkia Përmet
Adresa Sheshi "Abdyl Frashëri", kati i IV
Tel/Fax +35581322254
E-mail info@bashkiapermet.gov.al
Faqja në Internet http://www.bashkiapermet.gov.al

2. Lloji i procedurës: PROCEDURË E HAPUR

3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: "Ndërtim i rrjetit ujitës Bodar-Kutal"

4. Numri i referencës së procedurës/lotit: REF- 67956-08-06-2020

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Këshilli i Ministrave Tel.+ 355 4 22 77 510 <https://www.app.gov.al> 365/453

Buletini Nr. 85 datë 12 Tetor 2020

Agjencia e Prokurimit Publik

5. Fondi limit 22 399 254 (njëzetë e dy milion e treqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH

6. Vlera totale përfundimtare e kontratës (duke përfshirë lotet opsionet dhe nenkontraktimin):

Vlera 26 867 173,3 (njëzetë e gjashtë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e njëqind shtatëdhjetë e tre presje tre) lekë me TVSH
Monedha Lekë

7. Data e lidhjes së kontratës 06.10.2020

8. Emri dhe adresa e kontraktorit/nenkontraktimit

Emri: Bashkimin e Operatorëve Ekonomik "I.D.K KONSTRUKSION" sh.p.k & "4 A-M" sh.p.k
Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km.12, Rruga Zaja, Koder Bexulle, Nr.Pasurie 1014/3, ZK.1167 Vorë, Tiranë
Nr. NIPT K51408016J K92005016L

Buletini Nr. 85 datë 12 Tetor 2020

Agjencia e Prokurimit Publik

5. Fondi limit 22 399 254 (njëzetë e dy milion e treqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH

6. Vlera totale përfundimtare e kontratës (duke përfshirë lotet opsionet dhe nenkontraktimin):

Vlera 26 867 173,3 (njëzetë e gjashtë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e njëqind shtatëdhjetë e tre presje tre) lekë me TVSH
Monedha Lekë

7. Data e lidhjes së kontratës 06.10.2020

8. Emri dhe adresa e kontraktorit/nenkontraktimit

Emri: Bashkimin e Operatorëve Ekonomik "I.D.K KONSTRUKSION" sh.p.k & "4 A-M" sh.p.k
Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km.12, Rruga Zaja, Koder Bexulle, Nr.Pasurie 1014/3, ZK.1167 Vorë, Tiranë
Nr. NIPT K51408016J K92005016L

“POSTA SHOIPTARE” SH.A

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri “Posta Shqiptare” Sh.a
 Adresa Rruga “Reshit Çollaku”, Nr.4, Tiranë
 Tel/Fax 042222315
 Faqja e Internetit www.postashqiptare.al

2. Lloji i procedurës: E Hapur.

3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: “Rikonstruksion i Filialeve të Postës Berat, Lushnje dhe Fier”.

4. Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-62906-06-25-2020

5. Fondi limit: 43.596.234 (dyzet e tre milion e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e tridhjetë e katër) lekë pa tvsh

6. Vlera totale përfundimtare e kontratës: 51.713.312,16 (pesëdhjetë e një milion e shtatëqind e trembëdhjetë mijë e trëqind e dytëdhjetë presje gjashtëmbëdhjetë) Lekë me T.V.SH

7. Data e lidhjes së kontratës 02.11.2020

8. Emri dhe adresa e kontraktorit: Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Iliriada” sh.p.k. me NIPT J61828125L, Adresa: Artan Lenja”, Pallati “4A-M”, Shkalla 1, Kati i 2, Apartamenti Nr.7, Zone Kadastrale 8220, Tiranë & “4 A-M SHPK” sh.p.k me NIPT K92005016L, Adresa: Rruga “Artan Lenja”, Pallati “4 A-M”, Apartamenti A1, kati i I-rë, Tiranë.

Sa më sipër KVO nuk e ka konstatuar faktin se ky OE ka paraqitur deklaram të rremë në këtë procedurë prokurimi. Mosveprimi i KVO për paraqitjen e deklaramit të rremë, nga ana e OE 04.Mö ShPK, është në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 47, òS`kualifikimi i ofertuesveò, në të cilin kërkohet sa vijon: òAK s`kualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme, për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në fazën e shpalljes së kontratës fituese. AK për çdo s`kualifikim raporton APP, për qëllimet e parashikuara në nenin 13, pika 3 e këtij ligji.ò.

Neni 13, pika 3, ka përcaktuar se: ò3. APP përjashton një OE nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit pavarësisht nga çështja penale, që mund të ketë filluar , për një periudhë nga 1 deri në 3 vjet, për: keqinformim dhe dorëzim të dokumenteve që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, përcaktuar në nenet 45 e 46 të këtij ligji.ò.

Mangësitë e OE “F.” shpk janë si vijon:

Për plotësimin e kriterit në lidhje me makineritë, OE òF.ò ShPK ka paraqitur shtojcën 10 -Mbi disponimin e makineriveò si dhe ka paraqitur disa kontrata noteriale si më poshtë vijon: 1-Kontratë noteriale me nr. 6939 Rep., dhe 5253 Kol., të datës 21.11.2020 të lidhur me shoqërinë òA. B.ò ShPK, me anë të së cilës ka marrë me qira ndër të tjera 4 kamionë me targa: TR 1065 N, TR 1067 N, AA 627 TM dhe AA 028 VG.

Në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 òPër transportet rrugoreò, neni 1, 3, 5 dhe Kreut III.1, òTransporti i mallrave me qira dhe për të tretëò, nenet 41, 42, 43 dhe 44, si dhe Kreut III.2, òTransporti i mallrave për vetëò, nenet 45, 46, dhe 47, bëhet qartësisht ndarja midis këtyre mënyrave të transportit dhe përcaktohet ndalimi i secilës nga mënyrat e transportit pa pajisjen me licencën përkatëse.

Në rastet konkrete, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se certifikatat e mjeteve të mësipërme të cilat i disponon shoqëria “A. B.” ShPK sipas lejeve të qarkullimit, janë specifike dhe të lëshuara vetëm për transport për vete, për kryerjen e transportit të mallrave me kamion, vetëm për llogari të veprimtarisë së operatorit ekonomik “A. B.” ShPK.

Në këtë mënyrë, kryerja e transportit të mallrave nga ana e shoqërisë òF.ò ShPK me kamionët e shoqërisë òA. B.ò ShPK do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa licencën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit òPër transportet rrugoreö është i ndaluar.

Mangësitë e OE “V.” ShPK janë si vijon:

Në DST është kërkuar: *Deklaratë mbi kontratat e lidhur apo në proces, sipas Shtojcës 11;*
Për plotësimin e këtij kriteri, OE òV.ò ShPK, ka paraqitur këtë deklaratën si më poshtë vijon, në të cilën nuk ka paraqitur kontratën e lidhur me Bashkinë Tropojë, sipas buletinit nr. 99, datë 09.11.2020 të APP.

Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik)

DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROCES⁴

E operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë: 23.11.2020; nga Autoriteti Kontraktor: *Bashkia Tropoje*; me objekt: *Rikonstruksion i " 5 (pese) Segmenteve Rrugore fshati Gri, Bujan, Cernice, Tropoje(2) "*; me fond limit: *343 905 073* pa tvsh

Unë i nënshkruari Bashkim Byberi me cilësinë D/Ligjor të operatorit ekonomik Vllaznimi shpk deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës së prokurimit/kontratës	Vlera e shpallur fituese
1	S'ka	S'ka	S'ka

Data e dorëzimit të deklaratës 23.11.2020

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Bashkim Byberi

Sipas buletinit nr. 99, datë 09.11.2020 të APP, nuk ka deklaruar këtë kontratë të lidhur me Bashkinë Tropojë

BASHKIA TROPOJE

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor
Emri Bashkia Tropoje
Adresa Sheshi Azem Hajdari ,Bajram Curri

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Këshilli i Ministrave Tel.+ 355 4 22 77 510 <https://www.app.gov.al> 349/444

Buletini Nr. 99 datë 9 Nëntor 2020

Agjencia e Prokurimit Publik

Tel/Fax 0213-22-373 068 23 30 341
E-mail bashkiatropoj@gmail.com
Faqja në Internet _____

2. Lloji i procedurës: __Kerkese per Propozim

3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër Rikonstruksion i kanalit vadites Ahmataj – Sopot,(Vepra e marrjes), Bashkia Tropoje

4. Numri i referencës së procedurës/lotit REF-72539-09-22-2020

5. Fondi limit __1 847 831 (Nje milion e teteqind e dyzet e shtate mije e teteqind tridhjetë e nje)lek pa tvsh __

6. Vlera totale përfundimtare e kontratës (duke përfshirë lotet opsionet dhe nenkontraktorit):

Vlera 2 183 345 __ (me TVSH) Monedha __Lek__

Vlera e nenkontraktimit _____ me Tvsh Monedha _____

7. Data e lidhjes së kontratës _05/11/2020

8. Emri dhe adresa e kontraktorit/nenkontraktorit
Emri VLLAZNIMI SHPK
Adresa Sheshi Azem Hajdari ,B. Curri ,Tropoje
Nr. NIPT J796026010

Sa më sipër KVO nuk e ka konstatuar faktin se ky OE ka paraqitur deklaram të rremë në këtë procedurë prokurimi. Mosveprimi i KVO për paraqitjen e deklaramit të rremë, nga ana e OE òV.ò ShPK, është në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 47, òS` kualifikimi i ofertuesveò, në të cilin kërkohet sa vijon: òAK s` kualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme, për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në fazën e shpalljes së kontratës fituese. AK për çdo s` kualifikim raporton Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 13, pika 3 e këtij ligji.ò.

Si konkluzion: KVO nuk duhet të kishte kualifikuar ò4.Mò ShPK & òF.ò ShPK & òV.ò ShPK dhe nuk duhet të kishte propozuar titullarit për shpalljen fitues të tij. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, sipas neneve 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika nr. 1, germa (ç), neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3.

Shpallja fitues e BOE ò4.Mò ShPK & òF.ò ShPK & òV.ò ShPK, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar paligjshmëri në zbatimin e procedurës së prokurimit të fondeve publike në vlerën 340,421,901 lekë dhe ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga: M. V., P. R. dhe Sh. D..

Nuk është në dosje Shtojca 19 kushtet e veçanta të kontratës.

Bashkëlidhur kontratës nuk janë kushtet e veçanta të kontratës shtojca 19, si dhe nuk është përcaktuar drejtuesi i projektit, neni 3 i KVK, òDrejtuesi i Projektitò, pikat 3.1 dhe 3.2.

Kriteri: Dokumentet standarde të procedurës së prokurimit;Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, i ndryshuar;Buletinet e APP, etj.

Ndikimi/efekti: Paligjshmëri në zbatimin e procedurës së prokurimit të fondeve publike në vlerën 340,421,901 lekë

Shkaku: Mos zbatimi i kriterëve të veçanta për kualifikim të DST si dhe akteve nënligjore e ligjore të LPP.

Rëndësia: e lartë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni nëpërmjetë postës elektronike në adresën lbaholli@klsh.org alnga z.R. B., z.H. I., z.M. V., z.E. M., z.M. K., znj.A. H., z.B. B., z.Sh. D., z.P. K., ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Oponenca teknike. Konstatimi është i sakte, objektet nuk kane oponence teknike, mbasi jemi nisur nga vlere a secilit objekt, tek e tek, me projekte te hartuara nga kompani te ndryshme, dhe me mendimin se nuk kërkohet ky shërbim, mbasi vlera e asnjërit nga objektet nuk i kalon 100 milion, bazuar ne ligjin nr. 8402, te ndryshuar, me ligjet nr. 9200/2004, nr. 9794/2007, nr. 10324/2010, nr. 11/2012, dhe nr. 20/2013, pa patur dijeni as njoftim për përdorimin e ligjit nr. 3/2020, duke qene se edhe objektet per te cilat behet fjale, janë projektuar përpara kesaj periudhe, te hyrjes se këtij ndryshimi ne fuqi. Tani e tutje oponenca teknike do te kerkohet, sipas ligjit, 3/2020, per çdo projekt. (Bashkëlidhur janë dy ligjet ne fjale).

*Ku flitet per VNM- ne per rastin e **Rrugës Cerrnice**, sqarojme se pavaresisht nga ndryshimi i bazes ligjore per kte problem, çeshtje e vleresimit te ndikimit ne mjedis, nuk eshte anash kaluar, as per kte object dhe as per objektet e tjera, mbasi ne momentin e marrjes se Lejes se Ndertimit, ashte marre paraprakisht edhe mendimi perkates i Agjensise Kombetare te Mjedisit. (Bashkelidhur po ju sjellim edhe kte mendim per secilin objekt).*

*Po aty, **ne krye te Fq. 4**, ku thuhet se **nuk eshte bere perditesimi i projektit me terrenin**, ju sqarojme se per te gjitha projektet, e hartuara perpara vitit 2015, me **urdherin e Kryetarit te Bashkise, Nr. 250, date 19. 11. 2019**, eshte ngritur grupi i punes, per rishikimin e projekt-preventivave ekzistuese, qe do te financoheshin nga Bashkia Tropoje. Te gjitha detajet konstatimet dhe ndryshimet, ne zerat e punes dhe ne volume, per secilin objekt, ashtu siç i keni konstatuar edhe ju, jane te paraqitura e pasqyruara edhe ne **Relacionin Sqarues**, te rishikimit te objekteve ne terren, si dhe ne preventivat e objekteve per tenderim, ne zbatim te ketij urdheri. (Bashkelidhur Urdheri dhe Relacioni perkates). **Theksojme se Inxh. E. M. nuk ka qene ne grupin e rishikimit te projekteve, mbasi eshte punesuar ma vone ne instutucionin tone.***

*Ndersa persa i perket zerit te punimit, **Shtrese asfalto-betoni, granil gure kave**, lenë tek preventivat e tenderimit me shifer 0, kjo ashte ba me porosi, mbasi ky ze pune, per mungese fondesh do te tenderohet si nje kontrate e vecante ne nje faze te dyte. Materiali teknik per keto eshte gati.*

*Po aty, ne **Fq.4, Pika 2/2**, per **Rrugen Bujan - T'pla**, thuhet se mungon preventive i firmes projektuese, ne fakt ky preventive, ndodhej ne dosjen, e zbatimit, te objektit, dhe po ua dergojme bashkelidhur.*

*Ndersa persa i perket projektit te ketij objekti, **shenuar po aty, ne fq 4**, sqarojme se, ndersa eshte pare dosja e tenderimit, ne dosjen e zbatimit **gjendet projekti original**, me firma dhe vula nga Shoqeria Projektiese, dhe inxh G. Shehaj. (Per transparence disa flete te skanuara nga ky projekt).*

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se komentet tuaja me përjashtim të oponencës teknike merren në konsideratë pasi ju keni paraqitur prova dhe fakte të tjera.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga operatori ekonomik "4.M" shpk., është paraqitur observacioni në adresën zyrtare të emailit në datën 27.07.2021, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i operatorit ekonomik "4.M" shpk: përsa i përket mosdeklarimit të të gjitha punëve në proces, prej shoqërisë nuk është keqinformuar apo paraqitur dokumentacion me të dhëna të rreme nga ana e kompanisë sonë për qëllime kualifikimi pasi shoqëria jonë ò4.Mò shpk ka qenë brenda kufijve maksimalë të parashikuar të licensës dhe si rezultat i këtij fakti nuk ka pas arsye për të dhënë informacion të rremë.

Mos evidentimi i kontratave të mësipërme të referuara nga KLSH ka ardhur si rezultat i gabimit njerëzor duke iu referuar faktit se shoqëria ò4.Mò shpk ka qenë pjesëmarrëse e bashkimit të operatorëve tek këto kontrata por jo përfaqësuese e tij.

Por pavarësisht kësaj sikurse e pasqyruam më sipër shoqëria jonë nuk ka pasur arsye për të keqinformuar dhe dorëzuar dokumente, që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, përcaktuar në nenet 45 e 46 të këtij ligji.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, ato nuk merren në konsideratë pasi ju keni detyrimin të deklaroni të gjitha punët në proces, dhe për këtë arsye komentet tuaja nuk merren parasysh.

2.Titulli gjetjes: Mangësi në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të procedurës së prokurimit publik me objekt: **"Rikonstruktion i kanaleve vaditese"**, me këto të dhëna:

Urdhër prokurimi 12/ 13.05.2020	NJHDT: Nr. 12/ 13.05.2020	KVO: nr. 19/ 13.05.2020
Lloji i procedurës òKërkesë për Propozimò	K. B. L. V. F. Q.	P. R.; K. A.; A. T..
Fondi limit 5,500,000lekë.		
Burimi Financimit:	OE fitues: òG.ò ShPK	OE Pjesëmarrës në tender: 7
Data e hapjes tenderit: 08.06.2020	Vlera e fituar: 3,494,818 lekë	Sòkualifikuar 1
Ankimime në AK: s`ka	Diferenca me FL: 2,005,182 lekë	Kualifikuar 6
Ankimime në KPP:- s`ka	Miratimi i procedurës datë 24.06.2020	Kontrata nr.7, datë 17.07.2020
Titullari i AK: Personi i autorizuar nga Titullari i AK Nën Kryetar A. K.		Vlera 4,193,782 lekë.

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlllogaritja e fondit limit: Me urdhrin nr. 18, datë 04.05.2020 të personit të autorizuar nga Titullari i AK, N/ Kryetar A. K., është ngritur grupi i punës për fondin limit dhe specifikimet teknike i për bërë nga: K. R.; B. G.; M. V..

Grupi sa më sipër sipas procesverbalit datë 13.05.2020, ka hartuar preventivin e punimeve dhe në analizat teknike të çmimit të zërave të punës për prita provizore për devijim lumi i Gashit dhe kanali Vigi i Vakës thuhet që është përdorur manuali i preventivit nr. 3, analiza 352, pa përcaktuar i kujt viti është ky manual si dhe libri i normativave të vitit 1981 me nr. 200 dhe 227, në një kohë që në RSH ekzistojnë analiza teknike të çmimeve ku më i fundit është i vitit 2015.

Ndërsa për tubat e brinjëzuar HDPE, me nr. fi të ndryshme ka marrë ofertë çmimi nga òFerrplastò Ferizaj, datë s`ka, të vlefshme si ofertë për 30 ditë, ofertë e pa kërkuar pasi nuk ka dokumentacion që të vërtetojë një gjë të tillë.

Në fund të këtij procesverbalit në paragrafin e fundit thuhet se: òPër detaje më të veçanta do të përcaktohen me kontratën objekt prokurimiò.

Theksojmë se çdo detaj sqarohet në DST ku çdo pjesëmarrës duhet të jetë i qartë për çfarë kërkohet. Sa më sipër është në kundërshtim me LPP dhe RPP.

Bashkëlidhur këtij procesverbalit gjenden përveç preventivit të punimeve:

- Projekti i prizë tip;
- Projekti pritë provizore ó devijim sezonal i lumit;
- Projekti ndërtim i murit të shembur kanali i Krasniqës òpërballë lapidarit të Këlsyrës;
- Projekti i mbrojtjes së kanalit nga shembje afër HEC të Këlsyrës;

- Tre projekte riparim vepra arti (riparimi i prizave dhe 2 riparime të njëpasnjëshme.

Asnjë nga këto projekte nuk ka firmë se nga kush është hartuar,

Gjithashtu nga auditimi i preventivit të punimeve rezultojnë kapitujt sa më poshtë vijon:

Në lekë.

Nr. Kap.	Objekti i kapitullit	Vlera
I	Rikonstruksion i kanalit të Krasniqes ku zërat e gërmim kanali shkojnë nga l= 5437 ml ó 420 ml)	537,547
II	Rikonstruksion i Kanalit të Gashit (l= 2100 ml)	601,119
III	Rikonstruksion i kanalit Vigi Vakes - Cërrnicë	1,408,691
IV	Rikonstruksion i kanalit Mahall Epër, Zogaj, Kepenek	369,528
V	Rikonstruksion i kanalit Shoshan	621,445
VI	Rikonstruksion i kanalit Shumicës	333,200
VII	Rikonstruksion i kanalit Llugajt (stacioni i pompave)	239,171
VII	Rikonstruksion i kanalit Bukovës (nga galeria e Rrogamit)	208,551
IX	Rikonstruksion i kanalit Bucaj dhe Tafaj Shipshan	142,712
X	Rikonstruksion i kanalit Kasaj - Vigidol	362,836
XI	Rikonstruksion i kanalit Lekbibaj, fshati Palc	70,000
XII	Rikonstruksion i kanalit fshati Rajë	185,883
XIII	Rikonstruksion i kanalit fshati Pac	260,170
XIV	Rikonstruksion i kanalit fshati fushë Lumi	126,000
XV	Rikonstruksion i kanalit fshati Babin	36,409

Për të cilat nuk ka projekte për punët që do të kryhen objekt i procedurës së prokurimit.

Hartimi i dokumenteve të tenderit: Procesverbali i hartimit të DT mban datën 20.05.2020. NJHD ka përcaktuar për të ftuar këta OE: òL.ò ShPK; òV.ò ShPK; òT.ò ShPK; òD.ò ShPK; òSh.ò ShPK.

Në hartimin e DT rezulton se nuk ka gjetur zbatim pika 1, e nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.01.2006, ndryshuar si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, sa vijon:

1- Seksioni II, òInformacione të veçanta për kontratatò, neni 26 òKontratrat për punë publikeò, pika 7.

2- Kreu VII, òZyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i proceduraveò, neni 61, òHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitò, pika 2, paragrafi 2.

Konkretisht kërkesat në lidhje me kategoritë e licencave, numrin e punonjësve dhe kategoritë e punësimit, numrin dhe llojin e mjeteve etj., nuk janë argumentuar me zbërthimin e preventivit dhe sipas grafikut të punimeve.

Si dhe nuk kanë mbështetje ligjore kërkesat në lidhje me sa vijon:

Në DT është kërkuar: Vërtetim për xhiro mesatare vjetore për tre vitet e fundit (2016, 2017, 2018) jo me te ulet se vlera e fondit limit qe prokurohet, dhe Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimorë.(Ku te cilësohet ky Vërtetim jepet për tender).(nënshkrim elektronik)

➤ Në lidhje me këtë kërkesë sqarojmë se nuk ka kuptim kërkesa e bërë nga AK që ky vërtetim të jepet për tender. Për çfarëdo arsye që të jepet ky vërtetim, nuk ndryshon shuma e tij, pasi xhiro vjetore është një shumë fikse financiare.

Në DT është kërkuar: Një punësim mesatar i të paktën **30** punonjësve të siguar.

Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve të figurojnë listë pagesën e muajt Janar-Mars 2020. (nënshkrim elektronik)

Listë pagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për të gjithë periudhën e kërkuar më sipër, shoqëruar këto dhe me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe TAP.

➤ **Kërkesa shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore**, është një kërkesë e fryrë dhe e tejkaluar e LPP, pasi nga vetë organet tatimore, bazuar në UMF nr. 23, datë 09.12.2014, òPër mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësoreò, të dalë në zbatim të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 òPër mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisëò, të ndryshuar, në të cilin në pikën 10, òTë tjeraò.

Sa më sipër fakti që OE ka marrë vërtetimin nga administrata tatimore dhe listë pagesat do të thotë që e ka paraqitur formularin e deklaratimit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

➤ **Kërkesa për numrin e mesatar të punësimit nuk është e argumentuar sipas grafikut dhe preventivit të punimeve bazuar në VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe te analizave teknike të tyre"**

Në DT është kërkuar: Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik (drejtues teknik licence) për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme noteriale, diplomë, CV, stafin inxhinierik si më poshtë:

Ing. hidroteknik 1

Ing . topograf 1

1 manovrator te punësuar, dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive te renda te lëshuar nga organet kompetente DPSHTRR, dhe te figuroj në listë pagesën e shoqërisë për *Janar-Mars 2020 e në vazhdim*.

2 shofer kamioni te punësuar, leje drejtimi mjete te lëshuar nga organet kompetentë dhe te figurojë në listë pagesën e shoqërisë, për muajin *Janar-Mars 2020 e në vazhdim*.

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion qe nevojitet për ekzekutimin e kontratës OE duhet të paraqesë si më poshtë:

Nr.	lloji i makinerive	pronësia	sasia minimumi
1.	Kamionë me kapacitet mbi 16 ton	Në pronësi ose me qira	2 copë
2.	Kamionçine	Në pronësi ose me qira	2 copë
3.	Ekskavator me zinxhir	Në pronësi ose me qira	1 copë
4.	Vibrator Betoni	Në pronësi ose me qira	1 copë
5.	Autobot uji	Në pronësi ose me qira	1 copë
6.	betoniere 0.5 m3	Në pronësi ose me qira	4 copë
7.	Saldatrice	Në pronësi ose me qira	1 copë
8.	Minieskavator me zinxhir gome	Në pronësi ose me qira	1 copë
9.	Autovinç	Në pronësi ose me qira	1 copë

➤ **Kërkesat sa më sipër nuk janë argumentuar me volumet dhe grafikun e punimeve bazuar në VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".**

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 òPër rregullat e Prokurimit Publikò sipas të cilit: òKërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratësò, **ngarkohet me përgjegjësi NHJDT të përbërë nga K. B., L. V. dhe F. Q.** **Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Procedura e prokurimit është hapur më datë 08.06.2020 dhe është vlerësuar sa më poshtë vijon:

Nr.	Operatorë ekonomikë	Oferta	Vlerësimi i KVO
1	òG.ò shpk	3,494,818	Kualifikuar dhe shpallur fituese
2	òT. D.ò shpk	3,934,105	Kualifikuar
3	òH. 1.ò shpk	4,265,860	Kualifikuar
4	òA.ò shpk	4,416,049	Kualifikuar
5	òZ.ò shpk	4,686,052	Kualifikuar
6	òV.ò shpk	5,476,102	Kualifikuar
7	òT.ò shpk	5,000,000	S'kualifikuar pasi: - Mungojnë dosjet e inxhinierëve, makineritë, shtojcat janë të pa firmosura. - Oferta është me shumë mangësi në dokumentacion.

Nga auditimi rezulton se në këtë procedurë prokurimi ka fituar vlera më e ulët e vlefshme.

Raporti përmbledhës mban datën 23.06 2020. Nga ky raport rezulton se KVO nuk ka vepruar në lidhje me përlllogaritjen e gabimeve aritmetike si dhe për përlllogaritjen e vlerës anoM.sht të ulët.

Miratimi i procedurës së prokurimit është bërë me vendimin nr. 4, datë 24.06.2020.
Kontrata nr. 7, datë 17.07.2020, është lidhur me vlerë 4,193,782 lekë me afat 1 muaj.
 Bashkëlidhur kontratës nuk janë kushtet e veçanta të kontratës shtojca 19, si dhe nuk është përcaktuar drejtuesi i projektit, neni 3 i **KVK “Drejtuesi i Projektit”**, pikat 3.1 dhe 3.2.
Në lidhje me këtë procedurë prokurimi me vendimin e KPP nr.46, datë 27.04.2021, bazuar në një denoncim të bërë, nga ana e KPP, pasi janë konstatuar shkeljet e mësipërme si dhe në drejtim të vlerësimit, sipas të cilit janë dënuar me gjobë 50,000 lekë NJHDT dhe KVO.

3.Titulli gjetjes: Mangësi në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të procedurës së prokurimit publik me objekt: òRikonstruksion i kompleksit sportiv te lojrave me dorë, Bajram Curriò, me këto të dhëna:

Urdhër prokurimi Nr. 36, datë 24.09.20	NJHDT: K. B.	KVO: nr. 58, datë 24.09.20 M. V.
Lloji i procedurës òe hapurò	H. I.	Sh. D.
Fondi limit 17,814,500 lekë.	B. B.	P. R.
Burimi Financimit:	OE fitues: òSh. A.ò ShPK & òT.ò ShPK	OE pjesëmarrës në tender: 1 Skualifikuar 0 Kualifikuar 1
Data e hapjes së tenderit: 16/11/2020	Vlera e fituar: 16,928,438 lekë	Kontrata nr. 18, datë 10.12.2020 Vlera 20,314,126 lekë.
Ankimime në AK: s`ka	Diferenca me fondin limit 886,062lekë	
Ankimime në KPP: s`ka.	Miratimi procedurës 26.11.2020	Afati 6 muaj
Titullari i AK: Personi i autorizuar nga Titullari i AK Nën Kryetar A. K.		

Situata nr.1:

Hartimi i projektit: Projekti është hartuar nga òD. E.ò shpk dhe është miratuar nga personi i autorizuar nga Titullari i AK Nën/Kryetar A. K. Ky projekt thuhet se është hartuar nga òD. E.ò shpk i përbërë nga grupi i projektimit: B D., Q Q., E Th., M R. dhe A K., por në asnjë prej fletëve nuk është e firmosur prej tyre dhe nuk ka miratim. Gjithashtu ky projekt nuk ka datë kur është hartuar.

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlllogaritja e fondit limit: Me urdhërin nr. 56, datë 22.09.2020 të personit të autorizuar nga Titullari i AK Nën Kryetar A. K., është ngritur grupi i punës për fondin limit dhe specifikimet teknike i për bërë nga: A. H., P. K. dhe M. K..

Hartimi i DT: Procesverbali i hartimit të DT mban datën 24.09.2020. Në hartimin e DT rezulton se nuk ka gjetur zbatim pika 1, e nenit 46, të ligjit nr. 9643, datë 20.01.2006, ndryshuar si dhe me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, sa vijon:

1- Seksioni II, òInformacione të veçanta për kontratatò, neni 26 òKontratat për punë publikeò, pika 7.

2- Kreu VII, òZyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i proceduraveò, neni 61, òHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitò, pika 2, paragrafi 2.

Në lidhje me kriteret për kualifikim nga ana e APP me email datë 21.03.2020, janë sugjeruar modifikime të KVK:

- *Heqjen e klasifikimit B të kategorive të licencës;*
- *Heqjen e kategorive NP 4, NS 2, NS 19;*
- *Heqjen e kërkesës për inxhinier gjeolog;*
- *Për kohëzgjatjen e kërkesës për paraqitje të listë pagesave;*
- *Për prezencën e drejtuesit teknik;*
- *Për mjek*
- *Për person të certifikuar për ndihmën e parë;*

- Për person përgjegjës për sigurinë dhe higjienën në punë;
- Për përgjegjës për dëmet në mjedis;
- Për koordinator për realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë;
- Për 4 manovrator, 5 karpentier, 8 specialist ndërtimi, 3 hekurkthyes, 5 shofer, 5 punonjës në larësi;
- Për shërbime ekspertize të mbrojtjes civile kodi I.2.A;
- Për shërbime hyrëse higjieno shëndetësore, kodi II.8.B ;
- Për numrin 70 të punonjësve të kërkuar;
- Për certifikatat ISO;
- Për kërkesat e elementëve të pasqyrave financiare të OE;
- Për fatura për çdo situacion punimesh;
- Në lidhje me mjetet e kërkuara.

Nga ana e NJHDT është hartuar shtojca nr. 1, datë 02.11.2020, ku janë reflektuar minimisht sugjerimet e APP (analizuar më hollësisht në akt konstatimin nr.4, datë 04.06.2021).

Sa më sipër NJHDT ka bërë pjesërisht modifikime të DT, por pa i argumentuar ato, konkretisht kërkesat në lidhje me kategoritë e licencave, numrin e punonjësve dhe kategoritë e punësimit, numrin dhe llojin e mjeteve etj., nuk janë argumentuar me zbërthimin e preventivit dhe sipas grafikut të punimeve.

Si dhe nuk kanë mbështetje ligjore kërkesat në lidhje me sa vijon:

Në DT është kërkuar: Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm OE duhet të paraqesë kopje të certifikuara të bilanceve të 3 viteve të fundit ushtrimore (2017, 2018, 2019), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet.

➤ Kriteri i përcaktuar nga ana e NJHDT që pasqyrat financiare të pasqyrojnë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, është evaziv dhe jo konkret. NJHDT duhet të kishte përcaktuar parametra dhe elementë konkretë mbi të cilat do të kryhet vlerësimi i qëndrueshmërisë së aktivitetit.

Në DT është kërkuar: Licenca e shoqërisë të ketë kategoritë e punimeve.

Nga ana e NJHDT nuk janë argumentuar kategoritë me volumet e punimeve. Gjithashtu rezulton se për kategorinë N.P. 12 A (Punime të inxhinierisë mjedisore), nuk ka punime bazuar në përcaktimet e VKM nr. 42, datë 16.01.2008.

➤ Në lidhje me klasifikimin B òNP-2/B, Ndërtime civile dhe industriale theksojmë se fondi limit është shumë më 17,814,500 lekë dhe bazuar në VKM nr. 42, datë 16.01.2008, òPër miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, kategoria B është për punime me vlerë mbi 20 milion lekë.

➤ Nisur nga fakti që objekti i prokurimit është rikonstruksion nuk duhej kërkuar NP-2/B, Ndërtime civile dhe industriale, pasi është kërkuar kategoria NP-3/A, Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.

➤ Gjithashtu rezulton se për kategorinë N.P. 12 A (Punime të inxhinierisë mjedisore), nuk ka punime bazuar në përcaktimet e VKM nr. 42, datë 16.01.2008.

Në DT është kërkuar: Kualifikimet dhe eksperiencia e personelit kryesor si drejtues teknik në licencën e shoqërisë të cilët do të realizojë zbatimin e objektit, të vërtetuara për secilin punonjës me diplome, kontrate pune të vlefshme, libreze pune. Shoqëria të ketë në stafin drejtues teknik në licence të cilët të figurojnë në listë pagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit (korrik-shtator 2020), një inxhinier Ndërtimi, një inxhinier hidroteknik, një inxhinier mekanik, një inxhinier elektrik, një inxhinier topograf dhe arkitekt me licence projektimi.

➤ **Numri prej 6 inxhinierësh në staf** si drejtues teknik, është i fryrë dhe ul konkurrencën në procedurë. OE mund të marrë staf edhe të punësuar me kontratë. Gjithashtu sa i përket kërkesës së autoritetit kontraktor që stafi i punonjësve të jetë i pasqyruar në listë pagesa, **kjo kërkesë kufizon numrin e shoqërive pjesëmarrëse që nuk zotërojnë staf teknik të përherëshëm** (gjë që reflektohet në listë pagesat e shoqërisë), por që kanë mundësinë të sigurojnë këtë staf, duke lidhur kontrata pune me afat sa afati i kontratës objekt prokurimi.

➤ **Në lidhje me kërkesën për arkitekt në staf si drejtues teknik, sqarojmë se** në dokumentet e procedurës së prokurimit AK ka publikuar njëherazi *Preventivin e punimeve*, *Relacionin Tekniko*, *Specifikimet Teknike*, *Grafikun e punimeve* dhe *Projektin e Zbatimit*, duke i vënë në dispozicion, informacionin OE pjesëmarrës mbi projektin të cilët këto të fundit do të zbatohen në rast të fitimit të kontratës. Disponueshmëria si pjesë e stafit teknik të një arkitekti në fazën e zbatimit të punimeve, ku ndër të tjera autoriteti kontraktor ka kërkuar referuar kritereve të veçanta të kualifikimit pjesë të stafit teknik, inxhinierët, si ndërtimi, hidroteknik, mekanik, gjeodet, elektrik, mjedisi, gjeolog, shkon përtej synimit të autoritetit kontraktor dhe njëherazi nuk është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës. Disponueshmëria e një arkitekti referuar natyrës së punimeve dhe duke marrë në konsideratë faktin se AK ka parashikuar në mënyrë të detajuar projektin e zbatimit, specifikimet teknike, nuk shfaqet e nevojshme në proporcion me natyrën dhe volumin e punimeve.

Në DT është kërkuar: OE duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt

➤ Kërkesë e përcaktuar në kundërshtim me kreun I, pika 2.1 të UKM nr. 2, datë 13.05.2005, *Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*, ku parashikohet se për punime deri në 30 milion lekë nuk është e detyrueshme qëndrimi i drejtuesit teknik në kantier gjatë gjithë periudhës së punimeve.

Në DT është kërkuar: OE ofertues duhet të ketë **1 mjek të përgjithshëm** të punësuar dhe të rezultojë në listë pagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune të vlefshme, Urdhër Mjeku, CV, librezë pune, diplomën përkatëse. *(Në rastin e bashkimit të OE, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë pjesë të stafit 1 mjek të përgjithshëm).*

➤ Kërkesa për mjek është e tepërt dhe nuk ka lidhje me asnjë nga përcaktimet e kontratës dhe është në kundërshtim me VKM nr. 632, datë 15.07.2015, e cila ka ndryshuar VKM nr. 108, datë 9.2.2011 Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë, pika 1.

Në DT është kërkuar: OE ofertues duhet të dëshmojë se ka pjesë të stafit të shoqërisë dy persona që përmbushin kriteret për të qenë: **përgjegjës/koordinator për realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve**, i cili duhet të jetë i pajisur me certifikatë/ dëshmi trajnimi (Përgjegjës/ koordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë) që tregon pjesëmarrjen e tij në kurse specifike për sigurinë, të organizuara nga subjekte të njohura publike ose private, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 datë 18.02.2010 *Për sigurinë dhe shëndetin në punë* dhe VKM. nr. 312, datë 05.05.2010 *Për miratimin e rregullores Për sigurinë në kantier dhe të rezultojë në listë pagesat e shoqërisë 3 muajt e fundit.*

➤ Koordinatorin është parashikuar për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë gjatë realizimit të punimeve, por duke qenë se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar edhe kërkesa që subjekti duhet të jetë i pajisur me certifikatën OHSAS 18001- 2007 mbi *Shëndetin dhe Sigurimin në punë*, konsiderohet e tepërt kërkesa për koordinatorin pasi certifikata OHSAS 18001-2007 në vetvete është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në

nivel ndërkombëtar dhe që përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurimit në punë. Shoqëritë që pajisen me këtë certifikatë duhet të plotësojnë kriteret përkatëse të cilat janë konsideruar të nevojshme nga institucionet certifikuese ndaj dhe kjo certifikatë i jep garanci autoritetit kontraktor lidhur me aftësinë dhe kapacitetet që disponon OE për menaxhimin e shëndetit e sigurisë në punë, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Në DT është kërkuar:OE ofertues duhet të ketë 1 “**Ekspert për auditim energjie**” të punësuar dhe të rezultojë në listë pagesat e shoqërisë 3muajt e fundit.

➤ Në nenin 16 pika 4 dhe 5 të ligjit nr. 125/2015 òPër efincencën e energjisë parashikohet se: ò4. Auditimi energjetik është i detyrueshëm për:

a) çdo person juridik, publik ose privat, që kategorizohet si konsumator i madh energjie;
b) të gjithë personat fizikë dhe/ose juridikë, që aplikojnë për një program të financuar nga Fondi për Efincencën e Energjisë për nxitjen dhe përmirësimin e efincencës së energjisë.

5. Auditimet energjetike të detyrueshme kryhen:

a) çdo 3 vjet për subjektet e përcaktuara në shkronjën òaö, të pikës 4, të këtij neni;
b) çdo herë, përpara se një ndërtesë, objekt industrial dhe objektet e tjera që vlerësohen, vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm.ò

Në dokumentet e procedurës së prokurimit, AK ka publikuar njëherazi òPreventivin e punimeveò, òRelacionin Teknikò, òSpecifikimet Teknikeò, òGrafikun e punimeveò dhe òProjektin e Zbatimitò. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në tërësi, konstatohet se në asnjë rast AK nuk ka parashikuar në òRelacionin Teknikò, òSpecifikimet Teknikeò kryerjen e shërbimit të auditimit të efincencës së energjisë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, nga auditues energjetik të licencuar. Gjithashtu AK nuk ka parashikuar si zë të veçantë kryerjen e shërbimit të auditimit të efincencës së energjisë. Sa më sipër, kriteri i mësipërm i vendosur nga AK në kriteret e veçanta të kualifikimit, nuk është proporcionale me objektin e procedurës së prokurimit, natyrën, përmasat e kontratës si edhe me qëllimin e kërkuar nga vetë AK. Bazuar në detyrimet që rrjedhin nga ligji nr. 124/2015 òPër efincencën e energjisëò, AK në çdo moment mund të kryejë procesin e auditimit energjetik me një procedurë të veçantë përpara hapjes së procedurës së prokurimit.

Në DT është kërkuar:OE duhet të ketë në stafin e tij, një person te certifikuar për *ndihmën e pare dhe ndërhyrje ndaj emergjencave*, i cili duhet të figurojë në listë pagesë e shoqërisë 3muajt e fundit.

➤ Në lidhje me këtë kërkesë sqarojmë se eksperiencia të tilla të kërkuara nga NJHDT nuk janë kusht i nevojshëm për të dëshmuar se OE ka kapacitetin e nevojshëm për ekzekutimin e kontratës. Këto janë kërkesa shtesë dhe të pa argumentuara duke mos qenë të lidhura ngushtë me objektin e procedurës së prokurimit. Si të tilla ato nuk kanë vend për të qenë kriterë kualifikuese.

Në DT është kërkuar:

- OE duhet të ketë ne stafin e tij, një person te certifikuar *përgjegjës për sigurinë dhe higjienën në kantieret e përkohshme të ndërtimit*, i cili duhet të figurojë në listë pagesën e shoqërisë 3muajt e fundit .

- OE duhet të ketë ne stafin e tij, një person te certifikuar (inxhinier mjedisi ose staf me kualifikim te ngjashëm) si *"Përgjegjës për dëmet në mjedis"* gjatë kryerjes së veprimtarisë, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 òPër mbrojtjen e mjedisitò me eksperiencë pune jo më pak se 3 vjet, i cili duhet të figurojë në listë pagesë e shoqërisë 3muajt e fundit .

➤ Në lidhje me këtë kërkesë sqarojmë se eksperiencia të tilla të kërkuara nga NJHDT nuk janë kusht i nevojshëm për të dëshmuar se OE ka kapacitetin e nevojshëm për ekzekutimin e kontratës. Këto janë kërkesa shtesë dhe të pa argumentuara duke mos qenë të

lidhura ngushtë me objektin e procedurës së prokurimit. Si të tilla ato nuk kanë vend për të qenë kritere kualifikuese.

Në DT është kërkuar: OE duhet të ketë në stafin e tij, një person të certifikuar **Përgjegjës për vlerësimin e risqeve në kantier**, i cili duhet të figurojë në listë pagesë e shoqërisë 3muajt e fundit .

➤ Bazuar në kërkesat e ligjit nr. 10237 datë 18.02.2010 ÷Për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe VKM. nr. 312, datë 05.05.2010 ÷Për miratimin e rregullores ÷Për sigurinë në kantierë, këto janë detyra të kantierit dhe jo të NJHDT, duke sjellë për rrjedhojë vendosjen e këtij kriteri jo në lidhje me objektin e prokurimit.

Në DT është kërkuar: OE duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, si më poshtë:

3 elektrikist	3 karpentier	3 pllakashtrues	2 hekurkthyes
2 saldator	3 bojaxhi	4 shofer	2 punonjës gipsi
2 teknik ndërtim, topograf, elektrik, gjeondertim	2 hidraulik	3 punonjës në lartësi	2 punonjës izolimi
2 manovrator	6 Specialist Ndërtimi		

➤ **Kërkesa sa më sipër nuk është e argumentuar sipas grafikut dhe preventivit të punimeve bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre"**

Në DT është kërkuar: Një punësim mesatar i të paktën 62 personave, për periudhën Korrik 2020-Shtator 2020 të vërtetuar me;

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Korrik 2020-Shtator 2020.

- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën Korrik 2020 - Shtator 2020, shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore si dhe mandat pagesat në banke.

➤ **Kërkesa shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, është një kërkesë e fryrë dhe e tejkaluar e LPP, pasi nga vetë organet tatimore, bazuar në UMF nr. 23, datë 09.12.2014, ÷Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të dalë në zbatim të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 ÷Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar, në të cilin në pikën 10, ÷Të tjera.**

Sa më sipër fakti që OE ka marrë vërtetimin nga administrata tatimore dhe listë pagesat do të thotë që e ka paraqitur formularin e deklaramit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

➤ **Kërkesa për numrin e mesatar të punësimit nuk është e argumentuar sipas grafikut dhe preventivit të punimeve bazuar në VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre". NJHDT duhet t'i referohej kreut III, të VKM nr. 42, datë 16.01.2008, ÷Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, nenit 78, pika 1 dhe 4, si dhe nenit 83 të Kodit të Punës.**

Si konkluzion AK nuk ka arritur të argumentojë teknikisht mbi kërkesën për disponimin e një numri prej 62 punonjësish si dëshmi të fuqisë punëtore

Në DT është kërkuar: Numri dhe lloji i mjeteve dhe pajisjeve në pronësi/qira: (Shtojca 9) (analizuar më hollësisht në akt konstatimin nr.4, datë 04.06.2021).

➤ Nuk është argumentuar me volume punimesh dhe me grafik numri dhe kapaciteti i mjeteve të kërkuara, në zbatim të nenit 61 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014.

Në DT është kërkuar: Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë: Kokore minimumi 60 copë; Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 8 copë; Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 6 copë; Kulle ndriçimi 2 copë; Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 30 copë; Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 50 copë;

➤ Kjo kërkesë është e tejkaluar pasi NJHDT në hartimin e preventivave, të cilat janë bërë pjesë e DT, duhej të gjente zbatim VKM nr. 664, datë 26.09.2012, ÷Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 514, datë 15.8.07, ÷Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit, pika 10, pasi nuk është parashikuar zbatimi i VKM nr. 312, datë 05.05.10, ÷Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantierë, aneksi VI, ÷Mbi sigurinë në kantierë, në vlerën jo më pak se 3% të vlerës së projektit. Pjesë përbërëse e këtij 3% janë materialet e kërkuara krahas makinerive e mjeteve.

Në DT është kërkuar: OE duhet të jetë i pajisur me certifikata cilësie **ISO 9001- 2015** (e vlefshme); **ISO 14001-2015** (e vlefshme); **OHSAS 18001-2007 ose 45001-2018;** (Ekuivalente, te vlefshme), **ISO 39001 -2012** (e vlefshme), **PASS 99:2012** (e vlefshme), **ISO 8000 : 2014** (e vlefshme) dhe **ISO 20000-1 : 2011** (e vlefshme).

➤ Sa më sipër në asnjë rast nga ana e NJHDT nuk është përcaktuar emërtimi i certifikatës ISO, veprim në kundërshtim me nenin 26 Kontratat për punë publike, pika 5 të VKM nr. 914, për RPP

÷Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. **Në çdo rast, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.**

➤ Nga ana e NJHDT nuk është argumentuar arsyeja se pse duhen këto certifikata ISO, me qëllim përmbushjen e kërkesave të nenit 30 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ku është përcaktuar se: Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mos diskriminimit.÷

➤ Gjithashtu është kërkuar Certifikata ISO / IEC 20000-1: 2011, e cila nuk ka lidhje me objektin e prokurimit pasi kjo certifikatë është një sistem standard i menaxhimit të shërbimit (SMS). ISO / IEC 20000-1: 2018 - Teknologjia e informacionit.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 “Për rregullat e Prokurimit Publik” sipas të cilit: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”, ngarkohet me përgjegjësi NHJDT të përbërë nga K. B., H. I. dhe B. B.

Kriteri

- VKM nr. 914, datë 24.12.2014 ÷Për rregullat e Prokurimit Publik;
- UKM nr. 2, datë 13.05.2005;
- VKM nr. 632, datë 15.07.2015, e cila ka ndryshuar VKM nr. 108, datë 9.2.2011 Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë;
- VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre";
- Ligji nr. 3/2020 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, ÷Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, të ndryshuar;
- Ligji 10440, datë 07.07.2011, ÷Për vlerësimin e ndikimit në mjedis;

• VKM nr. 42, datë 16.01.2008, òPër miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojnë veprimtari Ndërtimiò;

• Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò të ndryshuar, etj.

Ndikimi/efekti: Vendosja e kriterëve në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.

Rëndësia: e lartë

Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Tropojë të merren masa për vendosjen e kriterëve të DST në përputhje me objektin e prokurimit si dhe për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të OE që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

Situata nr.2:

Zhvillimi i procedurës së prokurimit: procedura e prokurimit është hapur më datë 16.11.2020 dhe është vlerësuar sa më poshtë vijon:

Nr.	Operatorë ekonomikë	Oferta	Vlerësimi i KVO
1	òSh. A.ò ShPK & òT.ò ShPK	16,928,438	Kualifikuar dhe shpallur fitues

Auditimi i ofertës fituese:

Në dokumentet standarde të tenderit është kërkuar: *Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo në proces, sipas Shtojcës 11;*

Në këtë shtojcë OE òSh.A.ò ka deklaruar 2 punë në proces por nuk ka deklaruar edhe këtë kontratë sipas buletinit të APP dhe më konkretisht:

Buletini nr. 77, datë 28.09.2020, sipas të cilit me datën 21.09.2020 ky operator së bashku me OE òNg Structuresò ShPK, kanë lidhur kontratën me ARRSH, me objekt òMasa inxhinierike për eliminimin e rrëshqitjeve, segmenti rrugor Qafë M. ó Fierzë, km 2.5 dhe për pikat e rrezikshme në km 24, km 25+400, 25+500ò për vlerën prej 22,351,116 lekë me TVSH. Kohëzgjatja e punimeve është 4 muaj, ndërkohë që ky operator nuk e ka deklaruar në shtojcën 11 këtë kontratë të lidhur.

Sa më sipër KVO nuk e ka konstatuar faktin se ky OE ka paraqitur deklaram të rremë në këtë procedurë prokurimi. Mosveprimi i KVO për paraqitjen e deklaramit të rremë, nga ana e OE òSh.A.ò ShPK, është në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 47, òS -kualifikimi i ofertuesveò, neni 13, pika 3.

Përsa i përket operatorit tjetër ekonomik pjesëmarrës në këtë bashkim operatorësh, OE òT.ò ShPK, nga shqyrtimi i dokumentacionit të tij rezultuan këto mangësi:

Në DST është kërkuar: Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka OE që është i regjistruar në Shqipëri.

Për plotësimin e këtij kriteri, OE òT.ò ShPK ka paraqitur vërtetimin me nr. 110 prot., datë 27.10.2020, sipas të cilit rezulton të ketë në total 218,664.54 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 27.10.2020, e cila është në proces ankimi dhe shqyrtimi nga ana e OSHEE, duke përfshirë faturën koherente të muajit shtator 2020.

Në DST është kërkuar: Një punësim mesatar i të paktën 62 personave, për periudhën **korrik 2020-shtator 2020** të vërtetuar me;

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **korrik 2020-shtator 2020**.

- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **korrik 2020 - shtator 2020**, shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore si dhe mandat pagesat në bankë.

OE òT.ò ShPK, ka paraqitur vërtetimin me nr. T03130598, datë 13.11.2020, për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesin, ku rezulton se ky subjekt ka për të paguar gjithsej 43,968 lekë detyrime, duke mos e plotësuar këtë kriter.

Për sa më sipër KVO nuk duhet të kishte kualifikuar bashkimin e OE dhe nuk duhet të kishte propozuar titullarit për shpalljen fitues të tij. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 për prokurimin publik, i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtme:

- neni 24 për anulimin e një procedure prokurimi, pika nr. 1, germa (ç), neni 46 për kualifikimin e ofertuesve, pika 1, neni 53 për shqyrtimin e ofertave, pika 3.

Shpallja fitues e BOE dhe Sh. A. dhe ShPK & T. dhe ShPK, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar **përdorim të paligjshëm të fondeve publike në vlerën 16,928,438 lekë dhe ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga: M. V., Sh. D. dhe P. R..**

Bashkëlidhur kontratës nuk janë kushtet e veçanta të kontratës shtojca 19, si dhe nuk është përcaktuar drejtuesi i projektit, neni 3 i KVK **“Drejtuesi i Projektit”, pikat 3.1 dhe 3.2.**

Kriteri: Dokumentet standarde të procedurës së prokurimit; Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 për prokurimin publik, i ndryshuar; Buletinet e APP, etj.

Ndikimi/efekti: Paligjshmëri në zbatimin e procedurës së prokurimit të fondeve publike në vlerën 16,928,438 lekë

Shkaku: Mos zbatim i kriterëve të veçanta për kualifikim të DST si dhe akteve ligjore e nënligjore të LPP.

Rëndësia: e lartë.

Pretendimi i subjektit

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion, protokolluar në KLSH me nr.361/16, datë 23.07.2021, nga z.H. I., M. V. e E. M., ku janë shprehur komentet si më poshtë:

“Në pikën 3, në Faqe 142, ku behet fjale për Projektin e Rikonstruksionit të Stadiumit të Lojrave me Dore, thuhet me të drejte se: ne lidhje me aktin e dhurimit ju nuk e keni paraqitur ate per rrjedhoje nuk meret ne konsiderate.

Për këtë sqarojme se: Ne e kemi aktin e dhurimit, por nuk eshte gjetur ne momentin e kerkuar dhe kur derguam observacionin e mëparshem kemi harruar ta ngarkojme të skanuar.

Për këtë pike sqarojme se: Projekti i objektit: **“Rikonstruksion i kompleksit sportiv të lojrave me dorë, B.Curri”**, është hartuar nga Studioja Projektuese **“D. E.” sh.p.k.** dhe i ka kaluar Bashkise Tropoje nga kjo studio me Kontratë Dhurimi (bashkëlidhur Kontrata e Dhurimit e skanuar).



BASHKIA TROPOJE

nr. 243 prot.

Date 12/07/2020

KONTRATE - DHURIMI

Sot më datë 10.07.2020 (dymbjethë e njëzet), lidhet kjo kontratë dhurimi nën palëve të mëposhtme:

PALA DHURUESE: Shoqëria "Derbi-E" sh.p.k. regjistruar si person juridik pranë QKB, me NUIS - K 77916947 A, me adresë në Diber Ilomsli SELIXE Hec "Antena" Selixe, përfaqësuar nga administratori i shoqërisë z. Bexhet Dedja, në cilësinë e palës Dhuruese

dhe

Pala PRANUESE e DHURIMIT; Bashkia Tropoje e njohur si person juridik Nr. Identifikimi Tatimor NUIS, K 49326606 C, me adresë, Sheshi "zem Hajdari", Qyteti "B.CURRI", përfaqësuar nga Kryetari i saj z. Rexhe ByBERI,

Ndërsa persa iu perket kriterëve të vendosura, ne pergjithësi, sqarojme se keto kriterë nuk jane vendosur me qellimin per te favorizuar ndonje firme apo per te shmangur konkurrencen,

por thjeshte per te hyre ne konkurim firma serioze, me specialist te kualifikuar, per vet natyren e punimeve ne kte objekt.ö

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarohet se komenti juaj në lidhje kontratën e dhurimit merret në konsideratë pasi ju keni paraqitur dokumentin. Ndërsa në lidhje me kriteret e veçanta për kualifikim komenti juaj nuk merret në konsideratë, ju nuk keni paraqitur prova dhe fakte.

4.Titulli gjetjes: Mangësi në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të procedurës së prokurimit publik me objekt: **“Mirëmbajtje e rrugëve rurale për vitin 2020-2021”** me këto të dhëna:

Urdhër prokurimi Nr. 51, datë 26.11.20	NJHDT: K. B.	KVO: nr. 96, datë 03.12.2020 P. R.
Lloji i procedurës òe hapurò	H. I.	Sh. Gj.
Fondi limit 4,500,000lekë.	Z. I.	M. V.
Burimi Financimit: Te ardhurat	OE fitues: òG.ò ShPK	OE Pjesëmarrës në tender: 2
Data e hapjes së tenderit: 14.12.2020	Vlera e fituar: 4,480,942 lekë	Skualifikuar 1 Kualifikuar 1
Ankimime në AK: s`ka	Diferenca me fondin limit 19,058 lekë	Kontrata nr. 25, datë 22.01.2021 Vlera 5,337,130 lekë.
Ankimime në KPP: - s`ka	Miratimi procedurës 08.01.2021	Afati 4 muaj
Titullari i AK: personi të autorizuar nga Titullari i AK Nën Kryetar A. K.		

Situata

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlllogaritja e fondit limit:

Me urdhër të personit të autorizuar nga Titullari i AK Nën Kryetar A. K., është ngritur grupi i përbërë nga: B. B., Sh. D., P. K..

Ky komision ka hartuar procesverbalin datë 25.11.2020 ku është përcaktuar në total preventivi i punimeve dhe grafiku i punimeve si dhe përcaktimin e segmenteve rrugorë që do të mirëmbahen.

Ky grup nuk ka përditësuar preventivat analitike për çdo segment rrugor të trajtuar nga ana e tyre në relacionin teknik e konkretisht, sipas aneks 4/6 por ka hartuar një preventiv përmbledhës sipas shtojcës 13 të DT, preventivat e punimeve.

Bashkëlidhur preventivit të firmosur nga B. B. për zërat e punimeve sa vijon:

Numër analize	Përshkrimi i punimit	Njësi	Sasi	Çmimi për njësi
An	Pastrim rruge nga bora me një kalim me borëpastruese + buldozer	km	310	3,690
An	Hedhje krypë në rrugë me makineri	m ²	46,000	6.8
An	Pastrim i bankinave të rrugës nga bimësia	m ²	9,811	7.5

Zëratë cilat përbëjnë 35% të fondit limit rezulton se nuk ka analizë të zërit të punimit, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi B. B..

Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi grupi i përbërë nga B. B., Sh. D., P. K..

Hartimi i DT: Procesverbali i hartimit të DT, mban datën 02.12.20, dhe në të rezulton se nuk ka gjetur zbatim pika 1, e nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.01.2006, ndryshuar si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, sa vijon: Seksioni II, òInformacione të veçanta për kontratatò, neni 26 òKontratat për punë publikeò, pika 7 dheKreu VII, òZyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i proceduraveò, neni 61, òHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitò, pika 2, paragrafi 2.

Në lidhje me DT nga ana e APP me email datë 15.10.2020, e cila bën vërejtje në lidhje me sa vijon:

- Për plotësimin e preventivit me zërat e punës;
- Shtojcën e sigurimit të ofertës;

- Për kategoritë NP 12, NS 6, NS 7;
- Kodi i ndikimit në mjedis III. 1.A ;
- Kodi III.1.A tipi C;
- Për shërbimet e ngjashme;
- Për certifikatat ISO;
- Për drejtuesin teknik që është kërkuar të jetë gjithë kohën në objekt;
- Për specialist të sigurimit teknik;

Në lidhje me sa trajtuar nga APP, nga ana e NJHDT është hartuar dhe publikuar shtojca nr. 1, datë 09.12.2020, ku janë bërë modifikimet, duke mos i reflektuar të gjitha vërejtjet dhe pa i argumentuar ndryshimet, (analizuar më hollësisht në akt konstatimin nr.4, datë 04.06.2021).

Konkretisht kërkesat në lidhje me kategoritë e licencave, numrin e punonjësve dhe kategoritë e punësimit, numrin dhe llojin e mjeteve etj., nuk janë argumentuar me zberthimin e preventivit dhe sipas grafikut të punimeve.

Si dhe nuk kanë mbështetje ligjore kërkesat në lidhje me sa vijon:

Në DT është kërkuar: Si dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, kandidati/ofertuesi duhet të vërtetojë se ka mesatarisht të siguruar, jo më pak se 20 punonjës për periudhën korrik 2020-tetor 2020. Kjo e vërtetuar me: Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore për periudhën e kërkuar, shoqëruar me formularët E-SIG të konfirmuara nga organet përkatëse (me nënshkrim elektronik ose në hard copy).

nuk është argumentuar me volume punimesh dhe me grafik numri i punonjësve (staf teknik + punëtorë). NJHDT duhet t'i referohej kreut III, të VKM nr. 42, datë 16.01.2008, òPër miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, neni 83 të Kodit të Punës parashikohet se: òKohëzgjatja normale e javës së punës është jo më shumë se 40 orë, neni 85 të Kodit të Punës

Në DT është kërkuar: OE duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) drejtuesin teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen shërbimet/punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm: diplome, kontratë pune të vlefshme. Të siguruar sipas legjislacionit në fuqi.

➤ Kërkesë e përcaktuar në kundërshtim me kreun I, pika 2.1 të UKM nr. 2, datë 13.05.2005, òPër zbatimin e punimeve të ndërtimit, ku parashikohet se për punime deri në 30 milion lekë nuk është e detyrueshme qëndrimi i drejtuesit teknik në kantier gjatë gjithë periudhës së punimeve.

Në DT është kërkuar: OE ofertues duhet të ketë 1 punonjës që të disponojnë dëshmi trajnimi si "Specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë në përputhje me klauzolat e ligjit nr. 10327, datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë kantier".

➤ Kërkesë jo në përputhje me neni 7 dhe 38 të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 òPër sigurinë dhe shëndetin në punë, i ndryshuar si dhe referuar rregullave të prokurimit publik dhe legjislacionit të fushës përkatëse, kërkesa e autoritetit kontraktor që punonjësit për sigurimin teknik dhe mbrojtjen e shëndetit në punë të figurojnë në listë pagesa, të figurojnë në licencën e shoqërisë dhe të kenë dëshmitë përkatëse, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe aspak në përputhje me ligjin nr. 10237, datë 18.02.2010 òPër sigurinë dhe shëndetin në punë, i ndryshuar.

Në DT është kërkuar: OE duhet të disponojnë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës.

➤ Nga ana e NJHDT nuk janë argumentuar kategoritë me volumet e punimeve. Gjithashtu rezulton se për kategorinë N.P. 12 A (punime të inxhinierisë mjedisore), nuk ka punime bazuar në përcaktimet e VKM nr. 42, datë 16.01.2008.

Në DT është kërkuar: OE duhet të disponoje mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t'ia vihen në dispozicion OE (analizuar më hollësisht në akt konstatimin nr.4, datë 04.06.2021).

Nga auditimi i zërave të punës së preventivit rezulton se në asnjë rast nuk flitet për shtrim me asfalt, e konkretisht zërat e punës dhe llojet e makinerive sipas VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre" janë:

Nr. analize	Përshkrimi i punës	Mjeti që kërkohet sipas manualit
3.90/a	Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, prani uji, kategoria III, me shk ne mjet	Ekskavator 0.25 m ³
3.95/a	Gërmim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke	Ekskavator 0.25 m ³
3.158/3a	Transport dheu me auto deri 3.0 km	Auto veteshkarkues deri 3.0 km
3.208	Shtresë çakëlli t=10cm, makadam, përhapur e ngjeshur me makineri	Grejder, Rul me vibrim, Autobot
3.209	Shtresë çakëlli mbeturine kave t=10cm, përhapur e ngjeshur me makineri	Grejder Rul me vibrim
3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm	Grejder, Rul me vibrim, Autobot
3.237	Struktura monolite b/betoni C 12/15 me 25% gur	Betonjere 500 liter Vibrator thelesie
An-8	Mbushje me cakell pas mureve	Fadrome
Analizë	Pastrim rruge nga bora me një kalim me borëpastruese + buldozer	Nuk ka analizë
Analizë	Hedhje krypë në rrugë me makineri	Nuk ka analizë
Analizë	Pastrim i bankinave të rrugës nga bimësia	Nuk ka analizë

➤ Nga ku rezulton se nuk është argumentuar me volume punimesh dhe me grafik numri dhe kapaciteti i mjeteve të kërkuara.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 òPër rregullat e Prokurimit Publikò sipas të cilit: òKërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratësò, **dhe ngarkohet me përgjegjësi NHJDT të përbërë nga K. B., H. I. dhe Z. I..**

Kriteri

- VKM nr. 914, datë 24.12.2014 òPër rregullat e Prokurimit Publikò;
- UKM nr. 2, datë 13.05.2005;
- VKM nr. 632, datë 15.07.2015, e cila ka ndryshuar VKM nr. 108, datë 9.2.2011 Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punëò;
- VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre";
- Ligji nr. 3/2020 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, òPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò, të ndryshuar;
- Ligji 10440, datë 07.07.2011, òPër vlerësimin e ndikimit në mjedisò;
- VKM nr. 42, datë 16.01.2008, òPër miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari Ndërtimiò;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò të ndryshuar, etj.

Ndikimi/efekti: Vendosja e kriterëve në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.

Rëndësia: e lartë

Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Tropojë të merren masa për vendosjen e kriterëve të DST në përputhje me objektin e prokurimit si dhe për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të OE që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit: procedura e prokurimit është hapur më datë 21.12.2020 dhe është vlerësuar sa më poshtë vijon:

Nr.	Operatorë ekonomike	Oferta	Vlerësimi i KVO
1	ōG.ō shpk	4,480,942	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	ōS. V.ō shpk	4,429,562	S`kualifikuar pasi: Mungon fatura tatimore tek punimet e ngjashme; I. V. i mungon kontrata e punës; Mungon dëshmia e datës 27.05.2019; Nuk janë urdhër pagesat e muajve korrik tetor 2020.

Nga auditimi rezulton se në këtë procedurë ka fituar oferta e vlefshme.

5. Titulli gjetjes: Mangësi në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të procedurës së prokurimit publik me objekt: **“Ujësjetësi i fshatit Dragobi”**, me këto të dhëna:

Urdhër prokurimi Nr. 30, datë 08.09.2020	NJHDT: K. B.	KVO: nr. 45, datë 08.09.2020
Lloji i procedurës òe hapur	H. I.	M. V.
Fondi limit 57,757,935 lekë.	A. H.	Sh. Gj.
Burimi Financimit: Buxheti i shtetit	OE fitues: òF.ō shpk & ò4. M.ō shpk	A. H.
Data e hapjes: 29/10/2020	Vlera e fituar: 56,891,217 lekë	OE pjesëmarrës në tender: 2 Shkualifikuar 1 me ofertë 0 lekë Kualifikuar 1
Ankimime në AK: s`ka	Diferenca me fondin limit	Kontrata nr. 16, datë 08.12.2020
Ankimime në KPP: - s`ka	866,718 lekë	Vlera 56,891,216.76 lekë.
Titullari i AK: personi i autorizuar nga Titullari i AK Nën/ Kryetar A. K.	Miratimi i procedurës datë 19.11.2020	Afati 6 muaj

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit:

Me urdhrin nr. 44, datë 03.09.2020 të personit të autorizuar nga Titullari i AK, është ngritur grupi i punës i përbërë nga: B. B., Sh. D. dhe P. K..

Nga auditimi i projektit rezultoi se:

- Projekti është hartuar nga D. ShPK dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Tropojë;
- Projekti nuk ka të përcaktuar emrat e grupit të projektuesve dhe nuk është konfirmuar në çdo faqe nga grupi i projektuesve.
- Projekti nuk rezulton të jetë bërë me procedurë prokurimi, nuk ka detyrë projektimi si dhe nuk ka as akt dhurimi.
- Për marrjen në dorëzim të projektit nuk ka urdhër të Titullarit të AK, gjithashtu ky projekt nuk është marrë në dorëzim sipas kërkesave të UMF nr.30.

- Preventivi është hartuar nga M. V. dhe H. N. si dhe është miratuar nga Titullari i AK R. B.. Theksojmë se këta punonjës nuk janë pjesë e grupit të ngritur për këtë qëllim.

Nga auditimi i preventivit rezultuan mangësi në drejtim të përcaktimit të çmimeve bazuar në numrin e analizës së vendosur në preventiv veprim jo në përputhje me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", konkretisht më hollësisht trajtuar në aneks 4,5 bashkëlidhur.

Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi grupi i caktuar i përbërë nga B. B., Sh. D. dhe P. K. si dhe hartuesit e preventivit M. V. dhe H. N..

Hartimi i dokumenteve të tenderit: Procesverbali i hartimit të DT mban datën 17.09.2020. Në hartimin e DT rezulton se nuk ka gjetur zbatim pika 1, e nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.01.2006, ndryshuar si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publikë, i ndryshuar, sa vijon:

1- Seksioni II, informacione të veçanta për kontratat, neni 26 Kontratat për punë publike, pika 7.

2- Kreu VII, zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave, neni 61, Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit, pika 2, paragrafi 2.

Në lidhje me DT nga ana e APP me email datë 15.10.2020, e cila bën vërejtje në lidhje me sa vijon:

- Për kategoritë e licencës NP 9A, NP 12 B; Për inxhinier mjedisi i pajisur me certifikatë VNM dhe periudhën e punësimit 6 mujor; Për periudhat e punësimit të punonjësve 6 mujore; Për numrin 120 të punonjësve të kërkuar; Për inxhinier pyjesh/ ose agronom; Kodi i ndikimit në mjedis III. 2.A (1+2); Kodi III.1.A tipi C; Për aktivitetin e qëndrueshëm të shoqëruar me raportin e audituesit për pasqyrat financiare; Për akt ekspertizën e ekspertit kontabël të miratuar; Për shlyerjen e taksave vendore viti 2020; Për faturat tatimore për çdo situacion; Për BS OHSAS 18001; Për certifikatat ISO të prodhuesit; Për mjetet.

Në lidhje me sa trajtuar nga APP, nga ana e NJHDT është hartuar dhe publikuar shtojca nr. 1, ku janë bërë modifikimet, duke mos i reflektuar të gjitha vërejtjet dhe pa i argumentuar ato, si dhe duke reflektuar minimisht sugjerimet e APP (analizuar më hollësisht në akt konstatimin nr.4, datë 04.06.2021)

Konkretisht kërkesat në lidhje me kategoritë e licencave, numrin e punonjësve dhe kategoritë e punësimit, numrin dhe llojin e mjeteve etj., nuk janë argumentuar me zbërthimin e preventivit dhe sipas grafikut të punimeve.

Si dhe nuk kanë mbështetje ligjore kërkesat në lidhje me sa vijon:

Në DT është kërkuar: Licenca Profesionale e Shoqërisë, për realizimin e punimeve në kategoritë:

NP- 1 A - Punime Gërmimi ne toke

NP-7 C - Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje

NP-12 B - Punime te inxhinierisë se mjedisit

NS ó 18 A - Punime topogjeodezike

➤ Nuk ka punime për kategorinë N.P. 12 dhe aq më tepër me klasifikimin B, (Punime te inxhinierisë mjedisore), bazuar në konceptet e VKM nr. 42, datë 16.01.2008, për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi.

Në DT është kërkuar: OE duhet të ketë Drejtues Teknik të përfshirë në licencën e shoqërisë inxhinierët si me poshtë: Inxhinier Hidroteknik; Inxhinier Ndërtimi; Inxhinier Mekanik; Inxhinier Topograf; Inxhinier Mjedisi i pajisur me certifikatë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis .

➤ Kërkesa që në stafin drejtues teknik të jetë edhe një Inxhinier Mjedisi i pajisur me certifikatë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, bazuar në preventivin e punimeve sipas preventivit rezulton se nuk ka asnjë lloj punimi për të cilën të duhej një ekspertizë e tillë. Për rrjedhojë kërkesa sa më lart nuk është e bazuar në përcaktimet e pikës 1, neni 26 të LPP

Në DT është kërkuar: OE duhet të paraqesë një dëshmi nga administrata tatimore për punësimin mesatar jo më pak se 110 punonjës për periudhën Maj 2020 ó Gusht 2020. Te shoqërohen me Listë pagesat përkatëse për të gjithë periudhën e kërkuar.

➤ nuk është argumentuar me volume punimesh dhe me grafik numri i punonjësve (staf teknik + punëtorë). NJHDT duhet të referojë kreut III, të VKM nr. 42, datë 16.01.2008, për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të

zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, pika ç, nenin 78 pika 1 e 4 si dhe neni 83 i Kodit të Punës.

Nga ana e autoritetit kontraktor është e rëndësishme të provohet disponimi i numrit të nevojshëm të punonjësve nga ana e OE por përcaktimi i numrit duhet të vijë pas një analize gjithëpërfshirëse të gjithë elementëve si më sipërcituar nga AK, me qëllim përcaktimin e numrit në mënyrë të arsyeshme, proporcionale, dhe në përputhje me nevojat reale për ekzekutimin e kontratës në mënyrë të suksesshme, në respekt të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò të ndryshuar dhe nenin 26 pika 5 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò të ndryshuar, ku parashikohet se: òKërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.ò

Si konkluzion AK nuk ka arritur të argumentojë teknikisht mbi kërkesën për disponimin e një numri prej **110** punonjësish si dëshmi të fuqisë punëtore.

Në DT është kërkuar: Të ketë të punësuar ose me një kontratë shërbimi mjekun e shoqërisë. Te paraqesë kontrate pune/shërbimi, diplome, si dhe licence (urdhri i mjekut).

➤ Kërkesa për mjek është e tepërt dhe nuk ka lidhje me asnjë nga përcaktimet e kontratës dhe është në kundërshtim me VKM nr. 632, datë 15.07.2015, e cila ka ndryshuar VKM nr. 108, datë 9.2.2011 Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë, pika 1, ku përcaktohet se:

òPas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje, si më poshtë vijon: ò6. Punëdhënësit e grupeve òAò dhe òBò, në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve òCò dhe òDò, për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtëò.

Në DT është kërkuar: OE të ketë në stafin e tij 1 òSpecialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punëò. Te paraqitet kontrata noteriale e punës si dhe certifikata e trajnimit/kualifikimit për òPër përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punëò e dhëna nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj dhe të rezultojë i siguruar në listë pagesa për periudhën Maj 2020 ó Gusht 2020.

➤ Kërkesë jo në përputhje me nenin 7 dhe 38 të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 òPër Sigurinë dhe Shëndetin në Punëò, i ndryshuar si dhe referuar rregullave të prokurimit publik dhe legjislacionit të fushës përkatëse, kërkesa e autoritetit kontraktor që punonjësit për sigurimin teknik dhe mbrojtjen e shëndetit në punë të figurojnë në listë pagesa, të figurojnë në licencën e shoqërisë dhe të kenë dëshmitë përkatëse, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe aspak në përputhje me ligjin nr. 10237, datë 18.02.2010 òPër Sigurinë dhe Shëndetin në Punëò, i ndryshuar.

Në DT është kërkuar: OE pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar 1 Ekspert Zjarrfikës të vërtetuar me kontratë pune, leje ushtrimi profesioni si ekspert zjarrfikës si dhe të rezultojë i siguruar në listë pagesa për periudhën Maj 2020 ó Gusht 2020.

➤ Nga ku rezulton se kërkesa e autoritetit kontraktor mbi disponueshmërinë e një eksperti zjarrfikës, shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin, pasi referuar ligjit nr. 152/2015 òPër shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtiminò, roli i ekspertit zjarrfikës nuk është në përpjesëtim me natyrën e kontratës, në kuptim të nenit 46 pika 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 òPër Prokurimin Publikò, të ndryshuar.

Në DT është kërkuar: OE të ketë në stafin e tij 1 Inxhinier Pyjesh ose Inxhinier Agronom dhe të rezultojë i siguar në listë pagesa për periudhën Maj 2020 ó Gusht 2020. Të paraqiten kontratë pune, diplomë, librezë pune

➤ Nga auditimi rezulton se në preventivin e punimeve nuk ka zëra pune konkretë për zbatimin e të cilave do të ishte e nevojshme ekspertiza e këtyre inxhinierëve, për rrjedhojë kjo kërkesë është e paargumentuar dhe diskriminuuese, nisur dhe nga fakti që është përcaktuar se duhet të jenë edhe në listë pagesa, ndërkohë që duhej të ishte kërkuar po të ishin të domosdoshëm edhe me kontratë punë për periudhën e zbatimit të kontratës.

Në DT është kërkuar: Ofertuesi duhet të disponojë këto makineri (analizuar më hollësisht në akt konstatimin nr.4, datë 04.06.2021)

➤ Në lidhje me mjetet e kërkuara, nga ana e NJHDT mbas vërejtjeve të APP, në disa raste është ulur numri i tyre, por në asnjë rast nuk është argumentuar teknikisht arsyeja pse u ul numri si dhe pse duhen këto makineri, bazuar në preventivin e punimeve, grafikun dhe me zberthimin e zërave të punës sipas manualit VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".

Në DT është kërkuar: OE duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore lëshuar nga QKL për stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme Kodi III.1.A tipi C.

➤ Nga ana e NJHDT nuk duhej të kufizohej vetëm me të pasurit këtë licencë, pasi OE që plotësojnë kriteret për realizimin e kontratës, këtë funksion mund ta realizojnë edhe duke lidhur kontrata me subjekte të licencuara për këtë qëllim, mbështetur në kërkesat e ligjit nr. 55/2020, òPër disa ndryshime në ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011, òPër lejet e mjedisitò, ndryshuar.

Në DT është kërkuar: OE duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore lëshuar nga QKL për veprimtarinë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis Kodi III.2.A (1+2).

➤ Kjo lloj licence nuk përkon me tipologjinë e objektit të kontratës (neni 46 i LPP dhe neni 26 i RPP). Kjo licencë ka lidhje me fazën e studimit dhe të projektimit të objekteve ndërtimore. Sa më sipër kjo kërkesë është e tejkaluar kërkesave të LPP.

Në DT është kërkuar: OE pjesëmarrës duhet të beje vet deklaram për prodhuesit/distributorit si dhe certifikatat ISO të prodhuesit (ISO 9001) për materialet/pajisjet si me poshtë:

Tuba PE	Reduktor stabilizues presioni trup gize
Saracineske me fllanxhe	Kontator 3/4"
Xhunto zmontimi çeliku me 3 fllanxhe	Impjant klorinimi me pompe për presione 10 bar prurje max përpunimi 5 l/sek me gjithë aksesoret e nevojshëm
Ajrues linja kryesore me 3 funksione	Pjese speciale e rakorderi, për lidhjet në depo PN 10 DN 80 -100 mm

➤ **Kërkesa - dhe certifikatat ISO të prodhuesit (ISO 9001)-** nuk u përmbahet përcaktimit të dispozitave nënligjore të LPP në hartimin e kriterëve për kualifikim, pasi kjo lloj kërkesë nuk është parashikuar në LPP. Kërkesa sa më lart janë dokumente që i takojnë palëve të treta të cilat nuk janë konkurrenca në procedurën konkrete të prokurimit. Përmbushja e specifikimeve teknike plotësohet me paraqitjen e deklaratës nga OE, e cila është pjesë e DATË

➤ **Nga auditimi rezulton se nga ana e NJHDT,** nuk është kërkuar që OE duhet të deklarojë medeklarate të administratorit drejtuesin/it teknik që duhet të jenë gjatë gjithë kohës në vepër dhe të paangazhuara në punë të tjera, kërkesë e përcaktuar në kreun I, pika 2.1 të UKM nr. 2, datë 13.05.2005, òPër zbatimin e punimeve të ndërtimit, ku parashikohet se për punime mbi 30 milion lekë është e detyrueshme qëndrimi i drejtuesit teknik në kantier gjatë gjithë periudhës së punimeve.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 "Për rregullat e Prokurimit Publik" sipas të cilit: òKërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46

të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, **ngarkohet me përgjegjësi NHJDT të përbërë nga K. B., H. I. dhe A. H.**

Kriteri

- VKM nr. 914, datë 24.12.2014 ÷Për rregullat e Prokurimit Publik;
- UKM nr. 2, datë 13.05.2005;
- VKM nr. 632, datë 15.07.2015, e cila ka ndryshuar VKM nr. 108, datë 9.2.2011 Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë;
- VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre";
- Ligji nr. 3/2020 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, ÷Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, të ndryshuar;
- Ligji 10440, datë 07.07.2011, ÷Për vlerësimin e ndikimit në mjedis;
- VKM nr. 42, datë 16.01.2008, ÷Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari Ndërtimi;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 ÷Për prokurimin publik të ndryshuar, etj.

Ndikimi/efekti: Vendosja e kriterëve në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.

Rëndësia: e lartë

Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Tropojë të merren masa për vendosjen e kriterëve të DST në përputhje me objektin e prokurimit si dhe për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të OE që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

Situata nr.2:

Zhvillimi i procedurës së prokurimit: procedura e prokurimit është hapur më datë **03.11.2020** dhe është vlerësuar sa më poshtë vijon:

Nr.	Operatorë ekonomikë	Oferta ekonomike në lekë	Vlerësimi i KVO
1	÷F.÷ ShPK & ÷4.M÷ ShPK	56,891,217	Kualifikuar dhe shpallur fituese
2	÷H.÷ ShPK	0	S`kualifikuar

Auditimi i ofertës fituese:

Në këtë procedurë prokurimi fituesi është bashkimi i operatorëve ÷4.M÷ ShPK & ÷F.÷ ShPK. Ndarja në përqindje e punimeve është 80 % e punimeve ka marrë përsipër ÷4.M÷ ShPK dhe pjesën e mbetur prej 20 % do të kryhet nga OE ÷F.÷ ShPK.

Nga mbledhja e të gjithë zërave të punimeve që ka marrë përsipër OE ÷F.÷ ShPK, kap vlerën prej 10,802,400 lekë pa TVSh, ndërkohë që pjesa prej 20 % e punimeve që ka marrë përsipër të kryejë është në vlerën prej 11,378,243 lekë pa TVSh.

Mangësitë e OE “4.M” ShPK.

Nuk ka deklaruar në shtojcën nr. 8 ÷Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të gjithë personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionarit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluesbrenda operatorit ekonomik, drejtuesin teknik M. L..

Në DST është kërkuar përsa i përket kapacitetit teknik: Ofertuesi duhet të dorëzoje:

- Punë të ngjashme, për 1(një) kontrate te vetme në një vlerë jo me te vogël se 50 % e vlerës limit te kontratës qe prokurohet, të realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit te tenderit, **Ose**
- Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

- Për të vërtetuar përvojën e suksesshme në ekzekutimin e një kontrate të ngjashme, OE duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtëm:

Për kontrata për punë publike të realizuar me institucione shtetërore kërkohen:

- a-Kontratën/at e Sipërmarrjes,
- b-Situacion përfundimtare të objektit,
- c-Faturat tatimore për situacion përfundimtar.
- d-Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës nr. 8.
- e-Akti i Kolaudimit
- f-Certifikatën e marrjes në dorëzim

Për plotësimin e këtij kriteri, OE “4.M” ShPK ka paraqitur 2 kontrata si më poshtë vijon:

1-kontratë me Ujësjetllës Kanalizime Tiranë, me nr. 9713/10 prot., datë 26.07.2019, me objekt òRikonstruksion i linjës së ujësjetllësit Ø 140 mm PE nga baseni i presionit në Dajt deri në depon e fshatit Ferrajò, në vlerën prej 45,730,907 lekë pa TVSh. OE ò4.Mò ShPK nuk ka paraqitur certifikatën e marrjes në dorëzim siç është kërkuar në DST, duke mos e plotësuar këtë kriter.

2-kontratë me Ujësjetllës Kanalizime Tiranë, me nr. 16976/12 prot., datë 10.10.2018, me objekt òNdërtim linje transmetimi ujësjetllësi nga Impianti i Bovillës deri te rruga -Demokraciaò, në vlerën prej 143,919,455 lekë pa TVSh. OE ò4.Mò ShPK ka marrë pjesë si bashkim operatorësh në këtë procedurë prokurimi së bashku me OE òL.ò ShPK & òShansi Investò ShPK dhe ka marrë përsipër kryerjen e 18.24 % të punimeve. Kjo përqindje punimesh e marrë përsipër nga ky OE i korrespondon vlerës prej 26,250,908 lekë pa TVSh, ndërkohë që vlera jo më e vogël se 50% e fondit limit të kontratës që prokurohet është të paktën 28,878,967 lekë, duke mos e plotësuar këtë kriter.

Gjithashtu kriterin e punëve të ngjashme nuk e plotëson as operatori tjetër pjesëmarrës në këtë bashkim operatorësh. OE òF.ò ShPK ka paraqitur 6 punë të ngjashme, 3 nga të cilat janë punime për mirëmbajtje rrugësh, ndërsa 3 punimet e tjera nuk kanë lidhje me ndërtim ujësjetllësi.

Në DST është kërkuar: OE duhet të ketë Drejtues Teknik të përfshirë në licencën e shoqërisë inxhinierët si me poshtë: Inxhinier Hidroteknik 1; Inxhinier Ndërtimi 1; Inxhinier Mekanik 1; Inxhinier Topograf 1; Inxhinier Mjedisi i pajisur me certifikatë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedisi 1;

Për secilin prej Drejtuesve Teknik ofertuesi duhet të paraqesë: Kontratë pune; Diplome përkatëse. Të rezultojnë të siguruar në listë pagesa për periudhën Maj 2020 ó Gusht 2020

- Për plotësimin e këtij kriteri, OE òF.ò ShPK ka paraqitur si inxhinier mekanik z. J. K.(i cili nuk figuron si drejtues teknik) si dhe znj. F. Rr. si inxhinierë ndërtimi (e cila nuk figuron si drejtuese teknike), duke mos e plotësuar kriterin e mësipërm.

Për sa më sipër KVO nuk duhet të kishte kualifikuar bashkimin e OE “4.M” ShPK & “F.” ShPK dhe nuk duhet të kishte propozuar titullarit për shpalljen fitues të tij. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm:

- neni 24 òAnulimi i një procedure prokurimiò, pika nr. 1, germa (ç): òAK anulon procedurën e prokurimit vetëm (ç) nëse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderitò

- neni 46 òKualifikimi i ofertuesveò, pika 1: òOperatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret í , që AK i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese.

- nenin 53 të Shqyrtimi i ofertave, pika 3: 53.AK, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.

Shpallja fitues e BOE 04.Mö ShPK & 0F.ö ShPK, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar **përdorim të paligjshëm të fondeve publike në vlerën 56,891,216 lekë dhe ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga: M. V., Sh. Gj. dhe A. H.**

Kriteri: Dokumentet standarde të procedurës së prokurimit; Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 për prokurimin publik, i ndryshuar; Buletinet e APP, etj.

Ndikimi/efekti: Paligjshmëri në zbatimin e procedurës së prokurimit të fondeve publike në vlerën **56,891,216** lekë

Shkaku: Mos zbatimi i kritereve të veçanta për kualifikim të DST si dhe akteve nënligjore e ligjore të LPP.

Rëndësia: e lartë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni nëpërmjet postës elektronike në adresën lbaholli@klsh.org.al nga z/znj R. B., H. I., M. V., E. M., M. K., A. H., B. B., Sh. D., P. K., ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Po aty, ne Fq. 44, ku thuhet se ne projekt, (behet fjale për Ujesjellesin Dragobi), nuk janë përcaktuar emrat e grupit të projektuesve, kjo qëndron, por projektin e zbatimit, e kemi të firmosur dhe të vulosur nga "D." shpk, si dhe kemi një akt dhurimi nga kjo kompani. (Bashkelidhur, disa flete të firmosura dhe të vulosura të projekt preventivit, si dhe një kopje e aktit të dhurimit të këtij projekti).

Po aty, ne Fq. 45, Tek: Auditimi i preventivit, ku citoni se rezultojnë mangesi në drejtim të përcaktimit të cmimeve bazuar në numrin e analizës së vendosur në preventive veprim jo në përputhje me vkm nr..., sqarojmë se: Fakti është se nga ana jone janë vendosur çmimet e duhura sipas manualit të preventivimit në fuqi, (shih fletën e manualit bashkëngjitur materilait), pasi zerat e preventivit janë pershtatur me projektin duke vendosur çmimin sipas llojeve të tubit, dimensionit dhe presionit PN-10, apo PN-20. Ndërsa për zerin An. 2.48/an, Germim shkemb i forte me cekic, me eskavator me zinxhire, ze ky i perseritur 9 here ne te 3 nenobjektet ne kte preventive, ne 8 raste eshte vendosur cmimi mire, 3 965 leke/meter kubi, dhe vetem ne nje rast ka mbetur gabimisht cmimi me i ulet, apo 1 865 leke/meter kubi".

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se komentet juaj për këto çështje merret në konsideratë, përjashtoj faktin që projekti nuk është i firmosur nga grupi i projektuesve.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni nëpërmjet postës elektronike në adresën lbaholli@klsh.org.al nga z/znj A. H., M. V., Sh. Gj., ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: "Ne Akt Konstatimin nr.4, pika 5 "Procedura e prokurimit me objekt "Ujesjellesi i fshatit Dragobi", faqe 25 të Auditimit i ofertës fituese, ku ka marrë pjesë B.O. 0F.ö shpk & 04.Mö shpk, në paragrafin "Mangesite e OE "4.M" shpk, keni cituar:

– Nuk ka deklaruar në shtojcën nr.8 "Deklaratë mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme" të gjithë personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, drejtuesin teknik M. L.

– **Z. M. L. referuar ekstraktit te shoqërisë është drejtues teknik dhe jo anëtar i ndonjë organi administrativ, drejtues, mbikëqyrës dhe nuk parashikohen për te kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese.**

– Persa i perket kapacitetit teknik “pune te ngjashme”, keni theksuar se asnjëri nga OE pjesemarres ne BOE “F.” shpk & “4.M” shpk nuk e plotesojne kete kriter.

Ju sqarojme se per objektin “Rikonstruksion i linjes se ujesjellesit Ø 140 mm PE nga baseni i presionit ne Dajt deri ne depon e fshatit Ferraj” ne vleren prej 45 730 907 leke pa t v sh me kontraktor OE “4.M” shpk, ju keni theksuar se OE nuk ka paraqitur çertifikaten e marrjes ne dorezim, siç theksohet ne DST, por duke qene se objekti eshte brenda afatit te garancise se punimeve, kjo çertifikate eshte e pamundur te disponohet, deri ne perfundim te ketij afati, por ky kriter plotesohet me dokumentacionin tjeter plotesues (kontrate, situacion, fature, formular vleresimi).

Kontrata e paraqitur nga shoqëria “4A-M” SHPK si eksperience e ngjashme me objekt “Rikonstruksioni i linjës se ujësjellësit Φ 140 MM PE nga baseni i presioni ne Dajt deri ne depon e fshatit Ferraj” ne vlerën 45,730,907 leke pa TVSH është brenda periudhës se garancisë dhe për rrjedhoje shoqëria nuk është pajisur ende me certifikatën e përhershme te marrjes ne dorëzim. Referuar nenit 30.3 te kontratës se paraqitur parashikohet se “garancia e objektit është 24 (njëzet e katër) muaj nga marrja ne dorëzim e objekti (nga data e nënshkrimit te procesverbalit te kolaudimit te punimeve)”.

– Persa i perket kerkeses Operatori/et ekonomike ofertues duhet të kete Drejtues Teknik te perfshire ne licensen e shoqërisë inxhinieret si me poshtë:

- Inxhinier Hidroteknik - 1 (nje)
- Inxhinier Ndertimi - 1 (nje)
- Inxhinier Mekanik - 1 (nje)
- Inxhinier Topograf - 1 (nje)
- Inxhinier Mjedisi i pajisur me certifikate per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis - 1 (nje)

Për secilin prej Drejtuesve Teknik ofertuesi duhet të paraqesë:

a) Kontratë pune.

b) Diplom epërkatëse.

c) Te rezultojne te siguruar ne listepagesa per periudhen Janar 2020 – Qershor 2020, sqarojme se:

OE “F.” shpk ka si Drejtues teknik inxhinerin e profilit ndertim z. L. Rr.

– Siç shkruhet në raportin e KLSH-se, OE F. shpk ka paraqitur dokumente të rreme per targat AA 402 OU, AA 971 NI, AA 894 YF, nuk qendron, ku pas verifikimit nga ana jonë nuk janë dokumente të rreme edhe janë në inventarin kontabel të bilancit, ku janë ngjyrosur, pavarsisht se nuk janë shenuar targat per mjetet 402 OU,B,AA 971NI dhe AA 894 YF.

Lidhur me Mangësitë e konstatuara nga KLSH-janë Bashkine Tropojë ju sqarojme dhe ju paraqesim prova sa më poshte:

Provat e reja per keto mjete janë si më poshte:

a) Targa AA 402 OU

-Ekstrakti nzjerre nga e-albania,

-Inventari kontabel me nr.KOD 0000000043.

-Dokumenta të origjines,deklarata doganore me nr.shasie ËMA70SZZ2AL057976.

-Certefikat pronsie me nr.shasie ËMA70SZZ2AL057976.

-Leje qarkullimi me nr.KUD0228016.

b) Targa,AA 971 NI

-Ekstrakti nzjerre nga e-albania.

-Inventari kontabel me nr.KOD0000000019

-Dokumenta të origjines, deklarata doganore me nr.shasie ËDB9062531N346771.

-Certifikat pronsie me nr.shasie ĒDB9062531N346771.

-Leje qarkullimi me nr.KUD0132216.

c) Targa AA 894 YF

-Ekstrakti nzjerre nga e-albania.

-Inventari kontabel me nr.KOD0000000298

-Dokumentatë origjines, deklarata doganore me nr.shasie ĒMAT460608M231279.

-Certifikat pronsie me nr.shasie ĒMAT460608M231279.

-Leje qarkullimi me nr.KUD0156619.

Theksojme se keto mjete janë të kontabilizuara dhe të kontrolluara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Kukes të cilat janë kontrolluar nga KVO e Bashkise gjatë vlersimit të ofertave”.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:

1- Në lidhje me mjetet komenti juaj merret në konsideratë.

2- Në lidhje me pretendimin tuaj: òM. L. referuar ekstraktit te shoqërisë është drejtues teknik dhe jo anëtar i ndonjë organi administrativ, drejtues, mbikëqyrës dhe nuk parashikohen për te kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrollueseò. Komenti juaj nuk merret në konsideratë pasi ky person figuron ne ekstraktin historik si drejtues teknik.

3- Në lidhje me kontratat e ngjashme ju sqarojmë se

1-kontratë me Ujësjiellës Kanalizime Tiranë, me nr. 9713/10 prot., datë 26.07.2019, me objekt òRikonstruksion i linjës së ujësjiellësit Ø 140 mm PE nga baseni i presionit në Dajt deri në depon e fshatit Ferrajò, në vlerën prej 45,730,907 lekë pa tvsh. OE ò4.Mò shpk nuk ka paraqitur certifikatën e marrjes në dorëzim siç është kërkuar në DST, duke mos e plotësuar këtë kriter.

2-kontratë me Ujësjiellës Kanalizime Tiranë, me nr. 16976/12 prot., datë 10.10.2018, me objekt òNdërtim linje transmetimi ujësjiellësi nga Impianti i Bovillës deri te rruga -Demokraciaò, në vlerën prej 143,919,455 lekë pa tvsh. OE ò4.Mò shpk ka marrë pjesë si bashkim operatorësh në këtë procedurë prokurimi së bashku me OE òL.ò shpk & òS. I.ò shpk dhe ka marrë përsipër kryerjen e 18.24 % të punimeve. Kjo përqindje punimesh e marrë përsipër nga ky OE i korrespondon vlerës prej 26,250,908 lekë pa tvsh, ndërkohë që vlera jo më e vogël se 50% e fondit limit të kontratës që prokurohet është të paktën 28,878,967 lekë, duke mos e plotësuar këtë kriter.

Në lidhje me drejtuesit teknik ju sqarojmë se: Për plotësimin e këtij kriteri, OE òF.ò shpk ka paraqitur si inxhinier mekanik z. J. K.(i cili nuk figuron si drejtues teknik) si dhe znj. F. Rr. si inxhinier ndërtimi (e cila nuk figuron si drejtuese teknike), duke mos e plotësuar kriterin e mësipërm.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga operatori ekonomik “4.M” shpk., është paraqitur observacioni në adresën zyrtare të emailit në datën 27.07.2021,ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i operatorit ekonomik “4.M” shpk: Në lidhje me mosdeklarimin në shtojcën nr 8 òDeklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të gjithë personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, drejtuesin teknik M. L.. Z. M. L. është emëruar më datë 16.01.2019 me vendim të Ortakut të Vetëm të shoqërisë në detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë për transport kombëtar dhe ndërkombëtar të mallrave, sikurse rezulton edhe në dokumentacionin përkatës, bashkëlidhur ekstraktit historik të shoqërisë lehtësisht të aksesueshëm pranë QKB).

Përsa i përket kontratës me Ujësjiellës Kanalizime Tiranë, me nr. 9713/10 prot., datë 26.07.2019, me objekt òRikonstruksion i linjës së ujësjiellësit Ø 140 mm PE nga baseni i presionit në Dajt deri në depon e fshatit Ferrajò, në vlerën prej 45,730,907 lekë pa tvsh nuk

është paraqitur certifikata e marrjes në dorëzim siç është kërkuar në DST, duke mos e plotësuar këtë kriter.

Certifikata e marrjes në dorëzim është një dokument që lëshohet nga AK pas përfundimit të periudhës së garancisë së punimeve. Në rastin e kësaj kontrate AK nuk e ka lëshuar këtë dokument pasi nuk e ka detyrim.

Përsa i përket drejtuesit teknik të paraqitur nga OE òF.ò shpk, të cilët nuk bëjnë pjesë në licencën e shoqërisë si drejtues teknik, por janë staf shtesë dhe nuk bëjnë pjesë në përlllogaritjen e stafit të propozuar.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: nuk merret parasysh mungesa e deklaramit në shtojcën nr 8 òDeklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të gjithë personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, drejtuesin teknik M. L..

Përsa i përket kontratës me Ujësjetllës Kanalizime Tiranë, me nr. 9713/10 prot., datë 26.07.2019, me objekt òRikonstruksion i linjës së ujësjetllës Ø 140 mm PE nga baseni i presionit në Dajt deri në depon e fshatit Ferrajò, në vlerën prej 45,730,907 lekë pa tvsh nuk është paraqitur certifikata e marrjes në dorëzim siç është kërkuar në DST, duke mos e plotësuar këtë kriter. Gjithashtu, nuk jeni shprehur edhe për punën tjetër të ngjashme e cila si vlerë nuk e plotëson kriterin prej 50% të kërkuar për punë të ngjashme gjatë 3 viteve të fundit (dhe ku e keni paraqitur certifikatën e marrjes në dorëzim siç është kërkuar në DST).

Në lidhje me drejtuesin teknik të OE òF.ò shpk, në DST është kërkuar që ata të jenë në licencën e shoqërisë dhe jo staf shtesë, prandaj as ky argument nuk merret parasysh.

6.Titulli gjetjes: Procedura e prokurimit publik me objekt: **“Projektim, rikonstruksion rrugësh për vitin 2020”**, me këto të dhëna:

Urdhër prokurimi Nr. 8, datë 06.04.2020	NJHDT: K. B., teknik inxhinieri	KVO: nr. 11, datë 20.04.2020 P. R., ekonomist
Lloji i procedurës òe hapur - konsulencë	L. V., jurist	A. T., shërbim social
Fondi limit 9,419,818lekë.	Z. I. - ekonomiste	K. A., juriste
Burimi Financimit: të ardhurat	OE fitues: òD. E.ò shpk	OE pjesëmarrës në tender: 7 Sòkualifikuar 6
Data e hapjes tenderit: 01.06.2020	Vlera e fituar: 9,345,200 lekë	Kualifikuar 3
Ankimime në AK: s`ka		Faza e pare kualifikuar 3
Ankimime në KPP: - s`ka	Diferenca me fondin limit 74,618 lekë	Kontrata nr. 1488/5, datë 24.08.2020 Vlera 11,214,240 lekë.
Titullari i AK: personi i autorizuar nga Titullari i AK Nën/ Kryetar A. K.		Miratimi i procedurës datë 18.08.2020

Nga auditimi i procedurës rezultoi se janë zbatuar aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Sa trajtuar më sipër është mbajtur aktkonstatimi nr.4, datë 04.06.2021.

Blerjet me vlera të vogla

Për vitin 2019 është krijuar Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël nr.29 prot., datë 07.01.2019, me Urdhër nr.1, datë 07.01.2019 të Titullarit të AK B. D., i përbërë nga:

- Bardhyl Hoxhaj;
- Ardon Brecani;
- P. R..

Për vitin 2020 është krijuar Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël nr.185 prot., datë 15.01.2020, me Urdhër nr.1, datë 07.01.2019 të Titullarit të AK R. B., i përbërë nga:

- K. B.;
- K. A.;

- Z. I.

Nga auditimi i **zonës së llogarisë 602**, për blerjet me vlera të vogla, rezultoi se janë zhvilluar për periudhën objekt auditimi blerje me vlerë të vogël sa vijon:

Vitet	Blerje të vogla		Seleksionuar për tu audituar bazuar në riskun e auditimit		
	Numër	vlerë	numër	vlerë	në % ndaj totalit
2019	81	13,937,331	10	2,675,584	19%
2020	46	9,240,030	10	2,084,827	23%
Totali	127	23,177,361	20	4,760,411	21%

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike Bashkia Tropojë

Tabela analitike e procedurave të blerjeve me vlerë të vogël të zhvilluar për periudhën 2019 ó 2020 si dhe ato të audituara janë në aneksin bashkëlidhur këtij akt verifikimi

Bazuar tek vlerësimi i riskut janë kampionuar për t'u audituar në total 20 procedura prokurimi me vlerë të vogël, në shumën 4,760,411 lekë ose 21% e vlerës.

Procedurat e prokurimit me blerje me vlera të vogla, të audituara me të dhënat specifike sipas UMF nr.57, datë 12.06.2014, òPër gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartëò, paraqiten sipas tabelës sa më poshtë vijon:

- Në asnjë rast të përdorimit të formës së prokurimit òBlerje me vlerë të vogëlò, fondi limit nuk ka qenë mbi 800,000 lekë pa TVSH, pra mbi kufirin monetar të përcaktuar me vendimin e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër rregullat e prokurimit publikò, kreu II, pika 2 si dhe udhëzimin e APP nr. 3, datë 27.01.2015 òPër procedurën e prokurimit me vlera të voglaò të ndryshuar.

- Nga Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla është zbatuar limiti i përcaktuar për prokurimet me vlera të vogla i cili nuk është tejkaluar në asnjë rast.

- Miratimi i kërkesës për prokurim në të gjitha rastet janë miratuar nga Nëpunësi i Autorizuar i AK.

-Shpallja elektronike në sistem e procedurës, është realizuar në kohën e përcaktuar sipas dispozitave ligjore në fuqi. Anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël në të gjitha rastet, pasi kanë krijuar në sistem dosjen e tenderit, u janë drejtuar nëpërmjet ftesës për ofertë (sipas formularit nr. 3), 5 (pesë) operatorëve ekonomikë për një periudhë 1-2 ditë nga nxjerrja e urdhrat të prokurimit.

- Në të gjitha rastet është zbatuar kriteri i çmimit më të ulët për klasifikimin përfundimtar.

- Në të gjitha rastet nga anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, është mbajtur procesverbal për shpalljen e OE fitues, mbi bazën e ofertës më të ulët të shpallur nga sistemi. (Në të gjitha rastet ishin printuar ofertat e gjeneruara nga sistemi).

Në të gjitha rastet OE fitues është njoftuar nëpërmjet sistemit elektronik. Ne rastet e tërheqjes së ofertave të vendeve të para është dokumentuar me shkresat zyrtare nga operatorët ose printimit nga sistemi i emaile-ve të kryera nga AK(njoftimi) dhe OE(përgjigja).

- Në dosjen e prokurimeve me vlera të vogla ndodheshin Faturat Tatimore Shitje, të njëjta me vlerën e ofertuar si dhe me urdhër shpenzimet përkatëse.

- Në të gjitha rastet AK ka bërë përlllogaritjen e fondit limit, duke u bazuar në ofertat e marra në treg dhe të pasqyruara dokumentin e hartuar për llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike.

- Për gjithë periudhën objekt auditimi për procedurat me blerje te vogla, është bërë inventarizimi i dosjeve dhe arkivimi, sipas Udhëzimin nr. 3 datë 03.04.2014,òPër zhvillimin e Prokurimeve me vlerë te vogël ne sistem të prokurimit elektronik për autoritetin kontraktor dhe operatorët ekonomik òku thuhet shprehimisht që òAutoriteti kontraktor duhet te bëjë

arkivimi e procedurës së prokurimit brenda lditë punë nga mbyllja e fazës së njoftimit fitues”, pasi faza arkivimit të kontratës është e papërfunduar.

- Për të gjitha rastet e blerjeve si për shërbimet dhe mallrat është kryer procesi i marrjes në dorëzim të mallit dhe shërbimit nga komisioni i ngritur për çdo rast nga Nëpunësi Autorizues.

Konkluzion: Nga auditimi i pagesave për blerje me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël rezultoi se procedurat në përgjithësi ishin të plotësuara dhe dokumentacioni bashkëlidhur përbën gjurmën e auditimit të këtyre procedurave në të gjitha fazat dhe hapat e kryera për realizimin e këtyre procedurave deri në momentin e kontabilizimit të tyre në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 dhe Për rregullat e prokurimit publikë i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017, kreu II, Udhëzimi i APP nr. 2, datë 24.04.2017 dhe Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, pika 2 dhe me UMF nr.57 datë 12.06.2014 dhe Për Gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë.

Të dhëna për rregjistrin e prokurimeve me vlera të vogla jepen në aneksin nr.4/7, bashkëngjitur raportit të auditimit.

Për sa më sipër për blerjet me vlera të vogla është mbajtur akt verifikimi nr.1.

Pika nr.4. Nën-pika 4.4. Auditim mbi hartimin e projekteve, zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomike fitues.

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në objektin "Shkolla Asim Vokshi-Palestër dhe terrene sportive dhe sistemime të jashtme "Asim Vokshi", konstatohet:

Projekti parashikon ndërtimin e një palestere në shkollën "Asim Vokshi" me beton arme, me mbulesë me panele sanduiç, me sistem ngrohje, instalimet elektrike, hidraulike dhe sistemime të jashtme e të terreneve sportive.

- Objekti i kontratës "*Shkolla Asim Vokshi-Palestër dhe terrene sportive dhe sistemime të jashtme "Asim Vokshi"* është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 1269/8 prot. datë 24.09.2019, të lidhur midis Autoritetit Bashkisë Tropojë, përfaqësuar nga z. R. B. dhe Operatorit Ekonomik "4. M."shpk përfaqësuar nga administratori z. A. M.. Vlera e kontratës është 59,441,140 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar 3 muaj nga dita e dorëzimit të sheshit të punimeve. Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku bazuar nën 39 të kontratës, preventivi do të përdoret për të llogaritur vlerën e kontratës, ku kontraktori paguhet me sasinë e punës e realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh. Për mbikëqyrjen e kontratës së zbatimit është lidhur kontrata nr. 29/60 datë 27.06.2019, të lidhur midis Autoritetit Bashkisë Tropojë, përfaqësuar nga z. B. D. dhe Operatorit Ekonomik "G. C. E."shpk përfaqësuar nga administratori z. G. B.. Për kolaudimin e punimeve është kontraktuar operatori ekonomik "R."shpk, përfaqësuar nga drejtuesit ligjor Ing. R. Sh., me kontratën nr. 29/70 prot. datë 23.07.2019.

- Akti e dorëzimit të sheshit të ndërtimit është mbajtur më datë 24.09.2019. Procesverbali i fillimit të punimeve dhe njoftimi i fillimit të punimeve janë mbajtur nga palët më datë 24.09.2019. Me kërkesën e sipërmarrësit nr. 1269/9 prot. datë 22.11.2019, drejtuar mbikëqyrësit dhe Bashkisë Tropojë, kërkohet ndërprerja e punimeve për arsye atmosferike me temperatura nën zero. Kjo ndërprerje është e domosdoshme për disa procese pune, ku nuk mund të punohen në kushtet e të ftohtit sipas kushteve teknike të zbatimit dhe ndërprerja të zgjasë deri në krijimin e kushteve të favorshme atmosferike. Gjithashtu mbikëqyrësi me shkresën nr. 1269/11 prot. datë 22.11.2019, kërkon ndërprerjen e punimeve nga Autoriteti Kontraktor. Procesverbali i ndërprerjes së punimeve është mbajtur nga palët me nr. 1269/10 prot. datë 25.11.2019, ku citohet se rifillimi i punimeve do të jetë akt i mbajtur midis palëve. Procesverbali i rifillimit të punimeve është realizuar midis palëve me nr. 1269/12 prot. datë

10.02.2020. Palët kanë amenduar kontratën me nr. 1269/13 prot. datë 10.02.2020, ku kanë cilësuar zgjatjen e afatit të zbatimit të punimeve me 5 muaj e 15 ditë, nga dorëzimi i sheshit të punimeve, për shkak të ndërprerjes së punimeve nga faktorët atmosferik. Më datë 10.03.2020, sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve kanë njoftuar bashkinë Tropojë për përfundimin e punimeve. Procesverbali i përfundimit të punimeve mbajtur nga palët me nr. 1311/2 prot. datë 10.03.2020, brenda afateve kontraktuale të miratuara. Akti i kolaudimit është realizuar me nr. 1530 prot. datë 08.04.2020.

- Me procesverbalin e datës 14.02.2020, rishikohet preventivi i punimeve i miratuar nga palët në zbatim të nenit 38 të kontratës ku citohet "*Investitori mund që në cdo kohë të porositë sipërmarrësin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të kontratës në secilën prej rasteve më poshtë:*

Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet teknike

Korrigjime në materiale

Korrigjime në sasi.

- Në procesverbalin e rishikimit të volumeve vlera e punimeve më tepër rezulton në vlerën 12,782,312 lekë me TVSH dhe vlera e punimeve më pak 9,909,767 lekë me TVSH. Diferenca e punimeve që shtohen me punimet që hiqen është 2,872,545 lekë me TVSH, e cila mbulohet nga fondi rezervë dhe punimet e paparashikuara realizohen brenda vlerës së kontratës. Procesverbali i negocimit të çmimit për zërat e rinj është realizuar më datë 14.02.2020, i cili përmban 5 zëra punimesh si "*Patinim tavani me kartonxhes*", "*Motor për portën e oborrit*", "*Rrjete mbrojtëse zingato për dritaret*", "*Kamera IP 4mp*", "*F.V Sëitch*". Procesverbali i përdorimit të fondit rezervë të miratuar nga Autoriteti Kontraktor është realizuar më datë 17.02.2020, me nr. 1269/17 datë 17.02.2020. Ditari i punimeve fillon nga data 24.09.2019 deri më datë 09.03.2020. Dosja e punimeve përmban procesverbale të ndryshme mbi zbatimin e punimeve, procesverbale për punimet e maskuara dhe testime të ndryshme mbi rezistencën kubike të betoneve.

-Kontrata përbëhet nga 2 situacione pjesore progresive, ku situacioni pjesor nr.1 nuk është shoqëruar me librezë masash pjesore, veprim i cili është në kundërshtim Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005 *ËPër zbatimin e punimeve të ndërtimit* Kreu II, pika 8.1; "*Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori*" dhe Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011 *ËPër disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave* *ËPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*, 3.3 ku përkatësisht përcaktohet se: 3.3 "*Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave*". Në dosjen teknike administrohet vetëm librezë e masave përfundimtare e cila korrespondon me situacionin përfundimtar.

Nga verifikimi i strukturës së preventivit dhe pagesës në situacionin përfundimtar, u konstatua pasaktësi si më poshtë vijon:

1. Në situacionin përfundimtar, kapitulli nr. VII të punimeve të suvatimit, veshje bojatisje, zëri nr. 4, nr. anal 2.358 /b *ËVeshje fasade me polisterol jeshil t=5cm + rrjete + suvaö*, çmimi përkatës të ofertuar prej 2,400 lek/m², është llogaritur në përputhje me VKM nr. 629, datë 15.07.2015, me çmimin 2,869 lekë/m², si më poshtë:

Nr.	EMERTIMI	Njesia	PUNTORI			TRANSPORT			MAKINERI			MATERIAL			Shuma	Shp	Fitim	TOTALI
			op	çmimi	Vlefte	T*km	çmimi	Vlefte	o.p	çmimi	Vlefte	Sasia	çmimi	Vlefte				
2.358/b	Veshje fasade me polisterol jeshil t=5cm + rrjete + suva.	m2																
	Sp + p	op	6	185	1,073													
	Sigurime shoqerore 16.7%	leke	1,073	0	179													
	Transport	T*km				1	21	20										
	Elektro argano	op							0	45	16							
	Trapano	op							0	95	17							
	Polisterol kompakt jeshil 5cm	m2										0	9,050	453				
	Kolle per ngjitje	kg										4	25	100				
	Upa betoni plastike	cope										9	22	198				
	Rrjete plastike	m2										1	80	88				
	Grafiato per suva	kg										5	25	125				
	Skele inventar	m2										1	130	163				
	Shuma :				1,252			20			33			1,126	2,431	194	243	2,869

Nga verifikimi i analizave sipas manualeve për zërat nr. anal 2.358 /b, konstatohen se në strukturën e çmimit përfshihet Grafiato për suva.

Ndërkohë, po në kapitullin nr. VII të punimeve të suvatimit, veshje bojatisje, zëri nr. 5, nr. anal 2.308/a *ðSuvatim me grafiato* me çmimin e ofertuar prej 1,057 lek/m² (në përlllogaritjen e fondit limit) dhe çmimi i ofertuar nga ð4AMö shpk me 1,000 lekë/ m², i cili është zë pune i mbivendosur proceseve të Veshjes së fasadës, pasi përfshihet edhe suvatimi me grafiato bazuar VKM nr. 629, datë 15.07.2015, si në tabelën e mëposhtme:

Nr.	EMERTIMI	Njesia	PUNTORI			TRANSPORT			MAKINERI			MATERIAL			Shuma	Shp	Fitim	TOTALI
			op	çmimi	Vlefte	T*km	çmimi	Vlefte	o.p	çmimi	Vlefte	Sasia	çmimi	Vlefte				
2.308/a	Suvatim me grafiato h > 4 m	m2																
	Sp + p	op	4	185	648													
	Sigurime shoqerore 16.7%	leke	648	0	108													
	Transport	T*km				0	21	8										
	Vinç	op							0	53	6							
	Grafiato e gatshme	kg										5	25	125				
	Shuma :				756			8			6			125	895	72	90	1,057

- Rrjedhimisht për sa më sipër, zëri i *ðSuvatim me grafiato*, përbën mbivendosje të punimeve të veshjes së fasadës, për shkak të pasaktësisë së preventivit, në të cilën sipërmarrësi ka likuiduar më tepër sasinë prej 818 m² me çmimin 1,000 lekë/m², ku rezulton vlera prej 818,000 lekë pa TVSH.

- Nga verifikimi i dosjes teknike në fotot e objektit, konstatohet se nuk ka dokumentim të procesit të zërit "*Suva e zakonshme fasade mur tulle h-8m*", i cili është zë pune i maskuar.

- Nga verifikimi në terren i palestrës dhe i sistemimeve të territorit, u konstatuan disa defekte në punimet e parketit dhe të shtesave të pllakave granili me bojë, ku nga autoriteti kontraktor duhet të merren masa për korrigjimet e tyre në fazën e çlirimit nga garancia e punimeve të sipërmarrësit.

Për këtë investim rezultoi se **nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej 818,000 lekë pa TVSH, e përfituar nga sipërmarrësi**, për çmimet e punimeve, të cilat mbivendosen proceseve të punës, të cilat mund të ishin korrigjuar në hartimin e preventivit të rishikuar apo situacionit përfundimtar.

Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve Ing. G. B., nuk është zbatuar rigorozisht përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se:

"Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit."

Titulli i Gjetjes 1: Pasaktësi në mbivendosje punimesh në objektin "Shkolla Asim Vokshi-Palestër dhe terrene sportive dhe sistemime të jashtme "Asim Vokshi".

Situata: Objekti i kontratës "Shkolla Asim Vokshi-Palestër dhe terrene sportive dhe sistemime të jashtme "Asim Vokshi" është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 1269/8 prot. datë 24.09.2019, të lidhur midis AK dhe Operatorit Ekonomik "4. M."shpk. Vlera e kontratës është 59,441,140 lekë me TVSH me afat 3 muaj. Nga verifikimi i strukturës së preventivit dhe pagesës në situacionin përfundimtar, u konstatua pasaktësi në, kapitulli nr. VII të punimeve të suvatimit, veshje bojatisje, zëri nr. 4, nr. anal 2.358/b *ËVeshje fasade me polisterol jeshil t=5cm + rrjete + suvaö*, cmimi përkatës i ofertuar prej 2,400 lek/m², është llogaritur në përputhje me VKM nr. 629, datë 15.07.2015, me çmimin 2,869 lekë/m². **Ndërkohë**, po në kapitullin nr. VII të punimeve të suvatimit, veshje bojatisje, zëri nr. 5, nr. anal 2.308/a *ËSuvatim me grafiatoö* me çmimin e ofertuar prej 1,057 lek/m² (në përlllogaritjen e fondit limit) dhe çmimi i ofertuar nga *AMö shpk* me 1,000 lekë/ m², është zë pune i mbivendosur proceseve të Veshjes së fasadës, pasi përfshihet edhe suvatimi me grafiato bazuar VKM nr. 629, datë 15.07.2015. Rrjedhimisht, zëri *ËSuvatim me grafiatoö*, përbën mbivendosje të punimeve të veshjes së asadës, për shkak të pasaktësisë së preventivit, në të cilën sipërmarrësi ka likuiduar më tepër sasinë prej 818 m² me çmimin 1,000 lekë/m², ku rezulton vlera prej **818,000 lekë pa TVSH**. Nga verifikimi i dosjes teknike në fotot e objektit, konstatohet se nuk ka dokumentim të procesit të zërit "*Suva e zakonshme fasade mur tulle h-8m*", i cili është zë pune i maskuar. Kontrata përbëhet nga 2 situacione pjesore progresive, ku situacioni pjesor nr.1 nuk është shoqëruar me librezë masash pjesore, veprim i cili është në kundërshtim Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005 *ËPër zbatimin e punimeve të ndërtimitö* Kreu II, pika 8.1. Nga verifikimi në terren i palestrës dhe i sistemimeve të territorit, u konstatuan disa defekte në punimet e parketit dhe të shtesave të pllakave granili me bojë, ku nga autoriteti kontraktor duhet të merren masa për korrigjimet e tyre në fazën e çlirimit nga garancia e punimeve të sipërmarrësit.

Kriteri: Situacioni përfundimtar jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *ËPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimitö*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *ËPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitö e konkretisht Kreu II, Pika 3.*
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1269/8 prot. datë 24.09.2019. Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve me nr. 29/60 datë 27.06.2019.

VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 *ËPër miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknikeö*

Ndikimi/Efekti:Dëme ekonomike të paargumentuara në vlerën 818,000 lekë pa TVSH

Shkaku: Pasaktësi në situacionin përfundimtar për shkak të preventivit fillestar

Rëndësia:I lartë.

Rekomandime:

- Kryetari i Bashkia Tropojë të marrë masa duke ngritur grup pune të veçantë me specialistë të fushës, për të përcaktuar shkaqet që kanë çuar në pasaktësinë e preventivit dhe të kërkojë likuidimin e vlerës prej **818,000 lekë pa TVSh** nga operatori ekonomik *AMö ShPK*.

Pretendim i subjektit: Në lidhje me trajtimin e mësipërm në fazën pas dërgimit të projektraportit janë bërë kundërshti nga operatori ekonomik "4.M" shpk, me nr. 935/49 prot. datë 27.07.2021 (të dhëna të subjektit), dërguar me postën elektronike në adresën bmecaj@klsh.org.al, ku pretendohet se në lidhje me zbatimin e objektit "Shkolla Asim Vokshi-Palestër dhe terrene sportive dhe sistemime të jashtme "Asim Vokshi", cmimi i ofertuar për

“Veshje fasade me polisterol jeshil $t=5\text{cm}$ + rrjete + suva”, nuk është sa analiza e manualit me cmimin 2,869 lekë pa TVSH por 2,400 pa TVSH (që shpjegon faktin se kontraktori nuk e ka përfshirë grafiaton në këtë zë pune).

Qendrim i grupit të auditimit: Pretendimi i mësipërm nuk merret në konsideratë, pasi zëri i *“Suvatim me grafiato”, sipas manualit të cmimeve nr. 2.308/a është në vlerën 1,057 lekë/m² dhe cmimi i ofertuar nga kontraktori është me çmimin 1,000 lekë/m².*

2. Objekti "Rikonstrukcion rrugë lagja 28 Gushti "Bajram Curri", konstatohet:

Projekti parashikon sistemime të rrugëve, shesheve, trotuare, sistemimet e kanalizimeve dhe punime ndriçimi në lagjen 28 Gushti.

- Objekti i kontratës *"Rikonstrukcion rrugë lagja 28 Gushti "Bajram Curri"* është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 124/7 prot. datë 26.03.2019, të lidhur midis Autoritetit Bashkisë Tropojë, përfaqësuar nga z. B. D. dhe Operatorit Ekonomik "F."shpk përfaqësuar nga administratori z. Z. B.. Vlera e kontratës është 20,543,366 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar 2 muaj nga dita e dorëzimit të sheshit të punimeve.

Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku bazuar *nenit 39* të kontratës, preventivi do të përdoret për të llogaritur vlerën e kontratës, ku kontraktori paguhet me sasinë e punës e realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh.

- Për mbikëqyrjen e kontratës së zbatimit është lidhur kontrata nr. 29/24 datë 26.03.2019, të lidhur midis Autoritetit Bashkisë Tropojë, përfaqësuar nga z. B. D. dhe Operatorit Ekonomik "R."shpk përfaqësuar nga administratori z. R. Sh..

- Për kolaudimin e punimeve është kontraktuar operatori ekonomik "X. M."shpk, përfaqësuar nga drejtuesi ligjor Ing. X. D., me kontratën nr. 29/47 prot. datë 03.06.2019.

- Akti e dorëzimit të sheshit të ndërtimit dhe procesverbali i piketimit, janë mbajtur nga palët më datë 27.03.2019. Procesverbali i fillimit të punimeve dhe njoftimi i fillimit të punimeve është realizuar më datë 28.03.2019. Ditari i punimeve fillon nga data 27.03.2019 deri më datë 27.05.2019. Në dosjen teknike disponohen procesverbalet e punimeve të maskuara, analiza laboratorike. Procesverbali i përfundimit të punimeve mbajtur nga palët më datë 29.05.2019, ku cilësohet se punimet kanë përfunduar më datë 27.05.2019, brenda afateve kontraktuale të miratuara.

- Me shkresën e sipërmarrësit datë 04.05.2019 dhe të mbikëqyrësit datë 06.05.2019, drejtuar bashkisë Tropojë, kërkohet përdorimi i fondit rezervë, për shkak të ndryshimeve të volumeve në preventiv, që mund të mbulohen me fondin rezervë. Me procesverbalin e datës 06.05.2019, përdorimi i fondit rezervë miratohet nga Investitori Bashkia Tropojë.

Akti i kolaudimit është realizuar me datë 26.06.2019. Me urdhrin e titullarit nr. 128 datë 05.07.2019, ngrihet komisioni i marrjes në dorëzim dhe certifikate e marrjes së përkohshme në dorëzim realizohet më datë 08.07.2019.

Nga verifikimi i strukturës së preventivit dhe pagesës në situacionin përfundimtar, u konstatua pasaktësi si më poshtë vijon:

1. Në situacionin përfundimtar, kapitulli nr. II të punimeve të trotuareve zëri nr. 4, me nr. analize nr. 3.211 *"Shtresë me çakëll mbeturine kave $t=20\text{ cm}$, përhapur e ngjeshur me makineri"*, paraqet sasia prej 634 m³. Librezat e masave paraqesin të njëjtën sasi prej 634 m³ në total të trotuareve, ku nuk janë përcaktuar akset apo koordinatat e trotuare, por vetëm profilin tip i trotuarit. Çmimi i ofertuar për shtresën e çakallit është 904 lekë/m³ shumëzuar me sasinë prej 634 m³, rezulton vlera 573,136 lekë pa TVSH.

- **Ndërkohë**, po në kapitullin nr. II të punimeve të trotuareve zëri nr. 6, me nr. analize nr. 3.205/1 *"Shtresë zhavorri lumi $t=15\text{ cm}$, përhapur e ngjeshur me makineri"*, paraqet sasinë

prej 634 m³. Librezat e masave paraqesin të njëjtën sasi prej prej 634 m³ në total të trotuareve, ku Profili tip dhe projekti i zbatimit, paraqet shtresat e trotuarit si më poshtë:

- Zhavorr = 10 cm
- Beton = 10 cm
- Ranë = 4 cm
- Pllaka = 6 cm

Çmimi i ofertuar për zhavorrin e lumit me t=15 cm është 322 lek/m³ shumëzuar me sasinë prej 634 m³, rezulton vlera 204,148 lekë pa TVSH.

Rrjedhimisht sa më sipër, mbështetur në kushtet teknike të zbatimit, projektin e zbatimit, konstatohet se në trotuaret është zbatuar vetëm shtresa e zhavorrit të lumit t=15 cm, ku zëri nr. 4 "*Shtresë me çakëll mbeturine kave t=20 cm, përhapur e ngjeshur me makineri*", rezulton zë pune i paargumentuar apo i justifikuar **nga sipërmarrësi në vlerën 573,136 lekë pa TVSH**, cilat mund të ishte korigjuar në hartimin e preventivit të rishikuar apo situacionit përfundimtar.

Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve Ing. R. Sh., nuk ka zbatuar rigorozisht përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se:

"Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit."

Titulli i Gjetjes 2: Pasaktësi në situacionin përfundimtar të objektit *Rikonstruksion rrugë lagja 28 Gushti "Bajram Curri"*, Bashkia Tropojë.

Situata: Objekti i kontratës "*Rikonstruksion rrugë lagja 28 Gushti "Bajram Curri"* është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 124/7 prot. datë 26.03.2019, të lidhur midis AK dhe operatorit ekonomik "F."shpk. Vlera e kontratës është 20,543,366 lekë me TVSH me afat 2 muaj. *Nga verifikimi i strukturës së preventivit dhe pagesës në situacionin përfundimtar, u konstatua pasaktësi në kapitullin nr. II të punimeve të trotuareve zëri nr. 4, me nr. analize nr. 3.211 "Shtresë me çakëll mbeturine kave t=20 cm, përhapur e ngjeshur me makineri"*, ku paraqet sasia prej 634 m³. Librezat e masave paraqesin të njëjtën sasi prej prej 634 m³ në total të trotuareve, ku nuk janë përcaktuar akset apo kordinatat e trutuar, por vetëm profilin tip i trotuarit. Çmimi i ofertuar për shtresën e çakallit është 904 lek/m³ shumëzuar me sasinë prej 634 m³, rezulton vlera 573,136 lekë pa TVSH. Ndërkohë, po në kapitullin nr. II të punimeve të trotuareve zëri nr. 6, me nr. analize nr. 3.205/1 "*Shtresë zhavorri lumi t=15 cm, përhapur e ngjeshur me makineri*", paraqet sasinë prej 634 m³. Librezat e masave paraqesin të njëjtën sasi prej prej 634 m³ në total të trotuareve, ku Profili tip dhe projekti i zbatimit, paraqet shtresat e trotuarit si më poshtë: Zhavorr = 10 cm, Beton = 10 cm, Ranë = 4 cm, Pllaka = 6 cm. Çmimi i ofertuar për zhavorrin e lumit me t=15 cm është 322 lek/m³ shumëzuar me sasinë prej 634 m³, rezulton vlera 204,148 lekë pa TVSH. Rrjedhimisht, mbështetur në kushtet teknike të zbatimit, projektin e zbatimit, konstatohet se në trotuaret është zbatuar vetëm shtresa e zhavorrit të lumit t=15 cm, ku zëri nr. 4 "*Shtresë me çakëll mbeturine kave t=20 cm, përhapur e ngjeshur me makineri*", rezulton zë pune i paargumentuar apo i justifikuar nga sipërmarrësi në vlerën **573,136 lekë pa TVSH**, cilat mund të ishte korigjuar në hartimin e preventivit të rishikuar apo situacionit përfundimtar.

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *oPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*o, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *oPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*o e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve me nr. 124/7 prot. datë 26.03.2019
- Kontratën e mbikëqyrjes së punimeve nr. 29/24 datë 26.03.2019

Ndikimi/Efekti:Dëme ekonomike të paargumentuara në vlerën 573,136 lekë pa TVSH .

Shkaku: Pasaktësi nga mbikëqyrësi i punimeve në situacionin përfundimtar

Rëndësia:I Lartë.

Rekomandime: Bashkia Tropojë të marrë masa, të ngrëjë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, për të përcaktuar shkaqet që kanë çuar në pasaktësinë e preventivit dhe të kërkojë likuidimin e vlerës prej **573,136 lekë pa TVSh** nga operatori ekonomik òF.ò ShPK.

5. Zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, dërguar në Bashkinë Tropojë me shkresën nr. 1082/48 prot., datë 05.06.2020.

1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

2. Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.

3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Nga verifikimi rezultoi:

Në bazë të programit të auditimit nr. 1475/1, datë 31.12.2018 të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Bashkia Tropojë është audituar për periudhën nga data 01.01.2017 deri në datën 31.12.2018. Me shkresën nr. 1475/7 prot., datë 27.07.2019 është dërguar raporti përfundimtar i auditimit dhe rekomandimet. Zbatimi i rekomandimeve është audituar në bazë të programit të auditimit nr.1082 prot., datë 28.12.2019.

Në shkresën nr. 1082/48 prot., datë 05.06.2020, KLSH ka dërguar në Bashkisë Tropojë raportin përfundimtar të auditimit, në të cilin ka rikërkuar zbatimin e rekomandimeve të cilat kanë qenë të pa zbatuara dhe në proces zbatimi.

Hartimi i programit (Plan veprimit) mbi respektimin e afatit ligjor prej 20 ditësh nga data e marrjes së kërkesës, për informimin e KLSH për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm në zbatim të shkronjës (j) të nenin 15 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Zbatimi nga subjekti

Nga Kryetari i Bashkisë Tropojë, ka dalë urdhri nr. 244/1, datë 12.06.2020, òMbi ngritjen e komisionit për hartimin e planit të veprimit në zbatimin të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 1082/48 prot., datë 05.06.2020. Komisioni i ngritur për këtë qëllim, i përbërë nga znj. Z. I., me detyrë n/kryetare e Bashkisë prej muajit shtator 2019 e në vijim, z.K. R.j, me detyrë zëvendës kryetar bashkie, z. B. T., me detyrë drejtor ekonomik, z. P. M.j, me detyrë përgjegjës i sektorit të buxhetit dhe financës prej datës 12.06.2020 e në vijim, z. Hazir Isufi, me detyrë përgjegjës i urbanistikës, z. N. A., me detyrë përgjegjësi i sektorit të taksave dhe tarifave vendore, znj. K. A., me detyrë përgjegjëse e sektorit të burimeve njerzore prej 08.11.2019 e në vazhdim, z. K. B., me detyrë drejtor i drejtorisë së pyjeve kullotave dhe bujqësisë, ka hartuar planin e veprimit, me nr.1451/8 prot., datë 26.06.2020. Në planin veprimit, janë caktuar afate dhe struktura përgjegjëse për zbatimin e tyre.

- Bashkia Tropojë nuk ka raportuar pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit për punën e bërë për zbatimin e rekomandimeve të rikërkua, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pika 2, ku thuhet: ò*Subjekti i audituar, brenda 6*

muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

- Nga auditimi konstatohet se Kryetari i Bashkisë nuk ka raportuar në këshillin Bashkiak Tropojë për progresin e zbatimit të rekomandimeve, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore, neni 50, ku thuhet: *“Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit (i cili është realizuar) dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij (i pa realizuar).*”

Zbatimi i masave organizative

Me shkresën nr. 1475/7 prot., datë 27.07.2019, i janë rekomanduar Bashkisë Tropojë 15 masa organizative. Pas përfundimit të auditimit për zbatimin e masave të mësipërme, me shkresën nr. 1082/48 prot., datë 05.06.2020, KLSH ka dërguar në Bashkisë Tropojë, raportin përfundimtar të auditimit, në të cilin ka rikërkuar zbatimin e rekomandimeve të cilat kanë qenë të pa zbatuara dhe në procs zbatimi. Në këtë raport auditimi nga KLSH është konstatuar se nga 15 masa organizative të rekomanduara, janë zbatuar plotësisht 2 masa, janë në proces zbatimi 7 masa dhe nuk janë zbatuar 6 masa, (pa zbatuar rekomandimet nr.1, 3,7,8,9 dhe 14). KLSH ka rikërkuar zbatimin e 7 masave të cilat kanë qenë në proces zbatimi dhe 6 masave të pa zbatuara. Në mënyrë të detajuar zbatimi i 13 masave organizative të ri kërkuara për zbatim në auditimin e fundit, paraqitet si më poshtë (*numrat rendor janë lënë sipas origjinalit të rekomandimeve fillestare*):

1.Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Tropojë gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen deri në një farë mase. Nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, pavarësisht se këtë e realizon referuar kompetencave dhe akteve nënligjore në fuqi, duke reflektuar kështu nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Nuk është ngritur një sistem efektiv i menaxhimit financiarë dhe kontrollit të brendshëm. Raporti vjetor i monitorimit të sistemit të kontrollit të brendshëm nuk identifikon pikat e forta dhe të dobëta të këtij sistemi si dhe nuk merë në analizë të pestë komponentët e MFK. Nuk janë hartuar rregulla për ruajtjen e aktiveve, nuk është hartuar regjistri i risqeve dhe harta e procedurës së punës për gjurmën e auditimit, në kundërshtim me ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin ò, i ndryshuar, respektivisht neni 8,16,22,23,24; Manuali për MFK; ligji nr. 107 date 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territoritò me ndryshime, respektivisht nenin 14-të; Urdhrin nr. 41 datë 06.03.2018 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës të Bashkisë Tropojë.

Në lidhje me mjedisin e kontrollit. Është hartuar Rregullorja e funksionimit të Njësisë, pjesë e së cilës është edhe kodi i etikës. Nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke mos hartuar dhe zhvilluar programe trajnimesh.

Në lidhje me menaxhimin e riskut: Nuk ka të miratuar një strategji të risqeve e përcaktim të koordinatorit të riskut sipas nenit 21. Nuk ka asnjë procedurë për menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

-Në lidhje me informacionin dhe komunikimin: Në rregullore nuk është përfshirë mënyra e komunikimit brenda institucionit, por në fakt veprohej me komunikim verbal, nuk ka sistem IT-së që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë(*Trajtuar në pikën A, faqe 26-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe akt-konstatimin nr. 4, date 05.04.2019).*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe Drejtori Ekonomik në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së riskut dhe përcaktim të koordinatorit të riskut me qëllim menaxhimin e tij, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit, si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Menjëherë

Zbatimi nga subjekti:

Në auditimin e mëparshëm, kjo masë është konstatuar e pa zbatuar.

Nga verifikimi në auditimin aktual të vitit 2021 nuk u paraqitë dokumentacion për të vërtetuar zbatimin pjesërisht apo plotësisht të rekomandimit.

Për rrjedhojë ky rekomandim vijon të jetë i pa zbatuar.

3. Gjetje nga auditimi: Pasqyrat financiare të vitit 2017 (bilanci), janë mbyllur jashtë afatit ligjorë, konfirmuar me shkresën nr.2121prot., datë 10.05.2018, që Bashkia Tropojë ka paraqitur të konfirmuar nga Dega e Thesarit Tropojë, pra me 3 muaj vonesë. Ndërsa për periudhën *raportuese ushtrimore 2018*, u konstatua se procesi i auditimit në lidhje me përgatitjen, hartimin, ndërtimin, raportimin dhe dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore (*bilanci kontabël*) me anekset përkatëse nuk është mbyllur deri në datën e përfundimit të punës auditues në terren. Sipas kësaj deklarate afati për mbylljen e pasqyrave financiare nuk mund të jetë më parë se data 15.04.2019, periudhë e cila është jashtë periudhës objekt auditimi.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me shkronjën (d) e pikës 4 e nenit 9, dhe shkronjës (b) e pikës 2 të nenit 12, të ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 òPër menaxhimin Financiar dhe Kontrollitò; UMF nr. 8, datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësinë e Qeverisjes së Përgjithshmeò, pika 118(*Trajtuar në pikën A, faqe 28-29, të Rraportit të Auditimit, si dhe akt-konstatimin nr. 8, datë 05.04.2019*).

3.1. Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të marrë masa për hartimin në afat të pasqyrave financiare. Gjithashtu në pasqyrat financiare të përshkruhet qartë baza mbi të cilën janë përgatitur, duke referuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për klasifikimin dhe raportimin e pasqyrave financiare. Përgjegjësia për raportim në çdo kohë të jetë e dokumentuar jo nëpërmjet shkresës përcjellëse të dërgimit të pasqyrave, por evidentohet në përgjegjësi të plotë në kapakun e pasqyrave financiare, se kush janë hartuesit dhe drejtuesit.

Menjëherë

Zbatimi nga subjekti:

Në auditimin e mëparshëm, kjo masë është konstatuar e pa zbatuar.

Nga verifikimi në auditimin aktual rezultoi se pasqyrat financiare të vitit 2019 kanë përfunduar së hartuari në datën 14.04.2020, ndërsa për vitin 2020 në datën 10.05.2021 jashtë afateve ligjore (të cilat janë brenda 31 mars të vitit pasardhës buxhetor). Nuk është përshkruar baza ligjore mbi të cilën janë hartuar pasqyrat financiare. Hartuesit e pasqyrave financiare janë evidentuar në faqen e parë të tyre.

Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi, duke theksuar se elementët thelbësorë të tij janë të pa zbatuar (afati dhe baza ligjore).

4. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e bilancit, konstatohet se totali i faturave të pa likuiduara në fund të vitit 2017 në Llog (401-408) òFurnitor e llogari të lidhura me toò, dhe detyrime të tjera në llog. (467) òKreditorë të ndryshëmò, paraqitet në vlerën 84,336,307 lekë

(lista bashkëlidhur materialit, pasqyra Aneks B/1 &2), ose 24% e vlerës së buxhetit të vitit 2017.

Në testet e kryera ne dokumentet bankës (periudha Janar-Dhjetor 2018), në **38 raste** me vlerë **72,423,619 lekë**, u konstatua se pagesat e faturave të prera nga sipërmarrësit në vitin 2017 e përpara, nuk janë të kontabilizuar në llog (401-408) *ōFurnitor e llogari të lidhura me toō dhe llog. (467) ōKreditorē të ndryshēmō*(sipas pasqyrës Aneks B/3, bashkëlidhur materialit) Gjithashtu dhe për aktivitetin e vitit 2018, ku gjendja e faturave të pa likuiduara në llog. (401-408) *ōFurnitor e llogari të lidhura me toō dhe llog. (467) ōKreditorē të ndryshēmō* paraqitet në vlerën **51,849,487 lekë** (sipas pasqyrës Aneks B/3, bashkëlidhur materialit), ose 14% e vlerës së buxhetit të vitit 2018.

Nga testet e kryera në dokumentet e bankës (periudha Janar - Mars 2019), në **16 raste** me vlerë **31,279,137 lekë**, pagesat e faturave të prera nga sipërmarrësit në vitin 2018 e përpara, nuk janë të kontabilizuar në llog. (401-408) *ōFurnitor e llogari të lidhura me toō dhe llog (467) ōKreditorē të ndryshēmō* (lista sipas pasqyrës Aneks A.3.3/2, bashkëlidhur materialit). Mangësitë e mësipërme (mos regjistrim i faturave kreditore), në fund të periudhës ushtrimore si detyrime që Bashkia Tropojë ka ndaj subjekteve të ndryshme, vjen si rezultat i mungesës së fondeve nga FZHR, ministritë e linjë dhe nga mos realizimi i të ardhurave të planifikuara nga taksat e tarifave vendore. Gjithashtu të dhënat e mësipërme nuk pasqyrojnë situatën reale të faturave të palikujduara në fund të periudhave ushtrimore (*Trajtuar në pikën A, faqe 53-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe akt-konstatimin nr. 8, datë 5.4.2019*).

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, në mbledhjet e Këshillit Bashkiak për miratimin e buxheteve vjetore, të paraqes një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite dhe të hartojë grafik për shlyerjen e detyrime në vlerën **51,849,487 lekë**, duke ndjekur radhën e pagesave. Nuk duhet të fillojnë procedura të reja pa mundësuar lidhjen e kontratave të vjetra.

Menjëherë

Zbatimi nga subjekti

Në auditimin e mëparshëm, kjo masë është konstatuar në proces zbatimi. pasi është konstatuar se:

Me vendimin nr. 60 datë 30.12.2019, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Kukës me shkresën nr. 2/4 datë 14.01.2020 është miratuar PBA e vitit buxhetor 2020-2022. Sipas tabelës nr. 2 detyrimet e prapambetura janë në vlerën totale 99,759,404 lekë, kjo e krijuar përpara datës 31.12.2019. Nga Bashkia janë parashikuar që likuidimi i detyrimeve për vitin 2020 do të jetë në vlerën 37,738,452 lekë, për vitin 2021 në vlerën 22,535,139 lekë, për vitin 2022 janë parashikuar në vlerën 29.288.458 lekë dhe nuk është programuar vlere prej 10.197.355 lekë. KLSH, në përputhje me planin e hartuar për shlyerjes se detyrimeve të prapambetura, i ka rikërkuar Kryetarit të Bashkisë Tropojë që të mos fillojnë procedura të reja prokurimi pa mundësuar shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Nga verifikimi në auditimin aktual të vitit 2021, rezultoi se: Në pikën nr.4 të VKB nr.60, datë 30.12.2019, për buxhetit të vitit 2020, nga këshilli bashkiak, është marrë vendim: Të bëjë shtyrjen e miratimit të grafikut të detyrimeve të prapambetura, sipas tabelës nr.2 për periudhën 2015-2019, të paraqitura në këshillin bashkiak, ku miratimi i tyre do të bëhet sapo të krijohen burime financiare nga rishikimi i planit të të ardhurave, ose rishikimi i transfertës së pakushtëzuar, sipas propozimit të kryetarit të bashkisë. Nga auditimi u konstatua se buxheti i miratuar me VKB nr.60, datë 30.12.2019, ka diferenca me të dhënat e relacionit dhe projekt vendimit të përgatitur nga Drejtoria Ekonomike për këshillin bashkiak, por të pa miratuara nga Kryetari i Bashkisë z. R. B.. Pra likuidimi i detyrimet e prapambetura të vitit 2019 gjatë vitit 2020 nuk ka gjetur miratim konkret të Kryetarit të Bashkisë si dhe të këshillit bashkiak Tropojë. Edhe në hartimin e buxhetit të vitit 2020 është i njëjti fenomen, në hartimin e buxhetit nuk janë planifikuar fonde për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Si përfundim rekomandimi 4.1 është i pa zbatuar, pasi si për vitin 2019 edhe për vitin 2020 janë marrë angazhime të reja buxhetore pa planifikur buxhet për detyrimet e prapambetura.

4.2. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike të bashkëpunojë me sektorin e zbatimit të kontratave, me qëllim kontabilizimin në kohë të faturave të lëshuara nga të tretët sipas kërkesave të VKM nr. 783, datë 22.11.2006 për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabëlë.

Zbatimi nga subjekti: Nga auditimi u konstatua se ky fenomen është eliminuar.
Rekomandimi konsiderohet i zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: *Për vitin 2017 buxheti është realizuar në masën 89% ose nga 391,239 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 349,484 mijë lekë, ndërsa për vitin 2018 është realizuar në masën 98% ose nga 373,987 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 366,892 mijë lekë.*

Në zërin investime, buxheti për vitin 2017 është realizuar në masën 79% ose nga 157,416 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 124,842 mijë lekë, nga të cilat financim me të ardhurat e veta në vlerën 48,945 mijë lekë ose 39%. Ndërsa për vitin 2018 është realizuar në masën 96% ose nga 110,547 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 106,206 mijë lekë, nga të cilat financim me të ardhurat e veta në vlerën 29,119 mijë lekë ose 27%.

Të ardhurat e veta, për vitin 2017 është realizuar në masën 84.6% ose nga 55,000 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 46,541 mijë lekë, dhe për vitin 2018 është realizuar në masën 70.7% ose nga 71,101 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 50,269 mijë lekë.

Veprime dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtime me Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 për sistemin e taksave vendore të ndryshuar, ligji nr. 68-2017, për Financat e Vetëqeverisjes Vendore, ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për vetëqeverisjen vendore, UMF nr. 10, datë 28.02.2017, për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020, si dhe UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendorë; Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016, për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak (Trajtuar në pikën B, faqe 50-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe akt-konstatimin nr. 10, datë 5.4.2019).

5.1. Rekomandimi: Ne mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Tropojë të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Menjëherë

Zbatimi nga subjekti

Në auditimin e mëparshëm, kjo masë është konstatuar në proces zbatimi.

Nga verifikimi në auditimin aktual në vitin 2021, rezultoi se:

Për vitin 2019, planifikimi i buxhetit për zërin e shpenzimeve, duke përfshirë edhe ndihmën ekonomike dhe PAK, ka vlerën 727603976 lekë, ndërsa realizimi në vlerën 709891068 lekë, ose nëmasën 98%.

Për vitin 2020, planifikimi i buxhetit për zërin e shpenzimeve, duke përfshirë edhe ndihmën ekonomike dhe PAK, ka vlerën 734,239,239 lekë, ndërsa realizimi në vlerën 672,527,570 lekë, ose nëmasën 92%.

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2019 është në vlerën 147,7 milion lekë, ndërsa realizimi në vlerën 51 milion lekë, ose në masën 35%, ndërsa për vitin 2020 planifikimi dhe realizimi kanë respektivisht vlerën 55 milion lekë dhe realizimi në vlerën 47 milion lekë, ose në masën 85%.

Në planifikimin e buxhetit të vitit 2019 janë rritur në mënyrë artificiale të ardhurat që mund të realizohen nga vetë Bashkia Tropojë, duke sjellë edhe marrjen e angazhimeve buxhetore pa mundësi reale financimi. Kjo ka bërë që të mos shlyhen të gjitha angazhimet buxhetore të marra gjatë vitit 2019.

Gjithashtu edhe gjatë vitit 2020 planifikimi i buxhetit për shpenzimet nuk ka qenë real, pasi janë lënë pa u planifikuar detyrimet e prapambetura. Evidentohet fakti se planifikimi i buxhetit për vitin 2020 në vlerat e tij të përgjithshme, është mbështetur në realizimin e të ardhurave në vitin e mëparshëm.

Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi

6. Gjetje nga auditimi: Në analizën e pasqyrave financiare të vitit 2017, u konstatuan këto mangësi, si më poshtë vijon:

-Llog. 202-*Studime e projekte*”, paraqitet në vlerën 2,871,000 lekë, me një rritje nga vitit paraardhës për vlerën 1,246,000 lekë. Kontabilizimi i këtyre vlerave në llog. 202-*Studime e projekte*” është i gabuar, pasi vlera e këtyre projekteve duhej të paraqitej në zërat e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara (sipas objekteve), e cila përfaqëson vlerën e projekteve, investimet e të cilave kanë përfunduar dhe duhet të kapitalizohet në vlerën e objektit;

-Llog. 230-*Shpenzime në proces për AQ, të patrupëzuara*”, paraqitet në vlerën 150,000 lekë, dhe përfaqëson një projekt të ish- Komunës Llugaj, pa emërtesë. Regjistrimi në këtë llogari nuk është i saktë, pasi duhej paraqitur në llog. 202-*Studime e projekte*;

-Llog. 212-*Ndërtime e Konstrukione*”, sipas analizës paraqitet në vlerën 1,182,883,629 lekë, vlerë e cila nuk përputhet me shifrën e paraqitur në pasqyrën financiare për shumën 690,000 lekë (kjo më e madhe në pasqyrën financiare);

-Llog. 468-*Debitorë të ndryshëm*, paraqitet në vlerën **10,986,966 lekë**. Referuar analizës që subjekti i ka bërë kësaj llogarie, konstatohet se janë përfshirë detyrimet ndër vite që persona të ndryshëm kanë ndaj Bashkisë Tropojë, ku vlerën më të lartë e zënë detyrimet për grabitje të vlerave monetare gjatë vitit 1997 dhe grabitje të zyrave dhe shkollës së mesme Llugaj, për vlerën totale prej 4,836,666 lekë. Pjesa tjetër janë detyrimet që persona të ndryshëm kanë ndaj bashkisë nga auditimet e kryera nga Auditimi i Prefekturës dhe auditimet e KLSH.

Në këtë llogari nuk janë të përfshira detyrimet debitorë që subjektet fizik/juridik kanë ndaj Bashkisë Tropojë, ku sipas të dhënave të Drejtorisë së Taksave e Tarifave Vendore për vitin 2017 paraqiten në shumën **8,602,542 lekë** dhe për vitin 2018 në shumën **10,557,990 lekë**, pavarësisht fakti se nga Drejtoria e Taksave Vendore me shkresa përcjellëse lista me detyrimet e biznesit i janë përcjellë Drejtorisë Ekonomike (*për vitin 2017 shkresa datë 15.02.2018 dhe për vitin 2018 shkresa datë 07.01.2019*).

-Për periudhën raportuese 2017; Kryetari i Bashkisë ka ngritur komisionin e inventarizimit me urdhër nr. 142, datë 20.11.2017 (shkresa nr. 3971 prot, datë 20.11.2017) *oPër ngritjen e komisionit të inventarizimit për vitin 2017 Bashkia Tropojë dhe Njësitë Administrative në juridiksionin e saj.* Referuar të dhënave të inventarëve në fund të vitit 2017 (depozituar nga Sektori i Financës pranë grupit të auditimit), si dhe pasqyrave financiare të vitit 2017, u konstatua se për llog. 218-*Inventar ekonomik*, llog. 32-*Objekte në inventar*, gjendja kontabël nuk përputhet me gjendjen fizike, konkretisht:

-Llog. 218-*Inventar ekonomik*, sipas pasqyrave financiare paraqitet në vlerën 100,786,113 lekë, me një rritje nga viti paraardhës 2016 për shumën 16,834,635 lekë. Ndërsa sipas të dhënave (pasqyrës) të inventarëve në fund të periudhës, vlera e llog. 218-*Inventar ekonomik*, paraqitet në shumën 156,668,425 lekë, pra me një diferencë prej 55,882,312 lekë. Duke marrë në konsideratë dhe vlerën e materialeve të dala jashtë përdorimit për këtë llogari në vlerën 27,410,883 lekë, rezulton se diferenca midis fizikut dhe kontabël për llog. 218-

Inventar ekonomik, paraqitet në vlerën 28,471,429 lekë (156,668,425 lekë sipas inventarit – 27,410,883 lekë materiale dalë jashtë përdorimit - 100,786,113 lekë shifra sipas bilancit).

-Llog. 32-Objekte inventari, sipas fletë inventarëve paraqitet në vlerën 11,097,336 lekë, nga e cila materiale të dala jashtë përdorimit në vlerën 7,351,580 lekë, ndërsa sipas të dhënave të pasqyrave financiare 2017 (aktivi), në llog. 32-Objekte inventari (AQT), paraqitet vlera prej 24,527,060 lekë ose më shumë se inventarët fizik për vlerën 20,781,304 lekë (24,527,060 ó 3,745,756).

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e nenit 3, pika 1, nenin 7, 9 dhe 10, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 *ËPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare* me ndryshime; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 *ËPër përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabëlë, Kap. II; rubrikën 3- ËProcedurat e rakordimit dhe te mbylljes se llogarive* të UMF nr. 14, datë 28.12.2006 *ËPër përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësisive që varen prej tyre, si dhe të njësisive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huajë i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 Ë Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, neni 2, neni 4, pika 9 Ë përgjegjshmëria menaxheriale, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 Ë Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, ndryshuar me udhëzimin nr. 20, datë 17.11.2014, pika 36, pika 52, pikat 73, 81, 82, 83, 85, germa (c), 86 dhe 95 (Më hollësisht trajtuar në pikën A.2. faqe 29-40, të Projekt raportit të Auditimit, si dhe akt-konstatimin nr. 8, datë 5.4.2019).*

6.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike, të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202-*ËStudime e projekte*”, në mënyrë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve të proces dhe të pazbatuara, duke e transferuar në debi të llogarive të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara për objektet e përfunduara, vlerën 2,871,000 lekë, që i përket vlerës së projekteve të vënë në zbatim dhe të përfunduara.

Zbatimi nga subjekti: *Nga analizimi i llogarisë 202 -Studime e projekte për vitin 2019 u konstatua se tre projekte në vlerën 1,380,206 lekë, investimet e të cilave kanë përfunduar vazhdojnë të jene ende në llogarinë 202.*

Edhe për vitin 2020 kjo llogari është ende e pa sistemuar plotësisht.

Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.

6.2. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike, të marrë masa që vlera prej 150,000 lekë e paraqitur në llog. 230-*ËShpenzime në proces për AQ, të patrupëzuara*”, që përfaqëson projektet e mbetura të ish- Komunës Llugaj, të evidentojnë llojin e projektit, vitin e hartimit të tij dhe nëse këto projekte janë vënë në zbatim ose jo, dhe regjistrimi në llogarinë përkatëse sipas gjendjes së saj.

Zbatimi nga subjekti: Sipas raportimit të bërë nga drejtori ekonomik z. B. T., vlera e projektit 150,000 lekë i përket investimit ende të pa kryer në ish Komunës Llugaj, por nuk u paraqitën të dhëna për llojin e projektit, vitin e hartimit të tij, emërtimin e investimit me të cilin lidhet projekti. Pra nëse do të kryhet investimi për të cilin ky projekt është hartuar, Bashkia Tropojë nuk e administron praktikisht këtë projekt, përveçse është i regjistruar në kontabilitet.

Rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar.

6.3. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike, të analizojë diferencën e konstatuar në llog. 212-*ËNdërtime e Konstruksione*ë, midis shifrës së paraqitur në aktiv të pasqyrës financiare (1,183,573,629 lekë) dhe vlerës sipas analizës analitike të kësaj llogarie (1,182,883,629 lekë), për të saktësuar diferencën prej 690,000 lekë, dhe bërë veprimet kontabël për sistemimin e vlerës në pasqyrat financiare të vitit 2018, të pambyllura akoma.

Zbatimi nga subjekti: *Drejtorja Ekonomike nuk ka analizuar diferencën e konstatuar në llog. 212-“Ndërtime e Konstruksione”, midis shifrës së paraqitur në aktiv të pasqyrës financiare*

(1,183,573,629 lekë) dhe vlerës sipas analizës analitike të kësaj llogarie (1,182,883,629 lekë), për të saktësuar diferencën prej 690,000 lekë,

Rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar.

6.4. Rekomandimi: Drejtoria e Ekonomike në bashkëpunim me Sektorin e Taksave Vendore, Bashkia Tropojë, të marrë masat për kontabilizimi dhe arkëtimin e detyrimeve të pa shlyera të taksave e tarifave vendore në fund të periudhës të vitit 2018 në vlerën **10,557,990 lekë**, si debitorë në llog 468- *Debitorë të ndryshëm*.

Zbatimi nga subjekti: Nga auditimi u konstatua se sektori i taksave dhe tarifave vendore ka përcjellë në protokoll dhe financë, listën e debitorëve progresiv në fundin e vitit 2019 dhe 2020 dhe nga financa është bërë kontabilizimi i tyre. **Rekomandimi konsiderohet i zbatuar.**

6.5. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë (në cilësinë e Nëpunësin Autorizues), në bashkëpunim me Drejtorin Ekonomik (në cilësinë e Nëpunësit Zbatues) dhe me komisionet inventarizues, të analizojë inventarët e paraqitur në fund të vitit 2017 për llog. 218-*Inventar ekonomik*, llog. 32-*Objekte në inventar*, për saktësimin e diferencës midis fizikut dhe kontabël në shumën 49,252,733 lekë, nga e cila llog. 218 në vlerën 28,471,429 lekë dhe llog. 32 në vlerën 20,781,304 lekë.

Zbatimi nga subjekti: Nga Drejtoria Ekonomike nuk u paraqit dokumentacion dhe argumente të tjera të natyrë së sistemimit kontabël të situatës së mësipërme. **Rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar.**

6.6. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorin Ekonomik, për rastet e ekzistencës së mospërputhjes midis fizikut dhe kontabël, të llog. 32-*Objekte në inventar* me vlerë 20,781,304 lekë, të bëhen sistemimet dhe rregullimet përkatëse në kontabilitet dhe pasqyrat financiare, të nxjerrjen si debitorë të gjithë personat përgjegjës, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **20,781,304 lekë**, në rast te ekzistencës së diferencës.

Zbatimi nga subjekti: Nga Drejtoria Ekonomike nuk u paraqit dokumentacion dhe argumente të tjera të natyrë së sistemimit kontabël të situatës së mësipërme. **Rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar.**

7. Gjetje nga auditimi: Në auditimi e veprimeve me arkën, u konstatua se për periudhën janar-dhjetor 2017 janë prerë gjithsej 4268 mandat arkëtime (ma) për vlerën 14,335,001 lekë, dhe 291 mandat pagesa (MP) për vlerën 13,556,361 lekë.

Gjendja e arkës në fund të vitit 2017 paraqitet në vlerën 1,116,162 lekë, e cila përputhet me pasqyrat e bilancit llog. 531 –veprime me arkë.

Ndërsa për periudhën janar-dhjetor 2018, janë prerë gjithsej 3078 mandat arkëtime (MA) për vlerën 11,411,959 lekë, dhe 71 mandat pagesa (MP) për vlerën 12,408,630 lekë. Gjendja e arkës në fund të vitit 2018, paraqitet në vlerën **120,000 lekë**.

Arkëtime me arkë janë kryesisht detyrimet e taksave e tarifave vendore nga bizneset dhe abonentët familjar, vërtetime të ndryshme, pagesat e kopsht/ çerdhe, nga NJA (detyrimet taksash dhe vërtetim), nga zjarrfikësit, etj. Ndërsa në lidhje me pagesat janë kryer kryesisht pagesat e ndihmës së emergjencës, të shpërblimeve të lindjes, blerje në vlera të vogla, dhe bonus strehimi (kjo vetëm për vitin 2017).

Sipas të dhënave të mësipërme, konstatohet se nga Bashkia Tropojë janë kryer veprimeve me arkën (kryesisht për arkëtimet), mbi limitin e lejuar ligjorë, në kundërshtim me pikat 63 dhe 64, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve të njësisë së sektorit publikò, të ndryshuar dhe VKM nr. 290, datë 14.6.1993 òPër limitin e arkës në ndërmarrjet shtetërore. (Trajtuar në pikën A, faqe 40-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe akt-konstatimin nr. 8, datë 5.4.2019).

7.1. Rekomandimi: Drejtori Ekonomik në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, të marrë masa për eliminimin e veprime të kryera me arkë mbi limitin e lejuar ligjorë dhe të bëjë kanalizimin e

veprimeve nëpërmjet bankës në lidhje me pagesat që realizohen gjatë një viti ushtrimorë, për të eliminuar përdorimin CASH të veprimeve financiare.

Zbatimi nga subjekti: Nga auditimi i llogarisë 531 - Mjete monetare në arkë, u konstatua se vijon të jetë e njëjta situatë, janë kryer pagesa mbi limitin e arkës.

Rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar.

8. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të prokurimit me vlera të larta, konstatohet se nga AK (Bashkia Tropojë), për asnjë rast nuk është bërë i mundur që urdhër prokurimet të konfirmohen në Degën e Thesarit Tropojë, për të siguruar garancinë e fondeve, dhe mos krijimin e vlerave të papaguara në fund të përfundimit të kontratës së punimeve/shërbimeve.

Për vitin 2017, nga vlera e kontratave të lidhura prej 190,265,905 lekë, janë likuiduar gjatë vitit ushtrimorë vlera prej 124,532,370 lekë/ ose 70.1 % e totalit, dhe mbetet për likuidim vlera e kontratave të mbyllura por të palikujduara prej 67,715,836 lekë, *ndërsa për vitin 2018*, nga vlera e kontratave të lidhura prej 178,335,471 lekë, janë likuiduar gjatë vitit ushtrimorë vlera prej 122,062,983 lekë/ ose 68.4 % e totalit, dhe mbetet për likuidim vlera **56,223,411 lekë**.

Arsyeja e mos likuidimit të vlera të kontratave të lidhura dhe të përfunduara, vjen si rezultat i mos çeljes së fondeve nga Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë, FZHR, Ministrisë Arsimit dhe Sportit dhe nga mos realizimi i të ardhurave nga taksat e tarifave vendore.

Në kryqëzimin e të dhënave (testet e kryera), për faturat e palikujduara në fund të periudhës (paraqitur nga Drejtoria e Financës), që Bashkia Tropojë ka ndajë të tretëve (*llog. 401-408 dhe 467*), me listën e detyrimeve të kontratave të lidhura dhe të mbyllura për periudhën 2017 - 2018, konstatohet se *për vitin 2017* për 6 kontrata me vlerë 67,715,836 lekë, dhe *për vitin 2018* për 7 kontratat me vlerë 56,233,411 lekë, nuk paraqiten në listën e faturave të palikujduara në fund të periudhave ushtrimore 2017 -2018, veprim i cili tregon se gjendja e faturave të palikujduara në fund të periudhave 2017 -2018 nuk është e saktë, dhe se pasqyrat financiare nuk paraqesin vërtetësi në hartimin e tyre, veprimet në kundërshtim me nenin 52-*Kryerja e shpenzimeve*, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 *oPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar; nenin 9 dhe 10, të ligjit nr. 9928, datë 29.04.2004 *oPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*, i ndryshuar; UMF nr. 5, datë 27.12.2014 *oPër shlyerjen e detyrimeve të prapambetura* i ndryshuar me UMF nr. 5/1, datë 21.05.2014; Udhëzimin udhëzimi plotësues i MF nr. 02, datë 10.01.2018 *oPër buxhetin e vitit 2018*, pikat 82-91 *o Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 *oPër përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabëlë, pjesa e parë, oRregulla të përgjithshme* kapitulli i parë *oMbajtja e kontabilitetit*; UMF nr. 26, datë 27.12.2007, *oPër përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huajë*, dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018, *oPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme* (*Trajtuar në pikën C, faqe 69-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe akt-konstatimet nr. 2 & 3, datë 5.4.2019*).

8.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike, të analizojë llog. 401-408-*oFurnitorë e llogari të lidhura me to*” të vitit 2018, dhe të evidentojë të gjitha faturat e palikujduara në fund të periudhës ushtrimore për kontratat e lidhura dhe përfunduara, të bëjë kontabilizimin dhe paraqitjen në pasqyrat financiare të vitit 2018 (akoma të pambyllura), dhe pagesën e faturave në vlerën totale **56,223,411 lekë**, duke respektuar radhën e pagesës sipas vitit të krijimit e faturave.

Nuk duhet të planifikohet investime të reja, pa likuiduar kontratat e vjetra.

Zbatimi nga subjekti:

Nga verifikimi i grupit të mëparshëm ka rezultuar se: Ky rekomandim konsiderohet i pa zbatuar pasi me vendimin nr. 60 datë 30.12.2019, i konfirmuar nga Prefekti me shkresën nr. 2/4 datë 14.01.2020 është miratuar PBA e vitit buxhetor 2020-2022. Sipas tabelës nr. 2 “Grafiku i detyrimeve”, detyrimet për vitin 2018 janë në vlerën 80,051,054 lekë dhe në vitin 2019 detyrimet janë shtuar në vlerën 19.708.350 lekë vlerë e cila nuk është kontabilizuar në pasqyrat financiare të vitit 2018, referuar llog 401-408-“Furnitorë e llogari të lidhura me to”.

Pra një pjesë e rekomandimit është ezauruar nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve. Pjesa tjetër e rekomandimit që ka të bëjë me mos planifikohet investime të reja, pa likuiduar kontratat e vjetra, konstatohet e pa zbatuar, sepse nga verifikimi në auditimin e kryer në vitin 2021, u konstatua se hartimin e buxhetin e vitit 2019 dhe 2020 nuk janë planifikuar fonde për detyrimet e prapambetura.

Zbatimi nga subjekti: Rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar

9. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Bashkia Tropojë lidhur me pasuritë e transferuara, konstatohet se nuk janë kryer veprime për marrjen në dorëzim dhe pasqyrimin në inventar dhe kontabilitet, nuk është ngritur grup i posaçëm pune për vlerësimin e gjendjes aktuale të pronës, nuk kanë filluar procedurat për përgatitjen e dokumentacionit ligjor për verifikimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme publike dhe marrjen në dorëzim të aseteve për të realizuar regjistrimin e pronave pranë ZVRPP Tropojë.

Nga Drejtoria Ekonomike për pronat e regjistruar në kontabilitet në llogaritë 210-“Toka, troje, terrene” në vlerën 22,460,270 lekë, llog 211- “Pyje, kullota plantacione”, në vlerën 10,727,302 lekë, llog 212- “Ndërtime e konstrukion” në shumën 1,183,573,629 lekë dhe llog 213- “Rrugë, rrjetë dhe vepra ujore” në vlerën 2,508,638,370 lekë, nuk janë të regjistruara në ZVRPP Tropojë. Për pronat të cilat rezultojnë të zëna forcërisht nuk është çelur dosje e veçantë dhe nuk janë marrë masat e nevojshme për lirim të saj nga zaptuesit dhe përdoruesit e paligjshëm.

Nga Bashkia Tropojë dhe kryesisht Drejtoria Ekonomike, nuk i është kërkuar Kryetarit të Bashkisë ngritjen e komisionit për vlerësimin e pasurive me çmimin e tregut të si: truall, tokë bujqësore, ndërtesa, pyje, kullota etj., me qëllim vënien në efikasitet të tyre dhe sigurimin e të ardhurave të cilat kanë një vlerë të konsiderueshme për buxhetin e Bashkisë, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare; pikave 9, 10, 11 dhe 22 të VKM nr. 500, datë 14.8.2001 për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore, dhe kreun III- *Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre* të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik (Trajtuar në pikën A, faqe 63-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe akt-konstatimin nr. 8, datë 5.4.2019).

9.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë të ngrejë grup pune me specialist të fushës, për evidentimin e të gjitha pronave të kaluar me VKM në pronësi të Bashkisë Tropojë, duke bërë evidentimin mbi gjendjen e tyre, dhe përfundimin e procedurave ligjore për regjistrimin në ZVRPP dhe kontabilitet, dhe për pronat që janë të regjistruara në kontabilitet, të merren masa për regjistrimin e tyre në ZVRPP.

Zbatimi nga subjekti: Nga titullari i bashkisë nuk janë marrë masa për ngritjen e grupit të punës me qëllim evidentimin e të gjitha pronave të kaluar me VKM në pronësi të Bashkisë Tropojë.

Rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar.

9.2. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Sektorin e Aseteve në Bashkisë Tropojë, të marrë masat dhe të kryej të gjitha procedurat për mbajtjen e regjistrimit kontabël të të gjithë aktiveve që zotëron apo ka në administrim, si dhe regjistri i veçantë për

secilën nga pasuritë e dhëna me qira ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit, kontrata e qirasë, afati i vlefshmërisë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore, arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik.

Zbatimi nga subjekti: Rregjistrii asetëve është jo i plotë. Në këtë rregjistër kontabël nuk janë të rregjistruara të gjithë aktivet që zotëron apo ka në administrim Bashkia Tropojë. Gjithashtu nuk është hartuar rregjistër i veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qira ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit, kontrata e qirasë, afati i vlefshmërisë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore, arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik.

Rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar

10. Gjetje nga auditimi: Akt-rakordimet e mbajtura nga Sektori i të Ardhurave në Bashkinë Tropojë, nuk janë në përputhje me modelet e përcaktuara në UMF nr. 26, datë 04.09.2008, *ËPër Taksat Kombëtare*, i ndryshuar dhe nuk janë protokolluar në përputhje me kërkesat e nenit 13 të Normave Arkivore në R.Sh.

Për periudhën 2017 ó 2018 paguajnë rentë minerale gjithsej 11 subjekte, ku për vitin 2017 nga 850 mijë lekë të planifikuara është likuiduar vlera 201 mijë lekë dhe për vitin 2018 nga 850 mijë lekë të planifikuara është paguar vlera prej 70 mijë lekë.

Nga ana e Bashkisë Tropojë, nuk është krijuar baza e domosdoshme e të dhënave me qëllim verifikimin dhe rakordimit e saktë të pagesave të Rentës Minerare, si dhe nuk janë zbatuar penalitetet për këtë qëllim deri në 50% të vlerës së pa arkëtuar, veprime në kundërshtim me Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 *ËPër sistemin e taksave vendore* të ndryshuar; pika 2 shkronja (a) e nenit 25 të ligji nr. 68-2017, *ËPër Financat e Vetëqeverisjes Vendore*; ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *ËPër vetëqeverisjen vendore*; neni 117 të ligjit nr. 9920 *ËPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar, UMF nr. 26, datë 04.09.2008, *ËPër Taksat Kombëtare*, i ndryshuar; kërkesat e nenit 13 të Normave Arkivore në R.Sh dhe UMF Nr. 12, Dt. 4.4.2017, *ËPër Taksat Kombëtare (Trajtuar në pikën B, faqe 57-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe akt-konstatimin nr. 9, datë 5.4.2019)*.

10.1. Rekomandimi: Sektori i Taksave Vendore në Bashkinë Tropojë, të marrë masa për të krijuar bazën e të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat e të cilave mbledhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, si dhe të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimit të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave.

Zbatimii rekomandimit nga subjekti: Nga verifikimi në auditimin e mëparshëm kjo masë ka rezultuar në proces zbatimi si vijon: Ky rekomandim do të konsiderohet në proces pasi nga sektori i taksave dhe tarifave vendore janë marrë masat e nevojshme për kryqëzimin e informacionit me agjentët tatimor si dhe me institucionet e tjera përkatëse respektivisht, Me shkresën nr. 4270 prot., datë 07.11.2018, janë kërkuar të dhëna analitike për pasurinë sipas zotëruesve në teritorin e Bashkisë Tropojë. Me shkresën nr. 2101, prot., datë 09.05.2018, është kërkuar informacion OSHE në lidhje me abonentët që kanë lidhur kontratë me OSHE-s në teritorin e Bashkisë Tropojë (qytet + njësitë administrative).

Nga auditimi aktual në vitin 2021, u konstatua se janë kryer akte rakordimi për tatimin e thjshuar mbi fitimin për biznesin e vogël, midis Bashkisë Tropojë dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Kukës. Janë hartuar akte rakordimi midis Bashkisë Tropojë dhe Degës e Shfrytëzimit të Automjeteve. Janë rregjistruar nga sektori i taksave dhe tarifave vendore kalimet e kryera nepermes deges thesarit për transfertat e rentës minerare për vitin 2019 dhe 2020, por nuk janë hartuar akte rakordimi midis Bashkisë dhe Drejtorisë së Doganave dhe DRT Kukës. Nga ana tjetër nga Bashkia Tropojë për rentën minerare ka korrespondencë si vijon:

- Shkresa nr. 3469 prot., datë 19.08.2020, drejtuar Degës Doganore Kukës nga Bashkia Tropojë, për kërkesë të dhënash për rentën minerare dhe rakordim midis tyre. Shkresa nr.

1237/1, datë 28.08.2020 e Degës Doganore Kukës me lëndë “Kthim përgjigje”, në të cilën kthehet përgjigje Bashkisë Tropojë, se “Nga Dega Doganore Kukës është dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë informacion mujor, sipas formularit nr.9, mbi rentën e arkëtuar në llogarinë e pagesave online të DPD, për llogari të Degës Doganës Kukës. Nga MFE janë autorizuar degët e thesarit dhe DPD për shpërndarjen e pjesës përkatëse të rentës minerare për llogari të NJVV”.

- Shkresa nr.3471, datë 19.08.2020, e Bashkisë Tropojë, me lëndë “Kërkesë për të dhëna për rentën minerare”, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Nga kjo e fundit është kthyer përgjigje për rentën e paguar nga subjektet e listuara në shkresën e vetë Bashkisë Tropojë.

Trajtime të hollësishme pasqyrohen në aktin e konstatimit për taksat dhe tarifatat vendore.

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi vetëm për kryerjen e aktit të rakordimit sipas formularit nr.9 për entën minerare, pasi pjesa tjetër e rekomandimit konsiderohet e zbatuar.

11. Gjetje nga auditimi: Agjencia e Pyjeve dhe Kullotave Bashkia Tropojë, për subjektet të cilat nga MIE kanë marrë leje shfrytëzimi të sipërfaqeve Pyjore/ kullosore nuk ka zbatuar kërkesat ligjore, për lidhjen e kontratave për shfrytëzim të fondit pyjor nga 20 subjekte me sipërfaqe 389.72 ha, nga e cila 6.4 ha rrugë (lista në pasqyrën aneks B/10, bashkëlidhur materialit), për realizimin e të ardhurave për buxhetin e Bashkisë, veprim në papajtueshmëri me kërkesave të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 òPër pyjet dhe shërbimin pyjorë, të ndryshuar, të pikës 6 neni 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 òPër Fondin Kullosorë, etj., nuk ka njoftuar subjektet për t'u paraqitur për lidhjen e kontratave për të ushtruar këtë aktivitet dhe likuidimin e detyrimeve që lindin nga zbatimi i VKM nr. 391, datë 21.6.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 (Trajtuar në pikën B, faqe 65-68, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Bashkia Tropojë nëpërmjet Agjencisë së Pyjeve dhe Kullotave, të bëjë evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private duke i hequr nga fondi pyjorë dhe kullosorë, t'ia kërkojë Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimin e veprimtarisë së kompanive minerare deri në lidhjen e kontratave të shfrytëzimit, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura.

Zbatimi rekomandimit nga subjekti: Nga verifikimi në auditimin e mëparshëm ka rezultuar se ky rekomandim është në proces zbatimi, si vijon:

Nga Agjencisë së Pyjeve dhe Kullotave pas hartimit të databasi-t me të dhënat për subjektet, detyrimet, sipërfaqet, etj. Struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat ka dërguar për verifikim në terren të subjekteve minerare dhe gjatë muajit dhjetor 2019 kanë mbajtur proces-verbalet e konstatimit për subjektet minerare.

Subjektet që ushtrojnë aktivitete minerare gjatë kontrollit në terren janë:

1. M. I. Sh.P.K (ish L.), ka kontratë, është njoftuar për detyrimin .
2. A.-K shpk (ish F. shpk) nuk ka kontratë , është njoftuar për detyrimin.
3. A. M. sh.p.k (ish B. shpk) nuk ka kontratë , është njoftuar për detyrimin
4. A.-L. shpk, ka kontratë, ka likuiduar detyrimin
5. Fabrika e Pasurimit Kromit Bulqize shpk nuk ka likuiduar detyrimet, nuk ka kontratë por nuk ka ardhur ne listen e AKBN.
6. E.-A shpk nuk ka kontratë, është njoftuar për detyrimin.
7. A. Sh.p.k ka kontratë, ka likuiduar detyrimin

Subjektet që nuk ushtrojnë aktivitete minerare gjate kontrollit në terren por janë në listën e AKBN-së :

8. B. Sh.p.k Nuk ka kontratë.
9. B.- A. shpk (ish A. shpk) Ka kontratë dhe ka detyrime

10. M. shpk (ish E. shpk) Ka kontratë dhe marrëveshje.
11. B. shpk Nuk ka kontratë dhe ka detyrime
12. L. G. nuk ka kontrate.
13. B. Shpk Nuk ka kontratë dhe ka detyrime
14. A. M. sh.p.k (ish B. shpk)
15. A. G. ka kontratë, ka likuiduar detyrimin ka pezulluar aktivitetin dhe na ka njoftuar me shkresën nr.10508/3Prot.datë.06.09.2018
16. B.-A. shpk
17. S. A. sh.p.k ka kontratë
18. S. A. sh.p.k nuk ka kontrate
19. N..P.-Ing shpk nuk ka kontrate
20. V. M. A. Ka kontrate.
21. E. C.& E. M. I. Sh.p.k Nuk ka kontratë dhe ka detyrime
22. M. F. N. Shpk Nuk ka kontratë dhe ka detyrime
23. ATA-E. E. shpk Ka kontrate
24. G. G. Nuk ka kontratë dhe ka detyrime
25. B. shpk (Llugaj)
26. M. shpk Ka kontrate
27. A. F. Nuk ka kontratë dhe ka detyrime
28. B.& N., Sh.p.k Nuk ka kontratë dhe ka detyrime

Nga Agjencisë së Pyjeve dhe Kullotave na u sqarua fakti se pas njoftimeve të bëra janë arritur që me 11 subjekte të lidhen kontrata/marrëveshje në bashkëpunim me zyrën juridike dhe për pjesën tjetër po punojmë bazuar në legjislacionin e pyjeve dhe kullotave për arritje të lidhjes së kontratave për çdo sipërfaqe të territorit të bashkisë që përdoret nga subjekte për aktivitete të ndryshme të miratuara dhe aktive sipas AKBN.

Nga auditimi aktual në vitin 2021, u konstatua se: Me shkresën nr.2673, datë 7.7.2020, me lëndë “ Informacion dhe kërkesë për marrje masash”, Bashkia Tropojë i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, AKBN, për marrje informacioni dhe mendimi lidhur me subjektet që zhvillojnë aktivitetet minerar në Bashkinë Tropojë. Gjithashtu i është kërkuar organeve të mësipërme që të bëjë mbylljen e veprimtarisë së subjekteve të cilat nuk kanë lidhur kontratë për aktivitetin e tyre në njësinë vendore.

Në përgjigjen e kthyer nga MIE, me shkresën nr.518/1, datë 5.10.2020, thuhet se në nenin 46 të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, janë të përcaktuara shkeljet për të cilat pezullohet një leje minerare. Ligji minerar nuk parashikon pezullimin e aktivitetit minerar në rastet kur shoqëritë, nuk kanë nënshkruar kontratë me bashkinë në të cilin zhvillojnë aktivitetin.

MTM me shkresën nr.4947/1 , datë 4.8.2020, ka kthyer përgjigje bashkisë Tropojë ku thuhet: Mbështetur në pikën 1 të nenit 16, të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020 “ Për pyjet”, strukturat vendore përgjegjëse për pyjet kanë kompeyenca të kontrollojnë inspektojnë apo të pezullojnë leje për aktivitete që ushtrohen mbi fondin pyjor. Sa më sipër është kompetencë e bashkisë tuaj për të zgjidhur problemin që shtroni.

Zbatimi i rekomandimit konsiderohet në proces zbatimi

12.Gjetje nga auditimi: Në auditimin e 28 rasteve të procedurave me vlerë të vogël me vlerë 5,288,320 lekë, është konstatuar se procedura e ndjekur nuk është në përputhje me dispozitat e LPP, pasi kemi copëzim të fondeve, duke shmangur nga procedura me vlerë të lartë.

Në urdhër prokurimet nuk janë përcaktuar arsyet e përdorimit të procedurës së prokurimit, ndërsa në sistemin SIT është shënuar e “zgjedhur kjo lloje procedure për shkak të fondit limit”. Në këtë rast nuk del e qartë arsye e saktë e përdorimit të kësaj procedure prokurimi siç përcaktohet në kreun V ÷Zhvillimi i procedurës pika 1 shkronja (ç).

Gjithashtu, në të gjitha procedurat e prokurimit me vlere nën 100,000 lekë mungon vendimi i kryetarit i përcaktuar sipas (Formularit 5) për blerjet emergjente, me qëllim të shmangtes kalimi i fondit limit, veprime në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 për miratimin e rregullave të prokurimit publikë Kreu i VI pikës 2/a; me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publikë neni 40 dhe me Udhëzimi e APP nr. 03, datë 27.01.2015 për procedurën e prokurimit me vlera të vogla pika 8 (*Trajtuar gjerësisht në pikën A, faqe 47-49, e Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe akt-konstatimin nr. 11, datë 05.04.2019*).

12.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë me specialist të fushës, me miratimin e buxhetit vjetor në fillimit të vitit, të përcaktojë saktë nevojat e bashkisë për mallra/ shërbime, dhe të eliminojë praktikën për copëzim të fondeve me natyrë të njëjtë, për të devijuar nga procedurat e prokurimit.

Zbatimi rekomandimit nga subjekti: Nga verifikimi në auditimin e mëparshëm ka rezultuar se ky rekomandim është në proces zbatimi, si vijon: Bashkia Tropojë sqaron se ka marrë masa për plotësimin e nevojave për mallra dhe shërbime duke eliminuar praktikën e copëzimit të fondeve duke miratuar PBA e vitit buxhetor 2020-2022 të miratuar nga prefekti me shkresën nr. 2/4 datë 14.01.2020.

Nga auditimi aktual në vitin 2021, i cili ka të bëjë me zbatimin konkret të procedurave të planifikuara, nuk u konstatuan raste të copëzimit të fondeve të blerjeve të vogla, trajtuar më gjerësisht në aktin e konstatimit për prokurimet publike.

Rekomandimi konsiderohet i zbatuar

13.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës nr. 11, datë 25.8.2017 me objekt “*Shtesë ujësjellësi Valbonë për qytetin Bajram Curri*”, Bashkia Tropojë, me vlerë të kontratës 67,494,569 lekë, fituar nga BOE òN.ò & òS.ò SHPK, rezulton se është situacionuar kapitulli 4 òRrethimi i kaptazhitò, me nënkaptujt òRrethimiò me vlerë 384,533 lekë dhe òPortaò me vlerë 70,590 lekë, ose 455,123 lekë gjithsej.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje (fotot), rezulton që këto punime janë kryer nga kontraktori, por nga verifikimi i objektit në terren, këto punime nuk ekzistojnë. Nga fotot e paraqitura në fazën e Projektraportit të auditimit rezulton se rrethimi është ribërë, por jo sipas projekt preventivitet fillestar dhe nuk është paraqitur akt i marrjes në dorëzim nga UK Tropojë (*Trajtuar në pikën C/1, faqe 92-93, të Raportit të Auditimit, si dhe akt-konstatimin nr. 6, datë 5.4.2019*).

13.1. Rekomandimi: Bashkia Tropojë, në bashkëpunim me Ujësjellës Kanalizime sha Tropojë, si institucion varësie, të nxjerrë përgjegjësitë për prishjen e rrethimit të kaptazhit të ujësjellësit dhe të marrë masa për rindërtimin e rrethimit sipas projektit fillestar, si objekt i një rëndësie të veçantë për jetën e qytetarëve të Tropojë.

Nga verifikimi në auditimin e mëparshëm ka rezultuar se: Nga Ujësjellës-Kanalizime sha Tropojë nuk është marrë në dorëzim objekti i mësipërm dhe nga informacioni i paraqitur nga administratori, rezulton se nuk ka rrethim të objektit.

Nga auditimi aktual në vitin 2021 nuk u paraqit dokumentacion për zbatimin e rekomandimit të mësipërm gjatë fazës në subjekt.

Pretendimi i subjektit:

Pas lënies së aktit të verifikimit janë bërë kundërshti nga subjekti

Nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni nga z. R. B., znj. Z. I., z. K. R.j, z. H. I., me shkresë nr. 935/35, datë 16.06.2021 (të dhëna të subjektit), protokolluar në KLSH me nr.361/10, datë 18.6.2021, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Së bashku me observacionin është paraqitur urdhri i Kryetarit të Bashkisë z. R. B., nr.116, datë 9.6.2021, për riparimin urgjent të rrethimit të dëmtuar të kaptazhet e ujësjellësoit të qytetit në Valbonë”. Në këtë urdhër është urdhëruar Ujësjellës Kanalizime sha, të marrë masa

urgjente për rindërtimin e rrethimit të kaptazheve. Me shkresën nr. 935/22, datë 09.06.2021, grupi i punës i përbërë nga z. K. R., me detyrë N/Kryetar i Bashkisë, znj. Z. I. me detyrë N/Kryetare e Bashkisë dhe z. H. I. me detyrë Drejtor i PZHT. Kanë informuar Kryetarin e Bashkisë se : Grupi i punës verifikoi gjendjen në vend me datën 03.06.2021 dhe konstatoi se Rrethimi i Kaptazhit të objektit: Shtesë Ujësjiellësi Valbonë për qytetin Bajram Currië, Bashkia Tropojë, i rindërtuar mbas porosive të lëna nga ana e KLSH-së, dërguar me shkresën nr.1082/48 Prot., datë 05.06.2020, është hequr përsëri dhe simbas pretendimeve të rojës së objektit, pretendues i pronës në të cilën është ndërtuar kaptazhi, rezulton se rrethimi është hequr nga ai, mbasi është dëmtuar nga reshjet dhe akulli që ka rënë gjatë dimrit të shkuar, nisur nga kjo dhe arsyeja që ata vetë e kanë si pronë të rrethuar, dhe për objektin nuk përbën asnjë rrezik, e hoqën rrethimin e dëmtuar, mbasi ishte jo estetik, për sezonin turistik.

Ne si grup pune i lamë detyrë që në mënyrën më urgjente të bëhet rrethimi, në gjendjen që ka qenë, dhe nisur nga ana estetike, le të punohet edhe me dru apo gjëra dekorative, por kaptazhi të jetë e rrethuar, në të kundërt mbahet përgjegjësi penale.

Në vazhdimësi për ndjekjen e këtij problemi iu la porosi me shkrim sh.a. të Ujësjiellës Kanalizimeve, që të marrin masat dhe të shohin në vazhdimësi, zgjidhjen e këtij problemi, në mënyrë që të mos cënohet në asnjë moment siguria e objektit. Gjithashtu duhet theksuar se ashtu siç vërehet edhe në fotografi, kaptazhet janë të siguruara, me mure guri, soleta beton arme, dhe dyer hekuri, pa asnjë mundësi hyrje në to të personave të paautorizuar.

Bashkëlidhur urdhëri për sh.a. Ujësjiellës Kanazimet Tropojë, për të riparuar dëmtimet.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Përsa përshkruhet nga ana juaj kjo masë është në proces zbatimi. Kërkojmë ndjekjen në vijimësi të këtij problemi deri në zbatim përfundimtar dhe ngritjen e grupit të punës për të verifikuar përfundimin e realizimit sipas urdhrat të ngritur nga titullari.

14.Gjetje nga auditimi: Me shkresën nr. 495/26, datë 06.10.2017 (prot subjekti nr. 2915/4 prot, datë 11.10.2017), nga KLSH-^{ja} janë dërguar Rekomandimet për përmirësimin e gjendjes sipas Vendimit nr. 136, datë 30.9.2016 të Kryetarit të KLSH. Për masat e marra Bashkia Tropojë ka njoftuar KLSH-në me shkresën nr. 2915/5, prot, datë 06.11.2017 *brenda 20 ditëve nga dërgimi i rekomandimeve.*

Në auditimin i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve, konstatohet se:

-*Nga 13 masa, organizative të cilat janë pranuar plotësisht, janë zbatuar 6 masa, është në proces zbatimi 1 masë dhe nuk janë zbatuar 6 masa organizative;*

-*Nga 23 masa, shpërblim dëmi me vlerë 24,862,009 lekë të cilat janë pranuar plotësisht, është në zbatuar 1 masa në vlerën 2,400,000 lekë, në proces 2 masa në vlerën 195,594 lekë, nga e cila arkëtuar vlera 41,676 lekë dhe mbetet për arkëtim vlera 153,918 lekë dhe nuk janë zbatuar 20 masa për vlerën 22,266,415 lekë.*

-*Në lidhje me masat disiplinore nga 22 masa janë zbatuar plotësisht 22 masa;*

-*Nga 7 masa administrative, janë në proces 7 masa nga APP për vlerën 1,000,000 lekë, për penalitetet e vendosura nga APP mbi shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve (Më hollësisht trajtuar në pikën F/1. faqe 104-106, të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe akt-verifikimin nr. 1, datë 28.3.2019).*

Nga verifikimi në auditimin e mëparshëm ka rezultuar se rekomandimi është në proces zbatimi, si vijon: Nga gjashtë masa organizative të lëna nga auditimi i mëparshëm dërguar në Bashkinë Tropojë me shkresën nr. 495/26 prot, datë 06.10.2017, është zbatuar vetëm 1 masa organizative, janë në proces 2 masa administrative respektivisht masa nr. 6 dhe masa nr.13. Nuk janë zbatuar 3 masa organizative respektivisht masa nr. 1, masa nr. 5 dhe masa nr.10.

Nga bashkia Tropojë nuk janë kryer ndalesat për 20 masa shpërblim dëmi në vlerën 22,266,415 lekë.

Nga 7 masa Administrative me gjobë të vendosura nga APP në vlerën 1,000,000 lekë janë zbatuar plotësisht 3 masa në vlerën 500,000 lekë dhe janë në proces zbatimi 4 masa në vlerën 500,000 lekë nga të cilat janë arkëtuar 234,376 lekë dhe ka mbetur pa u arkëtuar vlera prej 265,624 lekë.

Nga auditimi aktual në vitin 2021 nuk u paraqit dokumentacion i ri, duke lënë të pa ndryshuar situatën e mësipërme.

Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi

Zbatim i masave për shpërblim dëmi ekonomik.

Me shkresën nr. 1475/7 prot., datë 27.07.2019 është dërguar raporti përfundimtar i auditimit dhe rekomandimet. Në këtë raport janë dhënë 6 masa për shpërblim dëmi në vlerën **11,473,160 lekë**. Zbatimi i rekomandimeve për këto masa është audituar në bazë të programit të auditimit nr.1082 prot., datë 28.12.2019, në të cilin është konstatuar e zbatuara një masë në vlerën **1,240,388 lekë**. Në shkresën nr. 1082/48 prot., datë 05.06.2020, KLSH ka dërguar në Bashkisë Tropojë raportin përfundimtar të auditimit, në të cilin ka rikërkuar zbatimin e 5 masave të pa zbatuara në vlerën **10,232,772 lekë**. Nga auditimi aktual u konstatua se Bashkia Tropojë nuk ka marrë masa për arkëtimin e vlerës **10,232,772 lekë**, duke lënë të pa ndryshuar situatën e konstatuar nga auditimi i mëparshëm tematik, i cili ka pasur si objekt zbatimin e rekomandimeve.

Në vijim situata e 5 masave për shpërblim dëmi në vlerën **10,232,772 lekë**, të rikërkua për zbatim me shkresën nr. 1082/48 prot., datë 05.06.2020 të KLSH:

Nga verifikimi rezultoi se nga vlera e rekomanduara nga KLSH është **11,473,160 lekë**.

Është arkëtuar vlera **1,240,388 lekë**.

Pa arkëtuar vlera **10,232,772 lekë**.

Nga të cilat:

-Janë nisur njoftimet për 5 rekomandime por ende skanë filluar arkëtimet e vlerës **10,232,772 lekë**

-Nuk janë zbatuar 5 rekomandime në vlerën **10,232,772lekë**

Në mënyrë tabelore rekomandimet për shpërblim dëmi, arkëtimet dhe natyra e rasteve të mos realizimit paraqiten në aneksin nr.5, bashkangjitur raportit të auditimit.

Në mënyrë të detajuar realizimi rekomandimeve për shpërblim dëmi paraqitet si më poshtë:

1.Gjetje nga auditimi: Nga analiza e detajuar te llog. 215- *Mjetë transporti*, dhe shpjegimeve të subjektit në fazën e Projektraportit të Auditimit paraqitur më shkresën nr. 787/40, datë 31.05.2019, konstatohen diferenca midis fizikut dhe kontabëlilit për vlerën **1,766,333 lekë**, më e madhe në pasqyrat financiare.

Sipas dokumentacionit, por dhe shpjegimeve të subjekti (shkresa nr. 787/30, datë 12.04.2019), kjo diferencë vjen si rezultat i mungesës së 1 (një) mjete të pa dorëzuar nga ish-Kryetari i Komunës Lekbibaj z. D. M. për mjetin tip òTOYOTAö për vlerën 1,034,400 lekë (ish- Kryetar Komune periudha 2000-2003)

Në lidhje me diferencën prej 731,933 lekë, bashkia nuk ka informacion se çfarë përfaqësojnë dhe nga vjen, veprime financiare me efekt negativ me dëm në buxhetin e Bashkisë Tropojë për vlerën **1,766,333 lekë**.

Konstatohet se si nga ish- Komuna Lekbibaj por dhe sot Bashkia Tropojë, nuk është ndjekur asnjë procedurë ligjore për vënien para përgjegjësisë së personave përgjegjës për kthimin e mjeteve ose arkëtimin e kundër vleftës së tyre në buxhet, veprime në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.6.2015 òPër miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi

administrativo-territorialë; Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 ÷Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare të ndryshuar, Kreu II, neni 7, pika 2, neni 9, neni 10; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 ÷Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabëlë, pjesa e parë, ÷Rregulla të përgjithshme kapitulli i parë ÷Mbajtja e kontabilitetit. (Trajtuar në pikën A, faqe 31-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe akt-konstatimi nr. 13, datë 5.4.2019).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe Sektorin Juridik, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **1,034,400 lekë**, të mjetit tip ÷TOYTA ÷ të pakthyer në Bashkinë Tropojë nga ish- Kryetari i Komunës Lekbibaj z. D. M. si person përgjegjës.

1.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa për ngritjen e një komisioni me specialist të fushës, për kryerjen e inventarit të mjeteve në përdorim të Bashkisë Tropojë, për evidentimin e mjeteve të cilat nuk janë gjendje në fund të periudhës ushtrimore 2017 në vlerën **731,993 lekë**, duke evidentuar përgjegjësitet material, nxjerrjen debitorë dhe arkëtimin e vlerës prej **731,993 lekë**.

Bashkia Tropojë nëpërmjet Sektorit Juridik, në çdo rast të mos kthimit të mallit ose të kundër vleftës të njoftojë organet përkatëse për veprime të mëtejshme procedurale.

Zbatimi nga subjekti: Nga auditimi i kryer në vitin 2020, për zbatimin të rekomandimeve, është konstatuar në proces zbatimi si vijon: Drejtoria e Financës me shkresën nr. 1423 prot datë 25.04.2019 ka bërë njoftimin e ish/Kryetarit të Komunës Lekbibaj z.D. M. për arkëtimin e vlerës prej 731,993 lekë, të mjetit tip “TOYTA”, të pa dorëzuar.

Nga auditimi aktual në vitin 2021 nuk u paraqit dokumentacioni i ri, duke lënë të pa ndryshuar situatën e mësipërme. Në procesin e inventarizimit vjetor të vitit 2019 dhe 2020, vazhdon të ketë diferencë midis gjendjes kontabël dhe gjendjes fizike.

Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi

2. Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2017, nga Bashkia Tropojë janë kryer pagesa për ÷Bonus strehimi ÷ në vlerën 3,756,198 lekë, në mbështetje të ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004 ÷Për programet sociale ÷; VKM nr. 1093, datë 28.12.2015 ÷Për miratimin e procedurave, kriterëve dhe përparësive për dhënien e burnusit të strehimit, i ndryshuar; Udhëzimit nr. 3, datë 30.12.2008 ÷Për përmbajtjen e bonusit të strehimit. Sipas dokumentacioni të paraqitur, rezultojnë se kanë përfituar bonus strehimi 130 familje, miratuar me VKB nr. 29, datë 31.01.2017 dhe konfirmuar nga Prefekti Qarkut Kukës me shkresën nr. 2/9, datë 14.02.2017. Në verifikimin e të dhënave në lidhje me llogaritjen dhe derdhjen e tatimit në burim (sipas kontratave), konstatohet se nga Bashkia Tropojë nuk është llogaritur dhe mbajtur tatim në burim në vlerën **563,429 lekë (3,756,198 lekë x 15%)**, veprime në kundërshtim me nenin 33, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.2019 ÷Për tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar (Trajtuar në pikën A, faqe 39-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe akt-konstatimi nr. 8, datë 5.4.2019).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **563,429 lekë**, ndaj të gjithë personave që kanë lidhur kontratë me Bashkinë Tropojë për strehimin e banorëve që kanë përfituar bonos strehimi në vitin 2017 (sipas kontratave që disponon Zv/Kryetarja e Bashkisë Tropojë), ndaj të cilëve nuk është mbajtur dhe derdhur në buxhet tatimin në burim.

Zbatimi nga subjekti: rekomandimi rezultojnë i pa zbatuar, pasi nuk ka as procedurë të filluar për këtë problem, as vlera financiare të arkëtuara.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës nr. 2863/6 prot datë 21.09.2018 me objekt “Rikonstruksion shkolla “Asim Vokshi”, Bashkia Tropojë, me vlerë të kontratës 74,353,036 lekë, fituar nga shoqëria ÷4. M. ÷ SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 521,050 lekë pa TVSh.

Nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit në zërat e punimeve òFV hekur betoni periodik D 6-10 mmò, òFV hekur betoni periodik D >12 mmò, òPragje dritare mermer granitiò, òSuva solete h ó 4 m, me drejtues me krahëò, òSuva brenda mur tulle h ó 4 m, me krahëò, òVeshje me pllaka majolikeò, òDyer të blinduara importiò, òBojë hidroplastike importi cilësi e Iò, òParapet shkalle e ballkone me lartësi 0.9 mò, lidhur me volumet e punës të situacionuar si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga AK, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **521,050 lekë pa TVSh**, veprime në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2863/6prot, datë 21.09.2018 të lidhur mes AK òBashkia Tropojëò dhe shoqërisë ò4. M.ò (*Trajtuar në pikën C/1, faqe 94-99, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe akt-konstatimi nr. 5, datë 5.4.2019*).

3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Tropojë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **521,050 lekë** nga OE ò4. M.ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2863/6 prot datë 21.09.2018, me objekt òRikonstruksion shkolla òAsim Vokshiò, Bashkia Tropojë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Zbatimi nga subjekti: *Nga auditimi i kryer në vitin 2020 nga KLSH rekomandimi është konstatuar në proces zbatimi si vijon: Bashkia Tropojë me shkresën nr.1509 prot., datë 06.04.2020 “Njoftim për përmbushjen e detyrimeve sipas rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ka njoftuar Shoqërinë OE “4. M.” për përmbushjen e detyrimeve, shlyerjen e dëmit ekonomik në vlerën totale prej 521,050 lekë.*

Nga auditimi aktual në vitin 2021 nuk u paraqit dokumentacion i ri, duke lënë të pa ndryshuar situatën e mësipërme.

Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës nr. 1742 prot datë 27.04.2017 me objekt “Ujësjellësi i jashtëm i fshatit Tropojë e Vjetër dhe Rrethinat, Faza II”, Bashkia Tropojë, me vlerë të kontratës 8,244,335 lekë, fituar nga shoqëria òSh.ò SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 231,900 lekë.

Zëri 1.2. Gërmim dheu në seksion të lirë me krahë, në tokë të butë, kat. I-II, pa hedhje.

Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 2418 m³. Në situacionin përfundimtar dhe në librin e masave, ky zë pune figuron në sasinë 1546.1 m³ (145 ml gjatësi kanali x 5 m gjerësi x 2.13 m lartësi mesatare). Nga rillogaritja e bërë sipas përmasave të përcaktuara në projekt, rezulton që ky volum është 773 m³ (145 ml gjatësi kanali x 2.5 m gjerësi x 2.13 m lartësi mesatare). Diferenca prej 773 m³ është punë e pakryer, për pasojë vlera **231,900 lekë pa TVSh** është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve, e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, veprime me në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1742prot, datë 27.04.2017 të lidhur mes AK òBashkia Tropojëò dhe shoqërisë òSh.ò. (*Trajtuar në pikën C/1, faqe 99-101, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe akt-konstatimin nr. 6, datë 5.4.2019*).

4.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Tropojë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **231,900 lekë** nga OE òSh.ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2863/6 prot datë 21.09.2018, me objekt òUjësjellësi i jashtëm i fshatit Tropojë e Vjetër dhe Rrethinat, Faza IIò, Bashkia Tropojë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Zbatimi nga subjekti: *Nga auditimi i kryer në vitin 2020 nga KLSH rekomandimi është konstatuar në proces zbatimi si vijon: me shkresën nr.1555 datë 10.04.2020 “Njoftim për përmbushjen e detyrimeve sipas rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ka njoftuar OE òSh.ò ShPK, se në rast se nuk përmbushet detyrimi në mënyrë vullnetare nga ana e subjektit, sektori juridik do të inicioj procedurat gjyqësore sipas legjislacionit përkatës.*

Nga auditimi aktual në vitin 2021 nuk u paraqit dokumentacion i ri, duke lënë të pa ndryshuar situatën e mësipërme.

Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.

5.Gjetje nga auditimi: Në auditimin e taksave e tarifave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se nga zyra përkatëse nuk është krijuar një regjistër i posaçëm për mbajtjen e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti. Nga krahasimi me faqen online të QKB-së, u konstatua një diferencë në numrin e subjekteve që kanë objekt aktiviteti tregtinë e hidrokarbureve dhe derivateve të tyre, si karburant ose si lëndë djegëse.

Nga auditimi i lejeve përkatëse të tregtimit dhe pagesave të tyre, u konstatua se si nga ish-komunat dhe ish-bashkitë, por edhe pas konsolidimit, vazhdimisht është aplikuar në mënyrë të gabuar tarifa për pajisjen me leje tregtimi për karburantet, duke evidentuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Tropojë në vlerën **7,150,000 lekë**, veprime në kundërshtim me ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 òPër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyreò dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij; ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 òPër Procedurat Tatimoreò; VKM nr. 170, datë 25.04.2002 i ndryshuar me nr. 344, datë 19.4.2017 dhe nr. 970, dt. 02.12.2015 òPër Liçencat e tregtimit të Hidrokarbureveò; UMF nr. 26, datë 04.09.2008 dhe nr. 12, datë 4.4.2017, òPër Taksat Kombëtareò(*Trajtuar në pikën B, faqe 45-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe akt-konstatimi nr. 9, datë 5.4.2019*).

5.1. Rekomandimi: Bashkia Tropojë të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **7,150,000 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit ndaj debitorëve, respektivisht:

- vlera **1,000,000 lekë** për subjekti òA.òA.ò
- vlera **1,100,000 lekë** për subjektin òD. O.ò;
- vlera **1,000,000 lekë** për subjektin òG. C. G.ò;
- vlera **1,050,000 lekë** për subjektin òP.ò;
- vlera **1,000,000 lekë** për subjektin òS.ò;
- vlera **1,000,000 lekë** për subjektin òS.ò;
- vlera **1,000,000 lekë** për subjektin òSh.ò.

Gjithashtu, të verifikojë nëse subjektet e tjera të cilat në QKB figurojnë aktivë dhe me objekt aktiviteti tregtinë e karburanteve apo lëndëve djegëse për popullatën, e zhvillojnë këtë lloj aktiviteti, të liçencohen duke paguar taksat ose të pezullohen sipas rastit.

5.2. Rekomandimi: Bashkia Tropojë të marrë masa për të krijuar një regjistër të posaçëm për këtë kategori biznesesh, por edhe regjistra të posaçëm për bizneset e tjera me natyrë specifike (si p.sh. subjekte që paguajnë rentën minerare, që përdorin pasuritë publike për grumbullimin e bimëve medicinale, peshkimin, etj.).

Zbatimi nga subjekti: *Nga auditimi i kryer në vitin 2020 nga KLSH për zbatimin e rekomandimeve, rekomandimi është konstatuar në proces zbatimi si vijon:me shkresat përkatëse në vijim, janë bere njoftime për pagese detyrimi për 7 subjekteve në vlerën 7,150,000 leke, por ende deri më datën 28.02.2020 kur po kryhet verifikim nuk ka filluar arkëtimi:*

Nr	Subjekti	Nr.Shkrese	Data e shkreses
1	A.òA. shpk	3177	31.10.2019
2	D.-O. shpk	3181	31.10.2019
3	G. C. G. shpk	3179	31.10.2019
4	P. shpk	3180	31.10.2019

5	S. shpk	3176	31.10.2019
6	S. shpk	3176	31.10.2019
7	Sh. shpk	3178	31.10.2019

-Nga sektori i tatim taksave janë krijuar regjistra të veçantë; - subjekteve të karburantit, subjekte me aktivitet hoteleri turizëm, subjektet minerare, duke i përditësuar të dhënat përkatëse në vazhdim.

Nga auditimi aktual në vitin 2021 nuk u paraqit dokumentacion i ri, duke lënë të pa ndryshuar situatën e mësipërme.

Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.

B/II. Masa për uljen e borxhit tatimor duke ritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara).

1.Gjetje nga auditimi: Detyrimet për taksat e tarifatat vendore në fund të vitit 2018 paraqiten në vlerën **12,997,009 lekë** (e ardhur e munguar), e cila përbëhet:

-Detyrimi nga taksat e tarifatat vendore në vlerën prej **10,557,990lekë;**

-Nga detyrimet në vlerën 633,479 lekë, përfaqëson vlerën e kamatëvonesave të përlllogaritura nga Bashkia Tropojë, në masën 0.06% (10,557,990 x 0.06%);

-Vlerën prej 1,805,540 lekë, mos arkëtimet e taksës së ndikimit në infrastrukturë (ndërtimet pa leje);

Në total, rezulton një vlerë prej **12,997,009 lekë** të ardhurash të munguara në buxhetin e Bashkisë Tropojë.

Këto vlera kanë ardhur si rezultat i mos arkëtimin të detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore. Në subjektet debitorë, bëjnë pjesë edhe subjekte të mbyllura ose me status pasiv në DPT, të cilët nuk kanë bërë likuidimin e detyrimeve, veprime në kundërshtim me Ligji nr. 33-2017, òPër shuarjen e detyrimeve tatimore; ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, òPër Sistemin e Taksave Vendore, i ndryshuar; ligji nr. 68-2017 òPër Financat e Vetëqeverisjes Vendore; nenin 70 pika 3 òE drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; UMF nr. 26, datë 04.09.2008; UMF nr. 12, datë 4.4.2017, òPër Taksat Kombëtare dhe ligji nr. 33/2017 òPër pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore, etj. *(Trajtuar në pikën B, faqe 55-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe akt-konstatimin nr. 9, datë 5.4.2019).*

1.1. Rekomandimi: Sektori i Taksave Vendore Bashkia Tropojë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimore për debitorët dhe të ndiqen rrugët arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën **12,997,009 lekë**, si më poshtë vijon:

a-Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore RSHö.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat Tatimore në RSHö.

c- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të aplikohet llogaritja e gjobës në masën 0.06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo dit gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më shumë se 365 ditë (gjobë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat tatimore në RSHö, të ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 15.12.2014.

d- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 të Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

e- Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me 8 Njësitë Administrative, respektivisht: Bajram Curri, Tropojë e Vjetër, Margegaj, Llugaj, Lekbibaj, Fierzë, Bytyc dhe Bujani, të evidentojë listat emërore të debitorëve në mënyrë elektronike dhe të printuar dhe në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 01, datë 17.01.2019 për zbatimin e buxhetit të vitit 2019, pika 98, të njoftojë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/ tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit.

1.2.Rekomandimi: Sektori i Taksave Vendore Bashkia Tropojë, të verifikojë detyrimet, kamatëvonesat dhe gjobat për subjektet debitorë për periudhën përpara vitit 2017, nëse këto detyrime janë prekur nga ligji nr. 33/2017 për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore.

Zbatimi nga subjekti: Nga auditimi i kryer nga KLSH në vitin 2020, për zbatimin e rekomandimeve, kjo masë është konstatuar në proces zbatimi si vijon: Detyrimet nga taksat e tarifave vendore në vlerën prej 10,557,990 lekë gjendje me 31.12.2018, nga sektori i taksave dhe tarifave vendore janë kryer njoftimet për subjektet debitorë që ushtrojnë aktivitetin e tyre tregtar. Rezulton se për vitin 2019 janë arkëtuar 1,012,824 lekë në 20 raste si detyrime të mbartura, duke mbetur pa u arkëtuar vlera prej 9,590,036 lekë. Për vlerën prej 1,805,540 lekë, në 51 raste mos arkëtimet e taksës së ndikimit në infrastrukturë (ndërtimet pa leje), nga ana e sektorit të tatim taksave janë dërguar shkresat përkatëse njoftim dhe kërkesë për pagim detyrimi, nga ku rezulton se për vitin 2019 janë detyrimet e prapambetura në 19 raste në vlerën 646,503 leke. Të dhënat të detajuara jepen në aneksin nr.5/1, bashkangjitur raportit të auditimit.

Nga auditimi aktual në vitin 2021, sipas informacionit të dhënë nga sektori i taksave dhe tarifave vendore, u konstatua se gjendja e debitorve në datën 31.12.2018 e cila ka qenë 10,557,990 lekë, në datën 31.12.2020 ka vlerën 9,087,280 lekë, pra janë arkëtuar 1,470,710 lekë.

Në mënyrë analitike duke përfshirë edhe vitin 2018 pasqyra e gjendjes së debitorëve në periudhat 31.12.2018, 31.12.2019, 31.12.2020 dhe arkëtimet në vitet 2019, 2020, paraqiten në tabelën sa më poshtë vijon:

(Në lekë)

Përshkrimi i debitorëve:	Gjendja e debitorëve 31.12.18	Arkëtuar viti 2019	Gjendja e debitorëve 31.12.19	Arkëtuar 2020	Gjendja e debitorëve 31.12.20	
					Nr.	Vlerë
Taksa/tarifa vendore të 2012-2018	10,557,990	957,395	9,600,595	513,315	141	9,087,280
Taksa/tarifa vendore 2019	-	-	4,479,111	1,552,742	90	2,926,369
Taksa/tarifa vendore 2020	-	-	-	-	124	4,408,304
Instit. për taksa/tarifa 2019	-	-	483,960	249,480	2	234,480
Instit. për taksa/tarifa shtuar 2020	-	-	-	-	3	650,680
taksë infrastrukturë 2018	1,805,540	592,496	1,213,044	437,917	22	775,127
Totali :	12,363,530	1,549,891	15,776,710	2,753,454	382	18,082,240

Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.

2.Gjetje nga auditimi: Në paketat fiskale të miratuara me VKB-të për të dy vitet në auditim, Bashkia Tropojë e ka deleguar përgjegjësinë e vjeljes të taksës së tokës në Njësitë

Administrative. Nga sektori i të ardhurave në bashkëpunim me sektorin e administrimit të tokës, nuk është grumbulluar dokumentacioni për tokën bujqësore, për ndryshimet e sipërfaqes gjatë viteve dhe arkëtimin e detyrimeve të papaguara për taksën e tokës.

Nga të dhënat konstatohet se për taksën e tokës për vitet 2017 dhe 2018, ka një shumë të evidentuar prej **10,231,000 lekë**, e cila nuk është kontabilizuar dhe arkëtuar, ndërsa për taksën e ndërtesës ka një shumë të evidentuar prej **20,419,118 lekë**, gjithashtu e pa kontabilizuar dhe arkëtuar, veprim në kundërshtim me përcaktimet në VKM-në nr. 510, datë 10.06.2015, òPër miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorialò; Udhëzimit të Përbashkët të Ministrit për Çështjet Vendore dhe Ministrit të Financave nr. 3237, datë 16.7.2015 òPër procedurat, afatet kohore, standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm, për riorganizimin administrativo-territorialò; ligji Nr. 9920, dt. 19.5.2008, òPër Procedurat Tatimoreò me ndryshime; ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 òPër Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiareò dhe me UMF nr. 8, Dt. 09.03.2018 òPër Paraqitjen e Pasqyrave Financiare në NJQPò(*Trajtuar në pikën B, faqe 59-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe akt-konstatimin nr. 9, datë 5.4.2019*).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Sektorin e Taksave Vendore, të verifikojë gjendjen në kontabilitet dhe mënyrën e kontabilizimit të detyrimit në ngarkim të familjeve debitorë për taksën e tokës dhe të arkëtoj vlerën prej **21,782,000 lekë**, nga e cila në vitin 2017 në vlerën 10,231,000 lekë dhe në vitin 2018 në vlerën 11,551,000 lekë, si dhe taksë ndërtesë në vlerën **20,419,118 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit nga personat përkatës.

2.2. Rekomandimi: Sektori i Taksave Vendore, në bashkëpunim me 8 Njësitë Administrative (*Bajram Curri, Tropojë e Vjetër, Margegaj, Llugaj, Lekbibaj, Fierzë, Bytyç dhe Bujan*), të evidentojnë listat emërore të debitorëve në mënyre elektronike dhe të printuar dhe në zbatim të pikës 71, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 òPër zbatimin e buxhetit të vitit 2017ò, të njoftojnë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës dhe ndërtesës.

Zbatimi nga subjekti: Nga auditimi i kryer nga KLSH në vitin 2020, për zbatimin e rekomandimeve, kjo masë është konstatuar e pa zbatuar, si vijon: *Parashikimi i taksa/tarifa për familjarët është bërë si diferencë e planifikimit në buxhet të kësaj takse nga Bashkia për vitet 2017-2018, krahasuar me realizimin në fakt (takse toke , takse ndërtesë për familjarët), sipas pasqyrës së mëposhtme:*

Nr	Lloji i taksës	Viti	Plan	Fakt	Ndryshimi
1	Takse ndërtesë për familjarët	2017	2,256	537	-1,719
	Takse ndërtesë për familjarët	2018	10,256	424	-9,832
	Totali 1		12,512	961	-11,551
2	Takse toke bujqësore	2017	5,318	178	-5,140
	Takse toke bujqësore	2018	5,318	227	-5,091
	Totali 2		10,636	405	-10,231
	Totali 1+2		23,148	1,366	-21,782

Nga të dhënat e vëna në dispozicion rezultoi se planifikimi nuk është real, sepse në vitin 2018, janë bërë shtese plani me VKB për 8,000 mijë lekë. Nga të dhënat e gjendjes civile nuk ka një ndryshim të dukshëm për të argumentuar këtë vendim me shume se viti 2017, kur nr. i familjeve nuk ka të dhënat për ndonjë ndryshim të dukshëm. Deri në datën 20.02.2020 nga ana e bashkisë nuk janë marë të dhëna nga institucionet &entet e tjera.

Gjithashtu theksojmë se akoma nga ana e Bashkisë Tropojë nuk është përcaktuar agjenti i vjeljes taksës familjarëve, ku pritet një definim përfundimtar me vendim Këshilli Bashkiak.

Vjelja e taksës së ndërtesës dhe taksës së tokës bujqësore për familjaret arkëtohet nga njësitë administrative, si edhe me parë.

-Deri më datën 28.02.2020 nuk është lidhur aktmarrëveshje me shoqërinë “Ujësjellësi” sha. Tropojë, për caktimin e këtij të fundit në rolin e agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat ujit të pijshëm (kjo e miratuar në KB).

Nga auditimi aktual në vitin 2021 nuk u paraqit dokumentacion i ri, duke lënë të pa ndryshuar situatën e mësipërme.

Rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar.

B/III. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efizienz dhe efektivitet të fondeve publike.

1. Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave të regjistrimit të realizimit të prokurimeve për periudhën 01.01.2017 ó 31.12.2018, janë kryer gjithsej 39 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit prej 374,043,501 lekë dhe vlerë kontrate të lidhur prej 328,322,045 lekë.

Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës duke marrë në konsideratë faktorët e riskut prej 2% për investimet/shpenzime, ku niveli i precizonit të materialitetit paraqitet në vlerën 7,038 mijë lekë (për vitin 2017) dhe në vlerën 6,966 mijë lekë (për vitin 2018), nga 39 procedura me vlerë kontrate 328,322,045 lekë, auditoi 28 procedura me vlerë 309,785,923 lekë, ose 82.8% e totalit të kontratave.

Në totalin e procedurave të audituara (28) me vlerë kontrate 309,785,923 lekë, rezultojnë se në 9 procedura me vlerë kontrate prej 104,244,657 lekë ose 33.6 % e kontratave të audituara, janë konstatuar parregullsi në shpalljen fitues të OE me mangësi në plotësimin e kriterëve të DST, ku procedurat përputhen formisht me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi për prokurimin publik, pasi KVO nuk është udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, sigurimit të dobishmërisë së përdorimit të fondeve publike, të cilat do të krijojnë mundësinë e shpalljes fitues të OE me ofertë ekonomike më të leverdishme midis operatorëve pjesëmarrës, veprime këto në paligjshmëri të procedurave të prokurimit për vlerën **11,203,468lekë**, veprime në paligjshmëri të procedurave të prokurimit, veprime në paligjshmëri të procedurave të prokurimit, dhe në kundërshtim me kërkesat në nenin 1, *Objekti dhe qëllimi*, pika 2, shkronja (a, b, d, dh), nenin 2 *Parimet e përzgjedhjes*, shkronja (a, b, c), nenin 46 pika 1, nenin 53 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *Për Prokurimin Publik*, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *Për miratimin e rregullave të prokurimit publik me ndryshime* (Trajtuar në pikën C, faqe 68-91, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe akt-konstatimet nr.2 & 3, datë 5.4.2019).

1.1. Rekomandimi: Bashkia Tropojë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publike, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i LPP, sigurimi i dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, për eliminimin nga procedura të operatorëve me ofertë më të leverdishme dhe me mangësi të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës.

Zbatimi nga subjekti: Nga auditimi aktual në vitin 2021 u konstatuan mangësi të së njëjtës natyre, kualifikime të operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST, të cilat gjerësisht janë trajtuar në pikën e prokurimeve publike.

Për këtë arsye rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Bashkia Tropojë nga fondi rezervë janë shpërndarë fonde për familjet të cilëve u janë dëmtuar shtëpitë nga fatkeqësi natyrore, duke i klasifikuar si ndihma të menjëhershme. Për periudhën objekt auditimi (2017 ó 2018), për 214 persona është paguar vlera 8,093,000 lekë, nga e cila në vitin 2017 kanë përfituar 92 persona në vlerën 2,520,000 lekë dhe për vitin 2018 kanë përfituar 122 persona për vlerën 5,573,000 lekë.

Në auditimin e dosjeve të personave që i kanë përfituar nga fondi rezervë për ndihma të menjëhershme, u konstatuan shkelje të shkronjës (f) e pikës 2, të VKM nr. 329, datë 16.05.2012 òPër kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore dhe pika 1 shkronja (c) të Udhëzimit të Ministrisë së Brendshme nr. 1185/1, datë 18.7.2007 òKriteret, rregullat dhe procedurat e përdorimit të fondit të emergjencave civile planifikuar në buxhetin vjetor të Ministrisë së Brendshme, si dhe të donacioneve që jepen si ndihmë në raste të emergjencave civile, konkretisht:

a- Kërkesa e personit të dëmtuar nuk është e protokolluar në Bashkinë Tropojë, dhe evidentuar në regjistër të veçantë për të parë sa është numër i personave që kanë bërë kërkesë dhe sa nga këto nuk kanë përfituar.

b- Personat që kanë përfituar këto fonde nuk janë familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, për të treguar pamundësinë e këtyre familjeve për përballimin e dëmeve.

c- Procesverbalet dhe projektet janë të njëjtit model, pa specifikime të veçantë për objekte të veçanta, ku rastësisht të gjithë personave në të njëjtën datë dhe muaj ju është dëmtuar çatia prej llamarine, dhe se gjatë gjithë periudhave të vitit kalendarik ka persona për përfitojnë nga këto fonde, ku 7 persona kanë përfituar nga 2 deri në 3 herë fonde emergjencash, brenda një muaj të një vitit kalendarit ose dhe për dy vite rresh, pa argumentuar arsyen e kryerjes së këtyre pagesave me vlerë 630,000 lekë

d-Mungesa e fotove që tregon prishjen e këtyre objekteve.

Mangësitë e mësipërme kanë çuar në paligjshmëri të përdorimit të fondit rezervë për vlerën **8,093,000 lekë** (për dy periudhat), duke i orientuar në fusha jo prioritare dhe në shërbim të komunitetit (*Trajtuar në pikën A, faqe 45-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe akt-konstatimi nr. 8, datë 5.4.2019*).

2.1. Rekomandimi: Bashkia Tropojë të analizojë me përgjegjësi rastet e dhënies së fondeve të emergjencës për personat që paraqesin kërkesë për fonde për dëmtimet e ndryshme të shtëpive, dukë evidentuar familjet më në nevojë dhe kryesisht ato me ndihmë ekonomike dhe në pamundësi të riparimit të dëmeve, për të eliminuar përdorimin pa efektivitet të fondeve në vlerën **8,093,000 lekë**.

Zbatimi nga subjekti: Nga auditimi aktual në vitin 2021 u konstatuan mangësi të së njëjtës natyrë gjatë vitit 2019, por ky fenomen ka ardhur në ulje gjatë vitit 2020, trajtuar më gjerësisht në aktin e konstatimit për pasqyrat financiare.

Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi

3.Gjetje nga auditimi: Në auditimin e rasteve të procedurave blerje me vlera të vogla, u konstatua në se **8 praktika me vlerë 2,689,558 lekë**, procedurat nuk janë në përputhje me dispozitat e LPP, pasi në to mungonin disa nga dokumentet shoqërues të cilat duhet të shoqërojnë procedurën, konkretisht:

Mungon preventivi paraprak me zërat e aktivitetit, kuotat dhe çmimet përkatëse të përcaktuara sipas specifikimit teknik (formulari nr. 3), nuk ndodhet kërkesa e studimit të tregut për përcaktimin e vlerës mbi të cilën është bazuar fondi limit, mungon kërkesa e sektorit për domosdoshmërinë e kryerjes së shpenzimeve, nuk ka një dokument për lënien e gjurmës së zhvillimit të aktivitetit si dhe material filmi apo fotografik të tij, dhe pa hedhur në sistemin elektronik. Komisioni i marrjes në dorëzim të mallit është i njëjti me komisionin e vlerësimit ofertave, veprime këto në paligjshmëri të përdorimit të fondeve të prokuruar, veprime në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikë Kreu i VI pikës 2/a; VKM nr. 914 datë 29.12.2014 òPër miratimin rregullave të prokurimit publikë neni 40 me ndryshime; Udhëzimi e APP nr. 03, datë 27.01.2015 òPër procedurën e prokurimit me vlera të vogla pika 8 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aseteve në sektorin publikë, pika 35; 36 (*Trajtuar gjerësisht*

në pikën A faqe 48-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe akt-konstatimin nr. 11, datë 5.4.2019).

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë të analizojë shkeljet e konstatuara në 8 rastet me vlerë **2,689,558 lekë**, të trajtuara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, dhe të nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për kryerjen e veprimeve në kundërshtim me ligjin.

Zbatimi nga subjekti: *Gjatë auditimit aktual nuk u konstatuan raste të natyrës së mësipërme. Rekomandimi konsiderohet i zbatuar.*

Pretendimi i subjektit:

Në fazën e projektraportit të auditimit, për sa është trajtuar në këtë pjesë të raportit të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni nga znj.F. D., me detyre speciliste e taksave dhe tarifave vendore, me shkresë nr. 935/23, datë 16.06.2021 (të dhëna të subjektit), protokolluar në KLSH me nr.361/9, datë 18.6.2021, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Në faqen 19 pika 5 është thënë për detyrime të lëna nga KLSH nga auditimi i mëparshëm:

Për dy subjektet ju dërgojmë kopje të vendimeve mbi ankesat që janë paraqitur nga vetë firmat pranë Bashkisë Tropojë:

1.P. shpk, vendim nr.175, dt.21.12.2020 ÷për shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga shoqëria P. shpkö

2.G. C. G., vendim nr.175/1 dt.22.12.2020 ÷për shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga firma G. C. G.ö.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Çështja që ju ngrini është trajtuar në auditimin e mëparshëm dhe këto pretendime Tuaja duhej të ishin paraqitur përpara se të përfundonte ai auditim. Në këtë auditim verifikohet vetëm zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm dhe nuk mund të shqyrtojmë observacione që lidhen me situata të cilat i përkasin auditimit të kaluar. Për sa më sipër nuk merret në konsiderat nga grupi i auditimit.

Zbatimi i masave administrative

C/1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik.

Referuar parregullsive dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurat e prokurimeve me vlerë të lartë për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2018, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ÷Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitö, shkronjën öio, të nenit 13 Agjencia e Prokurimit Publik, nenit 72 Kundërvajtjet administrative, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ÷Për prokurimin publikö, i ndryshuar, dhe pikës 1, të nenit 79 Sanksionet administrative, pikave 1 dhe 2 të nenit 81 Masat disiplinore, të kreut X Sanksionet administrative dhe masat disiplinore të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 ÷Për rregullat e prokurimit publikö, i ndryshuar, **KLSH me shkresën nr. 1475/8 datë 27.07.2019 i ka rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik z. Reida Kashta, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo me rekomandimin e autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore) për 3 personat.**

Zbatimi nga subjekti: *Nga auditimi i kryer nga KLSH në vitin 2020, për zbatimin e rekomandimeve, kjo masë është konstatuar në proces zbatimi, si vijon:*

*Ngaverifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 66 data 28.10.2019 ka vendosur masa dënim me gjobe për 7 persona në shumën **610,000 lekë**. Vetëm 2 persona janë në marrëdhënie pune pranë Bashkisë Tropojë. Për të cilët nga Bashkia Tropojë janë njoftuar personat ne lidhje me masat e vendosura dhe për likuidim vullnetare, janë kontabilizuar*

veprimet, deri më datën 06.03.2020 janë arkëtuar nga 4 persona vlera prej 340,000 lekë, në proces arkëtimi 1 personë në vlerën 90.000 lekë dhe në proces gjyqësor 1 person në vlerën 90.000 lekë dhe nisur njoftimet dhe ende nuk ka filluar arkëtimi për 1 person në vlerën 90,000 lekë. Më konkretisht: z. A. M.me shkresën nr. 424 prot datë 28.01.2020, është njoftuar nga drejtoria ekonomike për vendimin e APP-së, protokolluar në Bashkinë Tropojë me shkresës Nr.3142 prot, datë 30.10.2019, për ekzekutimin vullnetar të detyrimit. Deri në datën e verifikimit 21.02.2020.

Në mënyrë tabelore lista e personave të gjobitur nga APP dhe zbatimi nga Bashkia Tropojë, paraqiten në aneksin nr. 5/2, bashkangjitur projekraportit të auditimit.

Nga auditimi aktual në vitin 2021 nuk u paraqit dokumentacion për marrjen e masave të reja për zbatim, duke lënë të pa ndryshuar situatën e mësipërme.

Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi

C/2. Për Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes Territorit (IKMT).

Referuar shkeljeve të konstatuara në zbatimin e kontratave të punëve publike, përcaktuar në nenin 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a), të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **KLSHi ka rekomanduar, Kryetarit të Bashkisë Tropojë, ta kërkojë Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes Territorit (IKMT), të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative me gjobë për 1 mbikëqyrës dhe 1 kolaudator punimesh.** Nga verifikimi rezultoi se ky rekomandim nuk është zbatuar dhe në kushtet kur Bashkia Tropojë ka në strukturën e saj Kryeinspektor të Inspektoratit Mbrojtjes Territorit , i kërkon këtij të fundit që të vendosë gjobë ndaj **2 mbikëqyrësve të punimeve, si më poshtë:**

1.Për operatorin ekonomik “Gj. C.” SHPK, me përfaqësues z. H. M. në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin “Shtesë ujësjellësi Valbonë për qytetin Bajram Curriö, Bashkia Tropojë, me sipërmarrës punimesh BOE öN.ö SHPK & öS.ö SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **1,240,388 lekë pa TVSh.**

2.Për operatorin ekonomik “G. C. E.” ShPK, me përfaqësues z. G. B., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin: “Rikonstruksion shkolla “Asim Vokshi”, Bashkia Tropojë, me sipërmarrës punimesh OE ö4. M.ö SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **521,050 lekë me TVSh,** dhe në cilësinë e kolaudatorit të punimeve öShtesë ujësjellësi Valbonë për qytetin Bajram Curriö, Bashkia Tropojë, me sipërmarrës punimesh BOE öN.ö SHPK & öS.ö SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **1,240,388 lekë pa TVSH** (Trajtuar më hollësisht në pikën (C) faqet 91-101, të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe akt-konstatimet nr. 5; 6 dhe 7, datë 05.04.2019).

Nga auditimi i kryer nga KLSH në vitin 2020, për zbatimin e rekomandimeve, kjo masë është konstatuar e pa zbatuar: Nga Bashkia Tropojë nuk është bërë njoftimi i Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes Territorit (IKMT), për vlerësimin e shkeljeve të konstatuara nga KLSH në vendosjen e masës administrative me gjobë për 1 mbikëqyrës dhe 1 (një) kolaudator.

Nëse nuk fillojnë procedurat për vendosjen e vendimeve të gjobave për 2 rastet e mësipërme, ndaj Kryeinspektorit të IMTV-së, kryetar i Bashkisë të fillojnë procedurat ligjore dhe marrjen e masës disiplinore, bazuar në **Nenin 44-Përgjegjësia e punonjësit të organit**

administrative, ku përcaktohet se: Në rast se gjobat dhe detyrimet e tjera, të vendosura nga vendimi për kundërvajtjen administrative, nuk paguhen për mosveprim të punonjësit të organit administrativ, i cili ka miratuar vendimin përkatës dhe detyrimin që të kërkojë arkëtimin e shumave, apo për shkak se punonjësi nuk nis procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ, atëherë ndaj tij fillojnë procedurat e largimit nga detyra.

Nga auditimi aktual në vitin 2021 nuk u paraqit dokumentacion për marrjen e masave të reja për zbatim, duke lënë të pa ndryshuar situatën e mësipërme.

Rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar

Zbatimi i masave disiplinore

Me shkresën nr. 1475/7 prot., datë 27.07.2019 është dërguar raporti përfundimtar i auditimit dhe rekomandimet. Në këtë raport për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil i është rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Tropojë që t'ia kërkojë Komisionit Disiplinor, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH osë, për periudhën 01.01.2016 deri më 31.12.2018, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për **12 (dymbëdhjetë)** punonjës. Gjithashtu është kërkuar që të jepet masë disiplinore edhe për **23 (njëzetetë)** punonjës marrëdhëniet e punës të cilëve rregullohen sipas kodit të punës. KLSH ka kryer auditim për zbatimin e këtyre masave dhe me shkresën nr. 1082/48 prot., datë 05.06.2020, KLSH ka dërguar në Bashkisë Tropojë raportin përfundimtar të auditimit, në të cilin ka rikërkuar zbatimin e masave disiplinore.

Lista analitike e masave të rekomanduara dhe zbatuara paraqitet në aneksin nr.5/3, bashkangjitur raportit të auditimit.

***Shënim:** Nga verifikimi rezultoi se nga 33 masa disiplinore të rekomanduara nga KLSH (A. U. është i njëjti person me shtetasin A. I. e vërtetuar në bazë të dosjes personale të paraqitur nga drejtoria e burimeve njerëzore, ndërsa për znj. M. B. është shënim "lapsus"), për 1 punonjës (për z. B. H.), nuk është marrë masë, masat e tjera janë të zbatuara.*

Pretendimi i subjektit:

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të raportit të auditimit, nga subjekti i audituar gjatë fazës së projektraportit është paraqitur observacioni nga z/znj. K. A., me detyrë përgjegjëse e burimeve njerëzore, me shkresë nr. 935/30, datë 16.06.2021 (të dhëna të subjektit), protokolluar në KLSH me nr.361/10, datë 18.6.2021, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Me shkresën nr.1082/48 prot. date 05.06.2020 në Bashkinë tonë është dërguar Raporti Përfundimtar ku janë pasqyruar edhe masat disiplinore që janë marre. Janë vetëm tre persona pa marrë masë.

Sqarojë se: 1. Për z. G. S. me urdhrin nr.102 dt. 17.04.2020 është marre mase disiplinore "vërejtje me paralajmërim për zgjidhje të kontratës së punës" e cila ndoshta gabimisht nuk i është nisur KLSH, qe do të thotë se KLSH nuk është njohur me të, ndërsa me urdhrin nr.181 datë30.09.2020 Z.G. S. është larguar nga puna.

2.Z.A. M. me vendim nr.63 dt. 04.05.2020 është larguar nga puna .

3. Për Z.B. H. do zbatohet menjëherë siç është e parashikuar tek raporti përfundimtar. Bashkangjituobservacionit është paraqitur: vendimi nr.63, datë 04.05.2020 ò Për ndërprerje të marrëdhënieve tëpunës për z. A. M..

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se bashkangjitur ju keni paraqitur dokumentacion (kopje të shkresë përcjellëse të KLSH për zbatimin e rekomandimeve, Rubrika masat disiplinore, urdhërin e largimit për z.A. M.,si dhe urdhrin nr.102, datë 17.04.2020 për dhënie mase disiplinore òvërejtje me paralajmërim për zgjidhje të kontratës së punës, z. G. S..

Pretendimet Tuaja merren në konsideratë.

Për sa më sipër është mbajtur aktverifikimi nr.2

6. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit

Mbi zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 107/2014, òPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò, i ndryshuar.

Titulli i gjetjes: Nga auditimi me zgjedhje i procedurave për leje zhvillimi e ndërtimi të miratuara nga Bashkia Tropojë, rezulton se kjo bashki ka miratuar leje zhvillimi dhe leje ndërtimit në kundërshtim me Ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 òPër Planifikimin dhe Zhvillimin e Territoritò të ndryshuar, dhe VKM nr. 408, datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar.

Situata:1. Leja e zhvillimit nr.14, datë 14.12.2018 dhe leja e ndërtimit nr.1034/1 prot., datë 28.05.2019 me objekt: òPër ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m2 për objekt banimi dhe shërbimi 6 kat + nënçati dhe 2 kat bodrumò, paraqitur nga zhvilluesi òV.ò shpk. Rezulton se nuk disponohet Oponenca teknike për objektin e sipërcituar në kundërshtim me Ligjin nr.8402, datë 10.09.1998 " Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit ", i ndryshuar, **Neni 6** ku thuhet se *Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të bëhet për të gjitha llojet e ndërtimeve, me vlerë të preventivuar së paku 100 milionë lekë, nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve.*

- *Saktësia e llogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë dhe afati i pagesës*

Referuar relacionit arkitektonik dhe planvendosjes rezulton se sipërfaqja totale e godinës mbi tokë është 2,858 m2, ndërsa sipërfaqja nëntokë është 1032.2 m2, pra gjithsej 3,890.8 m2, ndërkohë që në lejen e ndërtimit me nr.1034/1 prot., datë 28.05.2019 është llogaritur vetëm sipërfaqja mbi tokë që është 2,858.6 m2, duke mos u pasqyruar pjesa nëntokë e kësaj leje.

Vlera e TNI-së e llogaritur sipas legjislacionit të sipërpërmendur është si më poshtë:

TNI = çmim shitje/m2 sipas UKM nr.3, datë 28.12.2016 x m2 x 5% = 5,427,666 lekë.

Me njoftimin e datës 03.05.2019, të firmosur në sistem nga përgjegjësi z. A. B., z. H. C. dhe nga kryetari i bashkisë Tropojë z. B. D., vlera e paguar nga subjekti òV.ò shpk, me njoftim kreditimi të bankën R.të datës 03.05.2019 është 3,840,103 lekë.

Pra konstatohet një diferencë e dukshme prej 1,587,563 lekë, e papaguar nga subjekti zhvillues òV.ò shpk, për shkak të keqlllogaritjes nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë. Diferenca prej 1,587,563 lekë për shkak të keqlllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë, përbën të ardhur të munguar me pasojë dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të bashkisë Tropojë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me email dhe shkresor me nr.935/44 prot., datë 15.07.2021(të dhëna të subjektit), nga z. H. Ç., protokolluar në KLSH me nr.361/16, datë 23.307.2021,ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1-“Ndërtim i ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m2 për “Objekt banimi dhe shërbimi 6 kate + nënçati dhe 2 kate bodrum nëntokë”:

I. Sipas regjistrimit elektronik nr.1034, në emër të zhvilluesit B. B., më datë aplikimi 15.03.2019, sipërfaqe ndërtimi 2858 m2, nr. pasurie 7/32/2, në ZK 1347, sip. trualli 1100 m2, në pronësi të B. B.t. Është dhënë Leja e Zhvillimit nr.14, datë 14.12.2018, Leja e Ndërtimit nr.1034/1 Prot., datë 28.05.2019 Për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m2 për **òObjekt banimi dhe shërbimi 6 kate + nënçati dhe 2 kate bodrum nëntokë**

Nga auditimi i ushtruar në sistemin elektronik e-Leje, rezulton se nuk disponohet Oponenca teknike për objektin e sipërcituar, në kundërshtim me ligjin nr.8402, datë 10.09.1998 Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò, i ndryshuar, neni 6 i tij...

- Ju sqarojmë se, miratimi i kësaj leje në mungesë të Oponencës teknike, pasi në nenin 15, òDokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimiò të VKM nr.408, datë 13.05.2015, i

ndryshuar òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò dhe në ligjin nr.107/2014 šPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò, ndryshuar, nuk është përmendur, në mënyrë të veçantë një kërkesë e tillë. Shkak është edhe mungesa e përvojës, pasi për ne ka qenë aplikimi i parë për objekt me të tillë vlerë investimi.

Për lejen e mësipërme është llogaritur vetëm sipërfaqja mbi tokë e objekti, duke mos u pasqyruar pjesa nëntokë e kësaj leje...

Por dhe nga eksperiencat e mëparshme të kontrollit nga KLSH-ja, rastet kur ka pasur diferencë në pagese të taksës së ndikimit në infrastrukturë, kjo është quajtur e ardhur e munguar dhe është lënë detyrim subjektit që duhej ta paguajë.

Bashkëngjitur ju paraqesim mandatpagesën e bankës datë 12.07.2021, me anë të së cilës subjekti ka paguar pjesën e mbetur të detyrimit për shumën prej 1,587,563 lekë.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

-Përsa i përket oponencës teknike, mungesa e saj është në kundërshtim me Ligjin nr.8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit ", i ndryshuar, **Neni 6** ku thuhet se *Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të bëhet për të gjitha llojet e ndërtimeve, me vlerë të preventivuar së paku 100 milionë lekë, nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve.* **Ky pretendim nuk merret në konsideratë.**

Në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë, duke qenë se nga ana e subjektit është bërë pagesa e kësaj takse në vlerën prej 1,587,563 lekë, me mandatpagesën e datës 12.07.2021, **ky pretendim merret në konsideratë.**

Ju sqarojmë se pretendimi juaj për mungesën e oponencës teknike nuk merret në konsideratë.

Situata 2- Leja e zhvillimit nr.5, datë 24.07.2019 dhe leja e ndërtimit nr. 2186/1 datë 08.08.2019 me objekt òHotel dhe Bar Restorant 2.5 kate mbi tokë dhe 1 kat nën tokë, me zhvillues B. R.. Nga auditimi i kësaj leje ndërtimi nuk rezultuan mangësi përsa i përket distancave me kufitarët apo saktësia e llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

a- *Dhënia e Lejes së Ndërtimit, krahasimi si dhe zbatimi i treguesve parametrik*

Nga auditimi rezulton se nuk ka shkelje të distancave përsa i përket kufijve të pronës.

b- *Saktësia e llogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë dhe afati i pagesës*

Nga auditimi rezulton se është përlllogaritur drejtë taksa e ndikimit në infrastrukturë.

Situata:3. Leja e ndërtimit nr. 6, datë 22.07.2020 me objekt: òPër banim 2 kat mbi tokë dhe 1 kat nën tokë, një kat nënçati dhe mur rrethues, paraqitur nga zhvilluesi A. M..

Nga verifikimi në sistemin e e-leje rezulton se nga ana e bashkisë Tropojë duhej të ishte kërkuar rifreskimi i këtyre certifikatave për të provuar se pasuritë e paluajtshme janë në pronësi të z. A. Sh. M..

a- *Dhënia e Lejes së Ndërtimit, krahasimi si dhe zbatimi i treguesve parametrik*

Nga auditimi rezulton se nuk ka shkelje të distancave përsa i përket kufijve të pronës.

b- *Saktësia e llogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë dhe afati i pagesës*

Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë do të llogaritej:

$TNI = 31,977,289 \text{ lekë} \times 1 \% = \mathbf{319,772 \text{ lekë}}$.

Me njoftimin e datës 06.07.2020, të firmosur në sistem nga znj. F. D. (specialiste e tatim taksave), z. B. T. (drejtor ekonomik), z. H. I. (drejtor i DPKZHT) si dhe nga kryetari i bashkisë Tropojë, z. R. B., është njoftuar z. A. M. se vlera që ai duhet të paguajë është në shumën prej 234,570 lekë. Kjo vlerë është paguar nga subjekti, në bankën R.në datën 07.07.2020.

Pra konstatohet një diferencë prej 85,202 lekë, e papaguar nga subjekti zhvillues 04.Mö shpk, për shkak të keqlllogaritjes nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë. Diferenca prej **85,202 lekë** për shkak të keqlllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë, përbën të ardhur të munguar me pasojë dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të bashkisë Tropojë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni në adresën zyrtare të emailit dhe shkresore me nr.935/46 prot., datë 19.07.2021 (të dhëna të subjektit), nga z. H. I., protokolluar në KLSH me nr. 361/16, datë 23.07.2021, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Për lejen e ndërtimit me objekt: 0Për banim 2 kat mbi tokë dhe 1 kat nën tokë, një kat nënçati dhe mur rrethues, janë paraqitur këto observacione:

Nga ana e bashkisë Tropojë duhej të ishte kërkuar rifreskimi i këtyre certifikatave për të provuar se pasuritë e paluajtshme janë në pronësi të z. A. Sh. M..

Ju sqarojmë, se në sistemin e-Leje, në çdo rast të aplikimit për leje, për të konfirmuar vërtetësinë e dokumenteve të pronësisë dhe përditësimin e tyre, ato dërgohen, nëpërmjet këtij sistemi në adresë të ASHK osë Tropojë.

Nga auditimi i ushtruar në sistemin elektronik e-Leje, rezulton se është dhënë leja e ndërtimit nr.6, datë 22.07.2020... pa u pajisur më parë me lejen zhvillimore...

Ju sqarojmë, se leja e ndërtimit nr.6, datë 22.07.2020 është dhënë pas miratimit të lejes se zhvillimit nr.1, datë 22.02.2019, me nr.3883/2 Prot., nr. aplikimi AN031020180139, leje të cilën e keni bashkangjitur.

Nga ana e Drejtorit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, z. H. I. në shkresën për dhënie mendimi, nuk është vendosur edhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.

Ju sqarojmë, se në dokumentin shkresë për dhënie mendimi institucioneve përkatëse, në rolin e Drejtuesit Tropojë, rol të cilin e mbulon z. H. I., ka një lapsus (nuk është vendosur institucioni, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, por ky institucion nuk është anashkaluar në përzgjedhjen në sistemin e-Leje, në rubrikën e përzgjedhjes së tyre, duke mos e hequr të drejtën e kontrollit nga kjo agjenci e të gjithë dokumentacionit të ngarkuar në sistem, dokumentacion i cili është i rëndësishëm të kontrollohet dhe jo përmbajtja e shkresës së mësipërme. Për të vërtetuar veprimin në sistemin e-Leje (dërgimin për dhënie mendimi tek institucioni i mësipërm nga Drejtori i e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, z. H. I., bashkangjitur keni, dokumentin e nxjerrë nga sistemi, rubrika e historikut të veprimeve në këtë sistem.

Bazuar në paketën fiskale të vitit 2020, miratuar me VKB nr.401, dat 20.11.2019, norma e taksës është 3%.

Ju sqarojmë, se objekti në fjalë është objekt banimi i vet pronarit Azem Shpend Mataliaj, dhe për të tillë objekte, bazuar në paketën fiskale të vitit 2020, norma e taksës është 1%. d.m.th. llogaritja e kësaj takse është bërë në rregull, për sipërfaqen e përgjithshme të ndërtimit 713 metër katrorë x 32 899 leke/ metër katrorë, qe është çmimi i EKB-se për Tropojën x 1 % = 234 570 lekë.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Përsa i përket rifreskimit të certifikatave të pronësisë në sistemin e-Leje nuk figuron asnjë gjurmë se bashkia Tropojë i është drejtuar ASHK Tropojë për përditësimin e tyre.

Në lidhje me lejen e zhvillimit, ajo nuk figuronte në sistemin e-Leje në dosjen e aplikuesit, por pretendimi juaj merret parasysh pasi na e vendosët në dispozicion lejen e zhvillimit me nr.3883/2 prot., datë 22.02.2019, të firmosur elektronikisht nga ish kryetari i bashkisë Tropojë z. B. D.. **Ky pretendim merret parasysh.**

Përsa i përket shkresës drejtuar Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, që ju pretendoni se është lapsus, pas letërkëmbimit me email zyrtar me Agjencinë e Zhvillimit të Territorit, nga verifikimet që ajo ka bërë në sistemin elektronik të lejeve, rezulton se Agjencia Kombëtare për Zonat e Mbrojtura e ka miratuar në heshtje këtë aplikim.

Ky pretendim merret parasysh.

Në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë, sipas paketës fiskale të vitit 2020, *keni të drejtë përsa i përket normës së taksës që është 1 %*, por llogaritja duhej të bëhej sipas vlerës së preventivit dhe jo sipas çmimit të shitjes për metër katrorë.

Llogaritja sipas vlerës së investimit (preventivit) që është ngarkuar në sistem, është 31,977,289 lekë për objektin e mësipërm. Atëherë Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë do të llogaritej: $TNI = 31,977,289 \text{ lekë} \times 1 \% = 319,772 \text{ lekë}$. Diferenca prej **85,202 lekë**, përbën të ardhur të munguar me pasojë dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të bashkisë Tropojë.

Ju sqarojmë se pretendimi juaj për taksën e ndikimit në infrastrukturë nuk është i argumentuar si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merret në konsideratë.

Kriteri: Ligji Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, dhe VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Miratimi i këtyre lejeve në kundërshtim me ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, dhe VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar, nga Kryetari i Bashkisë Tropojë nuk ka siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, për aplikantë të cilët kanë mangësi në dokumentacion, gjë që i bën aplikimet jo të plota dhe miratimin e lejeve të mësipërme në kundërshtim me ligjin.

Shkaku: Mos respektimi i përcaktimeve të Ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar

Rëndësia: E lartë

Për këto veprime ngarkohet me përgjegjësi ish kryetari i bashkisë Tropojë z. B. D., kryetari aktual z. R. B., për vendimmarrjen e jashtëligjshme lidhur me aplikimet për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi në territorin administrativ të bashkisë, ish Drejtori i DPZHT z. H. C. si dhe Drejtori aktual i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit z. H. I.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemit të kontrollit të brendshëm në Bashkinë Tropojë u konstatuan mangësi në implementimin në praktik të elementëve të këtij sistemi.

Mjedisi i kontrollit. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit. Politika dhe praktika e burimeve njerëzore nuk garanton ruajtjen dhe zhvillimin profesional të stafit, pasi nuk ka programe trajnimi për punonjësit, për të ngritur në vazhdimësi nivelin e tyre profesional.

Për periudhën 01.01.2019-31.12.2020 kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës 156 punonjës, që përbën rreth 45% e numrit total të punonjësve gjë e cila përbën një risk përsa i përket përvojës së punës (me detyra të ndryshme si, drejtor ekonomik, specialiste financash, përgjegjës shërbimesh, magazinier etj). Punonjësit përpara largimit nuk kanë bërë dorëzimin e detyrës me procesverbal (dorëzimin e dosjeve shkresore, elektronike, pra të gjithë punës së krijuar prej tyre gjatë qëndrimit në institucion). Këto veprime nuk garantojnë ruajtjen e bazës së të dhënave për sektorët përkatës të institucionit, krijojnë vështirësi për vazhdimësinë e punës së kryer dhe transmetimin e saj nga një punonjës te tjetri. Gjithashtu nuk ka një dokument të shkruar (akt të brendshëm administrativ), i cili të përcaktojë detyrimet që ka punonjësi dhe veprimet që ai kryen përpara largimit, si dhe detyrat që ka institucioni (njësia e burimeve njerëzore dhe financa) në këtë proces.

-Menaxhimi i riskut. Nga titullari në cilësinë e kordinatorit të riskut dhe menaxherët e tjerë, nuk është hartuar strategjia dhe regjistri i riskut, nuk janë identifikuar aktivitete me risk, nuk është bërë vlerësimi dhe kontrolli i risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë. Mungon dokumenti i gjurmës së auditimit dhe listës së proceseve të punës për veprimtaritë kryesore të njësisë publike. Megjithatë është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik, nuk janë miratuar plane zhvillimi strategjikë me afat jo më pak se sa 5 vjet.

-Veprimtaritë e kontrollit. Nga ana e Titullarit të Bashkisë, nuk janë nxjerrë urdhra me shkrim për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së kontrollit. Nuk ka rregulla të brendshme për ruajtjen e aktiveve si dhe për sigurinë e sistemit IT. Mungon sistemi rezervë (back-up) për ruajtjen e të dhënave dhe nuk ka rregulla të shkruara për këtë qëllim. Pas shkrirjes së njësisë së auditit të brendshëm në vitin 2020 dhe mos lidhjes së kontratës me një njësi tjetër për këtë qëllim, kontrollet pas faktit kanë munguar.

-Informacioni dhe komunikimi. Realizohet sipas shkallës së strukturave, bazuar edhe në rregulloren e funksionimit të brendshëm, në zbatim të kërkesave të nenit 23 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010.

Monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit. Nuk janë përcaktuar rregulla të qarta lidhur me ndjekjen e zbatimit të kontratave të lidhura pas procedurave të prokurimit me tender. Për projektet në bujqësi, arsim, urbanistikë, infrastrukturë etj., në rregulloren e funksionimit të brendshëm nuk janë përcaktuar detyra për struktura dhe persona konkret për ndjekjen e zbatimit të kontratave lidhur me afatet dhe cilësinë e punimeve.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 16, 20, 21, 22, 23 dhe 24 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, ligjin nr. 68/2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, neni 32. (*Më hollësisht trajtuar në pikën nr.1.1 faqe 16-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

1.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Tropojë dhe menaxherët kryesorë të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe

kontrollin në njësinë vendore. Për këtë më parë të kryhen trajnime për njohjen e ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe kërkesat e Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Të hartohen rregulla për ruajtjen e aktiveve, për llojet e raporteve, frekuencën e raportimit me shkrim të Titullari nga secila drejtori/sector, etj. Të hartohet regjistri i riskut në nivel sektori, drejtorie dhe institucioni, gjurma e auditimit dhe lista (harta) e proceseve të punës.

Deri më 30.11.2021

2.Gjetje nga auditimi. Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka kryer auditime në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart si: prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, taksat dhe tarifatat vendore, etj.

Për këtë arsye kjo njësi nuk i ka dhënë mbështetjen e duhur Kryetarit të Bashkisë për arritjen e objektivave, pasi nuk janë kryer auditime bazuar në vlerësimin objektiv të riskut.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e pikës 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016, për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik, i ndryshuar, nenin nr. 5 dhe nr. 6 të ligjit nr. 114/2015 për auditimin e brendshëm në sektorin publik.

Nga shqyrtimi i dosjeve të auditimeve të periudhës 01.01.2019-31.12.2020 u konstatua se në dosjet e auditimit të vitit 2019 dhe 2020, nuk është bërë kontrolli i cilësisë së auditimit të kryer, në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, Kap. II, pika 10.

Nuk ka nxjerrje përgjegjësitë si dhe nuk ka marrje masa për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit, duke bërë që NJAB të mos e realizojë plotësisht misionin e saj për kryerjen e monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Në auditimet e kryera konstatohet se nga Njësia e Auditimit të Brendshëm për periudhën 01.01.2019-31.12.2020 nuk është kryer verifikimi i zbatimit të rekomandimeve me program tematik të veçantë, gjë që vjen në kundërshtim me Manualin e auditimit të miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik, pikën 4.1.13.2, Raportimi i ndjekjes së rekomandimeve. Në disa raste kur janë trajtuar gjetjet dhe rekomandimet nuk janë shoqëruar me referencën ligjore përkatëse, neni, pika, Ligje apo VKM, për pasojë një pjesë e këtyre rekomandimeve nuk janë të plota. Aktualisht Bashkia Tropojë nuk ka njësi të auditit të brendshëm dhe nuk ka lidhur kontratë me institucion tjetër për realizimin e këtij shërbimi. Me shkresën nr.2027 prot., datë 15.05.2020 me lëndë informacion për sektorin e Auditimit të Brendshëm, është vënë në dijeni Ministria e Financave dhe Ekonomisë për shkrirjen e Sektorit të Auditimit të Brendshëm për shkak se nga Titullari është konstatuar performancë e dobët në punë dhe është arsyetuar se nëse lind nevoja do të paraqitet projekt-vendim në Këshillin Bashkiak, sipas rasteve për të marrë audit të specializuar nga jashtë.

Shkrirja e Njesisë së Auditit të Brendshëm nga Kryetari i Bashkisë është në kundërshtim me nenin 49 të ligjit 68/2017 për financat e vetëqeverisjes vendore, si dhe pikën 1 të VKM nr.83, datë 03.02.2016 për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të brendshëm në sektorin publik, ku përcaktohet se në çdo njësi të vetëqeverisjes vendore krijohet njësi e auditimit të brendshëm.

(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.1.2 faqe 17-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Tropojë të marrë masa për organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm në bashki, duke krijuar Njësinë e Auditimit të Brendshëm brenda strukturës organizative të Bashkisë Tropojë. Në përzgjedhjen e punonjësve të kihet në konsideratë fakti se audituesi i brendshëm duhet të jetë i paisur me certifikatën e Audituesit të Brendshëm në sektorin publik.

3. Gjetje nga auditimi: Disa nga llogaritë kryesore të aktiveve afatgjata nuk paraqesin vlerën e saktë, pasi në këto llogari nuk janë përfshirë të gjitha asetet që administrohen nga Bashkia Tropojë, si:

-Llogaria 210 “Toka, troje, terreneo, për të dy vitet 2019 dhe 2020 në pasqyrat financiare ka vlerën 22,460,270 lekë, dhe përbëhet vetëm nga dy pasuri.

Në këtë llogari nuk janë përfshirë tokat, trojet dhe terrenet që njësia vendore ka në fakt si pasuri të saj, pasuritë që janë transferuar me VKM të posaçme pranë Bashkisë Tropojë dhe pranë ish komunave që tashmë janë pjesë e Bashkisë Tropojë. Nuk është hartuar regjistër i aktiveve për këtë llogarinë, ku minimalist duhet të identifikohet sipërfaqja e pasurisë, vendndodhja, statusi i saj (zaptuar ose jo), etj.

- Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione” për vitin 2019 dhe vitin 2020 në pasqyrat financiare ka vlerën 10,017,959 lekë dhe përbëhet vetëm nga 6 pasuri.

Nuk është hartuar regjistër i plotë i aktiveve për llogarinë 211, si dhe në vlerën e saj nuk janë përfshirë pyjet kullotat dhe plantacionet që njësia vendore ka në fakt si pasuri të saj, të cilat kanë kaluar në pronësi të njësisë vendore me VKM nr. 433, datë 8.6.2016 për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish- komunave/ bashkive.

-Llogaria 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, në pasqyrat financiare të vitit për vitin 2020 ka vlerën 1,168,261,128 lekë, e cila nuk rakordon me analizën e kësaj llogarie (vlerën e listës analitike), e cila jep informacion se kjo llogari përbëhet nga 146 aktive në vlerën neto 1,108,173,263 lekë. Vlera bruto e kësaj liste në datën 31.12.2020 është 1,329,807,522 lekë, e njëjtë me vlerën bruto të trashëguar nga pasqyrat financiare të vitit 2019, pra në listën analitike të vitit 2020 nuk janë reflektuar shtesat e bëra gjatë këtij viti.

Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, për vitin 2020 ka vlerën neto 1,706,372,666 lekë, me një rritje nga viti 2019 në vlerën neto 669,484 lekë, por e pa argumentuar shtesa me listë analitike.

Për periudhën 2019-2020 nuk është kryer inventarizimi i aktiveve të katër llogarive të mësipërme, si dhe nuk është ngritur grup i posaçëm pune për vlerësimin e gjendjes aktuale të pronës, përgatitjen e dokumentacionit për verifikimin dhe regjistrimin e të gjitha pronave të paluajtshme pranë Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ish ZRPP).

Nuk është krijuar regjistër i aktiveve në formë shkresore, gjendja ekzistuese e këtij regjistri është vetëm në formë elektronike.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018 për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, neni 3 -Përkufizime, pika 1,2, neni 7 - Dokumenti kontabël, neni 11 ó Qëllimi i pasqyrave financiare, neni 15-Inventari i aktiveve dhe detyrimeve;UMF nr. 30, datë 27.12.2011për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, kapitulli IV. pika 74, UMF nr. 8 datë 9.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3 faqe 71-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Tropojë të ngrijë grup pune me specialist të fushës për evidentimin e të gjitha aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara (AQT) të cilat janë pasuri e Bashkisë, duke evidentuar statusin dhe gjendjen e tyre faktike në teren.

3.2. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me strukturat e tjera të bashkisë të plotësojë regjistrin e të gjitha aktiveve sipas llogarive përkatëse, i cili të jetë elektronik dhe shkresor dhe të marrë masa për regjistrimin e pronave në ASHK dhe kontabilitet. Për çdo vit,

të kryhet inventarizimi i këtyre aktiveve. Të argumentohet në analizën e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore, shtesa neto 669,484 lekë.

Deri më 31.12.2021

4. Gjetje nga auditimi:Për llogarinë 215 -Mjete Transportipër të dy vitet 2019 dhe 2020, nga krahasimi i të dhënave të pasqyruara në aktivin e pasqyrës së pozicionit financiar, me të dhënat që jep për këtë llogari analiza e saj (lista analitike), konstatohet se ka diferencë midis tyre në vlerën 3,452,393 lekë, e cila është më tepër në pasqyrën e pozicionit financiar (bilanc). Sipas shënimeve shpjeguese të bëra në pasqyrat financiare të vitit 2019 dhe 2020 kjo diferencë i përket ish komunës Lekbibaj, për shkak të diferencave midis gjendjes kontabël dhe gjendjes fizike të mbartura nga kjo ish komunë, por pa dhënë shpjegime konkrete për këtë diferencë.

Lista analitike e llogarisë 215 përbëhet nga 32 mjete, për tetë prej të cilave me vlerë të kostos historike 6,791,000 lekë dhe vlerë të mbetur zero lekë (të amortizuara), këshilli bashkiak me vendimin nr. 154, datë 23.10.2018 ka miratuar daljen jashtë përdorimit, por ky proces nuk është kryer. Me urdhrin nr. 89, datë 20.06.2018 ish kryetari i bashkisë z. B. D., ka urdhëruar hyrjen në magazinë të tetë automjeteve, por ky urdhër nuk është zbatuar, duke lënë tetë mjetet e mësipërme (sipas listës në aneksin bashkangjitur projekt raportit të auditimit), pa përgjegjës material dhe pa i magazinuar, që megjithëse të dëmtuara, bëhen pre e humbjeve pjesore apo tërësore.

Gjithashtu për llogarinë 24 -*Aktive afatgjata te dëmtuara*, e cila përfaqëson 4 mjete transporti të dëmtuara, u konstatua se vlera neto në pasqyrat financiare është 3,013,808 lekë më e madhe se vlera neto që pasqyron analiza e kësaj llogarie. Sipas shpjegimeve të bëra në pasqyrat financiare kjo diferencë është e mbartur nga ish komuna Lekbibaj, për të cilën nga Bashkia Tropojë nuk u paraqit dokumentacion shpjegues.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, neni 3 -Përkufizime, pika 1,2, neni 7 - Dokumenti kontabël, neni 11 ó Qëllimi i pasqyrave financiare, neni 15-Inventari i aktiveve dhe detyrimeve;UMF nr. 8 datë 9.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme.

(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3 faqe 75-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandim: Drejtori Ekonomik të marrë masa për të shpjeguar me dokumentacion arsyet e diferencës prej 3,452,393 lekë, midis vlerës që mbartin më shumë pasqyrat financiare nga lista analitike, për llogarinë 215 -Mjete transporti, si dhe arsyet e diferencës prej 3,013,808 lekë që mbartin më shumë pasqyrat financiare nga lista analitike, për llogarinë 24 - Aktive afatgjata te dëmtuara.

4.2. Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë dhe Drejtori Ekonomik të merren masa për inventarizimin e tetë mjeteve me vlerë të kostos historike 6,791,000 lekë, të cilat janë propozuar për dalje nga përdorimi dhe të përcaktohen personat përgjegjës për ruajtjen e tyre. Të përshpejtohen procedurat për nxjerrjen e tyre jashtë përdorimit, bazuar në rregullat në fuqi, me qëllim shmangien e humbjeve.

Deri në 30.11.2021

5. Gjetje nga auditimi: Lista analitike e llogarisë 401-408 òFurnitorë e llogari të lidhura me toò nuk jep informacion të plotë, pasi një pjesë e të dhënave nuk është e plotësuar për një numër të konsiderueshëm subjektsh, si numri faturës, data e faturës dhe objekti i prokurimit, elementë të domosdoshëm për regjistrimet në kontabilitet dhe për kryerjen e pagesës ndaj furnitorit.

Konstatohet se mungesat e mësipërme në shumicën e rasteve lidhet me punën e pakujdesshme të Drejtorisë së Financës për mos regjistrimin e të dhënave të plota në listën e

detyrimeve, pasi kjo e dhënë mungon në shumicën e objekteve të prokurimit të zhvilluar në vitin 2018 dhe 2019 (pra nuk lidhet me mungesë të dhënash në vite, të lëna nga ish komunat etj.).

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, neni 3 -Përkufizime, pika 1,2, neni 7 - Dokumenti kontabël, neni 15-Inventari i aktiveve dhe detyrimeve;UMF nr. 8 datë 9.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme.

(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3 faqe 80-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike të marrë masa për plotësimin e listës së kreditorëve me të gjithë elementët e duhur, si objektin e prokurimit, numrin e faturës, datën e faturës, etj., elementë të cilët identifikojnë plotësisht llojin, kohën e lindjes së detyrimit, arsyen e detyrimit që Bashkia Tropojë ka ndaj të tretëve.

Deri në 30.11.2021

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se lista analitike e llogarisë 466 òKreditorë për mjetet në ruajtje, nuk jep informacion të plotë, pasi mungon afati i fillimit dhe mbarimit të garancisë së vlerës 5% të punimeve për subjektet private. Mungesa e këtij afati, nuk jep mundësi për ndjekjen e grafikut të kthimit të garancisë për investimet e marra në dorëzim në mënyrë përfundimtare dhe evidentimin e investimeve të pa përfunduara ende.

Në pasqyrat financiare të vitit 2020 vlera e llogarisë 466 është 28,728,604 lekë dhe është e analizuar për 81 raste. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollin, neni 12, pika 3, gërmë ogjë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3 faqe 80-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në Bashkëpunim me Sektorin e Urbanistikës të evidentojë subjektet të cilat kanë shlyer detyrimin për të cilin ju është ngurtësuar vlera 5% e garancisë së punimeve dhe të bëjë likuidimin e kësaj vlere për subjektet. Ky proces të ndiqet në vijimësi, sipas të dhënave që paraqesin kontratat e punimeve, akët e kolaudimeve, procesverbalet e marrjes në përkohshme në dorëzim etj.

Deri në 30.11.2021

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare dhe dokumentacionit të inventarizimit u konstatua se llogaria 327 òInventar i imët, ka mospërputhje midis vlerës së pasqyruar në pasqyrat financiare, vlerës së komisionit të inventarizimit dhe vlerës së listës analitike të kësaj llogarie që administrohet nga Drejtoria Ekonomike. Për vitin 2019 vlera e llogarisë 327 sipas rezultateve të inventarizimit është 5,777,588 lekë, sipas analizës së kësaj llogarie (listës analitike) është 6,044,150 lekë, ndërsa sipas pasqyrave financiare 12,339,373 lekë. Vlera në pasqyrat financiare është 6,561,785 lekë më e madhe se vlera e rezultateve të inventarizimit dhe 6,295,223 lekë më e madhe se vlera e analizës së kësaj llogarie.

Për vitin 2020 vlera e llogarisë 327 në pasqyrat financiare është 9,624,803 lekë më shumë se vlera e dalë nga rezultatet e procesit të inventarizimit, e cila është 6,605,586 lekë.

Për të dy vitet 2019 dhe 2020 për llogarinë 327 òInventar i imëtpasqyrat financiare nuk pasqyrojnë vlerën e saktë të pasurisë së institucionit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e nenit 3, pika 1, nenin 7, 11, 15 të ligjit nr. 25/2018 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare; Kap. II, të VKM nr. 783, datë 22.11.2006 òPër përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël; udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3 faqe 68-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

7.1.Rekomandim: Drejtoria Ekonomike të analizojë arsyet që sjellin mos rakordimin e vlerës së dalë nga procesi i inventarizimit me vlerën e pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar të pasqyrave financiare dhe të marrë masa për sistemimin e llogarisë 327 ó Inventar i imët. Kjo llogari në pasqyrat financiare duhet të përfaqësohet me vlerën e dalë nga procesi i inventarizimit.

Deri në 30.11.2021

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Tropojë, për llogarinë -105 -Teprica e Granteve kapitale, nuk ka informacion për justifikimin e kësaj vlere të mbartur nga pasqyrat e vitit paraardhës. Për të dy vitet 2019 dhe 2020 kjo llogari ka vlerën 67,358,609 lekë.

Llogaritë 105 mbeten me tepricë në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet kur grantet janë burim për investimet në proces (të papërfunduara ose të pa marra në dorëzim). Në aktiv të bilancit këto janë investime në proces në grupin e llogarive 23 dhe mbyllen (kapitalizohen) me fondet bazë në kohën kur investimi është përfunduar dhe marrë në dorëzim.

Por mbështetur në të dhënat e pasqyrës së pozicionit financiare të vitit 2020, shuma e llogarisë 230 dhe 231 është 17,138,144 lekë dhe nuk përputhet me vlerën që paraqitet në llogarinë 105, e cila mbart një vlerë prej 50,220,465 lekë më shumë se llogaria 230 dhe 231 së bashku.

Në pasqyrën e performancës financiare, llogaria 7206- Financim i pritshëm nga buxheti, për vitin 2020 ka vlerën 18,501,346 lekë dhe rakordon me shumën e llogarive të pasivit: 42 ó Detyrime ndaj personelit, 431 -Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa, 435-Sigurime Shoqërore, 436 -Sigurime Shëndetësore, por nuk është përfshirë vlera prej 108,423,719 lekë, e llogarisë -Furnitorë e llogari te lidhura me to.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 óPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeö, aneksi 1 -Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik, pika 1.1.2/a, si dhe pika 32 dhe 59.

(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3 faqe 82-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1.Rekomandim: Drejtoria Ekonomike të marrë masa për argumentimin me analizë analitike të vlerës së llogarisë Llogaria 105 -Teprica e grandeve kapitale te brendshme, të paraqitur në pasqyrat financiare, si dhe sistemimin e llogarisë 7206- Financim i pritshëm nga buxheti, në mënyrë që këto llogari të pasqyrojnë vlerën e saktë në pasqyrat financiare, në përputhje me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2021

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditim u konstatua se Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Tropojë, nuk ka ngritur komision inventarizimi për marrjen në dorëzim të aktiveve të dhuruara në vlerën 9,788,944 lekë, për pajisje të ndryshme për shkollën e mesme óAsim Vokshi. Gjithashtu këto aktive nuk janë regjistruar në kontabilitet. Me gjithë konstatimin nga ana e komisionit të inventarizimit nëpërmjet shkresës me nr. 1166 prot., datë 28.02.2020, procesi ka mbetur i paplotësuar, veprime këto në kundërshtim me kërkesat eudhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 óPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikö, rubrika -Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara, pika 55, 56, 57 dhe 89. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3 faqe 58-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

9.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Tropojë të marrë masa për ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve të furnizuara dhe të pa regjistruara librin e magazinës dhe në kontabilitet, në vlerën 9,788,944 lekë.

9.2.Rekomandim: Bazuar në rezultatet e komisionit të inventarizimit nga Drejtoria Ekonomike të merren masa për hyrjen e aktiveve në magazinë, shpërndarjen e tyre sipas personave përgjegjës që përdorin aktivin, duke plotësuar kartelat përkatëse. Në rast se gjatë

procesit të inventarizimit do të konstatohen aktive mangët, të merren masa për nxjerrjen e përgjegjëse dhe zhdëmtimin e tyre nga personat përgjegjës.

Deri në 31.12.2021

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan mangësi në procesin e vlerësimit të aktiveve për dalje nga përdorimi. Komisioni i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi për vitin 2019, për llogarinë 218 óInventar ekonomik, ka vlerësuar 679 aktive për tu nxjerrë jashtë përdorimit (me destinacion për asgjësim dhe skrap), kryesisht orendi shkolle si tavolina, karrige, banka, dollap, krevat hekuri, dyshek, por edhe disa paisje informatike si kompjuter, printer e fotokopje. Në datën 31.12.2019, vlera bruto e këtyre aktiveve është 18,459,741 lekë, ndërsa vlera e mbetur 9,386,124 lekë.

Për vitin 2020 komisioni i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi ka vlerësuar 150 aktive të llogarisë ekonomike 218 óInventar ekonomik (orendi zyre etj.), për tu nxjerrë jashtë përdorimit (për asgjësim dhe skrap), në vlerën 1,744,596 lekë, vlerë të mbetur 338,656 lekë.

Në listën e hartuar nga komisioni i vlerësimit për të dy vitet 2019 dhe 2020, jo të gjitha aktivet që janë vlerësuar për dalje nga përdorimi kanë plotësuar kohën e shfrytëzimit të tyre, në bazë të normave të amortizimit, pasi disa aktive nuk janë amortizuar plotësisht, ndërsa disa të tjera janë pa vlerë amortizimi, pra vlera bruto është e barabartë me vlerën neto, mungon viti i vënies në punë të aktivitetit, si dhe koha e shfrytëzimit të tij.

Në procesverbalin e vlerësimit të aktiveve, komisioni i vlerësimit nuk ka shpjeguar kriteret mbi bazën e të cilave ka vlerësuar këto aktive për tu nxjerrë jashtë përdorimit (nëse është plotësuar koha e shfrytëzimit në bazë të normave të amortizimit dhe nuk mund të riparohen, kanë humbur cilësitë e tyre të caktuara fizike etj.).

Procesverbali i vlerësimit të aktiveve nuk është firmosur nga përgjegjësi material dhe nuk është miratuar nga titullari i institucionit. Nga komisioni i vlerësimit nuk është hartuar relacioni i vlerësimit të aktiveve, i cili duhet të shpjegojë procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës.

Pasqyrat financiare të vitit 2020, nuk pasqyrojnë vlerën e saktë të llogarisë 218 - Inventar ekonomik. Kjo llogari në pasqyrat financiare ka vlerën bruto 74,744,833 lekë, ndërsa rezultatet e inventarizimit janë në vlerën bruto 74,684,359 lekë, pra pasqyrat kanë një vlerë bruto 60,474 lekë më shumë se vlera e aktiveve të konstatuara gjatë procesit të inventarizimit. Për sa më sipër është në kundërshtim me udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 óPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, pika 95 e rubrikës óProcesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi, pika 102 e rubrikës óLista e aktiveve të identifikuar për vlerësim, pika 103 e rubrikës óKriteret për vlerësimin e Aktiveve, pika 104 dhe 105 të rubrikës óProces verbali i vlerësimit, pika 106 të rubrikës óRelacioni i vlerësimit, me ligjin nr. 25/2018 óPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, neni 3; pika 1,2, neni 7, 11, 15. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3 faqe 78-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

10.1.Rekomandim: Drejtoria ekonomike të marrë masa që në rastet e kryerjes së procesit të vlerësimit të aktiveve për dalje nga përdorimi, komisioni i vlerësimit, përpara hartimit të kësaj liste të shpjegojë kriteret mbi bazën e të cilave vlerëson aktivet për dalje nga përdorimi, të hartohet relacioni i vlerësimit të aktiveve, i cili duhet të shpjegojë procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës. Për aktivet të cilat nuk kanë plotësuar normën e amortizimit dhe vlerësohen për jashtë përdorimit të dalin përgjegjësitë për pa mundësinë e përdorimit të mëtejshëm të aktivitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan mangësi në procesin e asgjësimit të aktiveve. Komisioni i vlerësimit të aktiveve për dalje nga përdorimi për vitin 2019 dhe 2020 ka përcaktuar se pjesa më e madhe e aktiveve është për asgjësim, ndërsa një pjesë e vogël e tyre, si kasafortë, krevat hekuri, etj., janë përcaktuar me destinacion për skrap. Komisioni i asgjësimit të aktiveve i ngritur me urdhrin nr.212, datë 10.12.2020, i cili ka asgjësuar si aktivet e propozuara për dalje nga përdorimi në vitin 2019 dhe në vitin 2020, ka kryer këtë proces, duke i asgjësuar/tjetërsuar të gjitha aktivet (të llogarisë 218 óInventar ekonomik dhe 327 óInventar i imët), pa identifikuar dhe veçuar ato aktive të cilat mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshme, dhe të shiteshin në ankand (sipas listës konkrete të aktiveve, për skrap dhe dru zjarri).

Nga komisioni i asgjësimit të aktiveve është vepruar në kundërshtim me kërkesat e pikës 109 të udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik dhe në kundërshtim me përcaktimin e bërë nga komisioni i vlerësimit të aktiveve (i cili ka vlerësuar aktive me destinacion për skrap).

(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3 faqe 62-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1.Rekomandim: Drejtoria Ekonomike dhe komisionet e inventarizimit vjetor të marrin masa që në rastet e kryerjes së procesit të asgjësimit të aktiveve, të identifikohen dhe veçohen ato aktive të cilat mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshme, të vlerësohen për vlerën e tyre, të bëhen hyrje në magazinë dhe të vazhdojnë procedurat për shitje në ankand.

Menjëherë dhe në vijimësi

12.Gjetje nga auditimi: Në planifikimin buxhetit vjetor 2019 dhe 2020 edhe pse janë planifikuar fonde për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura që i përkasin periudhës përpara vitit buxhetor, sërish janë krijuar detyrime të reja, duke mos zgjidhur situatën e detyrimeve të prapambetura.

Nga auditimi i pasqyrave financiare konstatohet se në datën 31.12.2019 detyrimet e prapambetura (shuma e llogarisë 401-408 dhe 467) kanë një vlerë prej 123,151,017 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 kjo vlerë është 121,462,192 lekë, duke pësuar ulje vetëm prej 1,688,825 lekë, ose në masën 1%.

Planifikimi i të ardhurave që do të realizohen nga burimet e veta gjatë vitit 2019 për mbulimin e shpenzimeve buxhetore, në hartimin e buxhetit është llogaritur në vlerën 147,788 mijë lekë, e cila është një vlerë jo reale, tre herë më e madhe se vlera e të ardhurave të realizuara në vitin paraardhës 2017 dhe 2018, ndërkohë që neni 5 i ligjit nr. 68/2017 për financat e vetëqeverisjes vendore, përcakton se në hartimin e buxhetit vjetor duhet bazuar në të ardhurat dhe shpenzimet faktike të viteve të mëparshëm. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, neni nr.52 -Kryerja e shpenzimeve, ligjin nr. 68/2017 për financat e vetëqeverisjes vendore, pika (a) neni 5.

(Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 2 faqe 23-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Tropojë dhe Drejtoria Ekonomike të marrin masa që në hartimin e projektbuxheteve afatmesëm dhe buxhetit vjetor, të planifikojnë fonde për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe pastaj të programojnë shpenzimet për vitin buxhetor. Planifikimi i të ardhurave të mos rritet artificialisht për të justifikuar marrjen e shpenzimeve, të cilat në fund të vitit nuk likuidohen për mungesë fondesh, por të ky planifikim të bëhet mbështetur në burimet reale të pritshme dhe duke marrë në konsideratë realizimin e tyre në vitet e fundit.

Në hartimin e PBA dhe buxhetit të vitit 2022

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua mospërputhje në vlerën e detyrimeve të prapambetura në pasqyrat financiare me atë të raportuar në MFE, duke u raportuar më pak detyrime në MFE, se vlera që paraqesin pasqyrat financiare, konkretisht një diferencë në vlerën 13,534,739 lekë më shumë në pasqyrat financiare të vitit 2019 dhe 45,841,455 lekë më shumë në pasqyrat financiare të vitit 2020. Në datën 31.12.2019 nga auditimi i pasqyrave financiare vlera e detyrimeve të prapambetura është 123,151,017 lekë (llogaria 401-408 - Furnitorë e llogari te lidhura me to në vlerën 110,112,904 lekë dhe llogaria 467 -Kreditore te ndryshëm në vlerën 13,038,113 lekë). Të gjitha këto detyrime kanë si shkak marrjen e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, pasi duhej të mbuloheshin nga të ardhurat e veta. Për vitin 2020 vlera e detyrimeve të prapambetura të raportuar në pasqyrat financiare është 121,462,192 lekë (llogaria 401-408 -Furnitorë e llogari te lidhura me to në vlerën 108,423,719 lekë dhe llogarisë 467 -Kreditore te ndryshëm në vlerën 13,038,113 lekë). Konstatohet se gjatë vitit buxhetor nga njëra shlyhen në një masë të caktuar detyrime të prapambetura, nga ana tjetër merren angazhime buxhetore pa pasur fonde në dispozicion. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 *ËPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHö, i ndryshuar, neni 40 , neni 52, UMF nr. 5, datë 27.02.2014 ËPër shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaö i ndryshuar, UMFE nr.9, datë 20.03.2018 ËPër procedurat standarde të miratimit të buxhetitö, neni 101 dhe 106. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2 faqe 31-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

13.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Tropojë dhe Drejtoria Ekonomike, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës dhe mos të merren angazhime te reja buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, në mënyrë që të mos krijohen detyrime të reja në vijimësi, si dhe të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE.

Deri në 30.11.2021

13.2.Rekomandim Për detyrimet e prapambetura, të hartohet një grafik për likuidimin e tyre, duke zbatuar radhën e pagesave. Të paraqitet në mbledhjen e këshillit bashkiak një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara si dhe plani dhe grafiku për likuidimin e tyre.

Deri në 30.11.2021

14.Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria Ekonomike dhe Kryetari i Bashkisë Tropojë për të dy vitet 2019 dhe 2020 nuk janë zbatuar detyrimet ligjore për hartimin e raporteve periodike të monitorimit për zbatimit të buxhetit, duke mos u kryer konkretisht monitorimi të buxhetit për këtë periudhë si për të ardhurat edhe për shpenzimet. Kjo ka sjellë mos informimin e këshillit bashkiak për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për vitin buxhetor, si dhe mos marrjen e masave për korrigjimin e buxhetit gjatë vitit, gjë e cila ka qenë e nevojshme sidomos gjatë vitit 2019, ku është planifikuar një buxhet mbi bazën e të ardhurave të veta jashtë mundësisë reale të njësisë vendore, në vlerën 147,788 mijë lekë, tre herë më shumë se vlera e realizuar në vitet e fundit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenit 44 -Raporti vjetor, të ligjit nr. 139/2015 *ËPër vetëqeverisjen vendore, nenin 47 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 ËPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.*

(Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 2 faqe 30-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1.Rekomandim: Drejtoria Ekonomikedhe Kryetari i Bashkisë Tropojë, të marrë masa që brenda datës 31 mars të vitit buxhetor të hartohet raporti për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, i cili të paraqitet për njohje dhe informim në këshillin bashkiak. Gjithashtu të monitorohet ecuria e të ardhurave, duke vlerësuar rrisqet që mund të ndikojnë në mosrealizimin e vlerës së planifikuar dhe mbi bazën e tyre, brenda muajit qershor të propozojë këshillit bashkiak ndryshimet e nevojshme, me

qëllim që të korigjohet niveli i shpenzimeve, në varësi të mundësisë faktike të realizimit të të ardhurave, duke eliminuar kështu marrjen e angazhimeve buxhetore për shpenzimet, pa pasur fonde në dispozicion.

Në vijimësi

15.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për vitin 2019 dhe 2020 janë kryer veprime të shpeshta me para në dorë nëpërmjet arkës, si për pagesa edhe për arkëtime, mbi limitin e lejuar dhe në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi. Për vitin 2019 totali i arkëtimeve në arkë ka vlerën 8,407,429 lekë totali i pagesave 8,307,429 lekë, ndërsa për vitin 2020 totali i arkëtimeve 6,543,708 lekë, totali i pagesave 5,945,836 lekë. Pagesat nga arka janë kryer për ndihmën e menjëhershme (të emergjencës) dhe të shpërblimeve të lindjes, ndërsa arkëtimet në arkë janë kryesisht detyrimet e taksave e tarifave vendore nga bizneset dhe abonentët familjar, vërtetime të ndryshme, pagesat e kopsht/çerdhe, etj., të cilat e kalojnë vlerën një mijë lekë, për një pagesë të vetme, e cila është vlera e lejuar ligjore.

Derdhjet gjatë vitit nga arka në thesar kanë vlera nga 100 mijë deri në 500 mijë lekë, të cilat tregojnë se vlerat financiare të mbajtura në arkë janë mbi limitin e lejuar (i cili është deri në 50 mijë lekë).

Nuk është monitoruar arka nga nëpunësi zbatues, pasi procesverbalet për përcaktimin e gjendjes së vlerave financiare në arkë, janë hartuar nga arkëtari dhe specialisti i financës, por jo nga nëpunësi zbatues.

Për sa më sipër është vepruar në kundërshtim me pikat 63, 64 dhe 78, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 dhe për menaxhimin e aktiveve të njësisë së sektorit publik, të ndryshuar dhe VKM nr. 290, datë 14.6.1993 dhe për limitin e arkës në ndërmarrjet shtetërore, pika nr.3.

(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3 faqe 64-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Tropojë dhe Drejtori Ekonomik të marrin masa për disiplinimin e veprimeve me para në dorë nëpërmjet arkës. Për arkëtimet në arkë, të lejohen vetëm veprime me para në dorë për arkëtimin e të ardhurave në vlera më të vogla se 1000 lekë, ndërsa për pagesat vetëm në formën e paradhënies për udhëtime e dieta. Kryetari i Bashkisë të nxjerrë rregulla të shkruara për veprimet financiare më arkë, me të cilat duhet të njihet arkëtari dhe struktura e financës. Drejtori ekonomik të kryej monitorimin e gjendjes së arkës çdo muaj, duke hartuar procesverbal të përbashkët me arkëtarin.

Menjëherë

16.Gjetje nga auditimi: Bashkia Tropojë gjatë vitit 2019 ka shpenzuar për zërin ÷udhëtim e dieta vlerën 2,296,066 lekë, ndërsa për vitin 2020 ka shpenzuar vlerën 1,410,905 lekë. Edhe pse dërgimi me shërbim i punonjësit është i autorizohet nga Kryetari i Bashkisë dhe është përcaktuar koha e zgjatjes së shërbimit dhe qëllimi i tij, vlerat e mësipërme janë të konsiderueshme duke marrë parasysh se përafërsisht 45% e buxhetit total të bashkisë përbëhet nga shpenzimet për ndihmën ekonomike dhe paaftësinë e kufizuar.

U konstatua se në dy raste nuk janë shlyer detyrimet financiare për këtë zë shpenzimi, ndaj dy ish punonjëseve të Njësisë së Auditit të Brendshëm, përkatësisht vlera 47,120 lekë për znj. M. G. dhe vlerën 34,560 lekë për znj. M. B.. Të dy punonjëset kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Bashkinë Tropojë në datën 27.05.2020 dhe kanë dokumentacionin e plotë justifikues për përfitimin e vlerave të mësipërme, të cilat i përkasin vitit 2019. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3 faqe 84-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

16.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë duhet të disiplinoj nivelin e shpenzimit për zërin ÷udhëtim e dieta, duke mos nënvlerësuar nevojën e marrjes pjesë në trajnime, apo takime të tjera zyrtare, të nevojshme. Disiplina financiare për këtë zë nuk duhet të ndiqet vetëm për periudhën e pandemisë, por edhe pas saj, duke ruajtur një ekuilibër të përshtatshëm midis nevojave që ka bashkia për udhëtim e dieta me buxhetin që ka në dispozicion dhe nevojat për shpenzim e tjera prioritare. Drejtorja Ekonomike të marrë masa, duke respektuar

legjislacionin në fuqi, për shlyerjen e detyrimit prej 47,120 lekë për ish punonjësen M. G. dhe vlerën 34,560 lekë për ish punonjësen M. B..

Deri në 30.11.2021

17. Gjetje nga auditimi: Për disa tregues të të ardhurave, megjithëse janë miratuar nga Këshilli Bashkiak në paketën fiskale, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka planifikuar dhe pasqyruar të ardhura, ndërsa ka evidentuar planin me 0 (zero), për pasojë edhe realizimi është me 0 (zero) konkretisht sa më poshtë;

-Tarifë për depozitim të inerteve, me programimin nivelin me 0 (zero).

-Për qytetarët, me programimin nivelin me 0 (zero).

-Për operatorët ekonomik, me programimin nivelin me 0 (zero).

-Tarifa për linjat ajrore e nëntokësore, me programimin nivelin me 0 (zero).

-Për shërbime në fushën transporti.

-Për shërbime transporti, me programimin nivelin me 0 (zero).

-Të tjera, me programimin nivelin me 0 (zero).

-Nga të ardhura jo tatimore, me programimin nivelin me 0 (zero): -10 tregues të kësaj tarife, me programimin nivelin me 0 (zero).

Në këto kushte, shkaqet dhe arsyt në mos realizimin e të ardhurave nga zbatimi i nivelit të taksave e tarifave vendore e gjykojmë se mund të ketë ndikim në:

- mos planifikimi i drejtë dhe mos përcaktimi i saktë i burimit të krijimit të të ardhurave.
- planifikimi pa argumentuar, duke marrë për bazë veçanërisht për tokën bujqësore të pa regjistruar në kadastër.
- largimi i banorëve dhe mospërdorimi i tokës bujqësore, si dhe mungesa e vullnetit për të paguar detyrimet nga kryefamiljarët, pavarësisht përpjekjeve të bëra nga inspektorët e terrenit.
- planifikimi i pa argumentuar duke marrë për bazë familjet sipas gjendjes civile dhe jo familjet.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 139/2015 *ËPër vetëqeverisjen vendore*, neni 34. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 39-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

17.1. Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për të planifikuar dhe realizuar të ardhurat vendore, sipas zërave të përcaktuar në paketën fiskale të të miratuar nga Këshilli Bashkiak, duke organizuar edhe mënyrën e vjeljes së secilës taksë.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2019 ka pasur mosrealizim të planit të përgjithshëm të të ardhurave në masën 65.5 %, ose 96,851 mijë lekë më pak se planifikimi, ndërsa për vitin 2020 me një mosrealizim 14.6%, ose 8,017 mijë lekë. Plani i vitit 2020 është më pak se plani i vitit 2019 për 92,788 mijë lekë ose 2.7 herë më i vogël se plani i vitit 2019.

Të dhënat e mësipërme flasin për një planifikim jo të drejtë të të ardhurave për vitin 2019. Planifikimi i të ardhurave për këtë vit tej kapaciteteve arkëtuese të bashkisë në masën 2.7 herë më shumë, ka ndikuar në mosrealizimin e financimit të investimeve me burim të ardhurat e veta për këtë vit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 139/2015 *ËPër vetëqeverisjen vendore*, neni 34. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 40-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

18.1. Rekomandimi: Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të merren masa për një planifikim sa më real të të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, duke u mbështetur në realizimet faktike të tyre në tre vitet e fundit, në burimet e reja që mund të krijohen, mundësitë për arkëtim, si dhe duke vlerësuar rrisqet që cenojnë realizimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi.

19. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Tropojë nuk ka strukture organike për menaxhimin e borxhit të taksave dhe tarifave vendore, e cila në bashkëpunim me Sektorin Juridik duhet të ndjekë arkëtimin e debitorëve, duke mos zbatuar kërkesat e ligjit nr. 139/2015, òPër vetëqeverisjen vendore, neni 9, òTë drejtat dhe përgjegjësitë, pika 1/1.1/c.

Në paketën fiskale të miratuara me VKB nr. 176, datë 23.11.2018 dhe VKB nr. 40, datë 20.12.2019, është përcaktuar se “...Taksat/tarifat për familjet shlyhet në bazë vjetore dhe mblihet nga administratorët e çdo njësie...”. Në këtë mënyrë Bashkia Tropojë e ka deleguar përgjegjësinë e vjeljes të taksës së tokës në Njësitë Administrative. Familjarët njoftohen nga Bashkia Tropojë për detyrimet.

Për kategorinë e taksapaguesve privat është krijuar në mënyrë manuale dhe elektronike në formatin Excel regjistri për taksat dhe tarifave vendore, por mungon ky rregjistër, si manualisht edhe elektronikisht për kategorinë e taksapaguesve familjar.

Nuk ka të dhëna për sipërfaqen e ndërtesave përkatëse, sipërfaqen e tokave për çdo familje, dhe nuk është bashkëpunuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Kadastrës, lidhur me marrjen e të dhënave të nevojshme. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 41-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

19.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Tropojë të marrë masa për ngritjen e strukturës për menaxhimin e borxhit lidhur me detyrimet që taksapaguesit kanë për taksat dhe tarifave vendore.

19.2. Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për krijimin e regjistrit të taksave për kategorinë e taksapaguesve familjar, duke evidentuar të gjitha të dhënat e nevojshme si sipërfaqen e ndërtesave, sipërfaqen e tokës bujqësore, truall etj. Për këtë të bashkëpunojë me organet të tjera shtetërore që disponojnë këto të dhëna, si Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë etj., lidhur me marrjen e të dhënave të nevojshme.

Menjëherë dhe në vijimësi.

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave rezultuan 24 debitorë privat pa NIPT, për të cilat është llogaritur detyrimi në shumën 2,356,275 lekë, por nuk është realizuar pagesë prej tyre. Nga Bashkia Tropojë nuk u paraqitën dokumente për marrjen e veprimeve të mëtejshme për këto subjekte. Konstatohet se Struktura Vendore e Apelit Tatimor, ka kërkuar nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të konfirmohet për detyrimet apo arkëtimet faktike sipas regjistrit të ardhurave, për subjektet të cilët pretendojnë se i kanë shlyer detyrimet e taksave e tarifave vendore, por Sektori i Taksave nuk ka kthyer përgjigje për këtë qëllim. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 40, òRegjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jo tregtarë, pikat 1 dhe 5, detyrën funksionale të Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 46-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

20.1 Rekomandim: Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të analizohen debitorët pa NIPT, të cilët nuk kanë shlyer detyrimet në shumën 2,356,275 lekë, si dhe të merren masa për regjistrimin e tyre në QKB në bashkëpunim me DRT Tropojë.

Të jepen sqarimet e duhura të kërkuara nga Struktura Vendore e Apelit Tatimor lidhur me gjendjen e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore.

Deri më 30.11.2021 e në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosjen fizike për subjektet që kryejnë aktivitet tregtim me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse në përdorim nga konsumatorët fundorë dhe tregtim të naftës bruto e nënproduktet e saj e lëndë djegëse të pajisur, apo

rifreskimme (licencë/autorizime), u konstatua se për të ardhurat e planifikuara nga zbatimi i nivelit të tarifës për pajisje, apo rifreskimin me (licencë/autorizime), këshilli bashkiak ka miratuar në paketën fiskale për periudhat ushtrimore vitet 2019 dhe 2020, òDhënie dhe përsëritje e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet dhe vajra lubrifikantë, me nivel tarifë: viti 2019 vlera 2,000,000 lekë dhe viti 2020 vlera 1,000,000 lekë. òDhënie dhe përsëritje e licencave për njësite e shitjes së lëndëve djegëse, për veprimtarin e tregtimit për përdorim nga konsumatorët fundor me nivel tarife për 100,000 lekë në çdo vit.

Ky nivel tarife i parashikuar dhe miratuar me VKB nr. 176, datë 23.11.2018 dhe VKB nr. 40, datë 20.12.2019, për të ardhurat që do realizohen nga zbatimi nivelit të tarifës për pajisje, apo rifreskim me (Autorizim/Licencë), nuk është në përputhje me kriteret e parashikuara në VKM nr. 970, datë 02.12.2015. Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajë, i ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.04.2017, pasi nuk është parashikuar afati i autorizimit si edhe rinovimi për 5 vite mbi të cilën duhet të planifikohet dhe përlllogaritet e ardhura vendore nga ky nivel tarife. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 50-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

21.1. Rekomandimi: Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që në rastet e lëshimit apo rinovimit të licencave/autorizimeve për subjektet që kryejnë aktivitet tregtim me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës bruto e nënproduktet e saj, të përcaktojë në këtë dokument afatin 5-vjecar të vlefshmërisë. Për ndjekjen në vijimësi të subjekteve, të krijohet rregjister për këtë qëllim, ku të evidentohet data e lëshimit të licencës, data e rinovimit etj.

Deri në 30.11.2021

22.Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave të regjistrimit të realizimit të prokurimeve për periudhën 01.01.2019 ó 31.12.2020, u konstatua se nga 17 procedura prokurimi të vlerësuara për auditim, me vlerë të lidhjes së kontratës 588,555,120 lekë, janë konstatuar me shkelje të aktive ligjore e nënligjore në fuqi, 16 procedura, me vlerë kontrate 579 milion lekë ose 98% e vlerës së audituar. Këto shkelje e mangësi rezultojnë në mos argumentimin e kriterëve të veçanta për kualifikim, vendosjen e tyre jo në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit dhe grafikun e punimeve. Vendosja e kriterëve në mënyrë të tillë ka sjellë një pjesëmarrje të ulët të OE në procedurat e prokurimit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1 òObjekti dhe qëllimi, pika 2 e nenit 2 òParimet e përzgjedhjes, pika 1, e nenit 46, të ligjit nr. 9643, datë 20.01.2006, ndryshuar si dhe me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, Seksioni II, òInformacione të veçanta për kontratat, neni 26 òKontratat për punë publike, pika 7 dhe Kreu VII, òZyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave, neni 61, òHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit, pika 2, paragrafi 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 88-170 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

22.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Tropojë të analizojë situatën e të nxjerrë përgjegjësitë për përcaktimet e gabuara të kriterëve të veçanta për kualifikim dhe të marrë masa që përcaktimi e kriterëve për kualifikim të jetë në lidhje të ngushtë me objektin e procedurës së prokurimit.

Menjëherë

23.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit publik rezultoi se operatorët ekonomikë janë shpallur fitues edhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DST, të miratuara nga Autoriteti Kontraktor dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, òPër prokurimin publik ndryshuar dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij, duke sjellë shpalljen e fituesit të procedurës së prokurimit në mënyrë të paligjshme, për vlerë kontrate pa TVSh 518,815,711 lekë.

Kjo anoM. për vitin 2019 është konstatuar në 10 procedura prokurimit me shumë të fondit limit 99,338,203 lekë, konkretisht:

- Rikonstruksion rrugë lagjeje õ28 Gushtiõ, B.Curri, me fond limit 17,225,606 lekë;
- Rikonstruksion i kanaleve vaditëse bashkia Tropojë, me fond limit 4,026,501 lekë;
- Sistemime lagje õPartizaniõ, B. Curri, me fond limit 11,221,024 lekë;
- Rikonstruksion rrugë lagjeje õDardaniaõ, Bajram Curri, me fond limit 16,347,126 lekë;
- Rikonstruksion rruga auto Lekbibaj ó Curraj Eper, me fond limit 6,666,667 lekë;
- Punime ndërtimore shkolla e fshatit Shoshan dhe Margegaj, NJA Margegaj; Buçaj, Aste dhe Kovaç, Nj. Ad. Tropojë Fshat, me fond limit 2,032,082 lekë;
- Rikonstruksion i shkollës Tinka Kurti, Lekbibaj, me fond limit 24,879,202 lekë;
- Sistemime Fshati Margegaj, NJA Margegaj dhe qyteti Fierzë, NJA Fierzë, me fond limit 2,823,771 lekë;
- Ndërtim i rrjetit shpërndarës të ujësjellësit të fshatit Kasaj, Tropojë, me fond limit 9,927,191 lekë;
- Ndërtim Ura, NJA Bujan; Fshati Vrane, NJA Lekbibaj, Fshati Bukovë, NJA Llugaj; -Lagje Iberhasaj, NJA Tropojë Fshat, me fond limit 4,189,033 lekë;

Kjo anoM. për vitin 2020 është konstatuar në 3 procedura prokurimit me shumë të fondit limit 419,477,508 lekë, konkretisht:

- Rikonstruksion i 5 Segmenteve Rrugore fshati Gri, Bujan, Cërrnicë, me fond limit 343,905,073 lekë.
- Rikonstruksion i kompleksit sportiv të lojërave me dorë, me fond limit 17,814,500 lekë.
- Ujësjiellësi i fshatit Dragobi, me fond limit 57,757,935 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 88-170 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

23.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Tropojë të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST. Të merren masa për eliminimin këtyre praktikave në të ardhmen.

Menjëherë

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Shkolla Asim Vokshi-Palestër dhe terrene sportive dhe sistemime të jashtme "Asim Vokshi, Bashkia Tropojë, u konstatua se situacioni pjesor progresiv, ishte i pashoqëruara me librezë masash pjesore, veprim i cili është në kundërshtim Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005 õPër zbatimin e punimeve të ndërtimitõ Kreu II, pika 8.1; "Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori" dhe Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave õPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitõ, pika 3.3. Në dosjen teknike administrohet vetëm librezë e masave përfundimtare e cila korrespondon me situacionin përfundimtar. Nga verifikimi në terren i palestrës dhe i sistemimeve të territorit, u konstatuan disa defekte në punimet e parketit dhe të shtresave të pllakave granili me bojë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4.4 faqe 173-175 Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

24.1. Rekomandim: Nga Bashkia Tropojë në të ardhmen të marren masa që kontratat e punimeve civile, situacionet pjesore të shoqërohen me librezë masash, në mënyrë që pagesat të argumentohen mbi bazën e volumeve të llogaritura.

24.2. Rekomandim: Bashkia Tropojë të marrë masa për korrigjimet e defekteve në punimet e parketit dhe të shtesave të pllakave granili me bojë, në fazën garancisë së punimeve nga sipërmarrësi, sipas përcaktimeve ligjore të kontratës së punimeve.

Menjëherë

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i aplikimeve për leje ndërtimi, u konstatua se janë dhënë leje ndërtimi në mos përmbushje të kriterëve të përcaktuara në ligj dhe më konkretisht: 1-Leja e zhvillimit nr.14, datë 14.12.2018 dhe leja e ndërtimit nr.1034/1 prot., datë 28.05.2019 me objekt: õPër ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m2 për objekt

banimi dhe shërbimi 6 kat + nënçati dhe 2 kat bodrumö, leje e cila është dhënë pa u kryer më parë oponenta teknike, kur vlera e investimit e kalon shumë prej 100,000,000 lekë.

2-Leja e zhvillimit nr.3883/2 prot., datë 22.02.2019 dhe leja e ndërtimit me nr.6, datë 22.07.2020, me objekt: òPër banim 2 kat mbi tokë dhe 1 kat nën tokë, një kat nënçati dhe mur rrethues, leje e cila është dhënë pa marrë më parë miratimin nga ZVRPP Tropojë se prona e përcaktuar për zhvillim është në pronësi të subjektit zhvillues. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.6 faqe 206-210 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

25.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Tropojë dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, të bashkërendojnë punën, të vlerësojnë dhe të marrin në konsideratë mendimet e autoriteteve publike kompetente gjatë aplikimit, duke verifikuar edhe vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur nga aplikantët, përpara miratimit të lejeve.

Në vijimësi

26.Gjetje nga auditimi: Në bazë të programit të auditimit nr. 1475/1, datë 31.12.2018 të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Bashkia Tropojë është audituar për periudhën nga data 01.01.2017 deri në datën 31.12.2018. Me shkresën nr. 1475/7 prot., datë 27.07.2019 është dërguar raporti përfundimtar i auditimit dhe rekomandimet. Zbatimi i rekomandimeve është audituar në bazë të programit të auditimit nr.1082 prot., datë 28.12.2019.

Në shkresën nr. 1082/48 prot., datë 05.06.2020, KLSH ka dërguar në Bashkisë Tropojë raportin përfundimtar të auditimit, në të cilin ka ri kërkuar zbatimin e rekomandimeve të cilat kanë qenë të pa zbatuara dhe në proces zbatimi.

Në këtë raport auditimi nga KLSH është konstatuar se nga 15 masa organizative të rekomanduara në vitin 2019, janë zbatuar plotësisht 2 masa, janë në proces zbatimi 7 masa dhe nuk janë zbatuar 6 masa, (pa zbatuar rekomandimet nr.1, 3,7,8,9 dhe 14).

- Nga auditimi aktual u konstatua se nga 13 masat organizative të ri kërkuara për zbatim (7 masave të cilat kanë qenë në proces zbatimi dhe 6 masave të pa zbatuara), është zbatuar plotësisht një masë, pa zbatuar pesë masa, janë në proces zbatimi 7 masa.

- Nga 6 masa për shpërblim dëmi në vlerën **11,473,160 lekë**, është zbatuara një masë në vlerën 1,240,388 lekë, pa zbatuar një masë dhe në proces zbatimi katër masa, por pa finalizuar arkëtim. Si përfundim vlera e pa arkëtuar është **10,232,772 lekë**.

-Nga dy masa për mungesë të ardhurash, një prej tyre është e pa zbatuar, ndërsa një masë është në proces zbatimit.

-Nga tre masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike, është zbatuar një masë, pa zbatuar një masë dhe në proces zbatimi një masë.

-Në zbatim të kërkesës së KLSH për mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit publik, APP me vendimin nr. 66 data 28.10.2019 ka vendosur 7 masa dënim me gjobe për 7 persona në shumë 610,000 lekë. Bashkia Tropojë ka zbatuar katër masa në vlerën 340,000 lekë, një masë në vlerën 90,000 lekë është në proces gjyqësor, dy masa në shumë 180,000 lekë janë në proces zbatimi (është kryer vetëm njoftimi).

- KLSH i ka rekomanduar, Kryetarit të Bashkisë Tropojë, t'ia kërkojë Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes Territorit (IKMT), të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative me gjobë për 1 mbikëqyrës dhe 1 kolaudator punimesh. Nga auditimi kjo masë u konstatua e pa zbatuar.

- Nga 33 masa disiplinore të rekomanduara nga KLSH, rezultojnë e pa zbatuar masat disiplinore për një punonjës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.5 faqe 179-206 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

26.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Tropojë të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të marrë masa

të përshpejtuara për zbatimin e rekomandimeve që janë ende të pa zbatuara dhe në proces zbatimi.

Sektori juridik të ndjek të gjitha procedurat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës 10,232,772 lekë për shpërblim dëmi të lëna nga KLSH.

Në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *Ë*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit neni 15 germa (b) dhe (c) *óTë drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 *óKodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë*, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *óPër vetëqeverisjen vendore* dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *óPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*, **nga Titullari i Njësisë Publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **9,587,836lekë** si më poshtë:

1.Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurës me objekt *óShkolla Asim Vokshi ó Palestër dhe terrene sportive dhe sistemime të jashtme në gjimnazin óAsim Vokshió*, zhvilluar në vitin 2019, me fond limit 50,319,591 lekë pa TVSh, nga KVO është kualifikuar dhe propozuar për tu shpallur fitues OE *ó4.Mó ShPK*, me vlerën më të lartë të ofertës ekonomike prej 50,269,533 lekë pa TVSh, i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në DST dhe është ofertë më e lartë se vlera e ofertës së *só*kualifikuar padrejtësisht.

Nga KVO është *só*kualifikuar padrejtësisht oferta me vlerë 42,072,833 lekë pa TVSh, e paraqitur nga BOE *óH. 1.ó shpk & óSh.ó ShPK*, e cila ka një vlerë prej 8,196,700 lekë më të ulët se vlera e OE *ó4.Mó ShPK* të shpallur padrejtësisht fitues. Veprimet e mësipërme kanë shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **8,196,700 lekë**, si diferencë midis dy ofertave dhe janë kryer në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 *óPër prokurimin publikó*, i ndryshuar, neni 1 *óObjekti dhe qëllimió* pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 *óParimet e përzgjedhjesó* germa (a), (b) dhe (c), me nenin 46 *óKualifikimi i ofertuesveó*, nenin 53 *óShqyrtimi i ofertaveó* dhe nenin 55 *óKriteret e përcaktimit të ofertës fitueseó*.

(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4 faqe 110-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Tropojë, të analizojë shkaqet që kanë çuar në kualifikimin e padrejtë të OE *ó4.Mó ShPK*, dhe në *só*kualifikimin e padrejtë të BOE *óH. 1.ó ShPK& óSh.ó ShPK*, me ofertë më të ulët, veprime të cilat kanë shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 8,196,700 lekë. Të ndjek të gjitha procedurat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës **8,196,700 lekë**, në vlerë të barabartë prej 2,732,233 lekë nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave si vijon: z. R. I. me detyrë ish Drejtor Ekonomik, ndërprerë marrëdhëniet e punës, z. R. B. me detyrë ish Z/Kryetar i Bashkisë, ndërprerë marrëdhëniet e punës, z. Z. Ç., me detyrë ish Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse, ndërprerë marrëdhëniet e punës.

Deri më 31.12.2021

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *“Shkolla Asim Vokshi-Palestër dhe terrene sportive dhe sistemime të jashtme "Asim Vokshi*, Bashkia Tropojë, me vlerë të kontratës 59,441,140 lekë me TVSh, nga operatori ekonomik *ó4. M.ó ShPK*, rezultuan mbivendosje të proceseve të punimeve në zërin *óSuvatim me grafiatoó*,

e cila mbivendoset punimeve të veshjes së fasadës, për shkak të pasaktësisë së preventivit, në të cilën sipërmarrësi ka likuiduar më tepër sasinë prej 818 m² me çmimin 1,000 lekë/m², ku rezulton vlera prej **818,000 lekë pa TVSH është dëm ekonomik.**

(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4.4 faqe 173-177 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkia Tropojë të marrë masa duke ngritur grup pune të veçantë me specialistë të fushës, për të përcaktuar shkaqet që kanë çuar në pasaktësinë e preventivit dhe të kërkojë likuidimin e vlerës prej **818,000 lekë pa TVSh** nga operatori ekonomik 04. M.ö ShPK.

Deri më 30.11.2021

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Rikonstrukcion rrugë lagja 28 Gushti "Bajram Curri", me vlerë të kontratës 20,543,366 lekë me TVSH, nga operatori ekonomik 0F.ö ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të paargumentuara apo të pa justifikuara, në vlerën **573,136 lekë pa TVSH, dëm ekonomik**, në zërin e punës 0Shtresë me çakëll mbeturine kave t=20 cm, përhapur e ngjeshur me makineri".

(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4.4 faqe 177-179 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandim: Bashkia Tropojë të marrë masa, të ngrerë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, për të përcaktuar shkaqet që kanë çuar në pasaktësinë e preventivit dhe të kërkojë likuidimin e vlerës prej **573,136 lekë pa TVSh** nga operatori ekonomik 0F.ö ShPK.

Deri më 30.11.2021

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurës për leje ndërtimi u konstatua 1 leje zhvillimi dhe ndërtimi në kundërshtim me ligjin nr.107 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" të ndryshuar, nenet 34 dhe 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" si dhe në kundërshtim me ligjin nr.95/2018 datë 03.12.2018 0Për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" duke shkaktuar kështu diferenca në pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja në **vlerën 85,202 lekë, specifikuar** respektivisht për secilën leje si më poshtë:

*1-Leja e zhvillimit nr.14, datë 14.12.2018 dhe leja e ndërtimit nr. 6, datë 22.07.2020 me objekt: 0Për banim 2 kat mbi tokë dhe 1 kat nën tokë, një kat nënçati dhe mur rrethues me diferencë në Taksën e Ndikimit në Infrastrukturë të papaguar prej **85,202 lekë.***

Këto leje janë miratuar pasi është bërë pagesa dhe ngarkimi në sistemin e-leje të faturës për Taksën e Ndikimit në Infrastrukturë, një pagesë e keq llogaritur dhe në kundërshtim të plotë me ligjin nr.95/2018 datë 03.12.2018 0Për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore". *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.6 faqe 206-210 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Tropojë të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme ligjore, për arkëtimin vlerës **85,202 lekë**, si diferencë e papaguar për shkak të keq llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Deri më 30.11.2021

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosjen fizike për subjektet që kryejnë aktivitet tregtim me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse në përdorim nga konsumatorët

fundorë dhe tregtim të naftës bruto e nënproduktet e saj e lëndë djegëse të pajisur, apo rifreskimme (licencë/autorizime), rezultuan diferenca në pagesë me nivelin e tarifës sipas VKM nr. 344, datë 19.4.2017, òPër disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 970, datë 2.12.2015, të Këshillit të Ministrave, òPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajò, në shumën 1,000,000 lekë. Mos aplikim i saktë i tarifës për pajisje me autorizim, ka çuar në mungesë të ardhurash në shumën **5,940,000 lekë**, në kundërshtim me nenin 70 pika 3 òE drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimorò, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat tatimore në R.SHò, i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 53-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandim: Bashkia Tropojë, bazuar në nenin 70 pika 3 òE drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimorò, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat tatimore në R.SHò i ndryshuar, të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **5,940,000 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve.

Deri më 30.11.2021

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të administruar në regjistrat e realizimit të prokurimit publik për periudhën objekt auditimi, në lidhje me punët publike të realizuara në Bashkinë Tropojë nga OE të shpallur fitues në procedurat e prokurimit të cilët kanë lidhur kontrata për punë publike në territorin e Bashkisë Tropojë, rezulton se Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, në kundërshtim me VKB për miratimin e paketës fiskale Kap. òTarifat Vendoreò, Pika II.1, tabela (13), nuk ka përllogaritur e aplikuar nivelin e tarifës për òpastrimin, largimin e mbetjeve, ndriçimin, gjelbërimin dhe kanalizimeòme afatet nën/mbi 4 muaj) ku me 13 kontraktorë janë lidhur kontrata për punë publike me afat (ën 4/muaj, me 7 kontraktorë janë lidhur kontrata për punë publike me afat mbi 4/muaj, ndërsa përpara fillimit të punimeve në kantier këta kontraktorë nuk kanë aplikuar në QKB për hapje e vendit të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshëm nga selia (sipas vendndodhjes të objektit të kontratës), për pasojë edhe nuk janë ngarkuar me detyrime për nivelin e tarifave të pastrimit, largimin e mbetjeve, ndriçimin, gjelbërimin dhe kanalizime të miratuara me paketën fiskale. Në këto kushte si pasojë e mos programimit dhe mos aplikimit të nivelit të tarifës për këto kontrata investimi, si dhe mos likuidimi i detyrimit nga operatorët ekonomik në cilësinë e kontraktuesit, vlera prej **1,974,000 lekë konsiderohet e ardhur e munguar e pa planifikuar për buxhetin e Bashkisë Tropojë**. Për sa më sipër është vepruar në kundërshtim me neni 43, pika 1.1, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 53-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandim: Bashkia Tropojë, bazuar në nenin 72 të ligjit 9920, mënyrat alternative të vlerësimit të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë arkëtimin e vlerës prej **1,974,000lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme ligjore.

Deri më 30.11.2021

4. Gjetje nga auditimi: Detyrimet për taksat e tarifave vendore në fund të vitit 2020 paraqiten në vlerën **18,082,240 lekë** (e ardhur e munguar), e cila përbëhet:

- Taksa/tarifa vendore të **2012-2018 në shumën** 9,087,280 lekë;
- Taksa/tarifa vendore **2019 në shumën** 2,926,369 lekë;
- Taksa/tarifa vendore **2020 në shumën** 4,408,304 lekë;
- Institucione për taksa/tarifa **2019 në shumën** 234,480 lekë;
- Institucione për taksa/tarifa shtuar **2020 në shumën** 650,680 lekë;
- Taksë infrastrukture **2018 në shumën** 775,127 lekë.

Këto vlera kanë ardhur si rezultat i mos arkëtimit të detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 68-2017 *ËPër Financat e Vetëqeverisjes Vendore*; nenin 70 pika 3 *Ë drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimorë*, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *ËPër Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar; UMF nr. 26, datë 04.09.2008; UMF nr. 12, datë 04.04.2017, *ËPër Taksat Kombëtare*. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 43-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1.Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Tropojë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimore për debitorët dhe të ndiqen rrugët arkëtimit e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në vlerën **18,082,240 lekë**, si më poshtë vijon:

4.2.Rekomandim: T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare.

4.3.Rekomandim: Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurorese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme).

4.4.Rekomandim: Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të aplikohet llogaritja e gjobës në masën 0.06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më shumë se 365 ditë (gjobë).

4.5.Rekomandim: Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal.

4.6.Rekomandim: Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me 8 Njësitë Administrative, të evidentojë listat emërore të debitorëve në mënyrë elektronike dhe të printuar të njoftojë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/ tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit.

Deri më 31.12.2021

5.Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Tropojë janë kryer pagesa për rastet e emergjencave nga fatkeqësitë natyrore për familjet të cilëve u janë dëmtuar shtëpitë. Për vitin 2019 janë dhënë ndihma të menjëhershme për 71 familje në vlerën 3,950,000 lekë, kryesisht emergjenca të krijuara nga stuhi dhe në tre raste dëmtim nga zjarri. Për vitin 2020 u konstatuan 7 raste ndihma për fatkeqësitë natyrore në vlerën 800,000 lekë.

Nga auditimi i dosjeve të personave përfitues të ndihmës së emergjencës, u konstatua se në një rast, për z. Arif Kortuçi, edhe pse fondi i përfituar prej tij për dëmtim e çatisë së shtëpisë në vlerën 90,000 lekë është miratuar me vendimin e këshillit bashkiak nr.21, datë 30.09.2019, mungon dokumentacioni i nevojshëm për argumentimin e dëmtimit të çatisë së shtëpisë. Vlera e përfituar prej 90,000 lekë konsiderohet përdorim i fondeve publike pa ekonomikitet dhe efikasitet.

Për sa më është në kundërshtim me shkronjën (f) e pikës 2, të VKM nr. 329, datë 16.05.2012 *ËPër kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore dhe udhëzimin e Ministrisë së Brendshme nr. 1185/1, datë 18.7.2007 ËKriteret, rregullat dhe procedurat e përdorimit të fondit të emergjencave civile planifikuar në buxhetin vjetor të Ministrisë së Brendshme*, si dhe të donacioneve që jepen si ndihmë në raste të emergjencave civile, pika 1, shkronja (c).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 86-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Tropojë të marrë masa që në rastet e fatkeqësive natyrore të cilat shkaktojnë dëmtime të pronës së qytetarëve, të akordohen fonde për ndihmë, vetëm për ata persona të cilët kanë dokumentacionin përkatës sipas kriterëve të përcaktuara ligjore.

Menjëherë

D. MASA ADMINISTRATIVE

I. Referuar parregullsive dhe shkeljeve të konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 òPër kundërvajtjet administrativeò, si dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, òPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, apo rekomandimin Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore) ndaj **9 personave**, për shkeljet në procedurat e prokurimit si më poshtë:

a) *Për tre anëtarët e njësisë së prokurimit (hartues të dokumenteve standarde të tenderit):*

1. **Z.K. B.**, me detyrë drejtor i drejtorisë së pyjeve, kullotave dhe bujqësisë;

2. **Z.H. I.**, me detyrë drejtor i drejtorisë së planifikimit dhe zhvillimit të teritorit

3. **Z.B. B.**, me detyrë teknik ndërtimi për emergjencat civile, për shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit me objekt: **Rikonstruksion i 5 segmenteve rrugore fshati Gri, Bujan, Cërrnicë**", me fond limit 343,905,073 lekë, zhvilluar në datën 23.11.2020.

Kjo procedurë prokurimi është zhvilluar pa u kryer më parë opoenca teknike për projektin e ndërtimit, nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, në kundërshtim me ligjin nr. 3/2020 òPër disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, òPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò, të ndryshuar, neni 6.

Kriteret e veçanta për kualifikim të vendosura në DST nuk janë argumentuar në kundërshtim me kreun VII, òZyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i proceduraveò, neni 61, òHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitò, pika 2, paragrafi 2, si dhe këto kritere nuk kanë lidhje të ngushtë më objektin e prokurimit (*Shih trajtimin në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga faqja 130-148*)

b) *Për 6 anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), si vijon:*

1. **Z.M. V.**, me detyrë teknik ndërtimi,

2. **Z.P. R.**, me detyrë punonjës i sektorit të shërbimeve,

3. **Z.Sh. D.**, me detyrë punonjës i sektorit të shërbimeve, për shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit, me objekt: òRikonstruksion i 5 segmenteve rrugore fshati Gri, Bujan, Cërrnicë", me fond limit 343,905,073 lekë, zhvilluar në vitin 2020. Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 2 ofertues, nga të cilët njëri me ofertë 0 lekë. Anëtarët e KVO kanë kualifikuar dhe shpallur fitues BOE òF.ò ShPK & ò4. M.ò ShPK & òV.ò ShPK, i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në dokumentet standarde të tenderit, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 24 òAnulimi i një procedure prokurimiò, pika nr. 1, germa (ç), neni 46 òKualifikimi i ofertuesveò, pika 1, nenin 53 òShqyrtimi i ofertaveò, pika 3.

(*Shih trajtimin në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga faqja 130-148*)

4. **Z. R. B.**, me detyrë ish z/kryetar i bashkisë Tropojë,

5. **Z. Z. Ç.**, me detyrë ish drejtor i shërbimeve mbështetëse,

6. **Z. R. I.**, me detyrë ish drejtor ekonomik, për shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit publik me objekt:

- Rikonstruksion rrugë lagjeje ò28 Gushtiò, Bajram Curri;

- Rikonstruksion i kanaleve vaditëse bashkia Tropojë;

- Sistemime Lagje òPartizaniò, Bajram Curri;

- Rikonstruksion rrugë lagjeje òDardaniaò, Bajram Curri;

- Rikonstruksion rruga auto Lekbibaj ó Curraj Eper;

- Shkolla Asim Vokshi ó palestër dhe terrene sportive dhe sistemime të jashtme në gjimnazin óAsim Vokshió;
- Punime ndërtimore shkolla e fshatit Shoshan dhe Margegaj, Njësia Administrative Margegaj, Buçaj, Aste dhe Kovaç, Njësia Administrative Tropojë Fshat;
- Rikonstruksion i shkollës óTinka Kurtiö, Lekbibaj;
- Sistemime Fshati Margegaj, Njësia Administrative Margegaj dhe qyteti Fierzë, Njësia Administrative Fierzë;
- Ndërtim i rrjetit shpërndarës të ujësjellësit të fshatit Kasaj, Tropojë;
- Ndërtim Ura, Njësia Administrative Bujan, Fshati Vrane, Njësia Administrative Lekbibaj; Fshati Bukovë, Njësia Administrative Llugaj, Lagje Iberhasaj, Njësia Administrative Tropojë Fshat.

Nga tre anëtarët e mësipërm të KVO, në procedurat e mësipërme janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet standarde të tenderit, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 óPër prokurimin publikö, i ndryshuar, neni 24 óAnulimi i një procedure prokurimiö, pika nr. 1, germa (ç), neni 46 óKualifikimi i ofertuesveö, pika 1, neni 53 óShqyrtimi i ofertaveö.

(Shih trajtimin në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga faqja 94-129)

II. Për përjashtim nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik

Bazuar në nenin 13, pika 3/a, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, óPër prokurimin publikö, i ndryshuar dhe neni 15 shkronja (c dhe ç), neni 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, óPër Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitö, i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, përjashtimin nga procedurat e prokurimit publik të tre operatorëve ekonomik: **“4.M” ShPK, “V.” ShPK dhe “Sh.A.” ShPK**për shkeljet e mëposhtme:

- OE ó4.Mö ShPK dhe OE óV.ö ShPK, për shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit publik me objekt *óRikonstruksion i 5 segmenteve rrugore fshati Gri, Bujan, Cërrnicë”*, me fond limit 343,905,073 lekë, zhvilluar në vitin 2020, në të cilën në dokumentacionin e paraqitur nga dy operatorët ekonomik rezultoi se:

Në DST është kërkuar: Deklaratë mbi kontratat e lidhur apo në proces, sipas Shtojcës 11.

Për plotësimin e këtij kriteri, **OE “4.M” ShPK**, ka paraqitur deklaratën mbi punimet e tij në proces. Ndërkohë ky OE nuk ka paraqitur edhe punë të tjera në proces të deklaruara po në këtë procedurë nga anëtari tjetër i BOE óF.ö ShPK, i cili është në marrëveshje bashkëpunimi për kontrata të mëparshme me OE ó4.Mö ShPK. Konkretisht óOE óF.ö ShPK, ka paraqitur deklaratën e punëve në proces, ku ndër të tjera ka deklaruar dhe objektin óNdërtim i ujësjellësit fshati Dragobiö, ku ka marrë përsipër 20% të punimeve. Në këtë objekt, fituesi është BOE i përbërë nga OE ó4.Mö ShPK që ka marrë përsipër 80% të punimeve, ndërkohë që nuk e ka deklaruar këtë punë në proces në deklaratën e saj.

Gjithashtu OE ó4.Mö ShPK, nuk ka deklaruar edhe këto punë të tjera në proces dhe më konkretisht: Sipas buletinit nr. 35, datë 15.06.2020 të APP, nuk ka deklaruar kontratën e lidhur me bashkinë Kolonjë, buletinit nr. 85, datë 12.10.2020 të APP, nuk ka deklaruar kontratën e të lidhur me bashkinë Përmet, buletinit nr. 99, datë 09.11.2020 të APP, nuk ka deklaruar kontratën e lidhur me Posta Shqiptare sh.a.

Në DST është kërkuar: Deklaratë mbi kontratat e lidhur apo në proces, sipas Shtojcës 11.

Për plotësimin e këtij kriteri, **OE “V.” ShPK**, ka paraqitur deklaratën që nuk ka punime në proces dhe nuk ka paraqitur punën sipas buletinit nr. 99, datë 09.11.2020 të APP, me objekt óRikonstruksion i kanalit vaditës Ahmataj ó Sopot (vepra e marrjes), Bashkia Tropojëö, kontratë e lidhur me Bashkinë Tropojë.

-Në procedurën e prokurimit me objekt *“Rikonstruksion i kompleksit sportiv të lojërave me dorë, Bajram Curri”*, me fond limit 17,814,500 lekë, zhvilluar në vitin 2020, në DST është kërkuar: Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo në proces, sipas Shtojcës 11.

Në këtë shtojcë **OE “Sh.A.”** ka deklaruar 2 punë në proces por nuk ka deklaruar edhe kontratën sipas buletinit të APP nr. 77, datë 28.09.2020, sipas të cilit me datën 21.09.2020 ky operator së bashku me OE *“Ng Structures ShPK*, kanë lidhur kontratën me ARRSH, me objekt *“Masa inxhinierike për eliminimin e rrëshqitjeve, segmenti rrugor Qafë M. ó Fierzë, km 2.5 dhe për pikat e rrezikshme në km 24, km 25+400, 25+500ö*, për vlerën prej 22,351,116 lekë me TVSH. Kohëzgjatja e punimeve është 4 muaj, ndërkohë që ky operator nuk e ka deklaruar në shtojcën 11 këtë kontratë të lidhur.

Për sa më sipër KVO nuk ka konstatuar mosdeklarimet e mësipërme nga operatorët ekonomik, në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, *“Për prokurimin publikö*, i ndryshuar, neni 47, *“s-kualifikimi i ofertuesveö*, në të cilin kërkohet sa vijon: *“AK s-kualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme, për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në fazën e shpalljes së kontratës fituese. AK për çdo s-kualifikim raporton Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 13, pika 3 e këtij ligjiö*.

(Shih trajtimin në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga faqja 133-152 dhe 155-162)

E.MASA DISIPLINORE

I. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitö*, në zbatim të nenit 58, *“ölojet e masave disiplinoreö të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civilö*, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civilö dhe, neni 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendoreö*, **i rekomandojmë** Kryetarit së Bashkisë Tropojë, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për një punonjës, si më poshtë:

a-mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj për punonjësit e mëposhtëm:

1.Znj. F. D., me detyrë përgjegjëse e sektorit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2019, për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 *“Për sistemin e taksave vendoreö*, si mos krijimi i regjistrit të taksave dhe tarifave vendore për kategorinë e taksapaguesve familjarë, mos marrja e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, të cilët kanë ardhur në rritje, nga 12,363,530 lekë në 31.12.2018 në 15,776,710 lekë në datën 31.12.2019, për planifikimin e gabuar të të ardhurave nga burimet e veta në vlerën 147,788 mijë lekë, trefish i mundësive reale të të ardhurave në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017 *“Për financat e vetëqeverisjes vendoreö*, neni nr.5, etj.

b- Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet, për punonjësit e mëposhtëm:

1.Z. B. T. me detyrë drejtor ekonomik, për mos marrjen e masave për likuidimin e detyrimeve të prapambetura gjatë vitit 2020, në kundërshtim me ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëö*, neni 40, 52 - Kryerja e shpenzimeve, për anoM.të e konstatuara në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve të vitit 2020, si mos regjistrimi në kontabilitet i aktiveve të dhuruara në vlerën 9,788,944 lekë, mos shpjegimi i kriteret mbi bazën e të cilave janë vlerësuar aktivet për tu

nxjerrë jashtë përdorimit në vitin 2020, mos hartim i relacionit të vlerësimit të aktiveve, i cili duhet të shpjegojë procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për jashtë përdorimit etj., për anoM.të e konstatuara në hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2019 dhe 2020. Në procesin e vlerësimit të aktiveve është vepruar në kundërshtim me kërkesat e udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, pika 95; 102; 103; 104;105; 106, ligjit nr. 25/2018 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò etj.

II. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me status të parashikuar në ligje të veçanta.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 òPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, shkronjat òeò dhe òçò, të nenit 1, kreun IV dhe nenet 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 òKodi i Punës në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, **nenit 11 –Masat disiplinore, të kontratës individuale të punës, i rekomandojë Kryetarin të Bashkisë Tropojë**, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore si vijon:

a- vërejtje me paralajmërim për largim nga puna, për tre punonjës si më poshtë:

1. Z. P. M., me detyrë përgjegjës i financës dhe buxhetit, prej datës 12.06.2020 e në vijim, për anoM.të e konstatuara në procesin e inventarizimit të vitit 2020, si mos rregjistrimin e aktiveve të dhuruara në vlerën 9,788,944 lekë, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të aktiveve për dalje nga përdorimi për mos shpjegim të kriterëve mbi bazën të cilave janë vlerësuar aktivet për tu nxjerrë jashtë përdorimit në vitin 2020, mos hartim i relacionit të vlerësimit të aktiveve, i cili duhet të shpjegojë procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për jashtë përdorimit etj, për anoM.të e konstatuara në hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2020. Për sa më sipër është vepruar në kundërshtim me kërkesat e udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, pika 95; 102; 103; 104;105; 106, ligjit nr. 25/2018 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò.

2. Z. F. M. me detyrë këshilltar i kryetarit të bashkisë, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të aktiveve për dalje nga përdorimi për vitin 2019, për mos zbatim të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, pika 95; 102; 103; 104;105; 106. Gjatë kryerjes së kësaj detyre nuk janë shpjeguar kriterëve mbi bazën e të cilave janë vlerësuar aktivet për tu nxjerrë jashtë përdorimit në vitin 2020, nuk është hartuar relacioni i vlerësimit të aktiveve, i cili duhet të shpjegojë procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për jashtë përdorimit, etj.

3. Z. N. A., me detyrë përgjegjës i sektorit të taksave dhe tarifave vendore, për periudhën 21.02.2020 e në vazhdim, për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 òPër sistemin e taksave vendoreò, si mos krijimi i rregjistrimit të taksave dhe tarifave vendore për kategorinë e taksapaguesve familjarë, mos marrja e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, të cilët kanë ardhur në rritje, nga **15,776,710**lekë në 31.12.2019 në **18,082,240** lekë në 31.12.2020, etj.

F. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara ekzistojnë, pasi personat nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin emasës disiplinore.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte:

a-mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj për ish punonjësit e mëposhtëm:

1.Znj.V. B. me detyrë ish përgjegjëse e financës, pezulluar nga ushtrimi i detyrës me vendimin e ndërmjetëm nr.4, nr.44/3 prot., datë 09.01.2020 të komisionit disiplinor, ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 22.06.2020, me urdhrin nr.97/1, datë 12.06.2020. Gjatë vitit 2019 nuk janë marrë masa të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, si për likuidimin e të gjitha angazhimeve buxhetore të marra gjatë këtij viti, duke krijuar detyrime të reja, veprime në kundërshtim me detyrës funksionale të përcaktuar në rregulloren e brendshme të Bashkisë Tropojë.

Shënim: Për shtatë punonjësit që kanë bërë shkelje, mangësi apo të meta më të ulta se risku, nuk rekomandojnë masë disiplinore:

- 1. Z. H. S.**, me detyrë specialist i taksave dhe tarifave vendore per periudhën 01.01.2019-31.12.2020;
- 2. Znj. B. S.**, me detyrë specialiste finance, në cilësinë e anëtares së komisionit të vlerësimit të aktiveve për dalje nga përdorimi për vitin 2020;
- 3. Znj. Z. K. I.**, me detyrë n/kryetare bashkisë, në cilësinë e kryetares së komisionit të asgjësimit të aktiveve
- 4. Znj. E. H.**, me detyrë inspektore e pyjeve, në cilësinë e anëtares së komisionit të asgjësimit të aktiveve;
- 5. Z. E. M.**, me detyrë specialist për administrimin. e regjistrin të teritorit, në cilësinë e anëtarit të komisionit të asgjësimit të aktiveve;
- 6.Znj. V. D.**, me detyrë arkëtare.

G. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Tropojë pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

- Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 oPër Nëpunësin Civilo, indryshuar.
- Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 oPër Nëpunësin Civilo, indryshuar.

V.ANEKSE

Aneksi nr.1.Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit trajtuar nga faqja 11 deri në faqen 25 të raportit të auditimit.

Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2019, miratuar me VKB nr.187, datë 19.12.2018. Në 000/ lekë		
Nr	Planifikimi i burimit të të ardhurave	Vlera
1	Të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2019	132,788
2	Transfertë e pakushtëzuar	201,742

3	Transferte specifike	88,917
4	Të ardhurat totale	423,447
	Planifikimi i shpenzimeve	
1	Art. 600&601-Paga dhe sigurime	220,363
2	Art. 230&231 Investime	117,072
3	Art. 602-Shpenzime operative	73,308
5	Shpenzime Shuma 1	410,743
6	Fondi rezervë nga granti	5,813
7	Fondi rezervë nga të ardhurat	2,656
8	Fondi kontigjencës nga granti	2907
9	Fondi kontigjencës nga të ardhurat	1,328
10	Fondi i emergjencës civile	0
11	Shpenzime Shuma 2	12,703
12	Total shpenzime Shuma 1+ Shuma 2	42,3447

Burimi Bashkia Tropojë

Aneksi nr.1/1.Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit trajtuar nga faqja 11 deri në faqen 25 të raportit të auditimit.

Nr	Miratimi i buxhetit shtese për alokimin e fondeve të trashëguara nga viti 2018, miratuar me VKB nr. 2, datë 22.01.2019 (shtesë në buxhetin fillestar të vitit2019) . Në 000/lekë	
1	Burimi i të ardhurave	Vlera
2	Të ardhura të trashëguara nga viti 2018	5,110
3	Të ardhura nga transfertat e pakushtëzuar	3,366
4	Të ardhura nga transfertat specifike	680
5	Të ardhurat totale	9,157
	Planifikimi i shpenzimeve me të ardhurat e mësipërme	
1	Për investime	6,476
2	Për paga	31
3	Artikulli 602 óShpenzime operative	2,650
4	Totali i shpenzimeve	9,157

Burimi Bashkia Tropojë

Aneksi nr.1/2.Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit trajtuar nga faqja 11 deri në faqen 25 të raportit të auditimit.

Nr	Burimi i të ardhurave të planifikuar për vitin 2019, miratuar me VKB nr. 15, datë 25.02.2019 (shtesë në buxhetin fillestar të vitit 2019)	Vlera në 000/lekë
	Të ardhurat	
1	Të ardhura nga tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave (lëndë drusore, shfrytëzim mineralesh, antena shërbimi, veprimtarinë turistike, arkëtime të prapambetura)	3,500
2	Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë	3,500
3	Total të ardhura shtesë	7,000
	Shpenzimet	
1	Investime për llogarinë 6330, për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjetës fshati Kasaj	7,000

Burimi Bashkia Tropojë

Aneksi nr.1/3.Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit trajtuar nga faqja 11 deri në faqen 25 të projektraportit të auditimit.

Llogaritja e fondit rezervë, kontigjencës dhe emergjencës. Në përputhje me pikën nr.6, neni 40, të ligjit nr. 139/2015 öPër vetëqeverisjen vendoreö, ku thuhet: öBuxheti vendor përfshin një fond rezervë dhe një fond kontigjence, të pashpërndarë, i cili miratohet nga këshilli bashkiak në buxhetin vjetor të bashkisë deri në masën 3 për qind të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, përjashtuar transfertat e kushtëzuaraö, nga Bashkia Tropojë është llogaritur fondi rezervë dhe kontigjencës në vlerën 10 551 450 lekë

(351,715,000 *3/100). Është parashikuar gjithashtu fondi i emergjencës civile në vlerën 3,517 mijë lekë, në masën 1.7% të buxhetit, (duke ju referuar llogaritjes mbi vlerën e transfertës së pakushtëzuar prej 206,870 mijë lekë).

Në VKB nr. 60, datë 30.12.2019 është miratuar për vitin 2020 fondi rezervë, i kontigjencës, si dhe fondi i emergjencës në total 14,068 mijë lekë, si vijon:

- fondi rezervë nga grandit në vlerën 5934 mijë lekë;
- fondi rezervë nga të ardhurat në vlerën 1100 mijë lekë;
- fondi kontigjencës nga granti në vlerën 2967 mijë lekë;
- fondi kontigjencës nga të ardhurat në vlerën 550 mijë;
- fondi i emergjencës civile në vlerën 3517 mijë lekë.

Përdorimi i të ardhurave për vitin 2019. Bazuar në aktin e rakordimit me thesarin për të ardhurat, rezulton se të ardhurat e realizuara nga burimet e veta të Bashkië Tropojë kanë vlerën 50,937 mijë lekë. Nga shpenzimet e kryera për vitin 2019, njësia vendore ka mbuluar me të ardhurat e veta, vlerën 47,695,924 lekë, ose 12% të shpenzimeve vjetore, pa përfshirë ndihmën ekonomike dhe PAK.

Nga vlera 47,695,924 lekë, të ardhurat e veta të përdorura për mbulimin e shpenzimeve gjatë vitit 2019, vlera 15,811,376 lekë është përdorur për paga, vlera 2,650,784 lekë për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, vlera 24,246,693 lekë për shpenzime operative, vlera 4,616,071 lekë për investime.

Përdorimi i të ardhurave për vitin 2020. Bazuar në aktin e rakordimit me thesarin për të ardhurat, rezulton se të ardhurat e realizuara nga burimet e veta të Bashkisë Tropojë kanë vlerën 46,983,212 lekë. Gjithashtu njësia vendore ka trashëguar të ardhura nga burimet e veta edhe nga viti i mëparshëm 2019, vlerën 8,051,136. Pra në total, fondet që ka pasur në dispozicion nga të ardhurat e veta për vitin 2020 kanë vlerën 55,034,348 lekë. Nga shpenzimet e kryera për vitin 2020, njësia vendore ka mbuluar me të ardhurat e veta, vlerën 14,341,141 lekë, ose 4% të shpenzimeve vjetore, pa përfshirë ndihmën ekonomike dhe PAK. (14,341,141/332,091,750*100).

Nga vlera 14,341,141 lekë, të ardhurat e veta të përdorura për mbulimin e shpenzimeve gjatë vitit 2020, vlera 2,042,402 lekë është përdorur për paga, vlera 600,000 lekë për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, vlera 4,061,701 lekë për shpenzime operative, vlera 7,637,038 lekë për investime. Pra nga 55,034,348 lekë në dispozicion, janë shpenzuar 14,341,141 lekë, ose në masën 26% të të ardhurave të veta në dispozicion.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

